Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Gjykata Supreme
Vrhovni Sud - Supreme Court

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE

Prishtinë, 2025

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ÇËSHTJE PENALE DHE CIVILE

Prishtinë 2025

Nëntor 2025

Shtypur në Prishtinë

Hartimi i materialit udhëzues: “Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në çështje penale dhe civile” është mundësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës , ndërkaq botimi nga Akademia e Drejtësisë.

PARATHËNIE

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, si autoriteti më i lartë gjyqësor, në përmbushje të mandatit të saj kushtetues dhe ligjor për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe sigurimin e zbatimit të qëndrueshëm të ligjit, për të tretin vit me radhë ka hartuar Përmbledhjen e Praktikës Gjyqësore.

Përmes kësaj përmbledhjeje synohet të kontribuohet në harmonizimin e praktikës gjyqësore dhe përmirësimin e cilësisë së vendimeve, duke rritur kështu efikasitetin, transparencën dhe besimin e qytetareve në sistemin gjyqësor, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Në kontekstin e zhvillimeve ligjore dhe shoqërore në Kosovë, Gjykata Supreme njeh sfidat me të cilat përballet sistemi gjyqësor, përfshirë edhe nevojën për interpretim të unifikuar të normave juridike materiale dhe procedurale. Andaj, komentet dhe analizat e përfshira në këtë botim të synojnë të ofrojnë udhëzime praktike për gjyqtarët dhe profesionistët e drejtësisë, duke i ndihmuar ata në interpretimin e saktë dhe unifikues të ligjit.

Ky botim trajton tema nga fusha penale dhe civile, si dhe një pjesë nga fusha administrative. Pjesa penale përfshin çështje që lidhen me mjetet juridike në procedurën penale, aspektet praktike të shqyrtimit fillestar, si dhe konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë. Pjesa civile fokusohet në të drejtën për gjykim të drejtë, parashkrimin, mbrojtjen e së drejtës së pronësisë, mbrojtjen gjyqësore në rastet e shpifjes, vlerën e objektit të kontestit, servitutet, si dhe zbatimin e ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Ndërsa pjesa administrative trajton kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së akteve normative dhe shqyrtimin incidental të akteve nënligjore.
Gjykata Supreme shpreh falënderimin e saj për të gjithë autorët dhe kontribuuesit që morën pjesë në përgatitjen e kësaj përmbledhjeje, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe kontributit të tyre në unifikimin e praktikës gjyqësore.

Fejzullah REXHEPI
Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje penale..... 18

Afrim Shala 19

Mjetet juridike në procedurën penale për të cilat është kompetente të vendosë Gjykata Supreme e Kosovës 19

1. Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale..... 19

2. Shqyrtime të përgjithshme dhe ndërkombëtare lidhur me ankesën . 20

2.1. Nocioni i ankesës 20

2.2. Llojet e ankesave..... 27

3. Ankesa sipas të drejtës ndërkombëtare 29

3.1. Shqyrtime të përgjithshme 29

3.2. Ankesa sipas rregullave të procedurës të disa gjykatave penale ndërkombëtare..... 33

3.2.1. Ankesa në procedurën penale pranë Tribunalit të Hagës..... 33

3.2.2. Ankesa në procedurën penale pranë Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare..... 36

4. Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë..... 38

4.1. Shqyrtime të përgjithshme 38

4.2. Plotësimi i ankesës..... 41

4.3. Përgjigja në ankesë..... 42

4.4. Vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike, si arsye për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë 47

4.5. Parimet "Reformatio in Peius" dhe "Beneficium Cohaesionis" 49

4.6. Të dhënat statistikore 51

5. Ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës..... 52

6. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë..... 53

6.1. Shqyrtime të përgjithshme 53
6.2. Të dhënat statistikore 58
6.2.1. Shqyrtime të përgjithshme 58
6.2.2. Mënyra e vendosjes në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilat janë paraqitur në lidhje me vendimet e formës së prerë, përkitazi me paraburgimin (caktim, vazhdim ose ndërprerje) 59
6.2.3. Mënyra e vendosjes në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilat janë paraqitur ndaj aktgjykimeve të formës së prerë 60
7. Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit 61
7.1. Shqyrtime të përgjithshme 61
7.2. Të dhënat statistikore 63
7.3. Pjesë të vendimeve gjyqësore 64
Përfundimet 73
I. Literatura 77
II. Publikime tjera 79
III. Akte juridike vendore dhe ndërkombëtare 79
IV. Praktika Gjyqësore 80

Agim Maliqi 81
Aspekte praktike të shqyrtimit fillestar sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale 81
1. Hyrja 81
1. Vështrime të përgjithshme të shqyrtimit fillestar 82
1.1. Shqyrtimi fillestar 82
2. Pranimi i fajësisë 89
2.1. Pranimi i fajësisë dhe shqiptimi i sanksionit penal gjatë shqyrtimit fillestar 97
3. Kundërshtimi i provave 107
3.1. Kërkesa për hudhjen e aktakuzës 109

3.2. Përgjigjet 110
3.3. Aktakuza e ndryshuar 111
3.4. Hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës 113
4. Aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor 115
4.1. Paraqitja e materialeve nga mbrojtja 116
Përfundimi 116
Literatura 118

Burim Ademi 119
Sekuestrimi dhe Konfiskimi i Pasurisë në Procedurën Penale 119
1. Hyrje 119
1. Sekuestrimi dhe konfiskimi 120
1.1. Standardi ligjor për sekuestrimin e pasurisë 121
2. Bazat për sekuestrim 123
2.1. Sekuestrimi i provave dhe pasurisë me rastin e bastisjes sipas urdhrit gjyqësor 124
2.2. Sekuestrimi i pasurisë pa urdhër gjyqësor 127
2.3. Sekuestrimi i pasurisë që identifikohet gjatë zbatimit të hetimit 127
2.3.1. Sendet që nuk mund të sekuestrohen përkohësisht 129
2.3.2. Urdhri për zbulimin e informacionit për hetimin për sekuestrim 130
3. Urdhri i përkohshëm i ndalimit 131
3.1. Kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar dhe kundërshtimet e kërkesës 134
3.2. Kundërshtimet ndaj kërkesës për urdhër ndalues përfundimtar 135
3.4. Nxjerrja dhe përmbajtja e urdhrit ndalues përfundimtar 136
3.5. Urdhri i përkohshëm ndalues për pasurinë shtesë të specifikuar 137
4. Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar 138
5. Konfiskimi 141
5.1. Procedura për konfiskim 142

5.2. Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit 143
5.3. Sfidat praktike në raport me sekuestrimin dhe konfiskimin 145
6. Raste praktike të vendosura nga Gjykata Supreme për sa i përket vendimmarrjes për konfiskimin..... 149

Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje civile..... 169

Rrustem Thaqi 170
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm në Ndërlidhje me të Drejtën për Proces të Rregullt Gjyqësor në Lëmin Civil 170
1. Shqyrtime të përgjithshme..... 170
2. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas dispozitave të Ligjit për Procedurës Kontestimore 175
3. Baza e referimit në jurisprudencën e GJEDNJ-së 184
4. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas praktikes së GJEDNJ-së ... 185
4.1. A duhet të arsyetohet secili vendim gjyqësor 186
4.2. A kërkohet sipas GJEDNJ-së që gjykatat të përgjigjen në secilin pretendim të paraqitur nga palët..... 187
4.3. A është e domosdoshme që arsyetimi i vendimeve gjyqësore të jetë i gjatë 188
4.4. Roli i gjyqtarit në dhënien e drejtësisë..... 188
4.5. Cilësia e vendimit gjyqësor si garanci e procesit të rregullt 189
5. Ndërlidhja mes vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe gjykimit brenda afatit të arsyeshëm 190
6. A ekzistojnë mjete juridike për procedura të tejzgjatura gjyqësore në sistemin e brendshëm juridik..... 192
7. E drejta e qasjes në gjykatë 194
8. E drejta për vendim të arsyetuar dhe vendimmarrja arbitrare 198
9. A ekzistojnë divergjenca në praktiken gjyqësore..... 200

10. Sa ndikon gjendja emocionale e gjyqtareve në cilësinë e vendimmarrjes 202
11. Të drejtat dhe detyrimet e gjykatave të rregullta në fushën e aplikimit të drejtpërdrejt të normave kushtetuese, si dhe parimet kryesore për interpretimin e KENDJ-së 203
12. Përmbarimi i aktgjykimeve dhe e drejta për gjykim të drejtë 205
13. Qasja dhe përdorimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së 210
14. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës 211
14.1. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës 213
Rrustem Thaqi 253
Parashkrimi, Rregullat e Përgjithshme, Afati, Ndalja dhe Ndërprerja e Parashkrimit në Marrëdhëniet e Detyrimeve 253
1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me parashkrimin 253
1.1. Rregullat e përgjithshme lidhur me parashkrimin 255
1.2. Kur fillon të rrjedhë parashkrimi 256
1.3. Krijimi i parashkrimit 258
1.4. Llogaritja e kohës së paraardhësve 258
1.5. Ndalimi i ndryshimit të afatit të parashkrimit 259
1.6. Heqja dorë nga parashkrimi 260
1.7. Njohja me shkrim dhe sigurimi i detyrimit të parashkruar 260
1.8. Efekti i përmbushjes së detyrimit të parashkruar 261
1.9. Kreditori, kërkesa e të cilit është e siguruar 262
1.10. Kërkesat aksesore 263
1.11. Kur nuk zbatohen rregullat për parashkrimin 264
2. Afati i Parashkrimit 265
2.1. Afati i përgjithshëm i parashkrimit 265
2.2. Kërkesat periodike 267

2.3. Parashkrimi i vet të drejtës 268
2.4. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale 269
2.5. Kërkesa e qirasë 269
2.6. Kërkesa e shpërblimit të demit 270
2.7. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale 271
2.8. Kompensimi i kërkesave për arsye të korrupsionit 273
2.9. Afati njëvjeçar i parashkrimit 273
2.10. Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente 276
2.11. Afatet e parashkrimit te kontratat për sigurimin 277
3. Ndalja e Parashkrimit 278
3.1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me ndaljen e parashkrimit 278
3.2. Kërkesat ndërmjet personave të caktuar 280
3.3. Kërkesat e personave të caktuar 282
3.4. Pengesat e papërballueshme 283
3.5. Ndikimi i shkaqeve të ndaljes në rrjedhën e parashkrimit 283
3.6. Kërkesat ndaj personave të paaftë për të vepruar dhe kërkesat e tyre 284
4. Ndërprerja e Parashkrimit 285
4.1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me ndërprerjen e parashkrimit 285
4.2. Pranimi i borxhit 286
4.3. Paraqitja e padisë 288
4.4. Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë 288
4.5. Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës 289
4.6. Thirrja e kreditorit 291
4.7. Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes 291
4.8. Parashkrimi në rastin e përtëritjes së detyrimit 292
5. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës 293
6. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës 295

Franciska Zhitija Ymeri.....322
E Drejta e Pronës dhe Mbrojtja Gjyqësore.....322
1. Shqyrtime të përgjithshme.....322
1.1. Komenti i shkurtër i dispozitave të cituara 324
1.3. Kufizimet e pronësisë..... 328
1.4. Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët..... 329
1.4.1. Komenti i shkurtër i dispozitave të cituara..... 330
2. Bashkëpronësia.....330
2.1. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve 330
2.3. Fitimi i bashkëpronësisë..... 331
2.4. Shuarja e bashkëpronësisë 332
3. Pronësia e Përbashkët.....333
3.1. Fitimi i pronësisë..... 335
4. Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë.....336
4.1. Shqyrtime të përgjithshme 336
4.2. Padit për mbrojtje gjyqësore 338
4.2.1. Padia Activo rei vindikatio..... 340
4.2.2. Padia Actio publiciana 345
4.2.3. Padia Actio Negatorio..... 346
5. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës..... 347
6. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës349
Lumni Sallauka.....361
Mbrojtja gjyqësore në rastet e shpifjes: Balanca ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtës për reputacion.....361
1.1. Vështrime të përgjithshme për lirinë e shprehjes..... 361
1.2. Kushtet për kufizimin e lirisë së shprehjes 362
1.3. Korniza kushtetuese dhe ligjore në Kosovë mbi shpifjen..... 363

2. Shpifja dhe figurat publike: Balanca ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtës për reputacion sipas GJEDNJ 369
3. Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet e shpifjes 374
3.1. Praktika e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në rastet e shpifjes 375
4. Të gjeturat nga praktika gjyqësore për raste e tilla 405

Zenel Leku 408
Vlera e objektit të kontestit në praktikën gjyqësore: rastet, mangësitë, pasojat juridike dhe sugjerime për unifikimin e praktikës 408
1. Hyrja 408
2. Baza ligjore 409
3. Roli i gjykatës së shkallës së parë në caktimin e vlerës së objektit të kontestit 410
3.1. Pasojat e mos caktimit ose caktimit në mënyrë jo të duhur të vlerës së objektit të kontestit 412
4. Të gjeturat nga praktika gjyqësore e gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese 416
5. Praktika gjyqësore dhe vlerësimet e Gjykatës Supreme për rastet e bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë 428
6. Vlerësime përfundimtarë dhe rekomandime për unifikim të praktikës gjyqësore lidhur me vlerën e objektit të kontestit 433

Nenad Lazić 436
Servitutet dhe mbrojtja gjyqësore e servituteve 436
1. Koncepti i servituteve 436
2. Servitutet personale 436

2.1. E drejta e frutgëzimit 437
2.2. E drejta e përdorimit 437
2.3. E drejta e banimit 437
3. Servitutet Sendore 438
3.1. Lindja, krijimi i servituteve sendore 438
4. Servitutet sendore kontraktuale 441
4.1. Servitutet sendore të lindura nga mirëmbajtja 441
4.2. Servitutet sendore të përcaktuara me vendim gjykate 442
4.3. Karakteristikat e servituteve sendore 443
5. Ndërprerja e servituteve sendore 449
6. Mbrojtja gjyqësore e servitutit 451
Ekstrakte nga praktika gjyqësore 452

Milena Djeric 456
Puna e gjykatave të instancave më të ulëta në lidhje me zbatimin adekuat të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, në lidhje me nulitetin dhe anulimin e kontratave 456
1. Kontratat nule 457
1.1. Pasojat e nulitetit 459
1.2. Nuliteti i pjesshëm 459
1.3. Konversioni 459
1.4. Shuarja e mëvonshme e shkaqeve të nulitetit 460
2. Kontrata e rrëzueshme 460
2.1. Pasojat e anulimit 461
2.2. Shuarja e së drejtës 462
3. Gjetjet nga praktika e Gjykatës Supreme 462

Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje administrative ... 472

Delushe Halimi 473
Kontrolli gjyqësor i ligjshmërisë së akteve normative dhe shqyrtimi incidental i akteve nënligjore 473
Kapitulli I: Korniza juridike për aktet normative të organeve publike 474
1.1. Përkufizimi dhe karakteri juridik i akteve normative 474
1.3. Procedura e nxjerrjes së akteve normative në organet publike 477
Nxjerrja e akteve normative dhe parimi i Ligjshmërisë në Republikën e Kosovës. 477
Në praktikën administrative në Kosovë, shpesh paraqiten vështirësi kur: 479
1.4. Ndalimi i arbitraritetit dhe parimi i ligjshmërisë - Ndalimi i arbitraritetit në veprimtarinë publike. 479
1.5. Publikimi dhe hyrja në fuqi e akteve normative 483
Pasojat e parregullsisë së publikimit të akteve normative 484
Kapitulli II: Procedura administrative në lidhje me aktet normative .. 486
2.1. Kompetencat e organeve administrative për nxjerrjen e akteve normative 486
Parimet që rregullojnë kompetencën 487
Tejkalimi i kompetencave nga institucionet publike në nxjerrjen e akteve normative 487
Mënyrat se si institucionet publike tejkalojnë kompetencat 488
Pasojat e tejkalimit të kompetencave 489
2.2. Procedurat paraprake dhe konsultative 490
Sigurimi i legjitimitetit të akteve normative. 490
Procedurat që sigurojnë legjitimitetin e akteve normative. 490
Përfitimet e këtyre procedurave 491
Standardet evropiane për aktet normative dhe roli i Komisionit të Venecias 492
Karakteristikat kryesore të një akti normativ vendor sipas standardeve evropiane 492
Përfitimet e respektimit të standardeve evropiane 493

2.3. Parimi i proporcionalitetit dhe administrata e drejtë-Përmbajtja dhe dimensionet e parimit të proporcionalitetit 494
Rëndësia e parimit të proporcionalitetit 495
2.4. Mjetet e kontrollit administrativ të brendshëm 496
2.5. Dallimi midis akteve normative dhe atyre individuale - Dallimi midis aktit normativ dhe aktit individual 496
Karakteristikat kryesore të aktit normativ 497
Karakteristikat kryesore të aktit individual 497
Sfida praktike dhe rastet e gabueshme 498
Rëndësia e dallimit aktit normative dhe aktit individual 498
Kapitulli III: Kompetenca e gjykatave në raport me aktet normative . 499
3.1. Ligji për konfliktet administrative – kuadri themelor 499
Ligji për konfliktet administrative (LKA) dhe roli i tij në garantimin e ligjshmërisë. 499
Qëllimi kryesor i LKA-së 499
Funksionet e Ligjit për konfliktet administrative 500
Rëndësia e LKA-së në praktikën administrative 500
Kompetenca e gjykatave sipas Ligjit për konfliktet administrative 501
Roli i gjykatave në sundimin e ligjit. 502
Ky mekanizëm ka një funksion të dyfishtë: 502
3.2. Kompetenca e gjykatës për kontrollin e akteve normative 503
Kompetenca e Gjykatës Supreme për shfuqizimin e akteve nënligjore normative. 503
Sigurimi i hierarkisë normative. 503
Efektiviteti i së drejtës në praktikë. 504
Sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike. 504
4. Krahasimi me juridiksione të tjera evropiane 507
5. Arsyetimi juridik për rëndësinë e kësaj risie ligjore- juridike 507
3.4. Lidhja ndërmjet kontrollit gjyqësor dhe kontrollit kushtetues 508
Dallimi ndërmjet kompetencës së Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në lidhje me aktet normative në Republikën e Kosovës 508
1. Gjykata Supreme – Kontrolli i ligjshmërisë së akteve normative 508

2. Gjykata Kushtetuese – Kontrolli i kushtetutshmërisë së akteve normative 509

3. Bashkëveprimi i Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në kontrollin e akteve normative..... 509

Kapitulli IV: Shqyrtimi incidental i akteve normative nënligjore.....510

4.1. Kuptimi dhe natyra juridike e shqyrtimit incidental 510

4.2. Procedura gjyqësore në shqyrtimin incidental 511

4.3. Efektet juridike të vendimit të gjykatës 512

4.4. Roli i jurisprudencës dhe unifikimi i praktikës gjyqësore..... 513

1. Baza ligjore e shqyrtimit incidental 513

2. Roli i Gjykatës Supreme 514

3. Raporti me jurisprudencën evropiane 514

4. Ndikimi në sigurinë juridike dhe zhvillimin e jurisprudencës 515

Kapitulli V: Standardet ndërkombëtare dhe krahasimi me legjislacionin vendor.....515

5.1. Standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 515

5.2. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 517

5.3. Roli i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian..... 519

5.4. Modelet kombëtare: Gjermania, Franca dhe rajoni i Ballkanit 521

5.5. Vlerësimi krahasues dhe rëndësia për Kosovën..... 523

Kapitulli VI: Analiza teorike dhe praktike 525

6.1. Roli i praktikës gjyqësore në konsolidimin e vlerësimit të akteve normative dhe shqyrtimit incidental..... 525

Koment mbi objektin e kërkesës/padisë..... 528

2. Vendimmarrja e Gjykatës Supreme dhe konsolidimi i kontrollit gjyqësor mbi aktet nënligjore 530

3. Arsyet e vendimmarrjes 530

4. Pasojat dhe efektet e aktit normativ të shpallur të paligjshëm 532

6.2.2. Aktgjykimi Pa.nr.02/2025 i datës 06.04.2025..... 534

1. Objekti i kërkesëpadisë 534

Koment mbi Objektin e kërkesëpadisë 534
2. Vendimmarrja e Gjykatës Supreme 535
Koment mbi Vendimmarrjen e Gjykatës Supreme 535
3. Arsyet e vendimmarrjes 535
a) Parimi i ligjshmërisë 535
b) Kundërshtimi me Kushtetutën 536
Koment mbi Arsyet e vendimmarrjes 536
c) Mungesa e proporcionalitetit 536
Koment i mungesës së proporcionalitetit 537
6.2.3. Aktgjykimi Pa.nr.06/2025 i datës 10.06.2025 538
1. Objekti i kërkesëpadisë 538
1. Çfarë ka kërkuar paditësja? 538
2. Pse e ka kërkuar? 538
3. Implikimet juridike të kërkesëpadisë 539
2. Vendimmarrja e Gjykatës Supreme 540
1. Aprovohet kërkesëpadia dhe shpallet i paligjshëm neni 3 (2) i Rregullores së KPM-së 540
2. Dosja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për vlerësimin e vendimit për zgjedhjen e kryetarit 540
4. Aktgjykimi është i formës së prerë dhe duhet të publikohet nga KPM 540
3. Implikimet e vendimit të Gjykatës Supreme 541
I. Implikimet normative 541
1. Forcimi i hierarkisë së akteve juridike 541
II. Implikimet procedurale 541
1. Respektimi i parimit të dy shkallëve të gjykimit 541
III. Implikimet institucionale 542
1. Transparenca dhe përgjegjësia e institucioneve publike 542
IV. Arsyet e vendimmarrjes së Gjykatës Supreme 543
1. Karakteri normativ i aktit 543
2. Kundërligjshmëria e nenit 3 (2) të Rregullores 543

3. Shkelja e procedurës së miratimit të rregullores 544
4. Paaftësia funksionale e KPM-së..... 544
V. Pasojat juridike të aktgjykimit të Gjykatës Supreme 545
1. Pasojat normative..... 545
2. Pasojat individuale 546
3. Pasojat institucionale..... 546
6.2.4. Aktgjykimi Pa.nr.01/2025 i datës 20.03.2025..... 547
Rëndësia e vendimmarrjes 551
2. Arsyetimi mbi konfliktin normativ 552
3. Arsyetimi mbi të drejtat themelore 552
4. Mbështetja në jurisprudencën ndërkombëtare..... 553
5. Vlerësimi mbi parimin e proporcionalitetit..... 553
6. Dimensioni krahasimor dhe efekti normativ..... 553
7. Përmbledhje kritike..... 554
Efektet dhe pasojat e aktgjykimit të Gjykatës Supreme..... 554
1. Efektet në rendin juridik të brendshëm 554
2. Efektet mbi të drejtat themelore të individëve 555
3. Pasojat institucionale dhe praktike për administratën publike 555
4. Pasojat në sistemin gjyqësor 555
5. Pasojat shoqërore dhe politike 556
Kapitulli VII: Komente përmbledhëse dhe rekomandime 556
7.1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore 556
7.2. Vlerësimi i sistemit aktual në Kosovë..... 557
7.3. Rekomandime për gjykatat 558
7.4. Rekomandime për administratën publike..... 559
7.5. Rëndësia e harmonizimit me standardet evropiane..... 560

Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje penale

Afrim Shala

Mjetet juridike në procedurën penale për të cilat është kompetente të vendosë Gjykata Supreme e Kosovës

1. Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale

Duke u bazuar në nenin 103, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 25, paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat,[1] Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.[2]

Si autoriteti më i lartë gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës[3] në procedurë penale ka kompetencë të vendosë në lidhje me:

1) kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit;[4]
2) ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas paragrafit 1 të nenit 407 të KPP-së;
3) ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë nga kjo Gjykatë[5] dhe
4) çështje të tjera të parapara me ligj.[6]

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës mund të iniciohet sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Mjete të rregullta juridike janë: ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe ankesa kundër aktvendimit

---

[1] Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, datë 23.11.2018.

[2] SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë,* "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", Prishtinë, 2023, fq.6.

[3] Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat.

[4] Neni 419, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, datë 17.08.2022 (në vijim: KPP), pastaj, nenet 431, 435, etj.

[5] Neni 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. i KPP-së.

[6] Neni 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7. i Ligjit për Gjykatat.

të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë nga kjo Gjykatë, kurse mjete të jashtëzakonshme juridike janë: kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Andaj, edhe në vijim të këtij punimi, do të trajtohen këto katër (4) mjete juridike, për të cilat është kompetente që të vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

Përveç këtyre mjeteve juridike, duhet theksuar se Gjykata Supreme e Kosovës ka edhe kompetenca tjera të përcaktuara me ligj, por të njëjtat nuk do të jenë objekt i trajtimit të këtij punimi.

2. Shqyrtime të përgjithshme dhe ndërkombëtare lidhur me ankesën

2.1. Nocioni i ankesës

Në përgjithësi termi "ankesë" nënkupton shprehje të pakënaqësisë për ndonjë fenomen, ngjarje, ndodhi apo për ndonjë proces. Ankesa, pra është shprehje pakënaqësie e ndonjë personi për ndonjë gjendje apo për ndonjë ngjarje. Në anën tjetër, termi ankesë është edhe një lloj reagimi i një personi apo i një grupi të personave kundër një vendimi apo veprimi të një personi tjetër. Nga kjo shihet se ankesa, si nocion i përgjithshëm mund të përbëhet nga dy anë apo nga dy faza:

- shprehja e pakënaqësisë për ndonjë ngjarje apo vendim dhe
- reagimi i këtyre personave kundër këtyre ngjarjeve.[7]

Meqë marrëdhëniet juridike janë edhe marrëdhënie shoqërore, atëherë ankesës mund t'i qasemi edhe nga aspekti juridik. Nga aspekti juridik, ankesa është shprehje e pakënaqësisë së personave të autorizuar dhe reagim i tyre kundër një vendimi të organit shtetëror në përgjithësi dhe gjykatave në veçanti. Ankesa, në përgjithësi ka një domethënie të gjerë, e cila në vete përmban të gjitha mjetet juridike të goditjes së vendimeve të organeve shtetërore.[8]

---

[7] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2010, fq.21-22.

[8] Sipas nenit 407, paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (KPPRSH), termi *"ankim"*, në vete përfshinë apelin (e cila i përgjigjet ankesës në

Përveç tjerash, ankesa kundër një vendimi të një organi shtetëror, konsiderohet edhe si mjet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për arsye se ekziston mundësia që me këtë vendim të jenë shkelur të drejtat e njeriut. Në këtë mënyrë, organi më i lartë asnjëherë nuk e merr në shqyrtim çështjen të cilën e ka zgjidhur organi më i ulët, nëse kundër vendimit të organit më të ulët nuk paraqitet ankesë. Prandaj, me shqyrtimin e çështjes nga organi më i lartë, mundësohet që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në përgjithësi të eliminohen të metat që e kanë shoqëruar procedurën në shkallë të parë.

Në anën tjetër, mundësia e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve të organeve shtetërore konsiderohet edhe si e drejtë themelore e njeriut, e cila është e paraparë dhe e garantuar, me një numër të madh të akteve juridike ndërkombëtare. E drejta e paraqitjes së ankesës, si e drejtë themelore e njeriut, është e garantuar edhe me kushtetutat e shteteve të ndryshme të botës. Kjo e drejtë është e garantuar dhe e paraparë edhe me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila emërtohet si "E drejta për Mjete Juridike".[9] Në këtë dispozitë kushtetuese është parashikuar se "secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj". Duke e parë rëndësinë kaq të madhe të ankesës, ajo është e paraparë në të gjitha procedurat pranë organeve shtetërore, si p.sh. në procedurën penale, kontestimore, jokontestimore, përmbarimore, administrative, etj. Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale, është një nocion më i ngushtë se sa ankesa në përgjithësi, si mjet i rregullt juridik.

Në procedurën penale, sikurse në procedurat tjera, edhe përkundër shumë garancive procedurale të parashikuara me ligj, të cilat kanë për qëllim gjetjen e së vërtetës, përkundër faktit se me aktgjykim synohet vërtetimi i drejtë i gjendjes faktike, nuk përjashtohet mundësia që aktgjykimi i

---

përgjithësi), rekursi në Gjykatën e Lartë (e cila i përgjigjet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë) dhe kërkesa për rishikim (e cila i përgjigjet kërkesës për rishikimin e procedurës penale).

[9] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka hyrë në fuqi më 15.06.2008. Kushtetutën e Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e saj, mund ta gjeni në këtë link : https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702

gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, të jetë jo i drejtë ose me të, të jetë shkelur ndonjë dispozitë ligjore. Me qëllim që të pengohet efekti juridik i këtyre aktgjykimeve, KPP përmban një sistem të mjeteve të mbrojtëse procedurale, të cilat mund t'i përdorin palët dhe personat e tjerë. Ato mjete procedurale janë mjetet juridike. Detyra e tyre është që në procedurën e kontrollit gjyqësor të evitojnë vendimin e gabuar apo që të sjellin deri të gjykimi i ligjshëm.[10] Mjet juridik procedural është edhe ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale, qëllimi i së cilës në përgjithësi është evitimi i të metave që e kanë shoqëruar këtë procedurë.

Shumica e kodeve të procedurës penale të shteteve të ndryshme nuk e përcaktojnë nocionin e ankesës kundër aktgjykimit. Nocioni i ankesës kundër aktgjykimit nuk përcaktohet as me dispozitat ligjore të KPP-së. Sidoqoftë, edhe pse nuk është përcaktuar nocioni i ankesës kundër aktgjykimit, me dispozitat ligjore të KPP-së janë paraparë disa elemente në bazë të të cilave mund të përcaktohet nocioni i ankesës, si p.sh. përmbajtja, forma, personat e autorizuar për paraqitjen e saj, bazat dhe afati për paraqitjen e ankesës, procedura e ankesës pranë gjykatës së shkallës së parë, procedura e ankesës pranë gjykatës së shkallës së dytë dhe të tretë, etj.
Duke i marrë për bazë këto elemente të ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale, të parapara me ligj, teoria e së drejtës së procedurës penale është përpjekur të përcaktojë edhe nocionin e saj. Kështu, në teorinë e së drejtës së procedurës penale, në radhë të parë, theksohet se ankesa është një mjet i rregullt juridik.
Është një mjet i rregullt juridik, për shkak se përmes saj, mund të goditen vetëm vendimet gjyqësore të cilat nuk e kanë marrë formën e prerë, për dallim nga mjetet e jashtëzakonshme juridike të cilat paraqiten kundër vendimeve gjyqësore të cilat e kanë marrë formën e prerë. Shikuar historikisht, së pari janë paraqitur mjetet e rregullta juridike e më pas mjetet e jashtëzakonshme juridike. Tipar i përbashkët i këtyre mjeteve, qofshin të rregullta apo të jashtëzakonshme është synimi për të marrë

[10] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP, *E drejta e procedurës penale,* Prishtinë, 2016, fq. 399.

vendim të drejtë[11]. Përveç si mjet i rregullt juridik, ankesa kundër aktgjykimit është po ashtu edhe një mjet juridik universal, sepse me të pala ka të drejtë ta atakojë çdo aktivitet të gjykatës : procedurën që e ka zhvilluar, gjendjen faktike të konstatuar dhe vlerësimin juridik të çështjes që ka pasur për pasojë zbatimin e normës materialo-juridike[12].

Parimisht, kundër çdo aktgjykimi të gjykatës së shkallës së parë në procedurë penale lejohet paraqitja e ankesës, kurse kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, lejohet ankesa vetëm në disa situata të përcaktuara me dispozita ligjore.

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale është një mjet juridik i plotë, për arsye se mund të paraqitet nga të gjitha bazat: si juridike - *"Error iuris"* (shkeljet procedurale dhe materiale), ashtu edhe faktike - *"Error facti"*. Si mjet juridik jo i plotë konsiderohet p.sh. kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila mund të paraqitet për shkak të shkeljes së ligjit (penal dhe procedural),[13] etj.

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale ka efekt suspenziv, për arsye se me paraqitjen e ankesës shtyhet mundësia që ky aktgjykim të marrë formën e prerë dhe të ekzekutohet. Kjo cilësi e ankesës kundër aktgjykimit është paraparë edhe në nenin 380, paragrafi 3 të KPP-së, ku thuhet se "Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit".

Paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit, është e lidhur me parimin e shumëshkallëshmërisë në procedurën tonë penale. Lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë vendos gjykata e

[11] MURATI, REXHEP, *Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja*, Prishtinë, 2006, fq. 15.

[12] BRESTOVCI, FAIK, *E drejta procedurale civile*, Prishtinë, 2002, fq. 251.

[13] Sipas nenit 432, paragrafi 1 të KPP-së, është parashikuar se "Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese: 1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal; 1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafit 1 i këtij Kodi; ose 1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor".

shkallës së dytë, e cila sikurse tek ne, ashtu edhe në disa legjislacione emërtohet si "Gjykatë e Apelit"[14].

Kështu, edhe tek ne, në nenin 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP, është parashikuar "Përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, pala mund të paraqesë mjetin juridik në gjykatën e shkallës drejtpërdrejtë më të lartë përmes ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit". Se procedura jonë penale është shumëshkallëshe, mund të shihet edhe nga një numër i konsiderueshëm i dispozitave ligjore që i rregullojnë kompetencat dhe procedurat e veprimit në raste të caktuara.

Kështu, në nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat, është parashikuar se të "Gjykata e Apelit vepron si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës", kurse në nenin 25 të këtij Ligji, është parashikuar se "Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës".

Duke e marr për bazë këtë mënyrë të vendosjes, në teorinë e së drejtës së procedurës penale, theksohet se ankesa kundër aktgjykimit, ka karakter devolutiv, sepse për të vendos gjykata e rangut më të lartë. Pra, karakteri devolutiv i ankesës nënkupton se për ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë vendos gjykata e shkallës së dytë apo gjykata më e lartë.

Mirëpo, në teorinë e së drejtës së procedurës penale theksohet se ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka karakter devolutiv edhe në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, i cili e ka marr aktgjykimin vendos lidhur me ankesën, sa i përket lejueshmërisë dhe afatshmërisë së saj. Një situatë e tillë vjen në shprehje kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hedh poshtë ankesën si të paafatshme ose të palejuar, sipas nenit 388, paragrafi 2 të KPP-së. Në këtë mënyrë, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hedh ankesën me aktvendim:

[14] ISLAMI, HALIM; HOXHA, ARTAN, PANDA ILIR, *Procedura penale,* Komentar, Tiranë, 2003, fq. 542.

2.1. si të paafatshme kur konstatohet se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor; ose

2.2. si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj.

Gjithashtu, një situatë e tillë kur ankesa kundër aktgjykimit në procedurës penale hudhet nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, është parashikuar edhe në nenin 382, paragrafi 2 të KPP-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se "Kur ankesën e paraqet i akuzuari ose i dëmtuari i cili nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, dhe ankesa nuk është përpiluar në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga ankuesi që në afat të caktuar të ndryshojë ankesën me parashtresën me shkrim. Nëse ankuesi nuk e përmbush kërkesën nga neni 376 të këtij Kodi ose paragrafit 1 i këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hedh ankesën".

Sipas nenit 382, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, përveç elementeve tjera, ankesa kundër aktgjykimit duhet të ketë edhe propozimin e saj për anulimin e tërësishëm apo të pjesërishëm të aktgjykimit ose për ndryshimin e tij. Pra, ankuesi, në ankesën e tij duhet që gjykatës së shkallës së dytë t'i propozojë që aktgjykimin e atakuar ta anulojë apo ta ndryshojë.

Në literaturën juridike, vlerësohet se ankesa kundër aktgjykimit është mjet juridik i dyanshëm,[15] për arsye se gjykata para se të vendosë për të, duhet që palës kundërshtare t'i jepet mundësia që të deklarohet lidhur me thëniet dhe pretendimet të cilat i ka parashtruar ankuesi në ankesë. Mundësia e palës kundërshtare që të deklarohet lidhur me thëniet të cilat i ka paraqitur ankuesi në ankesë, emërtohet "përgjigje në ankesë" dhe është në harmoni me parimin kontradiktor në procedurë penale.[16]

[15] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, fq.28.

[16] Përgjigja në ankesë është parshikuar dhe rregulluar me nenin 388, paragrafët 3-5 të KPP-së.

Konsiderojmë se të dhënat e lartpërmendura ofrojnë bazë të mjaftueshme për ta përcaktuar edhe nocionin e ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale. Duke u bazuar në të dhënat e lartpërmendura, mund të konstatojmë se ankesa kundër aktgjykimit është një mjet juridik i rregullt, suspenziv, devolutiv, i plotë, i dyanshëm të cilën e paraqesin personat e autorizuar për shkak të shkeljeve ligjore apo gabimeve faktike dhe me të cilën i propozojnë gjykatës së shkallës së dytë që aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë apo ta anulojë.



2.2. Llojet e ankesave

Varësisht se cili kriter merret për bazë, në procedurë penale kemi ndarje të ndryshme të ankesave. Si kritere për klasifikimin e ankesave mund të merren lloji i vendimit që atakohet, numri i personave që e paraqesin ankesën, fakti se a paraqitet ankesa në dobi apo në dëm të të akuzuarit, lejueshmëria e ankesës, bazueshmëria e ankesës, etj.

a) Kështu nëse merret për bazë lloji i vendimit[17] që atakohet, kemi:

- ankesë kundër aktgjykimit,
- ankesë kundër aktvendimit dhe në disa raste të parashikuara me KPP, edhe
- ankesë kundër urdhrit.[18]

Sipas këtij kriteri, ankesa mund të ndahet edhe në:

- ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë[19] dhe
- ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.[20]

b) Kriter tjetër me rëndësi për ndarjen e ankesave është edhe numri i personave që e kanë paraqitur ankesën. Duke e marrë për bazë këtë kriter, kemi:

- ankesë individuale kundër aktgjykimit dhe
- ankesë kolektive kundër aktgjykimit.

Ankesa individuale kundër aktgjykimit është ajo ankesë të cilën e paraqet një person, kurse ankesë kolektive kundër aktgjykimit është ajo ankesë (si shkresë) të cilën e paraqesin dy ose më shumë persona. Ankesa kolektive kundër aktgjykimit ndryshe mund të quhet edhe si "ankesë e përbashkët kundër aktgjykimit". Nuk konsiderohet ankesë kolektive

[17] Në nenin 469, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se në procedurën penale vendimet merren në formë të aktgjykimit, të aktvendimit dhe të urdhrit.

[18] Në nenin 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 21 të KPP-së është përcaktuar domethënia dhe kompetencat e kolegjit shqyrtues. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, kolegji shqyrtues është kolegj i përbërë prej tre gjyqtarësh i cili formohet nga departamenti i njëjtë ose nga gjykata themelore për të shqyrtuar dhe vendosur mbi një kundërshtim ose ankesë kundër urdhrit ose aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Andaj, nga kjo dispozitë ligjore rezulton se kolegji shqyrtues, përveç tjerash vendos edhe në lidhje më ankesën kundër urdhrit.

[19] Nenet 380 - 406 të KPP-së.

[20] Neni 407 i KPP-së.

kundër aktgjykimit, nëse disa persona ankohen veç e veç kundër aktgjykimit të njëjtë.

c) Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale mund të paraqitet si në dëm, ashtu edhe në favor të të akuzuarit. Prandaj, duke u bazuar në këtë kriter në procedurë penale dallojmë:

- ankesën kundër aktgjykimit në dëm të të akuzuarit dhe
- ankesën kundër aktgjykimit në favor apo dobi të të akuzuarit.

Edhe pse nuk është thënë në mënyrë shprehimore me dispozitat ligjore të KPP-së, i akuzuari nuk lejohet që të paraqesë ankesë në dëm të tij. Një gjë të tillë nuk mund ta bëjë as mbrojtësi i tij.[21] Prokurori i shtetit, si palë në procedurë mund të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit, si në dëm ashtu edhe në dobi të të akuzuarit.[22] Në praktikën tonë gjyqësore, kemi konstatuar se në shumë raste kundër të njëjtit aktgjykim është paraqitur ankesë si në dëm, ashtu edhe në dobi të të akuzuarit.

d) Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale ndahet edhe në:
- ankesë të plotë dhe
- ankesë jo të plotë.

Ankesa konsiderohet e plotë nëse i përmban të gjitha elementet e parapara me ligj, në të kundërtën nëse ankesa nuk i përmban të gjitha elementet e parapara me ligj,[23] atëherë konsiderohet se ankesa është jo e plotë.

Përveç kritereve të lartpërmendura, ankesa mund të ndahet edhe në ankesë të lejuar dhe në ankesë të palejuar, në ankesë të bazuar dhe në ankesë të pabazuar, ankesë në formë të shkruar dhe në ankesë gojarisht e shënuar në procesverbal të gjykatës, etj.[24]

---

[21] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, fq.30.

[22] Neni 381, paragrafi 2 i KPP-së.

[23] Në nenin 382, paragrafi 1. të KPP është parashikuar përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimit.

[24] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, fq.30.

3. Ankesa sipas të drejtës ndërkombëtare

3.1. Shqyrtime të përgjithshme

E drejta e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve gjyqësore në përgjithësi, konsiderohet e drejtë themelore e njeriut, e cila për shkak të rëndësisë së madhe që ka, përveç me aktet e brendshme juridike, është e paraparë dhe e garantuar edhe me aktet juridike më të rëndësishme ndërkombëtare.

Deri pas Luftës së Dytë Botërore, çështja e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe e të drejtës së paraqitjes së ankesës kundër vendimeve gjyqësore në veçanti, kanë qenë kompetencë e brendshme e shteteve. Kurse, pas Luftës së Dytë Botërore, sidomos me miratimin e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe e drejta e paraqitjes së ankesës në veçanti, bëhen pjesë e së drejtës ndërkombëtare pozitive dhe ato njëherë e përgjithmonë pushojnë të jenë çështje e kompetencës ekskluzive të shteteve.[25] Kështu, me miratimin e kësaj Karte dhe të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut,[26] fillon një etapë e re në historinë e të drejtave të njeriut, për arsye se më të drejtat e njeriut në përgjithësi, nuk konsiderohen çështje e brendshme e shteteve, por çështje e bashkësisë ndërkombëtare. Prandaj, duke u bazuar në këtë parim, Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat tjera rajonale, kanë miratuar një mori aktesh juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në përgjithësi dhe për të drejtën e ankesës kundër vendimeve gjyqësore në veçanti. Sipas këtyre akteve, shtetet janë të detyruar që t'i garantojnë dhe respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që të janë parapara me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare. Këtë detyrë, shtetet e realizojnë duke i inkorporuar në legjislacionin e tyre të drejtat e njeriut të parashikuara në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare ose duke i aplikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë këto dokumente ndërkombëtare. Me të drejtën

[25] GRUDA, ZEJNULLAH: *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*, Libri I, Prishtinë, 2001, fq. 6.

[26] Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Orgaznizatës së Kombeve të Bashkuara, më 10.12.1948.

ndërkombëtare, jo vetëm se parashikohet detyra e shteteve që të implementojnë të drejtat e njeriut të shpallura me këto akte juridike, por edhe parashohin detyrën e shteteve që t'i mundësojnë qytetarëve që të përdorin mjetet efektive ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.
Edhe Republika e Kosovës, si pjesë e pandashme e Evropës, në legjislacionin e saj, ka parashikuar një numër të konsiderueshëm të akteve juridike ndërkombëtare, të cilat aplikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë si pjesë e pandashme e këtij legjislacioni. Kështu me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,[27] janë numëruar disa akte juridike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat aplikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë. Në mesin e akteve juridike ndërkombëtare të cilat aplikohen drejtpërdrejtë dhe të cilat konsiderohen e drejtë pozitive në Kosovë, janë :

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, si dhe
- Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.[28]

Në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe

[27] Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
[28] Amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nr. 07-V-058, datë 25.09.2020.

instrumentet ndërkombëtare të lartcekura, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Në vazhdim të këtij punimi do t'i shqyrtojmë dhe analizojmë vetëm Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, dhe Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet, dokumente këto në të cilat është paraparë e drejta e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve gjyqësore.

Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, përmban një numër të madh të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, që u takojnë të gjithë njerëzve të botës. Kjo deklaratë, siç është cekur edhe më lartë, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konsiderohet e drejtë pozitive dhe aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë. Në nenin 8 të Deklaratës së Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, është paraparë në mënyrë të përgjithshme dhe parimore e drejta në ankesë. Sipas këtij neni "çdo kush ka të drejtën e një mjeti efikas nga gjykatat kombëtare kompetente për aktet të cilat shkelin të drejtat themelore që atij i njihen me kushtetutë ose ligj".[29]

Akt tjetër juridik i rëndësishëm ndërkombëtar i cili e parasheh të drejtën në ankesë është edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.[30]

Për dallim nga Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, përmban dispozita më të elaboruara dhe konkrete për të drejtën në ankesë. Sipas këtij akti juridik ndërkombëtar, shtetet janë obliguar që të sigurojnë mjete efektive ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat janë të parashikuara me këtë Pakt. Kështu në nenin 2, paragrafi 3 të këtij Pakti, thuhet "secili shtet pjesëmarrës i marrëveshjes merr për sipër : a) të sigurojë që secili person

[29] MOSE, ERIK, *Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, "Standardi i Përbashkët që duhet arritur"*, Prishtinë, 1998, fq. 189.

[30] Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike është miratuar më 19.12.1966 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, ndërsa ka hyrë në fuqi më 23.03.1976.

..., të drejtat e të cilit janë shkelur të ketë mundësi përdorimin e mjetit efektiv ..., b) të siguroj që secili person që kërkon mjet të tillë të ketë të drejtë në të ..., si dhe të zhvillojë mundësitë për mjete gjyqësore, c) të sigurojë që autoritet kompetente do të zbatojnë mjetet e tilla të akorduara". Nga kjo shihet se përveç që është parashikuar mundësia e përdorimit të ankesës, njëherit autoritetet kompetente të shteteve janë obliguar që t'i zbatojnë mjetet e tilla efektive ligjore.

Edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut[31] ka parashikuar të drejtën e ankesës kundër vendimeve gjyqësore në procedurë penale. Në nenin 2 të Protokollit nr.7 të kësaj Konvente është paraparë e drejta e apelit në çështjet penale. Sipas paragrafit 1 të këtij neni "çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mundet të ushtrohet, janë të përcaktuara me ligj". Nga kjo shihet se me këtë Konventë është paraparë në mënyrë shprehimore e drejta e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve gjyqësore në procedurë penale.

Në paragrafi 2 të këtij neni janë parashikuar edhe rastet kufizimit të ushtrimit të ankesës kundër vendimeve gjyqësore në procedurë penale. Kështu në këtë paragraf thuhet se "kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta, siç është përcaktuar nga ligji ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë ...,".

Me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, nuk është përcaktuar nëse e drejta e ankesës nënkupton konstatimin e serishëm të provave apo përsëritjen e të gjitha veprimeve procedurale të cilat janë atakuar me ankesë, por kjo u është lënë legjislacioneve nacionale që këtë çështje ta rregullojnë me ligjet e tyre. E drejta në paraqitjen e ankesës kundër vendimeve gjyqësore është e paraparë edhe në dokumente tjera juridike ndërkombëtare. Kështu, ankesa kundër vendimeve gjyqësore (në emërtime të ndryshme) është paraparë edhe me këto dokumente juridike ndërkombëtare :

[31] Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut është miratuar 04.11.1950 nga Këshilli i Evropës dhe ka hyrë në fuqi më 03.09.1953.

- me nenin 25 të Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut (1969);
- me nenin 6 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1965);
- me nenin 2 të Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (1979);
- me nenin 7 të Kartës Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Popullit (1981);
- me nenin 13 të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degradimeve (1984), etj.[32]

3.2. Ankesa sipas rregullave të procedurës të disa gjykatave penale ndërkombëtare

3.2.1. Ankesa në procedurën penale pranë Tribunalit të Hagës

Tribunali i Hagës[33] është themeluar nga ana e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me Rezolutën nr.827, të datës 22 shkurt 1993.

Sipas Statutit të Tribunalit të Hagës (Statuti),[34] kjo gjykatë ka autorizim t'i ndjek personat përgjegjës për krimet e gjenocidit, shkeljeve të rënda të konventave të Gjenevës, shkeljeve të së drejtës së luftës apo zakoneve të luftës dhe për krimet kundër njerëzimit, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, prej vitit 1991.

Sipas nenit 11 të Statutit, Tribunali i Hagës përbëhet nga organet vijuese:

---

[32] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, fq.73.

[33] Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Cenime të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë, pas vitit 1991.

[34] Statute of International Criminal Tribunal for former Yugoslavia, U.N. Doc. S/25704 at 36, annex (1993) and S/25704/Add.1 (1993), adopted by Security Council on 25 May 1993, UN Doc. S/RES/827 (1993).

a) kolegjet të cilat përbëhen nga dy kolegje të shkallës së parë dhe kolegji apelit (kolegji i cili shqyrton ankesat);

b) prokurori dhe

c) sekretaria e Tribunalit.

Kolegji i apelit (kolegji që shqyrton ankesat) përbëhet nga pesë gjyqtarë.[35]

Duke u bazuar në nenin 15 të Statutit të Tribunalit të Hagës, më datën 15 mars 1994, ka hyrë në fuqi edhe Rregullorja mbi Procedurën dhe Provat (RPP),[36] e cila përmban dispozita me të cilat rregullohet procedura gjyqësore para Tribunalit të Hagës.

Sipas Rregullores mbi Procedurën dhe Provat, procedura gjyqësore pranë Tribunalit të Hagës, në përgjithësi kalon nëpër këto faza :

- faza e hetimeve,
- shqyrtimi gjyqësor pranë kolegjit të shkallës së parë dhe
- procedura sipas mjeteve juridike.

Procedura e ankesës (procedura e apelit) para Tribunalit të Hagës është e rregulluar me Statutin e Tribunalit dhe me Rregulloren mbi Procedurën dhe Provat.

Sipas paragrafi 1, të nenit 25 të Statutit, ankesa mund të paraqitet për shkak të gabimeve juridike, të cilat e bëjnë vendimin të mangët dhe për shkak të konstatimeve të gabuar të gjendjes faktike, të cilat kanë kontribuar në nxjerrjen e vendimit të padrejtë.

Pala e cila mendon që të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit, duhet që të dorëzojë një njoftim apo paralajmërim të ankesës, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e shpalljes së aktgjykimit.

Ankuesi duhet gjithashtu që të përcaktojë edhe vendimin e ankimuar, datën e shpalljes së tij, të tregojë thelbin e gabimeve dhe korrigjimin që kërkohet.[37]

---

[35] Neni 12 i Statutit.

[36] Rules of Procedure and Evidence, International Criminal Tribunal for former Yugoslavia, U.N. Doc. IT/32/Rev.7 (1996), entered into force 14 March 1994, amendments adopted 8 January 1996.

[37] Neni 108 i RPP-së.

Ankesa mund të paraqitet në afat prej 75 (shtatëdhjetepesë) ditëve, pas ditës së paraqitjes së njoftimit ose paralajmërimit të ankesës, sipas nenit 108 të kësaj Rregullore.

Një kopje e ankesës i dorëzohet palës kundërshtare, e cila në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas ditës së dorëzimit të ankesës, mund të paraqesë argumente që i kundërvihen ankesës.

Ankuesi mund të dorëzoj një përgjigje në parashtresën e palës kundërshtare brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas pranimit të parashtresës.[38]

Për shkak të rrezikshmërisë së madhe që paraqesin veprat penale, për të cilat është kompetent për gjykim Tribunali i Hagës, paraqitja e ankesës parimisht nuk ka efekt suspenziv. Mirëpo, Dhoma e Apelit mundet, nëse e sheh të arsyeshme në çdo kohë të pezullojë zbatimin e aktgjykimit të ankimuar.[39]

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e parashtresave sipas rregullave të lartcekura, Dhoma e Apelit do të caktoj seancën dhe sekretari do t'i njoftojë palët për këtë.[40]

Palët mund të paraqesin prova shtesë para Dhomës së Apelit. Secila palë e cila preket nga këto prova shtesë, mund të paraqesë material kundërshtues.[41]

Dhoma e Apelit do të vendosë se nëse provat shtesë kanë qenë në dispozicion të gjykatës, nëse kanë lidhje me çështjen, nëse janë të besueshme dhe a do të kishin ndikim në marrjen e vendimit në gjykatë. Nëse plotësohen këto kushte, Dhoma e Apelit do t'i marrë në konsideratë provat shtesë dhe materialin kundërshtues, për të arritur një gjykim përfundimtar. Në qoftë se disa të pandehur paraqesin ankesë, provat shtesë që pranohen për ndonjërin prej tyre do të merren në konsideratë për të gjithë bashkë, për aq sa kanë lidhje me të gjithë të pandehurit.[42]

[38] Neni 113 i RPP-së.

[39] Neni 108, pika C i RPP-së.

[40] Neni 114 i RPP-së.

[41] Neni 115, pikat A dhe B i RPP-së.

[42] Neni 115, pika D i RPP-së.

Dhoma e Apelit, do të shpallë gjykimin në bazë të dosjes së apelit bashkë me ato prova shtesë të cilat janë paraqitur, ndërsa gjykimi do të arrihet me shumicë votash të gjyqtarëve.
Pas shqyrtimit të ankesës dhe provave tjera, Dhoma e Apelit vendimin e kolegjit të shkallës së parë mund ta vërtetojë, të nxjerrë vendim tjetër apo ta ndryshojë.[43]
Gjykimi do të shpallet publikisht, në një datë e cila do t'u njoftohet palëve dhe avokatëve, të cilët kanë të drejtë të jenë të pranishëm.[44]
Dënimi i shpallur nga Dhoma e Apelit, do të zbatohet menjëherë. Në qoftë se i akuzuari nuk është i pranishëm kur të shpallet gjykimi, në qoftë se është shpallur fajtor për të gjitha akuzat ose për ndonjë arsye tjetër, Dhoma e Apelit mund të shpallë gjykimin në mungesën e të akuzuarit dhe përveç kur e shpall pafajësinë e tij, do të urdhërojë që i akuzuari të arrestohet ose t'i dorëzohet Tribunalit.
Nga të gjitha këto që u theksuan më lart mund të konstatojmë se procedura e ankesës pranë Tribunalit të Hagës, i ka specifikat e veta të veçanta, por ka edhe ngjashmëri me procedurën e ankesës sipas kodeve të procedurës penale të shteteve të ndryshme.

3.2.2. Ankesa në procedurën penale pranë Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare

Gjykata e Përhershme Penale Ndërkombëtare, u themelua më 17.07.1998, në Konferencën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në Romë, në të cilën morën pjesë delegatët e 160 shteteve, ku me shumicën absolute të delegatëve, u nënshkrua Marrëveshja për themelimin e Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare, selia e së cilës u vendos të jetë në Hagë. Me ratifikimin e kësaj marrëveshje nga numri i nevojshëm i shteteve më 11.04.2002, hyri në fuqi edhe Statuti i kësaj Gjykate. Gjykata e Përhershme Penale Ndërkombëtare filloi punën më 01.01.2003, ndërsa juridiksioni i saj u vendos të jetë retroaktiv prej 01.01.2002.

[43] Neni 25, paragrafi 2 i Statutit të Tribunalit të Hagës.
[44] Neni 117 i RPP-së.

Statuti i Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare (Statuti),[45] është hartuar duke u bazuar në konventat e Gjenevës dhe në statutet e gjykatave të mëparshme për krime lufte.

Në nenin 5 të këtij Statuti, thuhet se Gjykata do të ketë juridiksion që t'i gjykoj kryerësit e krimeve më serioze, që janë në interes të bashkësisë ndërkombëtare. Sipas kësaj dispozite ligjore, në juridiksionin e kësaj Gjykate do të jenë : a) krimi i gjenocidit, b) krimet kundër njerëzimit, c) krimet e luftës dhe d) krimi i agresionit.

Me Statutin e Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare, përveç çështjeve tjera, është rregulluar edhe struktura dhe administrimi i gjykatës, ku në mesin e organeve tjera është parashikuar edhe seksioni i apelit (ankimit) i cili përbëhet prej kryetarit dhe katër gjyqtarëve.[46] Çështjet që kanë të bëjnë me ankesën janë të rregulluara me Statutin e kësaj Gjykate dhe me Rregulloren mbi Procedurën dhe Provat (RPP).[47]

Në nenin 81 të Statutit janë përcaktuar bazat për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës dhe ku është parashikuar se prokurori mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit. Sipas paragrafi 1 të këtij neni, Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë për shkak të këtyre bazave : a) gabimeve procedurale, b) gabimeve faktike dhe c) gabimeve ligjore. Kurse sipas paragrafi 2 të këtij neni, i akuzuari ose prokurori, mund të paraqesin ankesë në dobi të të akuzuarit, për shkak të këtyre bazave : a) gabimeve procedurale, b) gabimeve faktike, c) gabimeve ligjore dhe d) për ndonjë bazë tjetër procedurale.

Ankesë kundër aktgjykimit në procedurën penale pranë Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare mund të paraqesë edhe përfaqësuesi ligjor i viktimës, si dhe personi nga i cili është konfiskuar pasuria e tij.[48] Sipas nenit 150, paragrafi 2 të RPP-së, ankesa mund të paraqitet në afat prej 30 ditëve, nga dita kur ankuesi është njoftuar me aktgjykimin e Gjykatës. Me kërkesën e palës, Dhoma e Apelit mund ta zgjasë afatin për

[45] Rome Statute of the International Criminal Court, as corrected by the process-verbaux of 10 November 1998 and 12 July 1999.

[46] Neni 39 i Statutit.

[47] Rules of Procedure and Evidence adopted by the Assembly of States Parties in First Session, New York, 3-10 September 2002, Official Records ICC-ASP/1/3.

[48] Neni 82, paragrafi 4 i Statutit.

paraqitjen e ankesës, nëse konstaton se ekzistojnë arsye për një gjë të tillë. Ankesa duhet të dorëzohet në sekretarinë e Gjykatës.[49]
Nëse nuk paraqitet ankesë brenda afatit të caktuar, atëherë aktgjykimi i trupit gjykues bëhet përfundimtar.
Sekretari i Gjykatës do t'i njoftoj të gjitha palët me ankesën e paraqitur.[50]
Ankuesi mund ta tërheq ankesën e tij, deri në momentin kur gjykata të vendos lidhur me ankesën. Në rast të tillë, ankuesi duhet që të dorëzojë në sekretarinë e gjykatës një njoftim me shkrim për tërheqjen e ankesës dhe sekretari e Gjykatës, do t'i informojë palët të tjera se një njoftim i tillë është paraqitur.[51]
Rregullat procedurale para trupit gjykues të shkallës së parë vihen përshtatshmërisht në zbatim edhe para kolegjit të apelit të Gjykatës.[52]
Kolegji i ankesave ka mundësi që duke vendosur sipas ankesës, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë, ta ndryshojë ose ta abrogojë.
Rregullat e tjera procedurale që kanë të bëjnë me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës, janë të gati të ngjashme me rregullat procedurale të ankesës pranë Tribunalit të Hagës.

4. Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë

4.1. Shqyrtime të përgjithshme

Parimisht procedura jonë penale është procedurë dyshkallëshe, çka do të thotë se një çështje penale mund të jetë objekt i shqyrtimit nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e shkallës së dytë nëse personat e autorizuar paraqesin ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Me marrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, sipas rregullit, çështja penale konsiderohet çështje e gjykuar ("Res iudicata"), sepse aktgjykimi e fiton formën e prerë.
Mirëpo, në disa raste të përcaktuara me dispozitat ligjore të KPP-së, lejohet mundësia e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës

[49] Neni 150, paragrafi 2 dhe 3 i RPP-së.
[50] Neni 151, paragrafi 2 i RPP-së.
[51] Neni 152, paragrafi 2 i RPP-së.
[52] Neni 83, paragrafi 1 i Statutit.

së shkallës së dytë, përkatësisht lejohet trishkallëshmëria në procedurë penale.
Rastet për të cilat mund të paraqitet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë të caktuara në mënyrë shprehimore me dispozitën ligjore të nenit 407 të KPP-së.
Sipas paragrafit 1 të kësaj dispozite ligjore, ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur:

1. Gjykata e Apelit shqipton dënim me burgim të përjetshëm ose vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore me të cilin është shqiptuar dënim i tillë;

2. Gjykata e Apelit pas shqyrtimit vërteton ndryshe gjendjen faktike nga gjykata themelore dhe aktgjykimin e bazon në gjendjen e tillë faktike të vërtetuar; ose

3. Gjykata e Apelit ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin.

Siç shihet lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë vendos Gjykata Supreme e Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës vendos për ankesat kundër aktgjykimit të shkallës së dytë në seancë të kolegjit të gjyqtarëve sipas dispozitave që vlejnë për procedurë të apelit në shkallë të dytë. Në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk mund të mbahet shqyrtimi gjyqësor.[53]
Pra, edhe procedura që zhvillohet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është e ngjashme me procedurën që zhvillohet pranë gjykatës së shkallës së dytë, me përjashtim se pranë kësaj gjykate nuk mund të mbahet shqyrtimi gjyqësor.
Jo vetëm sa i përket vendosjes në seancë të kolegjit, por edhe sa i përket çështjeve tjera, dispozitat ligjore që i referohen ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë zbatohen përshtatshmërisht edhe sa i përket ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

[53] Neni 407, paragrafi 2 i KPP-së.

Përndryshe, paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është vetëm mundësi e personave të autorizuar, por nuk është edhe obligim i tyre. Se a do të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit në procedurë penale apo jo varet prej vullnetit të tyre. Nga ky parim ekziston një përjashtim, kur është fjala te Prokurori i shtetit, i cili detyrohet që në çdo rast nëse konstaton se është shkelur ligji, të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit pavarësisht nga vullneti i tij i brendshëm. Mos paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paraqet një lloj supozimi se palët dhe personat e tjerë, janë pajtuar ose nuk kanë vërejtje ndaj këtij aktgjykimi.

Me paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë, i ipet mundësia që ta kontrollojë zhvillimin e procedurës pranë gjykatave të instancave më të ulëta. Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë, asnjëherë nuk e merr në shqyrtim çështjen të cilën e ka zgjidhur gjykata e shkallës së dytë, nëse kundër vendimit të kësaj gjykate nuk paraqitet ankesë. E drejta në ankesë bazën e saj e ka në dispozita ligjore përkatësisht në dispozitat ligjore të KPP-së. Mirëpo, siç është cekur më parë, edhe me dispozita të së drejtës ndërkombëtare është parashikuar e drejta e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve gjyqësore.

Ligjdhënësi e ka obliguar gjykatën, që aktgjykimet kundër të cilave lejohet ankesë, t'i dërgohen palëve me udhëzimin për të drejtën në ankesë.[54]

Udhëzimi për të drejtën në ankesë përmban këshilla juridike se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës, nga palët dhe personat tjerë të autorizuar, sipas nenit 381 të KPP-së, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes aktgjykimit. Ankesa duhet që t'i dorëzohet gjykatës themelore në numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën tjetër.

Siç shihet, udhëzimi për të drejtën në ankesë përfshinë udhëzimin se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës, gjykatës të cilës duhet t'i dorëzohet ankesa, afati për paraqitjen e ankesës, se ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme, etj.

---

[54] Shih nenin 369, paragrafët 5 dhe 6 dhe nenin 473, paragrafi 3 të KPP-së.

Udhëzimi për të drejtën në ankesë duhet shënuar në fund të aktgjykimit. Në praktikën gjyqësore kemi hasur emërtime të ndryshme për udhëzimin për të drejtën në ankesë, si p.sh. *''Udhëzim mbi mjetin juridik''*, *''Këshilla juridike'', "Udhëzim mbi të drejtën në ankesë", "E drejta në ankesë"*, etj.

Udhëzimi për të drejtën në ankesë ka rëndësi të madhe, sepse personat e autorizuar njoftohen se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës dhe njoftohen edhe për detaje tjera që kanë të bëjnë me ankesën.

Përndryshe, aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit. Një anëtar i kolegjit mund të paraqesë mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues mbi çështje ligjore ose faktike lidhur me ankesën, të cilat i bashkëngjiten aktgjykimit.[55]

Në anën tjetër, dispozitat e nenit 397 të KPP-së zbatohen edhe ndaj të bashkakuzuarit i cili nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Sipas dispozitës ligjore të nenit 397 të KPP-së, kur me rastin e paraqitjes së ankesës së cilitdo të akuzuar, Gjykata e Apelit çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur në atë drejtim, gjykata vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur edhe nga i bashkakuzuari ("Beneficium Cohaesionis").

4.2. Plotësimi i ankesës

Personat e autorizuar kanë të drejtë që brenda afatit ligjor të paraqesin një ose më shumë ankesa kundër aktgjykimit dhe ta plotësojnë ankesën e tyre.

Plotësimi i ankesës është një institut i cili njihet nga teoria e së drejtës së procedurës penale dhe nga praktika gjyqësore, por jo edhe nga ligji. KPP nuk përmban dispozita me të cilën rregullohet plotësimi i ankesës kundër aktgjykimit.

[55] Neni 407, paragrafi 3 i KPP-së.

Si plotësim i ankesës mund të konsiderohet ajo parashtresë e palëve ose e përfaqësuesve të tyre, e cila vetëm i plotëson dhe sqaron arsyet për të cilat është goditur aktgjykimi me ankesën e tyre të mëparshme.[56]

Në teorinë e së drejtës së procedurës penale janë shprehur dy qëndrime lidhur me afatin për paraqitjen e plotësimit të ankesës:

- sipas qëndrimit të parë, plotësimi i ankesës mund të bëhet brenda afatit ligjor për paraqitjen e ankesës dhe
- sipas qëndrimit të dytë, plotësimi i ankesës mund të bëhet deri para momentit të vendosjes në lidhje me ankesën nga gjykata e instancës më të lart.

Shumica e teoricienëve të së drejtës së procedurës penale e përkrahim qëndrimin e parë, sipas të cilëve, plotësimi i ankesës mund të bëhet brenda afatit ligjor për paraqitjen e ankesës. Kjo për faktin se plotësimi i ankesës është pjesë e ankesës, kurse ankesa mund të paraqitet brenda afatit ligjor. Duke u nisur nga parimi se afati për paraqitjen e ankesës është afat prekluziv dhe nuk mund të zgjatet, atëherë edhe plotësimi i ankesës me parashtresë nga ana e ankuesit mund të bëhet brenda këtij afati.

Plotësimi i ankesës duhet të përmbajë të dhëna që kanë të bëjnë me plotësimin dhe sqarimin e bazave ligjore, për të cilat është paraqitur ankesë më parë. Nëse ankuesi me parashtresë i zgjeron bazat (arsyet) për ankesë, atëherë këtu bëhet fjalë për "ankesë të re kundër aktgjykimit", e jo për plotësim të ankesës.

4.3. Përgjigja në ankesë

Njëri ndër parimet kryesore të procedurës penale është padyshim parimi kontradiktor, i cili shprehet përmes premisës *"Audiatur et altera pars",* sipas së cilit gjykata në çështjet penale ka për detyrë që gjatë zhvillimit

[56] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, fq.163.

të procedurës penale, para se të marrë vendim lidhur me çështje të caktuara, çdo herë të dëgjojë edhe palën tjetër.[57]

Në procedurën sipas ankesës, ky parim i procedurës penale realizohet në atë mënyrë që gjykata e shkallës së parë para se t'ia dërgojë ankesën gjykatës së shkallës së dytë, duhet që një kopje të ankesës t'ia dërgoj edhe palës tjetër, e cila në afat prej tetë (8) ditëve ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, ky parim i procedurës penale është trajtuar dhe nga GjEDNj-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore, me ç 'rast edhe mos respektimi i këtij parimi, në situata të caktuara është konsideruar edhe shkelje e nenit 6, paragrafi 1 të KEDNj-së, përkatësisht të drejtës për një proces të rregullt.[58]

Përndryshe, në nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se "Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës".[59]

Me dërgimin e ankesës palës tjetër, kjo e fundit njoftohet me pretendimet e paraqitura në ankesë dhe ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë, duke paraqitur kundër argumente, me qëllim të përfaqësimit sa më të drejtë të të drejtave dhe interesave në procedurë penale.

---

[57] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, fq. 93; SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 164.

[58] GjEDNj-ja në rastin *"Brandstetter kundër Austrisë"*, aktgjykimi i datës 28.08.1991, paragrafët 67-69, kishte theksuar se "E drejta për një gjykim kontradiktor do të thotë, në një çështje penale, që si prokurorisë, ashtu edhe mbrojtjes duhet t'i jepet mundësia të kenë njohuri dhe komente mbi dosjet dhe provat e paraqitura nga pala tjetër. Janë të mundshme mënyra të ndryshme në të cilat ligji kombëtar mund të sigurojë që kjo kërkesë është përmbushur. Megjithatë, cilado metodë të zgjidhet, ajo duhet të sigurojë që pala tjetër do të jetë e vetëdijshme për pretendimet që janë paraqitur dhe do të ketë një mundësi reale për të komentuar mbi to. Në rastin konkret, asnjë kopje e parashtresave të Prokurorit të Lartë Publik nuk i është dërguar parashtruesit dhe se ai nuk ishte i informuar as për paraqitjen e tyre".

[59] Në nenin 423 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, përgjigja në ankesë emërtohet "Apel kundërshtues". Në paragrafin 1 të këtij nenit është parashikuar se "Pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për apelin e palës tjetër".

Përveç që është detyrim për gjykatën për t'ia dorëzuar ankesën palës tjetër, kjo njëkohësisht është edhe e drejtë e palëve tjera, e cila e drejtë është e ndërlidhur edhe me të drejtën e saj për të paraqitur përgjigje në ankesë.

Përndryshe, dështimi për ta përmbushur këtë detyrim ("mos dorëzimi i ankesës palëve tjera") përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së, pasi që një shkelje e tillë ndikon ose mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.[60]

Paraqitja e përgjigjes në ankesë nuk është detyrim për palët tjetra, por kjo është vetëm një mundësi që të deklarohen lidhur me pretendimet që janë paraqitur në ankesë.[61] Një gjë e tillë mund të vërtetohet edhe nga vetë përmbajtja e dispozitës ligjore të nenit 388, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se "Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda ...".

E drejta e paraqitjes së përgjigjes në ankesë i takon vetëm palëve tjera. Për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, i cili në nenin 388, paragrafin 2 kishte përcaktuar se një kopje e ankesës është dashur që t'i

---

[60] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.44, datë 18.07.2000, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.239, datë 23.06.1999, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lënë në fuqi një vendim i Gjykatës së Apelit në Durrës. Gjykata Kushtetuese, kishte vendosur që të shfuqizoj vendimin dhe dërgimin e çështjes në rishqyrtim me këtë arsyetim: Nga materialet e dosjes rezulton se nuk ka asnjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, t'i jetë komunikuar rekursi i ushtruar nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit në Durrës. Në këtë mënyrë është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të KPP-së në të cilën shprehet se "Akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që e ka dhënë vendimin". Duke mos u përmbushur ky detyrim ligjor, të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dijë se çështja e tij do të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe njëkohësisht të dëgjohet e të mbrohet rreth parashtrimeve të bëra nga prokurori në rekursin e tij. Mohimi të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin jo të rregullt, në kuptim të nenit 42, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Cituar sipas: LUARASI, ALEKS: *Kodi i procedurës penale me praktikë gjyqësore*, Tiranë, 2002, fq. 243-245.

[61] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës,* fq. 165.

dërgohet "palëve kundërshtare", të cilët edhe kanë pasur të drejtë që të paraqesin përgjigje në ankesë, tani sipas dispozitave ligjore të KPP-së, një kopje e ankesës duhet që t'i dërgohet "palëve tjera" të cilat kanë të drejtë që të paraqesin përgjigje në ankesë. Andaj, sipas kësaj zgjidhje ligjore që është akceptuar në KPP, nga një kopje e ankesës duhet që t'i dërgohet palëve tjera, e jo vetëm palëve kundërshtare, siç ka qenë e parashikuar me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale.

Përgjigja në ankesë duhet të dërgohet në gjykatën themelore e cila e ka marrë aktgjykimin brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. E drejta e dhënies së përgjigjes në ankesë ekziston pavarësisht faktit se në çfarë shkaqesh është bazuar ankesa. Paraqitja e përgjigjes në ankesë i jep mundësi gjykatës së instancës më të lart që vendimmarrjen e saj lidhur me ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta bëj në mënyrë sa më objektive.[62] Afati për paraqitjen e përgjigjes në ankesë është tetë (8) ditë dhe fillon të llogaritet nga dita e nesërme pas pranimit të ankesës.[63]

Ankesa kundër aktgjykimi i dërgohet palëve tjera për përgjigje, vetëm pasi gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të konstatojë se ankesa është e afatshme dhe e lejuar.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues konstaton se ankesa është e paafatshme ose palejuar, atëherë e hedh me aktvendim dhe fare nuk i dërgohet palëve tjera.

Në nenin 388, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se "Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hedh ankesën me aktvendim:

2.1. Si të paafatshme kur konstatohet se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor; ose

2.2. Si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj".

---

[62] HAJDARI, AZEM: *Komentar i Kodit të Procedurës Penale,* Prishtinë, 2016, fq. 944.

[63] Në nenin 445, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se *"Ora ose dita kur është bërë dorëzimi, njoftimi apo kur ka ndodhur ngjarja që konsiderohet si fillim i afatit nuk llogaritet në afat, por për fillim të afatit merret ora apo dita e parë vijuese"*.

Me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është rregulluar në mënyrë shprehimore përmbajtja e përgjigjes në ankesë. Megjithatë, meqë përgjigja në ankesë është lloj i parashtresës në procedurë penale, atëherë edhe gjithçka që duhet të ketë çdo parashtresë, duhet të ketë edhe përgjigja në ankesë.

Në radhë të parë, përgjigja në ankesë duhet të përmbajë argumente me të cilat hedhen poshtë pretendimet e ankuesit të cilat i ka paraqitur në ankesë.[64]

Duke qenë se përgjigja në ankesë i mundëson palëve tjera që të deklarohen lidhur me ankesën, përmbajtja e përgjigjes në ankesë sillet parimisht në kufijtë e pretendimeve ankimore, me qëllim që ato të kontestohen, mbështetën ose tregohen më ndryshe nga ato të paraqitura në ankesë. Për këtë arsye, në procedurën lidhur me ankesën vendohet lidhur me ankesën dhe jo lidhur me përgjigjen në ankesë.[65]

Nëse palët tjera kanë paraqitur përgjigje në ankesë, atëherë gjykata themelore duhet që nga një (1) kopje të përgjigjes në ankesë t'ia dërgojë ankuesit. Në nenin 388, paragrafi 3, fjalia e dytë e KPP-së është parashikuar se "Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafin 3 këtij Kodi", kurse në nenin 377, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se "Përgjigja paraqitet në gjykatë themelore, e cila ia dërgon përgjigjen palës tjetër". Kjo tani konsiderohet risi në KPP, pasi që me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale nuk ka qenë e nevojshme dhe as që ka qenë detyrë e gjykatës themelore që kopjen e përgjigjes në ankesë t'ia dërgojë ankuesit.

Pasi të jetë paraqitur përgjigja në ankesë ose pasi të kalojë afati për përgjigje (nëse nuk është paraqitur përgjigje në ankesë), gjykata themelore duhet që t'ia dërgon gjykatës së shkallës së tretë, përkatësisht Gjykatës Supreme të Kosovës për vendosje ankesën, përgjigjen në ankesë (nëse ka) dhe shkresat tjera. Një gjë e tillë është parashikuar në nenin 388, paragrafi 4 të KPP-së, sipas së cilës "Kjo gjykatë i përcjell ankesën,

---

[64] SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës,* fq. 168.

[65] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës,* Komentar, Prishtinë, 2014, fq. 920.

përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës".

4.4. Vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike, si arsye për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë

Siç është theksuar edhe më parë, ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale është mjet juridik i plotë, sepse mund të paraqitet për të gjitha bazat si juridike ("Error iuris") ashtu edhe faktike ("Error facti"). Gabimet e natyrës faktike ("Error facti") kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Derisa shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet e ligjit penal, janë të përcaktuar në mënyrë takstative, të metat në të cilat thirret ankuesi sipas kësaj baze janë dhënë në KPP me një formulim të përgjithshëm.[66]

Kështu, sipas dispozitës ligjore të nenit 386 të KPP-së, aktgjykimi mund të kundërshtohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose të incizimit teknik vënë në pikëpyetje saktësinë ose bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme. Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore të KPP-së, gabimet e natyrës faktike ("Error facti"), mund të manifestohen në dy grupe :

1) në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe
2) në vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjendja faktike në procedurë penale është tërësi e fakteve vendimtare (fakteve juridike relevante). Ajo është gjendje e konstatuar me vendim gjyqësor, gjendje në të cilën mbështetet vendimi gjyqësor.[67] Pra, tërësia e fakteve vendimtare (fakteve juridike relevante) e përbëjnë gjendjen faktike. Ndërsa, faktet juridike relevante janë të gjitha faktet ekzistuese

[66] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale,* fq. 410.

[67] SAHITI, EJUP: *Argumentimi në procedurën penale,* Prishtinë, 1999, fq. 111-112.

ose që kanë ekzistuar, të cilat janë të përfshira në kushtet që i parashtron e drejta penale materiale për shqiptimin e sanksionit penal, faktet që gjenden në kushtet në të cilat e drejta e procedurës penale e lidh detyrimin e gjykatës që të zhvillojë procedurë penale, si dhe faktet të cilat gjenden në kushtet nga të cilat varet mënyra e ushtrimit të veprimeve procedurale. Gjendja faktike e vërtetuar me vendim gjyqësor, duhet të përputhet me të vërtetën materiale, e cila nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha fakteve relevante, nga të cilat varet zbatimi i së drejtës penale materiale dhe i të drejtës së procedurës penale. Të gjitha përpjekjet procedurale duhet të orientohen në atë që gjendja faktike e konstatuar të përputhet me të vërtetën materiale, që ajo të jetë shprehje e saj, sepse vetëm atëherë mund të konsiderohet se gjendja faktike është gjendje e vërtetuar saktë dhe drejt.

Konsiderohet se ekziston vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, atëherë kur gjykata në bazë të fakteve dhe provave të caktuara ka vërtetuar gjendjen faktike, por me rastin e vlerësimit të provave dhe përfundimit mbi të vërtetën e tyre ka gabuar. Ndërsa, vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka lëshuar të vërtetojë të gjitha faktet relevante dhe provat e duhura për marrjen e vendimit gjyqësor. Me fjalë të tjera, vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata nuk i ka proceduar të gjitha provat apo kur pas procedimit të provave ekzistuese janë paraqitur prova të reja ose fakte të reja të cilat tregojnë se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë.

Çështja e vërtetimit të gjendjes faktike është çështje e ndërlikuar, sepse gjendja faktike çdoherë paraqet një kompleks faktesh dhe rrethanash të ndryshme të cilat duhet të merren në lidhshmërinë dhe varëshmërinë e tyre. Çështja e gjendjes faktike asnjëherë nuk është e ndarë nga çështjet juridike. Vërtetimi i elementeve të veprës penale dhe i momenteve tjera të rëndësishme për përgjegjësinë penale ose për dënim më të madh ose më të vogël është problem faktik, por njëherit është edhe çështje e vlerësimit juridik, sepse dispozitat juridike janë udhërrëfyes për atë se cilat fakte janë të rëndësishme për rastin konkret. Prandaj, çështjet faktike dhe ato juridike vazhdimisht gërshetohen në veprimtarinë gjyqësore.[68]

---

[68] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale,* fq. 410-411.

4.5. Parimet "Reformatio in Peius" dhe "Beneficium Cohaesionis"

"Reformatio in peius" është një parim themelor i së drejtës procedurale penale, i cili ndalon përkeqësimin e pozitës juridike të të akuzuarit në rast se ndaj një aktgjykimi është parashtruar ankesë vetëm në dobi të tij. Ky parim synon të garantojë të drejtën për mjete juridike pa rrezikuar një vendim më të rëndë penal si rezultat i ushtrimit të kësaj të drejte.

Parimi "Reformatio in peius" ka lindur në kuadër të procedurës penale inkuizitore në Evropë. Fillimisht u përfshi në Kodin penal austriak të vitit 1803, dhe më pas në Kodin penal të Prusisë të vitit 1805. Gjatë zhvillimit të mëvonshëm të procedurës penale në shtetet e Evropës kontinentale, ky parim është përfshirë në mënyrë të konsoliduar në legjislacionin përkatës, si një garanci procedurale në favor të të pandehurit.[69]

Sipas dispozitës ligjore të nenit 395 të KPP-së, nëse është parashtruar ankesë vetëm në favor të të akuzuarit, aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij në asnjë aspekt që ka të bëjë me cilësimin juridik të veprës penale apo me sanksionin penal. Siç shihet, kjo dispozitë vendos një kufizim për gjykatën e shkallës së tretë, e cila nuk mund të rishqyrtojë vendimin në dëm të të akuzuarit nëse mjeti juridik është përdorur vetëm në favor të tij. Kjo përjashton mundësinë që gjykata e shkallës së tretë të ashpërsojë dënimin apo të rikualifikojë veprën penale në një vepër më të rëndë.

Përndryshe, parimi "Reformatio in peius" nuk është i zbatueshëm në rastet kur, përveç ankesës në dobi të të akuzuarit, ekziston edhe një ankesë në dëm të tij (p.sh., nga prokurori i shtetit). Në këto raste, gjykata e shkallës së tretë ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha aspektet e vendimit, duke përfshirë edhe mundësinë për përkeqësim të pozitës së të akuzuarit. Ky parim synon të ruajë balancën midis të drejtës së të akuzuarit për ankimim dhe sigurisë juridike, duke e mbrojtur atë nga rreziku i një sanksioni më të rëndë për shkak të ushtrimit të të drejtës për mjet juridik. Zbatimi i këtij instituti stimulon përdorimin e mjeteve juridike nga ana e të akuzuarit, sidomos kur ai konsideron se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i padrejtë apo në kundërshtim me ligjin.

---

[69] MURATI, REXHEP, *Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja,* fq. 82.

Parimi "Reformatio in peius" nuk ndalon rishqyrtimin e fakteve që mund të rezultojnë të pafavorshme për të akuzuarin (p.sh. në rigjykim). Megjithatë, pavarësisht konstatimit të fakteve të reja që implikojnë më rëndë të akuzuarin, gjykata nuk ka të drejtë të përkeqësojë cilësimin juridik apo të ashpërsojë dënimin nëse mjeti juridik është përdorur vetëm në favor të tij. Dhe në fund, duhet theksuar se ky parim aplikohet si me rastin e përdorimit të mjeteve të rregullta[70] dhe të jashtëzakonshme[71] me rastin e vendosjes në rigjykim deri te i cili ka ardhur në bazë të mjetit juridik të përdorur në dobi të të akuzuarit.

"Beneficium cohaesionis" është po ashtu një parim procedural që ka lidhshmëri me përdorimin e ankesës kundër aktgjykimit në procedurë penale. Ky parim procedural ndryshe quhet edhe "Beneficioni bashkangjitës'' dhe është i parashikuar në favor të të akuzuarit.

Thelbi i këtij parimi qëndron në atë se gjykata e ankesës është e detyruar që përshtatshmëritë të cilat i ka konstatuar se ekzistojnë për të akuzuarin i cili ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit, t'i zbatojë edhe ndaj të të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur ankesë në atë drejtim. Parimi "Beneficium cohaesionis" është i parashikuar në mënyrë shprehimore në dispozitën ligjore të neni 397 të KPP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore, kur me rastin e paraqitjes së ankesës së cilitdo të akuzuar, Gjykata e Apelit (në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë) çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur në atë drejtim, gjykata vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur edhe nga i bashkakuzuari. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjykata vepron ashtu sikur të ekzistonte ankimi: i bashkakuzuarit që nuk ka bërë ankim, i bashkakuzuarit ankimi i të cilit është hedhur poshtë si i palejuar ose jashtë afatit dhe në kushte të caktuara ankimi i të bashkakuzuarit që ka hequr dorë prej tij.[72]

---

[70] Neni 406, paragrafi 4 i KPP-së.

[71] Neni 428, paragrafi 4 dhe neni 439, paragrafi 4 i KPP-së.

[72] MURATI, REXHEP, *Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja,* fq. 95.

Siç shihet mundësia e bashkëngjitjes vjen në shprehje te koneksiteti i veprave penale. Kështu, nëse shumë persona janë përfshirë me një procedurë penale unike dhe ndaj tyre është dhënë një aktgjykim, parimi "Beneficuim cohaesionis" vjen në shprehje po qe se ndonjëri i akuzuar me sukses ushtron ankesë kundër atij aktgjykimi. Ekzistimi i këtij parimi në procedurën tonë penale arsyetohet me nevojën për sigurimin e barazisë së qytetarëve para ligjit.[73]

4.6. Të dhënat statistikore

Në vijim do të paraqiten disa të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë numrin e ankesave ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe mënyrën e vendosjes nga Gjykata Supreme e Kosovës.



Nga grafikoni i paraqitur më lart, shihet se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar katër (4) lëndë sipas ankesave ndaj aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së dytë, prej tyre:

- Në një (1) rast është refuzuar ankesa;
- Në një (1) rast është pranuar ankesa dhe
- Në dy (2) raste është hedhur ankesa.

[73] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale,* fq. 421.

5. Ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës

Siç është theksuar edhe më parë, në dispozitën ligjore të nenit 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së është parashikuar se Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente që të vendos në lidhje me ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëse gjykata në fjalë e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për të cilat është kompetente të vendosë Gjykata Supreme e Kosovës, mund të paraqitet në këto dy (2) raste:

1. *Së pari,* në rastet kur Gjykata e Apelit e Kosovës e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin, dhe
2. *Së dyti,* në rastet kur paraburgimi caktohet për herë të parë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Situata e dytë, në të cilën është parashikuar mundësia e paraqitjes së ankesës ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për të cilën vendos Gjykata Supreme e Kosovës është e qartë dhe vjen në shprehje në rastet kur paraburgimi është caktuar për herë të parë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Megjithatë, mbetet mjaft e paqartë se në cilat raste lejohet paraqitja e ankesës ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëse gjykata në fjalë e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin. Kjo për faktin se, në parim, kur Gjykata e Apelit e Kosovës vendos mbi ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me paraburgimin, atëherë vendimi bëhet i formës së prerë.

Në këto raste, kundër një vendimi të tillë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se "... kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit". Si dispozita ligjore e nenit 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së, duke parashikuar dy rastet kur mund të paraqitet ankesë kundër

aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ashtu edhe dispozita ligjore e nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, në të cilën është parashikuar mundësia e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, nën rrethanat kur është ndërprerë paraburgimi, janë dispozita të reja ligjore, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale.
Për këto arsye dhe duke qenë se deri më tani nuk është paraqitur ndonjë ankesë ku do të pretendohet lidhur me këto aspekte, atëherë mbetet që në një të ardhme sa më të afërt, të konsolidohet praktika gjyqësore në këtë drejtim.
Përndryshe, duhet theksuar se bazuar në dispozitën ligjore të nenit 417 të KPP-së, procedura e cila zbatohet në Gjykatën e Apelit të Kosovës lidhur me ankesën kundër aktvendimit të gjykatës themelore zbatohet përshtatshmërisht për procedurën në Gjykatën Supreme të Kosovës për vendosjen lidhur me ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.
Nga të dhënat e siguruara, rezulton se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar katër (4) lëndë sipas ankesave ndaj aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilat kjo gjykatë kishte caktuar paraburgimin për herë të parë. Në tre (3) prej këtyre rasteve, ankesat janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa në një (1) rast, ankesa është aprovuar, kështu që paraburgimi është ndërprerë dhe ndaj të pandehurit është caktuar masa e ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar.

6. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

6.1. Shqyrtime të përgjithshme

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është një mjet i jashtëzakonshëm juridik që mund të paraqitet në rastet e caktuara kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.
Arsyet për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, janë të përcaktuara në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se "Kundër vendimit

gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor."

Mirëpo, përtej këtyre arsyeve, është e rëndësishme që të theksohet se duke u bazuar në nenin 440 të KPP-së, mjetet e jashtëzakonshme juridike, përkatësisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqiten edhe në bazë të të drejtave të siguruara me KPP dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në dispozitën ligjore të nenit 432, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.

Gjithashtu, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.[74] Siç shihet, për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, tani me dispozitat ligjore të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, edhe në rastet kur me vendimin e formës së prerë është vendosur që të ndërprehet paraburgimi.

Përndryshe, siç do të shohim në vijim, përqindja më e madhe e çështjeve penale që shqyrtohen dhe gjykohen në Gjykatën Supreme të Kosovës iniciohen sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë.

[74] Neni 432, paragrafi 4 i KPP-së

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.[75]

Persona të autorizuar për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sipas dispozitës ligjore të nenit 433, paragrafi 1 të KPP-së janë: Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1 të këtij Kodi.[76]

Zyra e Kryeprokurorit të shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafin 1 të këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita e dorëzimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë. Me dispozitat ligjore të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, afati tre (3) mujor për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, për të gjithë personat e autorizuar, ka filluar që të llogaritet, nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë.[77] Ndërsa, tani sipas dispozitës ligjore të lartcekur, afati tre (3) mujor për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, për secilin prej personave të autorizuar, fillon të llogaritet nga dita e dorëzimit të vendimit të formës së prerë personit në fjalë. Gjithashtu, edhe në dispozitën ligjore të nenit 419, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga dita kur është dorëzuar aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së

[75] Neni 432, paragrafi 2 i KPP-së.

[76] Në dispozitën ligjore të nenit 424, paragrafi 1 të KPP-së, është parashikuar se "Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini gjaku në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit".

[77] Neni 433, paragrafi 2 i Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale (Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, datë 13.12.2012).

prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Po ashtu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se pala e paraqet kërkesën në gjykatën themelore e cila ka nxjerr vendimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme. Dispozitat ligjore të neneve 375, 376, 377, 378 dhe 379 të KPP-së Kodi zbatohen edhe në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.[78]

Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hedh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse kërkesa është e papranueshme ose janë plotësuar kushtet nga neni 434, paragrafi 2 i KPP-së. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës tjetër, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë.[79] Nëse Gjykata Supreme e Kosovës nuk e hedh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, atëherë e njëjta duhet që të vlerëson dhe të vendos në lidhje me meritat e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Në këtë drejtim, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës është vërejtur se mund të paraqiten këto situata:

1) që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
2) që të aprovohet/refuzohet pjesërisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ose
3) që të aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në rastet kur kemi disa të pandehur/dënuar për vepra penale të ndryshme apo të njëjta dhe janë paraqitur disa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë për secilën kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë veç e veç mund të paraqiten tre (3) situatat e lartcekura.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim e refuzon si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, nga nenet 386 dhe 432, paragrafi 2 të KPP-së.[80]

[78] Neni 419, paragrafi 4 i KPP-së.
[79] Neni 435, paragrafi 2 i KPP-së.
[80] Neni 437 i KPP-së.

Ndërsa, nëse Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.[81]

Në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është *"qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë"*.[82]

Duke e pasur parasysh se tani një mundësi e tillë është risi në KPP, kurse në anën tjetër, në dispozitat ligjore të KPP-së nuk është sqaruar se kur *"vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm"* ose *"i bazuar në gabim të rëndë"*, atëherë do t'i mbetet praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës që të definojë këto nocione, gjithnjë duke i pasur në konsideratë specifikat e rasteve konkrete, si dhe duke ju referuar edhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në dispozitat ligjore të nenit 436 të KPP-së janë parashikuar disa nga favoret e të pandehurit përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit të lartcekur, me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon. Pra, Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrton vetëm pretendimet e ngritura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në parim, nuk shqyrton aspekte tjera sipas detyrës zyrtare, nëse nuk janë ngritur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ("*Tantum devolutum quantum appellatum*").

Megjithatë, kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të pandehurit ekzistojnë edhe për

[81] Neni 438, paragrafi 1 i KPP-së.

[82] Neni 438, paragrafi 2 i KPP-së.

ndonjërin nga të bashkakuzuarit që nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga personi i tillë ("*Beneficium Cohaesionis*"). Gjithashtu, kur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur në dobi të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të KPP-së ("*Reformatio in Peius*").[83]

6.2. Të dhënat statistikore

6.2.1. Shqyrtime të përgjithshme

Në vijim do të paraqiten disa të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë numrin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë, natyrën e vendimit që kontestohet dhe mënyrën e vendosjes nga Gjykata Supreme e Kosovës.



Nga grafikoni i paraqitur më lart, shihet se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar 816 lëndë sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë. Prej tyre, në 329 lëndë (40.32%), kërkesat për mbrojtjen të ligjshmërisë janë paraqitur në lidhje me vendimet e formës

[83] Neni 436, paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së.

së prerë, përkitazi me paraburgimin (caktim, vazhdim ose ndërprerje), kurse në 487 lëndë (59.68%), kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur ndaj aktgjykimeve të formës së prerë.

6.2.2. Mënyra e vendosjes në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilat janë paraqitur në lidhje me vendimet e formës së prerë, përkitazi me paraburgimin (caktim, vazhdim ose ndërprerje)

Sa i përket kërkesave për mbrojtjen të ligjshmërisë të cilat janë paraqitur në lidhje me vendimet e formës së prerë, përkitazi me paraburgimin (caktim, vazhdim ose ndërprerje), gjithsej 329 lëndë, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në këtë mënyrë:

- Në 237 raste (72.04%) është refuzuar kërkesa;
- Në 58 raste (17.63%) është pranuar kërkesa;
- Në 31 raste (9.42%) është hedhur kërkesa dhe
- Në 3 raste (0.91%) është vendosur në mënyrë tjetër.



Në rastet kur është pranuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë:

- Në 18 raste (31.03%) është anuluar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë;
- Në 2 raste (3.45%) është anuluar aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë;

- Në 30 raste (51.72%) është ndryshuar aktvendimi i formës së prerë dhe është ndërprerë paraburgimi;
- Në 7 raste (12.07%) është ndryshuar aktvendimi i formës së prerë dhe është caktuar masa e arrestit shtëpiak dhe
- Në 1 rast (1.72%) është ndryshuar aktvendimi i formës së prerë dhe është caktuar masa paraqitja në stacionin policor.

6.2.3. Mënyra e vendosjes në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilat janë paraqitur ndaj aktgjykimeve të formës së prerë

Sa i përket kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilat janë paraqitur ndaj aktgjykimeve të formës së prerë, gjithsej 487 lëndë, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në këtë mënyrë:

- Në 318 raste (65.28%) është refuzuar kërkesa;
- Në 124 raste (25.46%) është pranuar kërkesa;
- Në 42 raste (8.62%) është hedhur kërkesa dhe
- Në 3 raste (0.62%) është vendosur në mënyrë tjetër.



Në rastet kur është pranuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë:

- Në 54 raste (43.55%) është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë;
- Në 7 raste (5.65%) është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së dytë;
- Në 39 raste (31.45%) janë anuluar aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë;
- Në 24 raste (19.35%) është anuluar vetëm aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë.



7. Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit

7.1. Shqyrtime të përgjithshme

Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme është një mjet i jashtëzakonshëm juridik, përmes të cilit kërkohet ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë vetëm sa i përket dënimit të shqiptuar.

Për dallim nga mjetet tjera juridike, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik mund të ushtrohet vetëm në dobi të personit të dënuar.

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënim më të ulët.[84] Rrethanat të cilat mund të sjellin deri tek zbutja e jashtëzakonshme e dënimit janë të shumta, megjithatë duhet theksuar se

[84] Neni 429 i KPP-së.

jo çdo rrethanë mund të jetë arsye për një zbutje të tillë të dënimit. Se cilat janë ato rrethana që do të mund të ishin arsye për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, kjo duhet të jetë objekt i vlerësimit të gjykatës, duke i pasur në konsideratë të gjitha rrethanat specifike të rasteve individuale. Duke ju referuar edhe rasteve nga praktika gjyqësore, rrethanë e tillë që mund të sjellë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është sëmundja e rëndë e të dënuarit. Ose, zbutja e jashtëzakonshme e dënimit do të mund të vjen në shprehje në situatat kur me rastin e matjes së dënimit është marrë për bazë fakti se i dënuari edhe më parë është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, mirëpo ky aktgjykim i formës së prerë, më pastaj është prishur sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit mund të vjen në shprehje në dy (2) situata:

1) Nëse pasi që aktgjykimi është bërë i formës së prerë janë paraqitur rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose,

2) Megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënim më të ulët.

Kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqesë prokurori i shtetit kur procedura është zbatuar me kërkesë të tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.[85]

Përndryshe, duhet theksuar se kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit, pra ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk ka karakter suspenziv.

Për kërkesën mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit vendos Gjykata Supreme e Kosovës, mirëpo kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me nenin 376 të këtij Kodi i paraqitet gjykatës themelore e cila ka marrë aktgjykimin. Gjykata themelore, më pastaj ia dërgon kërkesën prokurorit të shtetit, i cili përgjigjet në pajtim me nenin 377 të këtij Kodi. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të gjykatës themelore me aktvendim e hedh kërkesën që nuk është në

[85] Neni 430, paragrafi 1 i KPP-së.

pajtim me nenin 376 të këtij Kodi. Kundër aktvendimit nga paragrafit 4 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit. Kur gjykata themelore vërteton se a ekzistojnë shkaqe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e pastaj shkresat me propozimin e arsyetuar ia dërgon Gjykatës Supreme të Kosovës.[86]

Sipas dispozitës ligjore të nenit 419, paragrafi 2 të KPP-së, pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

Duke vendosur sipas kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës ka tre (3) mundësi:

1) ta hedh kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, nëse p.sh. është paraqitur nga personat e paautorizuar;

2) ta refuzon si të pabazuar, ose

3) ta aprovon si të bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën kur çmon se nuk ka bazë ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ndërsa kur e aprovon kërkesën, gjykata me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin.[87]

7.2. Të dhënat statistikore

Në vijim do të paraqiten disa të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë numrin e kërkesave për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe mënyrën e vendosjes nga Gjykata Supreme e Kosovës.



[86] Neni 431, paragrafët 1-6 të KPP-së
[87] Neni 431, paragrafi 7 i KPP-së.

Nga grafikoni i paraqitur më lart, shihet se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar 137 lëndë sipas kërkesave për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, prej tyre:

- Në 129 raste (94.16%) është refuzuar kërkesa;
- Në 6 raste (4.38%) është pranuar kërkesa dhe
- Në 2 raste (1.46%) është hedhur kërkesa.

7.3. Pjesë të vendimeve gjyqësore

Në vijim, do të paraqiten disa pjesë të vendimeve gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me kërkesat për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

Aktvendimi Pzd.nr.141/2024, datë 13.01.2025.

A K T V E N D I M

Pranohet kërkesa e mbrojtësit të dënuarit S. B. për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ndryshohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prishtinë, - Departamenti Special, PS.nr.10/2020, i datës 28.04.2023, përkitazi me vendimin për dënim, me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, i cili i është shqiptuar për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 421, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, zbutet në mënyrë të jashtëzakonshme në dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e shtatë (7) muajve, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpia nga data 19.09.2019 deri më datë 23.03.2020. Dënimi unik me gjobë në shumë prej 3.500 (tremijë e pesëqind) euro, ngel i paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.10/2020 të datës 28.04.2023, i dënuari S. B., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar

dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 19.09.2019 deri më datë 23.03.2020, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) euro, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, ashtu që e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë) euro, të cilën gjobë i dënuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dënuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në Administratën Publike ose në Shërbim Publik në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar me aktgjykim.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.45/2023 e datës 15.12.2023, me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të dënuarit, e ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin me burgim dhe dënimit me gjobë, ashtu që kjo gjykatë të dënuarit S. B. për veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 421 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) euro, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro. Në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 3.500 (tremijë e pesëqind) euro.

Pjesa tjetër e aktgjykimit për dënimin plotësues dhe konfiskimin e armës mbetet e pandryshuar. Ankesa e mbrojtësit në pjesët tjera. si dhe ankesa e Prokurorisë Speciale në Prishtinë lidhur me sanksionin penal është refuzuar si e pabazuar.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit S. B., avokati Besnik Berisha nga Prishtina, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën, ashtu që të ndryshoj aktgjykimin e formës së prerë dhe ti zbutë dënimin.

Kryeprokurori i Shtetit, me parashtresën KZJD.nr.141/2024 e datës 08.01.2025, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me shkresën, KP.nr.427/2024 e datës 12.12.2024, si dhe Prokuroria Speciale, në përgjigjen PPS.nr.52/2019 e datës 10.12.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me dispozitën e nenit 431, paragrafi 1 të KPP-së, gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e bazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikonin në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesën e tij, mbrojtësi i të dënuarit thekson se, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, janë paraqitur rrethana të reja të cilat kanë ndikim në shqiptimin e dënimit më të butë. Si rrethanë të re, thekson se tek i dënuari është shfaqur sëmundja e rëndë kancer në prostatë e shoqëruar me dhimbje të mëdha, po ashtu së bashku edhe me problemet shëndetësore të mëparshme. Kërkesës i ka bashkangjitur raportet mjekësore në emër të të dënuarit të lëshuar nga SHSKUK-Klinika e Kardiologjisë datave 18.03.202, 15.03.2022, raportin e kardiologut të datës 20.01.2024, fletë lëshimin me epikrizë nga Spitali Regjional në Pejë, datave 19.01.202, 03.03.2022, ordinancave specialistike si “XXX”, datave 20.05.2024, 30.07.2024, 05.08.2024, 13.08.2024, 30.10.2024, “XXX” Pejë datë 02.09.2023, CT scanner datë 18.08.2023, “Titan” i datës 23.08.2023, “XXX” i datës 03.06.2022, si dhe shumë raporte tjera mjekësore.

Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se është argumentuar ekzistimi i rrethanave të reja. I dënuari ka probleme shëndetësore të natyrës serioze për të cilat i ka bashkangjitur raportet mjekësore në emër të të dënuarit të lëshuar nga SHSKUK-Klinika e Kardiologjisë, të datave 18.03.202, 15.03.2022, raportin e kardiologut të datës 20.01.2024, fletë lëshimin me epikrizë nga Spitali Regjional në Pejë, datave 19.01.202, 03.03.2022, ordinancave specialistike si "XXX", datave 20.05.2024, 30.07.2024, 05.08.2024, 13.08.2024, 30.10.2024, "XXX" Pejë datë 02.09.2023, CT scanner datë 18.08.2023, "XXX" i datës 23.08.2023, "XXX" i datës 03.06.2022, si shumë raporte tjera mjekësore, ku shihe qartë se gjendja e të dënuarit po shkon duke u keqësuar dhe se ai nuk gëzon shëndet të mirë shëndetësore.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, sëmundjet e cekura janë një rrethanë e re, në kuptim të dispozitës së nenit të lartcekur, e cila nuk ka ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit të formës së prerë, e cila është e karakterit që ndikon në shqiptimin e dënimit më të ulët, gjegjësisht se sikur të kishte ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimeve, do të ndikonte që dënimi të jetë më i ulët. Andaj, kërkesa u aprovua dhe u vendos që dënimi i shqiptuar të dënuarit të zbutet për 5 (pesë) muaj, me bindje se me këtë dënim të cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

Nga të gjitha që u thanë më lart, e konform dispozitës së nenit 431, paragrafi 1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi Pzd.nr.90/2024, datë 09.08.2024.

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit B.P., për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë PK.nr.122/2023 të datës 24.11.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin PK.nr.122/2023 e datës 24.11.2023, ka aprovuar kërkesën e të të dënuarit B.P., për bashkimin e dënimeve, ashtu që ka ndryshuar vendimet mbi dënimin në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, PK.nr.381/2020, i datës 06.09.2021, i plotfuqishëm më datë 06.10.2021, aktgjykimin P.nr.380/2015, i datës 30.08.2017, i plotfuqishëm më datë 21.01.2018, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.136/2021, të datës 11.10.2021, i plotfuqishëm më datë 09.12.2021, ndryshohen sa i përket për bashkim të dënimeve dhe atë: dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) vite, si dhe dënim unik me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro, sipas aktgjykimit të kësaj gjykate PK.nr.381/2020 i datës 06.09.2021, i plotfuqishëm më datë 06.10.2021, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, sipas aktgjykimit P.nr.380/2015 të datës 30.08.2017, i plotfuqishëm më datë 21.01.2018 për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe dënimin me burgim të në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro, i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.136/2021 të datës 11.10.2021, i plotfuqishëm 09.12.2021, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Andaj, në mbështetje të nenit 420, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me paragrafin 5 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe në kuptim të nenit 76 e 78 të KPRK-së, të dënuarit i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) vite e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim unik me gjobë prej 700 (shtatëqind) euro. Aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm më datë 09.01.2024.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur mbrojtësi i të dënuari B. R., avokati Korab Vokshi nga Gjakova, me propozim që t'i zbutet dënimi.

Kryeprokurori i Shtetit, me parashtresën KZJD.nr.90/2024 e datës 06.08.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Gjakovë, me shkresën PK.nr.122/2023, e datës

23.07.2024, si dhe Prokuroria e Themelores në Gjakovë, në mendimin PP/I.nr.99/2021 e datës 09.07.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me dispozitën e nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), propozimin e gjykatës dhe prokurorisë së shtetit, gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë por gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikonin në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesën e tij, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se i dënuari është në mbajtje të dënimit që nga viti 2012, se këto vepra penale të vjedhjes i ka kryer në kohen kur ka qenë shumë i ri në moshë, tutje thekson se i ka të ndarë prindërit, jeton vetëm me nënën dhe motrën e cila është me paaftësi të përhershme dhe se prania e tij është e domosdoshme në familjen e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit. Disa prej rrethanave në të cilat thirret i dënuari në kërkesë kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykatat e sidomos mosha e re, kurse rrethanat tjera ne të cilat thirret në kërkesën nuk janë të asaj natyre që justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit kur kihet parasysh pesha e veprave panele. Në anën tjetër vuajtja e dënimit për pasojë ka mos mundësinë e përfilljes së disa obligimeve të cilat mund të kryhen kur personi është në liri dhe është pasojë e heqjes së lirisë.

Andaj, në kuptim të dispozitës së nenit 431, paragrafi 7 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi Pzd.nr.37/2024, datë 24.04.2024.

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejueshme kërkesa e babait të dënuarit B.M., për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, P.nr.6/2023, të datës 05.04.2023, të ndryshuar me aktgjykimit e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1156/2023 të datës 18.01.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, me aktgjykimin P.nr.6/2023, e datës 05.04.2023, të dënuarin B.M., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1 e lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së, e ka shpallur fajtorë dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjetë (15) ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1156/2023 e datës 18.01.2024, e ka aprovuar ankesën të dënuarit B.M. dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, P.nr.6/2023, të datës 05.04.2023, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të dënuarit B.M., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Aktgjykimi i ankimuar në pjesët tjera, ka mbetur i pandryshuar.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur babai i të dënuarit B.M., z. Abdullah Musa, për shkak të rrethanave të reja personale që ndikojnë në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovoj si të bazuar kërkesën, ashtu që dënimin e shqiptuar me burgim të ndryshohet me dënim me kusht.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KZJD.nr.37/24, e datës 19.04.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e

babait të dënuarit të hedhet si e palejuar. Kurse, Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, me shkresën P.nr.06/2023, të datës 11.04.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e babait të dënuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me shkresën PP.II.nr.1568/22, të datës 04.04.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar.
Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës dhe kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, në pajtim me nenin 431 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) konstatoi se:

- kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se z. Abdullah Musa, si parashtrues i kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, është babai i të dënuarit B.M.
Me dispozitën e nenit 430, paragrafi 1 të KPP-së, është paraparë se kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqesin prokurori i shtetit, kur procedura është zbatuar me kërkesën e tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij, kurse siç rezulton nga shkresat e lëndës, në rastin konkret kërkesën e ka paraqitur babai i të dënuarit, çka do të thotë se konform dispozitës së nenit 430 të KPP-së, e njëjta nuk është e lejuar.
Andaj, duke u bazuar në këto që u theksuan më lart dhe në bazë të dispozitës së nenit 431, paragrafi 4 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi Pzd.nr.113/2024, datë 09.10.2024.

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejueshme kërkesa e bashkëshortes se të dënuarit H.F., për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.125/2019, të datës 13.07.2020.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin P.nr.125/2020, e datës 13.07.32020, të dënuarin H.F., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë, nga neni 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.04.2019 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.375/202 e datës 25.11.2020, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur bashkëshortja e të dënuarit H.F., znj. L.F., për shkak të rrethanave të reja shëndetësore e të cilat ndikojnë në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovoj si të bazuar kërkesën, ashtu që dënimin e shqiptuar me burgim t'ia zbresë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KZJD.nr.113/2024, e datës 04.10.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e bashkëshortes të dënuarit të hedhet si e palejuar. Kurse, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me shkresën P.nr.125/2019, e datës 19.09.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e bashkëshortes se të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se znj. L.F., si parashtruese e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, është bashkëshortja e të dënuarit H.F..

Me dispozitën e nenit 430, paragrafi 1 të KPP-së, është paraparë se kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqesin prokurori i shtetit, kur procedura është zbatuar me kërkesën e tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij, ndërsa siç rezulton nga shkresa e lëndës në rastin konkret kërkesën e ka paraqitur bashkëshortja e të dënuarit, çka do të thotë se konform dispozitës së nenit 430 të KPP-së, e njëjta nuk është e lejuar.

Andaj, duke u bazuar në këto që u theksuan më lart dhe në bazë të dispozitës së nenit 431, paragrafi 4 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Përfundimet

Siç është theksuar edhe më parë, procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës mund të iniciohet sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Mjete të rregullta juridike janë: ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin është ndryshuar aktvendimi i gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi është caktuar për herë të parë nga kjo Gjykatë, kurse mjete të jashtëzakonshme juridike janë: kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

Duke u bazuar në elementet e përcaktuara me dispozitat ligjore të KPP-së, kemi konstatuar se ankesa kundër aktgjykimit është një mjet juridik i rregullt, suspenziv, devolutiv, i plotë, i dyanshëm të cilën e paraqesin personat e autorizuar për shkak të shkeljeve ligjore apo gabimeve faktike dhe me të cilën i propozojnë gjykatës së shkallës së dytë (tretë) që aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë apo ta anulojë.

E drejta e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve gjyqësore në përgjithësi, konsiderohet e drejtë themelore e njeriut, e cila për shkak të rëndësisë së madhe që ka, përveç me aktet e brendshme juridike, është e paraparë dhe e garantuar edhe me aktet juridike më të rëndësishme ndërkombëtare.

Parimisht procedura jonë penale është procedurë dyshkallëshe, çka do të thotë se një çështje penale mund të jetë objekt i shqyrtimit nga gjykata e

shkallës së parë dhe nga gjykata e shkallës së dytë nëse personat e autorizuar paraqesin ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Me marrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, sipas rregullit, çështja penale konsiderohet çështje e gjykuar ("Res Iudicata"), sepse aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

Megjithatë, në disa raste të përcaktuara me dispozitat ligjore të KPP-së, lejohet mundësia e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht lejohet trishkallëshmëria në procedurë penale.

Nga të dhënat e paraqitura në këtë punim, shihet se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar katër (4) lëndë sipas ankesave ndaj aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së dytë, ku prej tyre: në një (1) rast është refuzuar ankesa; në një (1) rast është pranuar ankesa dhe në dy (2) raste është hedhur ankesa.

Përveç ankesës ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, siç është theksuar edhe më parë, në dispozitën ligjore të nenit 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së është parashikuar se Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente që të vendos në lidhje me ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëse gjykata në fjalë e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Situata e dytë, në të cilën është parashikuar mundësia e paraqitjes së ankesës ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për të cilën vendos Gjykata Supreme e Kosovës është e qartë dhe vjen në shprehje në rastet kur paraburgimi është caktuar për herë të parë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Megjithatë, mbetet mjaft e paqartë se në cilat raste lejohet paraqitja e ankesës ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëse gjykata në fjalë e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin. Kjo për faktin se, në parim, kur Gjykata e Apelit e Kosovës vendos mbi ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me paraburgimin, atëherë vendimi bëhet i formës së prerë. Në këto raste, kundër një vendimi të tillë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se "... kërkesë për mbrojtje të

ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit".

Si dispozita ligjore e nenit 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së, duke parashikuar dy rastet kur mund të paraqitet ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ashtu edhe dispozita ligjore e nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, në të cilën është parashikuar mundësia e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, nën rrethanat kur është ndërprerë paraburgimi, janë dispozita të reja ligjore, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale. Për këto arsye dhe duke qenë se deri më tani nuk është paraqitur ndonjë ankesë, ku do të pretendohet lidhur me këto aspekte, atëherë mbetet që në një të ardhme sa më të afërt, të konsolidohet praktika gjyqësore në këtë drejtim.

Nga të dhënat e siguruara, rezulton se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar katër (4) lëndë sipas ankesave ndaj aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilat kjo gjykatë kishte caktuar paraburgimin për herë të parë. Në tre (3) prej këtyre rasteve, ankesat janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa në një (1) rast, ankesa është aprovuar, kështu që paraburgimi është ndërprerë dhe ndaj të pandehurit është caktuar masa e ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar.

Përndryshe, përqindja më e madhe e çështjeve penale që shqyrtohen dhe gjykohen në Gjykatën Supreme të Kosovës iniciohen sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë, që është një mjet i jashtëzakonshëm juridik që mund të paraqitet në rastet e caktuara kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Gjithashtu, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, edhe gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

Nga të dhënat e paraqitura në këtë punim, shihet se gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar 816 lëndë sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë, ku prej tyre, në 329 lëndë (40.32%), kërkesat për mbrojtjen të ligjshmërisë janë paraqitur në lidhje me

vendimet e formës së prerë, përkitazi me paraburgimin (caktim, vazhdim ose ndërprerje), kurse në 487 lëndë (59.68%), kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur ndaj aktgjykimeve të formës së prerë.
Sa i përket kërkesave për mbrojtjen të ligjshmërisë të cilat janë paraqitur në lidhje me vendimet e formës së prerë, përkitazi me paraburgimin (caktim, vazhdim ose ndërprerje), Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në këtë mënyrë: në 237 raste (72.04%) është refuzuar kërkesa; në 58 raste (17.63%) është pranuar kërkesa; në 31 raste (9.42%) është hedhur kërkesa, kurse në 3 raste (0.91%) është vendosur në mënyrë tjetër.
Në rastet kur është pranuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë: në 18 raste (31.03%) është anuluar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë; në 2 raste (3.45%) është anuluar aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë; në 30 raste (51.72%) është ndryshuar aktvendimi i formës së prerë dhe është ndërprerë paraburgimi; në 7 raste (12.07%) është ndryshuar aktvendimi i formës së prerë dhe është caktuar masa e arrestit shtëpiak dhe në 1 rast (1.72%) është ndryshuar aktvendimi i formës së prerë dhe është caktuar masa paraqitja në stacionin policor.
Sa i përket kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilat janë paraqitur ndaj aktgjykimeve të formës së prerë, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në këtë mënyrë: në 318 raste (65.28%) është refuzuar kërkesa; në 124 raste (25.46%) është pranuar kërkesa; në 42 raste (8.62%) është hedhur kërkesa dhe në 3 raste (0.62%) është vendosur në mënyrë tjetër.
Në rastet kur është pranuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë: në 54 raste (43.55%) është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë; në 7 raste (5.65%) është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së dytë; në 39 raste (31.45%) janë anuluar aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, kurse në 24 raste (19.35%) është anuluar vetëm aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë.
Po ashtu, nga të dhënat e siguruara, është parë që gjatë vitit 2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës janë shqyrtuar 137 lëndë sipas kërkesave për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, ku në 129 raste (94.16%) është refuzuar kërkesa; në 6 raste (4.38%) është pranuar kërkesa, kurse në 2 raste (1.46%) është hedhur kërkesa.
Bazuar në të dhënat e paraqitura, konstatohet se Gjykata Supreme e Kosovës, gjatë vitit 2024, ka pasur një aktivitet të lartë në shqyrtimin e

mjeteve juridike, me theks të veçantë te kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilat përbëjnë shumicën e lëndëve të trajtuara.
Edhe pse me dispozitat ligjore të KPP-së, në raste të caktuara, është parashikuar mundësia e ankesës ndaj aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës në lidhje me paraburgimin, praktika gjyqësore në këtë drejtim mbetet e pakonsoliduar, duke krijuar nevojë për interpretim më të qartë dhe të unifikuar të dispozitave ligjore. Kjo tregon për rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të jurisprudencës dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore, veçanërisht në çështjet që lidhen me paraburgimin, si dhe me çështjen e ndryshimit apo anulimit të aktgjykimeve të formës së prerë, në dëm të të dënuarit, nëse konstatohet që vendimi i gjyqësor i formës së prerë është "qartazi i papërshtatshëm" ose "i bazuar në gabim të rëndë", ashtu siç parashihet në nenin 438, paragrafi 2 i KPP-së.

I. Literatura

- Bayer, Vladimir: *Jugoslavensko krivično procesno pravo, knjiga prva: Uvod u teoriju krivičnog procesnog prava*, Osmo izdanje, Narodne Novine, Zagreb, 1988.
  Kazneno procesno pravo, Zagreb, 1995.
- Brestovci, Faruk: *E drejta procedurale civile*, Prishtinë, 2002.
- Cook G.J., Marccus Paul: *Criminal procedure*, Fourth Edition, Matthew Bender, 1997.
- Grubiša, Mladen: *Krivični postupak, Postupak o pravnim lijekovima*, Zagreb, 1987.
- Gruda, Zejnullah: *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*, Libri I dhe II, Prishtinë, 2000.
- Hajdari, Azem:
  E drejta e procedurës penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2013.
  E drejta e procedurës penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2014.
  Kodi i Procedurës Penale, Komentar, Prishtinë, 2016.
- Hall, E. Daniel: *Criminal Law and Procedure*, Fifth Edition, Delmar Cengage, New York, 2009.
- Ilić, Mihajlo: *Krivično procesno pravo*, Sarajevo, 1997.
- Islami, Halim; Hoxha, Artan; Panda, Ilir: *Procedura penale, Komentar*, Tiranë, 2003, fq. 542.

- Kelmendi, Besim; Ibrahimi, Hamdi: *Format e shkresave në procedurat penale*, Prishtinë, 2017.
- Krapac, Davor: *Kazneno procesno pravo*, Informator, Zagreb, 2001.
- Maliqi, Agim; Shala, Afrim:
  Përmbledhje me raste nga praktika gjyqësore lidhur me armët e zjarrit, Volume 1 | 2020-2024, E drejta penale dhe praktika gjyqësore në Kosovë, Prishtinë, 2024.
  Veprat penale të armëve, Komentar, Prishtinë, 2025.
- Mose, Erik: *Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, "Standardi i Përbashkët që duhet arritur"*, Prishtinë, 1998.
- Murati, Rexhep: *Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe të provave të reja*, Prishtinë, 2006.
- Sahiti, Ejup: *Argumentimi në procedurën penale*, Prishtinë, 1999.
- Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep: *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016.
- Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: *Kodi i Procedurës Penale, Komentar*, Prishtinë, 2013.
- Shala, Afrim:
  Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010.
  Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.
  Përmbledhje e ligjëratave nga "E drejta penale I", Gjilan, 2011.
  Doracaku për procedurë penale, Prishtinë, 2015, (bashkautor).
  Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike "Opinio Juris", Akademia e Drejtësisë, Viti II, nr. 2, Prishtinë, 2016.
  Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2018.
  Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale - materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021, (bashkautor).
  Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2012.
  Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2023 (bashkautor).
  Hyrje në të drejtën penale, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023.

Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale dhe civile, Prishtinë, 2023 (kontribuues).
Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës, Prishtinë, 2023, (kontribuues).
Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale, Tiranë, 2023.
Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet civile dhe penale, Prishtinë, 2024 (kontribues).
Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës, Prishtinë, 2024, (kontribues).

- Shala Afrim; Ademi Burim; Kuqi Ramiz: *Drejtësia Mjedisore*, Prishtinë, 2024.

II. Publikime tjera

Udhëzues për politikën ndëshkimore, Botimi 1, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2018.
Udhëzues i përgjithshëm për matjen e dënimit, Botimi II, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2024.
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Udhëzues i veçantë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Qershor, 2021.
Përmbledhje e ligjeve penale, Instituti i Kërkimeve Juridike dhe Shoqërore, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 1979.

III. Akte juridike vendore dhe ndërkombëtare

- Kodi i Procedurës Penale nr. 08/L-032, datë 14.07.2022.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, datë 09.04.2008.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, datë 23.11.2018.
- Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, datë 23.11.2018.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Këshilli i Evropës, 1950.
- Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, datë 10.12.1948.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, datë 02.09.1990.

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, datë 16.12.1966.
- Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Rome Statute), i korrigjuar nga proces-verbalet e 10 nëntorit 1998 dhe 12 korrikut 1999.
- Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë, U.N. Doc. S/25704 në faqen 36, aneksi (1993) dhe S/25704/Add.1 (1993), i miratuar nga Këshilli i Sigurimit më 25 maj 1993, U.N. Doc. S/RES/827 (1993).
- Rregullat e Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë, U.N. Doc. IT/32/Rev.7 (1996), në fuqi nga 14 marsi 1994, me amendamente të miratuara më 8 janar 1996.
- Rregullat e Procedurës dhe Provave të miratuara nga Asambleja e Shteteve Palë në Sesionin e Parë, New York, 3–10 shtator 2002, Dokumenti zyrtar ICC-ASP/1/.

IV. Praktika Gjyqësore

Rastet nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, Gjykatës Kushtetuese dhe të gjykatave tjera në Republikën e Kosovës, të cilat janë paraqitur në këtë punim.

Agim Maliqi[88]

Aspekte praktike të shqyrtimit fillestar sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale

1. Hyrja

Në këtë punim janë komentuar dispozitat që rregullojnë shqyrtimin fillestar sipas Kodit të Procedurës Penale (Kodi nr.08/L-032)[89], i cili ka hyrë në fuqi nga data 16 shkurt të vitit 2023.

Është e rëndësishme të potencohet fakti se komentimi i këtyre dispozitave është i rëndësishëm për faktin se jo rrallë herë mundësohet shmangia e një procesi të rregullt gjyqësor, përkatësish rritet mundësia e përmbylljen së një faze së procedurës, përkatësisht shqiptimi i dënimit, qysh në këtë fazë apo edhe mundësia e hudhjes së aktakuzës, që po ashtu rezulton me përmbylljen e çështjes konkrete. Këto dispozita u mundësojnë palëve në procedurë, prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe të dëmtuarit, të jenë aktivë, kurse gjykatës i jep mundësinë që të ketë rolin e saj në kontrollin e aktakuzës dhe garantuese e veprimeve të palëve në procedurë brenda kornizave ligjore.

Punimi fillimisht trajton shqyrtimin fillestar, për të vazhduar me pranimin e fajësisë, kundërshtimin e provave, kërkesën për hudhjen e aktakuzës, gjithashtu mjaft gjerësisht janë komentuar dispozitat ligjore duke specifikuar kushtet dhe rastet e hudhjes së aktakuzës, shqiptimin e dënimit, shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve për të përfunduar me paraqitjen e materialeve nga mbrojtja. Duhet theksuar faktin se komentimi i dispozitave ligjore që rregullojnë shqyrtimin fillestar është i gërshetuar me raste nga praktika gjyqësore sipas vendimeve të Gjyktatës Supreme të Kosovës e që këto raste do të shërbejnë në unifikimin e praktikës gjyqësore.

---

[88] Autori është gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë, kurse punimi me këtë temë është ligjëruar nga ana e autorit trajnimin e organizuar në Akademinë e Drejtësisë si dhe në trajnimin e organizuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

[89] Më tutje do t'i referohemi me termin Kod apo KPP.

Po ashtu punimi përmban përfundimin dhe literaturën e cila është përdorur për realizimin e këtij punimi.
Fjalët kyçe: KPP, shqyrtimi fillestar, pranimi i fajësisë, kundërshtimi i provave, kërkesa për hudhjen e aktakuzës.

1. Vështrime të përgjithshme të shqyrtimit fillestar

Shqyrtimi fillestar është stad i rëndësishëm i procedurës penale, meqë në këtë stad mund të përmbyllet një fazë e procedurës penale, qoftë përmes hudhjes së aktakuzës apo edhe me vendim fajësie në rastet kur i pandehuri pranon fajësinë apo arrihet marrëveshja për pranimin e fajësisë. Gjithashtu, shqyrtimi fillestar shërben si përgatitje për shqyrtimin gjyqësor duke evidentuar dhe larguar provat e papranueshme e palët në procedurë prokurori i shtetit dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij i shkëmbejnë provat të cilat planifikojnë ti paraqesin gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor.
Shqyrtimi fillestar shërben edhe për planifikimin, përkatësisht caktimin e shqyrtimit gjyqësor apo vendosjes sipas kërkesave nga palët përmes paraqitjes së kundërshtimeve të provave apo kërkesave për hudhjen e aktakuzës me qëllim që gjykata të vendosë përkitazi me këto propozime dhe tutje të vazhdoj me shqyrtimin gjyqësor apo të hudhë aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale, përkatësisht të përmbyllë çështjen penale.

1.1. Shqyrtimi fillestar

Shqyrtimi fillestar është një ndër fazat kryesore të procedurës penale e cila fillon nga ngritja e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe në fakt është piktakimi i parë i gjykatës me aktakuzën e paraqitur. Faza e shqyrtimit fillestar paraqet një kontrollë të aktakuzës nga ana e gjykatës dhe karakterizohet me faktin se palët procedurale[90] janë mjaft aktive, kurse gjykata vepron sipas iniciativës së palëve. Është e rëndësishme të potencohet fakti se me qëllim të mbajtjes së ritmit të shqyrtimit fillestar është përcaktuar afati ligjor për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit

[90] Neni 19 par.1.15 i KPP-së, përcakton se palë në procedure janë i pandehuri, prokurori i shtetit dhe i dëmtuari ose viktima.

fillestar dhe se ky afat është që shqyrtimi fillestar caktohet menjëherë, kurse duhet të mbahet brenda afatit prej 30 ditëve në procedurë të rregullt, kurse 15 ditëve në rastet kur i pandehuri është në paraburgim dhe kjo padyshim është mjaft pozitive dhe mundëson që të veprohet me efikasitet e gjithashtu hap mundësinë që edhe shqyrtimi gjyqësor të caktohet dhe mbahet sipas afateve të përcaktuara ligjore. Mirëpo në praktikë vërehet fakti se këto afate nuk respektohen në mënyrë të përpiktë për shkak të numrit të madh të lëndëve.
Në shqyrtimin fillestar është paraparë prania e prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit, që është e natyrshme dhe që përmbushë standardin minimal për një shqyrtim fillestar, megjithatë nuk është përcaktuar mënyra se si të sigurohet prania e palëve të cilët marrin pjesë në shqyrtimin fillestar, por gjithsesi kjo duhet të nënkuptohet se përshtatshmërisht duhet zbatuar dispozitat e thirrjes për shqyrtimin gjyqësor.

Prania e prokurorit të shtetit[91] është e pashmangshme dhe kushtëzohet me faktin se pa praninë e tij nuk mund të zhvillohet shqyrtimi fillestar, meqë pos faktit se është palë në procedurë ka gjithashtu kompetenca në përfaqësimin e aktakuzës gjatë të gjitha fazave të procedurës penale para gjykatave.
Gjatë shqyrtimit fillestar është e domosdoshme edhe prezenca e të pandehurit e që cilësinë e të pandehurit në procedurë penale mund ta fitoj çdo person fizik i cili posedon aftësinë për të vepruar, gjegjësisht personi që ka moshën e caktuar dhe që është i përgjegjshëm.[92] Meqë, Kodi nuk lejon zhvillimin e shqyrtimit fillestar në mungesë të pandehurit "*in absentia*", përndryshe me dispozita të veçanta (neni 303 i KPP-së) është mundësuar gjykimi në mungesë, por për zhvillimin e tij është e domosdoshme prania e të pandehurit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, kurse përjashtim paraqesin rastet e përcaktuara me dispozitën e nenit 104 të KPRK-së.

[91] Kompetencat e prokurorit të shtetit janë përkufizuar me nenin 7 të Ligjit të Prokurorit të Shtetit dhe neni 45 i KPP-së
[92] HAJDARI Azem, Procedura penale – Komentar, Prishtinë, 2010, faqe 155

Kurse prania e mbrojtësit nuk duhet kuptuar se duhet të jetë e domosdoshme pos rasteve të mbrojtjes së detyruar[93] apo rasteve të mbrojtjes me shpenzime publike, atëherë kur mbrojtja nuk është e detyruar[94] por e cila sigurohet sipas kërkesës së të akuzuarit nën kushtet e përcaktuara.

Edhe pse Kodi ka fuqizuar pozitën e të dëmtuarit në procedurën penale duke e ngritur në pozitën e palës[95] në procedurë, megjithatë është i pakuptueshëm fakti se gjatë shqyrtimit fillestar nuk është e paraparë prezenca e të dëmtuarit[96]. Për më tepër, kjo dispozitë është në kundërshtim me nenin 240 paragrafi 2 të Kodit ku përcaktohet se *"...pala e dëmtuar ose viktima dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës njoftohen për seancën e shqyrtimit fillestar dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm, por mungea e tyre nuk është pengesë për mbajtjen e seancës*".[97]

Andaj, për tu tejkaluar kjo situatë dhe sigurimin e prezencës së të dëmtuarit kjo mund të arrihet në dy mënyra:

- mënyra e parë mund të jetë që i dëmtuari gjithsesi të thirret në shqyrtimin fillestar posaçërisht në rastet duke marrë parasysh faktin se nëse i pandehuri pranon fajësinë duhet ti ipet mundësia që i dëmtuari të deklarohet përkitazi me llojin dhe lartësinë e kërkesës pasurore-juridike;

- kurse mundësia e dytë do të ishte që nëse gjatë shqyrtimit fillestar i pandehuri deklarohej fajtor, atëherë të caktohet një seanca e posaçme për caktimin e dënimit[98], përkatësisht vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin[99] dhe pastaj në këtë seancë i dëmtuari do të kishte mundësi të paraqiste propozimin e tij për kërkesën pasurore juridike,

[93] Neni 56 i KPP-së
[94] Neni 57 i KPP-së
[95] Neni 19 par.1.15 dhe neni 63 i KPP-së
96 Neni 240 par.1 të KPP-së ka kufizuar se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.
[97] Neni 240 par.2 i KPP-së.
[98] Neni 356 të KPP-së
[99] Neni 242 par.3 të KPP-së

meqë edhe kërkesa pasurore juridike është komponentë e rëndësishme për çështjen penale.
Sidoqoftë në rastet që janë analizuar gjatë përgatitjes së këtij punimi dominon versioni se i dëmtuari zakonisht thirret në shqyrtimin fillestar dhe me prezencën e tij bëhet pjesë aktive dhe e rëndësishme e shqyrtimit fillestar e që gjithsesi në rastin e pranimit të fajësisë së të pandehuri dhe përmbushjes së kushteve për pranimin e fajësisë, atëherë i dëmtuari mund të paraqes të dhëna të rëndësishme që gjykata bazuar në deklarimin e tij të vendosë për dënimin dhe kërkesën pasurore juridike, pos nëse i dëmtuar ka paraqitur paraprakisht deklaratë të dëmit.[100]

Fillimi i shqyrtimit fillestar ka për qëllim krijimin e parakushteve për një shqyrtim të suksesshëm të çështjes konkrete dhe së pari konstatohet fakti nëse i pandehuri ka pranuar kopje të aktakuzës dhe në rast të mos pranimit të saj, atëherë, të pandehurit i dorëzohet një kopje e aktakuzës. E që kjo në dukje të parë është veprim i karakterit teknik dhe nuk është aspak e preferueshme që kështu të ndodhë dhe atë nga arsyeja se e preferueshme do të ishte që dorëzimi i aktakuzës të bëhej para seancës së shqyrtimit fillestar për arsye se pranimi i aktakuzës paraqet një parakusht të rëndësishëm që i pandehuri të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë e tij. Pra do të ishte jo reale që të pritet nga i pandehuri që menjëherë pasi të pranoj aktakuzën të deklarohet lidhur me fajësinë, siç parashihet në seancën fillestare, andaj do të ishte shumë e rëndësishme që së bashku me thirrje për shqyrtimin fillestar të bashkëngjitet edhe aktakuza ashtu siç është paraparë për shqyrtimin gjyqësor jo më vonë se tetë (8) ditë[101] e cila do të krijonte parakushte të përshtatshme për procedim të suksesshëm të shqyrtimit fillestar.

Shqyrtimin fillestar e karakterizon fakti se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues, vendosë për të vazhduar, përkatësisht zbatuar masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe kjo është në frymën e parimit se masat e sigurisë së pranisë së të pandehurit janë të nevojshme

[100] Neni 214 i KPP-së
[101] Neni 282 par.3 i KPP-së

të trajtohen në çdo fazë të procedurës, meqë bazat dhe kushtet e masave mund të ndryshojnë pas ngritjes së aktakuzës.
Arsyeshmëria e shqyrtimit të këtyre masave gjatë shqyrtimit fillestar është e rëndësishme edhe për arsye:

- së pari për faktin se në shqyrtimin fillestar janë prezent palët dhe aty mund ti paraqesin pikëpamjet e tyre për këto masa;
- dhe e dyta me përfundimin e fazës së hetimit fillon faza e ngritjes së akuzës dhe kjo mund të ndryshoj bazat, por edhe kushtet për vazhdimin apo zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

Gjithsesi është e rëndësishme të potencohet fakti se Kodi nuk ka paraparë ndarje të masave së sigurimit të pranisë së të pandehurit para dhe pas paraqitjes së aktakuzës, përkatësisht nëse një masë është caktuar para ngritjes së aktakuzës mbetet në fuqi edhe pas ngritjes së saj deri te skadimi i kësaj mase, pra me një fjalë është braktisur koncepti që çdo masë e caktuar apo e vazhduar gjatë procedurës hetimore të shqyrtohet obligativisht pas ngritjes së aktakuzës dhe ku vendosej të vazhdohet apo hiqet ajo masë, por tani më Kodi ka përcaktuar që sa u përket masave për vazhdimin apo zbatimin e sigurimit të pranisë së të pandehurit të vendoset në shqyrtimin fillestar sipas propozimit të palëve në procedurë.

Është i rëndësishëm fakti se detyrimi për marrje në pyetje të të arrestuarit- të paraburgosurit buron nga parimi i njohur Habeas Corpus, sipas të cilit personi i arrestuar- paraburgosur duhet të dëgjohet nga gjyqtari dhe ky është një rregull i njohur përgjithësisht nga legjislacionet e shteteve dhe i zbatuar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.[102]

Por duhet të qartësohet fakti se përkitazi me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit mund të vendoset edhe para fillimit të shqyrtimit fillestar dhe atë në dy raste:

- në rastin e parë kur masa e tillë skadon pas paraqitjes së aktakuzës dhe para mbajtjes së shqyrtimit fillestar;

[102] ISLAMI Halim& HOXHA Artan & PANDA Ilir, Procedura Penale, Tiranë, 2012, faqe 352

- dhe rasti i dytë është kur në aktakuzën[103] e paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit është propozuar urdhëri i paraburgimit (kur i pandehuri gjendet në liri) apo është propozuar që i pandehuri që gjendet në paraburgim të lirohet nga paraburgimi dhe në këto raste nuk duhet që për të vendosur për një masë të tillë të pritet shqyrtimi fillestar.

Në kuadër të sigurimit të një procedure efikase gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata kujdeset që prokurori i shtetit ti përmbushë detyrimet për zbulimin e provave nga neni 239 i KPP-së e që kopjet e tyre të përshkruara hollësisht në këtë dispozitë kanë prcaktuar që ky veprim të bëhet jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet e mëposhtme ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, siç janë:
1.1. procesverbalet mbi deklarimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri;
1.2. emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshmim dhe çdo deklarim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë;
1.3. të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje;
1.4. rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen;
1.5. kallëzimet penale dhe raportet e policis; dhe
1.6. përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.
Kurse këto materiale i vihen në disponim të pandehurit në gjuhën që ai e kupton dhe e flet, gjithashtu obligimi i sigurimit të këtyre materialeve vazhdon edhe pas ngritjes së aktakuzës, brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve, duke pasur parasyshë në veçanti masat për mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarëve, të privatësisë së tyre dhe të dhënave konfidenciale.

[103] Neni 235 par.2 i KPP-së

Dispozita e nenit 239 të KPP-së, mund të krijoj paqartësi gjatë zbatimit të saj për faktin se krijon diskrepanc mes titullit dhe përmbajtjes dhe deri sa titulli i saj përshkruan *"materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës",* [104] kurse e gjithë dispozita i referohet mbrojtësit të të pandehurit (përjashto paragrafin 2 të këtij neni) sidoqoftë kjo mund të shkaktoj paqartësi se kujt duhet dorëzuar materialet e hetimeve të pandehurit apo mbrojtësit, por kjo duhet lexuar në atë mënyrë që është obliguese që materialet hetimore ti jepen të pandehurit dhe kjo nënkupton se përmbushet detyrimi.

Nga kjo paqartësi shtrohet një çështje se çka do të ndodhë nëse të pandehurit nuk i janë dhënë provat kurse mbrojtësit nuk iu kanë siguruar provat sipas nenit 239 të KPP-së. Kjo situatë nuk është rregulluar me ndonjë dispozitë përkatëse, por atëherë sigurisht se gjykata duhet të obligoj prokurorin e shtetit dorëzimin e tyre brenda një afati të përcaktuar nga gjykata (afat gjyqësor) dhe ky afat duhet të jetë i arsyeshëm duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes si dhe sasinë e materialeve që duhet dorëzuar e që do të ishte e arsyeshme ndërprerja e seancës me qëllim që pas sigurimit të tyre të vazhdohet me shqyrtimin fillestar, duhet potencuar se edhe kjo nuk është paraparë me dispozitë të veçantë, por duhet përshtatshmërisht të aplikohen dispozitat e shqyrtimit gjyqësor.

Në rastet kur në shqyrtimin fillestar nuk vie deri te pranimi i fajësisë, sipas dispozitës së nenit 240 paragrafi 7 të KPP-së, është përcaktuar mundësia që të mund të kërkohet paraqitja e propozimeve që nënkuptohet se propozimet duhet të bëhen nga palët, prokurori i shtetit, i pandehuri, pa përjashtuar edhe të dëmtuarin brenda afatit jo më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton të pandehurin dhe mbrojtësin se ata mund që të paraqesin propozime deri në datën e caktuar por jo më vonë se 30 (tridhjetë ditë):
- kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë; dhe

[104] Neni 239 par.1 i KPP-së

- kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe

Kjo është e rëndësishme për faktin se në shqyrtimin fillestar njoftohet i pandehuri që këto kundërshtime dhe kërkesa duhet ti ketë në dispozicion prokurori i shtetit me qëllim që të mund tu përgjigjet këtyre pretendimeve përmes formës së shkruar , por duhet të jetë e qartë se kundërshtimi mund të paraqitet për provat e propozuara në aktakuzë dhe tek më vonë paraqiten provat nga mbrojtja apo i pandehuri.

Gjatë shqyrtimit fillestar parimisht nuk paraqitet asnjë provë, përkatësisht nuk dëgjohen dëshmitar apo ekspert, por përjashtimisht lejohet paraqitja e provave nëse kjo është e nevojshme për vazhdimin ose zbatimin e pranisë së të pandehurit dhe kjo paraqet mundësinë që përmes këtij dëgjimi të vazhdohen, përkatësisht hiqen masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit, kjo për faktin se pas paraqitjes së aktakuzës nuk ndryshojnë bazat për vazhdimin e paraburgimit edhe pse nuk është specifikuar mendoj se do të ishte e justifikueshme të zbatohej vetëm për masën më të rëndë të sigurimit të prezencës së të pandehurit, përkatësisht masës së paraburgimit.

2. Pranimi i fajësisë

Në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar jepen udhëzime të pandehurit nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për të drejtat e tij e që këto udhëzime janë mjaft të rëndësishme, por është e pashpjegueshme se nuk është paraparë që fillimisht të pandehurit ti merren të dhënat e tij personale,[105] meqë kjo është mjaft e rëndësishme për faktin se gjykata për herë të parë kontakton drejtpërdrejt me të pandehurin, kurse të dhënat personale janë të rëndësishme për faktin se nuk janë thjesht një çështje e karakterit teknik apo ceremonial apo vetëm për të vërtetuar identitetin e tij, por janë çështje mjaft fundamentale, meqë përmes këtyre të dhënave gjykata krijon një pasqyrë lidhur me personalitetin dhe karakterin e të pandehurit, gjendjen e tij ekonomike

[105] Neni 317 par.1 i KPP-së

dhe sociale, shkallën e arsimimit dhe të cilat të dhëna janë mjaft të rëndësishme. Kurse rëndësia tjetër e sigurimit të plotë e të dhënave personale të të pandehurit është në rastet kur i pandehuri mund të pranoj fajësinë gjatë këtij shqyrtimi dhe të dhënat personale janë të rëndësishme për individualizimin e dënimit, përkatësisht për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Me rastin e udhëzimeve për të drejtat që i ipen të pandehurit është e rëndësishme që gjyqtari të jetë i kujdesshëm që i pandehuri ti kuptojë ato, meqë këto udhëzime duhet të ipen në mënyrë të thjeshtë, pa terma të tepruar të natyrës juridike dhe duhet të përshtaten me nivelin e të pandehurit si në aspektin e shkallës së arsimit, moshës dhe karakteristikave tjera. Rëndësia e këtyre udhëzimeve është edhe për faktin se të akuzuarit përmes këtyre udhëzimeve i bëhet me dije se është pjesë aktive e shqyrtimit fillestar dhe jo një person që është vetëm formalisht aty.

Udhëzimet e të pandehurit lidhur me të drejtat e tij duhet të jenë të qarta dhe të kuptohen nga ana e të pandehurit që kjo nënkupton se në rast se i pandehuri nuk i kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, atëherë duhet të sigurohet përkthyesi dhe mos sigurimi i tij paraqet shkelje esenciale të dispozitave të proceurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së, siç është konstatuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 654/2023 të datës 15.12.2023 me çka rezultoj me anulimin e dy aktgjykimeve të kontestuara të gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore dhe kthimin e çështjes në rigjykim. Si rezultat i mos prezencës së përkthyesit dhe fakti se i pandehuri ishte i nacionalitetit rom dhe nuk ishte njoftuar përkitazi me njohuritë e tij të gjuhës shqipe, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, ka konstatuar se kundër të pandehurit Xh.C ishte shkelur e drejta për një proces të rregullt gjyqësor pasi që nuk ishte pyetur për njohuritë e gjuhës shqipe me rastin e njoftimit të tij gjatë shqyrtimit fillestar. Tutje Gjykata Supreme e Kosovës ka arsyetuar aktgjyikimin e saj se pasi që i dënuari, nuk është pyetur rreth kësaj çështje (njohuritë e gjuhës shqipe) dhe me këtë rast i është mohuar përcjellja e seancave në të dy instancat gjyqësore në gjuhën që zhvillohet procedura penale është bërë shkelje e të drejtave të cilat të dënuarit sipas dispozitës

së nenit 384 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së, e gjithashtu edhe e drejta e garantuar e përdorimit të gjuhës sipas nenit 30 par.4 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 par.3 nënpar. e të KELDNJ dhe tutje e elaboruar edhe përmes vendimeve të GJELDNJ - Gjykatës së Strasburgut në rastin Hermi & Italisë ishte theksuar fakti se: "*...njohuritë gjyqësore të të pandehurit janë jetike, sidomos duke pasur parasysh natyrën e veprës penale dhe kompleksitetin e komunikimeve të adresuara për të pandehurin...*", si dhe në rastin Luedicke, Belkacem dhe Koç & Gjermanisë, me ç'rast është vendosur standardi se përdorimi i gjuhës është i karakterit absolut, "*... përkthimi është absolut kur konstatohet se personi nuk mund të kuptoj ose flet gjuhën e përdorur në gjyq dhe nuk mund të ketë asnjë përjashtim ose pezullim të kësaj të drejte...*". Kurse bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore del se të dy instancat gjyqësore këto garancione nuk i janë ofruar të pandehurit që të deklarohet përkitazi me njohuritë e gjuhëve në të cilat zhvillohet proceduara penale dhe pas këtij deklarimit të tij të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor apo të sigurohet prania falas e përkthyesit gjyqësor në gjuhën e tij. [106]

Posaçërisht i pandehuri udhëzohet përkitazi me të drejtën për të pasur mbrojtës, por në rast se bëhet fjalë për veprën penale ku parashihet mbrojtja e detyruar, gjykata paraprakisht kur e konstaton se i pandehuri nuk ka mbrojtës para shqyrtimit fillestar ka obligim që ta caktoj mbrojtësin dhe ti siguron materialet e nevojshme, meqë kjo paraqet parakusht për një seancë të suksesshme. Është e rëndësishme që me rastin e caktimit të mbrojtësit në rastet e mbrojësit të detyruar që gjyqtari të ketë kujdes që paraprakisht të konstatoj faktin se organet tjera që paraprakisht kanë udhëhequr procedurën e këtu në rend të parë prokurori i shtetit ka caktuar mbrojtës të pandehurit dhe nëse është caktuar mbrojtës nga këto organe do të duhej që të vazhdohej me angazhimin e tij kjo me qëllim që të ketë një kontinuitet të mbrojtësit, gjithashtu në këto raste duhet pasur parasyshë që të sigurohet përshtatshmëria e mbrojtjes që nënkupton të i

[106] Aktgjykimin Pml. Nr. 654/2023 të datës 15.12.2023

caktohet mbrojtës i pavarur me përvojë dhe në kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe kushteve të parapara me këtë Kod.[107]

Posaçërisht para fillimit të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të ketë kujdes të posaçëm në dy detyrime dhe atë detyrimi i parë është që të çmoj të drejtën e të pandehurit në mbrojtës dhe në rastet kur i pandehuri nuk ka angazhuar mbrojtës apo ndërkohë për arsye të ndryshme ka mbetur pa mbrojtës, atëherë gjykata të pandehurit i cakton mbrojtës në rastet kur mbrojtja është e detyruar[108] kurse në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesë të të pandehurit[109] dhe gjithsesi është e rëndësishme që nëse gjykata është në dijeni se i pandehuri nuk ka mbrojtës do të ishte e preferueshme që mbrojtësi të caktohet paraprakisht, pra para shqyrtimit fillestar, kurse materialet e hetimeve duhet ti sigurohen mbrojtësit. Rëndësia e caktimit të mbrojtësit ndërlidhet edhe me faktin se moszbatimi i kësaj dispozite paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.[110]
Ngjashëm është edhe në rastet kur nuk janë përmbushur detyrimet nga neni 239 i KPP-së, meqë përmbushja e detyrimeve sipas kësaj dispozite është e karakterit imperativ dhe nëse gjyqtari gjendet para një situate të tillë nuk do të duhej të vazhdonte me shqyrtimin fillestar, por të ndërpres atë dhe të vazhdohet pas krijimit të parakushteve.

Edhe pse kjo situatë në praktikë ndodh mjaft rrallë, meqë zakonisht të pandehurit i sigurohen këto materiale, megjithatë me qëllim që kjo situatë të mos ndodhë, gjithsesi ligjvënësi do të duhej që në raste të tilla të parashihte që gjykata lidhur me mospërmbushjen e detyrimeve të pa arsyeshme nga ana e prokurorit të shtetit[111] dhe kur kjo rezulton me shtyerjen e shqyrtimit fillestar duhet të parashihet që për këtë të njoftohet mbikqyrësi i tij që do të ishte në funksion të barazisë së armëve mes palëve në procedurë, duke pasur parasyshë që ndaj mbrojtësit janë

[107] Neni 11 i KPP-së
[108] Neni 56 i KPP-së
[109] Neni 57 i KPP-së
[110] Neni 384 par.2 nënpar.2.2 të KPP-së
[111] Dispozitë e ngjashme është paraparë me nenin 297 par.4 të KPP-së

paraparë dispozita ndëshkuese, në rastet kur nuk i përmbushë detyrimet e përcaktuara pa ndonjë arsye,[112] që rrjedh nga dispozita e nenit 250 par.3 të KPP-së.

Në të dy këto situata duhet pasur kujdes përndryshe nëse nuk janë plotësuar këto parakushte, atëherë hapet mundësia që të ndërprehet shqyrtimi fillestar dhe të vazhdohet me shqyrtimin fillestar pas krijimit të parakushteve siç përcakton dispozita.

Leximi i aktakuzës paraqet moment të rëndësishëm të shqyrtimit fillestar nga fakti se është momenti kur të pranishmit (bëhet fjalë për publikun dhe personat tjerë) për herë të parë kuptojnë pretendimet e prokurorit të shtetit. Leximi i aktakuzës paraqet fillimin e shqyrtimit fillestar pasi që pjesa e mësipërme i referohet udhëzimeve të palëve.

Është i rëndësishëm të theksohet fakti që i pandehuri duhet të deklarohet për fajësinë, por paraprakisht është e nevojshme që i njëjti ta kuptoj drejt aktakuzën që rëndon mbi të. Kjo shpesh herë paraqet vështirësi të natyrave të ndryshme, meqë, së pari aktakuza mund të jetë e pakuptueshme për të pandehurin dhe i njëjti mund të ketë vështirësi në kuptimin e saj edhe nga fakti se në aktakuzë mund të përdoret terminologji juridike, ashtu që nga kjo arsye pas leximit të aktakuzës duhet dhënë mundësia që prokurori i shtetit i cili ka rol aktiv gjatë shqyrtimit fillestar,[113] që ti sqaroj të pandehurit përmbajtjen e aktakuzës dhe kjo duhet zbatuar në atë mënyrë që sqarimi ti përshtatet moshës, shkallës së arsimimit, njohurive të përgjithshme të të pandehurit, sidomos përqendrimi duhet të jetë tek sqarimi i instituteve juridike siç janë pakujdesia, dashja, lajthimi juridik, lajthimi faktik, bashkëkryerja, shtytja, ndihma etj.

Po ashtu duhet sqaruar në mënyrë të drejtë, të qartë dhe të thjeshtë edhe elementet e veprës penale, meqë shpesh herë edhe këtu krijohen shumë

[112] Neni 250 par.3 të KPP-së
[113] ÇOLLAKU Hashim Roli i Prokurorit të Shtetit në Procedurën Penale, Prishtinë, 2013, faqe 134

paqartësi për të pandehurin. Kurse rëndësia e kësaj duhet të ndërlidhet me faktin se shpesh here i pandehuri mund të deklaroj edhe formalisht se e kupton aktakuzën, por kjo ndodhë shpesh here të jetë deklarim jo i saktë për arsye të ndryshme: qoftë nga fakti se po të mos kuptonte aktakuzën do ta ndiente veten keq e nganjëherë duhet ndërlidhur edhe me faktin se ky deklarim paraqitet para deklarimit për fajësinë dhe për këtë mund të ndikoj edhe fakti se me pranimin e fajësisë mund të dënohet më butë, që paraqet një motiv që i pandehuri edhe verbërisht të deklarohet se e kupton aktakuzën dhe e pranon fajësinë. Konsideroj se ligjvënësi me të drejtë kërkon që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, të jetë i kujdesshëm me rastin e sqarimit të përmabjtjes së aktakuzës dhe shpesh here duhet të kërkoj nga prokurori i shtetit që të bëj një sqarim të thjeshtë pa terma të tepruar juridik deri sa të bindet se i pandehuri e kupton drejt dhe e ka të qartë se për çfarë akuzohet.

Mos kuptimi i drejtë dhe i plotë i aktakuzës ka për pasojë faktin se në rast të këtij mos kuptimi paraqet edhe arsye që mbrojtja të jetë e gabuar, gjithsesi duhet të jetë e qartë se mos qartësimi i aktakuzës, përkatësisht mos kuptimi i plotë i saj paraqet bazë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.[114]

Në praktikë shpesh herë kemi pasur raste të tilla kur nuk janë vlerësuar në mënyrën e duhur elementet e veprës penale që kanë inkriminuar të pandehurin dhe mbi këtë bazë pranimi i fajësisë konsderohet se është i mangët dhe ka rezultuar me anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe njëkohësisht kthimin e çështjes në rigjykim, siç ka ndodhur në rastin Pml. nr.387/2025 të datës 17.07.2025 dhe kjo është konstatuar me rastin e shqyrtimit të kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga ana e mbrojtësit të të pandehurit Sh.K. Me ç'rast është konstatuar se pranimi i fajësisë ishte në kundërshtim me deklarimin e të pandehurit dhe i cili deklarim dërgon në konkludim se nuk ishin realizuar elementet e veprës penale për të cilën ishte gjykuar, dhe për më tepër, këtë shkelje nuk e kishte eliminuar as gjykata e shkallës së dytë. Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në procesverbalin e shqyrtimit fillestar kishte

[114] Neni 384 par.2 i KPP-së

konstatuar se i dënuari ishte deklaruar fajtor, mirëpo njëkohësisht kishte theksuar faktin se " ... *veprën penale për të cilën jam akuzuar, veprën nuk e kam bërë me qëllim. Dita kur ka ndodhur ka qenë ditë e ftohtë nuk e kam ditur se qeni është i dikujt dhe kam pritur mos po vjen dikush me marrë...".*

Nga ky konstatim i procesverbalit të shqyrtimit fillestar del se pranimi i fajësisë nuk është bërë sipas 248 paragrafit 1 të KPP-së[115], meqë nga deklarimi i të dënuarit rrjedh se i njëjti nuk kishte pranuar qëllimin e përvetësimit të sendit të huaj me qëllim të përfitimit, që në fakt këto elemente paraqesin elementet esenciale të veprës penale të vjedhjes. Përkundër faktit të pakontestueshëm se i dënuari është deklaruar fajtor, megjithatë, është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë që pranimin e fajësisë ta vlerësoj në dritën e dispozitës ligjore të nenit 248 paragrafit 1 të KPP-së dhe përshkrimit të veprimeve të të dënuarit, përndryshe pranimi i fajësisë bie ndesh me dispozitën e mësipërme ligjore, si dhe provave të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale, siç ka ndodhur me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastin Pml. nr. 444/2022 të datës 22.11.2022.

Me ç 'rast, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe me këtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.[116]

Në mënyrë të ngjashme Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 lidhur me nenin 369 paragrafi 7 të KPP-së, në çështjen penale Pml. nr. 296/2023 të datës 05.07.2023, me ç 'rast kishte aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të pandehurit I.Ç, pasi që pranimi i fajësisë nuk ishte bërë konform

[115] Në këtë rast duhet sqaruar faktin se është konstatuar shkelja e nenit 248 par.1 të KPP-së, sipas Kodit të mëparshëm, mirëpo dispozitë të ngjashme ligjore përmban edhe Kodi i Ri i procedurës penale e përcaktuar me nenin 242 të KPP-së

[116] Aktgjykimi Pml. nr. 444/2022 të datës 22.11.2022.

dispozitës ligjore të nenit 248 të KPP-së. Në këtë rast i pandehuri I.Ç ishte shpallur fajtor dhe ishte gjykuar për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 i KPRK-së. Mirëpo, përkundër faktit se i pandehuri I.Ç, ishte deklaruar fajtor dhe gjykata e shkallës së parë kishte bërë pranimin e fajësisë dhe konstatimin se ky pranim ishte bërë konform dispozitës ligjore, megjithëse diapozitivi i aktgjykimit kishte pasur mangësi përkitazi me llojin dhe sasinë e lëndës narkotike. Pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte aprovuar dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë me konstatimin se pranimi i fajësisë nuk ishte bërë sipas dispozitave ligjore. Kjo për faktin se në aktakuzë dhe as në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk ishte përcaktuar lloji dhe sasia e lëndës narkotike të cilën pretendohet se e kishte transportuar i pandehuri. Për më tepër, nga shkresat e lëndës nuk del se ishte përpiluar ekspertiza përkatëse e cila do të përcaktonte llojin dhe sasie e lëndës narkotike dhe e cila është e domosdoshme për të rezultuar me aktakuzë dhe me vendim fajësie, andaj, përkundër faktit se i pandehuri ishte deklaruar fajtor, megjithatë mbetet në kompetencën e gjykatës së shkallës së parë që pranimi i fajësisë të shqyrtohet në dritën e dispozitës ligjore dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.[117]

Në këtë punim është i rëndësishëm të potencohet edhe çështja penale Pml. nr. 212/2024 të datës 12.04.2024, me ç ‘rast Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 lidhur me nenin 369 paragrafi 7 të KPP-së të pretenduara nga ana e mbrojtësit të të pandehurit A.N, me ç ‘rast kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të pandehurit, pasi që pranimi i fajësisë ishte bërë në shkelje të dispozitës ligjore për pranimin e fajësisë. Në këtë rast i pandehuri A.N ishte shpallur fajtor dhe ishte gjykuar për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Mirëpo, përkundër faktit se i pandehuri A.N, ishte deklaruar fajtor dhe gjykata e shkallës së parë kishte

[117] Aktgjykimi Pml. nr.296/2023 të datës 05.07.2023.

bërë pranimin e fajësisë dhe konstatimin se ky pranim ishte bërë konform dispozitës ligjore, megjithatë mbrojtësi i tij kishte ngritur pretendime se i pandehuri nuk ishte këshilluar mjaftueshëm pasi që i dëmtuari kishte pësuar lëndim të lehtë trupor dhe nga kjo arsye aktakuza do të duhej të paraqitej për lëndim të lehtë trupor.

Pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte refuzuar si të pabazuara dhe aktgjykimet e kundërshtuara i kishte vërtetuar duke paraqitur arsyetimin se i pandehuri kishte bërë pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe në prani të mbrojtësit të tij dhe si rezultat i përmbushjes së kritereve të përcaktuara me dispozitën e nenit 242 paragrafi 1 të KPP-së, pranimi i fajësisë ishte aprovuar. Pretendimi i të pandehurit se nuk kishte pasur informacion përkitazi me veprën penale për të cilën ishte akuzuar dhe fakti i mos këshillimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, del të jetë pretendim i pabazuar duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe atë nga procedura hetimore, ku me rastin e marrjes në pyetje në cilësi të të pandehurit del se ishte njoftuar për veprën penale për të cilën ishin duke u zhvilluar hetimet. Përtej kësaj edhe gjatë shqyrtimit fillestar, përkatësisht procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor del se të pandehurit i ishte lexuar përmbajtja e aktakuzës dhe i cili ishte deklaruar se të njëjtën e kishte kuptuar dhe veprimet e tij i kishte pranuar, andaj pretendimi se nuk kishte pasur njohuri për cilësimin juridik të veprës penale dalin të jenë të pabazuara.[118]

Kurse në rastet që i pandehuri të mos deklarohet për fajësinë dhe atëherë procedohet sikurse i pandehuri të deklarohej i pafajshëm.

2.1. Pranimi i fajësisë dhe shqiptimi i sanksionit penal gjatë shqyrtimit fillestar

Faza më e rëndësishme e shqyrtimit fillestar është momenti i pranimit të fajësisë së të pandehurit dhe kjo është e rëndësishme për faktin se kushtet e parapara duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe vetëm në këtë rast mund të pranohet pranimi i fajësisë dhe assesi jo në rastet kur pranimi është i pjesërishëm, me dilema ose i paqartë.

[118] Aktgjykimi Pml. nr. 212/2024 të datës 12.04.2024

Vlerësimi i pranimit të fajësisë është mjaft kompleks dhe shumëdimensional dhe aspak i lehtë për të përcaktuar se a janë apo nuk janë plotësuar kriteret, meqë për deri sa disa kritere janë të matshme, kurse disa kritere tjera janë më shumë të natyrës objektive dhe më vështirë përcaktuese.

Më e rëndësishmja është fakti se pranimi i fajësisë duhet bërë në atë mënyrë që i pandehuri duhet *kuptuar natyrën dhe pasojën e pranimit të fajësisë* dhe kjo është mjaft komplekse pikërisht nga fakti se i pandehuri duhet të kuptoj aktakuzën që rëndon mbi të, pastaj se me pranimin e fajësisë do të kemi shmangie nga një proces i rregullt gjyqësor, përkatësisht se do të jetë një proces më i shkurtër se zakonisht, se privohet nga e drejta për paraqitjen e provave apo të kundërshtoj provat e paraqitura nga prokurori i shtetit se pas kësaj do ti shqiptohet menjëherë dënimi për veprimin e tij, se do të obligohet në përmbushjen e kërkesës pasurore-juridike të dëmtuarit (nëse ka të dëmtuar dhe ka propozim të personave të autorizuar për kërkesë pasurore-juridike), se pasuria e fituar si rezultat i veprës penale do të mund ti nënshtrohet konfiskimit (nëse ka propozim për konfiskim).

Fakti se i pandehuri nuk ka pasur njohuri përkitazi me konfiskimin e automjetit të tij të udhëtarëve është ngritur si pretendim në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të pandehurit S.E, mirëpo ky pretendim i tij është refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës sipas aktgjykimit Pml. nr. 444/2022 të datës 22.11.2022, me arsyetimin se i dënuari në shqyrtimin fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar. Në dritën e kësaj është e rëndësishme të potencohet fakti se nga shkresat e lëndës, përkatësisht procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, del se i dënuari në prezencë të mbrojtësit të tij dhe në mënyrë vullnetare ka bërë pranimin e fajësisë duke u njoftuar edhe për pasojat e pranimit të fajësisë e që mes pasojave të pranimit të fajësisë ishte edhe propozimi në aktakuzë për konfiskimin e automjetit i cili kishte shërbyer për kryerjen e veprës penale, ashtu që gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se pranimi i fajësisë ishte në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPP-së, përkatësisht

edhe për pasojat e tij, pra, konfiskimin e automjetit.[119] Andaj, pretendimi i theksuar përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë se nuk kishte njohur për pasojat e veprës penale, gjegjësisht se automjeti i tij do të konfiskohet u vlerësuan si të pabazuara nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kurse si *pasojë e pranimit të fajësisë* paraqet fakti se aktgjykimi nuk mund të atakohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike përkatësisht humb njërën bazë për ankesën e aktgjykimit. Pranimi i fajësisë duhet të *bëhet në mënyrë vullnetare*, të plotë dhe pa asnjë dilemë, për më tepër, i pandehuri duhet të jetë i pandehuri i vetëdijshëm për këtë pranim dhe jo që pranimi të arrihet me anë të dhunës, kanosjes, detyrimit, mosdijes, pastaj nëse është i njohur fakti se i pandehuri vuan nga ndonjë sëmundje e përkohshme apo e përhershme mendore dhe preferohet që në shumicën e rasteve pjesëmarrës në të duhet të jetë edhe mbrojtësi i të pandehurit dhe se duhet çmuar edhe faktin se a ka pasur kohë të mjaftueshme për konsultime, pra të gjitha këto elemente janë tejet të rëndësishme në të kundërtën pranimi i fajit do të ishte jo i plotë.

Një pikë tjetër e rëndësishme është se pranimi i fajësisë duhet të mbështetet me prova konkrete edhe pse në fakt formalisht në këtë fazë nuk shqyrtohet asnjë provë, megjithatë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, është i detyruar që të bëj një shqyrtim dhe vlerësim të kuantitetit dhe kualitetit të provave që ka në shkresat e lëndës dhe kjo domosdoshmërisht gjykatën e obligon që të ketë të qartë se a ekziston përgjegjësi penale e të pandehurit, pastaj a ekzistojnë elemente të veprës penale të përshkruar në aktakuzë dhe shumë elemente tjera. Gjithsesi duhet pasur parasysh edhe faktin se provat duhet çmuar edhe me faktin se a janë prova të pranueshme, meqë edhe siç dihet aktgjykimi nuk mundet që të bazohet në prova të papranueshme,[120] si dhe duhet ta

[119] Aktgjykimin Pml. nr.212/2024 të datës 12.04.2024.
[120] Neni 251 par.3 i KPP-së

ketë parasysh provat për përcaktimin e fajësisë,[121] përkatësisht pamjaftueshmërinë e provave për një vendim fajësie.

Është përgjithësisht i pranuar fakti se kriteret e përcaktuara më lartë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, përndryshe pranimi i fajësisë konsiderohet se është i mangët dhe mund të jetë bazë për anulimin e aktgjykimit dhe njëkohësisht kthimin e çështjes në rigjykim. Pikërisht kjo është konstatuar me rastin e shqyrtimit të kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, sipas aktgjykimit Pml. nr. 471/2021 të datës 19.01.2022 e paraqitur nga ana e mbrojtësit të të pandehurit M.K, me ç'rast është konstatuar se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë jo të duhur dhe si pasojë e kësaj rezultoi me anulimin e aktgjykimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore. Gjykata Supreme e Kosovës në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht procesverbali i shqyrtimit fillestar del se i dënuari kishte bërë pranimin e fajësisë dhe pas konstatimit se janë plotësuar kriteret e pranimit të fajësisë sipas nenit 248 të KPP-së[122], ishte vazhduar me shqiptimin e dënimit. Kurse me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ishte konstatuar fakti se në rastin konkret ishin plotësuar kriteret për pranimin e fajësisë të përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPP-së, mirëpo me këtë rast sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e pranimit të fajësisë nuk ishin plotësuar kriteret e kërkuara ligjore. Dispozita e nenit 248 par.1 të KPP-së ka përcaktuar se: "*Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse: 1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; 1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës; 1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe 1.4.*

[121] Shih neni 257 i KPP-së

[122] Në këtë rast duhet sqaruar faktin se është konstatuar shkelja e nenit 248 par.1 të KPP-së, sipas Kodit të mëparshëm, mirëpo dispozitë të ngjashme ligjore përmban edhe Kodi i Ri i procedurës penale e përcaktuar me nenin 242 të KPP-së.

aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.".
Nga leximi i dispozitës ligjore nënkuptohet se për tu bërë pranimi i fajësisë të gjitha kriteret duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe në të kundërtën, pranimi i fajësisë nuk do të ishte në harmoni me dispozitën ligjore. Kurse në rastin konkret nga përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rrjedh se përkundër faktit se i dënuari ishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 317 par.1 të KPRK-së, nuk ishte përshkruar elementi esencial i veprimit të tij se në rastin konkret, si ishte manifestuar përdorimi i forcës. Për më tepër, përdorimi i forcës, përkatësisht mënyra e përdorimit të forcës apo kanosjes duhet të jetë i natyrës serioze dhe për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, që paraqesin elementet e veçanta dhe tipare dalluese të kësaj vepre penale në raport me ndonjë vepër tjetër penale. Përkundër faktit të pakontestueshëm se i dënuari është deklaruar fajtor, megjithatë, është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë që pranimin e fajësisë ta vlerësoj në dritën e dispozitës ligjore të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe përshkrimit të veprimeve të të dënuarit, përndryshe bie ndesh me dispozitën e mësipërme ligjore, si dhe provave të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale, siç ka ndodhur në rastin konkret.
Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 12 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe me këtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.[123]
Është i rëndësishëm fakti edhe pse jo obligativ i kërkimit të mendimit nga prokurori i shtetit, mbrojtësi dhe i dëmtuari dhe se kjo mund të jetë e rëndësishme, meqë palët nga këndvështrimi i tyre do të paraqesin argumentet e tyre e që nganjëherë edhe mund të jenë kundërthënëse. Pa dyshim se do të ishte e preferueshme kërkimi i mendimit nga palët, meqë gjykata do të kishte një pasqyrë më qartë të ngjarjes dhe pastaj kjo i

[123] Aktgjykimi Pml. nr. 471/2021 të datës 19.01.2022.

mbetet çmuarjes së gjykatës dhe duke e ndërlidhur me provat që i ka në dispozicion.

Marrja e mendimit është e rëndësishme edhe për një fakt tjetër se gjykata mund të merr të dhëna të rëndësishme që pastaj të vendosë në lidhje me pranimin apo jo të fajësisë e që në kontest të kësaj bazuar edhe në faktin tjetër se në këtë fazë nuk është paraparë fare fjala përfundimtare, atëherë palët në procedurë mund ti paraqesin pikëpamjet e tyre edhe në lidhje me këtë e që i mundësojnë gjykatës që të ketë një pasqyrë më të qartë për rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të pandehurit dhe shumë rrethana të tjera të rëndësishme për të individualizuar dënimin gjegjësisht për të përcaktuar llojin dhe lartësinë e dënimit, përkatësisht dënimi konkret që caktohet nga gjykata ndaj autorit të veprës penale.[124]Edhe pse marrja e mendimit nuk është obligative, megjithatë gjatë analizave që kam bërë gjatë përgatitjes së këtij punimi marrja e mendimit është aplikuar në të gjitha shqyrtimet fillestare e konfirmuar përmes shikimit të procesverbaleve të shqyrtimeve fillestare.

Mirëpo, përkundër këtyre vështrimeve të provave sipas nenit 242 paragrafi 2 të KPP-së, megjithatë gjykata nuk ka ndonjë mundësi tjetër në këtë fazë pos faktit që nëse konstaton se nuk janë vërtetuar faktet e përcaktuara nga neni 242 paragrafi 2 i KPP-së apo konstaton ndonjë mangësi të provave me vendim e refuzon pranimin e fajësisë me qëllim që ti hapë rrugë shqyrtimit gjyqësor.

Po ashtu sikurse në paragrafin e mësipërm edhe në këtë rast aktvendimi për pranimin e fajësisë konstatohet në procesverbalin e shqyrtimit fillestar, megjithëse nuk është paraparë dispozitë e veçantë për përmbajtjen e procesverbalit të shqyrtimit fillestar e në mungesë të saj, përshtatshmërisht duhet të ndiqen hapat e procesverbalit e shqyrtimit gjyqësor, kurse procesverbali duhet të përpilohet me shkrim dhe të shënohet thelbi i rrjedhës së shqyrtimit.[125]

[124] MUÇI Shefqet, E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007, faqe 265
[125] HAJDARI Azem, Procedura penale – Komentar, Prishtinë, 2010, faqe 597

Fakti i moskujdesit të duhur të gjykatës së shkallës së parë me rastin e përpilimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor është hasur me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas çështjes penale 520/2024 të datës 05.09.2024, me çrast në gjykatën e shkallës së parë ishte konstatuar se i pandehuri V. G ishte deklaruar fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose anloge nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së, kurse ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose anloge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së, me ç'rast Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 i KPP-së dhe kërkesa për mbrojten e ligjshmërisë ishte aprovuar që kishte rezultuar me anulimin e dy aktgjykimeve të instancave më të ulëta gjyqësore, kjo për faktin se i pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për veprën penale më të pa favorshme për të.[126]

Padyshim se pjesa e cila më së shumti ka shkaktuar debat me hyrjen në fuqi të këtij Kodi është momenti kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pranon pranimin e fajësisë dhe atëherë mund të kemi tri situata të ndryshme.

E para se *vazhdon me shqiptimin e dënimit*[127] e që kjo paraqet një shkurtim të procesit gjyqësor, kurse dilemat e paraqitura te rastet kur trajtohen nga ana e departamentit për krime të rënda tani më janë tejkaluar edhe përmes mendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës[128] e cila ka përcaktuar se dënimi duhet të shqiptohet nga ana e kryetarit të trupit gjykues, meqë bëhet fjalë për situatë specifike gjatë shqyrtimit fillestar e që bazuar në praktikën gjyqësore vazhdimisht është shqiptuar dënimi nga ana e kryetarit të trupit gjykues. Sa për ilustrim në dy raste është shqiptuar edhe dënimi i përjetshëm, sipas rasteve Pml.nr.100/2025 të datës 01.01.2025 dhe rastit nga Gjykata Themelore në Ferizaj PKR. nr.91/2020

[126] Aktgjykimi Pml. nr.520/2024 të datës 05.09.2024.
[127] Neni 242 par.6 i KPP-së
[128] Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës GJA. nr. 207/13 të datës 19. 03. 2013.

i datës 26.10.2020, kjo pasi të pandehurit janë deklaruar fajtor për veprat penale të kryera.

Situata tjetër përkatësisht situata e dytë paraqitet në rastet pas pranimit të fajësisë vazhdohet, *me caktimin e seancën sipas nenit 356 të këtij kodi për të përcaktuar çështje që janë të rëndësishme për shqiptimin e dënimit,*[129] e që ky fakt relevant i do të mund të ishte i rëndësishëm dhe i nevojshëm për shqiptimin e dënimit dhe në këto raste edhe pse nuk është decidivisht e përkufizuar do të ishte e nevojshme që të mbyllet shqyrtimi fillestar dhe të caktohej një seancë dëgjimore vetëm për vërtetimin e fakteve në fjalë, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 356 të KPP-së. Sa i përket çështjeve të rëndësishme ato mund të jenë të natyrave të ndryshme, siç mund të jenë sigurimi i të dhënave nga evidenca e të dënuarve, ndonjë rrethanë e rëndësishme personale apo familjare e të pandehurit, nëse do të ishte i nevojshëm të vërtetohet fakti se a është kompensuar apo jo viktima, përkatësisht i dëmtuari, po ashtu një rrethanë e tillë mund të ishte edhe vërtetimi i fakteve kur i pandehuri ka aftësi të zvogëluar mendore dhe do të ishte i rëndësishëm fakti se cila është shkalla e aftësisë së zvogëluar mendore. Por në të gjitha rastet që mund të jenë të natyrave të ndryshme duhet që ekskluzivisht të ndërlidhen me vërtetimin e ndonjë fakti apo rrethane përkitazi me shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe kjo nganjëherë edhe shpie deri tek shtyrja e shqyrtimit fillestar dhe pastaj caktimi i një seancë të veçantë për shqiptimin e dënimit.

Kurse situata e tretë paraqitet në rastet e bashkëpunimit mes të pandehurit dhe prokurorit të shtetit dhe se kjo *pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit,*[130] për një afat deri sa të përfundon ky bashkëpunim e që mund të paraqitet në situatat kur bëhet negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe në rastet kur kemi të bëjmë me dëshmitarin bashkëpunues. Kurse me rastin e pezullimit në këto situata gjykata duhet të përcaktoj afat gjyqësor me qëllim që këto çështje të mos prolongohen në afat të gjatë dhe këto afate

[129] Neni 242 par.6 të KPP-së
[130] Neni 242 par.6 të KPP-së

gjithsesi do të duhej të caktoheshin në ndërlidhje me komplikueshmërinë e çështjes, por se ndoshta nëse do të stërzgjatej ky bashkëpunim, atëherë gjykata do të mund të shqiptonte dënimin, meqë tani më është vendosur për pranimin e fajësisë.

Një rast interesant është trajtuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës përkitazi me çështjen penale Pml. 665/2024 të datës 31.10.2024, kundër të pandehurve Gj.M dhe H.B, pasi që në bashkëkryerje ishin akuzuar për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 424 paragrafi1 të KPRK-së dhe mashtrimi me subvencione nga neni 324 paagrafi 3 lidhur me 1 të KPRK-së, me ç'rast pas shqyrtimit fillestar i pandehuri Gj.M kishte bërë pranimin e fajësisë, kurse i pandehuri tjetër nuk e kishte pranuar fajësinë, kurse gjykata e shkallës së parë menjëherë kishte shqiptuar dënimin. Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga ana e mbrojtësit të të pandheurit Gj.M, pretendohej se në këtë çështje penale do të duhej të pezullohej shqiptimi i dënimit kundër të pandehurit deri sa të konstatohej kontributi i të dënuarit Gj.M, përkatësisht deri sa çështja të përfundohej. Mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e saj kishte konstatuar se pretendimi i tillë ishte i pabuazuar për faktin se është në diskrecion të gjykatës së shkallës së parë që pas pranimit të fajësisë të shqiptoj dënimin, caktoj seancën për shqiptimin e dënimit ose të pezulloj dënimin deri në përfundim të bashkëpunimit, kurse në rastin konkret del se gjykata e shkallës së parë ishte përcaktuar për seancën e shqiptimit të dënimit dhe pas kësaj seance kishte shqiptuar dënimin. Fakti i bashkëpunimit të të pandehurit dhe vështirësitë eventuale të këtij bashkëpunimi pas shqiptimit të dënimit pa dyshim se paraqesin një sfidë për prokurorinë e shtetit, mirëpo aspeketet e bashkëpunimit mes të pandehurit Gj.M dhe Prokurorisë së Shtetit paraqesin marrëveshje mes tyre dhe epilogu i kësaj marrëveshje nuk mund të ndikohet nga ana e të tjerëve e kjo duke u bazuar edhe në dispozitat përkatëse që rregullojnë këtë materie të dëshmitarëve bashkëpunues – neni 231 i KPP-së.[131]
Sa i përket kësaj dispozite është e nevojshme të analizohen edhe dy situata që mjaft shpesh na paraqiten në praktikë pas ngritjes së aktakuzës

[131] Aktgjykimi Pml. nr.665/2024 të datës 31.10.2024.

e që është e rëndësishme për shkak të parimit akuzator *nemo iudex sine actore*[132]:
dhe atë situata e parë kur aktakuza paraqitet ndaj një të pandehuri për vepra të ndryshme penale dhe në këto raste logjikisht kemi edhe deklarim të të pandehurit për secilën vepër veç e veç dhe në disa pika të aktakuzës mund të deklarohet i fajshëm kurse në disa i pafajshëm, apo edhe situata kur për disa vepra pranimi i fajësisë është sipas kritereve të nenit 242 paragrafi 2 të këtij Kodi, e për disa të mos plotësohen këto kritere.

Në këto situata duhet që të përcaktohet saktë se për cilat vepra pranohet fajësia dhe për cilat refuzohet pranimi i fajësisë dhe për cilat janë plotësuar kriteret dhe për cilat nuk janë plotësuar këto kritere dhe gjithsesi e rëndësishme është që në këto raste duhet që të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor vetëm për akuzat në të cilat nuk është pranuar fajësia apo nuk janë plotësuar kriteret, kurse për veprat për të cilat është pranuar fajësia duhet në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të shqiptohet dënimi.

Kurse situata e dytë ekziston në rastet kur aktakuza ngritët ndaj disa të pandehurve dhe në këto raste ekziston mundësia që një apo disa të pandehur ta pranojnë fajësinë kurse një apo disa nga të pandehurit të deklarohen të pafajshëm. Në këto raste duhet që të veprohet sipas dispozitës së nenit 242 paragrafi 8 të KPP-së dhe me të pandehurit që pranojnë fajësinë të vazhdohet me shqiptimin e dënimit kurse me të pandehurit tjerë të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor.

Edhe pas përfundimit të shqyrtimit fillestar nuk shterret mundësia e pranimit të fajësisë përkatësisht ekziston mundësia që i pandehuri të pranoj fajësinë në çdo kohë pas shqyrtimit fillestar edhe pse kjo nuk është përcaktuar se në çfarë forme do të mund të bëhej ky deklarim gjithsesi kjo mund të bëhej përmes parashtresës me shkrim dhe nga kjo rrjedhimisht mund të determinoj zhvillimin edhe të një shqyrtimi fillestar që në fakt mund kushtimisht të zhvillohen më tepër se një shqyrtim fillestar.

[132] SAHITI Ejup, E drejta e Procedurës Penale , Prishtinë, 1986, faqe 173

3. Kundërshtimi i provave

Duhet theksuar se pas shqyrtimit fillestar është një mes fazë në të cilën zhvillohen një varg veprimesh procedurale mjaft të rëndësishme nga palët në procedurë të cilat iniciativa rrjedhin nga ana e të pandehurit përmes paraqitjes së kundërshtimit të provave të paraqitura nga ana e prokurorit të shtetit në aktakuzë dhe kjo paraqet fazën kur edhe i pandehuri përmes këtij instituti kundërshtimit të provave paraqet pretendimet e tij përkitazi me provat e propozuara nga ana e prokurorit të shtetit. Padyshim se kundërshtimi i provave është mjaft i rëndësishëm nga fakti se ekziston mundësia që në këtë fazë të procedurës që gjykata ti evidentoj dhe po ashtu edhe ti shpallë të papranueshme provat e caktuara dhe ky është një dekontaminim i lëndës nga provat e papranueshme, meqë në prova të tilla nuk mund të mbështetet vendimi gjyqësor.[133] Kundërshtimet mund të paraqiten vetëm në provat e caktuara dhe në rastet kur janë marrë në mënyrë jo të ligjshme nga organet që zhvillojnë hetime dhe kjo është e rëndësishme nga fakti se këto organe duhet të jenë të kujdesshme gjatë veprimeve të tyre dhe se tejkalimi i autorizimeve mund të shpie deri te fakti që provat janë marrë në mënyrë jo të ligjshme.
Sa i përket provave që janë në kundërshtim me Kapitullin XVII të Kodit, kjo në thelb paraqet ndryshe institutin e provave të papranueshme, për më tepër në këtë kapitull janë përshkruar edhe cilat janë provat e papranueshme.

Sa i përket bazës së tretë kur mund të paraqitet kërkesa për kundërshtimin e provës kur ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pa mbështetshme e që në Kod është paraqitur edhe përkufizimi i provës thelbësisht të pa mbështetshme.[134]

Është e zakonshme që në pretendimet e të pandehurit ti ipet mundësia që prokurori i shtetit të përgjigjet në këto pretendime në formë të shkruar e

[133]SAHITI Ejup& MURATI Rexhep E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, faqe 249
[134] Neni 19 par.1.30 i KPP-së

cila mund që të paraqitet pas shqyrtimit fillestar. Është e natyrshme që paraprakisht gjykata në rastet kur i pandehuri paraqet kundërshtim me shkrim këtë parashtresë të ia dërgoj palës tjetër përkatësisht prokurorit të shtetit, kurse afatet e përgjegjës janë brenda 15 ditëve, siç janë përcaktuar në dispozitën e nenit 245 paragrafi 3 të këtij Kodi.

Çështja tjetër që është e nevojshme të trajtohet është se çka do të ndodhte nëse nuk paraqiten përgjigjet nga ana e prokurorit të shtetit brenda afatit të përcaktuar, atëherë gjykata pas kalimit të këtij afati duhet të vendosë edhe pa përgjigjen e prokurorit të shtetit që të mos mbetet peng i kësaj përgjigje dhe të mos prolongohet çështja. Parimisht për shkak të shumë arsyeve do të ishte më e preferueshme që përgjigjja e prokurorit të shtetit të ishte obligative, meqë në konceptin si është aktualisht e ndërtuar norma kjo paraqet mundësi dhe jo obligim të prokurorit të shtetit, për më tepër një përgjigje e plotë dhe duke i analizuar hollësisht pretendimet e të pandehurit do të ishte mjaft e rëndësishme edhe për gjykatën.

Në nenin 243 paragrafi 3 të KPP-së, është përcaktuar se për të gjitha provat duhet të vendoset që të lejohet ose përjashtohet prova. Kjo në fakt paraqet një stopim të procedurës deri sa të vendoset lidhur me lejimin apo përjashtimin e provave, kurse sa i përket vendimet e saj mund të jenë të ndryshme pra ekziston mundësia që disa prova të lejohen dhe disa të përjashtohen, të gjitha provat të lejohen apo të gjitha provat të përjashtohen. Kundër aktvendimit për kundërshtimin e provave, mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve nga pranimit të aktvendimit me shkrim, kurse ankesa paraqitet në gjykatën e apelit.

Dispozita e nenit 243 paragrafi 4 të KPP-së, përshkruhen veprimet që merren kur konstatohen se në lëndë ekzistojnë prova të papranueshme dhe kjo është një standard i zakonshëm që provat të ndahen nga shkresat tjera, të mbyllen dhe që këto nuk lejohen që të shfrytëzohen deri sa të vendoset në lidhje me to dhe kjo paraqet një standard të zakonshëm bazuar në faktin se provat e shpallura si të papranueshme konsiderohen sikurse nuk ekzistojnë edhe pse nuk ka ndonjë definicion përkitazi me provat e papranueshme ato janë prova të marra në kundërshtim me

dispozitat ligjore, kjo konsiderohet provë e pavlefshme apo e papranueshme.[135]

Gjithashtu sa i përket provave të papranueshme në rastet kur palët nuk i kundërshtojnë provat, atëherë i është dhënë autoritet gjykatës që edhe sipas detyrës zyrtare të përjashtoj provën në rastet kur pranueshmëria e provës së caktuar cenon të drejtat e të pandehurit e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky paraqet një koncept mjaft të gjerë dhe me të drejtë ky legjitimitet i është besuar gjykatës si autoritet i cili ka mundësi të përjashtoj provën, meqë edhe në provat e papranueshme nuk mund të mbështetet një vendim fajësie apo pafajësie.

3.1. Kërkesa për hudhjen e aktakuzës

Mundësia e dytë e të pandehurit pas seancës së shqyrtimit fillestar është të paraqesë kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe se këtë kërkesë mund ta paraqesë për bazat e përcaktuara dhe se këto situata janë identike me bazat për lirim nga aktakuza.

Sikurse edhe në kundërshtimin e provave edhe në kërkesë për hudhje të aktakuzës, prokurorit të shtetit i ipet mundësia që të përgjigjet në këto pretendime në formë të shkruar, kurse pas përgjigjes nga ana e prokurorit të shtetit apo edhe pa përgjigje brenda afatit të përcaktuar me nenin 244 paragrafi 4 të këtij Kodi, gjykata ka dy mundësi ta refuzon kërkesën për hudhje të aktakuzës ose ta hudhë aktakuzën nëse vlerëson se ekziston ndonjë bazë nga neni 247 i KPP-së.

Është e rëndësishme të potencohet se në këtë rast ky vendim i gjykatës (me rastin e refuzimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës) paraqet një filtër të kontrollit gjyqësor të aktakuzës dhe shikuar në aspektin teorik

[135] ÇOLLAKU Hashim, Roli i Prokurorit të Shtetit në Procedurën Penale, Prishtinë, 2013, faqe 92

pas përfundimit të procedurave rreth kontrollit të aktakuzës, aktakuza faktikisht e fiton formën e prerë.[136]

Kundër aktvendimeve për hudhjen përkatësisht refuzimin e hudhjes, mund të paraqitet ankesë nga secila palë gjykatës së apelit, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve nga pranimit të aktvendimit me shkrim.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk është e lejuar paraqitja e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, përkatësisht kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, andaj janë konsideruara si të paluajuara nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës. Kështu është konstatuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit K.Th është hudhur si e palejuar në rastin Pml. nr.22/2025 të datës 28.01.2025, për faktin se shqyrtohen vetëm vendimet e formës së prerë. Tutje në arsyetim theksohet se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, sipas dispozitës së nenit 432 par.1 të KPPK, mund të ushtrohet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Kurse në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e çështjes, procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë, ajo ndodhet në fazën e ngritjes së aktakuzës dhe kundërshtimit të provave të parapara sipas kapitulli XVI të KPP-së, pra, shqyrtimi gjyqësor akoma nuk ka filluar dhe procedura nuk ka përfunduar në këtë çështje pasi që e njëjta do të vazhdojë sipas kapitullit XIX të KPP-së, prandaj kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në këtë rast nuk është e lejuar.[137]

3.2. Përgjigjet

Është e natyrshme që në kundërshtim dhe kërkesë të mbrojtësit apo të pandehurit, atëherë prokurorit të shtetit i mundësohet paraqitja e përgjigjeve dhe kjo me qëllim që gjykata ti ketë parasysh argumentet e palëve me rastin e vendosjes.

Përgjigjet mund të paraqiten me shkrim përmes parashtresës me qëllim që gjykata të ketë vëmendje me rastin e vendosjes, kurse konsideroj se

[136] SAHITI Ejup& MURATI Rexhep E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, faqe 347

[137] Aktgjykimi Pml. nr.22/2025 të datës 28.01.2025.

gjithsesi më e preferueshme do të ishte që komunikimi të ishte literal pra në formë të shkruar, meqë nga shkaku se edhe prokurori i shtetit do të kishte kohë më të gjatë në dispozicion.

Ligjvënësi me të drejtë ka vendosur afat ligjor prej 15 ditëve, për përgjigje të prokurorit të shtetit por, megjithatë gjykatës pas kalimit të këtij afati menjëherë i krijohet mundësia që të vendosë lidhur me kërkesën apo kundërshtimin edhe pa një përgjigje të tillë, por megjithatë do të ishte më e prefruar që prokurori i shtetit të pëgjigjej në pretendimet e të pandehurit, meqë në këtë situatë gjykata do ti kishte para vetes argumentet e të dy palëve dhe do të kishte më lehtë të vendoste.

Në mënyrë alternative është lënë mundësia që prokurori i shtetit në vend të përgjigjes në pretendimet e të pandehurit të ketë mundësinë e ndryshimit të aktakuzës fillestare përkatësisht ndryshimit të saj e që kjo paraqet risi në krahasim me Kodin e mëparshëm dhe se kjo po ashtu paraqet edhe mjaft paqartësi dhe dilema. Çështja elementare që duhet të trajtuar është fakti se çka nënkuptohet me aktakuzë të ndryshuar dhe se ky ndryshim në aktakuzë a nënkupton ndryshim substancional apo vetëm në aspektin e gabimeve teknike, a mund që ky ndryshim të përfshijë aspekte subjektive dhe objektive, a mund të ndryshohet edhe kualifikimi i veprës penale. Megjithatë ndryshimi duhet të nënkupton jo vetëm aspektin e gabimeve teknike, por edhe përmbajtësore sidomos duke iu referuar nenit 246 paragrafi 3 të KPP, që është paraparë si bazë e veçantë e kundërshtimeve dhe kërkesave ekskluzivisht për këtë ndryshim të aktakuzës.

3.3. Aktakuza e ndryshuar

Siç u tha edhe më lartë prokurori i shtetit duke u përgjigjur në pretendimet e të pandehurit për hudhje të aktakuzës, ka mundësi që të ndryshoj aktakuzën dhe këtë aktakuzë të ndryshuar duhet ta paraqes brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga pranimi i kërkesës për hudhje të aktakuzës, gjithashtu edhe ky ndryshim nuk është i specifikuar se në çka konsiston ndryshimi i aktakuzës në përmbajtje apo vetëm ndryshime të aspektit të

gabimeve teknike, por duke iu referuar nenit 246 paragrafi 3 të KPP, është e qartë se bëhet fjalë për ndryshime të karakterit substancional, meqë për pjesën e ndryshuar mund të paraqiten kundërshtime dhe kërkesa sikurse për aktakuzën fillestare.

Kjo dispozitë[138] është e paqartë dhe mund të krijoj dilema, meqë nuk është qartësuar se a bëhet fjalë për të pandehur të njëjtë sikurse tek paraqitja fillestare e aktakuzës apo mund të paraqitet edhe ndaj të pandehurve tjerë. Mund të jetë edhe njëra edhe tjetra, por se ka mundësi që aktakuza e ndryshuar të paraqitet edhe për të pandehur të tjerë dhe kjo nga fakti se me këtë aktakuzë veprohet sikurse aktakuza të ishte e re. E rëndësishme është të theksohet se përmes aktakuzës së ndryshuar kemi një riciklim përkatësisht një kthim në fazën e paraqitjes së aktakuzës.

Kundërshtimet dhe kërkesat mund të paraqiten vetëm për pjesët që janë të ndryshuar nga aktakuza dhe jo edhe për pjesët e tjera meqë për ato pjesë është shterrë mundësia e paraqitjes së tyre. Pra siç u përshkrua më lartë tani kemi një mundësi të paraqitjes së serishme të kërkesave dhe kundërshtimeve të paraqitura më parë, por, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë për kërkesat dhe kundërshtimet përkatësisht vendosë se nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar dhe nuk shqyrton më tej, pra vlerëson se kundërshtimet fillestare janë eliminuar me aktakuzën e ndryshuar.

Ekziston vetëm një herë mundësia e ndryshimit të aktakuzës pos rasteve kur sigurohen të dhëna që e bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës që edhe kjo dispozitë është mjaft komplekse, meqë lejon që *ndryshimi i aktakuzës të bëhet disa herë në rastet kur sigurohen të dhëna të reja që bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës*[139] siç e përkufizon ligjvënësi e që kjo është mjaft e paqartë duke u bazuar në faktin se nga do të sigurohen ato të dhëna kur me paraqitjen e aktakuzës pushon çdo aktivitet i prokurorit të shtetit, përkatësisht përmbyllet faza e hetimeve për atë çështje penale.

[138] Neni 246 par.2 i KPP-së
[139] Neni 246 par.5 i KPP-së

Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve Paragrafi në fjalë është shumë interesant të trajtohet dhe atë për disa arsye: së pari është e qartë se janë parashikuar që të mbahen nëse është e nevojshme disa shqyrtime për arsye që është përshkruar në dispozitë se këto shqyrtime kanë të bëjnë me *përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve*. Neni 247 paragrafi 2 i KPP-së, ka përcaktuar afatin maksimal të nxjerrjes së aktvendimit për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së propozimeve, por më esenciale është fakti se aktvendimi duhet të jetë në formë të shkruar dhe i arsyetuar.

3.4. Hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës

Me dispozitën e nenit 248 të KPP-së është rregulluar hudhja e aktakuzës e cila ndërlidhet me nenin 244 të KPP-së dhe gjithsesi i rëndësishëm është fakti se hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës mund të bëhet sipas kërkesave të palëve edhe pse është e natyrshme që kjo kërkesë zakonisht paraqitet nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij.

Pra sipas kësaj dispozite është e përcaktuar se hudhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës penale bëhet vetëm pas kërkesës së palëve e që përjashton mundësinë që gjykata të veproj sipas detyrës zyrtare. Këtu gjithsesi duhet sqaruar dhe dalluar situatën kur gjykata e hudhë parashtresën pasi që ia kthen paraqitësit të saj për korrigjim dhe plotësim dhe si pasojë e mosveprimit.[140] Gjithsesi dallimi mes këtyre situatave është substancional dhe atë nga fakti se tek *hudhja* e parashtresës nuk *pushohet* procedura dhe nuk konsiderohet si çështje e gjykuar "*ne bis in idem"* kurse me dispozitën e këtij paragrafi hudhet aktakuza dhe pushohet procedura dhe në këto raste kur aktvendimi merr formën e prerë nuk mund të vazhdohet procedura ndaj të pandehurit për atë vepër penale, pra ndërlidhet me identitetin subjektiv dhe objektiv të aktakuzës.[141]

[140] Neni 441 paragrafi 4 i KPP-së, si parashtresë e përcakton edhe aktakuzën
[141] Neni 4 i KPP-së

Sa u përket bazave për hudhje këto janë të përcaktuara në mënyrë taksative dhe janë të ngjashme me bazat e përcaktuara te aktgjykimi lirues, kurse gjykata nuk është e detyruar në cilësimin juridik sipas pretendimeve të prokurorit të shtetit, por gjithsesi ndërlidhet me përshkrimin e fakteve në aktakuzë.
Gjithashtu duke vepruar sipas kërkesës për hudhje të aktakuzës i jep mundësinë prokurorit të shtetit që në rastet e përgjigjes në pretendime të të pandehurit të bëj tërheqjen e aktakuzës në rastet kur konsideron se kërkesa është e bazuar.

Duhet theksuar faktin se në prakitkën gjyqësore kemi raste të hudhjes së aktakuzës në këtë fazë të procedurës penale që në një mënyrë shmang vazhdimin e procesit gjyqësor përmes shqyrtimit gjyqësor dhe ulë koston kohore të procesit gjyqësor.

Një rast interesant i hudhjes së aktakuzës për shkak të faktit se vepra për të cilën është ngritur aktakuza nuk përbën vepër penale është evidentuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj sipas çështjes penale 2022:235595 të datës 20.02.2023, me ç'rast Prokuroria Themelore në Ferizaj kundër të pandehurit E.A, kishte ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së.në këtë çështje penale i akuzuari dhe Prokuroia e shtetit kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe e cila marrëveshje ishte refuzuar nga ana e gjykatës dhe duke vendosur sipas kërkesës për hudhjen e aktakuzës të paraqitur nga ana e mbrojtëses së të pandehurit e njëjta ishte hudhur dhe ishin pushuar hetimet kundër të pandehurit E.A, kishte ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se pprokuroria me rastin e ngritjes së aktakuzës, ka dështuar t'i përmbahet këtij parimi të cituar sipas dispozitës ligjore, sepse nuk i ka trajtuar edhe faktet që janë në favor të pandehurit, sepse me të gjitha provat personale dhe materiale e bëjnë të besueshëm faktin se qëllimi i të pandehurit kur ka vendosur të ja mundësoj profesorit të edukatës fizike H.S që të shkoj jashtë vendit, ka qenë se, ky i fundit ka kërkuar me qëllim që ta dërgojë bashkëshorten e

tij jashtë vendit, konkretisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e që paraprakisht ishte marrë vesh me kolegen e tij J.A që kjo e fundit të ja mbajë orët e mësimit. Për më tepër prokuroria gjatë zhvillimit të procedurës para vetes e kishte të njohur edhe një fakt tjetër dhe atë sëmundjen edhe vetë të pandehurit, i cili sipas raporteve mjekësore ishte duke vuajtur nga një sëmundje e rëndë, e diagnotifikuar si tumor në fyt, gjë që ka rezultuar se edhe intervistimi i tij është përcjellë me vështirësi. Madje në këtë drejtim prokuroria fillimisht kishte pezulluar hetimet, për të rifilluar më 19.10.2022, pikërisht për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore. Faktet e tilla të theksuar janë pakontestueshëm, e që kanë përjashtuar elementin subjektiv të pandehurit, siç është dashja apo ‘’qëllimi kriminal’’ që i njëjti ta ketë pasur për ta kryer veprën penale keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, përkundrazi qëllimi i tij rezulton të jetë tërësisht human.[142]

4. Aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor

Me dispozitën e nenit 249 të KPP-së janë paraqitur rastet kur konsiderohet se aktakuza është konfirmuar dhe krijimi i kushteve për caktimin e shqyrtimit gjyqësor, pra konfirmimi i aktakuzës nënkupton kalimin e filtrit gjyqësor të aktakuzës dhe përgatitja për shqyrtimin gjyqësor si fazë mjaft e rëndësishme e procedurës penale.

Në varësi të shfrytësimit të mjeteve juridike që i ka në dispozicion i pandehuri në këtë fazë të procedurës penale, atëherë është përcaktuar se kur aktakuza konsdierohet e konfirmuar dhe atë fillimisht kur pas shqyrtimit fillestar nuk paraqiten kundërshtime të provave apo kërkesë për hudhje të aktakuzës, pasi që refuzohen kërkesat për kundërshtimin e provave apo hudhjen e aktakuzës, palët nuk paraqesin ankesë në instancën e shkallës së dytë dhe në rast se gjykata e shkallës së dytë refuzon ankesat. Në këto raste konsiderohet se aktakuza është konfirmuar dhe fillon të rrjedhë afati që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të caktohet shqyrtimi gjyqësor.

[142] Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj 2022:235595 të datës 20.02.2023.

4.1. Paraqitja e materialeve nga mbrojtja

Siç e potencuam edhe më lartë në shqyrtimin fillestar gjykata kujdeset që të përmbushen obligimet e mbrojtjes dhe të pandehurit ndaj prokurorit të shtetit sidomos përkitazi me nenin 250 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, përcaktuara në mënyrë taksative.

Është e rëndësishme që mbrojtja të paraqes prokurorit këto njoftime nga fakti se duhet që pastaj prokurori i shtetit të përgatitet për mundësinë e parashtrimit të çështjeve në shqyrtimin gjyqësor, për më tepër paraqitja e dëshmitarëve qysh në këtë fazë e ka rëndësinë e vet edhe për faktin se nëse nuk paraqiten në këtë fazë duhet që të arsyetohen se pse këto materiale nuk janë paraqitur në këtë fazë, kurse gjithashtu është e lejuar që informatat e përcaktuara më lartë mund të plotësohen deri para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, por që informatat gjithsesi duhet që të paraqiten para shqyrtimit gjyqësor.

Me qëllim të disiplinimit të mbrojtësit në procedurë dhe gjithsesi kur i njëjti nuk është në nivel të obligimit të marrë, gjykata në rast të mos përmbushjes së detyrimeve ka mundësinë që në rastet kur nuk gjendet ndonjë arsye, atëherë ka mundësinë që ndaj mbrojtësit të shqiptoj gjobë deri në dyqindepesëdhjetë (250) Euro dhe po ashtu të e njoftoj institucionin përgjegjës përkatësisht Odën e Avokatëve të Kosovës.

Përfundimi

Në përfundim të këtij punimit është e rëndësishme të theksohet se shqyrtimi fillestar, paraqet një ndër fazat më të rëndësishme të procedurës penale, e cila fillon me paraqitjen e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe mund të përfundoj pas shqyrtimit fillestar në rastet e hudhjes së aktakuzës apo mund të përfundoj edhe me aktgjykim dënues në rastet e pranimit të fajësisë apo arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Shqyrtimi fillestar paraqet fazën e rëndësishme të procedurës penale ku bëhet evidentimi i dëshmive dhe largohen provat e papranueshme, por se përmbanë edhe dispozita të karakterit teknik siç është dorëzimi i aktakuzës që konsideroj se është e tepërt dhe e panevojshme, meqë

aktakuza duhet të i dorëzohet paraprakisht të akuzuarit së bashku me ftesë me qëllim që të përgatitet për shqyrtimin fillestar.

Sigurohet se është respektuar e drejta e të akuzuarit për mbrojtës dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet për zbulimin e provave dhe të gjitha këto paraqesin një garanci dhe përgatitje për fazën kryesore përkatësisht shqyrtimin gjyqësor.

Gjatë shqyrtimit fillestar vendoset për masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit që është e rëndësishme, meqë palët mund që të paraqesin drejtpërdrejt gjatë këtij shqyrtimi pikëpamjet e tyre për vazhdimin apo zbatimin e këtyre masave dhe se përjashtimisht për këtë arsye lejohet dëgjimi i dëshmitarëve apo ekspertëve.

Gjatë shqyrtimit fillestar ekziston mundësia e palëve në paraqitjen e kundërshtimit të provave të caktuara e që kjo është një filtër gjyqësor i kontrollit të veprimeve të organeve që kanë zhvilluar procedurën hetimore dhe se në rast të evidentimit se ekzistojnë prova të tilla, atëherë gjykata mund ti evitoj këto prova nga lënda përmes shpalljes së tyre si prova të papranueshme.

Gjithashtu gjatë shqyrtimit fillestar është e mundshme të përfundohet një çështje penale përmes hudhjes së aktakuzës e cila mund të bëhet ekskluzivisht me kërkesën e palëve në procedurë përkatësisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, por se nuk është paraparë mundësia që hudhja e aktakuzës të bëhet sipas detyrës zyrtare dhe nga kjo vlerësoj se do të duhej të ekzistonte mundësia që gjykata të vepronte *ex officio* dhe të mund të hudhte aktakuzën pa kërkesat e palëve me qëllim që të mos vazhdohet me fazat e tjera të procedurës.

Po aq e rëndësishme është fakti se palët në procedurë në këtë fazë kanë rol mjaft aktiv qoftë përmes kërkesës për hudhjen e aktakuzës apo kundërshtimit të provave dhe se mbi bazën e kërkesës së njërës palë, kurse zgjidhje e mirë është fakti se është paraparë mundësia e vendosjes nga gjykata edhe pa marrjen e përgjigjes nga pala tjetër pas kalimit të afatit për përgjigje, e po ashtu risi paraqet fakti se ekziston mundësia që

prokurori i shtetit të ndryshoj aktakuzën e vet brenda afatit prej një jave e që sipas mendimit tim kjo është e panevojshme dhe e paarsyeshme.

Gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues drejton shqyrtimin fillestar duke e udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij dhe me rastin e pranimit të fajësisë apo arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë nëse plotësohen kushtet ligjore kanë kompetenca në shqiptimin e dënimit e është etabluar praktika gjyqësore dhe kjo dispozitë është aplikuar edhe në departamentin për krime të rënda ku janë shqiptuar dënime mjaft të larta e gjithashtu edhe dënime me burgime të përjetshme.

E veçantë e kësaj faze është fakti se përveç shqyrtimit fillestar është paraparë që mund të caktohen shqyrtime të posaçme me qëllim të përcaktimit të vlefshmërisë së propozimeve të palëve dhe këtu kemi të bëjmë me shqyrtimin e propozimeve sipas parimit të kontradiktoritetit në prezencë të palëve e që vërehet se maksimumi i marrjes së aktvendimeve janë shumë të gjata e që do të ishte më oportune që ky afat të ishte më i shkurtër përkatësisht maksimumi një javë me qëllim të vazhdimit me fazën kryesore përkatësisht shqyrtimit gjyqësor. Jam plotësisht i vetëdijshëm se komentimi i shkurtër i këtyre dispozitave mund të jetë i mangët dhe me ndonjë të metë eventuale, por mirëpres sugjerimet dhe vërejtjet nga lexuesit e këtij punimi

Literatura

- HAJDARI Azem, Procedura penale – Komentar, Prishtinë, 2010
- ISLAMI Halim& HOXHA Artan & PANDA Ilir, Procedura Penale, Tiranë, 2012
- SAHITI Ejup& MURATI Rexhep E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013
- ÇOLLAKU Hashim Roli i Prokurorit të Shtetit në Procedurën Penale, Prishtinë, 2013
- MUÇI Shefqet, E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007
- SAHITI Ejup, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 1986

Burim Ademi

Sekuestrimi dhe Konfiskimi i Pasurisë në Procedurën Penale

1. Hyrje

Kosova ka një histori të gjatë për sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë që ka qenë objekt i vendimmarrjes në kuadër të zhvillimit të procedurës penale. Duke qenë se Kosova ishte pjesë e përbërë e RSFJ-së, edhe në kuadër të ligjit penal të RSFJ-së ishte paraparë konfiskimi i pasurisë. Pas vitit 1999 kur ishte instaluar administrata e UNMIK-ut në Kosovë është miratuar Kodi i Përkohshëm Penal dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Në kuadër të këtyre dy akteve ligjore ishin paraparë mundësitë e konfiskimit të pasurisë ndaj të pandehurve kundër të cilëve zhvillohej procedura penale dhe gjykatat kishin mundësinë që përmes vendimit penal të konfiskonin pasurinë ndaj personave që ishte provuar në procedurë penale se kishin kryer vepër penale.

Me zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore në vend, posaçërisht me mundësitë e kryerjes së veprave penale në mënyrë më të sofistikuar ishte kërkesë e kohës që edhe sekuestrimi edhe konfiskimi të adaptoheshin në legjislacion, në mënyrë që të mundësohej zbatimi efektiv i sanksionimit dhe kthimit të pasurisë në interes të publikut kur ajo pasuri ishte në shërbim apo ishte përfitim i veprave penale, kështu që në Kosovë u miratua Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale që kishin hyrë në fuqi me datë 01.01.2013, dhe që ishte një procedurë tërësisht ndryshe si për sekuestrimin ashtu edhe për konfiskimin e pasurisë që ishte objekt i trajtimit në procedurë penale.

Tani nga 14 shkurti 2023, Kosova ka miratuar kodin e ri të Procedurës Penale i cili ka synuar disa qëllime themelore. Në radhë të parë synon garancinë e pronësisë, pastaj synon konfiskimin e pasurisë, që vërtetohet se është pasuri që shërben apo që është krijuar me vepër penale, pastaj synon garancitë procedurale në mënyrë që të konfiskohet pasuria duke mos u cenuar e drejta e pronës së ligjshme, pastaj synohet që të kenë rol aktiv palët në procedurë në mënyrë që gjykata të mund të zbatoj standardet e tilla që kërkohen me legjislacionin penal.

I gjithë legjislacioni i ndryshuar dhe plotësuar nga vitit 1999, përveç nevojës së përshtatjes së rrethanave shoqërore ishte po ashtu në kuadër të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për sa i përket pronës dhe njëkohësisht, kur ajo nuk kategorizohet si pronë e ligjshme të konfiskohet në mënyrë që, përveç dënimit që i shqiptohet kryerësit të veprave penale njëkohësisht të shtrihet efekti më i gjerë duke i pamundësuar gëzimin e fryteve nga vepra penale.

1. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Sekuestrimi si nocion nënkupton një masë ndaj pasurisë e cila mund të jetë në disponim të dyshuarit apo të personit të tretë. Përmes sekuestrimit mundësohet që pasuria e specifikuar të mos mbetet nën mbikëqyrjen e të akuzuarit apo të personit të tretë. Kjo mundëson që ajo pasuri të ruhet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore për të vendosur mbi fatin e saj se a do ti nënshtrohet konfiskimit apo duhet ti kthehet të dyshuarit apo personit të tretë.

Sekuestrimi në themel përbën masë ndaj pasurisë, që do të thotë se përmes sekuestrimit mundësohet sigurimi i asaj pasurie që mendohet se do t'i nënshtrohet konfiskimit përfundimtar. Përmes sekuestrimit mundësohen disa efekte që janë:

a) Ndalimi i disponimit,
b) Ndalimi i shkatërrimit,
c) Ndalimi i tjetërsimit.

Sekuestrimi përveç se krijon efektet e tilla për ruajtjen e pasurisë, shpesh herë pasuria e tillë krijon efekt edhe për të provuarit e fakteve, që mund të shërbejnë si për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve që pretendohen, e po ashtu edhe lidhur me përgjegjësinë penale. Aspekti i fakteve mund të jetë i ndërlidhur shumë ngushtë edhe në raport me pasurinë që i nënshtrohet sekuestrimit.

Konfiskimi

Konfiskimi nënkupton marrjen e pasurisë së specifikuar që përcaktohet sipas kodit të procedurës penale. Konfiskimi në themel godet kryerësin përtej sanksionit penal që i shqiptohet kur konstatohet fajësia. Konfiskimi i pasurisë ndaj kryerësit apo edhe ndaj personit të tretë, i pamundëson gëzimin apo shfrytëzimin sendeve që mund të shërbejnë për kryerjen e

veprave penale apo që janë dobi prej veprës penale, apo që janë në kategorinë e dhuratës së njollosur, andaj me konfiskimin e pasurisë i mundësohet shoqërisë që të njëjtat të shfrytëzohen në të mirën e përgjithshme.

1.1. Standardi ligjor për sekuestrimin e pasurisë

Për t'iu nënshtruara një pasuri sekuestrimit apo konfiskimit, duhet të kemi parasysh se duhen standarde ligjore, kjo për faktin se pasuria si kategori e pronësisë gjen mbrojtje si me aktet ndërkombëtare ashtu edhe me Kushtetutën e Kosovës, rrjedhimisht vetëm kur përmbushet standardi ligjor, një subjekti të së drejtës mund t'i kufizohen përkohësisht apo ti merret e drejta në pronën e tij që në procedurën penale ky kufizim bëhet përmes sekuestrimit gjegjësisht marrja e pasurisë bëhet përmes konfiskimit.

Kosova përmes inkorporimit në Kushtetutë ka adaptuar aktet ndërkombëtare të cilat gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë e të cilat akte garantojnë të drejtën e pronësisë.

Deklarata Universale për të drejtat dhe liritë e njeriut – në nenin 17 e kategorizon të drejtën e pasurisë si: "*1. Secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët. 2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij*"[143].Protokolli shtesë i datës 20.03.1952 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Protokolli nr. - 1, e përkufizon të drejtën e pronës si: " *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në*

[143] Neni 17, i Deklaratës së përgjithshme mbi te drejtat e njeriut, miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve te Bashkuara, me datë 10.dhjetor.1948.

përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera'[144].

Kushtetuta e Kosovës në nenin 46, e garanton të drejtën e pronës duke e normuar të drejtën e pronës si: "*1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës, nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet*"[145].

Këto akte juridike përcaktojnë një mbrojtje për sa i përket të drejtës së pronës. Megjithatë përkundër se aktet ndërkombëtare që gjejnë zbatim në Kosovë dhe përkundër se Kushtetuta e vendit përcakton një mbrojtje, e drejta e pronës nuk hynë në kategoritë e të drejtave absolute, dhe se lejohet marrja e të drejtës së pronës përmes eksproprijimit por sipas dispozitave ligjore lejohet edhe sekuestrimi dhe konfiskimi i pronës, përderisa ajo pronë sipas standardeve ligjore gjegjësisht dyshimeve që kërkohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, të konstatohet se bënë pjesë në kategoritë e pasurisë së specifikuar.

Më konkretisht Dispozitat e Kodit të procedurës penale, për sa i përket sekuestrimit, kanë paraparë standardin ligjorë që në nenin 260, është kusht që të përmbushet e që është " Dyshimi i Bazuar" – që ajo pasuri hynë në kategorinë e pasurisë së specifikuar.

Ndërsa dispozita nga neni 19[146] ka përcaktuar se pasuria e specifikuar përbën:

a) Mjetet – Qofshin ato të përdorura drejtpërdrejt, apo për të mbështetur ose financuar kryerjen e veprës, apo për të lehtësuar ndonjë

---

[144] Neni 1, i Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe lirive themelore e miratuar nga shtete anëtare të Këshillit të Evropës me datë 04.nëntor.1950.

[145] Neni 46 I Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 15.qershor.2008.

[146] Neni 19, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

veprim në kryerje të veprës (më konkretisht neni 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.38);

b) Dobi pasurore – është pasuria që është përfitim i drejtpërdrejt apo i tërthor nga vepra, qoftë ajo pasuri e ri investuar apo rifitimet nga ri investimi, çfarëdo përfitimi që rrjedhë nga pasuria e drejtpërdrejt apo e tërthortë dhe çfarëdo përparësie materiale që rrjedh nga ajo pasuri e fituar me vepër, apo kur pasuria e fituar me vepër penale është përzier me pasuri të ligjshme dobia pasurore që mund të konfiskohet shtrihet deri në masën e pasurisë së paligjshme apo më të ulët (më konkretisht neni 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.39);

c) Dhurata e njollosur – që nënkupton çdo pasuri e bartur kurdo (pasi që i pandehuri është dënuar) te pala e tretë me kundër shpërblim që vlera nuk është dukshëm më e ulët se çmimi i tregut, apo pasuria e bartur te pala e tretë pavarësisht çmimit kur pala e tretë ka ditur ose është dashur të dyshonte se pasuria ishte mjet apo dobi e veprës penale, apo që e ka ditur apo është dashur të dyshonte se bartja e pasurisë kishte qëllim në shmangien e konfiskimit (më konkretisht neni 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.40).

Gjithnjë, prokurori për të sekuestruar pasurinë, e cilësdo nga kategoritë e lartë theksuara ka për detyrim që të argumentoj, se ka prova për dyshimin e bazuar, që pasuria ndërlidhet me ndonjërën nga kategoritë e pasurisë së specifikuar.

2. Bazat për sekuestrim

Kodi i procedurës penale, ka paraparë tri baza për sekuestrimin e pasurisë varësisht nga aspekti ligjor që rregullohet në raport me veprimet procedurale. Më konkretisht bazat procedurale për sekuestrimin e pasurisë që njihen sipas kodit të procedurës penale:

1. Sekuestrimi i pasurisë sipas urdhrit të Gjykatës për bastisje – kjo formë e sekuestrimit të pasurisë bëhet me rastin e bastisjes që urdhërohet, dhe me rastin e bastisjes në urdhër gjyqësor specifikohen sendet që i nënshtrohen sekuestrimit.

2. Sekuestrimi i pasurisë pa urdhër gjyqësore – kjo bazë e sekuestrimit vije në shprehje kur me rastin e zbatimit të urdhër kontrollit përveç se sekuestrohen sendet – pasuria që kërkohet sipas urdhrit me rastin e tillë, haset në pasuri që nuk është e përcaktuar në urdhër por, ajo mund të i jetë nënshtruar automatikisht konfiskimit, apo ajo pasuri bënë pjesë në pasurinë e kategorive të specifikuara por nuk ndërlidhet drejtpërdrejt me veprën penale për të cilën zbatohet urdhër kontrolli por ndërlidhet me ndonjë vepër tjetër penale (te këto raste kryesisht kemi të bëjmë me pasuri që kategorizohet si mjete që përdoren në kryerjen e veprës penale apo si pasuri që është dobi e veprës penale).

3. Pasuria që identifikohet gjatë zbatimit të hetimeve – kjo pasuri mund të jetë cilado kategori e pasurisë së specifikuar që prokurori gjatë fazës së hetimeve siguron prova për pasurinë e tillë dhe e njëjta evidentohet qoftë si mjet, qoftë si dobi nga vepra penale apo dhuratë e njollosur, për të cilën mund të veproj për sekuestrimin e të njëjtës.

2.1. Sekuestrimi i provave dhe pasurisë me rastin e bastisjes sipas urdhrit gjyqësor

Për tu sekuestruar pasuria qoftë si provë apo si pasuri e specifikuar me rastin e bastisjes, duhet që veprimi i tillë të bëhet vetëm me urdhrin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, i cili urdhër lëshohet sipas kërkesës së parashtruar nga Prokurori.

Në kuadër të kërkesës për bastisje, prokurori duhet të arsyetoj përveç ekzistimit të dyshimit të bazuar edhe rrethanat që tregojnë se nga bastisja do të rezultojë në zbulimin e provave që propozohen për tu sekuestruar apo në pasurinë e specifikuar që mund ti nënshtrohet sekuestrimit.

Ndërsa në urdhër gjyqësor për bastisje, Gjykata duhet të saktësoj përshkrimin e provave apo të pasurisë së specifikuar që kërkohet me rastin e kontrollit. Kur zbatohet urdhri për bastisje të gjitha provat apo pasuria e specifikuar që përshkruhet në urdhër i nënshtrohet sekuestrimit.

Veprimet e mëtejme pasi që të gjinden provat apo pasuria e specifikuar, i ndërmerr prokurori lidhur me zbatimin e sekuestrimit. Më konkretisht nga momenti i përfundimit të kontrollit, policia detyrohet që në afat prej 48 (katërdhjetë e tetë) orëve, ta njoftoj prokurorin për çdo provë dhe pasuri të specifikuar që është gjetur.

Prokurori brenda afatit 7 ditor nga koha kur pranon njoftimin e policisë për provat dhe pasurinë e specifikuar, duhet të paraqes kërkesë pranë gjykatës për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar.

Sipas kësaj baze ligjore që rregullohet me nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale[147], duhet të kemi parasysh se është karakteristikë se Prokurori nuk lëshon urdhër të përkohshëm për sekuestrim. Kjo është e arsyeshme pasi që provat apo pasuria sipas kësaj baze ligjore sekuestrohet sipas urdhrit të Gjykatës që është lëshuar për bastisje, në të cilin urdhër përcaktohen edhe provat dhe pasuria që kërkohet për sekuestrim gjatë bastisjes.

Përveç sekuestrimit të provave dhe pasurisë që bëhet sipas bazës ligjore nga neni 103 përmes urdhrit që është lëshuar nga gjykata për bastisje në të cilin përshkruhen provat dhe pasuria që i nënshtrohet kontrollit, dispozitat nga neni 107 parashohin bazën e veçantë të sekuestrimit të provave apo pasurisë që mund të sekuestrohen edhe kur ato nuk janë të përshkruara në urdhrin për kontroll dhe sekuestrim[148].

Situata nga neni 107 rregullon zgjidhjen e sekuestrimit të provave apo pasurisë që mund t'i referohen veprës penale për të cilën është bërë kontrolli apo edhe ndonjë vepre penale tjetër. Këto prova apo pasuri që nuk janë përshkruar në urdhër kontroll mund të sekuestrohen duke qenë se mund të ketë situata të ndryshme praktike që mund të mos jenë në dijeni prokurori dhe policia por me rastin e zbatimit të kontrollit gjinden provat e tilla apo pasuria.

[147] Neni 103, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

[148] Neni 107, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

Për provat apo pasurinë që i nënshtrohet sekuestrimit të cilat nuk janë të përshkruara në urdhër për kontroll dhe sekuestrim, me atë rast policia lëshon vërtetim për sekuestrim të përkohshëm.
Pastaj policia menjëherë e jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i kontrollit e njofton me raport prokurorin për provat dhe sendet që janë sekuestruar të cilat nuk kanë qenë në urdhër për kontroll dhe sekuestrim që është lëshuar nga Gjykata.
Për provat dhe pasurinë e specifikuar që janë sekuestruar të cilat nuk janë të përshkruara në urdhrin gjyqësor, prokurori nga momenti i përfundimit të urdhër kontrollit duhet që brenda 72 orëve të kërkoj pranë gjykatës kontrollin dhe sekuestrimin e përkohshëm.
Nëse gjykata konfirmon në mënyrë retroaktive kontrollin dhe sekuestrimin e pasurisë që nuk kanë qenë të përshkruara në urdhrin për kontroll dhe sekuestrim (këtu bëhet fjalë për gjetjen e provave dhe të pasurisë shtesë që fillimisht nuk kanë qenë në urdhër të përshkruara nga gjykata për tu sekuestruar), atëherë Prokurori në afat prej 7 ditësh duhet të parashtroj pastaj kërkesë pranë gjykatës për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar.
Në praktikën Gjyqësore ka qenë një sfidë lidhur me afatin ligjor që e ka prokurori për të parashtruar kërkesë për konfirmim retroaktiv, duke qenë se paragrafi 2 dhe 3 i nenit 107, kanë një jo konsistencë, pasi që paragrafi 2 detyron policin *që pas përfundimit të kontrollit* në afat prej 48 orëve ta njoftoj prokurorin. Ndërsa paragrafi 3 ka paraparë që prokurori brenda 72 orëve *pas përfundimit të kontrollit,* duhet të parashtroj kërkesë për konfirmim retroaktiv. Dilemat rezultojnë se afati për paraqitjen e kërkesës a është 72 orë pas përfundimit të kontrollit (por duhet të kemi parasysh se janë 48 orë që policia i ka si afat për ta njoftuar prokurorinë), apo duhet interpretuar se afati i prokurorit është 72 orë nga momenti i pranimit të raportit policor në të cilën përshkruhen provat dhe pasuria e specifikuar që është sekuestruar.
Vlerësojmë se afati prej 72 orëve duhet të filloj të rrjedh nga momenti kur prokurori e pranon raportin policor dhe për këtë janë disa arsye:

1. Mund të ketë prova dhe pasuri të specifikuar që janë në sasi të mëdha;

2. Duhet të parashtrohet kërkesa dhe të arsyetohet se përse provat dhe pasuria e specifikuar duhet konfirmuar në mënyrë retroaktive nga gjykata,
3. Nuk cenon ndonjë të drejt të të dyshuarit apo personit të tretë, pasi që parashtrimet me kundërshtim mund të bëhen ndaj kërkesës për lëshimin e urdhrit përfundimtar dhe po ashtu mund të ankimohet urdhri përfundimtar nëse gjykata aprovon kërkesën e prokurorit.

2.2. Sekuestrimi i pasurisë pa urdhër gjyqësor

Përveç mundësisë së sekuestrimit të provave dhe pasurisë së specifikuar që nuk janë përshkruar në urdhrin që lëshohet për kontroll dhe sekuestrim nga Gjykata që rregullohet sipas nenit 107, Kodi parasheh mundësin e sekuestrimit dhe konfiskimit edhe pa urdhër gjyqësor, kjo situatë vije në shprehje kur kontrolli është bërë për shkaqe që lejohet ndërhyrja në raste të jashtëzakonshme e që rregullohen sipas nenit 108[149].
Në këtë rast kur kontrolli bëhet pa urdhër gjyqësor që parashihen shkaqet e ndërhyrjes për kontroll sipas nenit 108, nëse janë gjetur prova apo pasuri e specifikuar për një vepër penale policia duhet ti dërgoj raport prokurorit në afat prej 48 orëve, dhe prokurori brenda 72 orëve duhet të parashtroj kërkesë në gjykatë për konfirmim retroaktiv të kontrollit dhe sekuestrimit të pasurisë.
Nëse gjykata aprovonte kërkesën për konfirmim retroaktiv, prokurori në afat prej 7 ditësh pranë gjykatës kompetente, duhet të paraqes kërkesë për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar.

2.3. Sekuestrimi i pasurisë që identifikohet gjatë zbatimit të hetimit

Me rastin e zbatimit të hetimit prokuroria jo gjithnjë mund të gjej dhe identifikoj pasuritë e specifikuara vetëm përmes kontrollit që zbatohet, prandaj një ndër synimet e hetimit duhet të jetë edhe pasuria që është e specifikuar.

[149] Neni 108, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

Gjatë zbatimit të hetimit prokuroria duhet që, gjithnjë të vlerësoj aspektin e pasurisë së të dyshuarit, të bëjë vlerësime dhe analiza financiare mbi të ardhurat e ligjshme nga i dyshuari për pasuritë dhe të vlerësoj nëse ajo pasuri është krijuar nga të ardhurat që janë burime të ligjshme apo janë pasuri që është rrjedhojë e veprës penale për të cilën zhvillohen hetimet, për ta bërë këtë duhet të kihet parasysh se shpeshherë pasuritë e specifikuara fshihen nga ana e të dyshuarve, prandaj është e nevojshme, që të shikohen gjithnjë të dhënat nga kadastra për pronësitë (jo vetëm pronësitë aktuale por të shikohet historiati i pronësive të të dyshuarve kur ka pasur), pastaj të vlerësohen qarkullimet bankare dhe të analizohen ato se a janë qarkullime nga burimet e ligjshme apo të paligjshme apo janë të përziera, të merren informacione dhe ato të verifikohen nëse ka prona që nuk janë të evidentuara fare në librat pronësore, (duke qenë se ka shumë ndërtime që ende nuk janë të regjistruara titujt pronësor), më konkretisht hetimi për sa i përket pasurisë duhet të jetë i thellë nga ana e prokurorisë që ajo pasuri të mund të ndërlidhet, me veprën apo veprat penale për të cilat dyshohet se i pandehuri i ka kryer.

Në çdo rrethanë që prokuroria identifikon pasuri të specifikuar që nuk sekuestrohen sipas dispozitave që zbatohet kontrolli (ku me rastin e kontrollit sekuestrohet pasuria e specifikuar), në ato raste prokuroria duhet që të lëshoj urdhër ndalues të përkohshëm për sekuestrim, kjo bazë ligjore është e rregulluar sipas nenit 110 paragrafi 2 i Kodit të procedurës Penale[150].

Provat dhe pasuria e sekuestruar përmes identifikimit që bëhet gjatë zbatimit të hetimit, dhe kur lëshohet urdhri i përkohshëm për sekuestrim nga prokurori, ato duhet të evidentohen saktësisht në urdhër, dhe ai urdhër i lëshuar nga prokurori ka afat 7 ditor në të cilin urdhër përcaktohet se pasuria e specifikuar e sekuestruar duhet të ekzekutohet nga policia. Më konkretisht kushtet ligjore nga neni 260 duhet të përmbushen në kuptim të asaj se çfarë duhet të përmbaj urdhri i përkohshëm për sekuestrim që lëshohet nga prokurori.

[150] Neni 101, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

Më konkretisht dispozita nga neni 278[151] ka përcaktuar se prokurori mund të bëjë hetim për konfiskim, që nuk kufizohet vetëm në një fazë të procedurës penale, që do të thotë se kodi i procedurës penale i mundëson hetimin për konfiskim prokurorit në:

a). Në çdo fazë të hetimit penal;

b). Pas ngritjes së akuzës;

c). Para shqyrtimit gjyqësor;

ç). Gjatë shqyrtimit gjyqësor;

d). Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Sipas nenit 110, kur pasuria gjendet te personi apo organi i caktuar, e cila pasuri është e specifikuar për sekuestrim që është identifikuar, për të cilën prokurori ka lëshuar urdhër të përkohshëm ndalues, dhe për të cilën i ka parashtruar kërkesë gjykatës për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar, në raste të tilla nëse personi nuk e dorëzon atë pasuri te zyrtari i autorizuar i policisë, ai person apo organ mund t'i nënshtrohet ndjekjes penale për pengim të provuarit dhe po ashtu mund të gjobitet deri në 50% të vlerës së pasurisë së specifikuar. Kundër vendimit për shqiptimin e gjobës mund të parashtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, mirëpo gjoba mund të shmanget nëse dorëzohet pasuria në afat prej 7 ditësh nga dita kur vendimi për shqiptimin e gjobës merr formën e prerë.

2.3.1. Sendet që nuk mund të sekuestrohen përkohësisht

Për tu garantuar një proces i drejtë në përmbushje edhe të standardeve që parashihen me aktet ndërkombëtare, kodi i procedurës penale ka përcaktuar tri kategori të sendeve që nuk mund t'iu nënshtrohen sekuestrimit, më konkretisht në nenin 111 janë paraparë se cilat janë ato sende[152].

Sendet e tilla që nuk mund t'i nënshtrohen sekuestrimit, janë ekskluzivisht të ndërlidhura me dy kategori të dëshmitarëve, që janë:

[151] Neni 278, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

[152] Neni 111, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

a) Dëshmitarët e privilegjuar, dhe

b) Dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar.

Kategoritë që përjashtohen nga sekuestrimi janë:

a) Komunikimet me shkrim që janë bërë ndërmjet të pandehurit dhe personave që kategorizohen si dëshmitar të privilegjuar apo të liruar nga detyrimi për të dëshmuar;

b) Shënimet e dëshmitarëve të privilegjuar për informacionin e fshehtë që i pandehuri ua ka besuar atyre, dhe

c) Sendet tjera të mbrojtura me të drejtën e dëshmitarëve të privilegjuar apo dëshmitarëve të liruar.

Megjithatë ka përjashtim edhe në raport me sekuestrimin e pasurisë në raport me këto tri kategori të sendeve, pasi që paragrafi 2 i nenit 111, ka paraparë se nëse këta persona (dëshmitarët e privilegjuar dhe të liruar) ka mëdyshje se janë në çfarëdo forme si nxitës apo në bashkëpunim për pengim të drejtësisë apo pranim të mallrave të vjedhura, apo sendet janë marrë me vepër penale, janë përdorur apo kanë qëllim që të përdoren, në këto raste pasuria mund t'i nënshtrohet sekuestrimit të përkohshëm.

2.3.2. Urdhri për zbulimin e informacionit për hetimin për sekuestrim

Me qëllim që ti mundësohet prokurorit hetimi i plotë dhe gjithëpërfshirës për qëllim të sekuestrimit dispozitat ligjore kanë mundësuar që ndaj personave të mund të urdhërohet zbulimi i informacionit si veprime hetimore për sekuestrim.

Prokurori mund të parashtroj kërkesë pranë Gjyqtarit për të lëshuar urdhër ndaj cilitdo person për qëllim të dhënies së informatave lidhur me pasurinë e specifikuar në çështjen penale që zbatohet hetimi për sekuestrim.

Urdhri për zbulim të informacionit[153] duhet të konstatoj se, informacioni është relevant, dhe po ashtu duhet të ketë dyshim të arsyeshëm se personi ndaj të cilit lëshohet urdhri ka informacionin e tillë.

---

[153] Neni 279, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

Urdhri përfshinë çështje si:

a) Dhënie të përgjigjeve qoftë menjëherë apo në kohë të caktuar për aspektet e pasurisë së specifikuar që është duke u zhvilluar hetimi,
b) Dhënien me shkrim të informacionit lidhur me pasurinë e specifikuar që është duke u zhvilluar hetimi, dhe
c) Të siguroj dokumente ose përshkrimin e specifikuar të dokumenteve ose dhënie të informacioneve për një kohë të specifikuar apo informacionet të jepen në mënyrën specifike që përcaktohen në urdhër.

Urdhri për zbulimin e informacionit, nuk mund të përfshijë dhënien e përgjigjeve për informacionet e privilegjuara apo të dhënave të privilegjuara, përveç se një avokatit mund t'i kërkohet dhënia e emrit dhe adresa e klientit të tij. Kur sigurohen dokumente përmes urdhrit për zbulim të informacionit dhe kur prokurori ka bazë të arsyeshme për të besuar se ka rrezik që ato dokumente, në të ardhmen mund të jenë të padisponueshme për prokurorinë, ato mund të mbahen derisa të përfundoj procedura.

Kërkesa për urdhër për zbulim të informacionit, bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga prokurori te gjyqtari (pra këtu lejohet komunikimi shkresor - ex parte, dhe kërkesa nuk i njoftohet palëve tjera në procedurë), ajo bëhet me shkrim dhe pa seancë.

Vetëm urdhri për zbulim të informacionit i dërgohet të pandehurit dhe çdo subjekti ndaj të cilit është lëshuar urdhri. Prokurori ka të drejtë që të kërkoj anulimin apo ndryshimin e urdhrit për zbulim të informacionit, por këtë të drejt e kanë edhe personat që preken nga urdhri i tillë, dhe Gjyqtari mund ta ndryshoj apo ta anuloj urdhrin për zbulim të informacionit.

3. Urdhri i përkohshëm i ndalimit

Për qëllim të sigurimit të mëtejmë të pasurisë së sekuestruar nga prokurori, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale kanë paraparë se, prokurori mund të lëshoj urdhër të përkohshëm për ndalim, neni 260[154].

[154] Neni 260, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

Kushti ligjor për lëshimin e urdhrit të përkohshëm për ndalim, është ekzistimi i dyshimit të bazuar që pasuria e sekuestruar bie në kategoritë e pasurisë së specifikuar. Përmes urdhrit të përkohshëm të ndalimit, prokurori i ndalon çdo personi që ceket në urdhër që të ndërmerr ndonjë veprim në lidhje me pasurinë e specifikuar.

Se cilat janë detyrimet që prokurori mund të urdhëroj personat që iu adresohet urdhri, përcaktohen sipas dispozitës së nenit 260 paragrafi 2, i kodit të procedurës penale si:

1. Ndalimin që pasuria e specifikuar të;
    a) Shitet;
    b) Transferohet;
    c) Dhurohet;
    d) Zvogëlohet vlera e pasurisë;
    e) Tërhiqet nga llogaria bankare;
    f) Përdoren parat e përfituara nga qiraja që krijohet;
    g) Administrohet pasuria e specifikuar;
    h) Apo ndalimin e cilitdo veprim që ka ndikim negativ në ruajtjen e pasurisë së specifikuar.

Dispozita nga neni 260 paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale, përkundër se kanë numëruar taksativisht që mund të urdhëroj prokurori, kjo dispozitë përcakton se nuk është kufizuese vetëm në këto veprime, çka do të thotë se prokurori në kuadër të urdhrit mund të përcaktoj veprime ndaj personave që u adresohet urdhri, që ai vlerëson se përmes atyre veprimeve ruhet pasuria e sekuestruar e specifikuar, prandaj në çdo situatë prokurori duhet të ketë parasysh se cila është natyra e pasurisë së sekuestruar (cilat janë ato sende që e përbëjnë atë pasuri), dhe të caktoj veprime të tilla që janë të përshtatshme e që kanë ndikimin në ruajtjen e pasurisë së sekuestruar të specifikuar.

Përveç veprimeve që përcakton urdhri e që i detyron personat që u adresohet urdhri të veprojnë sipas asaj që kërkohet në urdhër, njëkohësisht urdhri i përkohshëm ndalues duhet që të përcaktoj;

a) Përshkrimin e pasurisë së specifikuar,
b) Përshkrimin e provave të artikulueshme që mbështesin ekzistimin e dyshimit të bazuar;
c) Nevojën e lëshimit të urdhrit të përkohshëm ndalues,

d) Urdhrin që i adresohet palës së caktuar dhe detyrimin që parashihet ndaj pasurisë së specifikuar që në afat prej 7 ditësh të mos ndërmarr asnjë veprim që është urdhëruar (afati rrjedh nga dita e lëshimit të urdhrit),
e) Specifikon të gjithë personat e njohur për prokurorin që mund të kenë interes në pasurin e specifikuar,
f) Përcaktohet koha e lëshimit dhe koha kur skadon urdhri i përkohshëm i ndalimit.

Në raste se urdhri i përkohshëm i ndalimit i drejtohet një subjekti që detyrohet ta dorëzoj pasurin e caktuar, dhe nëse ai subjekt nuk e dorëzon brenda kohës që kërkohet te zyrtari i autorizuar i policisë, ndaj ati personi mund të filloj ndjekja penale për pengim të të provuarit dhe po ashtu mund të shqiptohet gjobë deri në 50% të vlerës së pasurisë së sekuestruar të specifikuar të cilën gjobë e shqipton Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas kërkesës së prokurorit. Nëse personi në afat prej 7 ditësh, pasi që vendimi për shqiptimin e gjobës merr formën e prerë, e dorëzon pasurin e kërkuar atëherë mund të shmanget gjoba duke u anuluar vendimi për shqiptimin e saj. Subjekti ka po ashtu të drejt të paraqes ankesë në afat prej 7 ditësh.

Urdhri ndalues ka afat 7 ditë, dhe prokurori mund të parashtroj kërkesë pranë gjyqtarit të procedurës paraprake për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar.

Megjithatë sipas nenit 260 paragrafi 11, prokurori i shtetit mund të mos kërkoj urdhër ndalues përfundimtar nëse vlerëson se pasuria e sekuestruar e specifikuar, hynë në kategorinë që do të jetë:

a) Si provë për të provuar aspekte faktike për veprën penale, apo
b) Ajo pasuri i nënshtrohet automatikisht konfiskimit që parashihen bazat nga neni 276,

Në këto dy situata pasuria e sekuestruar, mbetet në ruajtje qoftë të policisë dogane, apo institucioneve tjera ligj zbatuese që ndërlidhen me detyrimet e tyre ligjore. Në këtë situatë urdhri i përkohshëm ndalues është me efekt deri në përfundimin e procedurës penale që mund të vendos Gjykata sipas propozimit që është bërë në akuzë nga prokurori, në të kundërtën nëse procedura penale pushohet atëherë, gjykata duhet të vendos për sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit, ndërsa për sendet që janë prova në procedurën penale varësisht se a mund t'i kthehen palës që i janë

sekuestruar duhet t'i kthej prokurori, në të kundërtën nëse pasuria që është si provë hynë edhe në kategorinë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit edhe për ato vendos gjykata.
Kur urdhri i përkohshëm ndalues, përshkruan pasurinë që gjendet jashtë territorit të Kosovës, atëherë zbatimi i urdhrit të tillë i nënshtrohet procedurës për bashkëpunim juridik ndërkombëtar përmes Ministrisë së Drejtësisë në vendin ku gjendet pasuria.

3.1. Kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar dhe kundërshtimet e kërkesës

Prokurori pasi që të lëshoj urdhrin e përkohshëm ndalues i cili ka afat 7 ditë, mund të parashtroj kërkesë për urdhër ndalues përfundimtar e cila duhet të përmbaj:

a) Përshkrimin e provave që vërtetojnë dyshimin e bazuar;
b) Përshkrimin e arsyeshmërisë së domosdoshme për urdhër ndalues përfundimtar për tu treguar se pasuria e disponueshme duhet të ruhet për qëllim të konfiskimit, duke përfshirë arsyeshmërinë e humbjes së vlerës që i kanoset pasurisë, apo parandalimin e shpërndarjes së pasurisë së specifikuar;
c) Të dhënat e të gjithë personave që janë të njohur për prokurorin që mund të kenë interesa në pasurinë e specifikuar;
d) Masat e përkohshme që propozohen për pasurinë e specifikuar që përmes atyre masave sigurohet pasuria;
e) Kërkesës i bashkëngjitet urdhri i përkohshëm ndalues.

Kërkesa e tillë i dërgohet përveç të pandehurit edhe çdo personi të tretë që mund të ketë interesa në pasurinë e specifikuar që kërkohet lëshimi i urdhrit ndalues përfundimtar. Në raste të pamundësisë për t'iu dërguar kërkesa secilit person duhet të dëshmohen përpjekjet e arsyeshme që ka bërë prokurori për t'i njoftuar personat që ceken në kërkesë, se çfarë përfshihet në përpjekjet e arsyeshme, më konkretisht përcaktohet në kuadër të nenit 261 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale[155].

[155] Neni 261, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

3.2. Kundërshtimet ndaj kërkesës për urdhër ndalues përfundimtar

Me rastin e pranimit të kërkesës së urdhrit ndalues përfundimtar që prokurori ua dërgon të pandehurve dhe personave që kanë interes juridik mbi pasurinë e sekuestruar të specifikuar – personat e tretë, cilado nga këto palë kanë të drejt të paraqesin kundërshtime ndaj kërkesës së prokurorit me të cilën ka kërkuar urdhër ndalues përfundimtar, sipas nenit 263[156] të Kodit te Procedurës Penale.

Kundërshtimet mund të paraqiten në pretendimet si;

a) Pasuria e specifikuar nuk përfshihet në kërkesën për urdhër ndalues përfundimtar;
b) Pasuria nuk është pasuri e specifikuar;
c) Urdhri ndalues përfundimtar nuk është i domosdoshëm për ta ruajtur disponueshmërinë e pasurisë së specifikuar;

Kur sendi është në pronësi të palës së tretë dhe që nuk përbën dhuratë të njollosur, pala e tretë mund të parashtroj kundërshtimet në drejtim të bazave si:

a) Sendi është në pronësi të palës së tretë;
b) Pala e tretë nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se pasuria ishte mjet që kategorizohet si pasuri e specifikuar.

Për tu provuar cilado nga këto baza si nga i pandehuri apo personi i tretë, ata mund të dorëzojnë çfarëdo provë që vërtetojnë pretendimet e tyre lidhur me bazën e kundërshtimeve që parashtrohen në gjykatë.

Afati për parashtrimin e kundërshtimeve është 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës që prokurori ua dërgon palëve, rrjedhimisht Gjykata nuk mund të lëshohet në vendosjen e kërkesës së prokurorit pa kaluar afati që i takon të pandehurit dhe personave të tretë për ti parashtruar kundërshtimet, në të kundërtën vendosja e kërkesës pa kaluar afati dhe vendosja e kërkesës pa qenë të njoftuar i pandehuri dhe personat e tretë që kanë interes juridik në pasurinë e specifikuar, do të përbënte shkelje të dispozitave të kodit të procedurës penale.

---

[156] Neni 263, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

3.4. Nxjerrja dhe përmbajtja e urdhrit ndalues përfundimtar

Gjykata me rastin e pranimit të kërkesës së prokurorit për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar dhe kundërshtimeve të të pandehurit apo të personave të tretë, në raport me çdo pasuri të përshkruar në kërkesë që është pasuri e specifikuar lëshon urdhër ndalues përfundimtar, sipas nenit 264[157] te Kodit të procedurës Penale.

Për ta lëshuar urdhrin e tillë duhet që prokurori të provoj me prova, se pasuria është pasuri e specifikuar, dhe se për atë pasuri ka dyshim të bazuar se është pasuri e specifikuar, se ndalimi përfundimtar është i nevojshëm për tu ruajtur disponueshmëria apo mos humbja e vlerës.

Kur i pandehuri apo pala e tretë kanë sukses në kundërshtimet e tyre, atëherë gjykata ndaj asaj pasurie që janë parashtruar kundërshtimet nuk lëshon urdhër ndalues përfundimtar, dhe sendet e tilla ua kthen pronarëve.

Megjithatë nëse pasuria e tillë, shërben si provë apo përbëhet nga sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit, ajo pasuri i dërgohet policisë në ruajtje, deri në përfundim të procedurës penale, ku me përfundimin e procedurës penale ato mund të urdhërohen për tu asgjësuar.

Gjykata duhet të vendos për urdhër ndalues përfundimtar brenda afatit prej 30 ditësh, afati këtu fillon nga momenti i kalimit të afatit prej 15 ditëve që i pandehuri ose personat e tretë kanë mundësi që të parashtrojnë kundërshtimet ndaj kërkesës për urdhër ndalues përfundimtar. Urdhrin ndalues përfundimtar e ekzekuton agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Urdhri ndalues përfundimtar sipas nenit 265[158], duhet të përmbajë:

a) Përshkrimin e pasurisë që përfshinë urdhri;
b) Provat që vërtetojnë dyshimin e bazuar se pasuria është pasuri e specifikuar, dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së pasurisë;
c) Përcaktimin e veprimit që i adresohet pranuesit që duhet të veproj sipas urdhrit;

[157] Neni 264, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

[158] Neni 265, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

d) Përcaktimin e masës së përkohshme nëse janë propozuar në kërkesën për urdhrin ndalues përfundimtar;
e) Përcaktimin e personave që mund të kenë interes në atë pasuri të specifikuar;
f) Pjesën e refuzimit nëse ndonjë pjesë e pasurisë së specifikuar nuk është urdhëruar me ndalim përfundimtar.

Urdhri mund të përfshij pasuri të specifikuar qoftë brenda apo jashtë vendit, urdhri i dërgohet prokurorit dhe të pandehurit e palëve të treta. Kundër urdhrit ndalues përfundimtar mund të ushtrohet e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh.

3.5. Urdhri i përkohshëm ndalues për pasurinë shtesë të specifikuar

Kur zbatohet procedura penale në hetime për veprat penale, mund të ketë situatë që pasuria e specifikuar të gjendet shumë më vonë. Duke qenë se jo gjithnjë është e mundur në fazën e hershme të identifikohet edhe pasuria që mund t'i nënshtrohet sekuestrimit, dispozita nga neni 266[159] ka paraparë që për pasurinë e gjetur më vonë mund të lëshohet urdhër ndalues i përkohshëm për pasurinë shtesë të specifikuar.

Këto dispozita ligjore i japin autorizim prokurorit që në çdo fazë të procedurës penale, gjegjësisht derisa aktgjykimi të marr formën e prerë të vazhdoj hetimin lidhur me pasurinë që mund t'i nënshtrohet konfiskimit. Kurdo që prokurori identifikon pasuri të specifikuar mund të lëshoj urdhër ndalues të përkohshëm për pasuritë shtesë që janë gjetur. Në këto rrethana prokurori pasi që të lëshoj urdhrin e përkohshëm ndalues për pasurin shtesë të identifikuar, atëherë zbaton dispozitat ku i drejtohet gjykatës për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar.

Dispozita nga neni 266, i mundësojnë prokurorit që edhe pasi që të marr formën e prerë aktgjykimi të vazhdoj hetimin lidhur me pasuritë që mund t'i nënshtrohet konfiskimit, dhe kur gjinden pasuri shtesë edhe pasi që aktgjykimi ka marr formën e prerë mund të lëshoj urdhër ndalues të përkohshëm për pasuritë e identifikuara që janë pasuri e specifikuar. Në

[159] Neni 266, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

këtë situatë prokurori po ashtu parashtron kërkesë nga dispozita e nenit 275, për konfiskimin e pasurive shtesë.
Në raste se gjendet pasuri shtesë para se aktgjykimi të marr formën e prerë, dhe kur prokurori ka lëshuar urdhër ndalues të përkohshëm për pasurinë shtesë, kur parashtrohet kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar, Gjykata zbaton procedurën për lëshimin e urdhrit ndalues përfundimtar që rregullohet nga neni 264 dhe 265 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

4. Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar

Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar qe parashihen ne nenin 262[160] te Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kanë një qëllim që pasuria të; ruhet, të mos i humb vlera e tregut, të mos krijoj shpenzime për mirëmbajtjen e saj.
Duhet të kemi parasysh se dispozitat e kodit të procedurës penale edhe pse numërojnë disa lloje të masave të sigurisë ato nuk janë të kushtëzuara, çka do të thotë se prokurorit i lejohet që të propozoj çfarëdo veprimi që është i përshtatshëm si masë e sigurisë për pasurinë. Varësisht se a kemi qëllimin e sigurimit të pasurisë, të shmangies së shpenzimeve për mirëmbajtjen apo për ruajtjen e vlerës, ato ndahen në:

1. Masat për sigurimin e pasurisë që kanë si qëllim ruajtjen e pasurisë janë:

a) Mbajtja e pasurisë në kasafortë;
b) Mbajtja e pasurisë në depo të sigurt;
c) Mbajtja e pasurisë te administruesi;
d) Mbajtja e mjeteve monetare në llogari bankare;
e) Shitja apo tjetërsimi i pasurisë;
f) Hapa të arsyeshëm në mbajtjen apo zvogëlimin e vlerës së pasurisë.

[160] Neni 262, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

2. Masat për shmangien e shpenzimeve të larta për mirëmbajtje janë:

a) Shitja e pasurisë sipas çmimit të tregut;
b) Therjen apo shitjen e bagëtisë;
c) Procesimin e të korrave apo materiale në produkte përfundimtare.

3. Masat për sigurimin e pasurisë që humb vlerën apo që janë të zëvendësueshme janë:

a) Shitjen e pasurisë për çmimin e tregut;
b) Përzierjen e pasurisë së saktësuar;
c) Procesimin e të korrave apo materialeve në produkte përfundimtare.

Karakteristikë është se praktika gjyqësore shpesh hasë në probleme nëse, prokurori ka propozuar një mase të caktuar për sigurimin e pasurisë, a mundet gjykata që të vlerësoj se një masë tjetër është më adekuate për sigurimin e asaj pasurie, ashtu që të vendos për një masë tjetër nga ajo që është propozuar. Vlerësojmë se Gjykata gjithnjë kur konsideron se edhe me ndonjë masë që cenon më pak të drejtat e të pandehurit apo të personave të tretë, mund të caktoj përkundër se prokurori ka propozuar një masë tjetër. P.sh. Nëse gjykata vlerëson se dërgimi i pasurisë në depo për ruajtje është më e balancuar dhe arrihet qëllimi i ruajtjes së pasurisë, në raport me masën që e ka propozuar prokurori, procesimin e të korrave apo materiale në produkte përfundimtare. Gjykata në këto raste duhet të ketë parasysh disa faktorë që janë:

a) Përveç masës që është propozuar nga prokurori a ka ndonjë masë më të balancuar dhe me ndikim më të vogël në të drejtat e të pandehurit dhe të personave të tretë;
b) Ajo masë tjetër që ndikon më pak në të drejtat e të pandehurit dhe personave të tretë a arrin që të jetë e efektshme për ruajtjen e pasurisë;
c) Masa tjetër që e vlerëson gjykata a e ndikon edhe uljen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe administrim të pasurisë;
d) Masa tjetër a e bënë të ruaj vlerën e vet pasuria apo ka rrezik që të ulet vlera e pasurisë për shkak të masës tjetër nga ajo që është propozuar nga prokurori.

Nga praktika gjyqësore, është vërejtur se masat që janë propozuar te caktohen, nuk ka një qasje unike për natyrën e vendimmarrjes edhe në kushte dhe rrethana të ngjashme. Janë ngritur probleme të shumta kur disa gjykata nuk lejojnë shitjen e sendeve të sekuestruara, me arsye se sendet e sekuestruara janë pronë dhe e drejta e pronës mbrohet me akte ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Kosovës.

Praktika e tillë jo vetëm se ka krijuar një trajtim të pabarabartë të qytetareve para ligjit, kur në një rajon janë lejuar nga gjykata shitja e sendeve të sekuestruara, ndërsa në një rajon janë refuzuar propozimet, por njëkohësisht ka ndikuar që të pamundësohet ruajtja e vlerës së tregut për sendet e tilla, kur dihet dhe janë të njohura rrethanat, se për shkak të zhvillimeve ekonomike ato sende e humbin shpejt vlerën e tyre në treg, (rastet e njohura të pasurive të sekuestruara - automjeteve që administrohen nga Agjencinë për Administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, ku janë prezantuar të dhënat se ka raste kur vlera e sendit është zhvlerësuar deri ne 70% si pasoj e kalimit të kohës dhe amortizimit).

Gjykata duhet të lejojnë masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, sepse përveç që ruhet vlera e sendeve kur propozohet marrja e ndonjë mase, njëkohësisht dëmi eventual që mund ti shkaktohet cilësdo palë në procedure ne mënyrë të veçantë të pandehurit dhe personave të tret është dukshëm me i vogël se sa mbajtja e sendit të tillë dhe vazhdimi i lejimit të zhvlerësimit të pasurisë së tillë për shkak të amortizimit dhe kalimit të kohës do të ishte një cenim i te drejtave ndaj palëve që kanë interes në atë pasuri. Në anën tjetër, shitja e pasurisë apo shqiptimi i ndonjë mase tjetër që kontribuon dhe parandalon dëmin është më rëndësi sepse parandalohen mundësit e zhvlerësimit të asaj pasurie, e kundërta e kësaj për shkak të mos caktimit të masave barra është e sistemit gjyqësor për shkak të kohëzgjatjes se procedimit. Poashtu përmes masave për sigurimin e pasurisë nuk cenohet e drejta e pronësisë duke qenë se ka një standard mbi të cilin është sekuestruar ajo pasuri dhe standardi është ekzistimi i dyshimit të bazuar, rrjedhimisht kur ka dyshim të bazuar atëherë sekuestrohet pasuria, dhe për qellim të ruajtjes dhe sigurimit të asaj pasurie janë paraparë edhe masat e tilla sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

5. Konfiskimi

Konfiskimi i pasurisë do të thotë marrjen e pasurisë ndaj të pandehurit apo personave të tretë të pasurisë së specifikuar. Për të urdhëruar gjykata konfiskimin e pasurisë, prokurori duhet që në shqyrtim gjyqësor të provoj me prova se pasuria që është e sekuestruar duhet të konfiskohet pasi që ajo është pasuri e specifikuar që bënë pjesë në cilëndo nga kategoritë e parapara në nenin 19 të Kodit të Procedurës Penale.

Mund të ketë situata kur pasuria e specifikuar përkundër se është e identifikuar nuk mund të i jetë nënshtruar sekuestrimit për shkak se sendet e tilla tanimë nuk gjinden te i pandehuri apo të personi i tretë, pra pasuria e tillë ka vazhduar të transferohet apo për çfarëdo arsye nuk është e disponueshme, në këtë situatë dispozita nga neni 273 e kodit të procedurës penale, ka përcaktuar " Zëvendësimin e vlerës së pasurisë"[161].

Në çdo rast që pasuria nuk është e disponueshme por që vërtetohet se ajo pasuri është dobi pasurore e veprës penale apo dhuratë e njollosur dhe ka kaluar te personat e tretë por që as te këta persona, atëherë gjykata mund të konfiskoj pasuri të të pandehurit deri në vlerën e pasurisë së specifikuar që nuk është e disponueshme, gjykata mund të urdhëroj konfiskimin e pasurisë tjetër të zëvendësuar edhe të palës së tretë kur pala e tretë ka pranuar dhuratën e njollosur dhe tani ajo pasuri nuk është në disponim të palës së tretë.

Me rastin e propozimit për konfiskimin e pasurisë së vlerës së zëvendësuar prokurori duhet të paraqes pasurinë e të pandehurit apo të palës së tretë që është në disponim të tyre e që mund të urdhërohet konfiskimi i saj. Pasuria e tillë mund të jetë qoftë me origjinë ligjore apo me origjinë të paligjshme që gjykata mund të urdhëroj konfiskimin.

Gjykata mund të njoftoj të pandehurin apo palën e tretë se do të konfiskohet pasuria e tyre si vlerë e zëvendësuar, në këtë rrethanë qoftë i pandehuri apo pala e tretë munden që t'i kërkojnë gjykatës pagesën e shumës për pasurinë e tillë, dhe në këtë situatë pasuria që do ta zëvendësonte vlerën nuk do të konfiskohet, duke qenë se vlera e pagesës

[161] Neni 273, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

që përcakton gjykata përmbush vlerën e pasurisë që nuk është e disponueshme e që vërtetohet se ka qenë dobi pasurie nga vepra penale apo dhuratë e njollosur.

5.1. Procedura për konfiskim

Procedura për konfiskimin e pasurisë zbatohet në kuadër të shqyrtimit gjyqësor në të cilin vendos edhe akuza. Në shqyrtim gjyqësor prokurori, i pandehuri – mbrojtja si dhe pala e tretë, mund të:

a) Paraqesin prova në shqyrtim gjyqësor,
b) Propozojnë dëgjim të dëshmitarëve për të argumentuar pretendimet e tyre lidhur me kërkesat që i kanë në raport me pasurinë që propozohet për konfiskim,
c) Paraqesin prova – ekspertiza dhe dëgjim të ekspertëve financiar për të argumentuar pretendimet e tyre lidhur me kërkesat që janë të drejtuara ndaj pasurisë që propozohet për konfiskim.
d) Gjykata mund të angazhoj ekspert për të vërtetuar ndonjë aspekt faktik që ndërlidhet me pasurinë e specifikuar që propozuar për konfiskim.

Pasi që të përfundoj shqyrtimi gjyqësor gjykata duhet të përfshij në aktgjykim vendimin lidhur me konfiskimin e pasurisë që është propozuar në aktakuzë, apo vendimin lidhur me refuzimin e pasurisë që është propozuar në aktakuzë për konfiskim.

Aktgjykimi po ashtu sipas nenit 369 paragrafi 8 dhe 9 dhe neni 274 paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale, duhet të përmbaj arsyetim lidhur me çdo pasuri që është vendosur se duhet të konfiskohet, duke përfshirë arsyet se në cilën kategori të pasurisë së specifikuar bënë pjesë ajo pasuri si është provuar se pasuria është pasuri e specifikuar e asaj kategorie, po ashtu duhet të përfshij arsyet se përse pretendimet e të pandehurit dhe personave të tretë nuk janë të bazuara cilat janë provat që rrëzojnë pretendimet e të pandehurit dhe personave të tretë duke dhënë arsye edhe për besueshmërinë e provave në raport me pasurinë si për provat që kane vërtetuar se pasuria e specifikuar duhet të konfiskohet e po ashtu dhe për provat që janë paraqitur nga i pandehuri dhe personat e

tretë përse nuk kanë vërtetuar ato pretendime dhe përse gjykata nuk ua ka falur besimin atyre provave.

5.2. Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit

Dispozitat e kodit të procedurës penale kanë përcaktuar disa kategori të pasurisë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit. Më konkretisht dispozita ligjore nga neni 276 që përcakton kushtet ligjore për konfiskimin automatik të pasurisë[162], është dispozita më e ashpër për disa arsye.

Sipas nenit 276 njihen dy kategori të pasurisë që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit e qe janë:

a) Pasuria qenësisht e rrezikshme; dhe
b) Pasuria e paligjshme.

Cilado pasuri që konsiderohet e tillë i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, që do të thotë se ligjdhënësi këtu ka përcaktuar shmangie të tërësishme të konstatimit të fajësisë dhe për shkak se ajo pasuri bie në ndonjërën nga këto kategori, konfiskohet në mënyrë automatike.

Më konkretisht, dispozitat përcaktojnë se pavarësisht fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit që mund të rezultojë në procedurën penale, kur pasuria është pjesë e ndonjërës nga këto kategori atëherë, ajo konfiskohet në mënyrë automatike edhe nëse prokurori ka ndërmarr apo nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për konfiskimin.

Neni 276 në paragrafin 2 ka përcaktuar se cila pasuri konsiderohet si qenësisht e rrezikshme e që janë;

a) Armët që janë krijuar apo përdorur në kryerjen e veprës penale;
b) Kimikatet, substancat, apo armët që janë përdorur në veprën penale;
c) Kimikatet apo substancat që janë krijuar në veprat penale;
d) Kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat që janë krijuar apo përdorur në veprat penale;
e) Parat apo sendet e falsifikuara apo të përdorura në veprat penale;

[162] Neni 276, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka hyrë në fuqi me datë 14.shkurt.2023

f) Sendet që janë jashtë qarkullimit apo sendet që sipas ligjit nuk mund të jenë në qarkullim.

Karakteristikë e kësaj dispozite është se Gjyqtari qoftë sipas detyrës zyrtare apo sipas propozimit të prokurorit në cilëndo fazë mund të lëshoj vendim për konfiskim. Ndërsa dispozita ligjore nga neni 276 paragrafi 1, parasheh një specifik shumë domethënëse ligjore, që përcakton se, i pandehuri, shfrytëzuesi apo poseduesi i kësaj pasurie nuk kanë të drejtë ankese.

Vlerësojmë se kjo është e arsyeshme mohimi i të drejtës së ankesës, duke pasur parasysh se pasuria e tillë " qenësisht e rrezikshme" duhet të veprohet urgjent ndaj saj dhe rrjedhimisht për këtë arsye edhe i mundësohet gjyqtarit që edhe sipas detyrës zyrtare të konfiskoj atë pasuri në mënyrë që të menaxhohet me të deri në eliminimin e rrezikut qoftë edhe duke e shkatërruar, andaj janë veprimet e tilla të natyrës urgjente që diktojnë procedurë efikase dhe të shpejt për të shmangur çfarëdo pasoje eventuale ndaj shoqërisë në mënyrë më të zgjeruar (sepse mund të ketë p.sh material radioaktiv) gjë që për pasurinë e tillë nuk mundet të pritet zbatimi i tillë i procedurës së rregullt. Megjithatë të pandehurit shfrytëzuesit apo poseduesit, nuk i mohohet e drejta që të parashtroj ankimin ndaj vendimit për konfiskim që paraqitet ankesa ndaj vendimit meritor të çështjes pra ndaj aktgjykimit aty palët kanë të drejtë të pretendojnë edhe në shkelje nëse vlerësojnë se u është cenuar ndonjë e drejtë si pasoj e vendimit për konfiskim që është marr në fazë më të hershme të procedurës para se të përfundoj shqyrtimi gjyqësor.

Mund të ketë situata që pasuria edhe pse është qenësisht e rrezikshme të jetë e nevojshme për tu përdorur si provë, në këtë kuptim dispozita nga neni 276 paragrafi 4 ka paraparë se në ato rrethana sendet e tilla, sigurohen duke u zhvilluar fotografi, teste dhe ekspertiza që mund të shërbejnë si provë ndërsa sendet që konfiskohen shkatërrohen.

Ndërsa është karakteristikë se po sipas kësaj nuk kërkohet që sendet që janë të kundërligjshme sipas paragrafit 2 nën paragrafi 2.6 të shkatërrohen, në këto situata kur sendet janë qenësisht të rrezikshme por janë të kundërligjshme ato mund të konfiskohen automatikisht, por mund të mos jetë e nevojshme shkatërrimi, nga se mund të përdoren për qëllime të përgjithshme apo edhe mundë të mbeten në ruajtje të organeve ligj zbatuese (dogana policia etj.), nëse është e nevojshme që të shfrytëzohen

si provë për të provuar gjendje faktike e si përfundim edhe të shiten apo të përdoren nga institucionet publike.

5.3. Sfidat praktike në raport me sekuestrimin dhe konfiskimin

Në praktikën gjyqësore janë krijuar disa probleme praktike duke u zbatuar në mënyrë jo konsistente dispozitat ligjore, kjo mungesë e harmonisë praktike është shkaktuar edhe për arsyen e hyrjes në fuqi të dispozitave të kodit të procedurës penale në vitin 2023, që ka ndikuar në një praktikë unike në zbatim për sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit. Si çështje që janë shfaqur si sfiduese në praktikën gjyqësore janë çështjet si:

a) Sendet që gjinden në vendin e ngjarjes që përbëjnë sende në kryerje të veprës penale a duhet zbatuar procedura e sekuestrimit apo ato duhet të mbahen nga prokurori dhe policia si qëllim i provës në procedurë, dhe si mund të i nënshtrohen konfiskimit ato sende?
b) Çka konsiderohet send jashtë qarkullimit apo send që sipas ligjit nuk mund të jenë në qarkullim – duke qenë se këto sende i nënshtrohen automatikisht konfiskimit në të kundërtën a duhet të zbatohet procedura e sekuestrimit?
c) Sendet që kanë shërbyer si mjet në kryerjen e veprës penale por që nga natyra e tyre nuk janë sende jashtë qarkullimit apo në kundërshtim me ligjin por që shërbejnë edhe si provë, a duhet sendet e tilla që t'i nënshtrohen sekuestrimit apo duhet që të mbahen vetëm si provë dhe pastaj t'i nënshtrohen konfiskimit?

Për sa i përket sfidës së parë – duhet gjithnjë të bëhet një dallim se sendet që gjinden në vendin e ngjarjes apo në bastisje, a përbëjnë sende qenësisht të rrezikshme që janë përdorur apo kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale që përcaktohen sipas nenit 276. Nëse sendet e tilla hyjnë në cilëndo kategori të ndonjë vepre penale që parashihet sipas nenit 276, për ato sende nuk është e nevojshme që të ndiqet zbatimi i procedurës së sekuestrimit fare, pasi që të këto sende vet ligjdhënësi në nenin 276 ka paraparë se ato detyrimisht në mënyrë automatike konfiskohen madje edhe nëse prokurori nuk ka marr asnjë veprim procedural për qëllim të

konfiskimit. Në këtë kontekst, kur kemi të bëjmë p.sh, me armë, thika, narkotik, substanca kimike apo çfarëdo sendi tjetër që përcaktohet sipas nenit 276, është e mjaftueshme që të merret nga policia dhe të privohet cilido person që ta disponoj atë send, dhe në ato rrethana prokurori mund t'i propozoj gjykatës që të lëshoj vendim për konfiskimin e sendit të tillë, njëkohësisht nëse i shërben si provë sendi i tillë prokurori varësisht se a ka kompetencë për të urdhëruar ekzaminimet apo ka kompetencë vetëm gjykata mund të urdhëroj apo të propozoj ekspertizë për sendin apo materien e tillë, në mënyrë që të marr të dhënat e sendit për shërbim të të provuarit të fakteve në procedurë, dhe sendi i tillë shkatërrohet, posa të sigurohet ekspertiza, procesverbali që mbahet apo fotografitë varësisht nga natyra e sendit që është konfiskuar.

Sa i përket sfidës së dytë – duhet të kemi parasysh se sendet jashtë qarkullimit janë sende që nuk lejohen t'i nënshtrohen raporteve juridikore civile, pra janë sende që nuk lejohen në asnjë mënyrë që të jenë në qarkullim apo transaksione. Ndërsa sendet që sipas ligjit nuk mund të jenë në qarkullim përbëhen ato sende që janë me qarkullim të kufizuar apo të mbikëqyrur, pra sendet e tilla janë që kanë paraprakisht përmbushjen e kushteve si marrja e licencave për tu mundësuar që sendet e tilla të lejohen për tu qarkulluar, ndërsa përveç licencave duhen edhe mbikëqyrje dhe përmbushje e procedurave të caktuara ligjore për tu konsideruara se janë në qarkullim.

Në këtë kuptim, ka shumë sende që sipas dispozitave ligjore të Kodit Penal përcaktohen se sendet e tilla konfiskohen, edhe pse nuk janë ato dispozita që përcaktuara në nenin 276 ku parashihet konfiskimi automatik.

Më konkretisht, të marrim shembull veprën penale nga neni 300 prodhimi i ndaluar, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se: "mallrat dhe pajisjet për prodhimin ose përpunimin e mallrave konfiskohen", sendet e tilla do të thotë se janë me qarkullim të kufizuar, pasi që për të prodhuar mallra duhen licenca për një subjekt nga disa fusha, e përveç licencave bëhet edhe mbikëqyrje e zbatimit rigoroz të atyre licencave, rrjedhimisht mallrat që prodhohen në kundërshtim me ligjin përbëjnë vepër penale, e pikërisht që janë në kundërshtim me ligjin ato nuk mund të jenë në qarkullim, në këto rrethana sendet që parashihen sipas si pozitave materiale në kuadër të veprës penale nuk duhet t'i nënshtrohen

procedurës së sekuestrimit duke qenë se ato kategorizohen në kuadër të nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6, si sende jashtë qarkullimit apo sende që sipas ligjit nuk mund të jenë në qarkullim, andaj sendet e tilla i nënshtrohen automatikisht konfiskimit.
Në këtë këndvështrim çdo send që dispozita materiale ka paraparë se sendet e tilla konfiskohen (që për nga natyra e tyre nuk janë sende qenësisht të rrezikshme) por janë sendet jashtë qarkullimit apo sende që sipas ligjit nuk mund të jenë në qarkullim, nga fakti se dispozita materiale kërkon konfiskimin e tyre, ato duhet të trajtohen në kuadër të nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe t'i nënshtrohen konfiskimit automatik, çka nënkupton se nuk është e nevojshme që të zbatohen dispozitat për sekuestrimin e pasurisë siç janë urdhri i përkohshëm ndalues apo urdhri ndalues përfundimtar.
Megjithatë duhet të kihet kujdes pasi që sendet e tilla duhet detyrimisht të jenë pjesë e ndonjërës nga kategoritë e pasurisë së specifikuar, dhe vetëm nëse ka dyshim të bazuar dhe pasuria është e ndërlidhur me ndonjërën nga kategoritë e pasurisë së specifikuar e posaçërisht është, mjet që ka shërbyer apo ka mundësuar kryerjen e veprës penale apo është dobi pasurore e veprës penale dhe kur dispozita materiale e parasheh se sendet e tilla konfiskohen, atëherë ato duhet të trajtohen sipas nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Kodit të Procedurës Penale dhe ato sende duhet t'i nënshtrohen automatikisht konfiskimit.
Nëse sendet e tilla nuk janë qenësisht të rrezikshme dhe mund të shërbejnë edhe si provë, atëherë prokurori mundet që sendet e tilla t'i trajtoj sipas nenit 260 paragrafi 11 nën paragrafi 11. 1 dhe 11.2 i Kodit të procedurës penale të Kosovës.
Sa i përket sfidës së tretë – kur sendet kanë shërbyer në kryerjen e veprës penale por që ato nuk janë qenësisht të rrezikshme dhe po ashtu mund të shërbejnë si provë, situatat e tilla duhet të kemi parasysh se a ka qëllim konfiskimin e këtyre sendeve apo kanë vetëm qëllim mbajtjen si provë. Gjithnjë nëse ka qëllim konfiskimin e sendeve të tilla që kanë shërbyer në kryerjen e veprës penale dhe që për nga natyra nuk janë të rrezikshme, por që njëkohësisht mund të shërbejnë si provë, në këto situata duhet ndjekur zbatimi i dispozitave për sekuestrimin në mënyrë që sendet e tilla të sigurohen në procedurë të ligjshme dhe njëkohësisht për të shmangur cenimin e të drejtave të të pandehurit apo cilitdo person.

Situata e tillë do të ishte, kur kryhet vepra penale e shantazhit nga neni 329, i Kodit Penal të Kosovës, dhe që telefoni shërben për kryerjen e veprimit penal, në këto rrethana kur prokurori ka si qëllim që të konfiskoj këtë send, sepse ka shërbyer si send në kryerjen e veprës penale, atëherë duhet ndjekur procedura penale që rregullohet sekuestrimi e deri në fazën e konfiskimit çka do të thotë se prokurori duhet të zbatoj me përpikëri dispozitat për garancionet procedurale ndaj të pandehurit edhe lidhur me pasurinë.

Ndërsa kur në rrethana të tilla telefoni që është përdorur për qëllime të veprës penale shantazhi, duhet vetëm si provë për të nxjerrë të dhënat e tilla për të provuar aspekte të fakteve, prokurori mund të trajtoj sendin e tillë që e ka si qëllim, vetëm si provë në mbështetje të nenit 260 paragrafi 11 nën paragrafi 11.1. Rastet e tilla të sfidave praktike përveç se duhet të trajtohen në interpretim të tille të normave, krijojnë efikasitet dhe nuk cenojnë të drejtat e palës së pandehur apo personave të tretë në procedurë. Për më tepër situata kur telefoni i sekuestrohet të pandehurit, qoftë sipas urdhrit të ndalimit të përkohshëm apo me pëlqimin e tij, për të qenë në zbatim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, ndërhyrja në të dhënat e tilla të telekomunikimit nuk mund të bëhet sipas urdhrit të prokurorit por duhet urdhër për ndërhyrje në të dhënat e tilla që të lëshohet nga Gjykata, sepse dispozita nga neni 36 i Kushtetutës së Kosovës përcakton qartësisht se të dhënat e tilla bien në kuadër të privatësisë, andaj çdo ndërhyrje në privatësi nuk mund të bëhet përveç se me urdhër të gjykatës. Nga ana tjetër prokuroria mundet, që kur propozon urdhër ndalues përfundimtar, ndër të tjera të propozoj edhe urdhrin për ekzaminim të telefonit, sepse në këtë mënyrë duke urdhëruar ekzaminim nga Gjykata që përbën ndërhyrje në privatësi, dhe vetëm urdhri i Gjykatës për qëllim të procedurës penale garanton zbatimin e drejt të nenit 36 të Kushtetutës së Kosovës.

6. Raste praktike të vendosura nga Gjykata Supreme për sa i përket vendimmarrjes për konfiskimin.

I.

Gjykata Supreme në Aktgjykimin, Pml.nr.178/2022, kishte kontestuar shkelje ligjore, ashtu që kishte urdhëruar kthimin e pasurisë – automjetin te pronari si person i tret.

A K T G J Y K I M

Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve Halil Biba dhe Shlirim Biba *dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në* Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.36/2020 të datës 13.10.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.458/2021 të datës 30.12.2021, *vetëm përkitazi me konfiskimin e automjetit të tipit "Honday Terrasan 2.9 CRDI", viti i prodhimit 2002, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit xx-KS-x5, ashtu që automjeti menjëherë i kthehet pronarit të saj, kurse pretendimet tjera të këtyre mbrojtësve si dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit* Kreshnik Biba *refuzohen si të pabazuara.*

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, *me aktgjykimin* PKR.nr. 36/2020 të datës 13.10.2021, *të dënuarit:* Halil Biba, Shlirim Biba dhe Kreshnik Biba *i ka shpallur fajtor për veprën penale* në bashkëkryerje dhe në vazhdim, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe anloge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së dhe i *ka gjykuar: të dënuarin Halil Biba me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 23.12.2019 deri me datë 15.06.2020, të dënuarin Shlirim Biba me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 10 (dhjetë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në*

paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 23.12.2019 deri me datë 15.06.2020, dhe të dënuarin Kreshnik Biba me dënim burgimi në kohëzgjatje prej (dy) vite dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) €. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e shumës prej nga 100 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej nga 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit. Konform nenit 115 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPPK-së janë konfiskuar në mënyrë të përhershme shuma prej 161 €, 200 lekë të Shqipërisë dhe vetura e tipit "Honday Terrasan 2.9 CRDI", viti i prodhimit 2002, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit xx7-KS-xx5.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 458/2021 të datës 30.12.2021, *ka aprovuar pjesërisht ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kualifikimin e veprës penale nga vepra penale* në bashkëkryerje dhe në vazhdim, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe anloge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së *në veprën penale* në bashkëkryerje dhe në vazhdim, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe anloge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së. Ankesat e Prokurorisë *Themelore në Ferizaj për bazat tjera ankimore dhe ankesat e mbrojtësve të të dënuarve* Halil Biba, Shlirim Biba dhe Kreshnik Biba *janë refuzuar si të pabazuara.*

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit Halil Biba av.Kushtrim Obrazhda nga Ferizaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të dënuarit ti shqiptohet dënim më i butë;

- mbrojtësja e të dënuarit Shlirim Biba, av.Vildane Hmaiti nga Ferizaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të

aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të dënuarit ti shqiptohet dënim më i butë; dhe

- mbrojtësja e të dënuarit Kreshnik Biba av.Labinota Qosa - Ilazi nga Ferizaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshon dhe të dënuarin të e liron nga akuza ose të dënuarit ti shqiptohet dënim më i butë;

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.112/2022 e datës 29.04.2022, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesa

Duke marrë parasysh faktin se kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve Halil Biba dhe Shlirim Biba kanë përmbajtje të njëjtë, atëherë edhe pretendimet e tyre do të trajtohen si të përbashkëta. Kurse në kërkesat e tyre theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, pasi që gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar dhe u ka falur besimin vetëm deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në stacionin policor dhe të cilat deklarime janë kontradiktore me deklarimet gjatë shqyrtimit gjyqësor, për më tepër, në këto deklarime të dëshmitarëve nuk është theksuar se të dënuarit kanë shitur substancë të llojit kokainë, por të gjithë kontaktet me të dënuarit i kanë pasur me qëllim të blerjes së substancës narkotike të llojit mariuhanë.

Pretendohet se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje me rastin e ricilësimit të veprës penale pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë nuk është arritur të provohet se në veprimet e të dënuarve janë plotësuar elementet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe janë dënuar pasi që është vërtetuar fakti se të dënuarit vetëm u kanë shitur substancë narkotike të llojit mariuhanë, kurse blerësit e kanë përdorur substancën narkotike vetëm për përdorim personal dhe asnjëherë për shpërndarje, shitje apo ofrim për shitje personave të tjerë. Më tutje në kërkesë janë parashtruar pretendime përkitazi me faktin se gjykatat e dy instancave më të ulëta nuk kanë vlerësuar mjaftueshëm

rrethanat lehtësuese pasi që të dënuarit kanë shprehur keqardhje dhe kanë premtuar se nuk do të kryejnë vepra të kësaj natyre. Kurse gjithashtu janë paraqitur pretendime përkitazi me konfiskimin e veturës duke theksuar faktin se vetura në fjalë është pronë e babait të të dënuarve dhe nuk është përfituar dhe as nuk është përdorur për veprën penale.

Mbrojtësja e të dënuarit Kreshnik Biba, av. Labinota Qosa – Ilazi në kërkesën e saj ka theksuar faktin se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, pasi që nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i kanë konsideruar të vërtetuara dhe po ashtu nuk janë paraqitur arsye të qarta apo të pranueshme mbi të cilat janë bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike.

Pretendohet se arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqëndrueshëm pasi që nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara është vërtetuar fakti se i dënuari Kreshnik Biba ishte përfshirë në aktakuzë vetëm për faktin se është vëlla me dy të dënuarit e tjerë dhe përkundër faktit se me asnjë provë i njëjti nuk është involvuar në kryerjen e kësaj vepre penale, megjithatë është shpallur fajtor, përkundër faktit se përgjegjësia është individuale dhe jo familjare.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve Halil Biba dhe Shlirim Biba *janë pjesërisht të bazuara, kurse kërkesa e mbrojtëses së të dënuarit Kreshnik Biba është e pabazuar.*

Duke shqyrtuar pretendimet e paraqitura në kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve Halil dhe Shlirim Biba, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në aktgjykimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk është vërtetuar se vetura është përdorur apo ka mundësuar kryerjen e veprës penale. Bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rrjedh se lënda narkotike është gjetur në shtëpinë e të dënuarve dhe se fakti i transportimit të saj deri në shtëpi me këtë automjet (duke u bazuar në deklarimin e të dënuarit Shlirim Biba arsyetim i theksuar nga gjykata e shkallës së parë dhe i

pranuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë) në asnjë rrethanë nuk paraqet kusht për konfiskim të automjetit, pasi që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për konfiskim të përhershëm.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk aprovon konkludimet e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore përkitazi me konfiskimin për faktin se me dispozitën e nenit 115 par.2 nënpar.2.2 të KPP-së janë përcaktuar bazat për konfiskim gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë: " *nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;*". Kurse bazuar në dispozitën ligjore në rastin konkret rrjedh konkludimi se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë vlerësuar kriteret për konfiskim dhe se si është mundësuar kryerja e veprës penale me sendin e konfiskuar-automjetin. Gjykata e shkallës së parë do të duhej të përdorte testin e nevojshëm për vërtetimin e fakteve se të dënuarit a ishin pronar të automjetit, a do të mund të kryhej vepra penale, përkatësisht a mund të transportohej sasia e lëndës narkotike pa sendin e konfiskuar dhe pastaj të bënte konfiskimin. Gjykata Supreme të Kosovës në rastin konkret aplikoi testin trehapësh dhe atë duke filluar me faktin se automjeti i konfiskuar a ishte pronë e të dënuarve, se pa sendin e konfiskuar-automjetin a do të mund të bëhej transportimi i lëndës narkotike dhe sasia e lëndës narkotike a do të mund të transportohej me mjete tjera. Ashtu që përmes këtij testi Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoj se fillimisht nga shkresat e lëndës del fakti se automjeti ishte pronë e personit Daut Biba (babai i të dënuarve) dhe i cili gjatë rrjedhës së procedurës nuk kishte pasur mundësi të deklarimit përkitazi me automjetin e konfiskuar përkundër faktit se kishte paraqitur kundërshtim në urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, mirëpo asnjëherë nuk kishte pasur mundësi të paraqitjes në mënyrë efektive pretendimet për konfiskimin përfundimtar të automjetit. Për më tepër, duke pasur parasysh peshën e lëndës narkotike prej 111.7 gr., mund të konkludohet se automjeti nuk ishte mjet i domosdoshëm për transportin e tij, andaj mbi këtë bazë u vendos që automjeti i konfiskuar të i kthehet pronarit të saj, meqë vetura nuk ka qenë mjet i domosdoshëm për kryerjen e veprës penale dhe me këtë rast nuk është plotësuar kushti për konfiskim të përcaktuar me dispozitën e nenit 115 par.2 nënpar. 2.2 të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës tutje vlerëson se çështja e pronës si e drejtë e karakterit absolut është e mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare, përkatësisht nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dhe kjo paraqet obligime shtesë për gjykatat e rregullta në zbatimin e tyre gjatë vendimmarrjes lidhur me pretendimet e palëve të treta dhe duhet të merr parasysh dy faktorë kryesorë. Së pari, gjykata merr parasysh nëse pala e tretë e prekur a ka patur mundësi t'i paraqesë pretendimet ndaj pasurisë në mënyrë efektive, dhe nëse këto pretendime janë shqyrtuar në proceset e zbatimit. Nga ky këndvështrim e rëndësishme të përmendet edhe praktika e GJEDNJ-së në rastin BKM Logjistik kundër Sllovenisë, "*...me ç 'rast është konstatuar se konfiskimi i pronës së palës së tretë mund të arsyetohej vetëm nëse interesat e palës së tretë që do ti kthehet prona peshonin më shumë se sa rreziku i kthimit të pronës dhe fakti se nuk ishte përshtatur për kontrabandim dhe nuk kishte rrezik se edhe në të ardhmen do të përdorej për kontrabandim, prandaj konfiskimi i pronës nga ana e autoriteteve janë konsideruar si të paarsyeshme, joproporcionale dhe paraqesin shkelje të nenit 1 të Protokolit nr.1 të KEDNJ*-së.". Kurse në rastin konkret ndonëse pala e dëmtuar, përkatësisht pronari i automjetit kishte paraqitur pretendime, mirëpo pretendimet e tij nuk janë shqyrtuar me rastin e konfiskimit të përfundimtar dhe përkundër faktit se automjeti nuk kishte dizajnim të posaçëm për transportin e narkotikut, si dhe në të ardhmen nuk kishte rrezik se do të përdorej për destinim të tillë pasi që pronari kishte sjellje të përgjegjshme, përkatësisht nuk rezulton nga shkresat e lëndës se ishte i involvuar në kryerjen e veprës penale.

Gjithashtu edhe në rastin Andonovski kundër IRMJ-së është theksuar rëndësia e qasjes së gjykatave lidhur me shqyrtimin nëse pala e tretë e prekur ishte në gjendje të paraqiste pretendime ndaj pasurisë në mënyrë efektive, duke konstatuar se "*ndonëse gjykata vendosi që ishte e qartë se parashtruesi i ankesës kishte vepruar në mirëbesim dhe që konfiskimi ishte joproporcional, ajo po ashtu vërejti që e drejta e brendshme, në veçanti, parashikonte konfiskim automatik të të gjitha automjeteve të përdorura për kontrabandim, pa përjashtim, prandaj, GJEDNJ*-së *gjeti shkelje të nenit 1 të Protokolit nr. 1 të KEDNJ*-së*."* Kurse konfiskimi i urdhëruar nga gjykatat e dy instancave konfiskimin e kanë bërë sipas dispozitës së nenit 115 par.2 nënpar.2.2 të KPP-së që në fakt rrjedh se

konfiskimi nuk ka pasur karakter obligativ por mund të bëhej nën kushtet e përcaktuara ligjore.
Sa i përket pretendimeve se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale *nga neni 384 par.1 lidhur me nenin 370 të KPPK-së*, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, meqë aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm dhe në mënyrë të plotë janë theksuar provat vendimtare që kanë vërtetuar fajësinë e të dënuarve. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në dëshminë e dëshmitarëve dhe provave tjera materiale.
Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj ka analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve përkitazi me rrethanat e ngjarjes, por përveç kësaj fajësia e të dënuarit ishte vërtetuar edhe bazuar në provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Përtej kësaj ndryshimi i kualifikimit ligjor nga ana e gjykatës së shkallës së dytë është si rezultat i ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe është në tërësi brenda kompetencave të saja. Për më tepër, në faqen e katërt dhe të pestë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë mënyra e veprimit të të dënuarve dhe se këto veprime janë cilësuar se përbëjnë elementet objektive dh subjektive të veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdim, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, pasi që të dënuarit kishin hyrë në fazën e shitjes së substancave narkotike, pra e kishin kaluar stadin e qëllimit për shitje pasi që personave konkret u kishin shitur substanca narkotike. Në këtë kontest Gjykata Supreme e Kosovës tërheq vëmendjen në faktin se për tu realizuar elementet e kësaj vepre penale të dënuarit duhet të shesin lëndën narkotike dhe pastaj është irelevant fakti se çka kanë vepruar blerësit me lëndën narkotike pasi që qarku përmbyllet me rastin e shitjes, përtej kësaj, inkrimini ligjor i kësaj dispozite është zbatuar ndaj të dënuarve kurse blerësit në këtë rast kanë pasur vetëm cilësinë e dëshmitarëve.
Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht faktin se ndaj të dënuarve

janë shqiptuar dënime të rënda, konstatoj se në mënyrë të *drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar për veprën penale të shpallur fajtor.* Megjithatë, *bazuar në* dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale.

Edhe pse kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur *për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe* shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, megjithatë, bazuar në përmbajtjet e tyre del se janë paraqitur pretendimet përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Andaj, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

II.

Gjykata Supreme në Aktgjykimin, Pml.nr.345/2024, kishte kontestuar shkelje ligjore, ashtu që kishte urdhëruar kthimin e pasurisë – automjetin te pronari si person i tret.

A K T GJ Y K I M

I. Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr. 64/2023 të datës 07.11.2023 vetëm përkitazi me urdhrin për konfiskim në atë mënyrë që kthehen palës së tretë pronarit të Kompanisë "ERËIN DOO" nga Novi Pazari sendet e konfiskuara dhe atë kamioni i markës "Man", ngjyrë të verdhë, me targa të regjistrimit

NP-113-RM, me nr. të shasisë WMA21XZZEM651249, me rimorkio me targa AE 421 NP, me ngjyrë të verdhë, me nr. të shasisë WKEZZ000000379153 dhe lejet përkatëse të qarkullimit për kamion dhe rimorkio.

II. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit Samir Hoxhiç, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.64/2023 të datës 07.11.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.15/2024 të datës 22.02.2024, kurse kërkesa e përfaqësuesit të palës së tretë hudhet si e palejuar.

A r s y e t i m i

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.64/2023 të datës 07.11.2023, i dënuari Samir Hoxhiç, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 paragrafi 1 të KPRK-së, duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 200 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 €. Konform nenit 277 par.1 të KPP-së është konfiskuar kamioni i markës "Man", ngjyrë të verdhë, me targa të regjistrimit NP-113-RM, me rimorkio dhe lejet përkatëse të qarkullimit për kamion dhe rimorkio.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.15/2024 të datës 22.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar, kurse ka hudhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të ndërmarrjes "Erëin" SHPK.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në

ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja të kthehet në rigjykim vetëm përkitazi me shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së përfaqësuesit të palës së tretë;
- mbrojtësja e të dënuarit, avokate Valbonë Morina nga Gjakova, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;
- përfaqësuesi i palës së tretë, avokatit Idriz Daci nga Gjakova, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe sendet e konfiskuara të i kthehen pronarit të ndërmarrjes "Ervin" SHPK.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.149/2023 e datës 31.05.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, meqë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të ankesës së përfaqësuesit të palës së tretë ka hudhur si të palejuar ankesën, përkundër faktit se me dispozitën e nenit 381 par.4 të KPP-së është përcaktuar se ankesë kundër aktgjykimit mund të paraqes edhe personi pasuria e të cilit është konfiskuar. Në këtë mënyrë del se është cenuar e drejta e palës së tretë që të shqyrtohet konfiskimi i pasurisë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Në kërkesën e paraqitur nga ana e mbrojtëses së të dënuarit theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave

të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së, meqë të dënuarit i është shkelur e drejta në mbrojtës e garantuar me dispozitën e nenit 52 të KPP-së dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pretendohet se një e drejtë e tillë të dënuarit i garantohet që nga fillimi i procedurës penale, kurse të dënuarit gjatë mbajtjes së seancës së hetimit të veçantë i është mohuar kjo e drejtë pasi që nuk ka pasur mbrojtës, përkundër faktit se në këtë seancë ka qenë prezent avokati Idriz Daci, mirëpo i njëjti ka qenë përfaqësues i palës së tretë, përkatësisht përfaqësuese i ndërmarrjes "Ervin" SHPK. Një shkelje e tillë pretendohet se është shkelje e cila ka ndikuar në vendimin gjyqësor pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është bazuar në procesverbalin e shqyrtimit të veçantë hetimor ku janë dëgjuar të dëmtuarit dhe në bazë të këtyre deklarimeve i dënuari është shpallur fajtor. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë këtë shkelje ka qenë dashur ta evitoj sipas detyrës zyrtare, mirëpo mos shqyrtimi i kësaj shkelje ka ndikuar që aktgjykimi të mbështetet në prova të papranueshme të marra gjatë procesverbalit të hetimit të veçantë dhe në deklarime të të dëmtuarve të cilat janë marrë në mungesë të avokatit të të dënuarit.
Kurse në kërkesën e përfaqësuesit të palës së tretë theksohet fakti se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke kontestuar konfiskimin e pasurisë së personit të tretë i cili nuk ka pasur njohur për veprimtarinë e të dënuarit, andaj edhe konfiskimi i pasurisë është bërë në mënyrë jo ligjore.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës penale (KPP) dhe pa vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është e bazuar, kërkesa e mbrojtëses së të dënuarit është e pabazuar, kurse kërkesa e përfaqësuesit të palës së tretë është e palejuar.

Duke shqyrtuar pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të paraqitura në kërkesën për mbrojtjes e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimet e theksuara përkitazi me mos

shqyrtimin e ankesës nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dalin të jenë të bazuara, pasi që me dispozitën e nenit 381 par.4 të KPP-së është lejuar ankesa edhe personit pasuria e të cilit është konfiskuar. Përkundër faktit se në kërkesën në fjalë është propozuar kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës së dytë për të vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të palës së tretë, mirëpo bazuar në shkresat e lëndës dhe parimin e ekonomizimit të procedurës penale, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, meqë vlerëson se nuk ishin plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore për të urdhëruar konfiskimin e përhershëm të pasurisë së palës së tretë, përkatësisht pronarit të Kompanisë "ERËIN DOO" nga Novi Pazari.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk aprovon konkludimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me konfiskimin për faktin se në rastin konkret rrjedh se nuk janë vlerësuar kriteret për konfiskim dhe se si është mundësuar kryerja e veprës penale me sendin e konfiskuar-kamionin dhe rimorkion. Gjykata e shkallës së parë do të duhej të përdorte testin e nevojshëm për vërtetimin e faktit vendimtar se i dënuari a ishte pronar i kamionit dhe pas kësaj të vërtetonte pronarin e kamionit dhe rimorkios dhe gjithashtu të vërtetonte njohurinë e palës së tretë se kamioni po përdorej për qëllime të jashtë ligjshme, përkatësisht të i jepte mundësinë e deklarimit të palës së tretë përkitazi me këto fakte dhe pastaj të bënte konfiskimin. Gjykata Supreme të Kosovës në rastin konkret aplikoi testin duke filluar me faktin se automjeti i konfiskuar a ishte pronë e të dënuarit dhe pastaj faktin e njohurive të palës së tretë se kamioni i tij po përdorej për qëllime të jashtëligjshme - kontrabandimin me migrantë. Ashtu që përmes këtij testi Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoj se fillimisht nga shkresat e lëndës, përkatësisht dokumentacioni i kamionit dhe rimorkios del fakti se automjeti ishte pronë e personit juridik përkatësisht pronarit të Kompanisë "ERWIN DOO" nga Novi Pazari dhe i cili gjatë rrjedhës së procedurës nuk ishte vërtetuar se kishte pasur njohuri se automjeti ishte duke u përdorur për kryerjen e veprës penale, meqë nuk ishte vërtetuar njohuria e palës së tretë- pronarit të kamionit se i njëjti ishte përdorur për kryerjen e veprës penale dhe me këtë nuk është plotësuar kushti për konfiskim të përcaktuar sipas dispozitave ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës tutje vlerëson se çështja e pronës si e drejtë e karakterit absolut është e mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare, përkatësisht nenin 1 të Protokolit nr.1 të KEDNJ dhe kjo paraqet obligime shtesë për gjykatat e rregullta në zbatimin e tyre gjatë vendimmarrjes lidhur me pretendimet e palëve të treta dhe duhet të merr parasysh dy faktorë kryesorë. Së pari, gjykata merr parasysh nëse pala e tretë e prekur a ka pasur mundësi t'i paraqesë pretendimet ndaj pasurisë në mënyrë efektive, dhe nëse këto pretendime janë shqyrtuar në proceset e zbatimit. Nga ky këndvështrim e rëndësishme të përmendet edhe praktika e GJEDNJ në rastin BKM Logjistik kundër Sllovenisë, "*...me ç'rast është konstatuar se konfiskimi i pronës së palës së tretë mund të arsyetohej vetëm nëse interesat e palës së tretë që do ti kthehet prona peshonin më shumë se sa rreziku i kthimit të pronës dhe fakti se nuk ishte përshtatur për kontrabandim dhe nuk kishte rrezik se edhe në të ardhmen do të përdorej për kontrabandim, prandaj konfiskimi i pronës nga ana e autoriteteve janë konsideruar si të paarsyeshme, joproporcionale dhe paraqesin shkelje të nenit 1 të Protokolit nr.1 të KEDNJ*.". Kurse në rastin konkret ndonëse pala e dëmtuar, përkatësisht pronari i automjetit kishte paraqitur pretendime, mirëpo pretendimet e tij nuk janë shqyrtuar me rastin e konfiskimit të përfundimtar dhe përkundër faktit se automjeti nuk kishte dizajnim të posaçëm për transportin e migrantëve, si dhe në të ardhmen nuk kishte rrezik se do të përdorej për destinim të tillë pasi që pronari kishte sjellje të përgjegjshme, përkatësisht nuk rezulton nga shkresat e lëndës se ishte i involvuar në kryerjen e veprës penale.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtëses së të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimi i theksuar në kërkesë del të jetë i pabazuar pasi që duke u bazuar në shkresat e lëndës del se i dënuari gjatë tërë kohës ishte përfaqësuar nga mbrojtësi Idriz Daci dhe atë që nga marrja në pyetje në polici, pastaj gjatë seancës për caktimin e masës së paraburgimit dhe posaçërisht gjatë seancës së veçantë hetimore, me ç 'rast shihet se i njëjti ka qenë përfaqësues i të dënuarit e kjo më së miri vërehet edhe me faktin se pikërisht ky mbrojtës ka ushtruar ankesa kundër aktvendimit për caktimin- vazhdimin e paraburgimit, dhe për më tepër, i njëjti mbrojtës ka paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës pikërisht në emër të të dënuarit, andaj pretendimi se ky mbrojtës nuk ka përfaqësuar të dënuarin është tërësisht i pabazuar. Fakti se tani i njëjti mbrojtës vazhdon në këtë fazë të procedurës penale (fazën e ankesës) përfaqësimin e palës së tretë

në asnjë rrethanë nuk e bën përfaqësimin e të dënuarit të mangët gjatë fazave të mëparshme të procedurës penale.
Sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të palës së tretë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dispozita e nenit 433 par.1 të KPP-së, ka përcaktuar se kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqes: Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Andaj, nga kjo dispozitë ligjore del se i dëmtuari, përkatësisht përfaqësuesi i palës së tretë nuk është në mesin e këtyre personave me të drejtë të paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, andaj edhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte e papranueshme.

III.

Gjykata Supreme në Aktgjykimin, Pml.nr.351/2025, kishte kontestuar shkelje ligjore, ashtu që kishte urdhëruar kthimin e pasurisë – automjetin te pronari si person i tret.

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti Special PN.S. nr.80/2024 të datës 11.03.2025.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PNDS.nr. 6/2024 të datës 22.10.2024, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS. nr. 44/2013 të datës 27.06.2024 në atë mënyrë që ka caktuar urdhrin kufizues përfundimtar për sigurimin e pasurisë për të mirëmbajtuar pronën dhe ekuivalentin e e saj dhe për të parandaluar humbjen e vlerës, me ç'rast i është ndaluar të dënuarit Florim Zekaj dhe çdo personi tjetër të ndërmerr çfarëdo veprimi për shitjen, transferimin, dhurimi apo çfarëdo veprimi tjetër për tjetërsimin apo uljen e vlerës për pasurinë e njësisë së objektit numër 30610881, shtëpi familjare me sipërfaqe prej 250 m ^{2} dhe objekt komercial 110 m ^{2} , që gjendet në adresën rr."UÇK" pn, Zona Kadastrale Istog. I cili urdhër ka efekt për Odën e Noterëve të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës – Drejtoria e Kadastrit në Komunën e Istogut, Oda e Përmbaruesve Privat, Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës dhe çdo pale apo institucioni tjetër që pranon urdhër dhe i cili urdhër mbetet në fuqi deri në ndryshimin apo anulimin e tij nga ndonjë urdhër tjetër i gjykatës.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti Special, me aktvendimin PN.S. nr.80/2024 të datës 11.03.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit Florim Zekaj avokatit Ramadan Shatri duke ndryshuar urdhrin kufizues përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PNDS.nr. 6/2024 të datës 22.10.2024 për lëshimin e urdhrit kufizues përfundimtar dhe duke shfuqizuar urdhrin kufizues përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PNDS.nr. 6/2024 të datës 22.10.2024, me të cilin ishte caktuar masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë: hapa të arsyeshëm për të mirëmbajtur pronën dhe ekuivalentin e saj dhe për të parandaluar humbjen e vlerës, me ç'rast i është ndaluar të dënuarit Florim Zekaj dhe çdo personi tjetër të ndërmerr çfarëdo veprimi për shitjen, transferimin, dhurimi apo çfarëdo veprimi tjetër për tjetërsimin apo uljen e vlerës për pasurinë e njësisë së objektit numër 30610881, shtëpi familjare me sipërfaqe prej 250 m^2 dhe objekt komercial 110 m^2 , që gjendet në adresën rr."UÇK" pn, Zona Kadastrale Istog. Urdhër me efekt për Odën e Noterëve të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës – Drejtoria e Kadastrit në Komunën e Istogut, Oda e Përmbaruesve Privat, Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës dhe çdo pale apo institucioni tjetër që pranon urdhër dhe i cili urdhër mbetet në fuqi deri në ndryshimin apo anulimin e tij nga ndonjë urdhër tjetër i gjykatës.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit nr. 06/L-87 – për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë nga neni 17 par.1 i këtij ligji, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të prishë aktvendimin e Gjykatës së Apelit e Kosovës - Departamenti Special, PN.S. nr.80/2024 të datës 11.03.2025 dhe çështjen të e kthej në rivendosje në të njëjtën gjykatë.

Mendimi i mbrojtësit të të dënuarit

Mbrojtësi i të dënuarit, avokati Ramadan Shatri, me shkresën e datës 27.06.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të hudhet si e palejuar apo të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë fillimisht është potencuar kronologjia e kësaj çështje gjyqësore duke theksuar faktin se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për lëshimin e urdhrit kufizuar përfundimtar të pasurisë dhe pretendohet se gjykata e shkallës së dytë konstatimin se urdhri kufizues përfundimtar është lëshuar pa aktvendim për inicimin e hetimit për konfiskim dhe për të cilën arsye procedura nuk është zbatuar në përputhje me dispozitën e nenit 17 par.1 nënpar.1.5 të Ligjit nr. 06/L-87 - për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Ngase dispozita në fjalë përdorë shprehjen mund dhe jo duhet dhe se ky formulim sugjeron një mundësi dhe jo detyrim për prokurorin e shtetit , pra shprehja mund i jep Prokurorit të Shtetit diskrecion për të vendosur nëse do të inicoj një hetim për konfiskim, pra paraqet mundësinë dhe jo detyrimin për veprimin e prokurorit të shtetit nëse ka dyshime se pasuria mund të jetë përfituar në mënyrë të paligjshme.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se në procedure janë respektuar afatet kohore të përcaktuara me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë ngase aktgjykimi me të cilin i dënuari është shpallur fajtor ka marrë formën e prerë me datë 29.07.2019, ndërsa kërkesa për verifikimin e pasurisë nga ana e PSRK-së është dorëzuar me datë 27.06.2024, që nënkupton se kërkesa është bërë brenda afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e nenit 4 par.1 nënpar.1.5.1 të LKZK-së e po ashtu është respektuar edhe dispozita e nenit 3 par.1 nënpar.1.5.1 të LKZK-së duke përcaktuar se pasuria e dyshuar duhet të jetë e regjistruar ose e fituar brenda një periudhe kohore 10 vjeçare para fillimit të hetimeve e që në shkresat e lëndës rezulton se pasuria në fjalë është regjistruar në vitin 2007 dhe 2009 e që nënkupton se kërkesa është brenda afatit ligjor, kurse kjo masë është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme me qëllim të parandalimit të shitjes dhe tjetërsimit të pronave nga i dënuari apo personat tjerë.

Në vazhdim të kërkesës theksohet fakti se masa e përcaktuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka pasur qëllim mirëmbajtjen e pronës ose ekuivalentin e saj për të parandaluar humbjen e vlerës dhe duke ndaluar ndërmarrjen e çfarëdo veprimi për tjetërsimin apo humbjen e vlerës së pasurisë e përveç kësaj pasuria mbetet në dispozicion për konfiskim në të ardhmen pas vlerësimit të kërkesës për verifikimin e pasurisë dhe ka efekt

në ndalimin e shitjes apo tjetërsimit deri në përfundim të procedurës sipas kërkesës për verifikimin e pasurisë. Për më tepër, nga shkresat e kësaj çështje vërtetohet fakti se i dënuari mes tjerash është dënuar edhe për veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2.1 dhe 2.2 të Ligjit 03/L-196 që është vepër penale e përcaktuar me dispozitën e nenit 2 par.1 të LKZK-së e për rrjedhojë pasuria e tij mund të i nënshtrohet konfiskimit pavarësisht faktit se nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor ose i konfiskimit në procedurë ku është dënuar e gjithashtu pasuria e propozuar për masën e udhrit kufizues përfundimtar është e regjistruar në emër të tij. Mbrojtja në këtë fazë nuk ka parashtruar asnjë provë se kjo pasuri i përket personave tjerë ose nuk është pasuri e të dënuarit edhe pse kishte detyrim ligjor, kurse pretendimi se kjo pasuri nuk mund të i nënshtrohet konfiskimit ngase kjo pronë është blerë në vitin 1999, pra shumë kohë para se i dënuari të dënohej dhe i cili pretendim nuk gjen mbështetje në prova.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i pabazuar, ngase aktvendimi i kundërshtuar nuk përmbajnë shkelje të pretenduara. Në rastin konkret nuk është i bazuar pretendimi, siç është theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë janë bërë shkelje për të cilat pretendohen.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në provat e administruara ka marrë aktvendim për ndryshimin e masës së urdhrit kufizues përfundimtar dhe refuzimin e kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e evidentuar me numrin PPS. nr. 44/2013 të datës 27.06.2024 duke shfuqizuar urdhrin kufizues përfundimtar duke arsyetuar në faktin se kjo kërkesë ishte në kundërshtim me dispozitën e nenit 17 par.1 nënpar.1.5 të LKZK-së dhe atë përkundër faktit se ishin plotësuar kushtet ligjore, përveç mungesës së bazës për urdhër të tillë nga fakti se nuk ishte marrë aktvendim për inicimin e hetimit për konfiskim dhe i cili kusht theksohet

se është i rëndësishëm për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale dhe për të shmangur vendime të paarsyetuara ose arbitrare, përkatësisht procedura në këtë rast nuk ishte formalizuar me aktvendim për inicimin e hetimeve për konfiskim. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo padyshim se paraqet një interpretim ekstenziv të dispozitës ligjore të nenit 17 par.1 nënpar.1.5 dhe par.2 të LKZK-së, meqë e njëjta në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se për të kërkuar një urdhër për kufizues përfundimtar dhe për të paraqitur kërkesë për verifikim të pasurisë mund të inicioj një hetim për konfiskim e që kjo nuk lë dyshim se shprehja mund paraqet një mundësi për prokurorinë e shtetit dhe jo detyrim të saj, pra i lë diskrecion përkitazi me inicimin apo jo të një hetimi për konfiskim varësisht prej situatës konkrete dhe kjo nuk do të duhet të interpretohet si ndalesë absolute se mos inicimi i hetimit paraqet ndalesë për paraqitjen e urdhrit kufizues përfundimtar. Kjo edhe për faktin se urdhri kufizues përfundimtar ka për qëllim sigurimin e mos tjetërsimit të pasurisë deri te konfiskimi eventual i saj, përkatësisht që të mos kemi një procedurës të konfiskimit me përfundim të tjetërsimit të pasurisë.

Gjykata Supreme e Kosovës përmes këtij aktgjykimi do të shqyrtoj tri segmente të rëndësishme të cilat do të shërbejnë me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe atë së pari në përmbajtjen e kërkesës së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, propozimin e saj dhe bazës ligjore për kthimin e çështjes në rivendosje. Së pari, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur kërkesë për anulimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes në rivendosje në të njëjtën gjykatë, së dyti propozimi për anulimin e aktvendimit të kundërshtuar dhe kthimin e çështjes në rivendosje dhe së treti përcaktimi i bazës ligjore. Mirëpo, veprimi i tillë i Gjykatës Supreme të Kosovës, përkatësisht anulimi i aktvendimit dhe kthimi i çështjes në rivendosje është i kufizuar vetëm në dy situata: kur vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë. Kurse, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç propozimit për anulim nuk ka argumentuar se në rastin konkret cilat janë shkeljet që aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë e bëjnë vendim qartazi të papërshtatshëm ose të bazuar në gabim të rëndë, por në të gjitha pretendimet dhe argumentet e paraqitura theksojnë shkelje të natyrës së zakonshme të dispozitës së nenit 17 par.2 të LKZK-së.

Mbi këtë bazë, vlerësojmë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të kishte në fokus të shkeljes qartësimin e pretendimit dhe evidentimin e shkeljeve se vendimi i kundërshtuar është vendim qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë, meqë nga interpretimi i dispozitës së nenit 438 par.2 të KPP-së, në parim Gjykata Supreme e Kosovës vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, kurse vetëm në situata përjashtuese e ligjvënësi ka përdorur shprehjen përveç (në vendimet qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabime të rënda), atëherë mund të vjen në shprehje aplikimi i propozimit të theksuar nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që çështja të kthehet në rivendosje. Për më tepër, bazuar në konceptin e përgjithshëm të dispozitave të procedurës penale është në barrën e prokurorisë së shtetit evidentimi dhe bërja e besueshme e fakteve se gjykata në rastin konkret ka nxjerrë vendim qartazi të papërshtatshëm apo vendimin e tyre e kanë bazuar në gabim të rëndë dhe kjo në ndërlidhje me dispozitën e nenit 436 par.1 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: "*...Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon*". Përtej kësaj në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përveç mungesës së arsyetimit përkitazi me bazën për shkeljet se vendimi është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabime të rënda i mungon edhe formalisht potencimi i kësaj dispozite ligjore (neni 438 par.2 i KPP-së), pra fare nuk ceket në kërkesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës mbetet në të njëjtën linjë me aktgjykimet e saj Pml. nr. 25/2025, më 24 shkurt 2025 dhe Pml. nr.46/2025 të datës 03 shkurt 2025, se shkeljet e pretenduara duhet të argumentohen nga ana e paraqitësit të kërkesës dhe në asnjë rrethanë këto shkelje të evidentohen dhe të përcaktohen nga ana e kësaj gjykate, meqë kjo do të cenonte barazinë e palëve në procedurë e përcaktuar me dispozitën e nenit 9 të KPP-së.

Gjithashtu ky aktgjykim është edhe në frymën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për rastet e bashkuara nr. KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, me ç'rast është theksuar fakti se "*...neni 438 paragrafi 2 i KPP-së, duhet interpretuar në kuadër të garancive procedurale të përcaktuara në nenet 29 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së*", respektivisht, Gjykata Supreme e Kosovës duhet

të ketë parasysh normat kushtetuese, përfshirë nenit 53 të Kushtetutës që përcakton se interpretimi i të drejtave të njeriut bëhet në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, detyrim ky që vlen për të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Kosovës dhe se vendosja në dëm të të pandehurit, vjen në shprehje vetëm në raste shumë përjashtuese e që këto përjashtime mund të zbatohen vetëm në raste të shkeljeve serioze të ligjit nga gjykatat më të ulëta, kurse në rrethana të tjera, Gjykata Supreme e Kosovës, duhet t'i përmbahet parimit që vendimi në dëm të të pandehurit, ka vetëm efekt deklarativ, mirëpo i cili efekt nuk ka mundur të zbatohet në këtë aktgjykim për shkak të mungesës së propozimit të tillë nga ana e parashtruesit të kërkesës.

Në këtë rast çështja penale, ishte filluar sipas Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, Nr.06/L-087 (tanimë dispozitat e ngjashme janë inkorporuar edhe në Kodin e Procedurës penale të Kosovës që është në fuqi), përkundër se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte refuzuar, Gjykata Supreme ka konstatuar se gabimisht ishte interpretuar dispozita ligjore nga Gjykata e Apelit, lidhur me çështjen se a mund të zbatohet procedura për konfiskimin e pasurisë të gjetur më vonë, vetëm sipas kërkesës së Prokurorit apo duhet që të filloj hetim Prokurori. Gjykata Supreme ka konstatuar se gjithnjë procedura mund të filloj sipas kërkesës, hetimi është vetëm mundësi për prokurorin kur ka nevojë për gjetjen e pasurisë, ndërsa kur pasuria është identifikuar procedura fillohet me kërkesën e prokurorit pa pasur nevojë për hetim.

Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje civile

Rrustem Thaqi

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm në Ndërlidhje me të Drejtën për Proces të Rregullt Gjyqësor në Lëmin Civil

1. Shqyrtime të përgjithshme

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nënkupton që çdo person të ketë mundësinë që çështja e tij të shqyrtohet publikisht, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e themeluar me ligj. Kjo e drejtë garanton jo vetëm mbrojtjen e barabartë të palëve në proces civil, por edhe sigurimin që vendimet gjyqësore të jenë të arsyetuara dhe pa ndikime të jashtme, në përputhje me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë kuadër, neni 31 paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (tani e tutje KRK) përcakton se: "1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj." Kjo e drejtë për gjykim të drejtë është garancion për palët se rasti i tyre do të shqyrtohet në mënyrë objektive nga një organ i pavarur, i përcaktuar me ligj dhe në një kohë të arsyeshme. Pra ky parim apo garancion është edhe barometër i zhvillimit të shtetit dhe nivelit të demokracisë në atë shtet, për arsye se varësisht se si e kanë të përcaktuar, si e zbatojnë në praktikë këtë të drejtë apo garancion, shtetet mund të cilësohen: shtete stabile demokratike dhe me nivel të lartë të respektimit të të drejtave të njeriut dhe shtete më pak demokratike deri tek shtetet totalitare apo autokratike ku niveli i të drejtave të njeriut është në minimum i respektuar nga organet shtetërore. Me nenin 102 të KRK-së, janë përcaktuar parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, sipas të cilave gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Me nenin 112 të KRK-së, është përcaktuar se Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me

Kushtetutën. Me nenin 113 të KRK-së, është përcaktuar juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese dhe palët e autorizuara që mund të paraqesin kërkesë për shkeljet e pretenduara. Nga përmbajta e paragrafit 7 dhe 8 të kësaj dispozite kushtetuese rezulton se individët janë të autorizuar të paraqesin shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Po ashtu, gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën, dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

Me tutje, me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese rezulton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; 8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Po ashtu, me nenin 53 të KRK-së është përcaktuar se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vetëm pasi të vendosen këto bazamente kushtetuese, në ndërlidhje me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, hyjmë në standardet ndërkombëtare të cilat kanë përcaktuar rregulla të veçanta të inkorporuara si në instrumente ndërkombëtare të karakterit deklarativ (si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në instrumente të karakterit detyrues si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje Konventa). Me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës, përcaktohet se: "*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij*". Neni 6 i Konventës, kuptohet dhe interpretohet në formë të ngurtë, mirëpo praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë GJEDNJ), i ka dhënë kuptim të drejtë këtij neni, pasi përmes praktikës ka evoluar edhe kuptimi i këtij neni duke marrë kuptim të plotë por edhe ekstenziv.

Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, e cila është një element i garantuar me nenin 6 të Konventës, duhet të theksohet se përcaktimi i asaj që konsiderohet "afat i arsyeshëm" varet nga rrethana të ndryshme të rastit dhe nuk ka një standard unik për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Pra, kriteri i kohës shihet në raport me kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve, efikasitetin e autoriteteve gjyqësore dhe interesin që kanë palët për një vendim të shpejtë.

Megjithatë, për dallim nga ky element relativ, elementet e tjera të nenit 6 si e drejta për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe nga një gjykatë e pavarur, konsiderohen standarde themelore dhe gëzojnë pothuajse konsensus të plotë në mesin e shteteve demokratike. Neni 6 gjithashtu garanton që gjykimi të jetë publik, si në çështjet penale ashtu edhe në ato civile, duke përfshirë dy të drejta të rëndësishme: 1) qasjen në gjykatë, që nënkupton mundësinë reale të çdo personi për të paraqitur pretendimet e tij; dhe 2) të drejtën për një aktgjykim të arsyetuar, që detyron gjykatat të japin arsye të qarta për vendimin e tyre. Mungesa e një arsyetimi

adekuat ose një vendim i paqartë mund të cenojë tërësinë e procesit gjyqësor dhe të përbëjë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.
Në këtë drejtim, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje GjEDNj) ka luajtur një rol vendimtar në konsolidimin e standardit për arsyetimin e vendimeve, duke theksuar se mungesa e arsyeve të qarta dhe të mjaftueshme përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës.
Sipas kësaj praktike, aktgjykimet e gjykatave duhet të deklarojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato bazohen dhe dështimi për të bërë këtë do të rezultojë në një gjykim të padrejtë. Shkalla në të cilën zbatohet ky detyrim për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Pa kërkuar një përgjigje të detajuar për çdo argument të paraqitur nga parashtruesi, ky detyrim presupozon që palët në procedurat gjyqësore mund të presin që të marrin një përgjigje specifike dhe të qartë për argumentet që janë vendimtare për rezultatin e atyre procedurave. Kjo e drejtë në procedurën gjyqësore ka rëndësi të veçantë, ngase gjykatat, si organe të pavarura që ushtrojnë funksionin e dhënies së drejtësisë, përfaqësojnë instancën e fundit për garantimin e të drejtave të njeriut, duke vepruar si mburojë kundrejt çdo përpjekjeje ose tendence nga organet e tjera shtetërore për t'i cenuar këto të drejta.
Praktika jonë gjyqësore e hulumtuar ndër vite ka vënë në pah problematika në vendimmarrje të gjykatave që përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut duke përfshirë nenin 31 të KRK-së, në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës. Vendimet gjyqësore të arsyetuara mirë, kanë për qëllim të transmetojnë tek palët në proces se argumentet e tyre janë dëgjuar dhe konsideruar në mënyrë meritore nga ana e gjykatës, përmes arsyetimit adekuat ligjor, palët arrijnë të kuptojnë se si gjyqtari ka arritur në një përfundim të caktuar në çështjen objekt gjykimi. Në përgjithësi, vendimet gjyqësore (aktgjykimet) të arsyetuara mirë janë po ashtu, në funksion të mbrojtjes ndaj gjykimit arbitrar dhe garantojnë dhënien e duhur të drejtësisë, por edhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Cilësia e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, arrihet vazhdimisht edhe me përdorimin dhe referimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, për çështjet të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me aspektin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Rëndësia e instrumenteve ndërkombëtare të

të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në sistemin juridik të brendshëm, përmes nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që njeh përparësinë e tyre ndaj legjislacionit vendor në rast konflikti, theksohet edhe nga neni 53 i Kushtetutës, i cili përcakton detyrimin që të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë të interpretohen në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

Përdorimi dhe referimi në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat e rregullta vendore është pothuajse në shkallën minimale, për faktin se gjykatat vendore pak dhe në raste të rralla i referohen apo përdorin për raste të caktuara vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Duke marrë parasysh trendin e zhvillimit të praktikës gjyqësore ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, konsiderojmë se është e nevojshme, me qëllim të ofrimit të një mbrojtje adekuate gjyqësore dhe hartimit të vendimeve cilësore gjyqësore, që gjyqtarët t'i referohen jurisprudencës së GJEDNJ-së. Për më tepër, detyrimi i gjykatave vendore për të dhënë arsye për vendimet e tyre është shprehur shprehimisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas nenit 6 të Konventës, i cili është burimi kryesor, por jo i vetmi i detyrimit të gjykatave vendore për të dhënë një vendim të arsyetuar gjyqësor, ky detyrim mund të rrjedhë gjithashtu edhe nga detyrimet pozitive dhe procedurale që rrjedhin nga një sërë dispozitash tjera thelbësore të Konventës si p.sh. nga nenet 2, 3, 5, 8 dhe neni 11.

Duke marrë për bazë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vështrim të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është thelbësore që gjyqtarët e gjykatave të rregullta, si dhe profesionistët tjerë të fushës së drejtësisë, të mbështeten në jurisprudencën e kësaj gjykate dhe varësisht nga natyra e kontestit, të referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në rastet përkatëse. Qasja dhe referimi në këto standarde mundësohen përmes bazës së të dhënave HUDOC-së, si dhe përmes Udhëzuesve të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilët ofrojnë një instrument të vlefshëm për interpretimin e neneve të KEDNJ-së. Kjo është me rëndësi të posaçme në procesin e hartimit të vendimeve gjyqësore, duke pasur parasysh se gjyqtarët dhe profesionistët ligjorë duhet të sigurojnë që standardet e përcaktuara nga Konventa dhe të zhvilluara nga GJEDNJ-së të respektohen dhe të zbatohen për të avancuar mbrojtjen gjyqësore të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

2. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas dispozitave të Ligjit për Procedurës Kontestimore

Me Ligjin nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, si dhe me Ligjin nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 (tani e tutje LPK), janë përcaktuar rregullat procedurale mbi bazën e të cilave gjykata shqyrton dhe zgjidh kontestet që burojnë nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, përveç rasteve kur me një ligj të posaçëm parashihet ndryshe.

E drejta procedurale civile është pjesë përbërëse e së drejtës pozitive dhe përfshin të gjitha normat juridike përmes të cilave sigurohet mbrojtja dhe realizimi i të drejtave subjektive që lindin nga marrëdhëniet juridiko-civile.

Me procedurë gjyqësore civile, në kuptimin material, nënkuptohet veprimtaria e përbërë nga një varg veprimesh konkrete të subjekteve të ndryshme, prania e të cilëve është e domosdoshme për mbrojtjen gjyqësore ose realizimin e një të drejte subjektive të shkelur. Ndërsa, në kuptimin formal, procedura gjyqësore civile përfaqëson tërësinë e normave juridike që përcaktojnë pjesëmarrësit në proces, të drejtat dhe detyrimet e tyre procedurale, format dhe afatet për ushtrimin e veprimeve procedurale, si dhe efektet juridike që këto veprime prodhojnë në procesin gjyqësor.

Duhet theksuar se mbrojtja e të drejtave subjektive nuk realizohet vetëm përmes procedurës kontestimore para gjykatave, por mund të realizohet edhe nëpërmjet procedurës administrative para organeve administrative, procedurës së konfliktit administrativ, si dhe nëpërmjet procedurës penale, varësisht nga natyra e të drejtës së cenuar.

Varësisht nga natyra e raportit juridiko-civil mbi të cilin zhvillohet procedura, mbrojtja juridike mund të realizohet në disa forma: përmes procedurës kontestimore, procedurës jokontestimore, procedurës përmbarimore ose procedurës së falimentimit.

Sipas dispozitave të LPK-së, procedura kontestimore përbëhet nga veprimet procedurale të subjekteve të procesit në kuadër të një gjykimi gjyqësor. Subjektet themelore të procedurës kontestimore janë: paditësi, i cili paraqet kërkesën për mbrojtje juridike; i padituri, ndaj të cilit drejtohet kjo kërkesë, si dhe gjykata, e cila shqyrton pretendimet dhe në

bazë të rezultateve të shqyrtimit, me aktgjykim vendos për themelësinë ose pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Procedura kontestimore iniciohet me paraqitjen e padisë në gjykatë. Padia përbën veprimin e parë procedural të paditësit dhe njëkohësisht parashtresë formale përmes së cilës ai kërkon realizimin e një të drejte subjektive. Përmbajtja e padisë përcaktohet në mënyrë të detajuar nga neni 253 paragrafi 1 pika a), b), c), d), e) dhe f) të LPK-së.

Në praktikë, procedura kontestimore zakonisht zhvillohet në katër faza kryesore:

1. Faza përgatitore, e cila fillon me paraqitjen e padisë dhe përfundon me caktimin e seancës për shqyrtim kryesor;
2. Shqyrtimi kryesor, që përbën bërthamën e procesit gjyqësor dhe zhvillohet në një ose disa seanca publike;
3. Vendimmarrja meritorë, gjatë së cilës gjykata nxjerr aktgjykimin dhe ua komunikon palëve ndërgjyqëse;
4. Shqyrtimi i aktgjykimit nga gjykata e shkallës së dytë, përmes mjeteve juridike të lejuara (mjetet e goditjes), që synojnë kontrollin e ligjshmërisë dhe themelueshmërisë së vendimit të shkallës së parë.

Me nenin 160 paragrafi 1 të LPK-së, rezulton qartë se çka duhet të përmbajë aktgjykimi i përpiluar me shkrim. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të ketë:

- pjesën hyrëse,
- dispozitivin,
- arsyetimin, dhe
- udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.

Me paragrafin 2 të nenit 160 të LPK-së, është përcaktuar se pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.

Me paragrafin 3 të nenit 160 të LPK-së, është përcaktuar se dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë, si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.
Me paragrafin 4 të nenit 160 të LPK-së, është përcaktuar se arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.
Me paragrafin 5 të nenit 160 të LPK-së, është përcaktuar se: gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.
Me nenin 173 të LPK-së, është përcaktuar se: "Aktvendimi duhet ta ketë arsyetimin po që se kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë, e mund të përmbajë atë edhe në ndonjë rast tjetër kur gjykata e quan të nevojshme një gjë të tillë".
Me nenin 175 të LPK-së, është përcaktuar se: "Dispozitat e neneve 146, 153, 160 dhe 169 paragrafi 2 të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe kur kem të bëjmë me aktvendimet".
Po ashtu me dispozitat e LPK-së, është përcaktuar procedurën sipas mjeteve të goditjes si: mjetet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve gjyqësore.
Me nenin 181 paragrafi 1 të LPK-së, janë përcaktuar shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, rezulton se aktgjykimi mund të goditet:

a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore;

b) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;

c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të goditen për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkaku se deklarata e pohimit, gjegjësisht e heqjes dorë nga kërkesëpadia, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

Me nenin 182 paragrafi1të LPK-së, është përcaktuar se: "Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mund të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë". Ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni, është përcaktuar se: shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

a) në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në çoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;
b) në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;
c) në çoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies se vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;
d) në çoftë se gjykata sipas prapsmit të palëve gabimisht ka vendosur se është e kompetencës lëndore;
e) në çoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;
f) në çoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;
g) në çoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji);
h) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerr aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;

i) në qoftë se ndonjërës nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;
j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;
k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve te veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;
l) në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykimi i formës se prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;
m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;
o) në qoftë se me aktgjykim është tejkaluar kërkesëpadia.

Me nenin 183 të LPK-së, është përcaktuar se: *"1 Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare. 183.2 Ekziston konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike edhe kur për këtë flasin faktet e reja apo provat e reja"*.

Me nenin 184 të LPK-së, është përcaktuar se: "Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale qe është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.
Me nenin 208 të LPK-së, përcaktohet se: "Në procedurën sipas ankesës së veçantë, të paraqitur kundër aktvendimit, në mënyrë adekuate do të zbatohen dispozitat e këtij ligji që vlejnë për ankesën kundër aktgjykimit, përveç dispozitave me të cilat parashihet mundësia e shqyrtimit të çështjes drejtpërsëdrejti nga gjykata e shkallës së dytë".
Prandaj duke ju referuar dispozitave të cituara Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e paraqitura, ka konstatuar shkelje të dispozitave të LPK-së.
Këtu do të fokusohemi vetëm sa i përket shkeljeve të LPK-së, me theks të veçantë: mungesa e arsyetimit ligjore të vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta
Në disa raste aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë:

1) ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet;
2) I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës;
3) Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës;
4) Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë ose pathemelësinë e kërkesëpadisë;
5) Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave;

6) Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë apo pathemelësinë e kërkesëpadisë;
7) Nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk mund të kuptohet se çka realisht gjykata ka aprovuar dhe çka ka refuzuar;
8) Përveç të theksuarave:
   a) Në disa raste gjykata e shkalles së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejt dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë;
   b) Në disa raste gjykatat e shkallës së parë kanë vendosur lidhur me kërkesëpadinë, pa nxjerrjen e provave me ekspertim nga lëmia përkatëse, me të cilat do të vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë;
   c) Edhe në rastet kur gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë ka nxjerr provën me ekspertim nga lëmia përkatëse, mendimi i ekspertit i dhënë në ekspertizë është i mangët dhe jo i plotë, e gjyqtari i çështjes nuk ka kërkuar plotësimin e mendimit dhe nuk e ka ftuar ekspertin e lëmisë përkatëse, për të dhënë sqarime lidhur me mendimin e dhënë në ekspertizë;
   d) Në disa raste gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar prezumimet procedurale negative për lejueshmërinë e procesit gjyqësor, gjegjësisht nuk ka vlerësuar lejueshmërinë/ afateshmërinë e padisë edhe në rastet kur ka pasur kundërshtim nga pala e paditur, në përgjigje në padi, në seancën përgatitor dhe seancën kryesore;
   e) Po ashtu gjykatat në disa raste nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i këtyre, kanë bërë shkelje dispozitave të LPK-së.

Duhet theksuar faktin se në praktikën gjyqësor janë në rritje rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës anulon vetëm aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe rastin e kthen në rivendosje në gjykatën e shkallës së dytë.

Në disa raste aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për faktin se:

1) Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të bazuara ose të pabazuara, dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë;
2) Gjykata e shkallës së dytë vetëm në dispozitiv ka trajtuar ankesën ndërsa në arsyetim nuk kanë dhënë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë, në aspektin e shkeljeve të dispozitave procedurale, aspektin e gjendjes faktike të vërtetuar si dhe në raport me pretendimin për aplikim të gabuar të drejtës materiale;
3) Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar pretendimet ankimor vetëm mbi bazën e një konstatimi të tillë, pa dhënë arsye të qarta për shkeljen konkrete të pretenduar nga pala ankuese, në këto raste vetëm është konstatuar se nuk ekziston shkelja dhe është përsëritë formulimi i dispozitës ligjore, ndërsa nuk ka asnjë arsye në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar;
4) Gjykata e shkallës së dytë nuk ka paraqitur arsye në vendimin e saj, në raport me pretendimet ankimore të paraqitur nga pala në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, duke mos pranuar si arsyetim të mjaftueshëm konstatimin se: “ Me vlerësim të drejtë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë në mënyrë bindëse dhe në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike relevante për marrjen e vendimit të drejtë në këtë çështje juridiko civile ”;
5) Gjykata e shkallës së dytë nuk ka paraqitur arsye në lidhje me aplikimin e të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, pretendim ankimor në të cilin është thirr pala apo për të cilin gjykata e shkallës së dytë është dashur të kujdeset sipas detyrës zyrtare. Nga rezulton se nuk mund të kuptohet nga arsyetimi i vendimit se cili

është vlerësimi i kësaj gjykate në raport me të drejtën materiale të aplikuar nga gjykata e shkallës së parë.

Referuar dispozitave të LPK-së, mungesa e arsyetimit ligjor në një vendim gjyqësor cenon vetë qëllimin për të cilin është nxjerr vendimi. Qëllimi i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se pretendimet e tyre janë shqyrtuar në mënyrë meritore dhe njëkohësisht t'u mundësojë atyre ushtrimin efektiv të së drejtës për ta kundërshtuar vendimin me mjetet juridike të parashikuara. Një vendim gjyqësor duhet të mbështetet vetëm mbi faktet e paraqitura gjatë procedurës dhe të përmbajë bazën ligjore të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe arsyetimin logjik mbi të cilin gjykata mbështet përfundimin e saj. Për shkak se aktgjykimi mund të i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë nga gjykata më e lartë, është e domosdoshme që ai, në përmbajtje dhe strukturë, të jetë në përputhje me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata, në arsyetimin e aktgjykimit, jo vetëm që duhet të ndjekë strukturën e përcaktuar nga ligji, por gjithashtu duhet të japë përgjigje substanciale mbi kërkesat, pretendimet dhe kundërshtimet e palëve ndërgjyqësore. Kjo detyrë është konfirmuar edhe në jurisprudencën kushtetuese të Kosovës, ku është theksuar se, e drejta për një vendim të arsyetuar përbën pjesë përbërëse të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në disa raste, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk i plotësojnë këto detyrime, duke shkelur kështu nenin 6.1 të KEDNJ-së, për të dhënë një vendim të arsyetuar (shih, ndër të tjera, rastin KI.89/13).

Në të njëjtën linjë, edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, ka theksuar se arsyetimi i aktgjykimit është një element thelbësor i të drejtës për gjykim të drejtë, duke shërbyer jo vetëm si garanci për ndarjen e drejtësisë, por edhe si tregues se gjykata ka shqyrtuar realisht pretendimet e palëve. Sipas GJEDNJ-së, funksioni i vendimit të arsyetuar është t'i bëjë palët të ndihen se janë dëgjuar dhe të mundësojë kontrollin publik të administrimit të drejtësisë. Kjo është vendosur në rastet *Tatishvili kundër Rusisë* (9 korrik 2007, par. 58) dhe *Hirvisaari kundër Finlandës* (27 shtator 2001, par. 30), ku gjykata ka theksuar se mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm përbën shkelje të nenit 6 të Konventës.

Si përfundim, mos arsyetimi i një vendimi përfundimtar paraqet shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të garancive kushtetuese për proces të rregullt, me ç ‘rast një vendim i tillë, në të gjitha rastet, prishet nga gjykata më e lartë dhe çështja kthehet në rigjykim.

3. Baza e referimit në jurisprudencën e GJEDNJ-së

Arsyetimi mirë i vendimeve gjyqësore nuk është thjesht një detyrim ligjor, por gjithashtu një proces i cili ka për qellim të shërbej në disa dimensione. Fillimisht, vendimet gjyqësore të arsyetuara mirë, kanë për qellim të transmetojnë dhe tu tregojnë palëve se argumentet e tyre janë dëgjuar dhe konsideruar në mënyrë meritore nga ana e gjykatës. Përmes arsyetimit adekuat ligjor, palët në procedurë mund të kuptojnë pse dhe si gjyqtari ka arritur në një përfundim të caktuar në çështjen objekt shqyrtimi dhe, për rrjedhojë, të marrin parasysh nevojën e përdorimit të mjetit juridik. Në këtë kontekst, arsyetimi i mirë gjithashtu lehtëson pranimin e gjykimit nga palët dhe nga publiku i gjerë. Në përgjithësi, vendimet gjyqësore (aktgjykimet) të arsyetuara mirë janë po ashtu, në funksion të mbrojtjes ndaj gjykimit arbitrar dhe garantojnë dhënien e duhur të drejtësisë, por edhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.
Në këtë kontekst, gjatë procesit të vendimmarrjes, gjykatat janë të detyruara, sipas ligjit, që vendimet e tyre të shoqërohen me një arsyetim të detajuar. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe për rrjedhojë, nuk është palë nënshkruese e Konventës, standardet themelore për arsyetimin e vendimeve gjyqësore burojnë pikërisht nga Konventa, ashtu siç janë interpretuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Ky detyrim për gjykatat vendore dhe institucionet publike është i sanksionuar nga suprema lex – Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
Në këtë kuadër, gjykatat përmes zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, janë të obliguara që të respektojnë standardet e zhvilluara nga GJEDNJ-së. Këtë e kërkon shprehimisht neni 53 i KRK-së, sipas të cilit të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë duhet të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Si rrjedhojë, arsyetimi i vendimeve nuk është vetëm një kërkesë formale e së drejtës vendore procedurale,

por edhe një detyrim kushtetues që reflekton standardet ndërkombëtare për një proces të rregullt ligjor.
Përmbushja e këtij detyrimi mbështetet në faktin se gjykatat dhe organet e tjera të ngarkuara me interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (KRK), janë të obliguara që të marrin parasysh dhe të mbështeten në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke i përfshirë rast pas rasti standardet e kësaj gjykate në përmbajtjen e vendimeve të tyre. Përveç nenit 53 të KRK-së, i cili përcakton detyrimin për interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, rëndësi të veçantë ka edhe neni 22 i KRK-së. Ky nen parashtron se instrumentet ndërkombëtare kryesore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut zbatohen drejtpërdrejt në territorin e Republikës së Kosovës dhe, në rast konflikti, gëzojnë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
Për rrjedhojë, përgjegjësia kryesore për sigurimin e një vendimi gjyqësor të arsyetuar në përputhje me standardet e GJEDNJ-së bie mbi gjyqtarin hartues të aktgjykimit. Megjithatë, kjo përgjegjësi nuk kufizohet vetëm te gjyqtarët por edhe prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional mbajnë gjithashtu një detyrim të përbashkët për të kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, forcimin e sigurisë juridike dhe përmirësimin e sundimit të ligjit. Kjo nënkupton se i gjithë sistemi gjyqësor, përmes aktorëve të tij kryesorë, është i lidhur me një përgjegjësi të përbashkët institucionale për respektimin dhe zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

4. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas praktikes së GJEDNJ-së

Garancitë e parashikuara në nenin 6 paragrafi 1 të Konventës përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. Një vendim i arsyetuar jo vetëm që u tregon palëve se pretendimet e tyre janë dëgjuar dhe shqyrtuar, por gjithashtu siguron që vendimi të perceptohet si rezultat i zbatimit korrekt të normave ligjore, i zhvillimit të një procedure të drejtë dhe i një vlerësimi të duhur të fakteve, duke u bërë kështu edhe i zbatueshëm në praktikë.

Megjithëse gjykata e rregullt gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi në zgjedhjen e argumenteve dhe pranimin ose refuzimin e provave, ajo ka detyrimin të justifikojë veprimet dhe vendimin e saj përmes një arsyetimi të qartë dhe të plotë. Në këtë drejtim, GjEDNj-së ka theksuar se gjykatat vendore duhet të shpjegojnë arsyet e refuzimit të pranimit të provave të propozuara nga palët. Vetë GjEDNJ-së nuk ka kompetencë për të rivlerësuar bazueshmërinë e refuzimit të provave nga gjykatat vendore, por ky është detyrim ekskluziv i tyre. Prandaj, arsyetimi i dhënë nga gjykata duhet të jetë i tillë që t'u mundësojë palëve përdorimin efektiv të së drejtës së tyre për ankim dhe kontroll të ligjshmërisë. Mungesa e një arsyetimi të mjaftueshëm cenon jo vetëm të drejtën e palëve për të kuptuar vendimin, por edhe garantimin e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës.

4.1. A duhet të arsyetohet secili vendim gjyqësor

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, gjykatat kanë detyrimin të japin arsyetim të mjaftueshëm për aktgjykimet e tyre, si në lëmin civil ashtu edhe në atë penal. Kjo ngrit pyetjen nëse çdo vendim gjyqësor duhet domosdoshmërish të jetë i arsyetuar. Përgjigjja varet nga dispozitat e legjislacionit vendor, por si rregull i përgjithshëm, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, vendimet që lidhen vetëm me menaxhimin e procedurës (p.sh. vendimi për shtyrjen e seancës) nuk kanë nevojë për një arsyetim të detajuar.

Në parim, detyrimi për arsyetim u rezervohet vendimeve përfundimtare dhe atyre vendimeve për të cilat parashihet e drejta e ankesës. Megjithatë, shkalla e arsyetimit ndryshon sipas natyrës së vendimit dhe rrethanave të rastit konkret. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së dytë mund ta përmbushë detyrimin për arsyetim duke u mbështetur ose duke miratuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë kur refuzon ankesën, me kusht që: a) aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ketë qenë i mjaftueshëm për të lejuar palët të përdorin në mënyrë efektive të drejtën e tyre për ankesë, dhe b) vendimi i gjykatës së shkallës së parë të ketë trajtuar çështjet thelbësore që i ishin paraqitur gjykatës së shkallës së dytë.

4.2. A kërkohet sipas GJEDNJ-së që gjykatat të përgjigjen në secilin pretendim të paraqitur nga palët

Neni 6 paragrafi 1 i Konventës i obligon gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk nënkupton detyrimin për t'u përgjigjur në mënyrë të detajuar ndaj çdo pretendimi të palëve. Në këtë drejtim, GJEDNj-së ka theksuar se një vlerësim i përgjithshëm i argumenteve të prezantuara nga palët, kur janë trajtuar çështjet themelore, nuk përbën shkelje të nenit 6 të Konventës. Sipas jurisprudencës së saj, e cila pasqyron parimin e administrimit të duhur të drejtësisë, aktgjykimet duhet të përmbajnë arsye të qarta dhe adekuate mbi të cilat mbështeten. Shkalla e detyrimit për të dhënë arsye ndryshon në varësi të natyrës së aktgjykimit dhe rrethanave të rastit konkret.

Edhe pse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë çdo pretendim dytësor, ato duhet të japin përgjigje të qarta dhe të plota për pretendimet thelbësore të ngritura nga palët në të gjitha fazat e procedurës. Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka përcaktuar se dhënia e arsyeve nënkupton ofrimin e shpjegimeve bindëse dhe të mbështetura ligjërisht, të cilat duhet të përfshijnë faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore të aplikueshme dhe një lidhje logjike ndërmjet tyre. Arsyetimi i vendimit duhet të shfaqë lidhjen ndërmjet vlerësimit të provave dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës, duke garantuar kështu transparencën dhe parandalimin e arbitraritetit në vendimmarrje.

Prandaj, e drejta për një vendim gjyqësor të arsyetuar nënkupton detyrimin e gjykatave të ofrojnë arsye të mjaftueshme si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material. Mos përmbushja e këtij detyrimi, sidomos kur gjykata dështon të japë përgjigje mbi çështjet thelbësore të parashtruara nga palët, përbën shkelje të të drejtës së tyre për t'u dëgjuar dhe të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës. Kjo tregon se arsyetimi i qartë dhe analiza ligjore e bazuar janë kërkesa themelore për çdo vendim gjyqësor, si dhe një element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

4.3. A është e domosdoshme që arsyetimi i vendimeve gjyqësore të jetë i gjatë

Nga aspekti i arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas praktikës së konsoliduar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shpjegimi i arsyeve nuk duhet domosdoshmërisht të jetë i gjatë. Qëllimi është të gjendet një ekuilibër midis koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Për të respektuar parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të tregojë qartë se gjyqtari ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore të paraqitura gjatë procedurës gjyqësore, duke krijuar një balancë ndërmjet fakteve të konstatuara dhe vlerësimit juridik të gjykatës.

Për nga përmbajtja, vendimi gjyqësor duhet të trajtojë çështjet faktike dhe juridike që qëndrojnë në qendër të kontestit. Në aspektin faktik, gjykata shpesh duhet të adresojë edhe kundërshtimet e ngritura ndaj provave, veçanërisht në lidhje me pranueshmërinë e tyre. Një vendim i qartë, i strukturuar mirë dhe koherent jo vetëm që përmbush kërkesat e gjykimit të drejtë, por gjithashtu demonstron se rasti është shqyrtuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Ky standard shërben gjithashtu për t'u mundësuar palëve ndërgjyqësore që të vlerësojnë nëse do të ushtrojnë ankesë dhe, nëse po, të formulojnë një mbrojtje të përshtatshme dhe efektive kundër vendimit. Për rrjedhojë, arsyetimi i qartë i vendimit është një garanci thelbësore si për sigurinë juridike, ashtu edhe për të drejtën e palëve për një proces të rregullt gjyqësor.

4.4. Roli i gjyqtarit në dhënien e drejtësisë

Gjyqtari, si bartësi kryesor i funksionit të dhënies së drejtësisë, luan një rol qendror në zgjidhjen e konflikteve brenda shoqërisë, duke marrë vendime në bazë të ligjit të zbatueshëm dhe të qëndrimeve të paraqitura nga palët, për të vendosur mbi zgjidhjen juridike që duhet të mbizotërojë. Vendimi i gjyqtarit është detyrues jo vetëm për palët, por edhe për shoqërinë në përgjithësi, duke përfshirë subjektet publike dhe private.

Në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar, të garantuar nga neni 31 i KRK-së dhe neni 6 i KEDNJ-së, është konsoliduar tashmë një praktikë gjyqësore, e cila mbështetet gjerësisht në jurisprudencën e

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Ky standard ka rëndësi të veçantë, pasi u mundëson gjyqtarëve të vetë kontrollojnë punën e tyre dhe arsyet mbi të cilat kanë ndërtuar vendimin, ndërsa palëve dhe publikut u jep mundësinë të perceptojnë dhe të verifikojnë themelin e vendimmarrjes gjyqësore dhe drejtësisë së saj.

Përgjegjësia për një aktgjykim të arsyetuar bie, para së gjithash, mbi gjyqtarin, i cili duhet të mbajë llogari për këtë detyrim. Megjithatë, gjyqtarët nuk janë të vetmit nga të cilët varet cilësia e performancës së sistemit gjyqësor. Ajo lidhet gjithashtu me ndërveprimin e subjekteve të tjera, si palët, përfaqësuesit e tyre dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Koncepti i përgjegjësisë së përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është i ngulitur në frymën e KEDNJ-së dhe në parimin e subsidiaritetit mbi të cilin është ngritur. Kjo nënkupton se të gjithë pjesëmarrësit në procedurë mbajnë një përgjegjësi të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për garantimin e sundimit të ligjit.

4.5. Cilësia e vendimit gjyqësor si garanci e procesit të rregullt

Një vendim i arsyetuar gjyqësor është i lidhur ngushtë me nivelin e besimit të publikut në gjyqësor. Detyrimi i gjyqtarit për të shpjeguar arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi i tij është një mekanizëm i përmirësimit të cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore. Ky proces nënkupton vetëkontroll dhe vetëdisiplinë nga ana e gjyqtarit, duke e detyruar atë të shqyrtojë dhe të rishqyrtojë faktet, provat, pretendimet dhe interpretimin e normave ligjore.

Arsyetimi i vendimit mundëson kontrollin e dijes dhe kompetencës së gjyqtarit, duke bërë të mundur identifikimin e gabimeve të mundshme faktike ose juridike, si dhe respektimin e kufijve brenda të cilëve gjyqtari duhet të qëndrojë, veçanërisht kur ushtron kompetenca diskrecionale. Këto kufizime marrin rëndësi të veçantë në sistemin gjyqësor për të siguruar parandalimin e vendimeve arbitrare dhe për të ruajtur integritetin e procesit gjyqësor.

Për këtë arsye, arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element thelbësor për legjitimitetin e tyre, ai u jep palëve dhe publikut një bazë të pavarur për të kuptuar ligjin e zbatuar dhe drejtësinë e vendimit, si dhe krijon standarde për kontrollin e ligjshmërisë nga gjykatat e instancave

më të larta. Vendimet e arsyetuara mirë jo vetëm që kanë më shumë gjasa të pranohen nga palët dhe rrjedhimisht të mos apelohen, por edhe në rast ankese, ato rrisin shanset që gjykata e apelit të konfirmojë drejtësinë e vendimit të shkallës së parë.

Përtej këtyre funksioneve, arsyetimi i vendimit gjyqësor ka rëndësi për disa dimensione të tjera themelore të shtetit të së drejtës, duke përfshirë:

- zbatimin uniform të ligjit dhe forcimin e sigurisë juridike;
- mundësinë e palëve për të mbrojtur veten dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurë;
- administrimin e mirë të drejtësisë;
- garantimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe sundimit të ligjit; dhe
- forcimin e përgjegjësisë së përbashkët të aktorëve gjyqësorë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

5. Ndërlidhja mes vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe gjykimit brenda afatit të arsyeshëm

Për gjyqtarët, ndërlidhja midis vendimit cilësor dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor ka rëndësi të veçantë me rastin e vendosjes në çështjet konkrete. Vlerësimi i cilësisë së vendimeve gjyqësore duhet të bëhet mbi bazën e parimeve themelore të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (në tekstin e mëtejmë: KKGJE), përmes Opinionit nr. 11, ka theksuar se "për të arritur vendime cilësore në një mënyrë që është në përpjesëtim me interesat në fjalë, gjyqtarët duhet të veprojnë brenda një kuadri legjislativ dhe procedural që u mundëson atyre të vendosin lirisht dhe të disponojnë në mënyrë efektive burimet kohore të nevojshme për t'u marrë siç duhet me rastin". Në këtë drejtim, KKGJE i referohet diskutimit për "menaxhimin e rastit" në Opinionin e saj nr. 6 (2004). Në këtë aspekt, mund të merret për bazë edhe praktika e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (në tekstin e mëtejmë: CEPEJ), i cili ka zhvilluar mjete të dobishme për menaxhimin e rasteve, duke përfshirë trajtimin e tyre brenda një kohe të arsyeshme.

Sa i përket gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, GJEDNJ, si pikënisje të fillimit të periudhës përkatëse, ka përcaktuar momentin e paraqitjes së padisë para gjykatës kompetente. Nga ky moment fillon të rrjedhë afati

për gjykim të arsyeshëm. Kriteri "kohë e arsyeshme" dhe "periudha që merret në konsideratë" në procedurë civile është theksuar në rastin *Poiss v. Austria*, në të cilin GJEDNJ ka përcaktuar se koha e arsyeshme sipas nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së normalisht fillon nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë. Sa i përket përfundimit të periudhës, ajo zakonisht mbulon të gjithë procedurën përkatëse, duke përfshirë procedurën para gjykatës së apelit dhe deri në vendimin përfundimtar për zgjidhjen e kontestit. Pra, kriteri i "kohës së arsyeshme" shtrihet në të gjitha fazat e procedurës që synon zgjidhjen e kontestit, duke mos përjashtuar fazat pas marrjes së vendimit përfundimtar. Në këtë drejtim, edhe përmbarimi i një vendimi gjyqësor duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e procedurës për qëllime të llogaritjes së periudhës përkatëse.

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e kritereve të mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit, sjellja e autoriteteve përkatëse dhe rreziku që paraqitet për palën në kontest. Një përcaktim të tillë GJEDNJ e ka elaboruar përmes rastit *Frydlender v. France*, ku është theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes duhet të vlerësohet në rrethana konkrete, duke u bazuar në këto kritere.

Sa i përket kompleksitetit të çështjes, ky kriter merr parasysh të gjithë faktorët që lidhen me të: natyra e interesave të përfshira, rëndësia e fakteve, rëndësia e zgjidhjes juridike, numri i palëve të paditura dhe dëshmitarëve, elementet ndërkombëtare, lidhja me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedurë. Sa i përket sjelljes së kërkuesit, ky kriter lidhet me mënyrën se si palët janë sjellë ndaj procedimit, diligjencën e treguar për përfundimin e procesit, pengesat e krijuara prej tyre dhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, ky kriter duhet vlerësuar rast pas rasti nga gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë në mënyrë aktive me autoritetet për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që mund të çojnë në kundërshtim me interesat e tij.

Lidhur me sjelljen e autoriteteve, GJEDNJ-së ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen nga autoritetet gjyqësore ose administrative. Jurisprudenca ka vënë në dukje shembuj si: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që shkakton vonesa të panevojshme, shtyrje të pajustifikuara të

seancave, ndërprerje të kundërligjshme të procesit, vonesa nga agjencitë publike në dorëzimin e provave të kërkuara apo transferimi i çështjes nga një gjykatë në tjetrën. Gjykimi i arsyeshëm, sipas GJEDNJ-së, nuk lidhet vetëm me veprimet e palëve, pasi edhe në sistemet ku palët janë zotër të procesit (dominūs litis), gjykata nuk lirohet nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm siç kërkohet nga neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së.

Sa i përket kriterit të katërt, që lidhet me rrezikun për palën, GJEDNJ-së ka kategorizuar çështje që për nga natyra e tyre kërkojnë një ekspedim të veçantë. Kujdes i veçantë kërkohet në çështjet që lidhen me gjendjen statusore. Në rastin *Mikulić v. Croatia*, gjykata theksoi se, duke pasur parasysh të drejtën e kërkuesit për vërtetimin e atësisë dhe shmangien e pasigurisë për identitetin prindëror, autoritetet duhet të veprojnë me kujdes të veçantë. Po ashtu, kujdestaria e fëmijëve kërkon zgjidhje të shpejtë, megjithatë GJEDNJ-së nuk e konsideron shkelje të afatit të arsyeshëm kur për çështjen nevojitet një periudhë më e gjatë për marrjen e provave apo ekspertizave (shih rastin *Hokkanen v. Finland*, ku procedura prej 18 muajsh në tri instanca u konsiderua e arsyeshme).

Gjithashtu, kontestet nga marrëdhëniet e punës kërkojnë trajtim të përshpejtuar, pavarësisht nëse kanë të bëjnë me qasje në një profesion, pushim nga puna, transferim ose rikthim në vendin e punës. Po ashtu, kujdes i jashtëzakonshëm duhet të ushtrohet në çështjet që lidhen me sëmundje të pashërueshme ose jetëgjatësi të kufizuar.

Në përfundim, përfshirja e kritereve të afatit të arsyeshëm në vendimet gjyqësore rrit cilësinë e vendimmarrjes dhe siguron zbatim të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të palëve.

6. A ekzistojnë mjete juridike për procedura të tejzgjatura gjyqësore në sistemin e brendshëm juridik

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (KRK), sikurse edhe neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së, përcakton shprehimisht garancinë procedurale për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Parimi i gjykimit të shpejtë është parashikuar gjithashtu edhe me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). Megjithatë, mund të vlerësohet në mënyrë kritike se, ndonëse LPK-së ka shpallur parimin

e gjykimit të shpejtë dhe pa zvarritje, ai nuk përmban mjete procedurale të mjaftueshme për të mundësuar arritjen e këtij qëllimi.
Në këtë aspekt, GJEDNJ-së ka filluar të shqyrtojë procedurat e tejzgjatura gjyqësore nga këndvështrimi i të drejtave që burojnë nga Konventa, duke përfshirë: (a) të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (neni 6 paragrafi 1), dhe (b) të drejtën për mjet juridik efektiv kundër shkeljeve të së drejtës së parashikuar me Konventë. Edhe shtetet tjera me trashëgimi nga sistemi socialist janë përballur me probleme të ngjashme për garantimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë drejtim, në rastin *Lukenda v. Slovenia*, GJEDNJ-së konstatoi se sistemi ligjor slloven nuk ofronte mjete juridike efektive kundër shkeljes së kësaj të drejte.
Sa i përket këtij garancioni, GJEDNJ-së ka theksuar domosdoshmërinë e ekzistimit të mjeteve juridike që synojnë përshpejtimin e procedurave dhe parandalimin e zgjatjeve të panevojshme, duke shmangur kështu shkelje të përsëritura për llojin e njëjtë të procedurave. Në këtë linjë, në rastin *Scordino v. Italy*, përveç kërkesës për kompensim lidhur me shpronësimin e tokës, ishte ngritur edhe pretendimi për kohëzgjatjen e procedurës, e cila kishte zgjatur tetë vite e gjysmë në dy shkallë gjyqësore.
Lidhur me mjetin efektiv juridik, GJEDNJ-së ka theksuar se shkeljet mund të adresohen përmes mjeteve të ndryshme, ku disa shtete zgjedhin të kombinojnë mjetet përshpejtuese me ato kompensuese. Prezantimi i vetëm një mjeti kompensues nuk konsiderohet joefektiv, përderisa është në përputhje me KEDNJ-së. Ekziston një supozim i fortë, por i kundërshtueshëm, se procedurat tepër të gjata shkaktojnë dëm jomaterial, megjithatë niveli i kompensimit varet nga efektiviteti dhe karakteristikat e mjetit juridik vendor. Ligjet që synojnë mbrojtjen e kësaj të drejte parashohin kryesisht kompensim financiar për dëmin jomaterial, zakonisht në shumën prej 3000 deri 5000 euro. Përveç kompensimit monetar, pala mund të kërkojë nga gjykata që të publikojë vendimin me të cilin konstatohet shkelja e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
Në sistemin juridik të Kosovës ende nuk ekziston një ligj i veçantë që garanton mbrojtjen e të drejtës për një proces gjyqësor të përshpejtuar. Kohëve të fundit është ndërmarrë nisma nga Ministria e Drejtësisë për

hartimin e Projektligjit për realizimin e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, qëllimi i të cilit është mbrojtja e kësaj të drejte procedurale.

Megjithatë, edhe pse nuk ka ende një ligj të tillë të miratuar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin KI.210/24 të datës 10 mars 2025 ka vendosur të deklaroj kërkesën të pranueshme, ku ka konstatuar shkelje të nenit 31 të KRK-së në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së lidhur me gjykimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Rrjedhimisht gjykatat e rregullta kanë për detyrim të vendosin brenda afatit të arsyeshëm duke marr parasysh kriteret e përcaktuara sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të lartcekur, e duke marr parasysh edhe kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

7. E drejta e qasjes në gjykatë

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e paraqitura, ka konstatuar shkelje të dispozitave të LPK-së, si pasoj e mungesës së arsyetimit ligjor, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse parashtruesit të kërkesës i është mohuar “e drejta e qasjes në gjykatë”, dhe si pasoj ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale.

E drejta e qasjes në gjykatë është një aspekt i cili është i mishëruar në përmbajtjen e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Çdokush ka të drejtë që të inicioj padi për të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykatë. Në këtë mënyrë neni 6 paragrafi 1 mishëron "të drejtën në gjykatë", aspekt i të cilës është e drejta e qasjes në gjykatë, që nënkupton të drejtën për të iniciuar procedurë gjyqësore para gjykatave për çështje juridike civile. Pra, kësaj të drejtë i shtohen garancitë e parashikuara në nenin e lartcekur për sa i përket organizimit dhe përbërjes së gjykatës dhe zhvillimit të procesit gjyqësor. Nga kjo rezulton se e tëra përbën të drejtën për një gjykim të drejtë. E drejta e qasjes në gjykatë duhet të jetë praktike dhe efektive. Që e drejta e qasjes të jetë efektive, një individ duhet “të ketë një mundësi të qartë dhe praktike për të sfiduar një vendim që përbën ndërhyrje në të drejtat e tij.

Mirëpo, e drejta në gjykatë dhe e drejta për qasje në gjykatë nuk janë të karakterit absolut. Sipas praktikes gjyqësore të GJEDNJ-së, kjo e drejtë mund t'i nënshtrohet kufizimeve të cilat nuk guxojnë të zvogëlojnë qasjen në gjykatë në atë mënyrë apo deri në një masë që cenojnë vete thelbin e se drejtës. Kufizimet e tilla nuk do të jenë të arsyetuara, nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre. Një kufizim i të drejtës se qasjes në gjykatë në sistemin tonë procedural mund të merret shembulli i ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik – revizionit i cili ndërlidhet me vlerën e kontestit (ratione valoris). Në këtë drejtim, parimet e përgjithshme të qasjes në gjykatat me të larta dhe kufizimet ratione valoris në këtë aspekt janë trajtuar edhe nga GJK-së, dhe GJEDNJ-së.

GJEDNJ, në rastin *Zubac v. Croatia*, në lidhje me zbatimin e kufizimeve ligjore ratione valoris për qasje në gjykatat me të larta, zhvilloi një test me tri kritere, përmes të cilit duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen: 1) parashikueshmëria e kufizimeve; 2) çështja nëse parashtruesi apo shteti duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të kryera gjatë procedurës; dhe 3) çështja e "formalizmit të tepruar" në zbatimin e kufizimeve.

Në lidhje me kriterin e parë, GJEDNJ-së specifikoi se: a) çështja e mjetit ligjor ne këtë rast ishte e parashikueshme nga këndvështrimi i palëve ndërgjygjese. Në këtë kontekst, GJEDNJ-së shtoj se, b) supozimi se kufizimi i qasjes është i parashikueshëm plotësohet nëse ka praktikë koherente gjyqësore; dhe c) zbatim konsistent të kësaj praktike, dhe në vijim po ashtu vlerësoj se, d) merr parasysh qasjen e parashtruesit në praktiken përkatëse gjyqësore, dhe e) nëse i njëjti përfaqësohet nga një avokat i kualifikuar.

Në lidhje me kriterin e dytë GJEDNJ-së theksoj se, duhet të përcaktohet nëse parashtruesi ka qenë i përfaqësuar gjate procedurave, si dhe nëse ai ka treguar zellin e duhur në ndërmarrjen e veprimeve përkatëse procedurale, duke vijuar me përcaktimin e çështjes nëse gabimet mund të ishin shmangur që në fillim dhe nëse gabimet mund t'i atribuohen kryesisht parashtruesit apo autoriteteve kompetente.

Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht formalizmit të tepruar, GJEDNJ-së theksoi se formalizmi i tepruar nga ana e gjykatave mund të jetë në kundërshtim me të drejtën për qasje në gjykatë. Në këtë kuptim,

GJEDNJ-së gjithashtu ka theksuar se, "megjithatë, e drejta për qasje ne gjykate konsiderohet se është dëmtuar në atë moment kur rregullat pushojnë te jenë në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe për pasojë krijojnë një barriere e cila i pamundëson palëve ndergjygjese që rasti i tyre të gjykohet në merita nga gjykata kompetente." Rrjedhimisht, natyra e kufizimit ratione valoris e bazuar në dispozitat e LPK-së, bazohet në paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së. Në këtë mënyrë, në momentin e arritjes së këtij pragu, Gjykata Supreme bazuar në nenin 223 të LPK-së, mund të anulojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët dhe të kthejë çështjen në rivendosje në gjykatën e shkallës më të ulët apo edhe të anulojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët dhe për pasojë të refuzojë kërkesëpadinë e palëve. Pra, mund të themi se, në kuptim të administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, aplikimi i rregullave formale dhe procedurale që ndërlidhen me lejueshmërinë e revizionit është i një rëndësie të tillë që i shërben sigurisë juridike gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore para Gjykatës Supreme.

Vlen të theksohet gjithashtu se, kriteri i kufizimit ratione valoris sa i përket parashtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik - revizionit, është shfuqizuar nga shumë ligje procedurale evropiane, dhe kjo për arsye të mundësimit të qasjes se palëve në gjykatë, mirëpo duke pas parasysh çdoherë plotësimin e kritereve tjera formale të palëve për qasje në gjykatë.

Po ashtu e drejta për qasje në gjykatë mund të cenohet në rastet që, ndër të tjera, ndërlidhen me:

- afatet kohore;
- kufizimet ratione valoris për qasje në Gjykatën Supreme;
- pengesat procedurale që pengojnë ose kufizojnë mundësitë e qasjes në gjykatë, e që mes tjerash ndërlidhen me (a) mos pagesën e taksës gjyqësore; dhe (b) autorizimin e përfaqësuesit ligjor, si në procedurën civile dhe atë penale;
- mos shqyrtimin e akteve administrative të autoriteteve publike;
- mos shqyrtimin e kërkesëpadive/ankesave të palëve në procedurë gjyqësore; dhe
- kufizimet procedurale që ndërlidhen me parimin e imunitetit sovran të shteteve.

Duhet theksuar se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Yagtzilar dhe të Tjerët kundër Greqisë*, konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, në lidhje me të drejtën e qasjes në gjykatë dhe kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore, si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, që garanton të drejtën për gëzim paqësor të pronës, duke konstatuar:

- Kufizim joproporcional në të drejtën e tyre për qasje në gjykatë - thelbi i të drejtës së tyre për gjykatë u dëmtua;
- GJEDNJ - kishte vënë theks që procedurat në fjalë kishin filluar në vitin 1933; që shteti kishte ngritur disa herë, që nga viti 1979, pa sukses, kundërshtimin se kërkesa ishte e parashkruar; vetëm në vitin 1995 – ndërkohë që një vit më parë Gjykata e Shkallës së Parë kishte vlerësuar shumën e kompensimit të detyrueshëm për aplikantët, Gjykata e Apelit mbështeti për herë të parë kundërshtimin e shtetit dhe konstatoi se e drejta e të aplikuarve për kompensim kishte skaduar, duke theksuar se ajo kishte qenë e parashkruar që nga viti 1971;
- GJEDNJ - kishte theksuar që ajo nuk ka juridiksion të vendosë për kufizimin e veprimeve sipas ligjit nacional dhe/ose meritat e rastit bazuar në ligjin nacional; megjithatë, kishte theksuar faktin që aplikantët u njoftuan se veprimi i tyre ishte i parashkruar në një fazë kaq të vonë të procedurave, të cilat ata i kishin zhvilluar me mirëbesim dhe me zell të mjaftueshëm, duke i privuar ata njëherë e përgjithmonë nga çdo mundësi për të kërkuar të drejtën e tyre për kompensim për ullishtën e tyre, e cila u zaptua fillimisht dhe më pas u shpronësua nga shteti Grek.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në rastin KI.54/21, kishte konstatuar: shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse parashtruesit të kërkesës i është mohuar "e drejta e qasjes në gjykatë"- aspektet që ndërlidhen me afatet kohore, ndër të tjera kishte vlerësuar:

- Parimet relevante bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së:
- Administrimi i mirëfilltë i drejtësisë – rregullat që përcaktojnë hapat formal që duhet të ndërmerren dhe afatin kohor që duhet të respektohet në parashtrimin e një ankese kanë për qëllim

administrimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe të njëjtat duhet të shqyrtohen në pajtueshmëri me parimin e sigurisë juridike;

- Karakteristikat e veçanta të rastit – shqyrtimi në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në rrethanat e rastit konkret;
- Ndërveprimi në mes formalizmit të tepruar dhe fleksibilitetit - aplikimi i rregullave procedurale, duhet të mënjanoj sikurse formalizmin e tepruar që do t'ia pamundësonte procedurën e drejtë ashtu edhe fleksibitetin e tepruar që do t'i bënte kriteret procedurale të përcaktuara me ligj të pavlera;
- Sipas Gjykatës - konstatimi i Gjykatës Supreme se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është paraqitur jashtë afatit ligjor, pas një dekade procedurash në të cilat padia e parashtruesit të kërkesës ishte vendosur e rivendosur në merita përfshirë nga vet Gjykata Supreme, nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

8. E drejta për vendim të arsyetuar dhe vendimmarrja arbitrare

E drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor është e mishëruar në përmbajtjen e KEDNJ-së, dhe që ka për qellim mbrojtjen e individit nga arbitrariteti. Një vendim gjyqësor i gjykatës vendore duhet të përmbajë arsye që janë të mjaftueshme për t'ju përgjigjur aspekteve esenciale të argumenteve faktike dhe ligjore, e po ashtu edhe materiale dhe procedurale të palës në kontest. Cilësia e një vendimi gjyqësor varet kryesisht nga cilësia e arsyetimit të tij. Pra, arsyetimi i duhur është një domosdoshmëri imperative që nuk duhet neglizhuar në interes të shpejtësisë. Mirëpo, arsyetimi i duhur kërkon që gjyqtarët të kenë kohën e duhur për të përgatitur dhe arsyetuar vendimet e tyre. Arsyet e dhëna në vendim, jo vetëm që e bëjnë vendimin më të lehtë për t'u kuptuar dhe pranuar nga palët ndërgjyqëse, por është mbi të gjitha një mbrojtje kundër arbitraritetit. Së pari, kjo e detyron gjyqtarin t'i përgjigjet parashtresave të palëve dhe të specifikojë pikat që justifikojnë vendimin dhe që bëjnë

atë të ligjshëm; dhe së dyti, i mundëson shoqërisë të kuptojë me mirë funksionimin e sistemit gjyqësor.

Arsyet e vendimit duhet të jenë të qëndrueshme, konsistente, të qarta, jo dy-kuptimore dhe jo kontradiktore. Me saktësisht, duhet të lejojnë lexuesin të ndjekë zinxhirin e arsyetimit që e ka udhëhequr gjyqtarin për një vendimmarrje. Gjithashtu, arsyetimi duhet të pasqyrojë pajtueshmërinë e gjyqtarëve me parimet e shpallura nga GJEDNJ, përkatësisht respektimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtës për një gjykim të drejtë. Kur vendimet kanë të bëjnë me liritë individuale (p.sh., urdhër-arrest) ose që mund të ndikojnë në të drejtat e individëve ose pasurive të tyre, (p.sh. kujdestaria e përkohshme e një fëmije ose sekuestrimi i llogarive bankare), në këto raste, kërkohet një deklaratë e përshtatshme e arsyeve. Pra, deklarata e arsyeve duhet t'i përgjigjet parashtresave të palëve. Kjo është një garancion thelbësor sepse u lejon palëve ndërgjyqëse të sigurohen se parashtresat e tyre janë shqyrtuar dhe për rrjedhojë gjyqtari i ka marrë parasysh ato. Çka është edhe me rëndësi, arsyetimi duhet të jetë i lirë (mos të përmbajë) çfarëdo vërejtje fyese ose armiqësore ndaj palëve në kontest.

Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhënia e arsyeve në vendim varet nga argumentet e ndryshme të parashtruara nga secila palë, si dhe nga dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe opinionet ligjore, si dhe nga praktikat e ndryshme në lidhje me hartimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të shteteve të ndryshme. Për të respektuar parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të tregojë se gjyqtari ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë parashtruar para tij. Pra, funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për me tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për tu ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e apelit. Neni 6 i KEDNJ-së, dhe neni 31 i KRK-së, i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si detyrim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të palës në kontest. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshoje sipas natyrës se vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, inter alia, shumëllojshmërinë e parashtresave të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes se

vendimeve. Prandaj, pyetja nëse një gjykatë ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i KEDNJ-së, mund të përcaktohet vetëm në varësi të rrethanave të secilit rast individual.

Lidhur me këtë, e drejta për gjykim të drejtë mund të jetë efektive, vetëm nëse gjykata është e detyruar të arsyetoj vendimet e saj, e që është gjithashtu një garancion vital kundër arbitraritetit. Sipas KEDNJ-së, nëse nuk jepen arsye për vendimin ose nëse arsyet e dhëna bazohen në një gabim të qartë faktik ose ligjor të kryer nga gjykata, kjo pashmangshmërisht rezulton në "mohim të drejtësisë, " e për rrjedhojë në gjykim arbitrar. GJEDNJ-së në disa raste është ballafaquar jo me mungesë të plotë të arsyeve, por me inkoherencë të hapur të arsyeve të dhëna në aktgjykim, dhe nga gjykata kjo është konsideruar si arbitraritet. Në rastin Tatishvili v. Russia, GEDNJ-së, ka riafirmuar se, arsyetimi dukshëm i mangët nga gjykata e shkalles se parë, dhe aprovimi i mëvonshëm i një arsyetimi të tillë joadekuat nga gjykata e apelit, nuk përmbush kërkesat e një gjykimi të drejtë, dhe rezulton në vendimmarrje arbitrare.

9. A ekzistojnë divergjenca në praktiken gjyqësore

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e paraqitura, ka konstatuar shkelje të dispozitave të LPK-së, dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, si dhe praktikë jo unike, lidhur me vendimmarrjen, për çështje pothuajse identike.

Ndryshimet në praktiken gjyqësore në vend, kërkesa e sigurisë juridike dhe mbrojtja e pritjeve legjitime nuk përfshijnë të drejtën për një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Zhvillimi i praktikes gjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë, pasi dështimi për të mbajtur një qasje dinamike dhe evolutive do të parandalonte çdo reformë apo përmirësim të sistemit. Sipas praktikës se GJEDNJ-së, Gjykata Supreme mund të shmang zbatimin unik të praktikes se konsoliduar, mirëpo çdoherë duhet të jep arsye bindëse se përse ka vendosur shmangien nga praktika e konsoliduar e gjykatave me të ulëta dhe vet praktikes se saj, në rast se e drejta e individit për vendim

të arsyetuar do të shkelej. Pra, gjykata (kryesisht Gjykata Supreme) është e detyruar për të dhënë arsye bindëse, duke shtjelluar mjaftueshëm shkakun e shmangies nga praktika e saj e mëparshme, gjegjësisht faktin e ndryshimit të aktgjykimeve të gjykatave të instancës me të ulet dhe të qëndrimeve të saj juridike.

Sa i përket çështjes së divergjencës në praktikën gjyqësore, GJEDNJ-së ka theksuar rëndësinë e vendosjes së mekanizmave për të siguruar qëndrueshmëri në praktikën e gjykatave dhe unifikim të praktikës gjyqësore. Pra, duke qenë se praktika gjyqësore nuk është e pandryshueshme, por përkundrazi, në thelb evolutive, GJEDNJ-së vlerëson se parimi i administrimit të mirë të drejtësisë nuk mund të merret për të imponuar një kërkesë strikte të konsistencës së praktikës gjyqësore. Megjithatë, arritja e konsistencës së zbatimit të ligjit mund të marrë kohë, dhe për rrjedhojë periudhat e praktikes gjyqësore konfliktuale mund të tolerohen, pa cenuar sigurinë juridike. Mirëpo, për me tepër, lind pyetja se në cilat raste lejohet shmangia nga praktika gjyqësore? Ekzistojnë rrethanat në të cilat mund të lejohet shmangia nga një praktikë gjyqësore e konsoliduar, e që mund të jetë si rezultat i a) reformave; ose b) evoluimit të praktikes gjyqësore, me qellim të administrimit me të mirë të drejtësisë, ashtu siç kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së.

Tek ne, edhe pse praktika gjyqësore nuk është formalisht e njohur si burim i se drejtës, në praktikë, praktika gjyqësore e konsoliduar është një autoritet i rëndësishëm, dhe gjykatat e ulëta janë të prirura për ta përcjellë pozicionin e Gjykatës se Apelit, dhe të Gjykatës Supreme. Një nder funksionet e Gjykatës Supreme është gjithashtu të garantoj uniformitetin e praktikes gjyqësore të gjykatave. Në këtë drejtim, argumenti i precedentit ka fituar një rëndësi kushtetuese ne vendin tonë, deri në atë masë saqë shmangia në mënyrë arbitrare nga praktika gjyqësore (e konsoliduar, uniforme), mund të rezultojë në shkeljen e garancioneve procedurale kushtetuese, dhe për rrjedhoje të ngritët kërkesë për shqyrtim gjyqësor kushtetues para gjykatës kushtetuese. Është një nder elementet e gjykimit të drejtë që gjyqtari nuk duhet në mënyrë arbitrare (pa dhënë arsye të detajuara) të shmang praktiken e konsoliduar gjyqësore, dhe në të kundërtën nëse një shmangie e tillë ndodh, gjykata kushtetuese përmes ankesës kushtetuese mund të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin dhe të kthej çështjen në rivendosje.

Duhet theksuar se zbatimi uniform i ligjit dhe siguria juridike janë thelbësore për parimin e barazisë para ligjit. Disa divergjenca në interpretim mund të pranohen si tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet gjykatash. Gjykatat e ndryshme mund të arrijnë kështu në përfundime të ndryshme, por megjithatë racionale dhe të arsyetuara në lidhje me të njëjtën çështje ligjore të ngritur nga rrethana të ngjashme faktike. Konsideratat e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë janë një pjesë e qenësishme e sundimit të ligjit. Në një shtet të sunduar nga ligji, palët në një rast me të drejtë presin që të trajtohen si të tjerët dhe mund të mbështeten në vendimet e mëparshme në raste të krahasueshme, në mënyrë që të mund të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Nga ana tjetër, kur një gjykatë vendos të largohet nga praktika gjyqësore e mëparshme, kjo duhet të shprehet qartë në vendimin e saj.

Nga arsyetimi duhet të rezultojë se gjyqtari e dinte se praktika gjyqësore e vendosur për këtë çështje ishte e ndryshme, dhe duhet të shpjegohet tërësisht pse qëndrimi i aplikuar më parë nuk duhet të qëndrojë.

10. Sa ndikon gjendja emocionale e gjyqtareve në cilësinë e vendimmarrjes

Të qenit pjesë e sistemit gjyqësor është stresues, dhe gjyqtarët i nënshtrohen një sërë faktorësh stresues. Edhe pse shumë gjyqtarë besojnë se puna e tyre shpaguhet, megjithatë pozita e tyre shoqërohet dhe i nënshtrohet ekspozimit ndaj një mori faktorësh stresues të mundshëm. Gjyqtarët mund të përjetojnë stres kur marrin vendime që ndikojnë në jetën e pjesëmarrësve në gjykatë dhe familjeve të tyre, shoqërinë dhe në vendimet e ardhshme që mund ta përdorin vendimin e njëjtë si precedent (praktika gjyqësore). Gjyqtarët janë gjithashtu vazhdimisht nën "mikroskopin" e publikut, pasi vendimet e tyre mund të paraqesin mundësinë për kritika nga media dhe komuniteti, një pasojë që do të prekte gjyqtarët me mandat fillestar më shumë sesa gjyqtarët me mandat të përhershëm. Sipas studimeve supozohet se emocionet janë irracionale dhe se në këtë kontekst kanë një efekt shkakësor në vendimmarrje.

Pra, mënyra se si gjyqtarët ndër veprojnë me publikun, avokatët, palët ndërgjyqëse, porotët, dëshmitarët, personelin e gjykatës dhe njëri tjetrin,

ka rëndësi. E tërë kjo ka implikime në vendimmarrjen e gjyqtarit. Thënë shkurt, gjendja emocionale ka pasoja reale për mirëqenien e gjyqtarëve, cilësinë e drejtësisë në raste individuale, qëndrueshmërinë e gjyqësorit si institucion dhe nivelin e respektit me të cilin publiku e konsideron atë institucion. Lidhur me këtë, gjatë karrierës profesionale të një gjyqtari, ai/ajo mund të përballet me situata që mund të krijojnë një barrë të vërtetë psiko-sociale. Përveç sulmeve të mundshme, ai duhet të përballet me situata ose imazhe që mund të jenë shumë të dhunshme (pornografi për fëmijë, forma të ndryshme të keqtrajtimit dhe braktisjes se fëmijëve, etj.,) dhe, në baza ditore, edhe me situatën e përballjes me palët ndërgjyqëse të cilat i nënshtrohen gjykimit. Në situata të tilla, gjyqtari mund ta gjejë veten të pafuqishëm nga izolimi i tij/saj dhe nga fakti se parimi i paanshmërisë kërkon që emocionet të përjashtohen nga procesi i vendimmarrjes.

Studimet e kryera në botën gjyqësore tregojnë se, gjyqtarët përballen me punë reale emocionale që gjeneron stres në jetën e tyre të përditshme. Në përgjithësi, cilësia e vendimit gjyqësor është e lidhur ngushtë me cilësinë e mjedisit të punës së gjyqtarit. Kontrolli emocional i gjyqtarit dhe aftësia për të menaxhuar stresin e shkaktuar (si dhe stresin organizativ) do të influencoj imazhin e tij për drejtësinë. Prandaj, kushti i "aktgjykimi të mirë" qëndron edhe në "mirëqenien" e gjyqtarit. Kjo është arsyeja pse duhet të adresohet kjo çështje në kontekstin e politikave publike për efikasitetin dhe cilësinë e sistemit gjyqësor.

11. Të drejtat dhe detyrimet e gjykatave të rregullta në fushën e aplikimit të drejtpërdrejt të normave kushtetuese, si dhe parimet kryesore për interpretimin e KENDJ-së

Bazuar në KRK-në, gjykatat e rregullta kanë të drejtë dhe detyrim të drejtpërdrejtë të aplikojnë dhe interpretojnë së pari normat kushtetuese pastaj dispozitat ligjore në fuqi, duke përdorur dhe referuar po ashtu në jurisprudencën e GjEDNj-së.

Në lidhshmëri me ketë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës përmes aktgjykimit në rastin KI.207/19, ka bërë vlerësimi lidhur me parimet si në vijim:

- Statusi i instrumenteve ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës në sistemin juridik të Kosovës;
- Të drejtat dhe obligimet e gjykatave të rregullta në fushën e aplikimit të drejtpërdrejt të normave kushtetuese.

Nëse i referohemi aktgjykimit të cituar rezulton se:

- Gjykatat e rregullta kanë të drejtë dhe për më tepër obligim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjykojnë, fillimisht sipas Kushtetutës, e pastaj sipas ligjit;
- Gjykatat e rregullta janë të obliguara që të interpretojnë normat ligjore në harmoni me normat kushtetuese;
- Roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës nuk ndikon në juridiksionin dhe autorizimet që i janë dhënë Gjykatës Kushtetuese sipas 112 të Kushtetutës, si autoritetit përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën;
- Gjykatat e rregullta "kanë të drejtë" të referojnë çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, mirëpo, Kushtetuta në asnjë mënyrë nuk i obligon gjykatat e rregullta që patjetër t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese sa herë që mund të lind një pyetje e tillë në nivel të gjykatës së rregullt (e drejtë diskrecionale por jo një detyrim kushtetues);
- Kushtetuta ia njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme ligjore në harmoni me një normë kushtetuese dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të normës kushtetuese, por kompetencën e "shfuqizimit" të normave ligjore si të papajtueshme me Kushtetutën, kjo e fundit nuk e ka paraparë si kompetencë për gjykatat e rregullta;
- Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm në Republikën e Kosovës me autorizim ekskluziv kushtetues për të shfuqizuar një ligj ose normë ligjore si dhe për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me të;
- Gjykata Kushtetuese është organ publik me autorizim ekskluziv kushtetues për të interpretuar përfundimisht Kushtetutën dhe për të interpretuar përfundimisht përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën - gjë që nënkupton se para saj edhe autoritetet e tjera publike mund të angazhohen në interpretim kushtetues.

Ndërsa nëse i referohemi praktikës gjyqësore të GjEDNj-së janë përcaktuar parimet kryesore për interpretimin e KENDJ, sipas së cilës:

- Doktrina e Instrumentit të Gjallë - KEDNJ interpretohet në dritën e kushteve të sotme, duke siguruar që dispozitat e saj evoluojnë me ndryshimet shoqërore;
- Parimi i Efektivitetit (Të Drejta Praktike dhe Efektive) - KEDNJ duhet të interpretohet për të siguruar që të drejtat janë praktike dhe efektive, jo teorike apo iluzore;
- Koncepte Autonome - disa terma të KEDNJ (p.sh., "akuza penale", "jeta familjare") u jepen kuptime autonome nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të pavarura nga përkufizimet e ligjit vendas, për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm;
- Proporcionaliteti dhe Nevoja - kufizimet në të drejta duhet të jenë proporcionale me një qëllim legjitim dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike;
- Margjina e Vlerësimit - shtetet kanë një shkallë diskrecioni në zbatimin e të drejtave të KEDNJ, veçanërisht kur çështjet morale, kulturore ose sociale ndryshojnë, subjekt i mbikëqyrjes nga Gjykata Evropiane;
- Interpretimi Dinamik dhe Evolutiv - KEDNJ interpretohet në mënyrë progresive për të pasqyruar përparimet në standardet e të drejtave të njeriut dhe konsensusin në zhvillim midis shteteve anëtare;
- Përputhshmëria me Objektin dhe Qëllimin e KEDNJ - interpretimet duhet të jenë në përputhje me qëllimin kryesor të KEDNJ për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit;

12. Përmbarimi i aktgjykimeve dhe e drejta për gjykim të drejtë

Përmbarimi i aktgjykimeve dhe e drejta për gjykim të drejtë janë dy koncepte kyçe të së drejtës, të cilat lidhen ngushtë me parimin e sundimit të ligjit dhe me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm përbën një nga shtyllat themelore të shtetit të së drejtës. Kjo e drejtë nuk përfundon me shpalljen e

aktgjykimit, por shtrihet edhe në fazën e zbatimit të tij, përkatësisht në përmbarimin e vendimit gjyqësor.
Përmbarimi përfaqëson fazën përfundimtare të procesit gjyqësor, ku një aktgjykim i formës së prerë (i pa atakuar) ekzekutohet përmes mjeteve ligjore, të cilat zbatohen nga përmbaruesit privatë ose gjykatat kompetente, sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore të Republikës së Kosovës. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e garantuar me Nenin 31 të KRK dhe Nenin 6 të KENDJ. Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, përmbarimi i vendimeve gjyqësore është konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, duke qenë se zbatimi i vendimit është thelbësor për të siguruar një qasje efektive në drejtësi.
Përmbarimi i aktgjykimeve nuk është thjesht një procedurë teknike, por një garanci thelbësore që vendimet e gjykatave të mos mbesin vetëm në letër, por të marrin formë të zbatueshme në realitetin juridik dhe shoqëror. Pa një mekanizëm funksional dhe efikas të përmbarimit, procesi gjyqësor do të ishte i paplotë dhe i pamjaftueshëm. Për më tepër, përmbarimi kontribuon në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit, pasi vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për të gjitha palët, pavarësisht nga statusi apo natyra e tyre juridike. Në këtë kontekst, përmbarimi shpreh edhe parimin e barazisë para ligjit, duke siguruar që asnjë individ apo institucion nuk i shmanget detyrimit për të respektuar dhe zbatuar vendimet e gjykatave, dhe duke ndaluar çdo formë të privilegjimit apo imunitetit të padrejtë. Në përfundim, lidhja mes përmbarimit të aktgjykimeve dhe së drejtës për gjykim të drejtë është jo vetëm logjike dhe funksionale, por edhe kushtetuese. Përmbarimi është hallka përmbyllëse e garantimit të së drejtës për drejtësi efektive dhe një mjet esencial për jetësimin e të drejtave të fituara përmes gjyqësorit.
Neni 31 i KRK, garanton të drejtën për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe publik, duke siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave themelore të individit gjatë tërë procesit gjyqësor. Kjo dispozitë kushtetuese përbën një nga themelet e rendit juridik demokratik dhe i imponon shtetit detyrimin që çdo person, pavarësisht nëse paraqitet në cilësinë e paditësit apo të padituri, të trajtohet me barazi të plotë dhe paanshmëri të garantuar nga ana e organeve gjyqësore.

Ky standard nuk kufizohet vetëm në respektimin e një procedure formale ligjore, por nënkupton një proces real dhe substancialisht të drejtë, ku të gjitha palët kanë mundësi të barabarta për të paraqitur provat, për të shtruar argumentet e tyre dhe për të ushtruar mjetet e tyre juridike në mënyrë efektive. Për më tepër, neni në fjalë sanksionon që gjykimi duhet të zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e cila është e themeluar me ligj, duke u siguruar kështu që drejtësia jo vetëm të realizohet, por edhe të shihet se është realizuar.
Duke qenë se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm bën pjesë në spektrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Neni 53 i KRK, përcakton qartazi se interpretimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ. Ky detyrim kushtetues e vendos praktikën e GJEDNJ-së në një pozitë normative superiore dhe detyruese për autoritetet vendore, duke siguruar që standardet evropiane për të drejtat e njeriut të jenë jo vetëm inspirim, por edhe burim zbatueshëm i drejtësisë në Kosovë.
Neni 31 i KRK, është i harmonizuar në përmbajtje me nenin 6 të KEDNJ, duke reflektuar parimet themelore të një procesi të drejtë, të paanshëm dhe të barabartë. Për më tepër, neni 22 i Kushtetutës sanksionon qartë se Konventa, ka fuqi të drejtpërdrejtë dhe përparësi në zbatim ndaj legjislacionit të brendshëm, përveç vetë Kushtetutës. Kjo do të thotë se gjykatat, autoritetet publike dhe institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës janë të obliguara që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të zbatojnë jo vetëm Kushtetutën dhe ligjet e brendshme, por gjithashtu edhe dispozitat e Konventës dhe jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ. Ky obligim përfshin edhe fushën e përmbarimit të aktgjykimeve, si pjesë e pandashme e të drejtës për gjykim të drejtë, e cila gëzon mbrojtje të posaçme në të dy aktet – si në Kushtetutën e Kosovës ashtu edhe në KEDNJ. neni 6 i Konventës zë një vend qendror në sistemin evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sepse garanton jo vetëm një proces të drejtë në aspektin formal, por një proces të rregullt, efektiv dhe të ekuilibruar për të gjitha palët në një procedurë gjyqësore – qoftë ajo penale apo civile. Ky nen ofron mbrojtje kundër gjykimeve të njëanshme, siguron të drejtën për barazi të palëve, dhe u jep palëve mundësi reale për të paraqitur rastin e tyre para një gjykate të pavarur, të paanshme dhe të themeluar me ligj. Megjithëse shpeshherë interpretohet

në kontekstin e fazës gjyqësore, interpretimi bashkëkohor i nenit 6 nga ana e GJEDNJ-së, thekson qartë se e drejta për një gjykim të drejtë nuk përfundon me nxjerrjen e vendimit, por përfshin gjithashtu edhe ekzekutimin e aktgjykimit, përkatësisht përmbarimin.

Moszbatimi i një vendimi përfundimtar gjyqësor mund të konsiderohet si shkelje substanciale e nenit 6, pasi i mohon palës fituese frytin e procesit gjyqësor dhe e redukton të drejtën për drejtësi në një garanci formale dhe të papërdorshme. Prandaj, përmbarimi i aktgjykimeve nuk mund të konsiderohet thjesht si një aspekt teknik i procedurës civile apo penale, por si një garanci themelore për realizimin efektiv të të drejtave të njeriut, të cilat janë të mbrojtura si në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, ashtu edhe në kuadër të rendit juridik evropian përmes Konventës dhe jurisprudencës së saj.

Sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, nuk kufizohet vetëm në sigurimin e një gjykimi të drejtë në aspektin formal, por përfshin gjithashtu edhe fazën e zbatimit të aktgjykimit, përkatësisht përmbarimin e tij. Kjo nënkupton se përmbarimi i një vendimi gjyqësor përbën element përbërës dhe të pandashëm të të drejtës për gjykim të drejtë.

Një prej rasteve më të rëndësishme në këtë drejtim është rasti *Hornsby kundër Greqisë* (1997), në të cilin GJEDNJ-së, vendosi se ekzekutimi efektiv i vendimeve gjyqësore është pjesë thelbësore e të drejtës për gjykim të drejtë. Sipas këtij standardi, nëse një vendim gjyqësor – qoftë për kompensim, kthim prone apo pagesë – nuk zbatohet brenda një afati të arsyeshëm ose nuk zbatohet fare, atëherë kjo situatë përbën shkelje të nenit 6 të Konventës, dhe rrjedhimisht edhe të nenit 31 të KRK-së.

GJEDNJ-së, ka theksuar vazhdimisht se nuk ka rëndësi nëse përmbaruesi është organ publik apo privat – përgjegjësia për moszbatimin efektiv të vendimeve mbetet gjithmonë tek shteti. Kjo qasje u konfirmua në rastin *Burdov kundër Rusisë* (2009), i cili përbën një pikë kyçe referimi në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sa i përket moszbatimit të aktgjykimeve. Në këtë rast, Gjykata vlerësoi se shteti nuk mund të arsyetohet me mungesë fondesh, vonesa procedurale apo vështirësi administrative, duke theksuar se vendimet gjyqësore duhet të zbatohen në mënyrë efektive, të plotë dhe brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht vështirësive që mund të paraqiten gjatë procesit të përmbarimit.

Gjithashtu, në rastin *Fuklev kundër Ukrainës* (2005), GJEDNJ, konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak të moszbatimit për më shumë se pesë vjet të një vendimi përfundimtar dhe të ekzekutueshëm, duke nënvizuar se një vonesë e tillë komprometon vetë efektivitetin e procedurës gjyqësore. Gjykata rikujtoi se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin jo vetëm procedurën gjyqësore, por edhe përmbarimin e vendimit, dhe se nëse ky vendim nuk ekzekutohet, e gjithë procedura humb kuptimin dhe efikasitetin e saj juridik.

Bazuar në rastet e lartcekura nga jurisprudenca e GJEDNJ, mund të konkludohet se:

- Ekzekutimi efektiv i vendimeve gjyqësore është pjesë thelbësore e të drejtës për gjykim të drejtë;
- Moszbatimi i vendimeve, si pasojë e paaftësisë, neglizhencës apo mosveprimit të autoriteteve shtetërore, përbën shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Konventë;
- Shteti nuk mund të justifikohet me mungesë burimesh, pengesa burokratike apo vështirësi organizative për të mos ekzekutuar një vendim të formës së prerë.

Në përputhje me parimet e përmendura më sipër, Ligji i Republikës së Kosovës për Procedurën Përmbarimore synon të sigurojë zbatimin efikas, të ligjshëm dhe efektiv të aktgjykimeve gjyqësore, duke përfaqësuar kështu një hallkë të domosdoshme në realizimin e të drejtës për gjykim të drejtë. Ndër parimet themelore të kësaj procedure, është parimi i formalitetit rigoroz, i cili kërkon që çdo hap në kuadër të procedurës përmbarimore të përmbushet në përputhje të plotë dhe strikte me rregullat dhe format e parashikuara nga ligji. Ky parim është themelor për të garantuar siguri juridike dhe mbrojtje të balancuar të interesave të palëve të përfshira.

Në praktikë, ky parim nënkupton se:

- Çdo veprim procedural – si lëshimi i urdhrit për përmbarim, njoftimi i debitorit, sekuestrimi i pasurisë, mbajtja e ankandit, etj. – duhet të kryhet në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse ligjore;
- Çdo devijim, qoftë edhe minimal (p.sh., mungesa e njoftimit të rregullt, shkelje e afateve apo ndonjë e metë formale), mund të

rezultojë në pavlefshmëri ose shfuqizim të veprimeve përmbarimore;

Kjo ndodh për faktin se procedura përmbarimore, në thelb, përfaqëson një ndërhyrje në të drejtat e individit, shpesh në pasurinë apo pronën e tij, dhe çdo ndërhyrje e tillë duhet të bazohet në respektimin e rreptë të standardeve procedurale.

Respektimi i këtij parimi është i domosdoshëm për të garantuar mbrojtjen e të dyja palëve – kreditorit dhe debitorit – në mënyrë të barabartë, dhe atë:

- Kreditori ka të drejtë që vendimi gjyqësor të zbatohet në kohë, në mënyrë të saktë dhe efikase;
- Debitori, në anën tjetër, ka të drejtë të mbrohet nga çdo përmbarim që mund të ndërmerret në mënyrë të paligjshme, të njëanshme apo pa respektuar të drejtën për njoftim dhe pjesëmarrje.

Përmes këtij balancimi, ruhet integriteti i procedurës së përmbarimit dhe njëkohësisht garantohet respektimi i standardeve të një procesi të drejtë, siç kërkohet nga neni 31 i KRK-së, dhe neni 6 i KENDJ-së.

Pra, përmbarimi i aktgjykimeve nuk mund të trajtohet thjesht si një hap formal apo teknik i ndarë nga procesi gjyqësor, por si një komponent themelor i së drejtës për gjykim të drejtë. Vetëm përmes zbatimit të plotë dhe të drejtë të vendimeve gjyqësore mund të realizohet drejtësia e plotë për palët. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur standarde të qarta në këtë drejtim, duke e obliguar shtetin që të sigurojë mekanizma të efektshëm për përmbarim dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Në këtë kontekst, respektimi i parimeve kushtetuese, ndërkombëtare dhe ligjore është jetik për forcimin e sundimit të ligjit dhe garantimin e drejtësisë në praktikë.

13. Qasja dhe përdorimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së

Ekzistojnë mënyra dhe forma të ndryshme të qasjes në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, me qëllim të përdorimit nga ana e gjyqtareve për nevoja të referencës në rastin e hartimit të vendimeve gjyqësore. Faqja e internetit e GJEDNJ-së ofron shumë botime që janë me interes për avokatët, gjyqtaret dhe profesionistet e tjerë ligjor.

a) Udhëzuesit e praktikës gjyqësore (Guides).

Ofrojnë një përmbledhje të praktikës gjyqësore të KEDNJ për secilin nen të veçantë. Rekomandohet t'i referoheni versioneve të gjuhës zyrtare për zhvillimet më të fundit të praktikes. Qasja në secilin Udhëzues është përmes faqes se internetit të GJEDNJ, në linkun, si në vijim: ECHR–KS (Case Law Guides); https://ks.echr.coe.int/ëeb/echr-ks/all-case-laë-guides

b) Baza e të dhënave HUDOC e vlefshme në web faqen (faqen e internetit) të GJEDNJ

Baza e të dhënave HUDOC ofron qasje në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetit të Ministrave. Qasja është përmes web faqes se GJEDNJ-së, duke klikuar në vegëzen HUDOC, dhe që të dërgon direkt në faqen e kërkimit të praktikes gjyqësore, në linkun:
https://hudoc.echr.coe.int/#{%22documentcollectionid2%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22]}

Përmes këtyre mënyrave të mjeteve apo formave të kërkimit të jurisprudencës së GJEDNJ-së, gjyqtaret mund të marrin informacione të dobishme si referencë gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore. Pra, faqja e internetit të GJEDNJ-së ofron informacione të vlefshme në këtë drejtim, dhe gjyqtareve u mundësohet lehtësisht qasja për çdo nen të KEDNJ-së dhe praktikes gjyqësore lidhur me nenin përkatës.

14. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e paraqitura në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk kanë ekzistuar kushtet për ndryshimin e aktgjykimeve të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Në disa raste aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182

paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak te të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me ato prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e atyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Në disa raste gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht ose në tërësi të bazuara/pabazuar.

Në disa raste është konstatuar se gjykata në mënyrë të gabuar kanë aplikuar dispozitat procedurale dhe si pasoj palës janë kanë mohuar të drejtën në e qasjes në gjykatë.

Në disa raste është konstatuar se aktgjykimet e gjykatave të instancave me të ulëta nuk kanë vlerësim dhe arsyetim, se si është aplikuar e drejta materiale.

Në disa raste mënyra si është vlerësuar kërkesa e palës nga gjykatat e instancës më të ulët është në kundërshtim me dispozitat materiale.

Në disa raste është konstatuar se gjykatat e instancave me të ulëta, duke mos përjashtuar as Gjykatën Supreme, për çështje faktike dhe juridike të njëjtë ka pasur vendimmarrje ndryshe.

14.1. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

Aktvendim Rev.nr.114/22, i datës 12.07.2022

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditësit: Rexhep Haxhi Peqanki, nga Gjakova rr. "Ali Pashë Tepelena", nr.134, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2494/17, i datës 01.11.2021, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.10/13, i datës 16.02.2017, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak te të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi

mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia nuk përmban elementet që duhet ti përmbajë çdo parashtresë, në fakt kërkesa në padi është e pa qartë dhe e pa kuptueshme dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësi në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit është dashur që padinë e paditësit ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë përfshirë edhe me zbatim të gabuar të se drejtës materiale, për arsye se:

Me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, përcaktohet se: “Trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit

janë trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm në qoftë se janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë", dhe me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: "Personat e cekur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, janë trashëgimtarë të domosdoshëm kur sipas radhës ligjore të trashëgimit janë thirrur për trashëgim".

Me nenin 31 paragrafi 1, të këtij ligji, përcaktohet se: "Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet pjesë e domosdoshme", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe bashkëshortit përbën një të dytën, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë një të tretën e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimit".

Me nenin 32 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Vlera e pasurisë trashëgimore në bazë të së cilës llogaritet pjesa e domosdoshme llogaritet në këtë mënyrë: me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Së pari, inventarizohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes, duke llogaritur këtu të gjitha ato që ka disponuar me testament, si dhe të gjitha borxhet që ia kanë të tjerët, edhe ato që ia ka ndonjë trashëgimtar, me përjashtim të borxheve që qartazi që nuk mund të arkëtohen", me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: "Nga vlera e përcaktuar e të mirave që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes zbritet shuma e borxheve të tij, shuma e shpenzimeve të inventarizimit e të vlerësimit të pasurisë trashëgimore dhe e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit", dhe me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: "Pjesës që mbetet i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi ka bërë në çfarëdolloj mënyre ndaj ndonjë trashëgimtari ligjor, madje edhe e dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimi, si dhe e atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore".

Me nenin 33 të këtij ligji, përcaktohet se: "Në kuptim të këtij Ligji "dhurim", konsiderohet çdo heqje dorë nga një e drejtë, falja e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore, ose për të themeluar apo për të zgjeruar familjen, ose për të ushtruar mjeshtërinë, si dhe çdo disponim tjetër pa shpërblim" .

Me nenin 34 të këtij ligji, përcaktohet se: "Për vlerësimin e dhurimit merret vlera e sendit të dhuruar në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, e sipas gjendjes së tij në kohën e dhurimit të bërë".
Me nenin 38 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij".
Me nenin 39 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: " Kur cenohet pjesa e domosdoshme, më parë zvogëlohen disponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyrë, atëherë kthehen dhurimet", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Nëse dhurata nuk mund të kthehet si send (in rem), personi që ka marrë dhuratën duhet të kthejë vlerën e saj sipas dispozitave mbi kthimin në rast të pasurimit pa bazë".
Me nenin 43 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Kthimi i dhurimeve bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdon në të kundërtën me radhë tek dhurimet më të hershme", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit".
Me nenin 45 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme mund ta kërkojnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshëm", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Kjo e drejtë nuk mund të cenohet nga kreditorët e trashëgimtarit të domosdoshëm".
Me 46 të këtij ligji, përcaktohet se: "Zvogëlimi i disponimeve me testament mund të kërkohet brenda afatit prej tri vitesh nga shpallja e testamentit dhe kthimi i dhurimeve brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit për arsye se: trashëgimia e domosdoshme ligjore në vetvete nënkupton kufizimin e bazës së disponimit me tërë pasurinë nga ana e trashëgimlënësit. Ky institut ka të bëjë me një pjesë të caktuar të trashëgimisë dhe me një rreth të caktuar të personave. Në këtë kuptim me vullnetin e tij të fundit nuk mundet që në masë të pakufizuar të disponoj me pasurinë e tij dhe se është i detyruar që një pjesë të pasurisë si masë trashëgimore t'ua lë rrethit të caktuar të personave - trashëgimtarëve siç përcaktohet me dispozitat e LTK-së. Pavarësisht kësaj sipas LTK-së, ekziston mundësia që me testament në rastet e caktuara testatori të mund të disponoj me tërë pasurinë e tij, përjashtimisht në rastet kur plotësohen kushtet ligjore për përjashtimin nga trashëgimia ose privimi nga pjesa e domosdoshme.

Pjesa e domosdoshme është e përcaktuar me dispozitat e lartcekura të LTK-së, dhe si e tillë mund të cenohet kur me testament, ose me ndonjë punë tjetër juridike, për në rast vdekje testatori e ka shpërndarë tërë pasurinë e tij dhe trashëgimtarëve të domosdoshëm nuk iu ka lënë asgjë, si dhe në rastet kur testatori duke disponuar me pasurinë e vet me testament ose me ndonjë punë tjetër juridike trashëgimtareve të domosdoshëm iu lenë pjesë më të vogla të trashëgimisë se sa atyre kishte me ju taku sipas ligjit.

Në rastet kur vjen deri te cenimi i pjesës së domosdoshme trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë që të sigurohen nga masa trashëgimore një pjesë që do ti përgjigjej pjesës së domosdoshme. Realizimi i pjesës së domosdoshme mund të bëhet në dy mënyra; a) pjesa e domosdoshme mund të sigurohet nga pasuria që trashëgimlënësi ka disponuar me testament dhe b) kthimin e dhuratave që i ka dhuruar personave të caktuar me ligj, në afatin e caktuar ligjor nëse nuk ka urdhëruar se në çfarëdo mënyre të sigurohet pjesa e domosdoshme. Ndërsa mënyra e zvogëlimit të disponimeve me testament apo kthimin e dhuratave për realizimin e pjesës së domosdoshme është përcaktuar me nenin 39 të LTK- së.

Kthimi i dhuratave vjen në shprehje për realizmin e pjesës së domosdoshme në rastet kur me zvogëlimin e disponimeve me testament nuk mund të përmbushet cenimi i pjesës së domosdoshme dhe kthimi i

dhuratave bëhet në atë mënyrë duke filluar nga dhurata e fundit dhe shkohet kundrejt radhës sipas të cilës janë të dhuruara dhuratat të cilat duhet të kthehen vetëm në atë masë sa është e nevojshme për realizimin e pjesës së domosdoshme dhe me dispozitat e LTK-së, është përcaktuar saktë pozita e dhuratëmarrësit se çka ai duhet të kthejë, ndërgjeshmëria e tij dhe gjendja në të cilën duhet të kthehet dhurata.
Sipas dispozitave të LTK-së, procedura për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme duhet të zhvillohet nga gjykata trashëgimore gjatë shqyrtimit të trashëgimisë vetëm sipas propozimit të palës së interesuar - gjegjësisht trashëgimtarit të domosdoshëm i cili mund të kërkoj zvogëlimin e disponimit me testament dhe kthimin e dhuratave, me të cilat dhurata është cenuar pjesa e tij e domosdoshme, mirëpo nëse trashëgimtari i domosdoshëm nuk ka marrë pjesë në procedurë trashëgimore, për arsyet e caktuara sipas dispozitave të LTK-së, ai mundet që me padi në procedurë të veçantë të parashtroj kërkesë për shkak të realizimit të pjesës së domosdoshme duke kërkuar zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhuratave.
Sipas dispozitave të LTK-së, afati për paraqitjen e kërkesës për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme është tri vjet nga shpallja e testamentit dhe kthimi i dhurimeve brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij dhe nëse kërkesa paraqitet pas afateve të caktuara sipas dispozitave të LTK-së, kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës.
Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë dhe atë se:
Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës/ave kadastrale - kontestuese, në të cilat pala paditëse ka pretenduar se është cenuar pjesa e domosdoshme, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikoje saktësisht se cila është parcela/t kadastrale apo pjesa e saj/tyre, në të cilën ka pretenduar se ka të drejtën në realizimin e pjesës

së domosdoshme, me saktësisht si në kërkesëpadi lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj/tyre, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë/ve kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur më atë parcelë/a kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezulton se nuk ka përshkrim të pronës, nuk ka të dhëna të sakta për parcelën/at kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela/t kontestuese apo pjesa e saj/tyre, nuk ka konstatuar se parcela/t kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka detajisht - duke përshkruar pjesën e saj/tyre sipas kulturave në vend, cila është shtrirja gjeografike e saj/tyre, me cilat parcela fqinje kufizohet, nuk ka kërkuar historiatin e pronës, nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, nuk ka marr në shikim shkresat e lëndës sipas kontratës LRP. Nr. Rendor 677/16, LRP Nr. Ref. 068/2016 e datës 26.01.2016, kontratës LRP.nr.1681/2013, Ref.nr.253/2013, e datës 16.05.2013, kontratës VR.nr.125/06 e datës 17.01.2006, kontratës Leg.nr.2854/06, e datës 05.09.2006, shkresat e lëndës sipas kontestit C.nr.637/06, nuk është caktuar nxjerrja e provës me ekspertim nga lëmia përkatëse për të vlerësuar tërë pasurin e dhuratëdhënësit, e pastaj vlerësohet se a është cenuar pjesa e domosdoshme dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj. Përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se nuk ekzistojnë asnjë nga kushtet se kontrata mbi dhuratën është nule në kuptim të dispozitave të LMD-së, përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e ka pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë, mirëpo nëse i referohemi shkresave të lëndës e në veçanti kërkesëpadisë së paditësit, rezulton se i

njëjti nuk ka kërkuar anulimin e kontratës mbi dhuratën për shkak të shkaqeve, për pavlefshmëri relative të kontratës e as për shkaqe për pavlefshmëri absolute, mirëpo i njëjti ka kërkuar anulimin e kontratës mbi dhuratën me pretendimin se është cenuar pjesa e domosdoshme si trashëgimtarë i rendit të parë ligjor në bazë të Ligjit për Trashëgimin e Kosovës, dhe në këtë kuptim Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë para se të vendos për kërkesëpadinë e paditësit është dashur ti administroj provat dhe ti marr në shikim shkresat e lëndës të cekura me lartë, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes e pastaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët, të udhëzoj ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtëshmërisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit - raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në Gjakovë, të kërkohet historia e pronës për paluajtëshmerinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, dëgjimin dëshmitarëve eventual mundësisht të pronarëve apo poseduesve të paluajtshmërive fqinje, e në rast nevoje edhe ballafaqimin e tyre, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës në kuptim të

dispozitave të LPK-së, të marrë në shikim shkresat e lëndës LRP. Nr. Rendor 677/16, LRP Nr. Ref. 068/2016 e datës 26.01.2016, kontratës LRP.nr. 1681/2013, Ref.nr.253/2013, e datës 16.05.2013, kontratës VR.nr.125/06 e datës 17.01.2006, kontratës Leg.nr.2854/06, e datës 05.09.2006, shkresat e lëndës sipas kontestit C.nr.637/06, të caktohet nxjerrja e provës me ekspertim nga lëmia përkatëse për të vlerësuar tërë pasurinë e dhuratëdhënësit, e pastaj vlerësohet se a është cenuar pjesa e domosdoshme sipas pretendimeve nga padia e paditësit, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.
Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendim Rev.nr.171/24 i datës 15.10.2024

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditëses: Florinë Kelmendi, nga Peja, rr. "Xheladin Hana", nr.19, Prishen aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8179/21, i datës 10.01.2024, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1905/2021 i datës 31.08.2021, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk

ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktvendimit të goditur, për të cilin shkak aktvendimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishet.
Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktvendimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 2 paragrafi 1 dhe 4 dhe nenit 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet.
Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare mbi hedhjen e padisë si të palejuar në mungesë të interesit juridik dhe atë:
Me nenin 99 të LFK-së, përcaktohet se: “ 1. At i fëmijës së lindur në martesë, do të konsiderohet burri i nënës së fëmijës nëse fëmija është lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditësh pas mbarimit së martesës. 2. Nëse fëmija është lindur në martesën e mëvonshme të nënës së vet pas kalimit të afatit prej 270 ditësh e deri në afatin prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës së saj të mëparshme, at do të konsiderohet burri i nënës nga martesa e mëparshme, përveç nëse burri i nënës nga martesa e mëvonshme me pëlqimin e saj e pranon fëmijën për të vetin.”
Me nenin 100 të LFK-së, përcaktohet se: “1. Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës. 2. Nëse prindërit e fëmijës të lindur jashtë martesës kanë pasur qëllimin që ta lidhin martesën dhe në këtë gjë kanë qenë të penguar me vdekjen e njërit prej tyre ose me ndonjë pengesë martesore që ka lindur pas zënies së fëmijës, në bazë të kërkesës së njërit prind të fëmijës, gjykata në procedurë jashtëkontestimore do të shpallë se fëmija ka lindur në martesë. 3. Nëse asnjëri prej prindërve nuk është i gjallë ose prindit të gjallë i është hequr aftësia për të vepruar apo i është hequr e drejta prindërore, procedurën pranë gjykatës për shpalljen se fëmija i mitur ka lindur në martesë mund ta iniciojë Organi i Kujdestarisë. 4. Nën kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni kërkesa për shpalljen e fëmijës martesor mund të parashtrohet gjithashtu edhe në kontestin për vërtetimin e atësisë, nëse atësia nuk është vërtetuar më parë me pranimin ose me vendimin e gjykatës”.

Me nenin 101 të LFK-së, përcaktohet se: “At i fëmijës, i cili nuk ka lindur në martesë, as brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës, konsiderohet burri i cili e pranon për të vetin ose atësia e të cilit është vërtetuar me vendimin e gjykatës”.
Me nenin 103 të LFK-së, përcaktohet se: “1. Personi i cili e konsideron vetën atë të fëmijës mund të pranojë atësinë në procesverbal para ofiqarit. 2. Atësia mund të njihet para Organit të Kujdestarisë, gjykatës apo organit tjetër të autorizuar me ligj. Këto organe janë të detyruara që pa vonesë të dërgojnë procesverbalin e vërtetuar tek ofiqari kompetent, i cili duhet të regjistrojë fëmijën në regjistrin e të lindurve. 3. Atësia gjithashtu mund të njihet edhe me testament”.
Me nenin 104 të LFK-së, përcaktohet se: “1. Nëna e fëmijës së lindur jashtë martesës, në paraqitjen e lindjes së fëmijës mund ta shënojë personin të cilin e konsideron atë të fëmijës së vet. Ajo mund të ofrojë deklaratë me gojë që do të shënohet në procesverbal te ofiqari ose te organi i autorizuar për përpilimin e dokumenteve publike, në dokumentin e vërtetuar ose në testament. 2. Nëse nëna në paraqitjen e lindjes së fëmijës nuk e ka shënuar personin që e konsideron at të fëmijës, ofiqari do ta udhëzojë për të drejtën e saj që ta bëjë këtë gjë. 3. Kur e merr deklaratën e nënës për identitetin e atit të fëmijës së saj, ofiqari do ta ftojë personin e shënuar të deklarohet për atësinë e vet drejtpërdrejt para ofiqarit ose të ofrojë dokumentin e vërtetuar brenda afatit prej 30 ditësh. Letërthirrja për një person të këtillë medoemos i dorëzohet personalisht dhe sipas mënyrës me të cilën sigurohet fshehtësia. 4. Për veprimet që i ndërmerr dhe për deklaratat me gojë të nënës së fëmijës dhe të personit për të cilin nëna pohon se është atë i fëmijës, ofiqari do të përpilojë procesverbalin. 5. Nëse personi i ftuar deklaron se nuk është atë i fëmijës ose brenda afatit prej 30 ditësh nuk deklarohet për atësinë e fëmijës, ofiqari lidhur me këtë gjë do ta informojë nënën e fëmijës. 6. Nëse personi i ftuar deklaron në procesverbal para ofiqarit se konsideron veten atë të fëmijës, dhe kjo është e regjistruar në procesverbal ose në dokumentin e verifikuar, ofiqari zyrtarisht do ta regjistrojë si atë të fëmijës, në regjistrin amë të të lindurve dhe për regjistrimin duhet të informojë nënën e fëmijës”.
Me nenin 106 të LFK-së, përcaktohet se: “1. Njohja e atësisë prodhon efekt juridik dhe regjistrohet në librin amë të të lindurve vetëm nëse me

njohjen pajtohet nëna e fëmijës. 2. Deklaratën mbi pëlqimin për njohjen e atësisë mund ta japë nëna sipas rregullave të përcaktuara me nenin 103 të këtij Ligji për njohjen e atësisë. 3. Ofiqari ka për detyrë ta ftojë nënën e fëmijës që brenda afatit prej 30 ditësh të deklarohet për njohjen e atësisë nëse ajo nuk e ka paraqitur më parë personin e njëjtë si at të fëmijës".

Me nenin 107 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Nëse fëmija është më i vjetër se 16 vjeç është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij për njohjen e atësisë. Ky pëlqim jepet sipas mënyrës së rregulluar me nenin 109 të këtij Ligji. 2. Nëse fëmija pavarësisht nga kjo moshë, është i paaftë për të gjykuar në mënyrë të vazhdueshme, ose nëna nuk është më e gjallë, apo ka vendqëndrimin e panjohur ose është shpallur e vdekur apo plotësisht i është hequr aftësia për të vepruar, deklaratën mbi pëlqimin për njohjen e atësisë e jep kujdestari i fëmijës me lejen e Organit të Kujdestarisë".

Me nenin 108 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Nëse nëna e fëmijës ose fëmija që është më i vjetër se 16 vjeç, ose kujdestari i fëmijës kur nevojitet pëlqimi i tij, nuk pajtohen për njohjen e atësisë, ose nuk deklarohen lidhur me këtë gjë brenda afatit prej 30 ditësh, pasi të marrin në dijeni njohjen, personi i cili e ka njohur fëmijën për të vetin mund t'ia paraqesë padinë gjykatës për vërtetim se ai është at i fëmijës. 2. Padia mund të paraqitet brenda afatit prej tri vjetësh pas marrjes së njoftimit për mospajtimin e nënës, përkatësisht të fëmijës. Nëse në ndërkohë është vërtetuar atësia e personit tjetër, padia nuk mund të paraqitet pas kalimit të afatit për kundërshtimin e atësisë atij personi".

Me nenin 109 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Deklarata për njohjen e atësisë, si dhe deklaratat e nënës dhe të fëmijës, si dhe pëlqimi për njohjen e atësisë, nuk mund të revokohen. 2. Personi i cili ka dhënë deklaratën për njohjen e atësisë, mund të kërkojë anulimin e deklaratës nëse ajo është dhënë me shtrëngim, për shkak të mashtrimit ose në lajthim. 3. Padia për anulimin e deklaratës mund të paraqitet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data kur shtrëngimi është bërë i ditur, apo gabimi është vërejtur".

Me nenin 110 të LFK-së, përcaktohet se: "1. Padinë për vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesës, përveç personit i cili e konsideron vetën atë të fëmijës mund ta paraqesin fëmija dhe nëna e fëmijës. 2. Fëmija i lindur jashtë martesës mund të paraqet padinë për vërtetimin e atësisë në çdo kohë. 3. Nëse fëmija është i mitur ose nuk e ka aftësinë për të vepruar, padinë në emër të tij mund të paraqet nëna.

Nëse nëna nuk është e gjallë ose i është hequr aftësia për të vepruar, përkatësisht nga kujdesi prindëror dhe kur nëna ka vendqëndrimin e panjohur, padinë mund të paraqet kujdestari me lejen e Organit të Kujdestarisë. 4. Nëna mund të paraqet padinë për vërtetimin e atësisë derisa të ketë të drejtën të ushtrojë të drejtën prindërore".

Me nenin 37 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj".

Me nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë. 3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi. 4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. 5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore të lartcekura, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, rezulton se Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me shkaqet e hedhjes së padisë në mungesë të interesit juridik.

Gjykata Supreme vlerëson se nga dispozitat e lartcekura dhe nga shkresat e lëndës shihet se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mungesë të interesit juridik dhe as me çështje administrative e cila do të trajtohet në procedurë administrative, për faktin se paditësja me anë të padisë ka kërkuar vërtetimin e atësisë, e që konkretisht sipas librit amëz të të lindurve, nuk figuron emri i babait të paditëses, e që është e drejtë e pa kontestueshme që paditësja të kërkoj vërtetimin e atësisë.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar kur ka theksuar se nuk kanë nevojë të provohen faktet e provuara duke iu referuar aktvendimit të Kuvendit të Komunës së Pejës Drejtoria për Organizmin dhe Administrimin e Përgjithshëm, me numër 02. nr. 7/436, të datës

11.09.1969, dhe deklaratës së nënës së paditëses me nr.278, më datë 28 janar. 1971, për faktin se nga aktvendimi dhe deklarata e lartcekur ka rezultuar që paditësja të regjistrohet në librin amëz të të lindurve pa emrin e babait biologjik, gjë që edhe sot nuk është e konfirmuar vërtetuar se kush është babai i saj biologjik, e që është e drejtë ligjore dhe kushtetuese që paditësja të dijë se kush është babai i saj biologjik dhe të regjistrohet në librat amëz me emër të të dy prindërve.

Kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me çështje administrative ashtu siç ka theksuar gjykata e shkallës së parë, për faktin se organi administrativ në këtë rast ka pasur mundësi të regjistroj paditësen edhe në emër të babait të saj biologjik, vetëm nëse nëna në deklaratën e dhënë me nr.278, më datë 28 janar. 1971, do ta kishte pohuar - pranuar që personi që pretendon paditësja me padi është babai i saj biologjik dhe kishte kërkuar regjistrimin e tij në librat amëz dhe njëkohësisht babai kishte pohuar një gjë të tillë, ashtu siç përcaktohet me nenin 104 të LFK-së, gjë që nuk është bërë një gjë e tillë në këtë rast, prandaj në këtë rast paditësja ka legjitimitet dhe interes të plotë juridik që të kërkojë vërtetimin e atësisë.

Përveç të cekurave Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, edhe për faktin se të njëjtat, palës paditëse ja kanë mohuar qasjen në drejtësi, për arsye se:

Qasja në drejtësi përbën një element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar nga neni 31 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 6 i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, instrument ky drejtpërdrejtë i zbatuar në rendin tonë juridik sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, çdokush gëzon të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe se është pranuar si parakusht i të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Pra, e drejta e qasjes në gjykatë paraqet një ndër elementet bazë të parimit të sundimit të së drejtës ngaqë kjo u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate.

Në përgjithësi, e drejta për qasje në gjykatë garanton të drejtën për të filluar seancat gjyqësore përpara një gjykate dhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor, si rezultat i diskutimeve dhe vlerësimeve të bëra pranë një gjykate të pavarur lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile apo akuzat penale që rëndojnë mbi subjektet e së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si vlerë të rendit juridik kushtetues ekzistues (neni 7) ka mishëruar parimin e sundimit të së drejtës (ligjit) - ku autoriteti shtetëror përveç se krijon "të drejtën", njëkohësisht i nënshtrohet kësaj të fundit dhe e zbaton dhe detyrohet nga ajo në mënyrë të barabartë krahas subjektet tjera të së drejtës. Në këtë kontekst, garancia procedurale e qasjes në drejtësi paraqet një ndër "urat", lidhëse midis subjektit të së drejtës që pretendon se i takon, i është shkelur, kufizuar, cenuar apo dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes i tij dhe mekanizmave shtetërorë - gjykatat dhe/ose organet tjera të pavarura (kuazi gjyqësore) që janë të mveshur me juridiksion dhe kompetencë për garantimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra e drejta për qasje në gjykatë, iu jep efekt respektivisht i jetëson parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të së drejtës

Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute. GJEDNJ në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar është shprehur se vetë natyra e saj (të drejtës për qasje në gjykatë) kërkon rregullim përkatës legjislativ (që mund të ndryshojë në kohë dhe vendndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga shteti, megjithëse rregullime të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin/esencën e së drejtës e as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ. Në këtë kontekst gjykatat e rregullta në ushtrimin e funksionit të tyre kanë për obligim që të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe Gjykata Supreme e Kosovës në këtë rast ka vlerësuar se qasja në drejtësi është parakusht thelbësor për realizimin e të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës respektivisht Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim

të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.
Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim Rev.nr.89/2025, i datës 14.03.2025

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET i bazuar revizioni i të paditurës: Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovica, me seli në Mitrovicë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1176/2022, i datës 10.12.2024, në pikën I, të dispozitivit dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1014/2018 i datës 21.10.2021, në pikën I, III, IV dhe V, të dispozitivit, dhe gjykohet si në vijim: REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit: Ramadan Sejdiu nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ramadan Sejdiu nga Prishtina të anulohet si jo ligjor vendimi nr. 01-710 i datës 24.10.2018, për shkëputjen e kontratës së punës dhe të detyrohet e paditura KRU Mitrovica, që paditësit në emër të ardhurave personale prej datës 24.10.2018 e gjerë më datë 30.10.2020 t'ia paguaj dhe atë: në emër të pagave neto shumën prej 22,086.12 €, në emër të kontributeve pensionale (5%+5%) 2,519.10 €, në emër të tatimit 1,845.33 €, të gjitha këto me kamatë vjetore në lartësi prej 8% duke filluar që nga arritja e secilës kërkesë veç e veç e gjerë në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës t'i paguaj shumën prej 2,016 €, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Pjesa tjetër e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1176/2022, të datës 10.12.2024, në pikën II, të dispozitivit, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, si në pikën I, të dispozitivit të gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë, është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Parashtrimet e të padituerës si në revizion, sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara, dhe se aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë përfshirë në shkeljet e pretenduara, dhe as me shkeljet të cilat shikohen sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 215 të LPK-së, që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për arsye se:

Me nenin 2 paragrafi 2 të Ligjit të Punës përcaktohet se: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”.

Më nenin 10 paragrafi 7 të këtij ligji përcaktohet se: “Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj”.

Me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike përcaktohet se: “Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së”.

Me nenin 21 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin

dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarimin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarin për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet, në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarimin e arsyes. Ky Nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së", ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: "Secila NP do të ketë këta katër zyrtarë në vijim: (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm. Nëse është e nevojshme për shkak të madhësisë dhe/ose llojllojshmërisë së veprimtarive, NP mundet – nëse vendoset nga Bordi i Drejtorëve dhe përcaktohet në Rregullore - që po ashtu të ketë një ose dy poste të Zëvendës Kryetarit".

Me nenin 162 paragrafi 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përcaktohet se: "1. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare. Duke marrë parasysh rezervimet e lartpërmendura, çështjet në vijim që bien nën fushëveprimin e Bordit të Drejtorëve: 1.1. miratimi i planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të Shoqërisë Aksionare, kontrollet e brendshme, auditimin, si dhe procedurat e menaxhimit të riskut; 1.2. thirrja e kuvendeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve; 1.3. përgatitja e agjendës fillestare të kuvendit të aksionarëve; 1.4. përcaktimi i datës për listën e aksionarëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në kuvendin e aksionarëve; 1.5. emetimi i aksioneve brenda kufizimeve të përcaktuara në statutin e Shoqërisë Aksionare apo në vendimet e aksionarëve për secilin lloj dhe kategori të aksionit, kur autorizimi në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare apo me vendim të aksionarëve; 1.6. emetimi i bondeve, mundësive për blerjen e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë, kur ajo kompetencë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me Statut të Shoqërisë Aksionare apo me vendim të Aksionarëve; 1.7. punësimi i zyrtarëve/menaxherëve të lartë të Shoqërisë Aksionare dhe miratimi i kushteve të marrëveshjeve ndërmjet

menaxhmentit të lartë dhe Shoqërisë Aksionare; 1.8. vendosja e kompensimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e Shoqërisë Aksionare; 1.9. përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendave; 1.10. miratimi i raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare, raportit të bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe të humbjeve të cilat pastaj do të dorëzohen tek aksionarët për miratim; dhe 1.11. Nëse Shoqëria Aksionare ka arritur kufijtë e përcaktuar me ligjin në fuqi për raportimin financiar, Bordi i Drejtorëve angazhon auditor të jashtëm për të kryer auditimin e jashtëm të deklaratës financiare vjetore si dhe të librave e regjistrave të Shoqërisë Aksionare, si dhe raporti i auditimit i bashkëngjitet raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare; si dhe 1.12. vendosja e të gjitha çështjeve tjera të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar në statutin e Shoqërisë Aksionare".

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës sipas vlerësimit të Gjykata Supreme të Kosovës, kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë dhe e dytë në mënyrë të gabuar kanë konstatuar dhe kanë vendosur që kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për arsye se:

Nëse i referohemi shkresave të lëndës, provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë dhe deklarimi i palëve ndërgjyqëse, rezulton se nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura në vendin e punës Zyrtar Kryesor Financiar, fakt që konstatohet edhe nga kontrata e punës e cila është administruar si prova nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës në mënyrë të njëanshme nga e paditura. Kontestuese në mes të palëve në këtë çështje juridike - kontestimore, ka qenë ligjshmëria e Vendimit me numër 01-710 i datës 24.10.2018, duke u bazuar në vendimin e Bordit të drejtorëve Nr. 11./2018 të datës 23.10.2018.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke ju referuar gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykatat e instancave me të ulëta, dhe meqenëse në këtë rast, procedura kontestimore është zhvilluar në mes të paditësit dhe të padituërs si ndërmarrje publike regjionale e cila është kompani në pronësi

publike, ndërsa pozita e punës së paditësit për të cilën i është ndërprerë kontrata e punës ka qenë Zyrtar Kryesor Financiar, në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i cili e rregullon mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes e marrëdhënies së punës, për pozitën Zyrtar Kryesor i Financave. Në këtë kontekst me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përcaktohet se: "Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare". Andaj në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes është mbështetur edhe në dispozitat e Ligjit për Shoqëri Tregtare, duke marr për bazë faktin se e paditura e ka statusin e shoqërisë aksionare. Po ashtu, duke marr për bazë natyrën e kontestit, i cili ka të bëjë me ligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen marrëdhënie së punës, është mbështetur edhe në dispozitat e Ligjit të Punës.

Nga përmbajtja e nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, rezulton se: Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike ka kompetencë ligjore që të emëroj zyrtaret, përfshirë edhe pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, gjithnjë sipas kësaj dispozite ligjore të njëjtit zyrtar shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë me shumicën e votave të ndërpresë kontratën e tyre duke dhënë arsye, apo edhe pa dhënë arsye.

Nga përmbajtja e nenit 162 paragraf 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, rezulton se: Bordi i Drejtorëve është organi kryesor përgjegjës për marrjen e të gjitha vendimeve në kuadër të shoqërisë aksionare, pa përjashtuar edhe çështjet e punësimit.

Nga përmbajtja e nenit 2 paragrafi 2 dhe nenit 10 paragrafi 7 të Ligjit të Punës, rezulton se: në rastet e lidhjes së kontratës së punës me afat të caktuar, i njëjti i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet përcaktuara me Ligjin e Punës, por me përjashtimin nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj tjetër.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, Ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kjo gjykatë vlerëson se Ligji për Ndërmarrje Publike, në këtë rast paraqitet si ligj special, kjo për faktin se i njëjti i rregullon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, në raport me mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes së kontratës për Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, e po ashtu,

duke përcaktuar edhe kompetencat e Bordit të Drejtoreve të ndërmarrjes publike në raport me këtë pozitë. Meqenëse e paditura funksionon si shoqëri aksionare, kurse pozita e paditësit si Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit paraqitet ndër pozitat kryesore, nga dispozitat e lartcekura rezulton se kjo pozitë (si vend pune) ka status të veçantë të rregullimit ligjor, duke i dhënë Bordi të Drejtorëve kompetenca të plota ligjore për ndërprerjen e kontratës së punës, edhe pa deklarimin e arsyes.

Në këtë kontekst meqenëse Ligji për Ndërmarrjet Publike, është ligj i zbatueshëm në këtë rast, e duke marr për bazë autorizimet ligjore të cilat i janë bartur Bordit të Drejtorëve, i cili mundet sipas diskrecionit të tij, në çdo kohë dhe me shumicë të votave të ndërpresë kontratën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, me ose pa deklarimin e arsyes, e po ashtu, gjithnjë sipas këtij ligji, duke marr për bazë faktin se, ky përcaktim ligjor mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, kjo gjykatë konstatoj dhe erdhi në përfundim se vendimi me numër 01-710 i datës 24.10.2018 i nxjerr nga Bordi i Drejtorëve i të paditurës, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit në pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, është vendim i ligjshëm i nxjerr në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se, me rastin e ndërprerjes të marrëdhënies së punës nga e paditura me të drejt nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit të Punës. Në këtë kontekst shikuar përmbajtjen e kontratës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, e cila i referohet këtij ligji, si ligj i zbatueshëm, mirëpo siç është theksuar më lartë me nenin 2 paragraf 2 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: "Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, rezulton se zbatimi i dispozitave të Ligjit të Punës, ka edhe përjashtime, dhe atë sikurse në këtë rast Ligji për Ndërmarrje Publike, si ligj special ka përcaktuar zgjidhje për çështjen e caktuar që lidhet me emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të zyrtarëve në ndërmarrjeve publike, përkatësisht pozitës së paditësit Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit. Po ashtu edhe nga përmbajtja e nenit 21 paragraf 1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike, rezulton se në raport me emërimin dhe

ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj.
Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, edhe për faktin se e paditura me rastin e marrjes së vendimit, për ndërprerjen së marrëdhënies së punës paditësit, drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, i cili ligj nuk përcakton themelimin e komisionit disiplinor, apo zhvillimin e një procedure disiplinore, duke përcaktuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës nga Bordi i Drejtorëve, mund të behët edhe pa arsye.
Kjo gjykatë vlerëson se, e paditura duke funksionuar si shoqëri aksionare, ku Bordi i Drejtorëve është organi me i lartë menaxhues, dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë organ me të lartë brenda saj i cili do të trajtonte ankesën eventuale të paditësit. Po ashtu, një përcaktim i tillë ligjor përcaktohet me nenin 78 të Ligjit të Punës, me të cilin përcaktohet se: “I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura ”. Në këtë kontekst, në këtë rast organ me i lartë për shqyrtimin e ankesës eventuale të paditësit se Bordi i Drejtorëve nuk ka ekzistuar, dhe me të drejtë paditësi nuk është udhëzuar që kundër vendimit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të paraqet ankesë.
Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të parë, se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës është marrë në kundërshtim me të gjitha procedurat ligjore dhe dispozitat ligjore, veprime këto qe vendimin e atakuar e bëjnë me tepër se të paligjshëm dhe me ketë vendim edhe i cenohet e drejta e tij e punës e mbrojtur edhe me nenin 49 të Kushtetutës se Kosovës, për arsye se: dispozita kushtetuese në aspektin parimor e garanton të drejtën e punës, mirëpo kjo garanci i nënshtrohet dispozitave dhe rregullave ligjore, dhe në këtë rast pozita e paditësit i nënshtrohet përcaktimit ligjor në raport me detyrat dhe përgjegjësit e tij duke përfshirë edhe emërimin dhe shkarkimin e tij. Pra kjo gjykatë në këtë procedurë ka vlerësuar se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, ishte vendim i ligjshëm dhe në përputhje me dispozita ligjore, ndërsa në raport me nenin 49 të Kushtetutës, paditësi e gëzon të drejtën e punës në vende të tjera të punës sipas zgjedhjes së tij.

Kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatave të instancave me të ulëta, me konstatimin se paditësit ju ka cenuar e drejta në shfrytëzimin e mjetit juridik efektiv, për arsye se:

Me nenin 31 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".*

Me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".*

Me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".*

Me nenin 13 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcaktohet se: *"E drejta për zgjidhje efektive Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".*

Nga përmbajtja e dispozitave kushtetues dhe konventës të cituara rezulton se në këtë rast paditësit nuk ju ka mohuar e drejta për qasje në drejtësi dhe as cenimi i të drejtës për shfrytëzimin e mjetit juridik efektiv, për faktin se:

Në këtë kontekst në këtë rast organ me i lartë për shqyrtimin e ankesës eventuale të paditësit se Bordi i Drejtorëve nuk ka ekzistuar, dhe me të drejtë paditësi nuk është udhëzuar që kundër vendimit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të paraqet ankesë. Ndërsa edhe pse në vendimin me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, nuk ka udhëzim juridik, për mjetin juridik nuk ja ka pamundësuar e drejta, për paraqitjen e padisë në gjykatë, gjë të cilin e ka bërë paditësi dhe në këtë kontekst gjykata e ka vlerësuar padinë e paditësit si të lejuar dhe të afatshme dhe ka vendosur lidhur me kërkesën e paditësit në mënyrë

meritore, mirëpo paraqitja e padisë në gjykatë nuk nënkupton se kërkesëpadia e palës që ka paraqitur padi është e bazuar.
Përveç të cekurave palës paditëse, nuk ju ka mohuar qasjen në drejtësi, për arsye se:
Qasja në drejtësi përbën një element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar nga neni 31 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 6 i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, instrument ky drejtpërdrejtë i zbatuar në rendin tonë juridik sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, çdokush gëzon të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe se është pranuar si parakusht i të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.
Pra, e drejta e qasjes në gjykatë paraqet një ndër elementet bazë të parimit të sundimit të së drejtës ngaqë kjo u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate.
Në përgjithësi, e drejta për qasje në gjykatë garanton të drejtën për të filluar seancat gjyqësore përpara një gjykate dhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor, si rezultat i diskutimeve dhe vlerësimeve të bëra pranë një gjykate të pavarur lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile apo akuzat penale që rëndojnë mbi subjektet e së drejtës.
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si vlerë të rendit juridik kushtetues ekzistues (neni 7) ka mishëruar parimin e sundimit të së drejtës (ligjit) - ku autoriteti shtetëror përveç se krijon "të drejtën", njëkohësisht i nënshtrohet kësaj të fundit dhe e zbaton dhe detyrohet nga ajo në mënyrë të barabartë krahas subjektet tjera të së drejtës. Në këtë kontekst, garancia procedurale e qasjes në drejtësi paraqet një ndër "urat", lidhëse midis subjektit të së drejtës që pretendon se i takon, i është shkelur, kufizuar, cenuar apo dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes i tij dhe mekanizmave shtetërorë - gjykatat dhe/ose organet tjera të pavarura (kuazi gjyqësore) që janë të m' veshur me juridiksion dhe kompetencë për garantimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra e drejta për qasje në gjykatë, iu jep efekt respektivisht i jetëson parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të së drejtës

Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute. GJEDNJ në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar është shprehur se vetë natyra e saj (të drejtës për qasje në gjykatë) kërkon rregullim përkatës legjislativ (që mund të ndryshojë në kohë dhe vendndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga shteti, megjithëse rregullime të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin/esencën e së drejtës e as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ. Në këtë kontekst gjykatat e rregullta në ushtrimin e funksionit të tyre kanë për obligim që të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe Gjykata Supreme e Kosovës në këtë rast ka vlerësuar se qasja në drejtësi është parakusht thelbësor për realizimin e të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës respektivisht Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke marr për bazë faktin se paditësi nuk ka argumentuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë me shkelje të dispozitave ligjore të cituara, ka vendosur ta refuzoj edhe kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që në emër të kompensimit të dëmit në formën e pagave të parealizuara prej datës 24.10.202018 deri më datën 30.10.2020, t'i paguaj shumën si në vijim: në emër të ardhurave neto shumën prej 22.086,12 €, në emër kontributit pensional (5% +5%) shumën prej 2.519,10 €, në emër të taksës shumën prej 1.845,33 € dhe atë me kamat vjetore prej 8% nga përmbushja e çdo kërkese veçmas nga pagesa përfundimtare, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Obligohet e paditura Kompania Regjionale e Ujësjellësit - KRU Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, që paditësit Ramadan Sejdiu në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj shumën prej 2,016 €, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kjo gjykatë vlerëson se kërkesat nga marrëdhënia e punës janë të ndërlidhura dhe atë: fillimisht duhet të provohet me prova se ka ndodhur shkelja e të drejtave të punëtorit, pra ndërprerja e marrëdhënies së punës të jetë bërë në kundërshtim me dispozita ligjore, e pasi të vërtetohet/konstatohet një shkelje e tillë, e paditura mund të obligohet nga gjykata, për kthimin e paditësit në të njëjtën pozitë apo në një pozitë

ekuivalente me të, dhe detyrimin për pagesën e kompensimit përkatës, e që në këtë rast një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për arsye se ndërprerja e marrëdhënies së punë është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
Për hir të praktikës gjyqësore edhe pse në praktikën gjyqësore, e në veçanti në gjykatat e instancave më të ulëta, si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë, duke mos përjashtuar edhe këtë gjykatë rreth aplikueshmerisë së ligjeve të cituara si më lartë, se cili ligj në rastet e tilla duhet të aplikohet, ka pasur dilema dhe vendimmarrje ndryshe, këto nuk janë me ndikim për vendimmarrje ndryshe në këtë rast nga kjo gjykatë, për arsye se secili vendim gjyqësor me të cilin përfundon procedura kontestimore mund ti nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të LPK-së, mirëpo është fakt jokontestues se praktika gjyqësore si burim i së drejtës mund të përdoret vetëm kur ajo është krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, si e vetmja gjykatë kompetente në bazë të Ligjit për Gjykata, për krijimin e praktikës gjyqësore, si me qëndrime parimore, mendime juridike dhe udhëzues juridik, ashtu edhe me vendime gjatë vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme.
Sipas vlerësimit të kësaj gjykata, duke ju referuar gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykatat e instancave me të ulëta, dhe meqenëse në këtë rast por edhe në raste të ngjashme me gjendje faktike dhe juridike të njëjtë, procedura kontestimore është zhvilluar apo zhvillohet në mes të paditësit dhe të padituërës si ndërmarrje publike regjionale/qendrore e cila është kompani në pronësi publike, ndërsa pozita e punës së paditësit për të cilën i është ndërprerë marrëdhënia e punës ka qenë Zyrtar Kryesor Financiar apo pozita tjera siç është përcaktuar me nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, është qartësuar se në këto raste duhet aplikuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i cili e përcakton mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për pozitën Zyrtar Kryesor i Financave, si ligj special i cili në raport me emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj. Në këtë kontekst me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përcaktohet se: “Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare”. Andaj në këtë rast

por edhe në raste të ngjashme Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes duhet aplikuar edhe dispozitat e Ligjit për Shoqëri Tregtare, duke marr për bazë faktin se e paditura e ka statusin e shoqërisë aksionare. Po ashtu, duke marr për bazë natyrën e kontestit, i cili ka të bëjë me ligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen marrëdhënie së punës, duhet aplikuar edhe dispozitat e Ligjit të Punës, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast është pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka refuzuar kërkesën e palës paditëse edhe për kompensimin e shpenzimeve të procedurës, pasi pala paditëse e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar sipas revizionit kërkesë për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 449, 452 paragrafi 1, e lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas padisë së paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendimi Rev.nr.195/2025, i datës 07.07.2025

A K T V E N D I M

PRANOHET revizioni i paditësit: Ahmet Shala nga Peja, rr. “Ahmet Kukleci” dhe revizioni i të paditurit: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2209/2022, i datës 10.12.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.16/2020, i datës 18.02.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragrafi 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës.
Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.
Nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk mund të kuptohet se gjykata çka ka aprovuar, detyruar dhe çka ka refuzuar. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur sipas kërkesave të palëve dhe nuk ka sqaruar saktë se për cilat kategori të dëmit është aprovuar kërkesa dhe për cilat është refuzuar.
Duhet theksuar se arsyetimi mirë i vendimeve gjyqësore nuk është thjesht një detyrim ligjor, por gjithashtu një proces i cili ka për qellim të shërbej në disa dimensione. Fillimisht, vendimet gjyqësore të arsyetuara mirë, kanë për qellim të transmetojnë dhe tu tregojnë palëve se argumentet e tyre janë dëgjuar dhe konsideruar në mënyrë meritore nga ana e gjykatës. Përmes arsyetimit adekuat ligjor, palët në procedurë mund të kuptojnë pse dhe si gjykata ka arritur në një përfundim të caktuar në çështjen objekt shqyrtimi dhe, për rrjedhojë, të marrin parasysh nevojën e përdorimit të mjetit juridik. Në këtë kontekst, arsyetimi i mirë gjithashtu lehtëson pranimin e gjykimit nga palët dhe nga publiku i gjerë. Në përgjithësi, vendimet gjyqësore (aktgjykimet) të arsyetuara mirë janë po ashtu, në funksion të mbrojtjes ndaj gjykimit arbitrar dhe garantojnë dhënien e duhur të drejtësisë, por edhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Pra në këtë kontekst, gjatë procesit të vendimmarrjes, gjykatat janë zakonisht të detyruara sipas ligjit të japin arsyetim të detajuar për vendimet e tyre. Megjithatë, edhe pse vendi ynë nuk është pjesë e KEDNJ, detyrimet thelbësore në lidhje me përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore burojnë gjithashtu nga KEDNJ, siç interpretohet nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore. Një detyrim i tillë për gjykatat vendore dhe institucionet publike rrjedh nga suprema lex, Kushtetuta se Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KRK), dhe atë duke pasur parasysh faktin se, gjykatat, nëpërmjet zbatimit dhe interpretimit të normave kushtetuese për të drejtat e njeriut, në pajtim me praktikën e GJEDNJ, e kanë pranuar interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut në pajtim me vendimet gjyqësore të kësaj gjykate, prandaj edhe neni 53 i KRK, e kërkon përmbushjen e këtij detyrimi. Përmbushja e këtij detyrimi arsyetohet me faktin se, gjykatat dhe organet tjera që do t'i interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me KRK, do t'i përkrahin vendimet gjyqësore të GJENDJ, dhe të njëjtat rast pas rasti do t'i përfshijnë në përmbajtjen e vendimeve të tyre me rastin e vendosjes. Përveç nenit 53 të KRK, instrumentet kryesore në fushën e mbrojtjes se të drejtave dhe lirive të njeriut zbatohen drejtpërdrejt në territorin e Republikës së Kosovës përmes nenit 22 të KRK, dhe ajo çfarë është shumë me rëndësi është fakti se të këto të drejta dhe liri kanë epërsi në rast të konfliktit ndaj të gjitha dispozitave ligjore dhe akteve tjera të institucioneve publike.

Për me tepër, detyrimi i gjykatave vendore për të dhënë arsye për vendimet e tyre është shprehur shprehimisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, sipas nenit 6 të KEDNJ, i cili është burimi kryesor - por jo i vetmi - i detyrimit të gjykatave vendore për të dhënë një vendim të arsyetuar gjyqësor. Ky detyrim mund të rrjedhë gjithashtu edhe nga detyrimet pozitive dhe procedurale që rrjedhin nga një sërë dispozitash tjera thelbësore të KEDNJ (p.sh., nenet 2, 3, 5, 8-11 të KEDNJ). Pra, përgjegjësia parësore për një vendim të arsyetuar në harmoni me standardet e GJEDNJ bie mbi gjyqtarin hartues, duke mos lënë anash edhe profesionistet tjerë ligjor, siç janë: prokuroret dhe bashkëpunëtorët profesional, të cilët megjithatë, kanë gjithashtu një përgjegjësi të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar. Kjo nënkupton se të gjithë profesionistet brenda sistemit gjyqësorë janë të

lidhur nga një përgjegjësi e përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ngritjen e sigurisë juridike dhe përmirësimin e sundimit të ligjit.
Pra garancitë e parashikuara në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ, përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar, duke vendosur mbi bazën e parashtrimeve të tyre. Pra, vendimi gjyqësor duhet të perceptohet nga palët dhe nga shoqëria në përgjithësi si rezultat i zbatimit korrekt të normave ligjore, i një procedure të drejtë dhe i një vlerësimi të duhur faktik, si dhe i zbatueshëm efektivisht. Megjithëse gjykata e rregullt ka një kufi të caktuar vlerësimi kur zgjedh argumentet dhe pranon provat, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet e saj duke dhënë arsyet për vendimet e saj.
E drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor është e mishëruar në përmbajtjen e KEDNJ-së, dhe që ka për qellim mbrojtjen e individit nga arbitrariteti. Një vendim gjyqësor i gjykatës vendore duhet të përmbajë arsye që janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur aspekteve esenciale të argumenteve faktike dhe ligjore – materiale dhe procedurale të palës në kontest. Gjithashtu, arsyetimi duhet të pasqyrojë pajtueshmërinë e gjyqtarëve me parimet e shpallura nga GJEDNJ-së, përkatësisht respektimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtës për një gjykim të drejtë.
Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhënia e arsyeve në vendim varet nga argumentet e ndryshme të parashtruara nga secila palë, si dhe nga dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe opinionet ligjore, si dhe nga praktikat e ndryshme në lidhje me hartimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të shteteve të ndryshme. Për të respektuar parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të tregojë se gjyqtari ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë parashtruar para tij. Pra, funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për me tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t{u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e apelit. Neni 6 i KEDNJ-së, dhe neni 31 i KRK-së, i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si detyrim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të palës në kontest.

Lidhur me këtë, e drejta për gjykim të drejtë mund të jetë efektive, vetëm nëse gjykata është e detyruar të arsyetoj vendimet e saj, e që është gjithashtu një garancion vital kundër arbitraritetit. Sipas KEDNJ-së, nëse nuk jepen arsye për vendimin ose nëse arsyet e dhëna bazohen në një gabim të qartë faktik ose ligjor të kryer nga gjykata, kjo pashmangshmërisht rezulton në "mohim të drejtësisë, " e për rrjedhojë në gjykim arbitrar. GJEDNJ-së në disa raste është ballafaquar jo me mungesë të plotë të arsyeve, por me inkoherencë të hapur të arsyeve të dhëna në aktgjykim, dhe nga gjykata kjo është konsideruar si arbitraritet. Në rastin Tatishvili v. Russia, GEDNJ-së, ka riafirmuar se, arsyetimi dukshëm i mangët nga gjykata e shkalles se parë, dhe aprovimi i mëvonshëm i një arsyetimi të tillë joadekuat nga gjykata e apelit, nuk përmbush kërkesat e një gjykimi të drejtë, dhe rezulton në vendimmarrje arbitrare.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragraf 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara vetëm sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Pra kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet thelbësore të ngritura nga pala paditëse dhe pala e paditur, e që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial. Po ashtu në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë nga pala paditëse dhe pala e paditur, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Kjo mënyrë e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë është në kundërshtim me nenin 204 të LPK-së, i cili ka përcaktuar si obligim për gjykatën e shkallës së dytë që t'i vlerësoj pretendimet ankimore të palëve e të cilat kanë qenë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Sipas kësaj gjykate, nuk mjafton që gjykata e shkallës së dytë vetëm të konstatoj se nuk ekzistojnë këto shkelje dhe ta përsëritë formulimin e dispozitës ligjore, por është obligim që të paraqes arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar nga pala. Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimet të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst nëse i referohemi doktrinës juridike dhe posaçërisht praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vërehet influenca e të drejtave themelore në sferën e të drejtës private. Pra, ky ndikim i të drejtave themelore në të drejtën private shihet në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e personalitetit, konkretisht me shpërblimin e dëmit jomaterial në rastin e mbrojtjes se të drejtave të personalitetit, dinjitetit dhe reputacionit. Koncepti i dignitas hominis në mendimin klasik romak ka nënkuptuar kryesisht "statusin". Në fakt, dignitas nuk kufizohej vetëm për njerëzit por aplikohej për institucionet dhe vetë shtetin. Ky koncept i dinjitetit prej kohesh është përfshirë në disa sisteme juridike në kontekstin e së drejtës private, si bazë për sigurimin e mbrojtjes së dinjitetit në kuptimin e "statusit", "reputacionit", dhe "privilegjeve".

Në vendin tonë, dinjiteti i njeriut është ngritur në rang kushtetues, dhe paraqet një prej vlerave themelore mbi të cilën mbështetet rendi juridik kushtetues. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ka përcaktuar se, "Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut". Si i tillë, dinjiteti i njeriut hynë në kategorinë e të drejtave absolute dhe se shmangia nga kjo e drejtë nuk justifikohet në asnjë rrethanë, madje edhe rrethana të jashtëzakonshme qofshin ato.

Sa i përket mbrojtjes se ofruar nga KEDNJ-së, edhe pse në dispozitat e saj (përveç preambulës) dinjitetin njerëzor nuk e përmend shprehimisht, megjithatë, sipas praktikes gjyqësore të GJEDNJ-së, është riafirmuar koncepti se respektimi i dinjitetit të njeriut është vet thelbi i konventës.

Në të drejtën moderne është përfshirë koncepti i përgjegjësisë për dëmin jomaterial, i njohur si koncepti objektiv i dëmit jomaterial i cili bazohet në parimin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit. Më saktësisht, koncepti objektiv i dëmit jopasuror bazohet në rregullin se çdo shkelje e të drejtave të personalitetit përbën në vetvete një dëm jopasuror.

Në këtë mënyrë, kur vjen në shprehje cenimi i dinjitetit të njeriut, GJEDNJ-së ka përcaktuar inter - alia se kushdo që është ndaluar në kushte që nuk respektojnë dinjitetin personal të individit duhet të jetë në gjendje të marrë shpërblim adekuat. Lidhur me këtë, qëndrimi i praktikes gjyqësore të GJEDNJ-së, në rastet e cenimit të dinjitetit njeh si mjet juridik, shpërblimin e dëmit jomaterial.

Në anën tjetër, GJEDNJ-së në praktikën e saj gjyqësore, mbrojtjes së reputacionit i ka kushtuar kujdes të veçantë, dhe atë përmes sigurimit të mjetit efektiv juridik në rastet e cenimit të reputacionit. Në këtë mënyrë, sipas praktikës gjyqësore, e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur sipas nenit 8 të KEDNJ-së, si pjesë e të drejtës për respektimin e jetës private. Dhe, në mënyrë që të vie në shprehje efekti i këtij neni, sulmi ndaj reputacionit të ndonjë personi duhet të arrij një nivel të caktuar të seriozitetit, dhe të behet në një mënyrë që shkakton paragjykim ndaj gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private, (Libicki v. Poland).

Humbja e reputacionit vjen shprehje në shumicën e rasteve kur ndodh publikimi i informacioneve rreth jetës private të ndonjë personi, dhe atë përmes artikujve të të përditshmëve apo edhe në ndonjë forme tjetër. Mirëpo, në mënyrë që gjykata të marr në shqyrtim çështjen për cenimin e reputacionit, fillimisht aplikuesi duhet të dëshmoj se shteti nuk i ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme, dhe se kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e reputacionit.

Në rastin, Mas Gavarró v. Spain, shteti spanjoll kishte theksuar se, pala është dashur që të parashtroj padi me kërkesë për korrektimin e publikimit brenda afatit ligjor, apo të inicoj procedurë të veçantë për mbrojtjen e nderit të tij, me qellim të sigurimit të shpërblimit, për dëmtimin e reputacionit. Megjithatë, duke zgjedhur vetëm rrugën penale, i njëjti kishte privuar vetveten nga mundësia e sigurimit të shpërblimit, për shkeljen e pretenduar në procedurë civile.

Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se: kompensimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit/nderit është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së. Për të ekzistuar mundësia e shpërblimit të këtij dëmi duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet cenimi i autoritetit, nderit të njeriut, b) të shkaktojë vuajtje psikike të i dëmtuari, c) kjo vuajtje të ketë intensitet të caktuar dhe kohëzgjatje të caktuar, d) të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit, e) të ekzistojë lidhja kauzale midis këtij cenimi dhe dëmit të shkaktuar, dhe f) nga ky cenim të shkaktohet dëmi jomaterial.

Sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të heqjes së lirës pa bazë ligjore, për arsye se:

Nga perspektiva e praktikes gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial lidhur me arrestimin dhe privimin e kundërligjshëm duhet të jetë e vlefshme si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë praktik. Në këtë drejtim, GJEDNJ-së, në rastin Dubovik v. Ukraine, ka konstatuar mungesë të mundësisë teorike nga ana e aplikuesit, për të kërkuar shpërblimin, për privim nga liria para autoriteteve vendore. Ndërsa, sa i përket vlefshmërisë se shpërblimit nga aspekti praktik, GJEDNJ, në rastin Chitayev v. Russia, ka ripërsëritur se, mos përfundimi i procedurës, përkatësisht pezullimi i saj, i ka pamundësuar efektivisht palës që të kërkoj shpërblimin, për kohen e kaluar në paraburgim. Pra, në secilin rast autoritetet kompetente duhet t'i sigurojnë shpërblim individit i cili në ndonjë rast është subjekt i arrestimit ose paraburgimit të pabazë, dhe kjo mundësi duhet të jetë e vlefshme si në teori, po ashtu edhe në praktikë. Dhe për me tepër, gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e demit, për paraburgim të paligjshëm, autoriteteve u kërkohet që të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën e brendshme në frymën e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ), pa formalizëm të tepruar, dhe çdo veprim në kundërshtim më këtë kërkesë, rezulton në shkelje të dispozitave të KEDNJ-së, përkatësisht nenit 5.

Sidoqoftë, KEDNJ-së ka për qëllim të garantoj jo të drejtat të cilat janë teorike dhe iluzore, por të drejtat të cilat janë praktike dhe efektive, (Cumber v. The United Kingdom). Lidhur me këtë, GJEDNJ-së në raste

të caktuara ka hasur në mungesë të së drejtës, për shpërblim të dëmit jomaterial, për shkak të demit të pësuar si rezultat i paraburgimit të paligjshëm. Në këtë mënyrë, në rastin Khachatryan and Others v. Armenia është konstatuar se, shtetet e caktuara në dispozita të ligjeve civile [Kode Civile], e kanë kufizuar këtë të drejtë vetëm sa i përket shpërblimit të demit material, pa përfshirë edhe shpërblimin për demin jomaterial, për shkak të stresit dhe ankthit të përjetuar nga ana e personit si pasojë e mbajtjes në paraburgim pabazë ligjore.

Në këtë mënyrë, mos njohja e së drejtës, për shpërblim të demit jomaterial nga ana e autoriteteve në strukturën e tyre ligjore, ka për pasojë shkeljen e dispozitave të KEDNJ-së. Nga kjo perspektive e GJEDNJ-së, duhet të merret për bazë fakti se në çdo rast të cenimit të të drejtave të subjektit, për arsye të arrestit apo privimit të paligjshëm, e drejta për shpërblim të demit jomaterial, për ankthin dhe stresin e përjetuar duhet të jetë një e drejtë e garantuar, kjo paraqet një garancion të mishëruar në dispozitat e nenit 5.5 të KEDNJ-së, përndryshe çdo veprim në kundërshtim me këtë garancion, paraqet shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Përveç dispozitave të KEDNJ-së, e drejta e shpërblimit, për arrestim dhe privim të paligjshëm është përcaktuar edhe me dispozitat e Kushtetutës së Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Pra, Kushtetuta garanton të drejtën e shpërblimit pa përmendur apo kategorizuar format e demit të cilat pala mund t'i kërkoj, para organeve/institucioneve shtetërore.

Ky garancion është përcaktuar me nenin 29 paragrafi 5 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: *"Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj".*

Siç edhe u theksua me lartë, kjo normë kushtetuese garanton të drejtën e shpërblimit, për ndalim apo arrestim të paligjshëm, pa përmendur format e shpërblimit të demit, të cilat pala mund t'i kërkoj në procedure gjyqësore. Dhe, për me tepër, duke pas parasysh faktin se, Kushtetuta me nenit 53, ka përcaktuar se: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Andaj, në ushtrimin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe lirive themelore të

garantuara me Kushtetutë, institucionet duhet t'i marrin për bazë vendimet gjyqësore të GJEDNJ. Kjo është evidente në një masë si në praktiken gjyqësore të gjykatave të rregullta, ashtu edhe në atë të Gjykatës Kushtetuese. Ky rregullim i dyfishtë në rendin tonë juridik lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, padyshim se paraqet një mënyrë efektive për sigurimin e realizimit të së drejtës, për shpërblim të dëmit, në rrethanat kur atyre u është mohuar apo pakësuar një e drejtë e tillë, siç mund të ndodhë në rastet e arrestimit apo privimit të paligjshëm.

Vlerësimi i shumës së dëmit në rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial, nuk është një detyrë e lehtë, veçanërisht kur objekt i padisë është vuajtja personale, qoftë fizike apo psikike. Kjo, ngjashëm vlerësohet edhe nga perspektiva e GJEDNJ, e cila në rastin Vasilevskiy and Bogdanov v. Russia, ka theksuar se, nuk ka asnjë standard me të cilin dhimbja dhe vuajtja, përkatësisht shqetësimi fizik dhe ankthi psikologjik mund të maten në terma parash. Meqenëse, nga vlerësimi i GJEDNJ-së nuk ka një standard strikt sa i përket njohjes së shumës se shpërblimit, si mënyrë që ka marr parasysh është standardi i jetesës në vendin e caktuar, duke përfshirë, pagën minimale, mesataren e pensionit të pleqërisë, dhe pagën mesatare bruto, (Nikitin and Others v. Estonia). Në rastet kur një individi i njihet shuma e shpërblimit, ajo nuk duhet të jetë tepër e ultë saqë të minojë esencën e së drejtës për shpërblim sipas nenit 5.5 të KEDNJ. Pra, nuk duhet të jetë pa-arsyeshmerisht e ulët, dhe jo në konformitet me standardin e jetesës, përndryshe do të kualifikohet si shkelje e të drejtës së garantuar me këtë dispozitë.

Siç është theksuar edhe me lartë, e drejta për shpërblim lidhet kryesisht me kompensimin financiar. Në fakt, ky shpërblim nuk përcakton të drejtën për të siguruar lirimin e personit të ndaluar, e cila e drejtë rregullohet nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së. Pra, neni 5.5 i KEDNJ-së, përfshin të drejtën e shpërblimit jo vetëm sa i përket demit material, por edhe shpërblimin lidhur me stresin, ankthin dhe vuajtjen shpirtërore që një person mund t'i këtë përjetuar si rezultat i shkeljes se dispozitave tjera të nenit 5 të KEDNJ-së, (Sahakyan v. Armenia). Në rastet e paraqitjes së padisë, për shpërblimin e demit jomaterial, i cili derivon nga një situatë e privimit të kundërligjshëm, është e nevojshme që një procedurë e tillë e shpërblimit të zhvillohet nga institucionet shtetërore

pa formalizëm të tepruar, dhe në këtë mënyrë t'i mundësohet palës qasje e lehtë në realizimin e të drejtave të tij subjektive. Dhe, ky shpërblim në mënyrë që të jetë në përputhje me garancitë e përmbajtura në dispozitat e KEDNJ, nuk duhet kufizuar në shpërblimin vetëm të demit material, por duhet në çdo rast të jetë e zbatueshme e drejta e shpërblimit të demit jomaterial.

Nëse i referohemi dispozitave ligjore të LMD-së, rezulton se: shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore, është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

Shpërblimi i dëmit jomaterial mund të realizohet edhe kur shkaktohet cenimi i lirisë-gjegjësisht heqja e lirisë pa bazë ligjore. Këto raste të shpërblimit të dëmit janë të shpeshta në praktikën gjyqësore te vendit, sepse janë të shpeshta rastet kur cenohet liria për shkak të heqjes së saj, pa bazë ligjore. Andaj, kur këto raste ekzistojnë në kushte të caktuara, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë realizimin e shpërblimit të dëmit, për shkak të vuajtjes psikike të pësuar si pasojë e heqjes së lirisë pa bazë ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës tashmë ka ndërtuar praktikën gjyqësore se mbi cilat kritere do të vendoset për shpërblimet e dëmit të tillë jomaterial, ndërsa rol në këtë ka edhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, që ka përcaktuar se caktimi i kompensimit për këto kategori duhet të trajtohet si satisfaksioni i të dëmtuarve dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

Për t'u realizuar e drejta në shpërblimin e dëmit jomaterial, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore duhet të plotësohen këto kushte: a) të hiqet liria, b) me heqjen e lirisë të shkaktohet vuajtja psikike e të dëmtuarit, c) të ekzistoj lidhja kauzale midis heqjes së lirisë dhe shkaktimit të vuajtjes psikike, dhe d) heqja e lirisë të shkaktohet me fajin e dëmtuesit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se me rastin e gjykimit të shpërblimit për këtë lloj të dëmit, nuk ka arsye për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë, pasi vuajtjet janë evidente dhe nuk ka nevojë të provohen përmes ekspertizës. Përjashtimisht ekspertiza mund të caktohet nëse i dëmtuari ka histori mjekësore të trajtimit mjekësor të aspektit psikiatrik, dhe atë me qëllim të vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe dhënies së mendimit nëse ekziston lidhja kauzale në mes dokumentacionit mjekësor dhe privimit nga liria

Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit për këtë lloj të dëmit jomaterial, duhet të marrë parasysh moshën e të dëmtuarit, personalitetin e tij, profesionin, jehonën mediatike që i është dhënë rastit me rastin e arrestimit të dëmtuarit dhe gjatë kohës së heqjes nga liria, kohëzgjatjen e privimit nga liria, nëse heqja e lirisë ka konsistuar vetëm në arrest shtëpiak apo qëndrim në paraburgim, natyrën e veprës për të cilën është mbajtur në heqje lirie, si dhe kritere tjera.

Nga kjo rezulton se nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimet të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

Gjykata Supreme nuk mund ta pranoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë as për pjesën e kërkesës lidhur me fitimin e humbur, për arsye se:

Nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.

Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën.

Po ashtu nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se: Fitim i humbur është një lloj i veçantë i dëmit material. Ky lloj i dëmit ekziston kur i dëmtuari pengohet për t'iu rritur pasuria. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se fitimi i humbur mund të realizohet kumulativisht me dëmin real, nëse ekzistojnë kushtet e caktuar për të.

Fitimi i humbur sipas dispozitave të LMD-së, nënkupton vetëm atë fitim për të cilin është i sigurt se kreditori sipas rrjedhës së rregullt të gjerave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do ti realizojë.
Gjithashtu edhe në raport me pjesën e kompensimit të dëmit material për shpenzimet për avokat në procedurë penale, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke mos e argumentuar me prova bindëse se cilat kanë qenë shpenzimet e domosdoshme të palës në procedurë penale. Nuk mjafton vetëm fakti se pala ka pasur mbrojtës në këtë procedurë penale, por duhet të shihen edhe rrethanat e tjera se a ka qenë e domosdoshme prezenca e mbrojtësit, nëse po për cilat raste, nëse jo, a ka pas mundësi pala që ti mbroj të drejtat e tij edhe pa prezencën e avokatit, nëse avokati është paguar për seancat të cilat ka qenë, nga pala apo sipas detyrës zyrtare dhe rrethana të tjera që dëshmojnë se kërkesa lidhur me këtë pjesë të dëmit është e bazuar dhe se realisht palës i është shkaktuar dëm në ketë procedurë.
Përveç të cekurave, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se hartimi i dispozitivit si nga ana e gjykatës së shkallës së parë, po ashtu edhe nga gjykata e shkallës së dytë është i paqartë dhe kontradiktor, nuk dihet saktë dhe drejtë se çka është aprovuar dhe çka është refuzuar dhe të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se: gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë vlerësuar drejtë dhe saktë provat që gjenden në shkresat e lëndës, në arsyetim të aktgjykimit nuk janë dhënë sqarime të mjaftueshme mbi kërkesat të cilat janë aprovuar, dhe ato që janë refuzuar, përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, nuk i kanë vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimor dhe si rezultat i kësaj kanë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, andaj aktgjykimet e instancave më të ulëta është dashtë të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmerr hapat tjerë procedural në

drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrustem Thaqi

Parashkrimi, Rregullat e Përgjithshme, Afati, Ndalja dhe Ndërprerja e Parashkrimit në Marrëdhëniet e Detyrimeve

1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me parashkrimin

Parashkrimi në kuptimin e përgjithshëm nënkupton humbjen e mundësisë së kreditorit për të kërkuar në rrugë gjyqësore, realizimin e të drejtës së tij pas kalimit të afatit kohor. Rregullat e parashkrimit, në përgjithësi dhe në kuadër të së drejtës së detyrimeve, përcaktojnë se subjektet e këtyre marrëdhënieve duhet të jenë të kujdesshëm në realizimin e të drejtave të tyre, sepse nëse një kujdes i tillë mungon, pasojë do të jetë humbja e atyre të drejtave. Parashkrimi nuk cenon lirinë e veprimit të individit, pasi individët janë të vetëdijshëm se raportet juridike që ata krijojnë prodhojnë të drejta dhe detyrime, dhe kur këto raporte karakterizohen nga afate të caktuara kohore, atëherë, nëse këto afate nuk respektohen ose shfrytëzohen si duhet, pala (zotëruesi i kërkesës) humb të drejtën ose mundësinë për të kërkuar realizimin e së drejtës së vet në rrugë gjyqësore. Parashkrimi, si institut juridik, ekziston pothuajse në të gjitha fushat e së drejtës, si në atë penale, administrative, civile, kundërvajtëse, të punës, tregtare, disiplinore, etj. Parashkrimi është një institut juridik i së drejtës së detyrimeve, sipas të cilit pala humb të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit në gjykatë, për shkak të kalimit të afatit kohor brenda të cilit duhej paraqitur padia apo kërkesa. Parashkrimi i kërkesave, përveçse nuk cenon marrëdhëniet juridike, përkundrazi përbën një garanci për sigurinë juridike duke i shtyrë kreditorët që të jenë më efikas në aspektin kohor dhe që kërkesat e tyre t'i parashtrojnë e t'i mbrojnë brenda afateve të caktuara, sepse pas kalimit të afatit të parashikuar me ligj mund të bëhet e pamundur mbrojtja e atyre të drejtave në rrugë gjyqësore.

Në këtë kontekst, mund të thuhet se parashkrimi konsiderohet një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës së detyrimeve, sepse siguron që marrëdhëniet obligative të jenë më të qëndrueshme. Kreditorët duhet të jenë shumë të kujdesshëm që kërkesat e tyre të realizohen dhe të mos lejojnë që parashkrimi të ndikojë në marrëdhëniet e tyre. Prandaj,

parashkrimi paraqet një nga mënyrat e shuarjes së detyrimit, që manifestohet përmes sjelljes pasive të kreditorit dhe asaj aktive të debitorit. Këtu vihet në pah roli dhe rëndësia e palëve në procedurë, që të shuhet një detyrim apo të humbet e drejta për realizimin e tij në rrugë gjyqësore, kërkohet që kreditori të jetë pasiv ose joefikas në aspektin kohor (duke paraqitur kërkesën pas afatit të përcaktuar me ligj), ndërsa debitori të jetë aktiv (duke u thirrur në parashkrim); rrjedhimisht, rolet e tyre, megjithëse të ndara, janë përcaktuese për krijimin e parashkrimit.

Instituti i parashkrimit, në teori, arsyetohet në mënyra të ndryshme, të tilla si nevoja sociale; shmangia e kontesteve pa mbarim, sanksionimi i moskujdesit personal të bartësit të së drejtës subjektive, dhe pranimi i përgjithshëm i këtij instituti në vetëdijen e qytetarëve, etj. Mirëpo, arsyeja kryesore e krijimit të këtij instituti është sjellja e bartësit të së drejtës subjektive, përkatësisht sjellja e tij pasive, e cila krijon supozimin se ai nuk ka interes për të realizuar të drejtën e vet. Një supozim i tillë arsyeton qëndrimin e shoqërisë, sipas të cilit, kur bartësi i së drejtës subjektive sillet siç u theksua më lart, atij i kufizohet mbrojtja gjyqësore e asaj të drejte.

Parashkrimi, si institut juridik ka për qëllim garantimin e sigurisë juridike, duke i nxitur kreditorët që t'i mbrojnë kërkesat e tyre brenda një afati të caktuar, sepse pas kalimit të atij afati mbrojtja e të drejtave në rrugë gjyqësore mund të bëhet e pamundur, për shkak të kalimit të kohës së parashikuar me ligj. Sipas teoricienëve, parashkrimi i padisë përkufizohet si mosveprimi i subjektit të një të drejte civile, të shkelur ose të kundërshtuar, gjatë gjithë periudhës së caktuar nga ligji, për të siguruar, nëpërmjet paraqitjes së padisë, mbrojtjen e asaj të drejte nga organet shtetërore kompetente, ky mosveprim ka për pasojë shuarjen e së drejtës së padisë në kuptimin material.

Instituti i parashkrimit krijon siguri në marrëdhëniet juridike midis subjekteve të detyrimeve. Në këtë kontekst, mund të thuhet se interesi i përgjithshëm shoqëror kërkon që këto marrëdhënie të kenë qëndrueshmëri dhe përcaktueshmëri, dhe kjo mund të arrihet në atë mënyrë që, pas kalimit të një periudhe kohore të caktuar me ligj, nuk lejohet që e drejta e subjektit të detyrimeve të mbrohet me anë të padisë në gjykatë.

1.1. Rregullat e përgjithshme lidhur me parashkrimin

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012 (në tekstin e mëtejmë - LMD), ka rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve, përveç tjerash edhe shuarjen e marrëdhënieve të detyrimeve me parashkrim, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të.

Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar edhe rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm. Duhet theksuar se dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, dt.26.05.1978, dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.05.2012, sa i përket dispozitave lidhur me parashkrimin, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të kanë përmbajtje pothuaj identike, me përjashtim të disa risive të ligjit të ri, dhe atë: neni 352 afati i përgjithshëm i parashkrimit, 353 paragrafi 3 Kërkesat periodike, 357 paragrafi 4 kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale dhe neni 360 afati një vjeçar i parashkrimit.

Në praktikën gjyqësore, janë paraqitur një numër i konsiderueshëm i rasteve ku parashkrimi është një ndër rastet me të shpeshta të shuarjes së marrëdhënieve të detyrimeve kundër vullnetit të subjekteve të detyrimeve. Mirëpo dinamika e rasteve të paraqitura, si pasoj e parashkrimit, ka ndikuar që të ketë praktikë jo unike, pra për gjendje faktike dhe juridike të njëjtë kemi vendimmarrje ndryshe, lidhur me shuarjen e marrëdhënieve të detyrimeve me parashkrim, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të.

Parashkrimi me dispozitat e LMD-së, rregullohet prej nenit 341 deri me nenin 374.

Me nenin 341 të LMD-së, është përcaktuar se: “ 1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit. 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. 3. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”.

Nga përmbajtja e nenin 341 paragrafi 1 të LMD-së, rezulton se: Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit.

Natyrisht, kjo nënkupton pamundësinë e përmbushjes së detyrimit përmes rrugës gjyqësore, sepse detyrimi i parashkruar shndërrohet në detyrim natyror, që nënkupton se debitori, edhe pas kalimit të afatit të parashkrimit, mund ta përmbushë detyrimin e vet ndaj kreditorit, por kjo mund të ndodhë vetëm në mënyrë vullnetare dhe jo përmes rrugës gjyqësore, nëse ai e konteston përmbushjen e detyrimit për shkak të parashkrimit. Realizimi i kërkesës së parashkruar në procedurë gjyqësore mund të ndodhë vetëm nëse debitori nuk i referohet parashkrimit, për shkak se gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex officio) për parashkrimin.

Nga përmbajtja e paragrafit 2 të këtij neni, rezulton se: Kalimi i kohës, përkatësisht i afatit të caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, e krijojnë vet institutin e parashkrimit. Parashkrimi është i lidhur për kohën e caktuar, në të cilën kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e ndonjë detyrimi nga ana e debitorit. Pasiviteti i kreditorit për përmbushjen e kërkesës së tij nga ana e debitorit me kalimin e kohës së parashikuar me ligj, e bën të pamundur përmbushjen e detyrimit përmes rrugës gjyqësore në qoftë se debitori i referohet institutit të parashkrimit.

Nga përmbajtja e paragrafit 3 të këtij neni, rezulton se: gjykata nuk mund ta marrë parasysh parashkrimin, pra nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, në qoftë se debitori nuk i referohet parashkrimit. Gjykata edhe për kërkesat e parashkruara zhvillon procedurën gjyqësore në mënyrë të rregullt, derisa nuk i tërhiqet vërejtja nga ana e debitorit se një kërkesë e tillë, për të cilën po zhvillohet gjykimi, është parashkruar. Në këto raste, gjykata ka për detyrë ta respektojë kundërshtimin e debitorit dhe të konsiderojë se detyrimi i tillë nuk mund të përmbushet përmes rrugës gjyqësore. Kjo, në fakt, nënkupton shuarjen e një detyrimi të tillë. Pra, gjykata pasi të paraqitet kundërshtimi i parashkrimit, nuk e shqyrton ekzistimin apo mosekzistimin e detyrimit, por vërteton se a është parashkruar detyrimi.

1.2. Kur fillon të rrjedhë parashkrimi

Nëse marrim për bazë secilin afat ligjor që e ka kohen e fillimi, atëherë edhe parashkrimit e ka kohen e fillimit, dhe se palët por edhe gjykata në

rastet e paraqitura duhet të jenë të kujdesshme me rastin e llogaritjes se afatit të parashkrimit dhe veçanërisht kohës kur fillon tw rrjedh afati.
Në praktikën gjyqësore ka raste kur gjykata gabimisht ka llogaritur kohen apo afatin e parashkrimit, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.
Duhet theksuar se është me rendësi që fillimi i rrjedhjes së afatit të parashkrimit të jetë i qartë, që të mos krijohet dilema nëse ka ndodhur apo nuk ka ndodhur parashkrimi në një rast të paraqitur.
Për me tepër me afat të parashkrimit kuptojmë kohën e përcaktuar me ligj, me kalimin e së cilës kreditori e humb mundësia e realizimit të kërkesës në një gjykatë. Afati i parashkrimit gjithmonë është afat ligjor i caktuar me dispozitë ligjore, i cili nuk mund të ndryshohet, zgjatet e as të shkurtohet me vullnetin e palëve.
Me nenin 342, të këtij ligji, përcaktohet se: "1. Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. 2. Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të përsohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin".
Nga përmbajtja e nenit 342 paragrafi 1 rezulton se: Afati i parashkrimit fillon të rrjedhë ditën e parë, nga dita kur kreditori, sipas ligjit, ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Dita e parë, pas ditës kur kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, e konsideron si fillim të rrjedhës së afatit të parashkrimit. Mirëpo në pjesën e dytë të këtij paragrafi lejohet mundësia që të ketë edhe ditë tjetër të fillimit të rrjedhës së afatit, në qoftë se me ligj, për raste të veçanta, është parashikuar ndryshe.
Nga paragrafi 2 i këtij neni, rezulton se: në rastet e paraqitura kur detyrimi nuk ka të bëjë me ndonjë dare (dhënie) apo facere (bërje), por konsiston në diçka që nuk duhet bërë (mosbërje – non facere) ose të durohet (pati), atëherë parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë, pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin.

1.3. Krijimi i parashkrimit

Në praktikën gjyqësor ka raste kur gjykata gabimisht ka llogaritur kohen apo afatin kur ka lindur parashkrimi, gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.
Me nenin 343 të LMD-së, përcaktohet se: "Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se:
Parashkrimi lind një ditë më vonë (ditën e nesërme) nga dita e fundit kur kreditori ka mundur ta realizojë kërkesën përmes rrugës gjyqësore, përkatësisht ta parashtrojë padinë në kuptimin material. Në këtë kontekst parashkrimi është paraqitur pasi të kalojë edhe dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, si afat për parashkrimin e kërkesës së kreditorit. Llogaritja e afatit, përkatësisht fillimi dhe përfundimi i afatit përcaktohet me nenin 65 të LMD-së, nga përmbajtja e të cilit rezulton se:

1) Afati i caktuar në ditë fillon të rrjedhë ditën e parë pas ngjarjes nga e cila mund të llogaritet afati, ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit, të afatit;
2) Afati i caktuar në javë, muaj ose vite përfundon atë ditë që me emër dhe numër përputhet me ditën e lindjes së ngjarjes nga e cila ka filluar të rrjedhë afati; e në qoftë se një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, fundi i afatit bie në ditën e fundit të atij muaji;
3) Në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditën kur në bazë të ligjit është caktuar që të mos punohet, si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës në vijim;
4) Fillimi i muajit shënon ditën e parë të muajit, mesi i muajit me pesëmbëdhjetë (15) të muajt, dhe fundi i muajit në ditën e fundit të muajit, në qoftë se diçka tjetër nuk rezulton nga qëllimi i palëve, nga natyra e marrëdhënies, ose nga doket.

1.4. Llogaritja e kohës së paraardhësve

Me nenin 344 të këtij ligji, përcaktohet se: "Në kohën e parashkrimit llogaritet edhe koha që ka kaluar në dobi të paraardhësve të debitorit".

Nga përmbajta e kësaj dispozite ligjore rezulton se:
Koha e cila ka rrjedhë në dobi të paraardhësve të debitorit dhe se në afatin e parashkrimit doemos llogaritet edhe koha kur kreditori ka qenë pasiv edhe ndaj paraardhësve të debitorit. Kjo nënkupton se, në qoftë se një pjesë e kohës ka kaluar në dobi të paraardhësve dhe një pjesë tjetër kalon në kohën e debitorëve, si pasardhës, ato së bashku llogariten në kohën e parashkrimit.
Për me tepër pasardhësi juridik i debitorit, ndaj kreditorit mund t'i paraqet të gjitha kundërshtimet, të cilat ka mundur ti paraqet edhe paraardhësi i tij, duke përfshi edhe kundërshtimin e parashkrimit. Ndërrimi i debitorit mund të paraqitet për shkak të suksesionit univerzal apo singular. Univerzal- trashëgimtarët dhe ndryshimet statusore, ndërsa singular - marrja për sipër e borxhit.

1.5. Ndalimi i ndryshimit të afatit të parashkrimit

Fillimisht duhet theksuar se siguria juridike kërkon që fillimi dhe rrjedhja e afatit të parashkrimit të përcaktohet me ligj, pastaj që palët të mos kenë të drejtë të disponojnë me te drejtën, për ndryshimin, zgjatjen apo shkurtimin e afatit kohor të parashkrimit, me pune juridike.
Me nenin 345 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Me punë juridike nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose më e shkurtër e parashkrimit se sa koha e caktuar me ligj. 2. Me punë juridike nuk mund të caktohet që parashkrimi të mos rrjedhë për një kohë".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: me punë juridike nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose më e shkurtër e parashkrimit sesa koha e caktuar me ligj. Po ashtu, palët me punë juridike nuk mund të ndalojnë mos rrjedhjen e aftit të parashkrimit, dhe çdo marrëveshje apo punë juridike, në këtë kontekst nuk krijon asnjë efekt juridik.
Për me tepër, afati i parashkrimit është vetëm afat ligjor, dhe si i tillë nuk mund të ndryshohet nga palët, pra palët nuk e kanë një të drejtë të tillë, për të ndërhyrë në aspektin e ndryshimit të afatit.
Palët, përveç që nuk mund të disponojnë me të drejtën për zgjatjen apo shkurtimin e afatit të parashkrimit, nuk mund të disponojnë as me të drejtën e rrjedhjes apo ndërprerjes se afatit të parashkrimit, pra me punë juridike nuk mund të caktohet që parashkrimi të mos rrjedh për një kohë.

Palët nuk mund të merren vesh për një gjë të tillë. Duke marr për bazë që afati i parashkrimit është afat ligjor, fillimi, ndërprerja dhe rrjedhja e tij nuk mund të ndryshohet nga palët, pasi kjo përcaktohet me dispozita ligjore. Ky afat gjithnjë rrjedhë deri sa nuk kemi ndalje apo ndërprerje të parashkrimit.

1.6. Heqja dorë nga parashkrimi

Me nenin 346 të LMD-së, përcaktohet se: "Debitori nuk mund të heqë dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrim".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: debitori nuk mund të heq dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrim. Nuk mund të heq dorë nga diçka që akoma nuk ka lindur. Tek pas kalimit të këtij afati ai mund të heq dorë nga parashkrimi duke mos u thirr në parashkrim.
Për me tepër, debitorit i ndalohet heqja dorë nga parashkrimi, para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrimin. Debitori, pas kalimit të afatit të caktuar për parashkrim, mund të mos bëjë kundërshtimin e parashkrimit dhe kjo të merret si heqje dorë nga parashkrimi dhe ta përmbushë detyrimin ndaj kreditorit ose edhe nuk përjashtohet ndonjë marrëveshje në mes kreditorit dhe debitorit se heq dorë nga parashkrimi, i cili tanimë ekziston.

1.7. Njohja me shkrim dhe sigurimi i detyrimit të parashkruar

Me nenin 347 të këtij ligji, përcaktohet se: "1. Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi. 2. Efekt të njëjtë ka dhënia e pengut ose e ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Njohja me shkrim e detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi. Heqje dorë nga parashkrimi konsiderohet jo vetëm kur ajo bëhet me shkrim dhe sigurohet me ndonjë mjet sigurimi, por edhe në rastin kur kërkesa e kreditorit kërkohet të realizohet përmes rrugës gjyqësore, ndërsa debitori, edhe pse e di që kërkesa është e parashkruar, lejon

zhvillimin e procedurës gjyqësore, ndërsa gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, për parashkrimin e kërkesave, e debitori do ta përmbushë detyrimin e parashkruar. Kjo mënyrë e përmbushjes konsiderohet mënyrë e rregullt e përmbushjes së detyrimit në bazë të vendimit të gjykatës.
Heqja dorë nga parashkrimi ekziston vetëm në rastet kur debitori ka pasur dijeni se detyrimi, të cilin ai duhet ta përmbushë, është parashkruar dhe gjykata nuk mund ta detyrojë përmbushjen e një detyrimi të tillë, sepse me parashkrim është shuar detyrimi i debitorit.
Efekt të njëjtë ka dhënia e pengut ose e ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar. Në këtë kontekst lënia e sendit peng ose dhënia e ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar, ka efekt të njëjtë me njohjen me shkrim të detyrimit të parashkruar dhe në këtë rast konsiderohet se kemi heqje dorë nga parashkrimi, që nënkupton se heqja dorë nga parashkrimi të bërë njëherë, krijon rrjedhën e afatit të detyrimit prej fillimit, pra shfaqet vullneti i debitorit se dëshiron ta përmbushë detyrimin e parashkruar ndaj kreditorit.

1.8. Efekti i përmbushjes së detyrimit të parashkruar

Me nenin 348 të këtij LMD-së, përcaktohet se: “Në qoftë se debitori e përmbush detyrimin e parashkruar, ai nuk ka të drejtë të kërkojë që t’i kthehet ajo që ka dhënë edhe atëherë kur nuk e ka ditur, se detyrimi është parashkruar”.
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Në qoftë se debitori përmbush detyrimin e parashkruar, që nënkupton se detyrimi nuk ka mundur të realizohet përmes rrugës gjyqësore, përkatësisht se ai detyrim tani është shndërruar në detyrim natyror, ndërsa debitori këtë e ka përmbushur, duke mos e ditur se është parashkruar, ai nuk ka të drejtë të kërkojë që t’i kthehet ajo që ka dhënë. Kjo ndodhë për shkak se ai nuk ka bërë asgjë tjetër, përveçse e ka përmbushur një detyrim të vetin.
Në rastin kur krijohet parashkrimi debitori ka të drejtë të kundërshtojë përmbushjen e detyrimit të parashkruar, duke mos e përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, përkatësisht duke kundërshtuar se kërkesa e kreditorit, e paraqitur në gjykatë është parashkruar. Në ato raste kur gjykata e cila zhvillon procedurën në bazë të padisë, për përmbushjen e detyrimit të parashkruar, ajo nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe në

momentin që debitori e kundërshton padinë, për shkak të parashkrimit të kërkesës, atëherë gjykata e vlerëson kundërshtimin materialo - juridik të parashkrimit, me vendim përfundimtar duke vendosur sipas meritave të rastit.
Duhet theksuar se efekt tjetër i përmbushjes së detyrimit të parashkruar është edhe në rastet kur, nëse debitori heqë dorë nga përmbushja e detyrimit të parashkruar, atëherë kjo nuk vlen edhe për dorëzanin, sepse ai ka të drejtë të kundërshtojë detyrimin e parashkruar nga i cili ka hequr dorë debitori, nëse kërkesa për përmbushje të detyrimit do t'i drejtohej atij.

1.9. Kreditori, kërkesa e të cilit është e siguruar

Duhet theksuar se për dallim nga neni 347 paragrafi 2 i LMD-së, i cili përcakton rastet që kishin të bënin me dhënien e pengut ose të ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar, që në fakt është heqje dorë nga parashkrimi, neni 349 i këtij ligji përcakton dispozita me të cilat gjen shprehje parimi se pengu dhe hipoteka janë më të fuqishme se sa vetë parashkrimi.
Me nenin 349 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Kur të ketë kaluar afati i parashkrimit, kreditori kërkesa e të cilit është e siguruar me peng ose me hipotekë, mund të paguhet vetëm nga sendi i ngarkuar, në qoftë se e mban në dorë apo në qoftë se e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publikë. 2. Megjithatë, kërkesat e parashkruara të kamatës dhe të dhënieve tjera periodike nuk mund të përmbushen as edhe nga sendi i ngarkuar".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Kërkesa e parashkruar, e cila është e siguruar me peng ose me hipotekë, do të përmbushet kur sendi i pengut gjendet të kreditori ose dikush tjetër e ruan për kreditorin. Gjithashtu, debitori do t'a përmbush kërkesën e parashkruar edhe në rastet kur e drejta e pengut është e regjistruar në regjistrat publikë, këtu bëhet fjalë për hipotekën, si mjet për sigurimin e kërkesës, ku objekt është sendi i paluajtshëm, por në mënyrë analoge duhet të pranohet edhe pengu i regjistruar në regjistrat publik, të cilët nuk janë të rangut të regjistrit të tokave por janë regjistra të veçantë.
Realizimi i kërkesës së siguruar me peng apo me hipotekë bëhet përmes rrugës gjyqësore, ose organit tjetër kompetent, nga i cili do të kërkohet

shitja e sendit të lënë peng, për përmbushjen e detyrimit, i cili tani më mund të jetë edhe i parashkruar, por ky parashkrim nuk ka kurrfarë ndikimi kur bëhet fjalë për kërkesat e siguruara me peng apo me hipotekë. Nëse sendi i lënë peng nuk mjafton për përmbushjen e kërkesës së kreditorit, kur kemi të bëjmë me kërkesat e parashkruara, atëherë kreditori, për pjesën e mbetur pa u përmbushur nga shitja e sendit të lënë peng, nuk mund të parashtrojë padi, që detyrimi i mbetur të përmbushet nga masa pasurore tjetër e debitorit, sepse ajo pjesë e detyrimit, e cila nuk është arritur të përmbushet nga shuma e çmimit të shitjes së sendit, konsiderohet e parashkruar dhe debitori në çdo kohë ka të drejtë të kundërshtoj kontratën për kërkesë të parashkruar. Kërkesat aksesore si: kamatat dhe dhëniet tjera periodike, nuk mund të përmbushen nga sendi i lënë peng, edhe sikur të ketë mjete të mjaftueshme nga shitja e sendit të lënë peng.

Për me tepër, e drejta e pengut nuk e përmbush kamatën dhe dhëniet tjera periodike, kur kalon afati i parashkrimit të tyre. Në këtë kontekst debitori ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me kamatën dhe kërkesave të tjera aksesore e ka të drejtën t'i referohet parashkrimit, pa marrë parasysh faktin se sendi i pengut gjendet të kreditori ose dikush tjetër e ruan për kreditorin, me të cilin ka të drejtë ta përmbushë kërkesën kryesore.

1.10. Kërkesat aksesore

Me nenin 350 të LMD-së, përcaktohet se: "Kur parashkruhet kërkesa kryesore, atëherë parashkruhen edhe kërkesat akcesore, sikurse janë: kërkesat e kamatës, frutave, shpenzimeve dhe dënimeve kontraktuese".

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Kur parashkruhet kërkesa kryesore, atëherë parashkruhen edhe kërkesat aksesore, sikurse janë: kërkesat e kamatës, frutave, shpenzimeve dhe dënimeve kontraktuese. Këtu, duhet theksuar se shpenzimet e shitjes së sendit të lënë peng, me të cilin është siguruar kërkesa e parashkruar, dallojnë nga fjala shpenzime, që përdoret në nenin 350 të LMD-së, që bënë fjalë për kërkesat aksesore. Shpenzimet që bëhen në lidhje me shitjen e sendit të lënë peng, gëzojnë prioritet me rastin e përmbushjes së detyrimit dhe së pari përmbushen shpenzimet e sendit të lënë peng, ndërsa shitjen e

organizon gjykata ose organi tjetër kompetent, dhe pastaj do të përmbushet kërkesa kryesore, duke i përjashtuar kërkesat aksesore.
Për me tepër, kërkesat aksesore ndajnë fatin e kërkesës kryesore të parashkruar. Për dallim nga kërkesa kryesore e parashkruar, e cila mund të përmbushet nga sendi i lënë peng, si mjet i sigurimit të kërkesës, kërkesat aksesore nuk mund të përmbushen edhe kur për kërkesën kryesore është lënë mjeti i sigurimit.

1.11. Kur nuk zbatohen rregullat për parashkrimin

Në të drejtën e detyrimeve, parashkrimi i kërkesës nënkupton që, me kalimin e kohës bëhet e pamundur ose përmbushja e kërkesës përmes rrugës gjyqësore.
Me nenin 351 të LMD-së, përcaktohet se: "Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave. Këtu bëhet dallimi midis parashkrimit dhe afateve prekluzive me lëshimin e të cilave humb e drejta në kërkesë (e drejta në padi, ankesë etj). Ndërsa pas parashkrimit nuk humb e drejta në kërkesë por nëse debitori thirret në parashkrim, i cili nëse ka ndodh, atëherë humbet mundësia e realizimit të kërkesës përmes gjykatës apo organit tjetër kompetent. Kreditori edhe më tutje ka të drejtë të kërkoj përmbushjen e kërkesës së tij, e cila mund të përmbushet vullnetarisht nga debitori, por jo me detyrim.
Për me tepër, parashkrimi i kërkesës ka të bëjë gjithmonë me kërkesën dhe jo me të drejtën. Në këtë kontekst duhet bërë dallimi mes fjalës parashkrim i kërkesës dhe afatit prekluziv, sepse edhe me njërën edhe me afatin tjetër, bëhet i pamundur realizimi i kërkesës, përkatësisht kërkesës dhe të drejtës.
Me afatin parashkrimit shues humbet vetëm e drejta e kërkesës, ndërsa e drejta subjektive edhe më tutje vazhdon të ekzistojë, vetëm se nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore.

Ndërsa me afatin prekluziv, përveç që humbet e drejta e kërkesës, aty, me kalimin e kohës, humbet edhe vetë e drejta subjektive, sepse nuk është e mundur të kthehet e drejta që është përfshinë në afatin prekluziv.
Me nenin 351 të këtij ligji, është përcaktuar se për raste të caktuara nuk do të rrjedhë afati i parashkrimit, pra edhe pse kalon koha e caktuar, e drejta e kreditorit mund të realizohet pas kalimit të afatit për shkak se ky ligj, e përjashton zbatimin e parashkrimit.

2. Afati i Parashkrimit

2.1. Afati i përgjithshëm i parashkrimit

Në praktikën gjyqësore ka raste kur gjykata përveç tjerash gabimisht ka llogaritur kohen/afatin e përgjithshëm kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, veçanërisht në rastet e paraqitura për kërkesat, për të cilat me ligj nuk është caktuar një afat tjetër i parashkrimit.
Afati i përgjithshëm i parashkrimit, nënkupton kalimin e kohës brenda së cilës çdo kreditor do të duhej të kërkonte realizimin e kërkesës së vet, përmes rrugës gjyqësore, në qoftë se debitori nuk e ka përmbushur kërkesën e tij në mënyrë të rregullt.
Siç është theksuar me lartë afati i parashkrimit, është koha e caktuar me ligj pas kalimit të së cilës e drejta e kërkesës nuk mund të realizohet në rrugë gjyqësore.
Afati i parashkrimit në marrëdhëniet e detyrimeve, si element thelbësor i institutit të parashkrimit, përcaktohet me nenin 352 deri në 362 LMD-së.
Me dispozita të LMD-së, është përcaktuar afati i përgjithshëm i parashkrimit, i cili vlen për të gjitha kërkesat që i nënshtrohen parashkrimit, duke përcaktuar edhe mundësinë që në raste të caktuara, ligji mund të përcaktoj edhe afat tjetër të parashkrimit.
Me nenin 352 të LPK-së, përcaktohet se: “Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”.
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit. Afati i përgjithshëm nënkupton

parashkrimin e kërkesave në çdo rast, pasi të kaloj afati 5 vite. Mirëpo, ligji përjashtimisht ka përcaktuar mundësinë që me ligj të përcaktoj afat edhe më të gjatë se 5 vite, në raste të veçanta.

Duhet theksuar se të gjitha kërkesat, për të cilat nuk është përcaktuar një afat tjetër i parashkrimit, me ligj do të parashkruhen me kalimin e afatit 5 vite, sepse ky konsiderohet afat i përgjithshëm i parashkrimit dhe do të vlejë për të gjitha kërkesat e parashkruara, për të cilat nuk ekziston një afat i veçantë i parashkrimit i caktuar me ligj.

Afati i përgjithshëm i parashkrimit i caktuar me kalimin e kohës 5 vite, ka për qëllim sigurinë juridike të subjekteve në marrëdhëniet e detyrimeve.

Duhet theksuar se në praktikën gjyqësore ka raste kur gjykata ka shqyrtuar rastet ku është aplikuar ligji i cituar, gabimisht ka llogaritur kohen apo afatin kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, në rastet që Gjykata Supreme e Kosovës, ka shqyrtuar rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm, e veçanërisht në rastet e paraqitura për kërkesat, për të cilat me ligj nuk është caktuar një afat tjetër i parashkrimit.

Në këtë kontekst Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.10.1978 është ligj i aplikueshëm në Kosovë, në bazë të nenit 1.1. (b), të Rregullores së UNMIK-ut, me nr.1999/24 të datës 12.12.1999, e cila ka hyrë në fuqi më datë 10.06.1999, në bazë të nenit 34 të Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e RFJ-së, nr. 231/93 e datës 18.06.1993, i cili ka hyrë në fuqi më datë 25.06.1993, shprehimisht përcaktohet se neni 371 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr. 29/78 e datës 26.05.1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.10.1978, fjala “ pesë” zëvendësohet me fjalën “dhjetë”, dhe kështu në bazë të kësaj dispozite kërkesat parashkruhen për 10 vite, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në këto raste është qëndrim i Gjykatë Supreme të Kosovës, se duhet të aplikohet neni 34 i Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

2.2. Kërkesat periodike

Me nenin 353 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike akcesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. 2. E njëjta gjë vlen për pensionet vjetore me të cilat paguhet shuma kryesore dhe kamata në shuma të barabarta të përcaktuara më parë, por nuk vlen për pagesat në këste ose për përmbushje të tjera të pjesshme. 3. Pavarësisht paragrafit të parë të këtij neni, kamata në kërkesat periudha e parashkrimit e të cilave është më pak se tri (3) vjet, parashkruhen pas kalimit të periudhës së njëjtë si për kërkesën kryesore".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

1) Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurta (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vet e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Në këtë kontekst për praktikën gjyqësore tani është e qartë se e drejta e mbajtjes financiare respektivisht ushqimia, janë të drejta që nuk parashkruhen, por parashkruhen vetëm kërkesat periodike të ushqimit, të cilat është dashur të përmbushen muaj për muaj;
2) Të njëjta rregulla vlejnë për pensionet vjetore me të cilat paguhet shuma kryesore dhe kamata në shuma të barabarta të përcaktuara më parë, por nuk vlen për pagesat në këste ose për përmbushje të tjera të pjesshme. Kjo rregull nuk vlen për pagesat në këste, ose për përmbushje tjera të pjesshme, sepse pagesat në këste u nënshtrohen kërkesave në bazë të kontratës dhe këto kërkesa parashkruhen në afatin e parashikuar për secilin rast veç e veç dhe sipas bazës që krijohen;
3) Pavarësisht paragrafit të parë të nenit 353 të LMD-së, kamata në kërkesat periudha e parashkrimit e të cilave është më pak se tri (3) vjet, parashkruhen pas kalimit të periudhës së njëjtë si për

kërkesa kryesore. Pra, parashkrimi i kësaj kamate është e lidhur për kërkesën kryesore.

2.3. Parashkrimi i vet të drejtës

Në praktikën gjyqësor ka raste kur gjykata gabimisht ka konstatuar se ka ardhur deri të parashkrimi i vet të drejtës, për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Neni 354 i LMD-së, përcakton parashkrimin e vetë të drejtës, nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, sepse parashkrimi i kërkesës është i lidhur me arritjen e kërkesës së fundit të pa përmbushur.

Me nenin 354 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Vetë e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike parashkruhet për pesë (5) vite duke llogaritur nga arritja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie. 2. Kur parashkruhet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën jo vetëm të kërkojë prestime të ardhshme periodike, por edhe prestime periodike të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi. 3. Nuk mund të parashkruhet e drejta e ushqimit e caktuar me ligj".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

1) Vet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike parashkruhet për pesë (5) vjet duke llogaritur nga arritja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie. Kjo domethënë se, nëse është parashkruar edhe vet e drejta, atëherë kërkesat periodike gjithashtu konsiderohen të parashkruara, edhe pse nuk ka kaluar afati tre vjeçar për kërkesën e fundit, por mjafton që vet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, të jetë parashkruar. Për shembull, kur shuhet e drejta e qiradhënies, si e drejtë e përgjithshme, atëherë shuhen edhe kërkesat periodike që dalin prej të drejtës së qiradhënies;
2) Kur parashkruhet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën jo vetëm të kërkojë prestime të ardhshme periodike, por edhe prestime periodike të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi;

3) Nuk mund të parashkruhet e drejta e ushqimit e caktuar me ligj. Te e drejta e ushqimit pra, mund të ketë vetëm parashkrim të dhënieve periodike të tij, por jo edhe parashkrim të vet të drejtës, nga e cila rrjedhin kërkesat periodike.

2.4. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale

Kontratat komerciale paraqesin një lloj të veçantë të kontratave te të cilat ekzistojnë kërkesa reciproke, prandaj edhe rregullohen në mënyrë të veçantë.

Me nenin 355 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

1) Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për 3 vjet.

Në këtë kontekst kërkesat mes subjekteve, që konsiderohen shoqëri tregtare, parashkruhen për 3 vjet. Ky afat, për parashkrimin e kërkesave reciproke nga kontratat komerciale është afat i veçantë, i përcaktuar me dispozitë ligjore, dhe palët nuk mund të përcaktojnë një afat më të gjatë ose më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj.

2) Koha e parashkrimit apo parashkrimi rrjedh veç e veç, për çdo dërgim të mallit ose të kryerjes së punës ose shërbimit të kryer.

Në këtë kontekst nga kontratat komerciale lindin kërkesa reciproke mes palëve dhe tani secila kërkesë, përkatësisht koha e dërgimit të mallit, punës ose shërbimit, janë moment nga i cili fillon rrjedhja e afatit të parashkrimit.

2.5. Kërkesa e qirasë

Me nenin 356 të LMD-së, përcaktohet se: "Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht, ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shuma totale, parashkruhet për tri (3) vite".

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht, ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shuma totale, parashkruhet për tri(3)vjet. Në këtë rast kemi shuarjen e detyrimit të dhënies së qirasë, por jo edhe shuarjen e të drejtës, për marrjen e qirasë në mënyrë vullnetare nga ana e debitorit.

2.6. Kërkesa e shpërblimit të demit

Me nenin 357 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. 2. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit. 3. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi. 4. Kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë (15) vite pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë.
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

a) Afati subjektiv përcaktohet në paragrafin 1: tri (3) vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili ka shkaktuar dëmin;
b) Afati objektiv përcaktohet në paragrafin 2: në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vjet nga shkaktimi i dëmit;
c) Paragrafi 3 përcakton: kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi; dhe
d) Paragrafi 4 përcakton: kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë(15) vjet pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë.

Kjo e fundit është përcaktuar për shkak se fëmijët e mitur në të drejtën tonë pozitive dhe sipas Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, gëzojnë mbrojtje të veçantë. Kjo domethënë se brenda 15 viteve pas arritjes së moshës së pjekurisë, në këto raste, i mituri ka të drejtë të padisë për kompensim dëmi.

Për hir të praktikës gjyqësore, duhet theksuar se në rastet e paraqitura lidhur me rimbursimin e dëmit është paraqitur si dilemë se kur fillon dhe kur përfundon afati i parashkrimit, dhe si pasoj për çështje faktike dhe juridike të njëjtë, ka pasur vendimmarrje ndryshe.
Bazuar në dispozitat e LMD-së, dhe duke ju referuar praktikës gjyqësore, në këto raste është qëndrim i Gjykatë Suprem të Kosovës, se afati i parashkrimit është tri vite, fillon ditën e parë, pas momentit të pagesës dhe përfundon pas tri viteve, atë ditë që me emër dhe numër përputhet me ditën e lindjes së ngjarjes nga e cila ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit.

2.7. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e paraqitura për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale, ka konstatuar praktikë jo unike, si dhe gjykata përveç tjerash gabimisht ka llogaritur kohen apo afatin kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.
Me nenin 358 të LMD-së, përcaktohet se:”1. Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale. 2. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit. 3. E njëjta vlen edhe për ndaljen e parashkrimit.
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

1) Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë i parashkrimit, atëherë kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.

Pra, afati i parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale, lidhet për afatin e parashkrimit të ndjekjes penale;

2) Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale shkakton edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.

Shikuar në përcaktimin ligjor arsyet që vlejnë për ndërprerjen e parashkrimit të ndjekjes penale janë të mjaftueshme që të ketë edhe ndërprerje të afatit për parashkrimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit. Në qoftë se ndërpritet ndjekja penale dhe rishtas fillon procedura e ndjekjes penale e personit i cili ka shkaktuar vepër penale, atëherë afati i parashkrimit për ndjekjen e veprës së tillë penale nis prej fillimit, që do të thotë se edhe afati i cili ka rrjedhë për parashkrimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit do të pezullohet dhe do të fillojë të rrjedhë një afat i ri për parashkrimin e shpërblimit të dëmit, njësoj si edhe për afatin e parashkrimit për ndjekjen penale; dhe

3) E njëjta vlen edhe për ndaljen e parashkrimit.

Nëse i referohemi kësaj të fundit rezulton se për aq kohë sa kemi ndaljen e parashkrimit të ndjekjes penale, për aq kohë kemi edhe ndaljen e rrjedhës së afatit të parashkrimit të kërkesës, për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale.

Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore, se në rastet e paraqitura për shpërblimin e dëmit, të shkaktuar me vepër penale është qëndrim i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nëse kemi inicim të procedurës penale dhe ende nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë lidhur me këtë çështje, atëherë për parashkrimin e kërkesës vlejnë dispozitat e parashkrimit të veprës penale, ashtu siç është përcaktuar me nenin 357 dhe 358 të LMD-së, ndërsa nëse gjykata e shkallës së parë vërteton faktin se nuk kemi fare inicim të procedurës penale, ose kemi ndonjë vendim të formës së prerë, atëherë duhet të veproj konform dispozitave të LMD-së, të cekura më lartë, sepse është determinuese për gjykatën të konstatohet nëse pala është në njohuri për dëmin dhe shkaktarin e dëmit.

Duhet theksuar e njëjta vlen edhe në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës, ka shqyrtuar rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm.

2.8. Kompensimi i kërkesave për arsye të korrupsionit

Me nenin 359 të LMD-së, përcaktohet se: "Në rast se dëmi është shkaktuar nga akti në të cilin ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkesa e "ryshfetit" ose ndonjë përfitimi tjetër ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ose nga mosveprimi apo veprimi që do të kishte parandaluar aktin e korrupsionit, ose nga ndonjë akt tjetër që sipas ligjit ose traktatit ndërkombëtar paraqet korrupsion, kërkesa parashkruhet pesë (5) vite pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë; në cilindo rast, ajo parashkruhet pesëmbëdhjetë (15) vite pas kryerjes së aktit".

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Kërkesat për shpërblimin e dëmit për arsye të korrupsionit parashkruhen 5 vite, pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë. Ndërkaq në çdo rast, kur nuk është përcaktuar afati 5 vite, atëherë kërkesa e tillë për shpërblimin e dëmit, për arsye të korrupsionit, parashkruhet në afat15 vite, pas kryerjes së aktit, përkatësisht veprimit të korrupsionit, me të cilin është shkaktuar dëmi.

Në të gjitha rastet e cituara, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga rrethanat e theksuara si me lartë, parashkruhet në afat prej 5 vite, pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar veprimin e korrupsionit, me të cilin është shkaktuar dëmi. Mirëpo, në qoftë se afati nuk është i caktuar për ndonjë kërkesë që rezulton nga kjo dispozitë ligjore ose në qoftë se personi që ka shkaktuar dëmin nuk dihet, atëherë kërkesa e tillë parashkruhet me kalimin e afatit prej 15 vite, nga kryerja e atij veprimi, që është arsye e korrupsionit dhe me të cilin është shkaktuar dëm.

Prandaj shikuar formulimin ligjor të kësaj dispozite në këto raste, për kërkesat lidhur me shpërblimin e dëmit, për arsye të korrupsionit ku përcaktohet afati 5 vite, përkatësisht 15 vite, të parashkrimit, parashkrimi i shpërblimit të dëmit në këtë rast nuk është i lidhur me afatin e parashkrimit të ndjekjes së veprës penale.

2.9. Afati njëvjeçar i parashkrimit

Me nenin 360 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit; 1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separatëve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra; 1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi; 1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e “faqes elektronike“, dhe shërbimet e lidhura me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra; 1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtra. 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.

Nëse i referohemi nenit 360 të LMD-së, rezulton se:

1. Paragrafi 1, në gjashtë pikat e tij, përcakton se cilat kërkesa janë kërkesa që parashkruhen në afatin prej 1 viti. Pika 1.1 e këtij paragrafi, numëron kërkesat të cilat parashkruhen me kalimin e në afatin prej 1-viti, si: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, që nënkupton parashkrimin e kërkesës së kreditorit (furnizuesit me energji elektrike) ndaj debitorit - shfrytëzuesit të energjisë elektrike, për sasinë e faturuar për çdo muaj; pastaj kërkesat për furnizimin e energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake. Shprehja për nevojat shtëpiake nënkupton se ky furnizim nuk është kryer për nevojat e industrisë, por për nevojat e amvisërisë.

Pika 1.2 e këtij paragrafi, përcakton se kërkesat që parashkruhen në afatin prej 1-viti, janë edhe kërkesat e radios dhe televizionit, për përdorimin e stacionit. Pra, e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar për çdo muaj, parashkruhet në afatin prej 1 viti.

Në grupin e kërkesave që parashkruhen në afatin prej 1-viti, në bazë të paragrafit 1.3 e këtij paragrafi, janë edhe kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit, për përdorimin e telefonit dhe separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre, që arkëtohen në afate 3 mujore apo më të shkurtra.
Pika 1.4, e këtij paragrafi, përcakton se edhe kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës kur është porositur botimi, i konsideron kërkesa që parashkruhen në afatin prej 1 viti të parashkrimit, dhe si afat i parashkrimit në këtë rast merret kalimi i kohës për të cilin është porositur botimi.
Kjo nënkupton se me kontratën për veprën, porositet botimi, ndërsa nëse botuesi nuk e përmbushë këtë detyrim, një detyrim i tillë do të parashkruhet me kalimin e afatit prej 1 viti.
Pika 1.5 e këtij paragrafi, përcakton se edhe kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mailit, shërbimet për mirëmbajtjen e uebfaqes elektronike dhe shërbimet lidhur me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate 3 mujore apo më të shkurtra, do të parashkruhen në afatin prej 1 - viti.
Pika 1.6 e këtij paragrafi, përcakton se kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve, të shërbimeve dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate 3 mujore apo më të shkurtra do të parashkruhen në afatin prej 1 - viti.
2. Paragrafi 2, përcakton se afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë. Rrjedhja e afatit të parashkrimit nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë, nënkupton se nuk numërohet viti, në të cilin është dashur të përmbushet kërkesa e arritur. Nga kjo rezulton se për kërkesat që janë krijuar në bazë të paragrafit 1, gjatë vitit 2025, afati i parashkrimit do të fillojë nga 1 janari i vitit 2026 dhe përfundon në ditën e fundit të vitit 2026.
3. Paragrafi 3, përcakton se afati i parashkrimit rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë. Pra, edhe nëse pas kohës kur ka lindur e drejta e parashtrimin të padisë vazhdon furnizimi me energji elektrike, përkatësisht me shërbime të radios dhe televizionit, për përdorimin e stacionit, nuk domethënë se ndërpritet afati i parashkrimit, por ai vazhdon të rrjedhë edhe gjatë kësaj kohe.

Për hir të praktikës gjyqësore, duhet theksuar se e njëjta nuk vlen edhe në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës, ka shqyrtuar rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm, lidhur me llogaritjen e afatit, përkatësisht afati i parashkrimit do të llogaritet në këtë mënyrë:
Afati i caktuar në javë, muaj ose vite përfundon atë ditë që me emër dhe numër përputhet me ditën e lindjes së ngjarjes nga e cila ka filluar të rrjedhë afati, e në qoftë se një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, fundi i afatit bie në ditën e fundit të atij muaji.

2.10. Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente

Me nenin 361 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim. 2. Megjithatë, të gjitha kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujditë e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e parashikuar për parashkrimin e kërkesave periodike".
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se:

- Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim;
- Kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujditë e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, do të parashkruhen në afatin e parashikuar për parashkrimin e kërkesave periodike. Pra, kërkesat periodike, edhe pse janë krijuar me vendim të plotfuqishëm të organit shtetëror, i nënshtrohen afatit të parashkrimit të përcaktuar për kërkesat periodike.

2.11. Afatet e parashkrimit te kontratat për sigurimin

Me nenin 362 të LMD-së, përcaktohet se: ”1. Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, përkatësisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vjet, kurse nga kontratat e tjera për sigurimin për tre (3) vjet, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa. 2. Në qoftë se personi i interesuar provon se deri në ditën e caktuar në paragrafin paraprak nuk ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, parashkrimi fillon që nga dita kur të ketë marrë dijeni për këtë, ashtu që në çdo rast kërkesa parashkruhet te sigurimi i jetës për dhjetë(10) vjet, kurse te sigurimet e tjera për pesë (5) vjet nga data e caktuar në paragrafin paraprak. 3. Kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet. 4. Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj siguruesit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, përkatësisht kur i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin. 5. Kërkesa e drejtpërdrejtë e personit të tretë të dëmtuar ndaj siguruesit parashkruhet për të njëjtën kohë për të cilën parashkruhet kërkesa e tij ndaj të siguruarit përgjegjës për dëmin. 6. Parashkrimi i kërkesës që i takon siguruesit ndaj personit të tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të sigurimit fillon të rrjedhë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj këtij personi, dhe mbaron në të njëjtin afat”.

Në gjashtë (6) paragrafët e nenit 362 të LMD-së, janë përcaktuar afatet e parashkrimit te kontrata për sigurimin, si dhe dita e fillimit të rrjedhjes së këtij afati.

Nëse i referohemi këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

- Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, përkatësisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vite, kurse nga kontratat tjera për sigurimin për tre (3) vite, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa;
- Në qoftë se personi i interesuar provon se deri në ditën e caktuar në paragrafin paraprak nuk ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, parashkrimi fillon që nga dita kur të ketë marrë dijeni për këtë,

ashtu që në çdo rast kërkesa parashkruhet te sigurimi i jetës për dhjetë (10) vjet, kurse te sigurimet tjera për pesë (5) vjet nga data e caktuar në paragrafin paraprak.

3. Ndalja e Parashkrimit

3.1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me ndaljen e parashkrimit

Me ndalje të parashkrimit nënkuptojmë paraqitjen e fakteve të tilla të cilat pengojnë parashkrimin, qoftë ato që pengojnë fillimin e rrjedhës së parashkrimit apo gjatë rrjedhës së parashkrimit. Parashkrimi pushon të rrjedh derisa ekzistojnë pengesa të caktuara ligjore. Pas pushimit të ekzistimit të këtyre pengesave, afati i parashkrimit vazhdon të rrjedh, dhe se koha sa kanë zgjatur pengesat, nuk llogaritet në afatin e parashkrimit. Pra, kur paraqiten kushtet e caktuara me ligj, për ndaljen e parashkrimit, fillimi i parashkrimit pushon dhe pasi të pushojnë arsyet për ndaljen e parashkrimit, afati i parashkrimit vazhdon të rrjedh, koha e kaluar para paraqitjes të rrethanave të cilat shkaktojnë parashkrimin llogariten në afatin e parashkrimit. Prandaj koha për të cilën kanë zgjatur rrethanat, të cilat shkaktojnë ndaljen e parashkrimit vazhdojnë afatin e ndaljes.

Për me tepër, te ndalja e parashkrimit, koha që ka rrjedhë për parashkrim, para se të paraqiten shkaqet e pranuara nga ligji, për ndaljen e tij, vazhdojnë të llogariten në kohën e nevojshme për parashkrim, duke mos u llogaritur vetëm koha e kaluar, për të cilën ka ekzistuar ndalimi i parashkrimit. Nga kjo rezulton se në rastet kur kemi të bëjmë me ndaljen e parashkrimit, afati i tij fillon të rrjedhë, mirëpo koha gjatë së cilës ka ekzistuar pengesa që ka shkaktuar ndalimin, nuk llogaritet brenda kohëzgjatjes së afatit të parashkrimit.

Me dispozitat e LMD-së, janë përcaktuar rastet kur nuk rrjedh parashkrimi, dhe se palët nuk mund të caktojnë rregulla të reja, për ndaljen e parashkrimit. Arsyet se pse nuk rrjedh parashkrimi janë:

- ruajtja dhe mbrojtja e marrëdhënieve që krijohen rreth gjinisë;
- varësisë së gjendjes së shkaktuar nga lufta ose pengesa të tjera, ose arsyeja e moshës;
- gjendjes psikike ose kemi të bëjmë me shërbimin ushtarak;

- nuk rrjedh në mes të bashkëshortëve;
- midis prindërve dhe fëmijëve derisa ekziston e drejta prindërore;
- midis të mbrojturit dhe kujdestarit, gjatë kohës së ekzistimit të kujdestarisë si dhe organit të kujdestarisë, gjatë kohës së ekzistimit të kujdestarisë derisa nuk jepen llogari të caktuara;
- nuk rrjedhin midis dy personave që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore, derisa kjo bashkësi ekziston.

Përndryshe intervenimi eventual me dhunë mund të çrregulloj marrëdhëniet personale midis personave të caktuar, prandaj me ligj është përcaktuar rregulla se afatet e parashkrimit nuk rrjedhin derisa sa zgjasin raportet e tilla.

Përveç këtyre raporteve personale të cilat sjellin deri te ndalja e parashkrimit, sipas dispozitave të LMD-së, është përcaktuar se parashkrimi ndalet edhe për kërkesat e personave të caktuar. Në bazë të këtij parimi parashkrimi nuk rrjedh gjatë kohës së mobilizimit, rrezikut të drejtpërdrejt nga lufta ose nga lufta në pikëpamje të kërkesave të personave në shërbim ushtarak.

Pastaj në pikëpamje të kërkesave që kanë personat e punësuar në ekonomi të huaj shtëpiake ndaj punëdhënësve ose anëtarëve të familjes së tij, që bashkëjetojnë me të, derisa sa zgjatë kjo marrëdhënie.

Parashkrimi nuk rrjedh për tërë kohën gjatë së cilës kreditori nuk pasur mundësi të kërkojë përmbushjen e detyrimit përmes gjykatës, për shkak të pengesave të papërballueshme si: fuqia madhore, fatkeqësitë natyrore, tërmetet, etj.

Duhet theksuar se kur paraqiten shkaqet për ndaljen e parashkrimit ato kanë ndikim të caktuar për rrjedhën e parashkrimit. Varësisht rrethanave të rastit të paraqitur ndikimi i këtyre shkaqeve mund të jetë i ndryshëm. Në qoftë se parashkrimi nuk mund të rrjedh për shkaqe ligjore, ai fillon të rrjedh kur ato shkaqe pushojnë, mirëpo në qoftë se parashkrimi ka filluar të rrjedh para se të paraqiten shkaqet të cilat kanë shkaktuar rrjedhën e mëtejmë të saj, ajo vazhdon të rrjedh kur pushon shkaku, dhe se koha e cila ka kaluar para ndaljes llogaritet në afatin caktuar për parashkrim.

Përndryshe, ndalja e parashkrimit nënkupton ndaljen gjegjësisht pamundësinë e rrjedhës së parashkrimit, për shkak shkaqeve të caktuara me ligj. Me paraqitjen e këtyre shkaqeve, koha për parashkrim nuk mund

të rrjedh apo koha e kaluar pushon të rrjedh, mirëpo kur pushojnë këto shkaqe, koha e ndalur e rrjedhës së e parashkrimit vazhdon, dhe koha e kaluar bashkëngjitet me kohën e vazhduar më vonë të parashkrimit dhe llogaritet me kohën e caktuar me ligj, për parashkrim.
P.sh. Te debitorët solidar është caktuar se në qoftë se parashkrimi nuk rrjedh apo është ndërprerë ndaj njërit debitor, atëherë ai rrjedh për debitorët tjerë solidar dhe mund të përfundoj, mirëpo debitori ndaj të cilit kërkesa nuk është parashkruar, por ka qenë i detyruar të përmbush, ka të drejtë të kërkoj nga debitorët tjerë, ndaj të cilëve kërkesa është parashkruar, që secili t'i përmbush pjesën e vet të kërkesës. Prandaj, parashkrimi ndikon në raportet e debitorit të caktuar ndaj kreditorit, por nuk ka ndikim në raportet ndërmjet debitorëve solidar.

3.2. Kërkesat ndërmjet personave të caktuar

Me nenin 363 të LMD-së, përcaktohet se:"1. Parashkrimi nuk rrjedh: 1.1. ndërmjet bashkëshortëve; 1.2. ndërmjet prindërve dhe fëmijëve derisa zgjat e drejta prindërore; 1.3. ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit të tij si dhe të organit të kujdestarisë, gjatë kohës së kujdestarisë dhe derisa të mos paraqiten llogaritë; 1.4. ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë, derisa ekziston ajo bashkëjetesë".
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:
Parashkrimi nuk rrjedh: për kërkesat që ekzistojnë ndërmjet bashkëshortëve; ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, derisa zgjat e drejta prindërore; ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit të tij si dhe të organit të kujdestarisë, gjatë kohës së kujdestarisë dhe deri sa të mos paraqiten llogaritë si dhe ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë, derisa ekziston ajo bashkëjetesës. Kjo dispozitë ligjore, përcakton rastet ku kemi ndaljen e parashkrimit, përkatësisht mos rrjedhjen e afatit të parashkrimit, për shkak të marrëdhënieve personale që ekzistojnë mes kreditorit dhe debitorit:

- si fakt që shkakton ndaljen e parashkrimit të kërkesës është lidhja bashkëshortore dhe derisa ata janë në marrëdhënie bashkëshortore për kërkesat e tyre të ndërsjella të karakterit pasuror, të cilat ekzistojnë qoftë në favor të njërit person apo të

personit tjetër, nuk mund të rrjedhë afati i parashkrimit, sepse nuk ka rrjedhë të afatit të parashkrimit ndërmjet bashkëshortëve;

- si fakt që shkakton ndaljen e parashkrimit janë kërkesat që ekzistojnë ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre, derisa zgjat e drejta prindërore. Kjo ndodh për shkak se marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, në kohën sa zgjatë e drejta prindërore, janë marrëdhënie të veçanta dhe ligji këto rrethana që krijohen nga marrëdhënia ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, deri sa zgjat e drejta prindërore ex lege, i konsideron, shkak për ndaljen e parashkrimit të kërkesave. Prindërit, derisa ushtrojnë të drejtën prindërore ndaj fëmijëve të tyre, kanë për detyrim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, prandaj nuk është e nevojshme që të kërkojnë realizimin e kërkesave reciproke derisa zgjat e drejta prindërore.

Fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë, dhe një ndër detyrimet e prindit, është që të kujdeset ndaj fëmijës mbi të cilin ushtron të drejtën prindërore dhe jo të kërkojë përmbushjen e kërkesave të veta, për shkakun se ato kërkesa mund të parashkruhen me kalimin e kohës;

- si fakt që shkakton ndaljen e parashkrimit janë kërkesat që ekzistojnë ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit si dhe të organit të kujdestarisë gjatë kohës së kujdestarisë, derisa të mos paraqiten llogaritë. Këta persona janë personat nën kujdestari që janë pa përkujdesje prindërore dhe persona të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar me vendim të organit shtetëror. Kujdestari është personi i cili, me vendim të gjykatës, është caktuar të kujdeset për personin nën kujdestari, prandaj edhe kërkesat mes personit nën kujdestari dhe kujdestarit, si individ, i nënshtrohen institutit të ndaljes së parashkrimit, për kohën derisa ekziston kujdesi i kujdestarit ndaj personit nën kujdestari. Afati i parashkrimit nuk mund të rrjedhë edhe për kërkesat që ekzistojnë ndërmjet personit nën kujdestari gjatë kohës së kujdestarisë dhe pas saj, derisa të mos paraqiten llogarit mes organit të kujdestarisë dhe personit nën kujdestari;
- si fakt që shkakton ndaljen e parashkrimit janë kërkesat ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë (bashkësia faktike, bashkësia jashtëmartesore). Ndalja e parashkrimit përcaktohet

edhe për kërkesat ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë dhe kjo atë deri në ekzistimin e saj, sepse personat që jetojnë në bashkëjetesë detyrohen ndaj njëri-tjetrit, për respekt të njëjtë, mirëkuptim të dyanshëm dhe ndihmë, si në bazë të martesës ligjore.

3.3. Kërkesat e personave të caktuar

Me nenin 364 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Parashkrimi nuk rrjedh: 1.1. gjatë kohës së mobilizimit në rastin e rrezikut të drejtpërdrejt të luftës ose gjatë luftës lidhur me kërkesat e personave në detyrë ushtarake; 1.2. në pikëpamje të kërkesave që kanë personat e punësuar në ekonomi të huaj shtëpiake ndaj punëdhënësve ose anëtarëve të familjes së tij që bashkëjetojnë me te, derisa zgjat ajo marrëdhënie".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

- ndalja e parashkrimit ekziston edhe për kërkesat që ekzistojnë mes personave gjatë kohë së mobilizimit në rast rreziku të drejtpërdrejtë të luftës ose gjatë luftës, lidhur me kërkesat e personave në detyrë ushtarake. Pra kërkesat e personave të përfshirë në mobilizim në rast rreziku të drejtpërdrejt të luftës ose gjatë luftës, për shkak se këto janë detyra ushtarake, nuk do të ndodhë rrjedha e parashkrimit derisa zgjat mobilizimi në rast rreziku të drejtpërdrejtë të luftës ose derisa të bëhet ndërprerja e luftës, përkatësisht derisa të shpallet pushimi i armiqësisë mes palëve në luftë;
- ndaljen e parashkrimit ekziston edhe për kërkesat e personave të punësuar te punëdhënësi, por ky ushtrim i punës bëhet në ekonominë shtëpiake, p.sh., kuzhinieri familjar dhe kërkesat e tij ndaj punëdhënësit ose anëtarëve të familjes që bashkëjetojnë me të, janë të tilla që i nënshtrohen ndaljes së parashkrimit, pra, derisa zgjatë ajo marrëdhënie, nuk rrjedh afati i parashkrimit dhe për aq kohë sa ka zgjatur kjo marrëdhënie e personit të punësuar në ekonominë e huaj shtëpiake, për aq do të vazhdohet edhe afati i parashkrimit.

3.4. Pengesat e papërballueshme

Pengesa të papërballueshme konsiderohen rrethanat që kanë ndikim në ndalimin e punës së gjykatës, përkatësisht pamundësinë objektive që kreditori t'i drejtohet gjykatës, për përmbushjen e detyrimit të debitorit.
Me nenin 365 të LMD-së, përcaktohet se: "Parashkrimi nuk rrjedh për gjithë kohën për të cilën kreditori nuk ka pasur mundësi që për shkak të pengesave të papërballueshme të kërkojë përmes gjykatës përmbushjen e detyrimit".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Parashkrimi nuk rrjedh për gjithë kohën për të cilën kreditori, për shkak të pengesave të papërballueshme, të kërkojë përmes gjykatës përmbushjen e detyrimit që është objekt i detyrimit të debitorit.
Si pengesa të papërballueshme janë të gjitha ato pengesa që i pamundësojnë kreditorit t'i drejtohet gjykatës për përmbushjen e detyrimit. Mirëpo, këtu duhet të merren parasysh të gjitha ato pengesa që kreditori nuk mund t'i përballojë e që janë pasojë e fuqisë madhore, fatkeqësitë natyrore, tërmetet, etj.

3.5. Ndikimi i shkaqeve të ndaljes në rrjedhën e parashkrimit

Ndalja e parashkrimit nuk mund të bëhet me marrëveshje mes palëve, sepse parashkrimi i nënshtrohet dispozitave të LMD-së. Subjektet e detyrimeve nuk mund arrin marrëveshje për t'a heq parashkrimin e kërkesave të tyre, nuk mund të përcaktojnë ndaljen apo ndërprerjen e parashkrimit me marrëveshje, para se të vije deri të parashkrimi i kërkesës. Instituti i parashkrimit nuk është çështje e disponibilitetit të subjekteve të detyrimeve, për arsye se parashkrimi, se pari, krijon siguri juridike mes kreditorit dhe debitorit, ndërsa siguria juridike si parim është edhe interes i shtetit në përgjithësi.
Me nenin 366 të LMD-së, përcaktohet se; "1. Në qoftë se parashkrimi nuk ka mundur të fillojë të rrjedhë, për arsye të ndonjë shkaku ligjor, ai fillon të rrjedhë posa ai shkak të ketë pushuar së ekzistuari. 2. Në qoftë se parashkrimi ka filluar të rrjedhë përpara se të ketë ndodhur shkaku i cili e ka ndalur rrjedhën e tij të mëtejshëm, ai vazhdon të rrjedhë kur të

pushojë së ekzistuari ai shkak, ndërsa koha që ka kaluar para ndaljes llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim".
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

- në rastet kur parashkrimi nuk ka mundur të fillojë të rrjedhë për arsye të ndonjë shkaku ligjor, pra vetëm për shkaqe ligjore të parashikuara me ligj, atëherë parashkrimi fillon të rrjedhë nga momenti kur pushon së ekzistuari shkaku që ka sjellë ndaljen e parashkrimit;
- në rastet kur afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë përpara se të ketë ndodhur shkaku që ka ndaluar rrjedhën e mëtutjeshme të parashkrimit. Prandaj, në këtë rast afati i parashkrimit fillon të rrjedhë kur të pushojë së ekzistuari ai shkak ligjor që ka shkaktuar ndaljen e rrjedhës së parashkrimit, ndërsa koha që ka kaluar para ndaljes së parashkrimit, llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrimin.

3.6. Kërkesat ndaj personave të paaftë për të vepruar dhe kërkesat e tyre

Me dispozitat e LMD-së, është përcaktuar se, në rastet kur kemi të bëjmë me persona të mitur apo të paaftë për të vepruar, afati i parashkrimit, si rregull, rrjedh edhe për kërkesat e tyre, pa marrë parasysh se a kanë përfaqësues ligjorë ose nuk kanë. Në këtë kontekst nëse i mituri ka kërkesë ndaj një personi tjetër i cili është i aftë për të përmbushur detyrimin ndaj personit të mitur, kërkesa e të miturit parashkruhet sikurse edhe kërkesat e të gjithë të tjerëve, natyrisht në këto raste janë përcaktuar edhe përjashtimet, për afatin e parashkrimit ndaj kërkesave të të miturve dhe personave të tjerë të paaftë për të vepruar.
Me nenin 367 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Parashkrimi rrjedh edhe ndaj të miturit dhe personit tjetër të paaftë për të vepruar, pavarësisht nëse kanë ose jo përfaqësuesin ligjor të tyre. 2. Megjithatë, parashkrimi i kërkesës së të miturit i cili nuk ka përfaqësues, dhe i personit tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të fillojë të rrjedhë derisa të mos kenë kaluar dy (2) vjet nga data kur janë bërë plotësisht të aftë për të vepruar ose kur iu është caktuar përfaqësuesi. 3. Në qoftë se për

parashkrimin e një kërkese është caktuar një kohë më e shkurtër se dy (2) vjet, ndërsa kreditori është i mitur dhe nuk ka përfaqësues ose ndonjë person tjetër i paaftë për të vepruar pa përfaqësues, parashkrimi i asaj kërkese fillon të rrjedhë kur kreditori është bërë i aftë për të vepruar ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

- parashkrimi i kërkesave rrjedh edhe ndaj personave të mitur, por edhe ndaj personave të tjerë të paaftë për të vepruar, pavarësisht nëse kanë ose jo përfaqësues ligjorë të tyre;
- Megjithatë, parashkrimi i kërkesës së të miturit i cili nuk ka përfaqësues, dhe i personit tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të fillojë të rrjedhë derisa të mos kenë kaluar dy (2) vjet nga data kur janë bërë plotësisht të aftë për të vepruar ose kur iu është caktuar përfaqësuesi; dhe
- në qoftë se për parashkrimin e një kërkese është caktuar një kohë më e shkurtër se dy (2) vjet, ndërsa kreditori është i mitur dhe nuk ka përfaqësues ose ndonjë person tjetër i paaftë për të vepruar pa përfaqësues, parashkrimi i asaj kërkese fillon të rrjedhë kur kreditori është bërë i aftë për të vepruar ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi.

4. Ndërprerja e Parashkrimit

4.1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me ndërprerjen e parashkrimit

Ndërprerja e parashkrimit nënkupton faktin kur, për shkak të paraqitjes së rrethanave të caktuara, ndërpritet të rrjedhë afati i parashkrimit, i cili nis të rrjedhë prej fillimit, që nënkupton se koha e kaluar e afatit të parashkrimit humbet dhe duhet të nisë llogaritja e afatit nga fillimi.

Ndërprerja e parashkrimit nënkupton se, me paraqitjen e rrethanës relevante që ka ndikim në ndërprerjen e afatit të parashkrimit, bëhet anulimi i kohës që ka rrjedhë, për parashkrimin deri në momentin e paraqitjes së rrethanës së re, e cila ka ndikim të drejtpërdrejt në ndërprerjen e parashkrimit.

Ndërprerjen e parashkrimit është përcaktuar me dispozitat e LMD-së. Ndërprerja e parashkrimit mund të paraqitet në rastet dhe rrethana të ndryshme juridike.
Deri te ndërprerja e parashkrimit mund të vij: me pohimin e borxhit, paraqitjen e padisë, heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë, përkatësisht ndërmarrja e çdo veprimi tjetër të kreditorit kundër debitorit, drejtuar gjykatës apo një organi tjetër kompetent, me qëllim të realizimit të kërkesës, etj.

4.2. Pranimi i borxhit

Me nenin 368 të LMD-së, përcaktohet se: ”1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimi”.
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:
Parashkrimi ndërpritet kur debitori pranon borxhin. Pra, në çdo rast, kur debitori pranon borxhin e tij ndaj kreditorit, ndodh ndërprerja e parashkrimit. Në këto raste me pranimin e borxhit, koha e kaluar e afatit të parashkrimit do të nderpreht dhe nga momenti i pranimit të borxhit nis të rrjedhë afati i parashkrimit prej fillimit. Pranimi i borxhit nga ana e debitorit është mënyra më e shpeshtë e ndërprerjes së parashkrimit. Pranimi i borxhit mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me deklaratë të debitorit me gojë ose me shkrim.
Duhet theksuar se deklarata për pranimin e borxhit duhet të jetë e qartë, për të kuptuar se ajo deklaratë i është drejtuar kreditorit që ka për qëllim pranimin e borxhit. Pranimi i borxhit nga ana e debitorit mund të bëhet me deklarimin e vetë debitorit, por nuk përjashtohet mundësia që ky deklarim të bëhet edhe përmes përfaqësuesit të tij ligjor ose statutar. Pranimi i borxhit, i cili bëhet me deklarimin e vullnetit të debitorit përkatësisht përfaqësuesit të tij, konsiderohet një punë juridike e njëanshme, e cila prodhon efekte juridike, pa marrë parasysh kreditorin.
Me pranimin e borxhit kryesor, ndërprerja e parashkrimit vlen jo vetëm për borxhin kryesor, por edhe për kamatat që dalin nga borxhi kryesor.
Pranimi i borxhit, përveç që bëhet me deklaratën të cilën debitori ia bën kreditorit, por ai nga ana e debitorit mund të bëhet edhe në mënyrë të

tërthortë, siç është, p.sh., pagesa e këstit, pra kur për borxhin paguhet një shumë e caktuar në emër të këstit, atëherë me këtë veprim ndërpritet parashkrimi dhe afati i tij nis të rrjedhë prej fillimit.
Pastaj një veprim tjetër që nënkupton pranimin e borxhit konsiderohet edhe pagesa e kamatës ose dhënia e mjetit të sigurimit të kërkesës së kreditorit, pra lënia e sendit peng.
Këto veprime të debitorit duhet të kenë për qëllim pranimin e borxhit. Pra, vetë debitori është ai që manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet. Pranimi i borxhit, duhet të jetë i qartë, i caktuar, i pakushtëzuar, dhe duhet të jepet gjatë rrjedhës së afatit të parashkrimit.
Duhet theksuar se në praktikën gjyqësore është paraqitur si dilemë se për shkak të pagesës së kohëpaskohshme, a nderprehet parashkrimi sipas nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së.
Në rastet e paraqitura në praktikën gjyqësore, përfundimi i gjykatës së shkalles së parë dhe të dytë, për ndërprerjen e parashkrimit (në rastet kur dokument përmbarues paraqiten ekstraktin e verifikuar nga librat afariste, të lëshuar nga kreditori) nuk mund të pranohet si përfundim i drejtë dhe i ligjshëm nga Gjykata Supreme, për shkak se me nenin 368 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD - i datës 10 Maj 2012), përcaktohet se: “ Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin ”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “Pohimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë siç janë pagesat e këstit, pagimi i kamatës, dhënia e sigurimit”.
Në kontekstin e këtyre dispozitave përfundimet e gjykatave me të ulëta se në këto raste kemi pohim të borxhit nga ana e debitorit, për shkak të pagesës së kohëpaskohshme, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është i gabuar, për shkak se në këto raste nuk bëhet fjalë për dhënien e kësteve ngase pagesat e kohëpaskohshme të debitorit nuk mund të konsiderohen si këste. Ato pagesa janë të papërcaktuara në shumat që dallojnë njëra nga tjetra dhe nuk lënë të kuptohet se për cilën periudhë debitori ka paguar borxhin, po ashtu në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka ekzistuar ndonjë marrëveshje që borxhi të paguhet me këste.

4.3. Paraqitja e padisë

Me nenin 369 të LMD-së, përcaktohet se: "Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës".

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit në gjykatë ose në një autoriteti tjetër kompetent, me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës. Veprimet e kreditorit duhet të jenë ashtu siç përcakton ligji, për procedurën e realizimit të kërkesave të kreditorëve. Pra, kreditori duhet të respektojë procedurën që kërkohet për realizimin e kërkesave përmes rrugës gjyqësore ose përmes autoritet tjetër kompetent. Nuk është vetëm paraqitja e padisë veprim i kreditorit që ndërpret parashkrimin e kërkesës së tij, por edhe veprimet e tjera të cilat i ndërmerr kreditori kundër debitorit në një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent.

Sipas kësaj dispozite ligjore, veprimet e kreditorit kanë të bëjnë me vërtetimin e kërkesës, pra vërtetohet ekzistimi i vetë kërkesës së kreditorit, të cilën duhet ta përmbushë debitori. Pastaj, mund të kërkohet edhe sigurimi i kërkesës, duke lënë një send peng ose në një mënyrë tjetër të sigurimit të kërkesës dhe, në fund, veprimet e kreditorit kundrejt debitorit të ndërmarra në një gjykatë me qëllim të realizimit të kërkesës.

Padia duhet të jetë me kërkesë të lejueshme dhe t'i drejtohet gjykatës kompetente. Mirëpo, edhe nëse padia i drejtohet gjykatës jokompetente ndodh ndërprerja e parashkrimit. Për të ndodhur ndërprerja e parashkrimit, padia duhet t'i dorëzohet gjykatës, dhe kjo duhet të bëhet brenda afatit të rrjedhës së parashkrimit.

4.4. Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë

Me nenin 370 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Ndërprerja e parashkrimit e bërë me paraqitjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi të cilin e

ka ndërmarrë. 2. Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit apo e sigurimit është shpallur e pavlefshme".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: Ndërprerja e parashkrimit, që është bërë me paraqitjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit në një gjykatë ose një autoriteti tjetër kompetent, me qëllim të sigurimit, vërtetimit ose realizimit të kërkesës, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur, po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë kundër debitorit në një gjykatë ose një autoritetit tjetër kompetent. Në këtë kontekst shikohet vetëm padia, të cilën gjykata e ka aprovuar, sepse kur kreditori heqë dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë, atëherë nuk kemi ndërprerje të parashkrimit.

Duhet theksuar se nuk ka ndërprerje të parashkrimit edhe në rastin kur padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo është refuzuar ose, në qoftë se masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit apo e sigurimit është shpallur e pavlefshme. Hedhja poshtë e padisë nga ana e gjykatës nënkupton se, lidhur me padinë nuk është vendosur në mënyrë meritore, për sa i përket përmbajtjes së padisë, dhe hedhja poshtë e padisë konsiderohet sikur padia mos të jetë paraqitur fare dhe në këto raste nuk kemi ndërprerje të parashkrimit.

Po ashtu, edhe të refuzimi i padisë, nuk kemi ndërprerje tw parashkrimit, ndërprerje të parashkrimit nuk kemi edhe kur me ndonjë veprim tjetër të kreditorit drejtuar gjykatës apo një organi tjetër kompetent, është përcaktuar se masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit apo sigurimit të kërkesës është shpallur e pavlefshme.

Pra, në tri rastet - edhe kur hidhet poshtë padia, edhe kur refuzohet ajo, edhe kur masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit ose e sigurimit shpallet e pavlefshme, nuk kemi ndërprerje të parashkrimit. Prandaj, afati i parashkrimit rrjedh edhe gjatë kësaj kohe, në vazhdimësi të pandërprerë.

4.5. Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës

Me nenin 371 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të jo kompetencës së gjykatës ose

për ndonjë arsye tjetër i cili nuk i përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri paraqet padi brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data kur vendimi mbi hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formën e prerë do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë. 2. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjen në mbrojtje si dhe për paraqitjen e kompensimit të kërkesës në kontest si dhe në rastin kur gjykata ose ndonjë organ tjetër e ka drejtuar debitorin që kërkesën e tij të deklaruar ta realizojë në procedurë civile".

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: Hedhja poshtë e padisë, por për shkak të jokompetencës së gjykatës, e ndërpret parashkrimin. Në rastet kur padia e drejtuar kundrejt debitorit është hedhur poshtë, për shkak të jokompetencës së gjykatës, pra gjykata nuk ka qenë kompetente të vendos, lidhur me kërkesën e kreditorit ose hedhja e padisë bëhet për ndonjë arsye tjetër, që nuk ka të bëjë me meritat çështjes, dhe nëse kreditori, të cilit i është hedhur poshtë padia, për shkak të jokompetencës ose për ndonjë arsye tjetër që nuk i përket meritave të çështjes, përsëri mund të paraqet padi, brenda afatit prej 3 muajsh nga data kur vendimi për hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë, do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë të paraqitur.

Për të ardhur deri të ndërprerja e parashkrimit edhe në rastet kur kemi hedhjen poshtë të padisë, kërkohet të plotësohen dy kushte:

a) që hedhja poshtë e padisë të jetë bërë për shkak të jokompetencës së gjykatës ose për ndonjë arsye tjetër që nuk i përket meritave të çështjes, dhe
b) kreditori përsëri të paraqet padi brenda afatit prej 3 muajsh, nga data kur vendimi për hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë.

Pra, që të pranohet ndërprerja e parashkrimit kërkohet, përveç të tjerash, që kreditori përsëri të paraqesë padi dhe këtë brenda afatit prej 3 muajsh nga data kur vendimi për hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë.

E njëjta gjë vlen edhe për rastet kur i referohet mbrojtjes, domethënë një veprimi të caktuar të kreditorit, si:

- paraqitja e kërkesës pasurore në procedurën penale,
- paraqitja e kërkesës së shpërblimit në kontest, si dhe

- rastet kur gjykata ose një organ tjetër e ka udhëzuar palën që kërkesën e tij të deklaruar ta realizojë në procedurën civile.

4.6. Thirrja e kreditorit

Me nenin 372 të LMD-së, përcaktohet se: "Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditorit ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin. Pra, kërkohet që kreditori t'i drejtohet gjykatës për përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Në qoftë se debitori nuk i përgjigjet thirrjes së kreditorit për përmbushjen e detyrimit, për të cilin rrjedhë afati i parashkrimit, atëherë nuk ekziston efekti juridik që të shkaktojë ndërprerjen e parashkrimit.

4.7. Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes

Me nenin 373 të LMD-së, përcaktohet se: "1. Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim. 2. Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi)". 3. Kur ndërprerja e parashkrimit ka filluar me paraqitjen e padisë ose me thirrjen në mbrojtje, ose duke paraqitur kompensimin e kërkesave në kontest, përkatësisht me paraqitjen e kërkesave në ndonjë proces tjetër, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita kur kontesti të ketë marrë fund definitivisht ose të ketë përfunduar në ndonjë mënyrë tjetër. 4. Kur ndërprerja e parashkrimit të jetë shkaktuar me paraqitjen e kërkesës në procedurën e falimentimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita e përfundimit të asaj procedure. 5. E njëjta gjë vlen edhe kur ndërprerja e parashkrimit të jetë shkaktuar me kërkesën e përmbarimit të dhunshëm ose të sigurimit. 6. Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë".
Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se:

- pas ndërprerjes, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në kuadër të afatit të caktuar ligjor të parashkrimit;
- parashkrimi që është ndërprerë me anë të pranimit nga ana e debitorit, fillon të rrjedhë përsëri nga dita e pranimit;
- kur ndërprerja e parashkrimit ka filluar me paraqitjen e padisë ose me referimin në mbrojtje ose duke parashtruar kompensimin e kërkesave në një kontest tjetër, përkatësisht me paraqitjen e kërkesave në ndonjë proces tjetër, atëherë afati i parashkrimit fillon të rrjedhë përsëri që nga dita kur kontesti të ketë marrë fund me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- kur ndërprerja e parashkrimit të ketë ndodhur me paraqitjen e kërkesës në procedurën e falimentimit, edhe në këtë rast parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri nga dita e përfundimit të asaj procedure;
- kur ndërprerja e parashkrimit është shkaktuar me kërkesën për përmbarim të dhunshëm ose të sigurimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri nga dita e përfundimit të asaj procedure;
- parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë.

4.8. Parashkrimi në rastin e përtëritjes së detyrimit

Me nenin 374 të LMD-së, përcaktohet se: “Në qoftë se ndërprerja ka filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, ndërsa kreditori dhe debitori janë marrë vesh që ta ndryshojnë bazën ose objektin e detyrimit, kërkesa e re parashkruhet për kohën që është caktuar për parashkrimin e saj”.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: Në rastet kur ndërprerja e afatit të parashkrimit ka filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, ndërsa kreditori dhe debitori janë marrë vesh që ta ndryshojnë bazën ose objektin e detyrimit që, në fakt, është përtëritje e detyrimit, kërkesa e re e lindur në bazë të marrëveshjes mes kreditorit dhe debitorit, për ndryshimin e bazës ose objektit të detyrimit parashkruhet brenda kohës që është caktuar, për parashkrimin e saj.

Pra, në rastet kur objekt i detyrimit mes kreditorit dhe debitorit ka qenë çmimi i shitjes së sendit dhe me marrëveshje ndryshon baza e detyrimit, ashtu që nga kontrata e shitblerjes kalohet në kontratë të huamarrjes, sepse shuma e parave e cila ishte më parë objekt i detyrimit nga kontrata e shitblerjes, pas marrëveshjes, do të trajtohet si huamarrje. Për këtë rast, afati i parashkrimit është ai që vlen për detyrimet që dalin nga kontrata e huamarrjes. Në këtë rast, afati i parashkrimit nis nga fillimi, për shkak se kemi ndërprerjen e detyrimit të filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, pastaj ndryshohet baza ose objekti i detyrimit me marrëveshjen mes kreditorit dhe debitorit, duke u krijuar kështu detyrimi i ri, për të cilin vlejnë afatet fillestare të parashkrimit.

5. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Në gjykatat e Republikën e Kosovës në praktikën gjyqësore, janë paraqitur një numër i konsiderueshëm i rasteve ku parashkrimi është një ndër rastet me të shpeshta të shuarjes së marrëdhënieve të detyrimeve kundër vullnetit të subjekteve pjesëmarrëse. Mirëpo dinamika e rasteve të paraqitura si pasoj e parashkrimit, ka ndikuar që të ketë praktikë jo unike, pra për gjendje faktike dhe juridike të njëjtë kemi vendimmarrje ndryshe, lidhur me shuarjen e marrëdhënieve të detyrimeve me parashkrim, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të.

Ka raste kur Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk kanë ekzistuar kushtet për ndryshimin e aktgjykimeve të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Në disa raste aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak te të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e

shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me ato prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e atyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Në disa raste gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht ose në tërësi të bazuara/pabazuar.

Në praktikën gjyqësor ka raste kur gjykatat/gjyqtarët gabimisht kane llogaritur kohen/afatin kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Në praktikën gjyqësor ka raste kur gjykatat/gjyqtarët përveç tjerash gabimisht kanë llogaritur kohen/afatin e përgjithshëm kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, veçanërisht në rastet e paraqitura për kërkesat, për të cilat me ligj nuk është caktuar një afat tjetër i parashkrimit.

Në praktikën gjyqësor ka raste kur gjykatat/gjyqtarët kanë shqyrtuar rastet ku është aplikuar ligji i cituar gabimisht kanë llogaritur kohen/afatin kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, në rastet që Gjykata Supreme e Kosovës, ka shqyrtuar rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e

Detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm, e veçanërisht në rastet e paraqitura për kërkesat, për të cilat me ligj nuk është caktuar një afat tjetër i parashkrimit.
Në praktikën gjyqësor ka raste kur gjykatat/gjyqtarët gabimisht kanë konstatuar se ka ardhur deri të parashkrimi i vet të drejtës, për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.
Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e paraqitura për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale, ka konstatuar praktikë jo unike, si dhe gjykatat/gjyqtarët përveç tjerash gabimisht kanë llogaritur kohen/afatin kur ka lindur parashkrimi - gjegjësisht kur ka skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, dhe si pasoj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.
Në praktikën gjyqësore në rastet e paraqitura veçanërisht në procedurë përmbarimore, duke mos përjashtua as rastet në procedurë kontestimore është paraqitur si dilemë se, për shkak të pagesës së kohëpaskohshme, a ndërprerët parashkrimi sipas nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së, dhe si pasoj për çështja faktike dhe juridike të njëjtë, ka pasur vendimmarrje ndryshe.
Në praktikën gjyqësore, në rastet e paraqitura lidhur me rimbursimin e dëmit është paraqitur si dilemë se kur fillon dhe kur përfundon afati i parashkrimit, dhe si pasoj për çështja faktike dhe juridike të njëjtë, ka pasur vendimmarrje ndryshe.

6. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

Aktvendim Rev.nr.363/24 i datës 21.10.2024

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditësit: Skender Gabrrica nga fshati Gadime e Ulët, Komuna Lipjan, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1140/2021, i datës 22.05.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.504/2014 i datës 15.01.2021, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykatë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Pasi që në revizion pretendimet e paditësit janë vetëm në raport me refuzimin e kërkesëpadisë për shkak të parashkrimit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë në kontestet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit, gjykata i shqyrton gjithherë sipas prapësimit të palës, prandaj në këtë rast e paditura, ka paraqitur pretendim lidhur me parashkrimin e kërkesës ndaj saj, me pretendimin se ka kaluar afati i parashkrimit, ndërsa gjykata e shkallës së dytë gabimisht e ka vlerësuar këtë fakt dhe ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar,

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditësit të paraqitura në revizion, dhe të njëjtat janë të bazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 376 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 377 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), janë afate ligjore, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjatën dhe as të shtyhen, dhe se në rast të kalimit, të afatit kërkesa arrin parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është e parashkruar ose jo, e që në rastin konkret gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar saktë faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, për arsye se:

Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin “, ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: “Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi“.

Me nenin 377 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një

afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, për arsye se: në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk e kanë vërtetuar faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë së paditësit. Gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar faktin nëse ndaj shkaktarit të aksidentit është iniciuar procedurë penale ose jo. Në shkresat e lëndës kemi vetëm një procesverbal të vendshiqimit, me nr. PN.15/97, të datës 02.01.1997, i hartuar nga ana e gjyqtarit hetues të Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili ka dalë në vend të ngjarjes për ta bërë vendshikimin. Nga ky procesverbal nuk mund të konstatohet fakti nëse është filluar procedurë penale dhe nëse është filluar në cilën fazë të procedurës gjendet.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nëse kemi inicim të procedurës penale dhe ende nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë lidhur me këtë çështje, atëherë për parashkrimin e kërkesës së paditësit vlejnë dispozitat e parashkrimit të veprës penale, ashtu siç është paraparë me dispozitën ligjore nga nenin 376 dhe 377 të LMD-së, ndërsa nëse gjykata e shkallës së parë vërteton faktin se nuk kemi fare inicim të procedurës penale, ose kemi ndonjë vendim të formës së prerë, atëherë duhet të veproj konform dispozitave të LMD-së, të cekura më lartë, sepse është determinuese për gjykatën të konstatoj nëse pala është në njohuri për dëmin dhe shkaktarin e dëmit dhe si pasojë e mos veprimit në këtë drejtim, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje dispozitave të lartcekura të LPK-së.

Gjithashtu gjykata e shkallës së dytë nuk ka marrë parasysh fare faktin lidhur me ngecjen e parashkrimit ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore nga neni 382 dhe 383 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

(1978), duke mos arsyetuar fare mbi këtë bazë, duke pas parasysh se është fakt i pa kontestueshëm se gjatë vitit 1997-1999, ka qenë gjendje lufte në Kosovë, përkatësisht kanë ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme, dhe është dashtë që nga gjykata e shkallës së dytë të vlerësohet ky fakt dhe të konstatohet nëse janë plotësuar kushte për ngecjen e parashkrimit, dhe një mos vlerësim i tillë e bënë aktgjykimin e shkallës së dytë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe si rezultat i kësaj aktgjykimi është dashtë të prishet, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përveç të cekurave, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik as i gjykatës së shkallës së parë, për faktin se e njëjta nuk ka arritur të jap arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, për arsye se: në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka konstatuar në mënyrë të qartë se me fajin e kujt është shkaktuar ky aksident/incident, dhe sa është kontributi për secilin veç e veç. Paditësi në këtë rast a ka kontribuar eventualisht në shkaktimin këtij aksidenti/incidenti, a ka mundur i njëjti ti shmanget këtij aksidenti/incidenti apo kemi të bëjmë me përgjegjësi ekskluzive të padituri, apo të ndonjë personi/subjekti tjetër përgjegjës, pasi që i padituri gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të dëmit - gjegjësisht përgjegjësisë së tij. Edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë ka nxjerr provën me ekspertim nga lëmia e komunikacionit rrugor, ka dështuar të argumentoj se si ka ardhur deri të lëndimi i paditësit dhe nuk ka konstatuar se cilat janë konkretisht lëshimet nga ana e të padituri, me rastin e dëmit të shkaktuar dhe cilat janë lëshimet eventuale të paditësit, a ka mundur paditësi ti shmanget këtij aksidenti/incidenti, apo kemi të bëjmë me përgjegjësi ekskluzive të padituri, apo të ndonjë personi/subjekti tjetër përgjegjës, por vetëm kanë parafrazuar në atë se si ka ardhur deri shkaktimi i dëmit dhe lartësia e tij, ndërsa ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti Yll Koshi është e pa qarta dhe jo profesionale, për faktin se nuk kanë arritur të vërtetojnë saktë shkaktarin e aksidentit dhe kontributin e saktë të pjesëmarrësve në këtë aksident/incident, madje eksperti gjatë sqarimeve në seancën e datës 09.12.2020, ka refuzuar të jap përgjigje

rreth kontributit eventual të pjesëmarrësve në shkaktimin e atij aksidenti, gjë që ekspertizën e ka bërë edhe më të pa qartë.
Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë faktin se sa ka qenë kufizimi i shpejtësisë në atë pjesë ku ka ndodhë aksidenti, si ka qenë pjesa e rrugës, a ka qenë e mirëmbajtur sipas kushteve të dimrit, a ju kanë përmbajtur pjesëmarrësit në aksident kushteve atmosferike, duke paraqit kujdes të shtuar nëse rruga ka qenë e rrëshqitshme për shkak të mbulimit me borë. Si pasojë e kësaj gjykata e shkallës së parë gabimisht ka bërë ndarjen e përgjegjësisë për kontributin e të paditurit 40%, sepse nuk është vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të saktë kontributi i secilit pjesëmarrës në këtë aksident/incident
Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që fillimisht, të konstatoi se në këtë rast a është kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit/incidentit, nëse edhe me tej mbetët kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit/incidentit ti marr në shikim shkresat penale nëse është e nevojshme ti kërkojë sipas detyrës zyrtare, të shqyrtoj ngecjen e parashkrimit ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore nga neni 382 dhe 383 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) dhe pas kësaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementët e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi Rev.nr.326/24 i datës 21.10.2024

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditëses: "Dardania Company", sh.p.k., me seli në Prishtinë, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7747/21, i datës 21.03.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1934/2014 i datës 27.12.2019, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi refuzimin e kërkesëpadisë. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport

me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi refuzimin e kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pasi që në revizion pretendimet e paditëses janë vetëm në raport me refuzimin e kërkesëpadisë për shkak të parashkrimit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë në kontestet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit, gjykata i shqyrton gjithherë sipas prapësimit të palës, prandaj në këtë rast e paditura, ka paraqitur pretendim lidhur me parashkrimin e kërkesës ndaj saj, me pretendimin se ka kaluar afati i parashkrimit, ndërsa gjykata e shkallës së parë dhe të dytë gabimisht e ka vlerësuar këtë fakt dhe ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditëses të paraqitura në revizion, dhe të njëjtat janë të bazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 371 dhe nenit 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), janë afate prekluzive, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjatën dhe as të shtyhen, dhe se në rast të kalimit, të afatit kërkesa arrin parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është e parashkruar ose jo, e që në rastin konkret gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar saktë faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, për arsye se:

Me nenin 371 të LMD-së, përcaktohet se: “Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”.

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë

dhe të dytë, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, për arsye se: në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk e kanë vërtetuar faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë së paditëses.
Gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar faktin nëse kemi të bëjmë apo jo me borxh apo kompensim të dëmit, dhe se cilat afate duhet të merren për bazë në këtë rast, a kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës apo jo, duke ju referuar në neni 371, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se: "Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit", për arsye se:
Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.10.1978 është ligj i aplikueshëm në Kosovë, në bazë të nenit 1.1. (b), të Rregullores së UNMIK-ut me nr.1999/24 të datës 12.12.1999, e cila ka hyrë në fuqi më datë 10.06.1999, në bazë të nenit 34 të Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e RFJ-së, nr. 231/93 e datës 18.06.1993, i cili ka hyrë në fuqi më datë 25.06.1993, shprehimisht përcaktohet se neni 371 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr. 29/78 e datës 26.05.1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.10.1978, fjala " pesë" zëvendësohet me fjalën "dhjetë", dhe kështu në bazë të kësaj dispozite kërkesat parashkruhen për 10 vite, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në këtë rast duhet të aplikohet neni 34 i Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kjo dispozitë ligjore është e aplikueshme në Republikën e Kosovës, në bazë të nenit 1.2, të Rregullores së UNMIK-ut, të theksuar më lartë, për arsye se nuk ka karakter diskriminues, për shkak se është në përputhje të plotë me nenin 1.3, të kësaj rregullore, me të cilën respektohen të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si pjesë integrale e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst në këtë rast duhet të aplikohet neni 34 i theksuar më lartë për faktin se raporti juridik i detyrimeve është krijuar në kohën kur ishte në fuqi Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e LMD-së, dhe si përfundim kjo gjykatë konstatoi se gjykatat e instancave më të ulëta sa i përket vlerësimit të

parashkrimit të kërkesave për të cilat është refuzuar kërkesëpadia e paditëses, është e pa drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, prandaj edhe është dashtë të prishën dhe çështja të kthehet në rivendosje,

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që fillimisht, të konstatoi se në këtë rast a është kontestuese baza juridike dhe nëse edhe me tej mbetët kontestuese baza juridike, gjykata e shkallës së parë të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementët e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykimi Rev.nr.280/2025 i datës 01.09.2025

A K T GJ Y K I M

REFUZOHET i pabazuar revizioni i të padituri: Muja O.P., me seli në fshatin Duraj, Komuna Kaçanik, me pronar Muhamet (Hajredin) Zenuni nga fshati Duraj, Komuna e Kaçanikut, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8404/2022, të datës 18.02.2025.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

I padituri, në revizion pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Megjithatë, këto pretendime janë përmendur vetëm si bazë për atakimin e aktgjykimit të kontestuar, pa specifikuar dhe pa arsyetuar se cila dispozitë konkrete e LPK-së, është shkelur dhe në ç' mënyrë kjo ka ndikuar në rezultatin e procedurës. Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës, kufizon shqyrtimin e saj vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare, zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt, për çka edhe ka vlerësuar se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë është i qartë, i kuptueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Pretendimet e paraqitura në revizion se në këtë rast kemi shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe finalitetit të proceseve gjyqësore, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të bazuara, për arsye se deklarimi i të dëmtuarit në procedurë penale - këtu i dëmtuari se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore - juridike në procedurë penale, nuk nënkupton se ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike në procedurë kontestimore. Për me tepër në aktgjykimin penal P.nr.299/2016 të datës 03.03.2017, i dëmtuari udhëzohet që kërkesën pasurore - juridike ta realizojë në kontest civil.

Pretendimet e paraqitura në revizion se në këtë rast i dëmtuari - paditësi në procedurë penale ka heqë nga kërkesa pasurore - juridike, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, për arsye se për tu konsideruar se pala ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike që gjykata të ketë marr aktgjykim në kuptim të nenit 149 të LPK-së. Në këtë rast i dëmtuari - paditësi në procedurë penale nuk ka heqë dorë nga kërkesa pasurore - juridike, mirëpo ka deklaruar se nuk parashtron

kërkesë pasurore - juridike në procedurë penale, kjo nuk nënkupton se i dëmtuari - paditësi ka humbur të drejtën që kërkesën pasurore - juridike të realizoj në kontest civil. Për me tepër i dëmtuari - paditësi siç është theksuar është udhëzuar në kontest civil, dhe për realizimin e kërkesës pasurore - juridike ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, dhe dispozita e LMD-së.

Pretendimet e paraqitura në revizion se paditësit i mungon legjitimiteti aktiv në kuptimin material - juridik sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të bazuara, për arsye se i dëmtuari asnjëherë nuk ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike si tërësi, mirëpo i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike në procedurën penale, siç është theksuar, si dhe nëse i referohemi dispozitave ligjore të LMD-së, rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës, etj. (dëmi jomaterial). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.

Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas dispozitave të LMD-së, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore.

Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i

dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.
Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. Në këtë kontekst kërkohet që veprimet apo mosveprimet e kryesit të dëmit në raport me dëmin e shkaktuar të jenë me dashje apo nga pakujdesia. Dashja nënkupton se dëmi është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme apo thënë ndryshe kur dëmtuesi i dëshiron pasojat, ndërsa pakujdesia ekziston kur kryesi nuk ka qenë i kujdesshëm në ndërmarrjen e veprimeve të tij apo nuk ka vepruar, ndonëse është dashur të veprojë.
Nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se detyrimi i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, pra qëllim primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit. Pastaj nëse kjo nuk është e mundur, e që zakonisht është e pamundur të bëhet rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla. Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.
Në këtë rast i dëmtuari - paditësi ka legjitimitet në kuptimin material - juridik, për faktin se me provat e administruara dhe sidomos nga aktgjykimi penal i lartcekur është vërtetuar se i padituri është shpallur fajtor, se ka vepruar në kundërshtim me lejen ndërtimore dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe punëtorëve, ku nga këto lëshime nga pësuar i ndjeri Izahir Luma, babai i paditësit, prandaj nga kjo shihet qartë se paditësi ka legjitimitet të plotë aktiv në këtë çështje juridike - kontestimore për të kërkuar kompensimin e dëmit.
Pretendimet e paraqitura në revizion se kjo çështje është çështje e gjykuar (res iudicata), sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, për arsye se: i dëmtuari nuk ka hequr dorë asnjëherë nga kërkesëpadia, qoftë në procedurë penale apo civile dhe as nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë, që ka vendosur lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, në mënyrë që kjo çështje të konsiderohet si çështje e gjykuar.
Për me tepër me nenin 166 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështje kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar, çështja e ngritur me padi, dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston

vendim i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme", me nenin 167 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: "Aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetën ndaj palëve ndërgjyqëse përveç kur nga shkaku i natyrës së raportit kontestues apo sipas urdhrit të ligjit, prodhon efekt kundër personave të tretë ", me paragrafin 2 të këtij nenin përcaktohet se: " Forma e prerë e aktgjykimit lidhet për gjendjen e raportit juridik në kohën e përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes", ndërsa sipas nenit 391 paragraf 1, pika d), e LPK, përcaktohet se: "Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme, po qe se konstaton se çështja e ngritur me padi është gjë e gjykuar - res iudicata".

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se në këtë rast shikuar në aspektin subjektiv të dy gjykimet nuk janë identike për arsye se në të dy gjykimet nuk veprojnë të njëjtat palë, edhe pse njëra palë - këtu pala e paditëse, në gjykimin e mëparshëm në procedurë penale ka vepruar si palë e dëmtuar, ndërsa në anën e palës paditur ka vepruar si i akuzuar - tani i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykim penal të formës së prerë. Shikuar në aspektin objektiv të dy gjykimet nuk janë me objekt identik për arsye se në procesin gjyqësor sipas padisë kërkohet kompensimi i dëmit, ndërsa në procedurë penale ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore - juridike në procedurë penale, pra nuk kemi aktgjykim refuzues të formës së prerë. Në këtë kontekst rezulton se i dëmtuari - paditësi nuk ka humbur të drejtën që kërkesën pasurore - juridike të realizoj në kontest civil. Për me tepër i dëmtuari - paditësi siç është theksuar është udhëzuar në kontest civil, dhe për realizimin e kërkesës pasurore - juridike ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, dhe dispozita e LMD-së.

Po ashtu nëse i referohemi neni 1 dhe 2 të LPK-së, rezulton se gjykata i shqyrton dhe i zgjidh kontestet nga marrëdhëniet juridike - civile, të personave fizik dhe juridik, po që së më ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe dhe se gjykata në kontestet, për zgjidhjen e të cilave kërkohet nga gjykata nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëj me drejtën materiale dhe se rregullat e të drejtës materiale i vlerëson sipas çmuarjes së saj të lirë, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, mirëpo gjykata në procedurë kontestimore vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqës në kuptim të nenit 2 paragraf 1

të LPK-së, siç ka vepruar në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe të dytë.
Pretendimet e paraqitura në revizion se në këtë rast padia është e palejuar, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të bazuara, për arsye se:
Me nenin 391 paragrafi 1 pika f) të LPK-së, përcaktohet se: "Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore; b) palët kanë lidhë kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazhi; c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca); d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata); e) për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka hequr dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi; f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj; g) paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji".
Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se në këtë rast padia e paditësit nuk është e palejuar siç pretendon pala e paditur dhe se aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë nuk janë përfshirë me shkelje të dispozitave të LPK-së, për shkak se kjo dispozitë i referohet situatave kur hedhja poshtë e padisë nënkupton situatën kur gjykata e ka vlerësuar se procesi gjyqësorë është i palejueshëm për shkak se nuk plotësohen kushtet respektivisht prezumimet nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësorë. Hedhja e padisë mund të bëhet për shkak të pengesave procedurale që lidhen me gjykatën - kompetencën, palët - cilësinë e palëve dhe përfaqësimin, objektin e kontestit si: çështja e gjykuar, litispendenca, ekzistimi i ujdisë gjyqësore, ekzistimi i vendimit mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia apo edhe mungesa e interesit juridik dhe po ashtu mund të hedhet për shkak të parregullsisë formale të padisë nëse edhe pas kërkesës për plotësimin e padisë pala dorëzon parashtresën e pa plotësuar, si dhe në rastin e pengimit të posedimit dhe kontesteve të punës nëse nuk është parashtruar brenda afati ligjor. Pra për prapësimet e natyrës materiale siç janë heqja dorë nga kërkesëpadia, parashkrimi, etj, gjykata vendos në mënyrë meritore. Për të vendosur për prapësimin e parashkrimit gjykata duhet të theksoj rrethanat faktike që lidhen me te drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, afatin brenda të cilit

parashkruhet kërkesat, natyrën e kërkesave siç mund të jenë të përnjëhershme dhe periodike, fillimin e rrjedhjes së afatit për kërkesat periodike dhe pas vlerësimit të këtyre rrethanave gjykata duhet të vendosë me aktgjykim për themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë.
Në këtë rast nuk plotësohen asnjë nga kushtet respektivisht prezumimet nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësorë, dhe hedhja e padisë nuk mundet të behet për shkak të pengesave procedurale që lidhen me gjykatën - kompetencën, palët - cilësinë e palëve dhe përfaqësimin dhe objektin e kontestit.
Kjo gjykatë ka vlerësuar se nuk ka dispozita ligjore dhe as praktikë gjyqësore të deri tanishme që kanë konstatuar se në këto raste duhet të hedhet padia e palejueshme, madje nuk ka as divergjenca apo vendimmarrje ndryshe te rastet e ngjashme, prandaj nuk ka dilema se kjo çështje duhet të trajtohet sipas meritave të çështjes.
Kjo gjykatë, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë edhe për zbatimin e drejt, të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:
Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit gjënë mbështetje në nenin 154, 158 dhe 192 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01 Tetor 1978.
Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: *“ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij“,* me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia“*, ndërsa me nenin 192 paragraf 1, përcaktohet se: *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh nga sa do të ishte ka të drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar ”.*
Baza juridike lidhur me shkaktarin e incidentit dhe lartësia e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese sipas revizionit, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materialo - juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirishtë në këtë rast.

Për hir të praktikes gjyqësore Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, se në këtë rast kërkesa e paditësit, për kompensimin e dëmit nuk është parashkruar për arsye se:

Me nenin 360 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *"Me parashkrim pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit",* ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *"Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit".*

Me nenin 361 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *"Parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër".*

Me nenin 376 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *"Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin, që e ka bërë dëmin".*

Me nenin 377 paragraf 1, 2 dhe 3 të LMD-së, përcaktohet se: *"Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale. 2. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale pas sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit. 3. E njëjta gjë vlen edhe për ngecjen e parashkrimit".*

Me nenin 294 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, përcaktohet se: " (1). Personi përgjegjës i cili me rastin e projektimit, mbikëqyrjes apo kryerjes së ndonjë ndërtimi apo të punëve të ndërtimit vepron kundër ligjit apo standardeve të përgjithshme profesionale të pranuara ose kundër kushteve të lejes për ndërtim dhe me këtë rrezikon jetën apo trupin e njerëzve ose të pasurisë me vlerë të madhe dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet. (2). Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet. (3). Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij ligji rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet, e nëse

vepra e tillë penale rezulton me vdekjen një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet. (4). Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet".

Me nenin 90 paragrafi 1, pika 3 të këtij ligji, përcaktohet se: (1) Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme: 3) Dhjetë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgim".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e paditësit për të kërkuar kompensimin e dëmit, ndaj të padituri nuk është parashkruar, për arsye se paraqitja e padisë ka qenë e lidhur me zgjidhjen e çështjes në procedurën penale, gjë e cila procedurë ka përfunduar me aktgjykimin P.nr.299/16 të datës 03.02.2017, të nxjerr nga Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, ku paditësi me anë të këtij aktgjykimi ka mësuar për shkaktarin e dëmit. Ndërsa prej plotfuqishmërisë së aktgjykimit të lartcekur e deri në paraqitjen e padisë nuk kanë kaluar më tepër se tre vite, ashtu siç përcaktohet me nenin 376 paragraf 1 të LMD-së, prandaj gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me të drejtë kanë konstatuar se kërkesëpadia e paditësit nuk është parashkruar.

Përveç të cekurave në këtë rast por edhe në raste të ngjashme është qëndrim i kësaj gjykate se nëse kemi inicim të procedurës penale dhe ende nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë lidhur me këtë çështje, atëherë për parashkrimin e kërkesës vlejnë dispozitat e parashkrimit të veprës penale, ashtu siç është paraparë me dispozitën ligjore nga nenin 376 dhe 377 të LMD-së, ndërsa nëse gjykata e shkallës së parë vërteton faktin se nuk kemi fare inicim të procedurës penale, ose kemi ndonjë vendim të formës së prerë, atëherë duhet të veproj konform dispozitave të LMD-së, të cekura më lartë, sepse është determinuese për gjykatën të konstatohet nëse pala është në njohuri për dëmin dhe

shkaktarin e dëmit. Në këtë kontekst në këtë rast gjendja faktike është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj nuk ka bërë shkelje dispozitave të lartcekura të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për arsye se:

Me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: ”1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj. 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet. 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin. 6. Ndihma juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi. 7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit”.

Me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përcaktohet se: *“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës*

civile, ashtu edhe për besueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]".

Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Për me tepër arsyetimi mirë i vendimeve gjyqësore nuk është thjesht një detyrim ligjor, por gjithashtu një proces i cili ka për qellim të shërbej në disa dimensione. Fillimisht, vendimet gjyqësore të arsyetuara mirë, kanë për qellim të transmetojnë dhe tu tregojnë palëve se argumentet e tyre janë dëgjuar dhe konsideruar në mënyrë meritore nga ana e gjykatës. Përmes arsyetimit adekuat ligjor, palët në procedurë mund të kuptojnë pse dhe si gjyqtari ka arritur në një përfundim të caktuar në çështjen objekt shqyrtimi dhe, për rrjedhojë, të marrin parasysh nevojën e përdorimit të mjetit juridik. Në këtë kontekst, arsyetimi i mirë gjithashtu lehtëson pranimin e gjykimit nga palët dhe nga publiku i gjerë. Në përgjithësi, vendimet gjyqësore (aktgjykimet) të arsyetuara mirë janë po ashtu, në funksion të mbrojtjes ndaj gjykimit arbitrar dhe garantojnë dhënien e duhur të drejtësisë, por edhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Pra në këtë kontekst, gjatë procesit të vendimmarrjes, gjykatat janë zakonisht të detyruara sipas ligjit të japin arsyetim të detajuar për vendimet e tyre. Detyrimi i gjykatave vendore për të dhënë arsye për vendimet e tyre është shprehur shprehimisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, i cili është burimi kryesor - por jo i vetmi - i detyrimit të gjykatave vendore për të dhënë një vendim të arsyetuar gjyqësor.

Garancitë e parashikuara në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar, duke vendosur mbi bazën e parashtrimeve të tyre. Pra, vendimi gjyqësor duhet të perceptohet nga palët dhe nga shoqëria në përgjithësi si rezultat i zbatimit korrekt të normave ligjore, i një procedure të drejtë dhe i një vlerësimi të duhur faktik, si dhe i zbatueshëm efektivisht. Megjithëse gjykata e rregullt ka një kufi të caktuar vlerësimi kur zgjedh argumentet dhe pranon provat, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet e saj duke

dhënë arsyet për vendimet e saj. Në këtë drejtim GJEDNJ-së, vendos detyrimin për gjykatat vendore që në arsyetimin e aktgjykimeve të theksoj arsyet e refuzimit të pranimit të provave të propozuara nga ana e palëve. Pra, GJENDJ-së vëren se nuk është detyra e saj të shqyrtojë nëse refuzimi i gjykatës për të pranuar provat e paraqitura nga ankuesi ishte i bazuar mirë, një detyrim i tillë i përket gjykatave vendore të cilat duhet të përcaktojnë çështje të kësaj natyre. Pra, arsyet e dhëna duhet të jenë të tilla që t'u mundësojnë palëve të përdorin efektivisht çdo të drejtë ankimimi të vlefshëm.

Neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së, i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të detajuar për çdo pretendim/argument. Në këtë drejtim, GJEDNJ-së nuk e konsideron shkelje të standardit të vendosur përmes konventës në rastet kur një gjykatë vendore ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të argumenteve të prezantuara nga palët. GJENDJ-së ka ritheksuar se, sipas jurisprudencës së saj që pasqyron një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave duhet të deklarojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ata bazohen. Në çfarë mase zbatohet kjo detyrë, për të dhënë arsye mund të ndryshojë në varësi të natyrës së aktgjykimit, si dhe rrethanave të rastit konkret.

Edhe pse gjykatat nuk janë të detyruara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga pala, megjithatë ato duhet të adresojnë pretendimet që janë kryesore për rastet e tyre dhe të cilat ngrihen në të gjitha fazat e procedurës. Një përfundim i lartpërmendur vërtetohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e cila përcaktoi se dhënia e arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mirë ligjërisht për vendimin e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë edhe kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet të theksojë marrëdhënien ndërmjet gjetjeve të meritës dhe reflektimeve kur të merret parasysh prova e propozuar, nga njëra anë, dhe vlerësimin ligjor të gjykatës, nga ana tjetër.

Për me tepër, aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozita ligjore dhe marrëdhënie logjike midis tyre. Prandaj, e drejta e marrjes se vendimit gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin e gjykatave të ofrojnë arsye për

vendimet e tyre me baza të arsyeshme, si në nivelin procedural po ashtu edhe material. Në të kundërtën, dështimi i gjykatave vendore për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota në lidhje me pyetjen kryesore të parashtruesit të kërkesës, paraqet shkelje të të drejtës se parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e se drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Pra, arsyetimi dhe analiza e qartë janë kërkesa bazë në vendimet gjyqësore dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës për gjykim të drejtë.

Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhënia e arsyeve në vendim varet nga argumentet e ndryshme të parashtruara nga secila palë, si dhe nga dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe opinionet ligjore, si dhe nga praktikat e ndryshme në lidhje me hartimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të shteteve të ndryshme. Për të respektuar parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të tregojë se gjyqtari ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë parashtruar para tij. Pra, funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për me tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për tu ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga Gjykata e Apelit.

Neni 6 i KEDNJ-së, dhe neni 31 i KRK-së, i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si detyrim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të palës në kontest. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshoje sipas natyrës se vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, inter alia, shumëllojshmërinë e parashtresave të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes se vendimeve. Prandaj, pyetja nëse një gjykatë ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i KEDNJ-së, mund të përcaktohet vetëm në varësi të rrethanave të secilit rast individual.

Lidhur me këtë, e drejta për gjykim të drejtë mund të jetë efektive, vetëm nëse gjykata është e detyruar të arsyetoj vendimet e saj, e që është gjithashtu një garancion vital kundër arbitraritetit. Sipas KEDNJ-së, nëse nuk jepen arsye për vendimin ose nëse arsyet e dhëna bazohen në një gabim të qartë faktik ose ligjor të kryer nga gjykata, kjo pashmangshmërisht rezulton në "mohim të drejtësisë, " e për rrjedhojë

në gjykim arbitrar. GJEDNJ-së në disa raste është ballafaquar jo me mungesë të plotë të arsyeve, por me inkoherencë të hapur të arsyeve të dhëna në aktgjykim, dhe nga gjykata kjo është konsideruar si arbitraritet. Në rastin Tatishvili v. Russia, GEDNJ-së, ka riafirmuar se, arsyetimi dukshëm i mangët nga gjykata e shkalles se parë, dhe aprovimi i mëvonshëm i një arsyetimi të tillë joadekuat nga gjykata e apelit, nuk përmbush kërkesat e një gjykimi të drejtë, dhe rezulton në vendimmarrje arbitrare.

Ndryshimet në praktiken gjyqësore në vend, kërkesa e sigurisë juridike dhe mbrojtja e pritjeve legjitime nuk përfshijnë të drejtën për një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Zhvillimi i praktikes gjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë, pasi dështimi për të mbajtur një qasje dinamike dhe evolutive do të parandalonte çdo reformë apo përmirësim të sistemit.

Sipas praktikës se GJEDNJ-së, Gjykata Supreme mund të shmang zbatimin unik të praktikes se konsoliduar, mirëpo çdoherë duhet të jep arsye bindëse se përse ka vendosur shmangien nga praktika e konsoliduar e gjykatave me të ulëta dhe vet praktikes se saj, në rast se e drejta e individit për vendim të arsyetuar do të shkelej. Pra, gjykata (kryesisht Gjykata Supreme) është e detyruar për të dhënë arsye bindëse, duke shtjelluar mjaftueshëm shkakun e shmangies nga praktika e saj e mëparshme, gjegjësisht faktin e ndryshimit të aktgjykimeve të gjykatave të instancës me të ulet dhe të qëndrimeve të saj juridike.

Sa i përket çështjes së divergjencës në praktikën gjyqësore, GJEDNJ-së ka theksuar rëndësinë e vendosjes së mekanizmave për të siguruar qëndrueshmëri në praktikën e gjykatave dhe unifikim të praktikës gjyqësore. Pra, duke qenë se praktika gjyqësore nuk është e pandryshueshme, por përkundrazi, në thelb evolutive, GJEDNJ-së vlerëson se parimi i administrimit të mirë të drejtësisë nuk mund të merret për të imponuar një kërkesë strikte të konsistencës së praktikës gjyqësore. Megjithatë, arritja e konsistencës së zbatimit të ligjit mund të marrë kohë, dhe për rrjedhojë periudhat e praktikes gjyqësore konfliktuale mund të tolerohen, pa cenuar sigurinë juridike. Mirëpo, për me tepër, lind pyetja se në cilat raste lejohet shmangia nga praktika gjyqësore? Ekzistojnë rrethanat në të cilat mund të lejohet shmangia nga një praktikë gjyqësore e konsoliduar, e që mund të jetë si rezultat i a)

reformave; ose b) evoluimit të praktikes gjyqësore, me qellim të administrimit me të mirë të drejtësisë, ashtu siç kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së.

Tek ne, edhe pse praktika gjyqësore nuk është formalisht e njohur si burim i se drejtës, në praktikë, praktika gjyqësore e konsoliduar është një autoritet i rëndësishëm, dhe gjykatat e ulëta janë të prirura për ta përcjellë pozicionin e Gjykatës se Apelit, dhe të Gjykatës Supreme. Një nder funksionet e Gjykatës Supreme është gjithashtu të garantoj uniformitetin e praktikes gjyqësore të gjykatave. Në këtë drejtim, argumenti i precedentit ka fituar një rëndësi kushtetuese në vendin tonë, deri në atë masë saqë shmangia në mënyrë arbitrare nga praktika gjyqësore (e konsoliduar, uniforme), mund të rezultojë në shkeljen e garancioneve procedurale kushtetuese, dhe për rrjedhoje të ngritët kërkesë për shqyrtim gjyqësor kushtetues para gjykatës kushtetuese. Është një ndër elementet e gjykimit të drejtë që gjyqtari nuk duhet në mënyrë arbitrare (pa dhënë arsye të detajuara) të shmang praktiken e konsoliduar gjyqësore, dhe në të kundërtën nëse një shmangie e tillë ndodh, gjykata kushtetuese përmes ankesës kushtetuese mund të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin dhe të kthej çështjen në rivendosje.

Andaj duke ju referuar të cekurave me lartë sipas kësaj gjykate, në këtë rast janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial dhe se pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, janë të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi Rev.nr.158/23 i datës 11.05.2023

A K T GJ Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurit: Ekrem Havolli nga Podujeva rr.”Hakif Zejnullahu”, pn., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr. 981/2020, të datës 23.03.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të gjykatës së shkallë së parë, pasi që aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vet veten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e titullit përmbarimor dhe i përshtatshëm për përmbarim, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike me decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar

vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se: Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses gjejnë mbështetje në dispozitat e Rregullës 3, për Ndryshimin e Rregullit për Sigurimet e Detyruara të Autopërgjegjësisë, nga Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovë e datës 25.09.2008, e lidhur me nenin 262 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 17.06.2010, në bazë të nenit 4.6.1 të Rregullit 3, Mbi Ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, me të cilën përcaktohet se; " Në rast të demit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar Sigurimin e Detyruar të Autopërgjegjëses - zhdëmtimi paguhet deri ne të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte Sigurimi i Detyrueshëm i Autopërgjegjësisë nga Fondi i Garantues së Kosovës, në bazë të nenit 4.1, 2. Pika a) ".

Meqenëse paditësja në bazë të provave prezentë në shkresat të lëndës ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarit/ëve si pasojë e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkoi rimbursimin e shumës së paguar në bazë të nenit 4.6 pika 2 të Rregullit 3, me të cilën përcaktohet se: " Pas pagimit të dëmshpërblimit mund të bëhet rimbursimin i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime ".

Me nenin 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet se: " Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla ", ndërsa me nenin 319 të këtij ligji, përcaktohet se: " Secila palë

ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta ”.
Meqenëse i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar andaj Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej 11.765 €, e duke u mbështetur në nenin 262 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili përcakton se: “ Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkoi përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij ”, dhe si rezultat i kësaj paditësja ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç’ rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit ndërsa i padituri e ka cilësinë e debitorit.
Nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në revizion se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:
Me nenin 360 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Me parashkrim pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit ”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit ”.
Me nenin 361 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër ”.
Me nenin 377 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin, që e ka bërë dëmin”.
Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e paditëses për të kërkuar rimbursimin e dëmit ndaj të padituri nuk është parashkruar, për arsye se rasti ka ndodhur me datë 17.06.2010, pagesa për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar i është

bërë me datë 11.03.2013, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë me datë 02.12.2013, e nga kjo rezulton se nga momenti i pagesës (që nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse) me të cilën është kompensuar pala e dëmtuar, e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë nuk kanë kaluar 3 vite, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses nuk është parashkruar.
Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.
Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Franciska Zhitija Ymeri

E Drejta e Pronës dhe Mbrojtja Gjyqësore

1. Shqyrtime të përgjithshme

E drejta e pronësisë paraqet njërën ndër institutet juridike më të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi, gjegjësisht institutin me të rëndësishëm të së drejtës sendore në veçanti. Pronësia trajtohet jo vetëm si drejtë mbi sendin por edhe si marrëdhënie pronësore juridike.

E drejta e pronësisë për shkak të rëndësisë që ka për subjektin e së drejtës, ajo përveç që është e drejt subjektive mbi sendin, konsiderohet edhe si e drejtë themelore e njeriut. Kjo është përcaktuar në mënyrë shprehimore edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen dhe të Drejtave dhe Lirive të Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

E drejta e pronësisë është e drejt subjektive e karakterit absolut dhe se sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij, që kërkon pronësinë, në këtë rast paditësja ka pasur detyrim ta provojë pronësinë e saj, por edhe të paraardhësit të saj, deri sa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërën prej mënyrave origjinare si mënyra të fitimit të pronësisë.

Prona dhe mbrojtja e saj, si një e drejtë fondamentale e njeriut, përfaqëson detyrimin e secilit vend që me legjislacion sipas standardeve ndërkombëtare ta parasheh dhe mbrojë këtë të drejtë, por njëkohësisht kjo përfaqëson edhe një sfidë për vetë sistemin gjyqësor në kontekstin e ofrimit të mbrojtjes gjyqësore sipas standardeve për të drejta e njeriut.

Ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në vitet e fundit lidhur me mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve pronësore, ndryshimi i sistemit shoqëror lidhur me pronën dhe llojet e pronës, transaksionet joformale të bartjes së pronës në të kaluarën, mos shqyrtimi i trashëgimisë dhe mos kalimi formal i pronës në trashëgimtarët si dhe rrethanat tjera sociale e shoqërore,

kanë ndikuar që numri i rasteve pronësore në gjykatat tona të jetë tejet i madh.
Praktika gjyqësore për çështje të tilla, përballet me sfida të mëdha të cilat nuk janë adresuar në mënyrë unike në sistemin gjyqësor, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë juridike dhe në besueshmërinë e publikut në gjykata.
Gjykata Supreme e Kosovës, në kuadër të juridiksionit të saj, si gjykatë e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore të instancave më të ulëta, përmes shqyrtimit dhe vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme, e gjithashtu si gjykatë e vendosjes së standardeve të praktikës gjyqësore të cilat duhet të respektohen nga gjykatat e instancave më të ulëta, synon që përmes aktivitetit të saj të mbështesë drejtpërsëdrejti rritjen e performancës gjyqësore përmes rritjes së efikasitetit, rritjes së cilësisë, rritjes se transparencës dhe rritjes së besueshmërisë së publikut në gjyqësor.
E drejta e pronës është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku dhe garantohet e drejta e pronës, dhe konsiderohet si kategori kushtetuese, e cila me nenin 46 përcakton se: “ 1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijmin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet. 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprjimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente. 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj ”.
Po ashtu me nenin 1 të Ligjit për Pronësisë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës) nr. 03/L-154, (në tekstin e mëtejmë - LPDTS), përcaktohet se: “ 1. Ky ligj rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e të drejtave sendore. 2. Ky ligj rregullon pronësinë si dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Këto të drejta sendore të kufizuara mund të krijohen në

pronësi apo në të drejta sendore të tjera që mund të jenë të përshtatshme për këtë qëllim. 3. Të drejtat tjera sendore mund të krijohen vetëm përmes ligjit. Dispozitat e përgjithshme dhe parimet themelore të këtij ligji gjithashtu vlejnë për të drejtat sendore të cilat nuk parashihen në paragrafin 2 të këtij neni, përveç nëse ligjet e veçanta parashohin ndryshe. 4. Pronësia dhe të drejtat sendore të tjera mund të kufizohen ose të merren kundër vullnetit të titullarit vetëm sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me ligj. 5. Dispozitat e këtij ligji nuk aplikohen në të drejtat sendore publike ose vlerat pasurore të përbashkëta të cilat rregullohen me ligje të veçanta, përveç nëse në mënyrë specifike parashihet ndryshe me këtë ligj ".

Me nenin 5 të LPDTS-së, është përcaktuar se " 1. Të drejtat sendore mund të kufizohen me të drejtat sendore në sendet tjera ashtu si është paraparë me këtë ligj. 2. Të drejtat sendore duhet të ushtrohen sipas natyrës së sendit dhe sipas parimeve të këtij ligj ", ndërsa me nenin 6 të këtij ligji, është përcaktuar se: " 1. Keqpërdorimi i të drejtave sendore është i ndaluar."

Me nenin 18 parashihet se "1. Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti. 2. Pronësia intelektuale i nënshtrohet rregullave të posaçme."

Me nenin 37 të LPDTS-së, është përcaktuar se: " Pronësia në një paluajtshmëri shtrihet në hapësirën mbi sipërfaqen e tokës dhe në hapësirën nën sipërfaqen e tokës, mirëpo vetëm për aq sa ekziston interesi për ushtrimin e saj dhe nëse me ligj të veçantë dhe të drejtat e personave të tretë nuk përcaktojnë diçka tjetër ". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kemi kufizim të shtrirjes së të drejtës së pronësisë duke respektuar edhe interesin e të tjerëve ".

1.1. Komenti i shkurtër i dispozitave të cituara

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës gjegjësisht nenin 46 garantohet e drejta e pronësisë si të drejtë themelore të njeriut, duke e mbrojtur atë në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe

Konventën Evropiane për Mbrojtjen dhe të Drejtave dhe Lirive të Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, të cilat janë të pranuar edhe në legjislacionin tonë në fuqi. Kështu, kjo dispozitë konfirmon se prona gëzon mbrojtje të plotë kushtetuese, ndërsa ushtrimi i saj duhet të jetë në pajtim me ligjin dhe interesin publik. Kushtetuta njeh gjithashtu mundësinë e eksproprijimit, por vetëm në kushte të posaçme, kur ndërhyrja bëhet për interes publik, kur është e paraparë me ligj dhe kur garantohet kompensimi i drejtë dhe i menjëhershëm sipas vlerës reale të tregut. Parimi i propocionalitetit kërkon që çdo kufizim ose eksproprijimi të jetë i arsyeshëm dhe jo arbitrar, duke ruajtur balancën ndërmjet interesave publike dhe atyre private.

Andaj, Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore gjegjësisht neni 1 përcakton mënyrën dhe kushtet e krijimit, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore, si dhe ky ligj rregullon edhe të drejtat sendore siç është e drejta e posedimit, të drejtat e sigurimit, dhe të drejtat e shfrytëzimit, këto të drejta sendore të kufizuara mund të krijohen si e drejtë e pronës apo si e drejtë sendore të tjera që mund të jenë të përshtatshëm për këtë qëllim. Këto të drejta sendore mund të krijohen vetëm përmes ligjit, pra dispozitat ligjore të ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore mund të krijohen vetëm me ligj. Pronësia dhe të drejtat sendore të tjera mund të kufizohen ose të merren pa pajtimin e titullarit vetëm në kushtet dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Dispozitat e këtij ligji nuk mund të aplikohen në të drejtat e sendeve publike duke përfshirë edhe vlerat pasurore të përbashkëta të cilat rregullohen me ligj të veçantë për veç nëse në mënyrë sepcifike parashihet ndryshe me ligj.

Ndërsa, neni 5 i LPDTS-së: është një dispozitë themelore që përcakton kufijtë e ushtrimit të së drejtës sendore. Ai parashikon se të drejtat sendore nuk janë të pakufizuar dhe absolute, por mund të kufizohen nga të drejtat reale të palëve të tjera mbi të njëjtën send. Kjo gjen shprehje praktike në institucionet juridike si servitutet, pengjet, të drejtat e qirasë, etj., ku pronësia mbi një send ndërthuret me të drejtat e të tretëve. Qëllimi i kësaj dispozite është ruajtje e balancës ndërmjet interesave të ndryshme dhe shmangia e konflikteve të panevojshme, duke mbrojtur ekuilibrin e interesave juridike edhe ekonomike. Kurse paragrafi i dytë të këtij neni theksohet se ushtrimi i së drejtës sendore duhet të jetë në përputhje me

karakteristikat objektive të sendit dhe me parimet e përgjithshme të ligjit. Kjo nënkupton se titullari nuk mund ta përdorë një send në mënyrë që bie ndesh më natyrën e tij ose më rendin juridik, p.sh. një pronar tokë bujqësore nuk mund ta shëndrojë atë në tokë ndërtimore pa respektuar rregullat urbanistike, ngase një veprim i tillë do të cenonte interesin publik dhe funksionin shoqëror të pronësisë. Në këtë mënyrë neni 5 krijon bazën për kontrollin gjyqësor ndaj ushtrimit të të drejtave sendore dhe i hap rrugën ndërhyrjes së gjykatës kur titullari abuzon me të drejtën e tij ose kur cenohen të drejtat e të tjerëve . Dispozita gjithashtu kontribuon në parandalimin e konflikteve pronësore dhe në sigurimin e një bashkëjetese të drejtës e të balancuar midis pronarëve dhe përdoruesve të ndryshëm të pasurive. Pra, ky nën pasqyron parimin e propocionalitetit dhe funksionit shoqëror të pronësisë, duke ndërtuar ekulibrin ndërmjet autonomisë së pronarit dhe mbrojtjes së interesave kolektive.

Rëndësia e pronësisë lidhet më sigurinë juridike, zhvillimin ekonomik dhe respektimin e të drejtave themelore. Prandaj e drejta e pronësisë titullarit i garanton pushtetin ma të lartë mbi një send. Siç e kemi theksuar më lartë se e drejta e pronësisë është e drejtë e tërësishme ndaj një sendi, me nenin 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore përcaktohet e drejta e tërësishme e pronës ndaj një sendi ku pronari mund të disponoj me sendin sipas vullnetit të tij e posaçërisht me të drejtën e posedimit, me të drejtën e përdorimit, me të drejtën e disponimit dhe të drejtat tjera të përshtatshëm nga çfarëdo ndikimi që nuk janë në kundërshtim me ligjin ose nga të drejtat tjera. Përveç të drejtave sendore ky ligj rregullon edhe të drejtën e pronës intelektuale që i nënshtrohet rregullave të posaçme.

Neni 37 i LPDTS-së: rregullon përmbajtjen vertikale të së drejtës së pronësisë mbi paluajtshmëritë, duke përcaktuar se ajo shtrihet mbi dhe nën sipërfaqen e tokës, por vetëm në masën që ekziston një interes real për ushtrimin e saj, dhe për aq sa nuk bie ndesh me ligje të veçanta ose të drejtat e personave të tretë.

Ky parashikim përfaqëson një kufizim të natyrshëm dhe funksional të të drejtës së pronësisë, duke reflektuar parimin se pronësia nuk është e pakufizuar, por duhet të ushtrohet në përputhje me interesin legjitim të pronarit dhe me rendin juridik në tërësi. Në këtë kuptim, neni 37 duhet të

interpretohet në harmoni me nenin 5, i cili përcakton se të drejtat sendore kufizohen sipas natyrës së sendit dhe parimeve të ligjit, duke nënvizuar se mënyra e ushtrimit të pronësisë duhet të jetë e arsyeshme, funksionale dhe në përputhje me karakterin e sendit (në këtë rast, tokës dhe strukturës së saj fizike) dhe nenin 6, që ndalon keqpërdorimin e të drejtave sendore, për të parandaluar që pronari të veprojë në mënyrë që cenon interesin publik ose të drejtat e të tjerëve, p.sh. duke bllokuar infrastrukturën publike ose duke penguar përdorimin legjitim të hapësirës ajrore ose nëntokësore nga autoritetet ose subjektet e autorizuara.

Kjo dispozitë pasqyron edhe balancën ndërmjet të drejtës private dhe interesit publik, duke kufizuar kompetencat e pronarit në mënyrë proporcionale dhe të arsyeshme, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të ndalimit të abuzimit të së drejtës, të pranuar gjerësisht në të drejtën civile moderne.

1.2 Pronësia dhe pasuria

Nga praktikuesit si dhe në jetën e përditshme ka raste që ngatërrohen termet pronësia dhe pasuria sepse disa nuk mund të bëjnë dallimin në termet pronësi dhe pasuri. Atëherë që të jetë më qartë pasuria është tërësi e të drejtave subjektive civile me karakter pasuror që i takojnë një personi, ku lëndë e pasurisë janë sendet dhe vlerat ekonomike si dhe të drejtat e tjera me karakter pasuror.

Konventat Ndërkombëtare e përdorin shprehjen "property" që është me dy kuptime edhe si pronësi edhe si pasuri. Mirëpo neni 1 i Protokollit 1 të kësaj Konvente, me fjalën pasuri nënkupton edhe pronësinë. Për këtë në literaturën e Këshillit të Evropës, thuhet "Neni 1 i Protokollit nr.1 i Konventës Evropian, garanton të drejtën për respektimin e pasurisë, që zakonisht quhet e drejta e pronës.

Ndërsa e drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmban autorizime më të gjera lidhur me përdorimin, shfrytëzimin dhe dispononim e një sendi. Pronësia për nga përmbajtja e vet është e drejtë e pushtetit më të gjerë që i njihet pronarit mbi një send. Autorizimet më të gjera të pronësisë janë e drejta e përdorimit, shfrytëzimit dhe disponimit. Pra, pronari i sendit të cilin e ka në pronësi të veten atë send mund të përdorë sipas dëshirës së vet, mund t'i mbledh frutat dhe të ardhurat që i jep sendi, por edhe mund ta bartë sendin tek personi i tretë, duke e shitur, dhuruar, apo tjetërsuar në ndonjë formë tjetër të përcaktuar me ligj si dhe mund ta

shkatërrojë sendin. Përveç përdorimit të sendit pronari i sendit mund të disponoj më të njëjtin, duke bartur tek personi tjetër me anë të veprimit juridik, me ç ‘rast mund të vije deri te shuarja e pronësisë për pronarin e mëparshëm, sepse këtë të drejtë e fiton personi tjetër. Pronari po ashtu mund t’ia kalojë vetëm të drejtën e shfrytëzimit të sendit tek personi tjetër, qoftë përmes huazimit , qiradhënies etj., me çka ai ende vazhdon të jetë pronar i sendit.

Pronësia si e drejtë sendore bën pjesë në të drejtën subjektive absolute dhe është e rregulluar me dispozita imperative. Përmbajtja e pronësisë mund të ndryshojë ose të kufizohet me të drejtat tjera sendore të përcaktuara me normat pozitive.

Pronësia, jo vetëm që është e drejtë subjektive, pra pushtet mbi sendin, por pronësia konsiderohet edhe marrëdhënie juridike. Pra, konsiderohet marrëdhënie juridiko-civile. Në literaturën juridike pronësia definohet edhe si marrëdhënie juridike dhe thuhet: "E drejta e pronësisë është marrëdhënie ekonomiko-shoqërore, e shndërruar në marrëdhënie juridike, në të cilën me fuqinë e normës juridike, sendi i caktuar në tërësi i takon subjektit juridik të caktuar". Përveç asaj që u tha më sipër e drejta e pronësisë ka disa karakteristika, siç janë:

- uniteti i së drejtës së pronësisë;
- e drejta lidhur me subjektin e caktuar;
- veprim plotësisht i lirë për të disponuar;
- karakteri pasuror i pronësisë;
- karakteri absolut;
- e drejta e ndjekjes (e drejta e racionit).

1.3. Kufizimet e pronësisë

Në të kaluarën, pronësia (proprietas) ka qenë e pakufizuar dhe është konsideruar si e drejtë hyjnore. Pronari, jo vetëm që ka për pronë tokën, por edhe atë që është mbi dhe nën tokë. Mirëpo, më vonë kemi disa kufizime mbi pronësinë. Këto kufizime kanë për qëllim që pronari të ushtrojë autorizimet e veta në mënyrë të caktuar, duke i respektuar edhe nevojat e të tjerëve që lindin si rezultat i fqinjësisë. Prandaj e drejta e pronësisë edhe pse është e drejtë e karakterit absolut, edhe pse titullari i

së drejtës e posedon, e përdor, e shfrytëzon dhe disponon lirisht me sendin e vet, kjo nuk e liron titullarin - pronarin që sendin ta përdorë dhe të vë në funksion të vetvetes dhe shoqërisë në përgjithësi, për arsye se titullari-pronari sendin duhet ta ushtroj sipas natyrës së sendit dhe sipas parimeve të LPDTS-së.

Në këtë kontekst e drejta e pronësisë pra i nënshtrohet disa kufizimeve të karakterit të përgjithshëm por edhe të atyre që janë të veçanta. Kufizimet e përgjithshme të së drejtës së pronësisë janë se e drejta e pronësisë duhet të realizohet në pajtim me natyrën dhe qëllimin e sendit dhe në pajtim me interesin e përgjithshëm të përcaktuar me ligj. E drejta e pronësisë nuk mund të përdoret në kundërshtim me qëllimin për çka me ligj është pranuar dhe është themeluar ose në kundërshtim me moralin e shoqërisë. Me ushtrimin e të drejtës së pronësisë nuk lejohet që tjetrit t'i shkaktohet dëmi. Me ligj, ndalohet keqpërdorimi i të drejtës së pronësisë por edhe i të drejtave të tjera sendore, nëse përdoren ekskluzivisht ose qartas për t'i shkaktuar dëm personave të tjerë ose pasurive të tyre.

1.4. Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët

Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko - Pronësore, e rregullon edhe bashkëpronësinë nga neni 13 - 17. Me nenin 13 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Me shumë persona kanë të drejtën e bashkëpronësisë në sendin e pandarë kur pjesa e secilit prej tyre është përcaktuar në përpjesëtim me tërësinë (pjesa ideale). Në qoftë se pjesët nuk janë të caktuara supozohet se janë të barabarta. Bashkëpronari ka autorizime të pronarit në pjesën e tij ideale e cila është caktuar si pjesë ideale, pasi sendi realisht nuk është e ndarë ”.

Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, rregullon bashkëpronësinë në kapitullin e pestë nga neni 51-56. Me nenin 51 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. Në qoftë se pronësia në një send u takon disa personave në pjesë të caktuara (alikuote) ata kanë bashkëpronësi në send. 2. Në qoftë se pjesët e bashkëpronarëve janë të pacaktuara, atëherë prezumohet se ato janë të barabarta ”.

1.4.1. Komenti i shkurtër i dispozitave të cituara.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët nuk janë lloj i veçantë i pronësisë por paraqesin një prej formave të pronësisë kur shumë subjekte kanë autorizime pronësore mbi një send. Në të drejtën tonë është e mundur që një send individualisht i caktuar të jetë objekt edhe dy e më tepër personave ashtu që të ketë më shumë subjekte me të drejtë pronësie mbi një send. Kjo mund të paraqitet në formë të bashkëpronësisë dhe pronës së përbashkët. Nga kjo rezulton se bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët janë dy format e pronësisë ku shumë subjekte kanë të drejtën e pronësisë mbi një send. Sendet e bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme. Bazat e fitimit të bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët janë të ngjashme me bazat e fitimit të pronësisë me ndonjë specifik të veçantë.

2. Bashkëpronësia

Pronësia mbi një send mund t'i përkas një personi ose disa personave. Kur pronësia mbi një send u përket dy ose më shumë personave kemi bashkëpronësinë. Andaj, prona që u përket disa bashkëpronarëve quhet bashkëpronësi, ndërsa personat që marrin pjesë në këtë pronësi quhen bashkëpronar. Karakteristikë e bashkëpronësisë është se pjesët e bashkëpronarëve janë të caktuara më parë në mënyrë numerike - alikuote apo në pjesë ideale (1/2) ose në përqindje. Bashkëpronësia paraqitet si në sendet e luajtshme ashtu edhe në sendet e paluajtshmen. Në këto raste sendi në mënyrë reale është i pandashëm. Pjesa juridike e bashkëpronarëve paraqet të drejtën sendore të pavarur dhe ka natyrën juridike të pronësisë. Prandaj edhe te bashkëpronësia zbatohen rregullat e pronësisë.

2.1. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve

Bashkëpronarët duke hyrë në marrëdhënie-juridike me njëri-tjetrin, lidhur me bashkëpronësinë, lindin të drejtat dhe detyrimet në mes të tyre. Kështu me nenin 52 dhe 53 të LPDTS-së, janë përcaktuar të drejtat e bashkëpronarit, ku parashihet se bashkëpronari ka të drejtë, që sendin ta

merr në posedim dhe ta shfrytëzojë në proporcion me pjesën e tij; frutat të cilat i jep sendi ndahen sipas madhësisë së pjesës. Në qoftë se ndarja e frutave nuk është e mundshme, atëherë bashkëpronarët e fitojnë bashkëpronësinë mbi fruta; bashkëpronari mund të disponojë me pjesën e tij në send edhe pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë; në qoftë se objekt i bashkëpronësisë është një paluajtshmëri, atëherë secilit bashkëpronar i takon e drejtë e parablerjes. Në qoftë se disa bashkëpronarë parashtrojnë kërkesën për të drejtën e parablerjes, secilit i takon e drejta e parablerjes sipas pjesës së tij. E drejta e parablerjes ekziston edhe atëherë, kur një gjykatë ka urdhëruar shitjen e pjesës në ankand publik. E drejta e parablerjes nuk ekziston, nëse një bashkëpronar pjesën e tij ua shet trashëgimtarëve të tij; bashkëpronarët e administrojnë së bashku një send, në të cilin ekziston bashkëpronësia; punët e administrimit të rregullt të bashkëpronësisë janë të pavlefshme pa pëlqimin e bashkëpronarëve, pjesët e të cilëve së bashku përbëjnë më shumë se pesëdhjetë (50) % përqind; për punët e administrimit të jashtëzakonshëm, veçanërisht disponimi me sendin dhe ngarkimi i sendit ose emërimi i administratorit, është i nevojshëm pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve; vendimet e miratuara nga bashkëpronarët veprojnë edhe ndaj pasardhësve juridikë të një bashkëpronari.

Prandaj, nga përmbajta e neneve të lartcekura, rezulton se secili bashkëpronar, në përpjesëtim me pjesën e tij përfiton nga të ardhurat e sendit, ku të ardhurat e sendit përfshihet frytet natyrale dhe civile të sendit dhe se bashkëpronari ka të drejtë që sendin ta përdor dhe se kjo e drejtë i takon të gjithë bashkëpronarëve. Ata paraqiten në raport me sendin në tërësi si bashkë posedues. Asnjëri nga bashkë poseduesit nuk mund të ketë posedimin e tërësishëm të sendit, si dhe frutat të cilat i jep sendi ndahen sipas madhësisë së pjesës. Në qoftë se ndarja e frutave nuk është e mundshme, atëherë bashkëpronarët e fitojnë bashkëpronësinë mbi fruta në natyrë apo ato civile.

2.3. Fitimi i bashkëpronësisë

Fitimi i bashkëpronësisë mund të bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe fitimi i pronësisë individuale (një subjekti), pra në bazë të punës juridike (kontratës dhe testamentit), vendimit të organit kompetent dhe në bazë të

ligjit. Pra, bashkëpronësia mund të krijohet në bazë të kontratës së shitblerjes, ndërrimit, dhurimit etj. Edhe këtu vlejnë rregullat si tek fitimi i pronësisë në bazë të kontratës. Për dallim nga fitimi i pronësisë individuale të bashkëpronësia dy e më tepër veta e blejnë një send, p.sh, tre studentë blejnë një veturë në të cilën secili ka pjesën e vet e cila mund të jetë e barabartë ose në proporcion me pjesëmarrjen në blerje.
Fitimi në bazë të vendimit mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët (p.sh gjykata vendos se të dy bashkëshortëve ju takon 1\2 e pasurisë), fitimi në bazë të parashkrimit fitues (p.sh, një person e blen pjesën alikuote duke mos ditur se personi nga i cili e blen atë pjesë nuk ka qenë bashkëpronar dhe nëse kalon koha e nevojshme). Pastaj, kemi edhe krijimin e bashkëpronësisë pa pëlqimin e bashkëpronarëve (communion incident), p .sh, me specification (përpunimi) ose përzierje e sendeve të pronarëve të ndryshëm.
LPDTS, i Kosovës, kur bën fjalë për fitimin dhe humbjen e pronësisë në paluajtshmëri, shprehimisht parasheh se, dispozitat e këtij ligji lidhur me pronësinë në një paluajtshmëri janë të zbatueshme edhe për bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët në një paluajtshmëri. Andaj, me rastin e trajtimit të fitimit të pronësisë dhe humbjes së pronësisë në paluajtshmëri në mënyrë të veçantë do të trajtohet fitimi dhe humbja e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri që është e përbashkët edhe për fitimin e bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët në një paluajtshmëri.

2.4. Shuarja e bashkëpronësisë

Me nenin 16 të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko - Pronësore, është përcaktuar se: ” Bashkëpronari ka të drejtë që në çdo kohë të kërkoj ndarjen e sendit, përveç në kohën me të cilën ndarja do të ishte në dëm të bashkëpronarëve dhe ne qoftë se me ligj nuk është paraparë ndryshe ”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kjo e drejtë nuk parashkruhet. Kontrata është nule ku bashkëpronari heqë dorë nga e drejta e ndarjes. Bashkëpronarët me marrëveshje caktojnë mënyrën e ndarjes, në qoftë se nuk ka marrëveshje, vendos gjykata. Po ashtu gjykata mund të vendos që ndarja të bëhet me shitjen e sendit, në qoftë se ndarja fizike është e pamundur apo vjen deri në zvogëlimin e konsiderueshëm vlerës së sendit.

Ndërsa me nenin 56 të LPDTS-së, është paraparë se shuarja e bashkëpronësisë bëhet përmes njërës nga këto mënyra: ndarjes, marrjes përsipër të sendit nga një bashkëpronar, braktisjes së sendit të luajtshëm, apo kur vendoset në ankand të paluajtshmërive; në qoftë se bashkëpronarët vlerësojnë se tjetërsimi te personi i tretë është i papranueshëm për të gjithë bashkëpronarët, atëherë sendi mund të shitet në ankand publik dhe të ardhurat do të ndahen bashkëpronarëve sipas pjesëve të secilit; në qoftë se shuarja e bashkëpronësisë bëhet përmes ndarjes në natyrë apo kur një apo më shumë bashkëpronarë e fitojnë pronësinë në tërë sendin, atëherë vlera e qarkullimit të sendit duhet të përcaktohet përmes ekspertizës të një eksperti zyrtar, nëse nuk heqin dorë të gjithë bashkëpronarët nga ekspertiza e vlerës; në qoftë se ndërmjet bashkëpronarëve nuk mund të arrihet pajtimi rreth mënyrës së procedurës për zgjidhjen e bashkëpronësisë, atëherë sendi i përbashkët, nëse është i luajtshëm, duhet të tjetërsohet përmes rregullave të shitjes së pasurisë që është peng, ndërsa kur është një paluajtshmëri përmes shitjes në ankand detyrues, ndërsa të ardhurat e krijuara duhet tu ndahen bashkëpronarëve në pajtim me pjesët e tyre. Në qoftë se tentativa për tjetërsimin e pronësisë nuk është e suksesshme, atëherë një bashkëpronarë mund të kërkojë përsëritjen, nëse ai i merr përsipër shpenzimet.

3. Pronësia e Përbashkët

Në të drejtën tonë përveç bashkëpronësisë, ekziston edhe pronësia e përbashkët. Pronësia e përbashkët është e rregulluar me nenin 77 të LPDTS-së, ku parashihet se: “ 1. Nëse disa persona kanë të drejtë pronësie mbi një send në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara, atëherë ata janë pronarë të përbashkët. 2. Pronësia e përbashkët mund të krijohet përmes ligjit ose përmes kontratës. Marrëveshja me të cilën krijohet pronësia e përbashkët mund të lidhet vetëm nëse shprehimisht është e lejuar me ligj. 3. Pronarët e përbashkët disponojnë së bashku me pronësinë dhe përgjigjen së bashku për detyrimet në lidhje me këtë pronësi. 4. Pronarët e përbashkët mund të kërkojnë shitjen e pjesshme të pronësisë së përbashkët, por jo në kohë të papërshtatshme. 5. Dispozitat për bashkëpronësinë do të zbatohet, për pronësinë e përbashkët, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe ”.

Pronësia e përbashkët është e rregulluar edhe me nenin 47 të Ligjit për Familje të Kosovës, me të cilin përcaktohet se: “ 1) Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë; (2) Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve; (3) Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. (4) Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh ”.

Një rregullim i ngjash është edhe me nenin 18 të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko - Pronësore.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se pronësia e përbashkët është institut qendror i të drejtës së pronësisë dhe rrjedhimisht i të drejtës reale që nënkupton të drejtën e pronësisë të disa personave në një send të pandarë, pjesët e të cilëve paraprakisht nuk janë të caktuara, por mund të përcaktohen. Pronësia e përbashkët është e drejtë pronësore e më shumë personave mbi një send, sipas pjesëve që nuk janë të caktuara as realisht, as idealisht, por janë të caktuara. Andaj, kjo formë e pronësisë ekzistoni vetëm në rastet e përcaktuara me ligj.

Te prona e përbashkët, në rastet e përcaktuara me ligj, më shumë persona e kanë të drejtën e pronësisë në një send, ashtu që e drejta e pronësisë u takon të gjithëve atyre së bashku; pronarët e përbashkët administrojnë dhe disponojnë me sendin bashkërisht, me vendim unanim, nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastet konkrete, pronari i përbashkët nuk e ka pjesën e vetë të veçantë. Ai është pronarë i tërë sendit i pakufizuar me të drejtën e pronësisë të pronarëve tjerë të përbashkët, nga kjo arsye edhe nuk mundet të disponoj me asnjë pjesë të pronës së përbashkët pa pëlqimin e pronarëve tjerë të përbashkët; për detyrimet eventuale të sendit të përbashkët pronarët e përbashkët përgjigjen solidarishtë. Sikur te bashkëpronësia, pronari i përbashkët ka të drejtë të kërkoj ndarjen e pronës së përbashkët, e cila edhe bëhet në të njëjtën mënyrë, pronarët e përbashkët disponojnë së bashku me pronësinë dhe përgjigjen së bashku për detyrimet në lidhje me këtë pronësi; pronarët mundë të kërkojnë shitjen e pjesshme të pronësisë së përbashkët ,por jo në kohë të papërshtatshme dhe në dëm të të tjerëve; pronësinë e përbashkët është çdo herë i lidhur me bashkësinë jetësore apo të punës në mes të shumë

personave (bashkëshortët, ekonomitë familjare). Një përjashtim i pronësisë së përbashkët ku nuk nevojitet elementi i bashkësisë është pronësia e përbashkët e trashëgimtareve pas vdekjes së dekujusit në sendet e trashëgimisë.
Duhet theksuar se dispozitat ligjore në fuqi për bashkëpronësinë, përshtatshmërisht zbatohen edhe për pronësinë e përbashkët, përpos rasteve nëse me ligj parashikohet ndryshe.
Pronësia e përbashkët në bazë të ligjit/ligjeve në fuqi mund të paraqitet si:
- Prona e përbashkët e anëtarëve të familjes;
- Pronësia e përbashkët bashkëshortëve; dhe
- Pronësia e përbashkëte bashkëtrashëgimtarëve para ndarjes së trashëgimisë.

3.1. Fitimi i pronësisë

E drejta e pronësisë është kategori kushtetuese, sepse ajo garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, andaj, edhe fitimi i pronësisë në disa raste parashihet në Kushtetutë, por rregull është se baza e fitimit të pronësisë dhe humbja e të drejtës së pronësisë rregullohet me ligj të veçantë. E drejta e pronësisë fitohet në bazë të punës juridike, me trashëgimi në bazë të ligjit dhe në bazë të vendimit të organit shtetëror. Por, Ligji i Pronësisë dhe të Drejtave tjera Sendore të Kosovës, nuk ka nen të veçantë ku parashihen bazat e fitimit të pronësisë por numëron titujt juridik për fitimin e pronësisë, psh. fitimi me marrëveshje juridike (kontrata), fitimi me trashëgimi, fitimi me parashkrim fitues, fitimi me përvetësim (send pa pronar), fitimi me ndërtim, bashkim ose përzierje, fitimi me vendim gjyqësor ose administrativ, si dhe fitimi me ligje të veçanta. Mirëpo, ka ligje që shprehimisht përmendin bazat e fitimit të së drejtës së punësisë, sipas të cilëve e drejta e pronësisë fitohet në bazë të ligjit, në bazë të punës juridike me trashëgimi dhe në bazë të vendimit të organit kompetent.
Pronësia është pushtet faktik dhe juridik mbi sendin. Të fitosh pronësisë do të thotë të kesh fakte juridike të cilat i njeh e drejta objektive, si bazë e këtij pushteti juridik të pronësisë. Pronësia mund të fitohet në dy mënyra që janë të njohura që nga e drejta romake dhe ato janë: mënyra origjinare dhe mënyra derivative.

Fitimi derivativ i pronësisë ekziston atëherë kur personi të drejtën e vetë të pronësisë e nxjerrë nga e drejta e paraardhësit të tij. Ndërsa fitimi origjiner i pronësisë ekziston atëherë kur pronari të drejtën e vetë pronësore nuk e nxjerrë nga e drejta e paraardhësit por nga faktet e tjera juridike, respektivisht nga titujt juridik të cilat të drejtën e konsideron tituj juridik për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere.
Pra, e drejta e pronësisë mund të fitohet në sendet në të cilat ekziston një titullar paraprak i pronësisë dhe e drejta kalon nga një subjekt në tjetrin dhe rasti i dytë është kur pronësia fitohet në sendin në të cilin askush nuk e ka pasur të drejtën e pronësisë, respektivisht ekziston ndërprerja e kontinuitetit gjegjësisht, pronarit dhe pronarit të ri. Krijimi i sendit të ri është titull juridik për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere, respektivisht fitimi i të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues, është gjithashtu, titull juridik për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere.
Për fitimin e pronësisë kërkohet që të plotësohen disa kushte të përgjithshme ku bënë pjesë aftësia e sendit që të jetë objekt pronësie, zotësia e fituesit për të qenë pronar mbi atë send dhe titulli juridik për fitimi i pronësisë. Kështu, subjektet të së drejtës së pronësisë janë personat fizik dhe personat juridik. Prandaj, bartës i të drejtës së pronësisë mund të jetë si personi fizik ashtu edhe personi juridik. LPDTS i Kosovës, parasheh, se çdo person mund të fitojë të drejtën sendore përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. Titullar të të drejtave të pronësisë në Kosovë, mund të jenë personat fizik, personat juridik privat ose publik, por edhe Republika e Kosovës si dhe Komunat. Me LPDTS të Kosovës, nuk parashihet shprehimisht për Komunën si titullar i paluajtshmerisë por, këtë e gjejmë më ligje tjera të veçanta.

4. Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë

4.1. Shqyrtime të përgjithshme

Meqenëse kemi të bëjmë me një të drejtë absolute sikurse e kemi cekur edhe më lart dhe një e drejtë e cila vlen (erga omnes), apo ndaj çdo presoni tjetër, atëherë duhet të parashihet edhe mekanizmi i cili do të veproj ose i cili duhet të zbatohet në rast të shkeljes së kësaj të drejta. Pra, mekanizmi

i cili do të vije në shprehjen në atë moment nëse kjo e drejt i shkelet pronarit në fjalë.

Prona si e drejtë subjektive absolute civile dhe një nga të drejtat themelore të të drejtave të njeriut është e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës gjegjësisht me nenin Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] ku është theksuar se "E drejta e pronës është e garantuar" dhe në paragrafin 3 të këtij nenin është paraparë "Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet". Pronësia mbrohet edhe me instrumentet ndërkombëtarë dhe atë përmes Konventës Evropiane për lirit dhe të drejtat themelore të njeriut, ku në Protokollin 1 të saj është e paraparë se "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera".

Mbrojta e pronës është kategori kushtetuese dhe e mbrojtur me mekanizmat ndërkombëtar sikurse është cekur më herët, ajo është e mbrojtur edhe me dispozitat ligjore dhe atë me dispozitat e nenit 93 të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore ku është paraparë se "Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi". Dispozita të ngjashme ka pasur edhe ligji i vjetër dhe atë Ligji mbi marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, ku në nenin 37 kishte paraparë se "Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale".

Andaj, karakteristike për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë është fakti se ajo nuk parashkruat asnjëherë dhe mbrojtja e saj mund të kërkohen çdo herë. Në kuptim të të drejtave civile juridike e drejta e pronësisë dhe mbrojtja e saj është e drejta absolute me të gjitha karakteristikat e të

drejtave civile absolute (veprimi erga omnes, mos parashkrimi i tyre, detyrimi negativ etj.), mirëpo në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe kuptimit sipas Kushtetutës dhe Lirive dhe të Drejtave të Njeriut kjo e drejt nuk është e barasvlershme sikurse e drejta e për jetë e cila është absolute dhe në çdo aspekt. Kjo është thënë për faktin se mbrojtja e pronës, mund të kufizohet kur është nevoja për shkak të interesit publik, kuptohet kur një gjë e tillë është e paraparë me ligj dhe me kompensim adekuat. Me vet faktin se kemi përjashtime në këtë kuptim atëherë kuptojmë se në këtë aspekt nuk është e drejta absolute. Ekzistimi i të drejtës së pronësisë, pa ekzistim të mekanizmave mbrojtëse e bënë in ekzistente një të drejte të tillë, pasi që do të vinte deri tek pasiguria absolutet juridike dhe se pronari në momentin e cenimit të së drejtës së tij pronësore kishte mbetur pa asnjë rrugëdalje në kuptim juridik.

Pra, e drejta e mbrojtjes së të drejtës pronësore gjithmonë realizohet përmes gjykatës dhe se vet mbrojtja apo marr e vetëgjyqësisë është e ndaluar. Sistemin e mbrojtjes së të drejtës së pronësisë është i paraparë në të gjitha sisteme juridike, që nga e drejta romake e deri në aktet më të reja juridike. E drejta romake në sistemin e vet juridik i ka paraparë disa llojet e padive për mbrojtjen e të drejtave pronësore apo të drejtave reale në përgjithësi. Mbrojtja e të drejtave pronësore është paraparë dhe në Kodin Civil Françez, Kodin e Përgjithshëm Austriak, Kodin Civil Italian, Kodin Civil Gjerman etj. Pra sikurse është cekur edhe më herët, mund të konkludojmë faktin se sa është i vjetër koncepti i së drejtës së pronësisë aq është i vjetër edhe koncepti i mbrojtjes së të drejtës së pronësisë, apo thënë ndryshe njëri pa tjetrin nuk mund të ekzistojnë në praktiken juridiko civile.

4.2. Padit për mbrojtje gjyqësore

Sistemet e ndryshme juridike në botë parashohin mekanizmat të ndryshëm të mbrojtës së të drejtës së pronësisë. Llojet e ndryshime të padive të cilat pronari mund të parashtroj pasi që të cenohet e drejta e pronës, janë të parapara varësisht nga sistemi të cilën e ndjek dhe rregullativës ligjore të një shteti. Ligjvënësi për të ofruar mbrojtje ligjore pronarit fillimisht duhet të konstatohet se cilat janë shkeljet potenciale apo

shkeljet më të shpeshta të së drejtës së pronësisë dhe konform kësaj të caktoj mekanizmat sa më efikase për mbrojtjen e kësaj të drejte.
Në bazë të teorisë shkeljet më të shpeshta të së drejtës së pronësisë, të cilat mund ti bëjë personi i tretë pronarit janë: 1. Kur sendi mirët nga pronari – këtu kemi të bëjmë me shkeljen e tërësishme, dhe; 2. Pengimi i shfrytëzimit apo shqetësimin e të së drejtë pronësore apo në realizimin e kësaj të drejte e që në rastin konkret kemi shkelje të pjesshme të kësaj të drejte pasi që e drejta e pronësisë mbetet nën shfrytëzim të pronarit. Duke i shikuar këto dy shkelje të cilat u përmenden, pronari për mbrojtjen e të drejtës së tij mund të parashtroj pranë gjykatës padi pronësore. Paditët e sipër cekur por edhe në raste tjera, termin padi i cili vjen nga fjala latine "actio" e cila rrjedh nga folja "agere", që do të thotë veproj.
Pra, padia është një institut procedural, është një e drejt për të vepruar. Padia është mjetë juridik për mbrojtjen e së drejtës subjektive dhe si e tillë nuk duhet ngatërruar me vet të drejtën subjektive. Padia është garanci ligjore për mbrojtjen e të drejtës subjektive. E drejta e padisë në kuptim materiale është një e drejtë që i jepet mbajtësit të së drejtës subjektive, në këtë rast të drejtës subjektive absolute, të drejtën pronësore, që në rast të cenimit ose mohimi të kësaj të drejte, ta rivendosë atë duke iu drejtuar gjykatës.
Përveç të cekurave duhet theksuar edhe fakti se në raste të cenimit të së drejtës së pronësisë është e ndaluar vetëveprimi apo vetëgjyqësi, pasi që një veprim i tillë mund të konsiderohet i kundërligjshëm, në përjashtim kur vet ndihma është paraqitur si nevojë permanente, nga rreziku i atëçastshëm dhe nëse veprimi i tij është i përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtës së tij pa shkaktuar dëm. Pra pronari mund të kërkoj mbrojtje nga organi kompetent sipas ligjit në një gjykatë.
Për mbrojtjen e së drejtës se pronësisë dallojmë këto lloj të padive:

- Padia Actio rei vindikatio;
- Actio publiciana; dhe
- Actio negatoria

Paditë e theksuara më lartë kanë për qëllim të mbrojnë të drejtën subjektive, të drejtën e pronësisë, si të drejtë absolute e cila vlen apo e shtrin veprimin erga omnes, ndaj çdo personi të tretë, me të cilën pronari

i një të drejte të tillë nuk ka asnjë obligim po nuk është në ndonjë marrëdhënie detyrimore juridike.
Emërtimi përbashkët i padive të përmendura është paditë petitore. Përmes padisë, paditësi - pronari i të drejtës subjektive kërkon mbrojtje gjyqësore për të drejtën e cila i është shkelur. Në padi theksohet saktësisht masat e mbrojtjes së kërkuar, nga kush dhe prej kujt kërkohet mbrojtja dhe mbrojtja e afruar në çka konsiston.
Sipas ligjit për procedurën kontestimore kërkesëpadia duhet të jetë e precizuar mire, e që në kuptim të padive të theksuara si më lart, duhet të përmbaj përshkrimin e saktë psh., nëse kërkohet mbrojta e ndonjë të drejte që lidhet me paluajsthmëri atëherë ajo paluajtshmëri duhet të jetë saktësisht e përshkruar, duke përfshirë numrin e saj me të cilën është i regjistruar në kadastër, zona kadastrale ku gjendet ajo, sipërfaqja e saj, qëllim i përdorimit, etj, ndërsa nëse bëhet fjalë për ndonjë send të luajtshëm atëherë përshkrimi duhet të përbëj përshkrimin të cilin atë send e dallon nga sende tjera, për ndryshe në mungesë të përshkrimit të saktë këtë kërkesëpadi e bënë jo precize, jo të plot dhe sipas saj nuk mund të zhvillohet procedura dhe nuk mund të vendoset.

4.2.1. Padia Activo rei vindikatio

Kjo padi është e paraparë edhe me Ligjin për pronësisë dhe të drejta tjera sendore dhe atë në nenin 93 ku është paraparë se “Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”. Po ashtu, kjo padi ishte e paraparë edhe me ligjin e vjetër i cili ishte në fuqi para se të hy në fuqi LPDTS, dhe atë Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, ku në nenin 37 kishte paraparë se “Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale”. Në kuptim të dispozitave të cituara rrjedhë se pronari e ka të drejtën e mbrojtjes së pronësisë përmes padisë së Reivindikimit (Actio Reivindicatio). Padia e Reivindikimit është padi e pronarit jo posedues kundër poseduesit jo pronar, me të cilën kërkohet kthimi i sendit nga poseduesi jo pronar te pronari jo posedues.
Sipas nenit 18 të LPDTS-së, pronësia është pushteti i tërësishëm i pronarit të sendit mbi një send të caktuar përfshirë edhe të drejtën e tij që ta posedojë sendin, dhe në çdo rast kur pronarit i cenohet pushteti faktik mbi

sendin, ai ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore për të drejtën e tij subjektive. E drejta e tij subjektive me rastin e cenimit të posedimit rrjedhë nga e drejta objektive e normuar me nenin 93 të LPDTS-së. Çështje me rëndësi në procedurën e mbrojtjes gjyqësore sipas padisë së Reivindikimit është që të konstatohet se mbrojtja kërkohet sipas autorizimit të pronarit. Në këtë kontekst është e domosdoshme që gjatë procedurës pronësia e subjektit që kërkon mbrojtje gjyqësore të provohet si fakt. Tek padia e Reivindikimit paditësi ka për obligim që gjykatës t'i prezantojë dëshmitë e vlefshme, si certifikatën e pronës e lëshuar nga organi përkatës kompetent sipas librave për regjistrimin e të drejtave në patundshmëri, dhe rrjedhimisht gjykata ka për detyrë që në shqyrtimin kryesor të konstatoj faktin nëse paditësi është pronar. Për shembull në qoftë se do të paraqitej padia me dy kërkesa kryesore, vërtetimi i së drejtës së pronësisë dhe dorëzimi i sendit, nën supozimin se paditësi është i konfirmuar me dokument publik si pronar, atëherë kërkesa për vërtetimin e pronësisë do të hedhet si e palejuar në mungesë të interesit juridik. Pronësia si pushtet i tërësishëm mbi sendin e caktuar i jep të drejtë gjithmonë pronarit të sendit që ta kërkojë sendin prej së cilit që nuk e ka të drejtën e posedimit. Kjo padi e cila mund të ushtrohet për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë nuk parashkruhet dhe ajo mund të parashtrohet në çdo kohë nga ana e pronarit kur zhvishet nga pushteti faktit i sendit të tij.

Padia rivendikimit është një padi e veçantë, e cila parashtrohet vetëm nga pronari dhe vetëm për kërkimin e sendeve individualisht të përcaktuara dhe jo një padi universal sikurse mund të jetë padia për kërkimin e trashëgimisë:

Nga pikëpamja e të drejtës materiale juridike, padia e rivendikimit është padi pronësore, pasi që për objekt dhe qëllim ka mbrojtjen e së drejtës subjektive të pronësisë.

Kjo padi nisur nga e drejta themelore që ajo mbron është padi reale pasi ka për objekt drejtpërdrejt sendin, për nga natyra e mbrojtjes së pronësisë, kjo padi ka karakter represiv, për shkak se aplikohet atëherë kur ka ardhur deri te cenimi i të drejtës së pronësisë, pra me këtë padi pronari synon të kthej sendin e tij në posedim pasi që është privuar nga posedimi, pra është një padi transferueshme, jo "ex novo", pasi që si e tillë mund të transferohet nga pronari i tanishëm në pronarin e mëvonshëm, është padi njohje pasi në fakt sipas rregullimit të përgjithshëm të gjitha vendime për

nga objekti që ato kanë, janë vendime deklarative të një të drejte reale, sepse të gjitha vendime gjyqësore civile të cilat zgjidhin një mosmarrëveshje juridike civile përmbajnë një deklarim të së drejtës, kjo gjithmonë nëse padia është bazuar në ligj (padi njohje pozitivi apo negative), është padi krijuese pasi që në përfundim të gjykimit krijohet një situate e re krijuese për paditësit të cilin e kishte ngritur, pasi që nga pronari jo posedues bëhet pronari poseduese (nëse padia aprovohet). Kjo padi ka karakter detyrimi, e cila konsiston në faktin se i detyron personat të cilat e kanë cenuar të drejtën e pronësisë së paditësit, në ndalimin e cenimit përkatësisht në kthimin e sendit.

Në praktikën gjyqësore si kundërshtim i poseduesit jo pronar kundër pronarit jo poseduesi të paraqitur sipas padisë mund të jetë fitimi i të drejtës së pronësisë sipas parashkrimit fitues. Pra në raste të tilla mund të ndodhë që edhe për kundër faktit se dorëzimi i sendit kërkohet sipas autorizimit të pronarit, gjykata të vendosë për refuzimin e kërkesëpadisë, për shkak se në procedurën e njëjtë gjykata duke vendosur sipas kundërpadisë e ka gjetur si të themeltë kërkesën e të padituri - kundër paditësit si posedues i sendit me mirëbesim dhe rrjedhimisht si pronar me parashkrim fitues.

Çështje që është e diskutueshme në praktikën gjyqësore i referohet pyetjes nëse ka parashkrim humbës për pronarin jo posedues me kalimin e afatit prej 20 vitesh, nën supozimin që i padituri gjatë procedurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit - pronarit për shkak të parashkrimit humbës, por pa e paraqitur i padituri një kundërpadi për vërtetimin e pronësisë për parashkrimin fitues. Duket se praktika gjyqësore përkrah idenë që e drejta e pronarit mbi sendin e caktuar do të pushojë vetëm në rastin kur konfirmohet në procedurë përkatëse se e drejta e pronësisë mbi sendin e caktuar i takon subjektit tjetër. Nga kjo rrjedhë se edhe në qoftë se kemi një posedues me mirëbesim përkundër faktit se posedimi i tij i plotëson konditat që në procedurë kontestimore gjykata me vendim gjyqësor t'i njohë të drejtën e pronësisë, nëse i njëjti nuk ka paraqitur padi, ose kundërpadi kur ai është i paditur, gjykata potencialisht do ta konfirmojë në çdo rast dhe në çdo kohë të drejtën e pronarit për ta poseduar sendin. Mund të konkludohet se kundërshtimi materialo-juridik i parashkrimit humbës, i paraqitur nga i padituri (poseduesi me mirëbesim), do të ketë efekt vetëm nëse paraqitet së bashku

me kërkesën e poseduesit me mirëbesim për vërtetimin e të drejtës së pronësisë. Ky koncept gjen mbështetje në normat materialo-juridike të cilat të drejtën e pronësisë e kualifikojnë në të drejtat absolute të cilat nuk parashkruhen.

Në procedurën gjyqësore sipas padisë së Reivindikimit kur gjykata nxjerrë aktgjykim për dorëzimin e sendit tek pronari, aktgjykimi ka një specifikë, sepse efekti i aktgjykimit do të shtrihet edhe ndaj subjekteve që nuk kanë qenë palë në procedurë. Lidhur me efektin e aktgjykimit në pikëpamje subjektive, ligji përkitazi me kufijtë subjektiv nuk përmban rregulla të shprehura, megjithatë praktika gjyqësore dhe shkenca juridike pranojnë parimin e vjetër, se aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndaj palëve ndërgjyqëse (res judicata, ius facit interpartes). Kufizimi i efektit vetëm ndaj palëve është pasojë e parimit të shqyrtueshmërisë, sepse rezultati i gjykimit varet para së gjithash nga materiali procedural të cilin gjykata zakonisht e mbledhë nga palët. Personat e tretë nuk kanë ndikim në procesin gjyqësor, andaj nuk do të ishte e drejtë që vendimi edhe për ta të jetë i pakontestuar.

Përveç kësaj, është legjitimiteti real i palëve (aktiv dhe pasiv), që përcakton se kush është subjekti që ka të drejtë, dhe kush është subjekti që ka detyrim, megjithatë në rastin e mbrojtjes gjyqësore sipas padisë së Reivindikimit efekti i aktgjykimit të formës së prerë i zgjeron kufijtë subjektiv edhe ndaj disa subjekteve që nuk kanë qenë palë në procedurë. Është tipike situata që efekti i aktgjykimit të shtrihet edhe ndaj p.sh familjarëve të të paditurit i cili është detyruar që sendin e paluajtshëm t'ia dorëzojë pronarit. Nëse X-personi (që është bashkëshort dhe baba), ka qenë palë në procedurë si i paditur, dhe është urdhëruar ta dorëzojë sendin e caktuar, atëherë me rastin e zbatimit të aktgjykimit, aktgjykimi vlen edhe për bashkëshorten e të paditurit dhe fëmijët e tij.

Për nevojat e praktikës gjyqësore theksohet fakti, se edhe përkundër asaj se aktgjykimi e shtrin efektin edhe ndaj disa subjekteve që nuk janë palë në procedurë, kjo nuk nënkupton se çështja është e gjykuar për subjektet që nuk kanë qenë palë në procedure, pra, të njëjtit mund ta iniciojnë një proces gjyqësor ndaj pronarit.

Në procedurën sipas padisë së Reivindikimit shpeshherë në praktikën gjyqësore nga poseduesit e sendit paraqiten kundërshtime të natyrave të ndryshme, si mbrojtje nga padia, është i shpeshtë rasti kur të paditurit e

kundërshtojnë dorëzimin e sendit të caktuar-objekt kontesti, duke pretenduar se në sendin e poseduar kanë bërë investime dhe e kanë rritur vlerën e sendit, madje duke theksuar se u takon e drejta e posedimit apo parablerjes për shkak të investimeve.

Në praktikën gjyqësore kundërshtimet e të padituri në raport me pronarin do të kenë rëndësi dhe ndikim në rastin e vendosjes vetëm kur i padituri e pretendon të drejtën e pronësisë sipas parashkrimit fitues, dhe e provon para gjykatës se plotësohen të gjitha kushtet që gjykata t'ia njohë të drejtën e pronësisë. Në të kundërtën çfarë do pretendimi kundërshtues i të padituri, përfshirë edhe pretendimet për investimet janë irelevante në përcaktimin e mënyrës së vendosjes në raport me pronarin.

Pronari si paditës në procedurën e mbrojtjes gjyqësore për kthimin e sendit në posedim (reivendikimi), ka mundësi që të parashtrojë përveç kërkesë për dorëzimin e sendit edhe kërkesën për kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e posedimit nga ana e të padituri. Dëmi mund të jetë real, fitim i munguar apo pasurim pa bazë. Në qoftë se së bashku me kërkesën për kthimin e sendit është paraqitur edhe kërkesa për kompensimin e dëmit, atëherë në procedurën e të provuarit gjykata nuk kufizohet vetëm në konstatimin e rrethanave përkitazi me pronësinë e paditësit, por zgjerohet edhe në konstatimin e fakteve për të provuar lartësinë e dëmit.

Për nevojat e praktikës gjyqësore në qoftë se paraqitet së bashku kërkesa për kthimin e sendit dhe kompensimin e dëmit, atëherë gjykata ka mundësi të marrë edhe aktgjykim të pjesshëm në momentin që konstaton faktin se dorëzimi i sendit kërkohet sipas autorizimit të pronarit, dhe në këtë mënyrë pasi janë plotësuar kushtet për të vendosur për një pjesë të kërkesëpadisë, kurse për pjesën tjetër përkitazi me dëmin gjykata do të vendosë pastaj me aktgjykim për shkak se procedura për kompensimin e dëmit mund të zgjasë për shkak të vëllimit të materialit procedural (faktik dhe provues). Përveç procedurës kontestimore për dorëzimin e sendit sipas padisë së Reivindikimit, kërkesa e pronarit për dorëzimin e sendit në disa raste konsumohet në një procedurë tjetër. Në qoftë se i padituri e posedon sendin e pronarit në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që veprimet e tij konsumojnë ndonjërin nga veprat penale, atëherë është e mundshme që në procedurën penale të vendoset edhe për kërkesën

pasurore-juridike të palës së dëmtuar, e që në këtë rast është dorëzimi i sendit.

Pra, gjykata në procedurë penale nëse të akuzuarin e shpallë fajtor për ndonjë vepër penale që lidhet me mënyrën se si ai e posedon sendin e huaj, atëherë në procedurën e njëjtë mund të urdhërohet që ta dorëzojë sendin tek pala e dëmtuar. Për nevojat e praktikës gjyqësore duhet theksuar se urdhri që i akuzuari ta dorëzojë sendin e caktuar tek pala e dëmtuar, nuk përfaqëson çështje të gjykuar për të akuzuarin për çfarë do kërkesë që mund të ketë ai në të ardhmen të drejtuar ndaj pronarit të sendit. Paditësi, i cili e ka kthyer sendin në posedim, ia njeh shpenzimet që ia ka bërë poseduesi i padituri, lidhur me sendin që është objekt i kontestit të fituar me këtë padi. Poseduesit me mirëbesim i pranohen shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme që ia ka bërë lidhur me sendin deri sa ka qen posedues i sendit mbi të cilin nuk e kishte pasur të drejtën e pronësisë, ndërsa poseduesit me keq besim i pranohen vetëm ato shpenzimet të cilat ishin të nevojshme për mbajtjen e sendit.

4.2.2. Padia Actio publiciana

Kjo padi është padi për kthimin e sendit të cilit e paraqet poseduesi uzukaptien i mëparshëm kundër poseduesit aktual. Pra, kjo padi paraqitet nga poseduesi i kualifikuar kundër poseduesit pa bazë juridike apo me bazë më të dobët juridike. Tek kjo padi zbatohet e drejta e titullimit më të fortë. Këtë padi mund ta parashtroj në çdo kohë, personi i cili ka fituar sendin e caktuar në mënyrë individuale sipas bazës juridike dhe në mënyrë të ligjshme dhe nuk ka ditur apo nuk mund ta dinte se nuk është pronar i sendit, ka të drejtët të kërkoj kthimin sendit edhe nga mbajtësi me mirëbesim te i cili gjendet sendi pa bazë juridike apo me bazë më të dobët. Dallimi i kësaj padie me padinë rivendikimit e shtjelluar më herët është se tek padia e parë kërkohet gjithmonë e drejta e pronësisë mbi një send të caktuar, ndërsa tek kjo padi kjo nuk kërkohet, pasi që paditësi thirret në posedimin e tij të mjaftueshëm për parashkrim fitues. I padituri mund të jetë çdo person i cili e posedon sendin e paditësit i cili vetën e trajton si pronar. Po ashtu i padituri mund të kundërshtoj padinë e paditësit me pretendime se vet është pronar i sendit apo se janë përmbushur kushte për fitimin e të drejtës së pronësisë apo se i njëjti posedon bazën më të fort

juridike për posedimin e tij nga vet paditësi. Nëse të dytë, pra paditësi dhe i padituri janë posedues të kualifikuar, titulli më i fort nxjerr duke gjetur së pari paraardhësin e padyshimta. Nëse të dytë e kanë të njëjti atëherë titull më të fort ka ai që e kishte paguar sendin. Nëse edhe kjo është e pabarabartë përparësi ka ai që e posedon sendin në momentin e marrjes së vendimit.

4.2.3. Padia Actio Negatorio

Kjo padi është padi pronësore apo padi për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, sikurse edhe dy padi të cekura më herët. Sikurse kemi thënë më lart shkelja e të drejtës së pronësisë mund të ndodh me marrjen e sendi (shkelje e tërësishme), por ajo mund të cenohet edhe me shqetësimin gjatë shfrytëzimit (cenim i pjesërishëm). Pra, sendi mbi të cilin pronari ka të drejtën e pronësisë mbetet në posedim të tij, por që i njëjti shqetësohet nga persona të ndryshëm apo persona të tretë.

Në rastin kur pronari i së drejtës së pronësisë, pengohet apo shqetësohet në shfrytëzim të së drejtës së ai, ai ka të drejtë të bëjë padinë negatore për mbrojtjen e të drejtës së tij. Këtë padi mund ta bëjë vetëm pronari i së drejtës së pronësisë dhe askush tjetër. Të njëjtën padi nuk mund të bëjë shfrytëzuesi i së drejtës së pronësisë i cili këtë të drejtë e shfrytëzon sipas ndonjë marrëveshje juridiko civile me pronarin, p.sh., qiramarrësi. Kjo padi prejardhjen e tij e ka nga drejta Romake. Në këtë të drejtë kjo padi ishte mjet me anë të së cilës pronari kërkonte deklarimin e in ekzistencës së të drejtës reale të servitutit të afirmuara nga ana e personave të tretë në sendin e tij. Në praktikën gjyqësore, kjo padi mund të parashtrohet nga pronari/paditësi, kundër të padiurit/personit të tretë, në të gjitha rastet kur i padituri kërkon ushtrimin e ndonjë të drejte tek e drejta e pronësisë së pronarit. Sipas doktrinës dhe jurisprudencës qëllimi dhe funksioni kryesor i padisë mohuese konsiston në: - vërtetimin e in ekzistencës së të drejtave të të tjerëve mbi sendin; e drejta për të ndaluar cenimet apo shqetësimet e mëtejshëm që pengojnë pronarin në gëzimin e qetë të sendit; kërkimin e shpërblimit të dëmit në rast se nga cenimi i është shkaktuar dëmi material i pronës së paditësit; kthimi në gjendjen e mëparshme.

Nga pikëpamja e së drejtës materiale, padia mohuese është një padie pronësore, pasi që për objekt dhe qëllim e ka mbrojtjen e saj. Padia

mohuese, nisur nga e drejta themelore që ajo mbron bënë pjesë në padi reale, pasi ka për objekt drejtpërsëdrejti sendin edhe pse drejtohet kundër cenuesit të sendit.

Për nga natyra juridike e mbrojtjes së pronësisë, padia mohuese ka karakter represive, pasi që ajo aplikohet pasi që të cenohet e drejta e pronësisë. Kjo padi në thelb është padi njohje, njohje pozitive (paditësi duhet të provoj që është pronar), njohje negative (duhet të provoj se i padituri kishte cenuar të drejtën e tij), ka karakter detyrimi, pasi që obligohen të padituri potencial të ndërprenë cenimin e tyre. Pra dallimi i padisë mohuese nga ajo e rivendikimit, qëndron në atë se tek e para paditësi apo pronari është në posedim të pronës së tij dhe vetëm shqetësohet nga presona të tjerë, ndërsa te padia e dytë pronari tash më kishte mbetur pa posedimin e të drejtës së tij pronësore. Kundërshtimi i të padituri apo i personit i cili e ka bërë cenimin e të drejtës së pronësisë, mund të jetë se ai këtë cenim apo shqetësim e bënë sipas një të drejte të fituar në sendin e pronarit, si p.sh. të drejtën e servitutit.

5. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë se vendimeve të instancave më të ulëta në kontestet që kanë të bëjnë vërtetimin e pronësisë në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk kanë ekzistuar kushtet për ndryshimin e aktgjykimeve të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Në disa raste aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak te të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në

provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me ato prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e atyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë/pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata Supremë e Kosovës në praktikën e saj gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta haset edhe në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që ka të bëjë me nenin 182 paragrafi 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se padia dhe parashtresa nuk përmban elemente që duhet ti përmbajë çdo parashtresë, në fakt kërkesa në padi është e paqartë dhe e pakuptueshme dhe sepse nuk është specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësi në rastin konkret. Andaj në këto rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit/eve që padinë ta kthejë në plotësim/korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur më nenin 2 paragrafi 1 të LPK-së.

Në disa raste gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht ose në tërësi të bazuara/pabazuar.

Në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilema dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe përveç tjerash edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për vërtetimin e pronësisë, gjatë procedurë nuk kanë vërtetuar në tërësi gjendjen faktike.

Ka raste kur gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, më provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike ngase nuk e ka bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale-kontestuese, në të cilën paditësi/t ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë në palujshmërinë kontestuese, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi/t, të identifikoj saktësisht se cila është parcela kadastrale apo pjesa e saj gjeografike të saj, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e palujshmërisë kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë kadastrale, eksperiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, për shkak se nuk ka përshkrim për pronën kontestues, nuk ka të dhëna të sakta për parcelën kadastrale, çfarë kulture është, cila është gjendja gjeografike e saj, me cilat parcela fqinje kufizohet, nuk është kërkohet historiati i pronës kontestuese, etj.
Po ashtu gjykatat e instancave me të ulëta nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve në procedurë gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat të këtyre, kanë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

6. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

Aktvendimi Rev.49/23 datës 27.02.2023.
Arsyetimi
Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.
Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të dhe i njëjti është në kundërshtim me

nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së është i bazuar, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata nuk iu ka referuar dispozitave materiale - juridike të cilat nuk i ka cituar as si përmbajtje, e nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Përveç të cekurave nëse i referohemi dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, I njëjti është kontradiktor në vetvete në mënyrën si është formuluar, dhe nga i njëjti nuk mund të kuptohet se çka realisht gjykata ka vendosur, a e ka refuzuar kërkesëpadinë dhe nëse po çka ka refuzuar.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia e datës

21.12.2015 dhe precizimi i padisë si në parashtresën e datës 25.09.2018, nuk
përmban elementet që duhet ti përmbajë çdo parashtresë, në fakt kërkesa në padi është e paqartë
dhe e pakuptueshme dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësi në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit është dashur që padinë e paditësit ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.
Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për faktin se e njëjta nuk ka arritur të japë arsye lidhur me faktet vendimtare mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë dhe atë: Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale - kontestuese, në të cilën paditësi ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikoje saktësisht se cila është parcela kadastrale apo pjesa e saj, në të cilën paditësi ka pretenduar se ka të drejtën e tije më saktësisht si në kërkesën në padi dhe lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur më atë parcelë kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe tëligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari I çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezulton se nuk ka përshkrim të pronës, nuk ka të dhëna të sakta për parcelën kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela kontestuese apo pjesa e saj, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka detajisht - duke përshkruar pjesën e saj sipas kulturave në vend, cila është shtrirja gjeografike e saj, me cilat parcela fqinje kufizohet, nuk ka kërkuar historiatin e pronës, nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës në kuptim të

dispozitave të LPK-së, nuk ka marr në shikim shkresat e lëndës sipas kontestit C.nr.----/04, dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj.

Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë para se të vendos për kërkesëpadinë e paditësit është dashur ti administroj provat dhe ti marr në shikim shkresat e lëndës të cekura më lartë, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes e pastaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët, të udhëzoj ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtëshmërisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit - raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në K., të kërkohet historiati i pronës për paluajtshmërinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, të marrë në shikim shkresat e lëndës: C.nr.----/04, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të

ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi Rev.355/22 datës 12.12.2022.

Arsyetimi

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), e lidhur me nenin 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë përfshirë edhe me zbatim të gabuar të se drejtës materiale, për arsye se: nëse i referohemi nenit 26, 28, 31, 46 paragrafi 1 dhe 2, 47, 51 paragrafi 1, 2 dhe 3, 52, 53, 60, 61, 67, 70, 103, 110, 111, 112, 117, 139, 142, dhe 148 të LMD-së, rezulton se për të kërkuar anulimin e kontratave duhet të plotësohen disa kushte dhe atë: të cenohet interesi i përgjithshëm apo interesi individual dhe varësisht a cenohet interesi i përgjithshëm apo interesi individual kemi të bëj me pavlefshmëri absolute apo pavlefshmëri relative të kontratave. Pavlefshmëri absolute të kontratave kemi në të gjitha ato raste kur kontratat janë lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, janë lidhur në kundërshtim me normat e moralit dhe janë lidhur në kundërshtim me normat e dokeve të mira afariste siç përcaktohet në nenin 103 të LMD-së, ndërsa me pavlefshmëri relative të kontratave kemi të bëjmë në të gjitha ato raste kur kontratat janë lidhur nga personi i mitur me aftësi të kufizuar punuese, pa lejen e prindërit apo kujdestarit, kur kontrata lidhet me kërcenim, kur kontrata lidhet me lajthim esencial, kur kontrata lidhet me mashtrim dhe kur kontrata lidhet në mënyre fiktive, siç përcaktohet me nenin 56, 60, 61, 65 dhe 66 të LMD-së.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se gjykata e shkalles së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejt dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj faktet me rëndësi për të vendosur sipas padisë së paditësve, për arsye se: nëse i referohemi pretendimeve të palëve dhe

shkresave të lëndës rezulton se të paditurit ----, ------, ---- -----dhe --------, kanë lidhur aneks kontratë për ndryshimin dhe plotësimin e kontratës kryesore mbi shitblerjen e banesës ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në shikim shkresat e lëndës sipas kontratës e cila është objekt kontesti e as kontratave tjera dhe atë: shkresat e lëndës Vr.nr. ----, Vr.nr. ------, Vr.nr.------, Vr.nr. ------, Vr.nr.------, Vr.nr. ------, Vr.nr.-----, Vr.nr. ----, Vr.nr. ----- C.nr.-----, e provat e administruara si provë nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë në kopje, gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të objektit të kontestit - banesës kontestuese, në të cilat pala paditëse ka pretenduar se është pronë e saj, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikojë saktësisht se cila është banesa - objekt kontesti, në të cilën ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë, më saktësisht si në kërkesëpadi lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj/tyre, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë/ve kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë/a kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend(sepse siç ka konstatuar banesa ka qenë e mbyllur), nuk ka kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezulton se nuk ka përshkrim të pronës, nuk ka të dhëna të sakta për banesën/at kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është banesa/t kontestuese apo pjesa e saj/tyre, cila është shtrirja gjeografike e saj/tyre, në momentin e shikimit në vend kush i ka në posedim-shfrytëzim, nuk ka kërkuar historiatin e pronës, nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, nuk janë dëgjuar palët në cilësi të palës, për të sqaruar rrethanat e lidhjes së aneks kontratës së shitblerjes, nuk është sqaruar fakti se në çfarë bazë këtu të paditurit e në anekse kontratë (në cilësinë e shitësit), kanë bërë ndryshimet e kontratës bazë (kontrata bazë nuk është prezent në shkresat e lëndës dhe e njëjta nuk është administruar si provë), dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë dhe e

dytë, nuk i kanë vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj kanë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, pastaj të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj nëse është e nevojshme së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët rreth paluajtshmërisë kontestuese, të udhëzoj ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtëshmërisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit - raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në Gjakovë, të kërkohet historiati i pronës për paluajtëshmerinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, sipas detyrës zyrtare t'i marrë në shikim shkresat e lëndës sipas aneks kontratës e cila është objekt kontesti si dhe kontratave tjera dhe atë: shkresat e lëndës Vr.nr.------, Vr.nr.-----, Vr.nr.------, Vr.nr.-----, Vr.nr.-----, Vr.nr.-----, Vr.nr.-----, Vr.nr.------, Vr.nr.-------, C.nr.-----, dëgjimin e dëshmitarëve eventual e në rast nevoje edhe ballafaqimin e tyre, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës (në kuptim të vërejtjeve të theksuara si më lartë) dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet - juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të

evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozit.
Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
Aktgjykimi Rev.357/22 datës 29.11.2023.
Arsyetimi
Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është mjaft i qartë, aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.
Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Nuk qëndron pretendimi i paditësve se kemi tejkalim të kërkesëpadisë, gjykata pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në përputhje të plotë me kërkesëpadinë e paditësve dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me tejkalim të kërkesëpadisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë edhe për zbatimin e drejt, të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:

Me nenin 138 paragrafi 1 dhe 2 të LTK-së, përcaktohet se: " 1. E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjet duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes e trashëgimlënësit, kurse për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit. 2. Ndaj poseduesit me keqbesim kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vjetësh nga koha parashikuar në paragrafin 1 ".

Me nenin 125 të Ligjin mbi Trashëgimin KK.----- të datës 30.12.1974, përcaktohet se: " E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda dy vjetësh nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për posedimin e sendeve nga pasuria trashëgimore, e më së largu brenda 10 vjetësh duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga vdekja e trashëgimlënësit, për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit. Ndaj poseduesit me keqbesim kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vjetësh ".

Me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore - Juridike përcaktohet se: " E drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi si dhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushte dhe mënyrën e caktuar me ligj ",

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve me të cilën kanë kërkuar të vërtetohet se janë bashkëpronarë në pjesë ideale prej 1/7 të paluajtshmerisë së evidentuar në njësinë kadastrale - ngastra kadastrale P----------, oborr dhe shtëpi banimi me sipërfaqe të

përgjithshme prej ----- m2, në adresë rr.”--------”, në Gjakovë, për shkak të parashkrimit të kërkesëpadisë. Edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesëpadia e paditësve është e parashkruar bazuar në dispozitat e nenit 138 paragrafi 1 dhe 2 të LTK-së, pasi që paditësit si trashëgimtar ligjor të trashëgimlënësit, janë vënë në dijeni nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit pra më datë 08.03.1995, e po ashtu edhe me aktvendimin mbi ndarjen e trashëgimisë të nxjerrë nga Gjykata Komunale në Gjakovë T.nr.------- të datës 06.06.2008, në të dyja rastet kërkesa e paditësve është parashkruar, për faktin se në gjykatën e shkallës së parë padia është paraqitur më datë 07.09.2018, që nënkupton se është paraqitur pas afatit ligjor prej 10, përkatësisht 20, vitesh.

Pretendimi i paditësve se gjykata është dashur të zbatoj Ligjin për Trashëgimin KK.------ të datës 30.12.1974, dhe jo dispozitat e ligjit të cilin e kanë zbatuar instancat më të ulëta, Gjykata Supreme vlerëson se afatet e përcaktuara me Ligjin për Trashëgiminë e Kosovës (LTK), i zbatuar nga gjykatat e instancave më të ulëta i përmban të njëjtat afate sa i përket të drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore, sikurse ligji paraprak me të cilin pretendojnë paditësit, andaj me vet faktin se nuk kemi ndryshim të afateve, zbatimi i Ligjit të Trashëgimisë i zbatuar nga gjykatat e instancave më të ulëta është i drejtë dhe i ligjshëm.

Paditësit në këtë rast nuk kanë arritur ti vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështesin kërkesën e tyre edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Gjykata mund të kërkoi nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së ”.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lumni Sallauka

Mbrojtja gjyqësore në rastet e shpifjes: Balanca ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtës për reputacion

1.1. Vështrime të përgjithshme për lirinë e shprehjes

Të shprehurit përfshin të folurit, të shprehurit me shkrim, me imazhe, reklama dhe përmes artit. Po ashtu përfshin transmetimet (radio, TV), gazetat, librat, panfletat, sjelljet simbolike dhe përdorimin e simboleve. Liria e shprehjes garantohet me nenin 10 të KEDNj-së, i cili reflekton formulimin e nenit 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Neni 10 nuk mbron vetëm informacionet ose idetë e pranueshme [nga publiku] dhe ato që konsiderohen jo-ofenduese, por mbron edhe informacionet ose idetë që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë; të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur, pa të cilat nuk mund të ketë një shoqëri demokratike. Neni 10 nuk garanton vetëm mbrojtjen e përmbajtjes së fjalës, por edhe formën e saj. Për shkak të formës së saj, mbrojtje e posaçme i jepet satirës (rasti Różycki dhe Kuliś k. Polonisë), poezisë (Karatas k. Turqisë), dhe novelave (Akadas k. Turqisë). Përveç kësaj, neni 10, siç interpretohet nga GJEDNJ, ofron një mbrojtje të fortë për të drejtën e lirisë së shprehjes. Gjykata e përshkruan vazhdimisht të drejtën si "një nga themelet kryesore të shoqërisë demokratike dhe një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe për përmbushjen vetjake të çdo individi". Ashtu siç ka pohuar Gjykata në vendimin e saj themelor në çështjen Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, liria e shprehjes "gjen zbatim jo vetëm për 'informacionin' ose 'idetë' që pranohen pozitivisht apo konsiderohen si të padëmshme ose çështje për t'u shpërfillur, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo grup të populllsisë.

Neni 10 jo vetëm që u kërkon shteteve që të shmangin çdo akt që mund të shkelë të drejtën e lirisë së shprehjes, por edhe që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që çdo individ në juridiksionin e tyre e gëzon në mënyrë efektive këtë të drejtë. Detyrimi pozitiv i shtetit lidhur me objektin e nenit 10 lidhet me nenin 13 të KEDNj-së (e drejta për mjete efektive).

1.2. Kushtet për kufizimin e lirisë së shprehjes

Në zbatim të nenit 10 të KEDNj-së, e drejta e lirisë së shprehjes duhet të interpretohet gjerësisht, ndërsa kufizimet duhet të interpretohen në mënyrë strikte. Në lidhje me këtë, roli kryesor i nenit 10 është që të mbrojë lirinë e shprehjes së të gjithëve. Për këtë arsye, GJEDNJ ka vendosur rregulla të interpretimit strikt të kufizimeve të mundshme që parashikohen në paragrafin 2. Po ashtu, autoriteteve kombëtare nuk u kërkohet të ndërhyjnë në ushtrimin e lirisë së shprehjes sa herë që një nga shkaqet e renditura në paragrafin 2 është në rrezik, pasi kjo do të çonte në kufizim të përmbajtjes së kësaj të drejte. Gjykata shqyrton dhe vendos për secilin rast të veçantë nëse ekziston ndërhyrje apo jo, duke analizuar ndikimet përkatëse në ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes të miratuar nga autoritetet vendore. Liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute. Ajo vjen me përgjegjësi dhe me detyra. Në këtë drejtim, ekzistojnë dy sfera kufijsh të lirisë së shprehjes 1. Të drejtat e të tjerëve: reputacioni, privatësia, imazhi - Oberschlik k. Austrisë (çështja Nr. 20834/92); Von Hannover k. Gjermanisë (çështja Nr. 59320/00); 2. Interesi publik: siguria shtetërore, morali publik, mohimi historik, gjuha e urrejtjes- Kühnen k. Republikës Federale të Gjermanisë (çështja Nr. 12194/86).

Sipas paragrafit 2 të nenit 10 të KEDNJ, autoritetet vendase në çdonjërin prej shteteve palë mund të ndërhyjnë në ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen tre kushte kumulative: 1. ndërhyrja (çfarë do të thotë "formaliteti", "kushti", "kufizimi" ose "gjoba"), e cila përshkruhet me ligj; - Gawęda k. Polonisë (kërkesa Nr. 26229/95) Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (kërkesa Nr. 6538/74), 2. Ndërhyrja synon të mbrojë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar, integritetin territorial, sigurinë publike; parandalimin e trazive ose krimit, mbrojtjen e shëndetit, moralit, reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, parandalimin e nxjerrjes së informacionit që merret në konfidencë, dhe ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërinë e gjyqësorit; - Gazeta Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar (kërkesa Nr. 13585/88), 3. ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokraktike. - - Sabanovic k. Malit të Zi (kërkesa Nr. 5995/06) Tolstoy Miloslavsky k. Mbretërisë së Madhe (kërkesa Nr. 18139/91).

Ndërsa në kontekstin vendor, Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon të lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave. Neni 40 i Kushtetutës që rregullon lirinë e shprehjes parasheh kufizim të kësaj lirie vetëm me ligj në disa raste të kufizuara. Këto raste janë vetëm kur kufizimi i lirisë së shprehjes është i domosdoshëm për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Liria e mediave po ashtu i nënshtrohet kufizimeve. Kufizimet janë të pranueshme vetëm atëherë kur janë të domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

1.3. Korniza kushtetuese dhe ligjore në Kosovë mbi shpifjen

Kushtetuta e Kosovës, për dallim nga neni 10 i KEDNj-së, nuk parasheh mbrojtjen e reputacionit si shkak legjitim për kufizimin e lirisë së shprehjes. Neni 40.2 i Kushtetutës përcakton se*: "liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare."* As nenet 36 dhe 42 të Kushtetutës që rregullojnë mbrojtjen e privatësisë, përkatësisht lirinë e mediave nuk parashohin mbrojtjen e reputacionit si shkaqe legjitime për kufizimin e lirisë së shprehjes. Një padi për shpifje mbetet opsion në të drejtën civile: një individ mund të bëjë një padi nëse pretendon se i është shkelur pa të drejtë reputacioni.

Në anën tjetër, Ligji Civil kundër shpifjes dhe fyerjes - Ligji Nr. 02/L-65, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, cili ka për qëllim të rregulloj përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje duke siguruar: Të drejtën e lirisë së shprehjes siç garantohet me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Rregullat që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen të mos vënë kufijtë të paarsyeshëm mbi lirinë e shprehjes duke përfshirë edhe publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun. Ndërsa në anën tjetër i njëjti ka për qëllim që të siguroj kompensime efektive dhe të përshtatshme për personat të cilëve u është dëmtuar reputacioni nga shpifja dhe fyerja, si dhe që mjetet e informimit publik të kenë rol të

rëndësishëm në procesin demokratik si vëzhgues publik dhe transmetues i informatave te publiku. Sipas nenit 2, ky Ligj do të interpretohet në mënyrën e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij e maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në rast të ndonjë konflikti në mes të këtij ligji dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, do të zbatohet Konventa dhe praktika ligjore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes parasheh që një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj[163]. Përveç kësaj, me nenin 16.1 parashihet se një person ka të drejtë të kërkojë në procedurën gjyqësore të ndalet shpifja dhe fyerja dhe të tërhiqet informacioni shpifës dhe fyes lidhur me personalitetin e tij/saj si dhe të kërkojë premtimin se shpifja dhe fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj. Në anën tjetër, edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore, i cili zbatohet në këtë rast, me nenin 301, parashihet se: për sigurimin e të drejtave tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave, mund të caktohen këto masa sigurimi: ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara, apo urdhri që t'i kryeje aktivitetet e tilla, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese apo pengimit të dëmtimit të palës kundërshtare; autorizimi i propozuesit të sigurimit që t'i ndërmarrë aktivitetet e caktuara; lënia e pasurisë së caktuar të kundërshtarit të sigurimit për ruajtje dhe përkujdesje personit të tretë; dhe masa tjera të cilat i cakton gjykata si të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadisë së propozuesit

[163] Nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

të sigurimit. Përveç kësaj, edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 138.1 parasheh se: kushdo mund të kërkojë prej tjetrit që të mënjanojë burimin e rrezikut të dëmit të rëndë sishëm që i kanoset atij ose numrit të pacaktuar të njerëzve si dhe të përmbahet nga veprimtaritë nga të cilat rezulton trazimi ose rreziku i dëmit në qoftë se lindja e trazimit ose e dëmit nuk mund të parandalohet me masa përkatëse, ndërsa neni 138.2 përcakton se: Gjykata do të urdhërojë sipas kërkesës së personit të interesuar që të ndërmerren masat përkatëse për parandalimin e shkaktimit të dëmit ose të shqetësimit, ose të evitimit të burimit të rrezikut, me shpenzime të mbajtësit të burimit të rrezikut, në qoftë se ky vetë nuk e bën këtë.

Sipas këtij ligji, shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër (neni 3 i këtij ligji). Ndërsa, fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese. Çështje e interesit publik nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë.

Masat për mbrojtjen nga Shpifja-Sipas paragrafit 1 të nenit 4, një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj, kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.

-*Masat e përkohshme dhe të sigurisë*-Urdhëresat gjyqësore paraprake për të ndaluar përhapjen apo përhapjen e mëtejshme të informacionit, mund të lëshohen vetëm kur publikimi tanimë është kryer dhe kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar mund të sigurojë se informacioni i ka shkaktuar dëm reputacionit të tij apo të saj dhe se individi që pretendohet të jetë i dëmtuar do të pësojë dëmtim të pazëvendësueshëm si rezultat i përhapjes së mëtejshme (neni 16 i ligjit). Mbi këtë bazë, gjykata zbaton

përshtatshmërisht edhe dispoziten e nenit 301 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, si dhe nenin 138 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Detyrimet. Procedurat paraprake, gjyqësore, madje edhe të apelit në paditë për shpifje mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht si në lirinë e shprehjes, ashtu edhe mbrojtjen e reputacionit. Në lidhje me këtë, GJEDNJ ka pranuar se disa garanci procedurale janë të nevojshme. Masat paraprake gjyqësore si masat ndaluese, që janë formë paraprake kufizimi, kërkojnë garanci të posaçme. Qëllimi të cilit i shërbejnë masat ndaluese në legjislacionin për shpifje është të parandalojë botimin në radhë të parë ose të ndalojë përsëritjen e materialit të botuar tashmë. Duke pasur parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe pasojat me ndikim të gjerë të çdo forme kufizimi paraprak, ato duhet të përdoren e të jenë të vlefshme për përdorim vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe shumë të kufizuara. Si rrjedhojë, Gjykatat duhet të jenë të kujdesshme të sigurohen që vendosja e një mase ndaluese të mos ndërhyjë në mënyrë të panevojshme në të drejtën e lirisë së shprehjes. Garancitë procedurale janë të nevojshme edhe për të mbrojtur kundrejt vonesave të pajustifikuar dhe të mëdha në procesin gjyqësor, që mund të kenë ndikim negativ në lirinë e shprehjes, duke bllokuar atë dhe që mund të nënkuptojë gjithashtu se reputacioni i personit ndaj të cilit është kryer shpifja nuk vihet në vend në kohë. Po ashtu, GJEDNJ ka komentuar mbi rëndësinë e një periudhe të përshtatshme kufizimi për vendosjen e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes dhe reputacionit, në çështjen Times Newspapers Ltd. kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 1 dhe 2).

Çfarë mund të bëjë gjykata kur vlerëson se është shpifur kundër një personi-Neni 4 i Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes parasheh të drejtën e një personi që përmes procedurës gjyqësore të kërkojë: ndaljen e shpifjes dhe fyerjes, me premtimin se nuk do përsëriten veprimet e tilla në të ardhmen, të urdhërojë tërheqjen e informacionit shpifës, të caktojë kompensim për dëmin moral dhe material, apo të kërkoj nga gjykata kompetente që të urdhërojë publikimin e demantimit brenda tetë ditësh. Ndërsa me rastin e vendosjes, gjykata duhet të marr parasysh dhe zbatojë standardet e GJEDNJ-së, me të cilat kërkohet që çdo dëmshpërblim monetar duhet të marrë parasysh: të mos krijojë "efektin frenues" në raportimin e mediave (Tolstoy Miloslavsky k. MB), si dhe duhet merren parasysh edhe fakti se me rastin e vendosjes së sanksionit për dëmin

material dhe vuajtjet e shkaktuara nga shpifjet, të merren parasysh edhe mjetet financiare në dispozicion të gazetarit/publikimi.

Përgjegjësia për shpifje dhe fyerje-Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj (paragraf 1 i nenit 5). Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijojnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj.

Ndërsa në rastet kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi ndaj të cilit është shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij. Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publikë mund të paraqesin kërkesë për kompensim e dëmit nga shpifja apo fyerja privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal (paragrafi 4 i nenit 5).

Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia dhe kufijtë e përgjegjësisë- Rastet në të cilat Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes parasheh përjashtimin nga përgjegjësia parashihen në disa raste të veqanta. Kjo parashihet në çështjet e interesit publik dhe atë nëse deklarata lidhet me një çështje me interes publik, autori mban përgjegjësi vetëm nëse ka ditur ose është dashur të dijë se deklarata është e pavërtetë, ose ka vepruar me neglizhencë të pajustifikueshme për verifikimin e saj. Në këtë rast, barra e provës për të dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së tij bie në të padituri, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik (neni 6). Rasti tjetër është tek publikimet e arsyeshme, kur një publikim është bërë në mënyrë të arsyeshme, edhe nëse nuk rezulton i vërtetë, mund të ketë mbrojte nga përgjegjësia (neni 7). Përgjegjësia përjashtohet edhe tek shprehja e opinionit, pra shprehja e mendimit personal që nuk pretendon të paraqes një fakt si të vërtetë, përjashtohet nga përgjegjësia. Përveç kësaj përgjegjësia përjashtohet sipas këtij ligji edhe në rastet e caktuara kur autorët kanë imunitet ligjor për deklaratat e tyre, p.sh., disa deklarata

të bëra në kuadër të funksioneve të tyre publike (neni 9). Me pak fjalë, nuk ka përgjegjësi kur bëhet fjalë për çështje publike kur trajtohen me kujdes, për publikime të arsyeshme, për opinione personale dhe kur ekziston imunitet ligjor.

Kufijtë e përgjegjësisë- në lidhje me këtë nga interpretimi i nenit 11 të LCSHF-së, rezulton se kjo çështje ka të bëjë me përcaktimin se deri ku shkon përgjegjësia e personit që ka shkaktuar dëmin përmes shpifjes ose shprehjeve të dëmshme. Si rezultat i kësaj, kufijtë e përgjegjësisë ndërlidhen me ekzistencën e imunitetit (p.sh.: deputetët gjatë ushtrimit të mandatit), dallimit midis faktit dhe opinionit, apo ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes për interes publik.

Detyrimi për të zbutur dëmin- është parim i njohur në të drejtën civile, ku pala e dëmtuar nuk duhet vetëm të kërkojë kompensim, por edhe të marr masa për të zbutur apo parandaluar rritjen e dëmit. Në të kundërtën kompensimi i dëmit nga gjykata mund të zvogëlohet. Sidoqoftë, kompensimi duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar dhe duhet të caktohet vetëm me qëllim të korrigjimit të dëmit të shkaktuar ndaj reputacionit të personit në fjalë, ose për të kompensuar çfarëdo humbje të provueshme aktuale financiare apo dëmi material. Në secilin rast gjykatat duhet të caktojnë kompensimin në bazë të natyrës dhe shkallës së dëmit (material dhe moral), ndikimit publik të deklaratës shpifëse, si dhe masave të marra nga i dëmtuari. Kjo për faktin se proporcionaliteti siguron që kompensimi material të mos kufizojë në mënyrë disproporcionale lirinë e shprehjes, por as të mos mbetet simbolik nëse dëmi ka qenë i madh. Ndërsa sa i përket të drejtës për reagim e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, ky është një mekanizëm që i lejon personit të dëmtuar nga shpifja ose publikimi i pavërtetë, të kërkojë korrigjim ose përgjigje publike, përveç kompensimit financiar.

Afatet, mbrojtja e burimeve dhe gjykata kompetente-Afati për paraqitjen e një kërkese për kompensim në bazë të këtij Ligji është tre (3) muaj, nga dita kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pavërtetë dhe identitetin e autorit (afati subjektiv), dhe në asnjë rast nuk duhet të kalojë një (1) vit, nga dita kur shprehja është bërë publike (afati objektiv)[164].

[164] Neni 17 i LCSHF-së.

Nëse personi që pretendon se është dëmtuar vdes pas fillimit, por përpara përfundimit të procedurës gjyqësore, trashëgimtari i tij ose i saj i shkallës së parë mund ta vazhdojë procedurën në emër të të ndjerit, nëse trashëgimtari i paraqet padi Gjykatës brenda tre (3) muajve, nga data e vdekjes së personit që pretendohet se është dëmtuar.
Mbrojta e burimeve- Asnjë të padituri për një vepër të shpifjes apo fyerjes sipas këtij Ligji, nuk do ti kërkohet që të zbulojë një burim të fshehtë informacioni. Nuk do të nxirret asnjë konkluzion i pafavorshëm nga fakti që një i paditur për një vepër të shpifjes apo fyerjes sipas këtij Ligji, refuzon të zbulojë një burim të fshehtë informacioni. Gjykata mund të kërkojë nga i padituri për një veprim shpifës apo fyes sipas këtij Ligji, të zbulojë informacionin relevant në përcaktimin e vërtetësisë së materialit të publikuar, por pa e identifikuar burimin (neni 18).

2. Shpifja dhe figurat publike: Balanca ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtës për reputacion sipas GJEDNJ

Mbrojtja e reputacionit apo e të drejtave të të tjerëve është qëllimi legjitim më i shpeshtë dhe që paraqitet më së shumti në kërkesat pranë GJEDNJ në kuadrin e nenit 10. Ndërsa nëse i referohemi aktgjykimeve të GJEDNJ për këtë çështje, kjo e fundit përdor metodën "klasike" në analizën e proporcionalitetit për të konstatuar në bazë të rrethanave të mosmarrëveshjes që i paraqitet, se neni 8 nuk është i zbatueshëm për mbrojtjen e reputacionit apo të të drejtave të të tjerëve. Ndërsa metoda e dytë ose e ashtuquajtura përqasje e "baraspeshimit të të drejtave" zbatohet për kategorinë e çështjeve ku Gjykata çmon se neni 8 është i zbatueshëm për mbrojtjen e këtyre qëllimeve legjitime. Këto zakonisht janë çështje për publikimin e fotografive, imazheve apo shkrimeve që pasqyrojnë aspekte intime të jetës së një individi apo të familjes së vet[165]. Pas një zhvillimi në jurisprudencë që u konsolidua nga një gjykim i Dhomës së Madhe (Axel Springer AG k. Gjermanisë [DhM], § 83), mbrojtja e

[165] Rastet: Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës [DhM], § 79; Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2) [DhM], § 103; MGN Limited k. Mbretërisë së Bashkuar, § 142.

reputacionit mund të jetë – si element i jetës private – brenda fushëveprimit të nenit 8 të Konventës, por me një kusht: për të qenë shkelje e të drejtave të garantuara nga neni 8, duhet të tejkalohet një "prag ashpërsie". Ndërsa që neni 8 të zbatohet në çështjet e shpifjeve, sulmi ndaj reputacionit të një personi duhet të përmbajë njëfarë niveli ashpërsie dhe duhet të jetë në një mënyrë që cenon gëzimin personal të së drejtës për jetë private. Në lidhje me këtë, GJEDNJ nënvizoi edhe se neni 8 nuk mund të evokohet për të pretenduar cenim reputacioni që vjen si pasojë e parashikueshme e vetë veprimeve të personit, si për shembull kryerja e një vepre penale (*kjo është paraqitur në rastet: Axel Springer AG k. Gjermanisë [DhM], §§ 83-84; Hachette Filipacchi Associés k. Francës, § 43).*

Baraspesha e drejtë mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për jetë private në kontekstin e publikimeve (aspektet intime të jetës dhe reputacionit të individit)- Parimet e përgjithshme që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ lidhur me mbrojtjen e jetës private në kontekstin e një shkrimi shtypi paraqiten ndër të tjera në pikat 83 dhe 87 të vendimit në çështjen Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës [DhM]. Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes në këtë kontekst theksohen në pikat 88 dhe 93 të atij vendimi. Në lidhje me këtë, Gjykata është shprehur se megjithëse shtypi nuk duhet të kapërcejë kufij të caktuar, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen të reputacionit dhe të të drejtave të të tjerëve, prapëseprapë detyra e tij është të japë informacion dhe ide për çështje me interes publik - në një mënyrë që është në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e shtypit. Më tutje, GJEDNJ ka theksuar se jo vetëm shtypi ka detyrën që të japë të tillë informacion dhe ide, por edhe publiku ka të drejtë t'i marrë ato. Po të ishte ndryshe, shtypi do ta kishte të pamundur të luante rolin jetik të "rojtarit publik" (*Rasti: Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë [DhM]).*

Kriteret dhe zbatimi i tyre në praktikë- GJEDNJ ka përcaktuar parimet përkatëse që duhet të drejtojnë vlerësimin e saj dhe mbi të gjitha vlerësimin e gjykatave vendase, nëse ishte e nevojshme apo jo ndërhyrja në këtë fushë. Kështu, Gjykata ka identifikuar disa kriteresh në kontekstin e baraspeshimit të të drejtave konkurruese (Rasti: Axel Springer AG k. Gjermanisë [DhM], §§ 90-95). Ndërsa, pesë kriteret përkatëse janë: kontributi në një debat me interes publik; shkalla e famës e personit të

prekur; tema e lajmit/shkrimit; sjellja paraprake e personit në fjalë; përmbajtja, forma dhe pasojat e botimit; dhe, sipas rastit, rrethanat në të cilat janë bërë fotografitë (Rastet: Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2) [DhM], §§ 109-113; Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 3), § 46; Axel Springer AG k. Gjermanisë [DhM], §§ 89-95). Në lidhje me këtë, kur shqyrton një kërkesë të depozituar sipas nenit 10, Gjykata do të shqyrtojë edhe mënyrën si është përftuar informacioni dhe vërtetësinë e tij, si edhe ashpërsinë e dënimit ndaj gazetarëve apo publikuesve (Rasti: Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës [DhM]).

Rëndësia e fjalimit për çështje me rëndësi publike-Një koncept me rëndësi që thekson pjesë të madhe të praktikës gjyqësore të Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut është rëndësia e mbrojtjes së fjalimit mbi çështje të rëndësisë publike. Kurdoherë që konstaton se një deklaratë e veçantë ka të bëjë me një çështje me rëndësi publike, Gjykata i jep asaj një nivel të lartë të mbrojtjes. Debati politik gëzon nivelin më të lartë të mbrojtjes. Sipas fjalëve të GJEDNJ, «liria e debatit politik është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike që mbizotëron gjatë gjithë Konventës» (Lingens k. Austrisë, Aktgjykimi i 8 qershorit 1986). Por shprehja për çështje me rëndësi publike tejkalon fjalimin politik, ndërsa Gjykata ka zhvilluar jurisprudencën e saj, ajo e ka sqaruar se një nivel i lartë i mbrojtjes i jepet diskutimit për të gjitha çështjet me rëndësi publike. GJEDNJ gjithashtu ka sqaruar se për t'u konsideruar të një rëndësie publike, deklaratat nuk kanë nevojë të kenë rëndësi për të gjithë publikun e një vendi. Nuk ka ndonjë përcaktim të përgjithshëm të çështjeve të «rëndësisë publike» ose «interesit publik»; por çdo rast trajtohet për çështjet e saj dhe nëse konstatohet se shprehja në fjalë ka të bëjë me një çështje me rëndësi publike, atëherë do të gëzojë një nivel më të lartë të mbrojtjes.

GJEDNJ gjithmonë i ka kushtuar vëmendje të veçantë faktit se publikimi i informacionit, dokumenteve apo fotografive në shtyp i shërben interesit publik dhe kontribuon në një debat me interes të përgjithshëm. Ky interes mund të konstatohet vetëm në dritën e rrethanave të secilës çështje (Rastet: Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2) [DhM).

Sipas GJEDNJ, interesi publik zakonisht lidhet me çështje që prekin publikun në një masë të tillë që i legjitimon të kenë interes për to, të cilat tërheqin vëmendjen e publikut ose e shqetësojnë në një shkallë të

konsiderueshme, veçanërisht kur ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve ose në jetën e komunitetit. Kjo vlen edhe për çështjet që janë në gjendje të krijojnë polemika të mëdha, të cilat kanë të bëjnë me një çështje të rëndësishme shoqërore, ose një problem për të cilin publiku do të kishte interes të informohet[166].

Gjykata ka theksuar se masa sa profil publik ka një individ apo sa i mirënjohur është, ndikon te mbrojtja që mund t'i akordohet jetës private të këtij personi. Roli ose funksioni i personit në fjalë dhe natyra e aktiviteteve që janë objekt i raportimit dhe/ose fotografive përbëjnë një tjetër kriter të rëndësishëm, lidhur me të parin. Në lidhje me këtë, publiku ka të drejtë të informohet, sepse kjo është një e drejtë thelbësore në një shoqëri demokratike e cila, në rrethana të posaçme, mund të shtrihet edhe në aspekte të jetës private të figurave publike, sidomos politikanët (Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2) [DhM]). Edhe pse publikimi i lajmeve për jetën private të figurave publike bëhet zakonisht për argëtim sesa për edukim, prapë kontribuon në larminë e informacionit që i serviret publikut dhe padyshim që përfiton nga mbrojtja e nenit 10 të Konventës. Megjithatë, kjo mbrojtje mund të cedojë para kërkesave të nenit 8 kur informacioni ka natyrë private dhe intime saqë nuk ka interes publik në përhapjen e tij (Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2) [DhM], § 110).

Shkalla e ashpërsisë së sulmit ndaj reputacionit- Elementi qendror i shpifjes është sulmi ndaj reputacionit. Por, që neni 8 të hyjë në zbatim, duhet që sulmi ndaj reputacionit të personit duhet të ketë një shkallë të caktuar ashpërsie dhe një mënyrë që shkakton paragjykim të gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private (kjo është trajtuar nga GJEDNJ në rastet: Bédat k. Zvicrës [DhM], § 72; Axel Springer AG k. Gjermanisë [DhM], § 83; A. k. Norvegjisë, § 64). Në lidhje me këtë, GJEDNJ ka çmuar posaçërisht se reputacioni cilësohet e drejtë e pavarur kryesisht kur akuzat faktike janë të një natyre tejet fyese saqë publikimi i tyre ka shkaktuar efekt drejtpërdrejt të pashmangshëm në jetën e paditësit. Në çështjen Karakó k. Hungarisë, shkalla e ashpërsisë së ndërhyrjes që kërkohet për të qenë i zbatueshëm neni 8 i Konventës lidhur

[166] Cështja Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës [DhM], § 171.

me mbrojtjen e reputacionit, përshkruhet si ndërhyrje kaq e rëndë në jetën private saqë integriteti personal në vetvete kompromethet (§ 23).
Dallimi mes deklaratave faktike dhe gjykimeve vlerësuese (opinioneve)- Që në vendimet udhëheqëse në Lingens k. Austrisë dhe Oberschlick k. Austrisë (nr.1), GJEDNJ ka theksuar se duhet bërë dallim i kujdesshëm ndërmjet deklaratave faktike nga njëra anë dhe gjykimeve vlerësuese nga ana tjetër. Ekzistenca e fakteve mund të demonstrohet, ndërsa e vërteta për gjykimet vlerësuese nuk i nënshtrohet provave. Kërkesa për të vërtetuar të vërtetën e një gjykimi vlerësues është kështu e pamundur për t'u përmbushur, si dhe cenon vetë lirinë e mendimit, që është pjesë thelbësore e të drejtës së siguruar nga neni 10. Gjykata ka theksuar se kur legjislacioni i brendshëm apo gjykatat vendëse nuk bëjnë dallimin mes gjykimeve vlerësuese (opinioneve) dhe deklaratave të faktit, që shkon deri aty sa kërkohen prova për vërtetësinë e gjykimeve vlerësuese, një element thelbësor ky i nenit 10 të Konventës. Gjykata ka vënë në dukje mosbërjen e dallimit midis fakteve dhe gjykimeve vlerësuese në disa raste (OOO Izdatelskiy Tsentr Kvartirnyy Ryad k. Rusisë, § 44; Reichman k. Francës, § 72; Paturel k. Francës, etj), ndërsa kjo është trajtuar edhe në disa aktgjykime të Gjykatës Supreme të cilat do të elaborohen në vijim.
Ndërsa, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës gjyqësori dhe institucionet tjera duhet të interpretojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përveç faktit që KEDNJ-ja është e detyrueshme ashtu si legjislacioni i brendshëm, pasi Kosova e ka të paraparë në Kushtetutë, edhe zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së është i detyrueshëm me disa ligje në Kosovës si Kushtetuta dhe Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Në këtë drejtim, neni 53 i Kushtetutës parasheh se të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërsa, siç është cekur edhe më lartë Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes në nenin 2 parasheh se ky Ligj do të interpretohet në mënyrën e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij e maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane për të

Drejtat e Njeriut. Si rrjedhojë, gjykatat e të gjitha niveleve në Kosovë, në të gjitha rastet kur kërkohet mbrojtje gjyqësore për shkak të shpifjes, kanë detyrim që me rastin e vendosjes ti zbatojnë në tërësi dispozitat e përcaktuara me kushtetutë dhe LCSHF, me theks të veçantë praktikën gjyqësore të GJEDNJ për rastet e tilla.

3. Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet e shpifjes

Këtë çështje edhe Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar në disa prej vendimeve të saj, përfshirë këtu rastin nr. KI116/23, datë 12.02.2024, kur është kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev.nr.489/2022, të 19 dhjetorit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, i cili kishte të bënte me refuzimin e revizionit të paditësit dhe vërtetimin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë për hedhjen e padisë për shpifje, për shkak se e njëjta ishte parashtruar jashtë afatit ligjor. Në këtë drejtim, me 19 dhjetor 2022, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.489/2022] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës, paraqitur kunder Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.1992/2022] të 15 shtatorit 2022. Në aktvendimin e saj, Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim: *"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejtë i kanë zbatuar dispozitën e nenit 17.1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, me të cilën shprehimisht parashihet se: "Afati për paraqitjen e një kërkese për kompensim në bazë të këtij ligji është tre (3) muaj, nga dita kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pavërtetë dhe identitetin e autorit dhe në asnje rast nuk duhet të kalojë një (1) vit, nga dita kur shprehja është bërë publike".*

Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ka vendosur të deklarojë të papranueshme kërkesën, me arsyetim se: *"Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes padisë, ankesës dhe kërkesës për revizion, në lidhje me* çështjen *se a është paraqitur*

padia e parashtruesit të kërkesës brenda afatit të përcaktuar ligjor, si dhe çështjes së zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me ç' rast ka vlerësuar se gjykatat kanë pasur prova të mjaftueshme dhe bindëse që mbështesin konkluzionin e tyre përkitazi me vendimmarrjen në çështjen e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimet e gjykatave të rregullta qartazi vërehet se të njëjtat kanë arsyetuar se parashtruesi i kërkesës ka humbur të drejtën e mbrojtjes gjyqesore, si rezultat i paraqitjes së padisë pas kalimit të afatit prekluziv të përcaktuar në nenin 17.1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe fyerjes", (pika 48 e aktvendimit).

3.1. Praktika e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në rastet e shpifjes

Çështja e kompensimit të dëmit për shkak të shpifjes ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas mjetit juridik të jashtëzakonshëm Revizionit. Kështu, në vijim do të paraqiten katër (4) raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e kompensimit të dëmit për shkak të shpifjes.

Aktgjykimi Rev.nr.105/2024, datë 20.02.2025

Paditësi E.U, përmes të autorizuarit të tij, me datë 24.01.2013, ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të padituri M.M dhe A.B nga Mitrovica, për kompensimin e dëmit material të shkaktuar me fyerje, shpifje dhe diskriminim ti paguajnë në shumë totale shumën prej 900.000 euro, ndërsa e padituara e tretë Komuna e Mitrovicës, për shkak të diskriminimit mbi bazën e shkeljes së procedurave të punësimit dhe paaftësisë së paditësit për punësim, të paguajë në shumë totale shumën prej 1,200.000 euro, si dhe shpenzimet procedurale.
Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.61/13, të datës 12.07.2019, në pikën një të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E.U nga Mitrovica, kundër të paditurve M.M dhe A.B nga Mitrovica, për kompensimin e dëmit material të shkaktuar me fyerje, shpifje dhe diskriminim në shumë totale prej 900.000 euro. Në

pikën dy të dispozitivit, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E.U nga Mitrovica, kundër të padituresë Komuna e Mitrovicës, për shkak të diskriminimit mbi bazën e shkeljes së procedurave të punësimit dhe paaftësisë së paditësit për punësim, të paguajë në shumë totale prej 1,200.000 euro. Në pikën tre të dispozitivit është vendosur që secila palë i bart shpenzimet e saj të procedurës.
Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, me aktgjykimin Ac.nr.4754/2019, të datës 20.11.2023, e ka refuzuar të pabazuar ankesën e paditësit E.U nga Mitrovica, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.61/13, të datës 12.07.2019, e ka vërtetuar.
Vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë
Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka theksuar se në bazë të provave të administruara gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ngase Gjykata, lidhur me kërkesëpadinë e paditësit sa i përket shpifjes dhe fyerjes, gjeti se nga asnjë provë si nga deklaratat e deponuara nga nxënësit e shkollës së mesme të Mjekësisë "X…", ashtu edhe nga deklarata e deponuar nga A.B dhe K.P, në asnjë rrethanë nuk janë të përfshirë si subjekt të fyerjes dhe shpifjes dy të padituri M.M dhe A.B. Deklaratat e deponuara janë dhënë nga subjektet e treta dhe jo konkretisht nga të padituri. Për tu konsideruar shpifja dhe fyerja e efektshme dhe reale, duhet të burojë direkt nga subjektet siç janë paditësi dhe i padituri. Në rastin konkret deklarata e deponuar nga K.P dhe A.B nuk nënkupton se ka shpifje dhe fyerje nga të padituri në drejtim të paditësit, ngase këto deklarata janë përcjellë nga deklaratdhënësit tek organet kompetente. Tutje, gjykata vlerëson se edhe deklaratat e nxënësve rreth pretendimeve për marrje të shumës prej 5 euro nga paditësi për plotësim të diplomave, kanë qenë pretendime të nxënësve dhe ankesa të deponuara, të cilat asesi nuk konsiderohen se janë shpifje të padituri të parë M.M, në drejtim të paditësit, ngase, në cilësinë e ish Drejtorit të Shkollës “D..X…”, i padituri i parë M.M ka qenë i obliguar ti adresojë vërejtjet dhe shqetësimet e nxënësve të shkollës që menaxhonte. Edhe sa i përket pretendimeve të paditësit rreth shpifjes për deklaratën e deponuar nga nxënësi G.D rreth favorit të bërë nga paditësi për regjistrim të tij në shkollën e mjekësisë “X…" në Mitrovicë, në këmbim të një motori të veturës Golf 2, edhe ky pretendim edhe po që se

nuk qëndron, i njëjti nuk ka buruar drejtëpërdrejt nga i padituri i parë M.M, por deklarata është e nënshkruar nga nxënësi, edhe pse në dëshminë e tij babai i tij S.D deklaron se nuk din asgjë. Gjykata, tutje, të gjitha provat tjera, e sidomos edhe daljen e të paditurit të parë dhe të dytë në emisionin "Jeta në Kosovë", deklaratat e tyre gjykata i vlerëson si deklarata të deponuara nga ankesat e nxënësve dhe subjekteve tjera në drejtim të paditësit, dhe asesi nuk janë fyerje apo shpifje ndaj paditësit, por edhe i padituri i parë M.M, si drejtor i shkollës dhe i padituri i dytë A.B si ish drejtor i drejtorisë komunale për arsim në Mitrovicë, shqetësimet dhe ankesat e nxënësve që iu adresohen, kanë për obligim ti bëjnë mediale po që se kërkohet nga subjektet e caktuara, qoftë në drejtim të paditësit, apo çfarëdo subjekti tjetër që nxënësit, prindërit apo kushdo tjetër ka ndonjë ankesë ndaj tyre. Gjykata ka vlerësuar se edhe pse nuk qëndron në asnjë provë fakti i pretenduar se paditësi gjatë eskursionit në Shqipëri ka hyrë në mesnatë në dhomën e femrave, kjo shpifje dhe fyerje ndaj pretendimeve imorale të paditësit, nuk ka buruar dhe plasuar nga të padituri, por është deklaratë e dhënë nga subjektet e treta A.B dhe K.P, ku K.P më vonë e ka denoncuar këtë deklaratë. Sidoqoftë, të padituri me asnjërën nga këto nuk mund të pretendohet se kanë shpifur, fyer ndaj integritetit moral dhe personal të paditësit, pasi që, ata nuk kanë qenë nënshkrues dhe hartues të këtyre deklaratave, por vetëm kanë adresuar tutje shqetësimet, pretendimet e deklaratdhënësve në organet kompetente.

Andaj, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, konform nenit 6 paragraf 1, 11, paragraf 1, 14, dhe 15, të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nr. 02/L-65, në lidhje me nenin 4, par.1 të Ligjit kundër Diskriminimit nr. L/2004/03 (që ka qenë i aplikueshëm në rastin konkret), në lidhje edhe me nenin 2, par.1, nënparagraf 1.1, nenin 3, paragraph 2, 16, nenin 20 të Ligjit Kundër Diskriminimit nr. 05/L-021.

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit të atakuar me revizion ndër të tjera ka theksuar se pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore,

pasi që i njëjti nuk përmban të dhënat sipas nenit 160.4 të LPK-së, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për mos themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë për vendosje meritore. E drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për arsye se nga provat prezente në shkresat e lëndës në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar fakti se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shpifje dhe fyerje, pasi që deklaratat e bëra nuk i përmbushin elementet ligjore për tu konsideruar si shpifje dhe fyerje dhe se të njëjtat deklarata janë bërë nga personat e tretë dhe jo nga të paditurit M.M dhe A.B. Në mënyrë që shpifja dhe fyerja të konsiderohen reale dhe të efektshme duhet që të burojnë nga subjektet siç janë të paditurit, ndërsa në rastin konkret deklarata e dhëna nga personat e tretë nuk nënkuptojnë se ka shpifje dhe fyerje nga të paditurit në drejtim të paditësit.

Gjykata e Apelit më tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 3, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: "*Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër*", në pikën b), përcaktohet se: "*Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj*

një personi tjetër e cila është nënçmuese", ndërsa me nenin 5, paragraf 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: "*Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë ligj*". Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka konstatuar faktin se të padituri nuk kanë për detyrim që paditësit t'ia kompensojnë dëmin mbi bazën e shpifjes dhe fyerjes, dhe se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet konform dispozitave ligjore të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Meqenëse pala paditëse, përkatësisht i autorizuari i tij në revizion e paraqitur nuk është thirrur në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si rezultat i kësaj, kjo gjykatë ka trajtuar aktgjykimin e shkallës së dytë vetëm në aspektin e ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Si rrjedhojë, sipas Gjykatës Supreme aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale nga neni 215 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndërsa për shkelje të tjera siç është konstatuar edhe më lartë nuk ka pasur pretendime në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Në lidhje me këtë është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi juridik i gjykatave të instancave më të ulëta se nga provat e administruara të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në

mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar fakti se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shpifje dhe fyerje, pasi që deklaratat e bëra në gazetën "Jeta në Kosovë", me datë 28.01.2013, nuk i përmbushin elementet ligjore për tu konsideruar si shpifje apo fyerje dhe se të njëjtat deklarata burojnë nga personat e tretë dhe jo nga të padituri M.M dhe A.B, në cilësinë e drejtorit të shkollës së mesme të Mjekësisë "D.. X…" në Mitrovicë dhe drejtorit të Drejtorisë Komunale në po të njëjtin qytet. Në lidhje me këtë, rezulton i drejtë konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët se deklarimi i të paditurve për gazetën në fjalë, është bërë pas kërkesës së kësaj të fundit për marrjen e informacioneve rreth shqetësimeve të ngritura nga paditësi dhe jo vetëm, rreth punësimit të tij. Ndërsa deklaratat e tyre në cilësi të personave zyrtar, janë bërë bazuar në të gjitha ankesat e shkruara e të dorëzuara nga nxënësit e kësaj shkolle, rreth pretendimeve të tyre për qasjen dhe sjelljet e paditësit në raport me ta. Nga kjo rezulton se shprehjet e përdorura gjatë deklarimit të tyre, kanë të bëjnë me dhënien e informacioneve pikërisht lidhur me këto ankesa të nxënësve (të cilat edhe janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë), e jo akuza apo deklarata të cilat burojnë drejtpërdrejtë nga të padituri ndaj këtu paditësit.

Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme e sheh të nevojshme të bëjë edhe vlerësimin se çka konsiderohet shpifje sipas Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në mënyrë që të kemi një përfundim të qartë se deklaratat e bëra nga të padituri, a i përmbushin elementet ligjore për tu konsideruara të tilla (shpifje). Në këtë drejtim neni 3 pika a) e përkufizon shpifjen në këtë mënyrë: *"Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër".* Në lidhje me këtë, bazuar në definicionin e cekur më lartë, janë dy kushte themelore që duhet plotësuar për tu konsideruar që një veprim i caktuar të konsiderohet shpifje dhe atë: *1) duhet të jetë e shprehur në formë të një fakti apo deklarate*, si dhe 2) *personi i cili e bënë publikimin e faktit apo deklaratës e din ose është dashur ta dijë se fakti apo deklarata janë të pavërteta*. Nëse i referohemi deklaratës së të paditurëve, nuk rezulton se janë përmbushur të dy elementet e cekura më lartë, për tu konsideruar se të paditurit kanë shpifur ndaj paditësit. Kjo për faktin se deklarata e të paditurve më shumë përmban opinione, të cilat

burimin e kanë në ankesat e nxënësve të dorëzuara në Drejtorinë e shkollës përkatëse për sjelljet e pretenduara nga paditësi, se sa konstatime (apo akuza të drejtëpërdrejta) të paditurve për çështjet e ngritura përmes këtyre ankesave ndaj këtu paditësit. Në këtë kuptim, duke u bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ, Gjykata bën dallimin në mes të fakteve dhe opinioneve, apo gjykimit të vlerave. Lidhur me këtë, GJEDNJ ka theksuar se '*duhet bërë një dallim i qartë në mes të fakteve dhe gjykimit të vlerave. Ekzistenca e fakteve mund të dëshmohet, ndërsa vërtetësia e gjykimeve të vlerave nuk mund të provohet. Për sa i takon gjykimeve të vlerave, ky kriter për të provuar vërtetësinë e një gjykimi të vlerave është i pamundur të përmbushet dhe shkel vet lirinë e mendimit'* (Aktgjykimi në rastin *Lingens kundër Austrisë, i* datës 08 Korrik 1986, parag. 46; Aktgjykimi *Jerusalem kundër Austrisë*, i datës 27 Shkurt 2001).

Në lidhje me këtë, edhe neni 7 i Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, shprehimisht përcakton se: "*Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla".* Ndërsa se çka nënkuptohet me çështjen e "interesit publik", e sqaron neni 2 pika k) e ligjit të cekur më lartë, ku është përcaktuar se: *"Çështje e interesit publik nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë".* Nga interpretimi i këtyre dispozitave, rezulton i drejtë qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët, se në rastin konkret nuk është provuar fakti se i padituri i parë dhe i dytë, përmes deklarimit të tyre për gazetën e cekur më lartë, nuk kanë shpifur ndaj paditësit, pasi që të njëjtit referuar pozitës menaxheriale që kanë pasur *(njëri Drejtor i Shkollës dhe tjetri Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit),* si dhe duke pasur parasysh interesin e publikut për marrjen e informacioneve për çështjet e arsimit publik, kanë vepruar në kuadër të detyrimeve të tyre ligjore. Në lidhje me këtë, siç edhe është

cekur edhe më lartë, çështjet, përkatësisht deklaratat që ndërlidhen me paditësin, nuk është provuar se kanë buruar nga të padituri, por nga vetë ankesat e nxënësve të cilat janë dorëzuar në Drejtorinë e Shkollës "D.. X…" në Mitrovicë, për çka edhe të njëjtit nuk rezulton të kenë kryer shpifje ndaj paditësit. Andaj, edhe qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulët, për pathemelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, kjo gjykatë e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm.

Në anën tjetër, Gjykata Supreme ka vlerësuar edhe pretendimet në revizionit e paditësit ndaj të padituri së tretë Komuna e Mitrovicës, lidhur me diskriminimin në punësim, mirëpo të njëjtat kanë rezultuar të pabazuara. Në lidhje me këtë, është i drejtë konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët se nuk është provuar me asnjë provë materiale çështja e diskriminimit të paditësit në punësim nga ana e të padituri së tretë. Përveç kësaj, është i drejtë konstatimi në aktgjykimin e atakuar me revizion se përderisa paditësi nuk ka qenë i kualifikuar me kualifikim adekuat për pozitën e tij në Shkollën e Mesme të Mjekësisë "D.X…" në Mitrovicë, kontrata e tij është vazhduar çdo vit dhe në vitin e caktuar në vendin e tij është punësuar I.I me kualifikimin Bachelor i Matematikës, i cili rezulton ti ketë përmbushur kriteret e konkursit. Ndërsa qëndron edhe konstatimi se punëdhënësi ka në diskrecion të vlerësoj kandidatët e kualifikuar adekuat për pozitën përkatëse në bazë të rezultateve të testimit dhe poentimit gjatë intervistës dhe në rastin konkret ka rezultuar që kundër kandidati i paditësit të poentohet më tepër sesa paditësi. Si rrjedhojë, rezulton se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale, përkatësisht dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit Nr.2004/3, që ka qenë i aplikueshëm në rastin konkret, pasi që nuk është provuar fakti se e paditura e tretë ta ketë diskriminuar paditësin në çfardo forme lidhur me punësimin e tij, pasi që siç edhe rrjedhë nga shkresat e lëndës paditësi është ripunësuar sërish tek e paditura e tretë dhe vazhdon të punojë ende, duke i realizuar të gjitha të drejtat e tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Aktgjykimi Rev.nr.468/2024, datë 13.05.2025

Paditësi S.K nga Lipjani, përmes të autorizuarit të tij, më datë 28.03.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të padituri për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial për shkak të cenimit të rëndë të dinjitetit profesional, integritetit dhe dinjitetit personal, me arsye dhe kërkesë si në padi.
Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.821/13 të datës 18.12.2019, në pikën I të dispozitivit është refuzuar e pa bazuar, kërkesëpadia e paditësit S.K, avokat nga Komuna e Lipjanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, ta kompensoi paditësin, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, për shkak të cenimit të rëndë të dinjitetit personal, profesional, integritetit dhe nderit, në shumën e përgjithshme prej 150,000.00 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë euro), me kamatë në lartësinë prej 4,5% vjetore, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 797.50 euro (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, me aktgjykimin Ac.nr.2496/20 të datës 19.04.2024, ka refuzuar të pabazuar ankesën e paditësit S.K nga Lipjani, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.821/13 të datës 18.12.2019.

Vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.821/13 të datës 18.12.2019, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur

më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se paditësi në cilësinë e avokatit, e ka përfaqësuar në një rast kontestimor SH.B, deri në përfundimin e procedurës së përmbarimit. Kjo procedurë gjyqësore është zhvilluar në ish Gjykatën Komunale të Lipjanit, siç edhe konstatohet me aktgjykimin C.nr.642/2005 të datës 16.06.2006, aktgjykimin C.nr.94/2007 të datës 29.05.2007, aktgjykimin C.nr.208/2008 të datës 23.10.2008, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.133/2009 të datës 05.10.2009, Propozimin për përmbarim të datës 01.12.2009 dhe transferi i mjeteve sipas aktvendimit të ish Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1059/2009, ku transferi i është bërë SH.B më datë 26.10.2010. Në këtë rast nuk ishte kontestues fakti që sipas kërkesës së SH.B, Kryetari i ish Gjykatës Komunale në Lipjan kishte hartuar fletparaqitje penale ndaj paditësit duke e denoncuar për veprën penale të mashtrimit dhe veprën penale keqpërdorimi i besimit. Po ashtu nuk ishte kontestuese që Prokuroria Publike kishte hedhur poshtë kallëzimin penal, pasi ishte konstatuar se paditësi në cilësinë e avokatit, në raport me klientin e tij i ka përfunduar të gjitha detyrimet, gjegjësisht kishte gjetur se asnjë pretendim i paraqitur në kallëzimin penal, nuk qëndron. Ndërsa në anën tjetër Kryetari i Gjykatës si hartues i fletdenoncimit penal, nga e paditura ishte gjetur përgjegjës për shkelje disiplinore të detyrave të punës, për çka edhe i është shqiptuar masë disiplinore.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se kontestuese në këtë rast për palët ndërgjyqëse dhe gjykatën, ishte baza e kërkesës së paditësit, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, në emër të cenimit të rëndë të dinjitetit personal, profesional, integritetit dhe nderit të paditësit i shkaktuar nga punonjësi i të paditurës, i cili ishte Kryetar i Gjykatës Komunale në Lipjan. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të gjitha provave dhe me referim në nenin 5 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes Dhe Fyerjes, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, pasi këtu punonjësi i të paditurës - kryetari i gjykatës vetëm e ka përpiluar një procesverbal sipas kërkesës së qytetarit, përkatësisht ish

klientit të paditësit, mirëpo nuk ka përhapur shpifje apo fyerje dhe me përpilimin e procesverbalit nuk është ndikuar në asnjë mënyrë në shkeljen e dinjitetit dhe nderit të paditësit. Nga kjo rezulton se nuk kemi të bëjmë me shpifje dhe fyerje nga ish kryetari i gjykatës së cekur më lart, në raport me paditësin, vetëm pse procedurat të cilat i ka ndjekur më tej SH.B, si palë që e kishte përfaqësuar paditësi në një procedurë kontestimore, kanë rezultuar nga institucionet kompetente që nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se punonjësi i të padituës nuk është përgjegjës për përhapjen e të pavërtetave siç pretendon paditësi, ngase punonjësi i të padituës në këtë rast nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim për përhapjen e të pavërtetave, por vetëm e ka hartuar procesverbalin-fletëparaqitjen në fjalë, që ka rezultuar nga e paditura, që është në kundërshtim me ligjin e KGJK-së, dhe i njëjti i ka bartur pasojat për çka edhe ju ka shqiptuar masa e Qortimit. Pra paditësi nuk ka arritur të dëshmojë pretendimet e tij, se ish kryetari i gjykatës së lartcekur ka ndërmarr ndonjë veprim për publikimin e procesverbalit Agj.nr..../... të datës ..., që e kishte përpiluar. Mirëpo për përpilimin e procesverbalit të lartcekur ish kryetarit ju kishte shqiptuar masë e "Qortimi" nga e paditura, e cila masë edhe është publikuar në Gazetën Ditore "Kosova Sot" më datë 25.12.2013, me titull "*Po nuk e pate fort me ZPD- në, ndëshkohesh*", prandaj i njëjti edhe i kishte bartur pasojat. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 3 paragraf 1, pika a) dhe 5 paragraf 1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, lidhur me nenin 7 paragraf 1, 319 paragraf 1 dhe 322 paragraf 1 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të paqëndrueshme edhe pretendimet ankimore lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 3 paragraf 1, pika a) të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: "Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din

ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër". Ndërsa me nenin 5 paragraf 1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: "Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë së ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë ligj". Duke u bazuar në interpretimin e dispozitave të lartcekura, si dhe në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që me asnjë provë të administruar dhe të vlerësuar, nuk është vërtetuar se punonjësi i të paditurës ka bërë ndonjë deklaratë e cila do të trajtohej si shpifje dhe fyerje dhe se paditësit i është shkaktuar ndonjë formë e dëmit material apo jomaterial, si pasojë e veprimeve të paditurës.

Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme mori për bazë pretendimet e palës paditëse të paraqitura në revizion por që vlerëson se në këtë rast me të drejtë është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, kjo pasi që nga faktet e çështjes, praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJEDNJ, në veçanti neni 8 i KEDNJ, nuk janë përmbushur kushtet për përgjegjësinë e të paditurës në kompensimin e dëmit të pretenduar nga paditësi.

Pala paditëse pretendon se kallëzimi penal që është bërë nga kryetari i gjykatës për të janë përhapur të pavërteta, e për pasojë i janë shkaktuar dhimbje shpirtërore dhe i është shkaktuar dëm jomaterial në emër të cenimit të rëndë të dinjitetit profesional, integritetit dhe dinjitetit personal.

Kjo gjykatë vlerëson se kallëzimi penal i bërë nga kryetari i gjykatës nuk është vërtetuar se është paraqitur me qëllim të keq apo abuziv, por si vlerësim i kryetarit të gjykatës që pasi që pala është paraqitë dhe ka kërkuar ndihmë për këtë çështje, rasti të adresohet për veprime të mëtejshme në Prokurorinë Publike. Kallëzimi penal është shqyrtuar nga prokuroria dhe është hedhë poshtë në një procedurë të rregullt, ku është konstatuar se është hedhë kallëzimi penal i palës dhe jo i kryetarit të

gjykatës, pra prokuroria kallëzimin penal e ka trajtuar si kallëzim të palës, ashtu edhe siç është adresuar pala te kryetari i gjykatës për të deklaruar pretendimin e saj në raport me avokatin. Edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në rastin Fernandes v. Portugalia (nr.42736/15), gjykata thekson se vetë fakti i ndjekjes penale apo kallëzimit penal nuk përbën automatikisht shkelje të nenit 8 të Konventës, në mungesë të qëllimit keqdashës, publicitetit apo pasojave reale ndaj reputacionit.

Sipas kësaj gjykate element thelbësor në këtë çështje është mungesa e publicitetit të rastit, pra kallëzimi penal nuk është bërë publik në media dhe nuk ka pasur shpërndarje të informacionit në mënyrë që të krijohet perceptimi publik negativ për paditësin. Pala paditëse vetëm hipotetikisht vlerëson se kjo fletëparaqitje është përhapur si informacion në gjykatë, pastaj edhe në rrethin më të gjerë shoqëror, por që nuk paraqet prova për të argumentuar një pretendim të tillë, apo që ndonjë mënyrë të ketë pasur publikim mediatik për këtë rast. Në mungesë të këtij faktori, nuk mund të argumentohet se ka ndodhur një cenim real dhe i maturueshëm i reputacionit të tij profesional. Në mungesë të një përhapje publike, me të drejtë nxirret përfundimi në këtë rast se nuk ka pasur ndërhyrje të papërshtatshme në jetën private të paditësit. Ndikimi i kallëzimit penal në reputacion duhet të jetë real, i dukshëm dhe me pasoja të qarta, jo hipotetik siç ka pretenduar paditësi në këtë rast.

Përveç kësaj, pala paditëse vetëm ka supozuar në shkaktimin e dëmit jomaterial dhe material, por që nuk ka ofruar asnjë provë të drejtpërdrejt për të vërtetuar që në ndonjë formë ti jetë shkaktuar dëmi jomaterial apo material (ndikimit në klient). Gjykata Supreme vlerëson se në mungesë të plotësimit të kushteve të sipërtheksuara e paditura nuk mund të përgjigjet në kuptim të nenit 170 të LMD-së për dëmin e pretenduar nga paditësi, kjo pasi që pala paditëse nuk ka dëshmuar me prova konkrete për dëmin e pretenduar, por vetëm hipotetikisht ka vlerësuar se i është shkaktuar dëm jomaterial dhe material (ndikimit në klient). Nga rrethanat e çështjes nuk rezulton se në raport me paditësin kishte dëmtim të reputacionit, cenim nderi dhe autoriteti me faktin që ndaj tij është paraqitë fletëparaqitje penale, kjo pasi paraqitja e rastit nga kryetari i gjykatës nuk ishte bërë me qëllim te keq dhe tendencioz për të dëmtuar reputacionin e

paditësit, ndërsa ky si rast nuk ishte bërë as publik, pra nuk kishte përhapje publike dhe rrjedhimisht nuk ka pasë perceptim publik negativ për paditësin. Nga kjo rezulton se paditësi në mënyrë hipotetike, por që nuk ka mundur të argumentoj se kallëzimi penal ka pasur ndikim real, të matshëm dhe me pasoja qarta në reputacionin e tij.

Aktgjykimi Rev.nr.74/2024, datë 12.11.2024

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I.A, përmes të autorizuarit të tij, me 11.12.2017, ka ushtruar padi për shpifje.
Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.558/2017, të datës 05.03.2021, në pikën I të dispozitivit, është vërtetuar se të padituri P... - Dega Lipjan dhe I.H nga fshati B..., Komuna e Lipjanit, në rrjetet sociale kanë publikuar përmbajtje të pavërteta kundër paditësit I.A nga fshati T..., përkatësisht P.... - Dega në Lipjan, më datë – 06.11.2017, në Facebook me titullin „Fitorja e kompromituar e I.A, skandal me përmasa ndërkombëtare për shkak të mbështetjes financiare në procesin zgjedhor të I.A", më datë 06.11.2017, „P... - Dega në Lipjan, akuzon I.A nga L... që „ka zhvilluar kampanjë me para të dyshimta“ më datë 07.11.2017, në rrjetin social Facebook në një përgënjeshtrim nën titullin “Karvani juaj ka ngecur në baltë, jeni zhytur në krim dhe korrupsion", më 04.12.2017 në Facebook, nën titullin “Financuesi i fushatës së I.A, S.B arrestohet nga autoritetet suedeze“, ndërsa I.H më datë 06.11.2017, në faqen e tij zyrtare nën titullin „„Fitorja e kompрometuar e I.A, skandal me përmasa ndërkombëtare për shkak të mbështetjes financiare në fushatën e I.A", dhe më datë 07.11.2017, nën titullin "Karvani juaj ka ngecur në baltë, jeni zhytur në krim dhe korrupsion", ku P...- Dega në Lipjan dhe I.H e dinin ose duhej ta dinin se publikimet e tyre janë të pavërteta, gjë që dëmtoi reputacionin e paditësit dhe krijoi shqetësim te paditësi. Në pikën II të dispozitivit janë obliguar e paditura P... - Dega në Lipjan dhe i padituri I.H nga fshati B... që në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit ti demantojnë deklaratat e tyre të publikuara në rrjetet sociale të cilat janë të cekura në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimit. Në pikën III është obliguar e paditura P... - Dega në Lipjan që paditësit I.A në emër të kompensimit të dëmit për shkak të thënieve të pavërteta shpifjeve të përmendura në

rrjetet sociale, si në paragrafin I të dispozitivit të aktgjykimit, ti paguaj shumën prej 4.000,00 euro, me kamatë vjetore prej 8%, e cila do të llogaritet prej datës 05.03.2021 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën IV është obliguar i padituri H.I që paditësit I.A në emër të kompensimit të dëmit për shkak të thënieve të pavërteta - shpifjeve të përmendura në rrjetet sociale, si në paragrafin I të dispozitivit të aktgjykimit, ti paguaj shumën prej 1.500,00 euro, me kamatë vjetore prej 8%, e cila do të llogaritet prej datës 05.03.2021 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën V të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit I.A nga fshati T... për kompensim të dëmit jomaterial për shumat që tejkalojnë ato të dhëna në paragrafët III dhe IV të aktgjykimit si të pabazuara. Në pikën VI të dispozitivit janë obliguar e paditura P...- Dega në Lipjan dhe i padituri I.H nga fshati B..., që paditësit ti kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.027,20 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.5328/2021, datë 06.11.2023, është vendosur I. Aprovohet si e bazuar ankesa e të padituri P.D. e K-Dega në … dhe ankesa e të padituri I.H nga fshati …, Komuna Lipjan, Ndryshohet pika I, II, III dhe IV e dispozititvit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.558/2017, i datës 05.03.2021 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I.A nga fshati ... , Komuna Lipjan, me të cilën ka kërkuar që të "Vërtetohet se e paditura P. D. e K-Dega në … dhe i padituri I.H nga fshati ..., kanë publikuar në rrjetet sociale deklarata të pavërteta ndaj paditësit I.A nga fshati ... dhe atë P... - Dega në…,, me datë 06.11.2017, në facebook, me titull "Kompрometohet fitorja e I.A, skandal me përmasa ndërkombëtare për mbështetësit financiar të fushatës elektorale të I.A", me datë 06.11.2017, "P..-dega në .... akuzon I.A e L.. se "bëri fushatë me para të dyshimta", me datë 07.11.2017, në facebook në kundër reagim me titull "karvani juaj ka mbetur në baltë, jeni të zhytur në krim dhe korrupsion", me datë 04.12.2017, në facebook me titull "Financuesi i fushatës së I.A, S.P arrestohet nga autoritetet Suedeze" dhe I.H, me datë 06.11.2017 në faqen e tij zyrtare me titull "Kompрometohet

fitorja e I.A, skandal me përmasa ndërkombëtare për mbështetësit financiar të fushatës elektorale të I.A" dhe me datë 07.11.2017, me titull "karvani i juaj ka mbetur në baltë, jeni të zhytur në krim dhe korrupsion", për të cilat kanë qenë në dijeni P... dega në ... dhe I.A, ose është dashur ta dinë se deklaratat e tilla janë të pavërteta, me të cilën kanë dëmtuar reputacionin e paditësit dhe kanë krijuar shqetësim të drejtpërdrejtë tek paditësi. Të obligohen të padituri, P... -Dega në … dhe i padituri I.H nga fshati ..., që brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, të bëjnë përgënjeshtrimin e deklaratave të veta të publikuara në rrjetet sociale, të obligohet e paditura P…-Dega në …, që paditësit I.A ..., në emër të shpërblimit të dëmit për përhapje të pavërtetave-shpifjeve në rrjetet sociale të përmendura si më lartë t'ia paguaj shumën prej 4,000.00 €, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga dt. 05.03.2021, e deri te pagesa definitive brenda, afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Të obligohet i padituri I.H nga fshati ..., që paditësit I.A nga fshati ..., Komuna e Lipjanit në emër të shpërblimit të dëmit për përhapje të pavërtetave-shpifjeve në rrjetet sociale të përmendura si më lartë, t'ia paguaj shumën prej 1,500.00 €, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 05.03.2021, e deri te pagesa definitive, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm."

Vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se mbi bazën e provave të administruara, të cilave ua ka falur besimin, gjykata erdhi deri tek përfundimi se e paditura P… - dega në ... dhe i padituri I.H, në rrjetet sociale si në al.I. të dispozitivit të aktgjykimit të saj, kanë publikuar të pavërteta ndaj paditësit I.A edhe pse e kanë ditur ose është dashur ta dinë se këto deklarata të publikuara janë të pavërteta, me çka kanë dëmtuar reputacionin e paditësit, i cili në zgjedhjet e 22.10.2017 është zgjedhur kryetar i Komunës së …. Lidhur me bazën ligjore të kërkesëpadisë gjykata ju ka referuar nenit 5 par1, 2,3 dhe 4, nenit 14 paragraf 1 dhe 16.1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr.02/L-65 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.24/01.05.2008).

Vendimin për kamatën e ka bazuar në nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 452 par.1 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) lidhur me tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Gjykatës së Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të rrjedhës së procedurës në këtë çështje kontestimore i rezultoi se paditësi në deklarimet e tij si në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor kishte pohuar fillimisht i padituri i parë P.. (P...) me datën 06.11.2017, nëpërmjet një reagimi me shkrim në faqen zyrtare të saj në rrjetin social Facebook dhe në po të njëjtën datë dhe po të njëjtën formë edhe i padituri i dytë I.H ka bërë shpifje ndaj paditësit kur kanë lansuar komunikatën për media të titulluar "*Kompromentohet fitorja e I.A",* duke e emërtuar komunikatën, *"skandal me përmasa ndërkombëtare për mbështetësit financiar të fushatës elektorale të I.A".* Më tej, po me të njëjtën datë të padituri nëpërmjet portalit Koha.net, linku i së cilës është përshkruar në padi, të njëjtën shpifje që e kanë bërë në rrejtin social të tyre, të njëjtën e kanë plasuar edhe në portalin Koha.net. Pastaj kishte pohuar se të padituri me datën 07.11.2017 kanë përsëritur veprimin e tyre shpifës duke e emërtuar komunikatën për media, drejtuar për paditësin të emërtuar si kundër reagim *"Karvani juaj ka mbetur në baltë"*, duke vazhduar komunikatën *"jeni zhytur në krim dhe korrupcion"*. Ndërsa me datën 04.12.2017, tani vetëm e paditura e parë bënë për herë të tretë shpifje ndaj paditësit, duke e emërtuar se *"financuesi i fushatës së I.A, arrestohet nga autoritetet suedeze".* Në këtë drejtim, me rastin e shqyrtimit të lëndës, Gjykatës së Apelit i rezulton se në rastin konkret nuk është provuar që të padituri kanë bërë shpifje me rastin e publikimit të komunikatave të lartpërmendura, për shkak se në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se të padituri kanë qenë burim i shpifjes dhe fyerjes ashtu siç e parasheh legjislacioni që rregullon këtë fushë.

Nga shqyrtimi i provave të theksuara më lartë dhe shqyrtimi i të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike, nuk ishte kontestues fakti se të padituri me datën

06.11.2017 dhe 07.11.2017, kishin publikuar artikujt e lartcekur në rrjetin e tyre social Facebook, ndërsa e paditura e parë edhe me datën 04.12.2017, kishte publikuar artikullin e përmendur më lartë, mirëpo kontestuese në këtë çështje ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht nëse artikujt në fjalë kishin përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj paditësit, si dhe nëse të paditurit janë autor të këtyre publikimeve, që për paditësin vlerësohen si shpifje, e që do të ishte bazë për të kërkuar të drejtën e kompensimit.

Nga artikujt e datës 06.11.2017, kjo gjykatë gjeti të paditurit kishin publikuar shkrime, me karakter kritik për paditësin, por këto publikime rezulton se janë marr nga shkrimet e gazetave elektronike, përkatësisht ishte marr nga artikulli i datës 02.11.2016, nga gazeta KosovaSot, i datës 02.11.2016, nga protali Sakte.net, i datës 09.03.2017, nga gazeta Koha Ditore dhe nga portali LipjaniNews.net, ndërsa i datës 05.11.2017, është nga artikulli në portalin UlpianaPress.

Duke qenë se padia e paditësit ka të bëjë me kërkesën për kompensimin e dëmit në emër të shpifjes dhe fyerjes, kjo gjykata gjeti se, në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCSHF - Ligji nr. 02/L-65), si ligj i veçantë, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil në rastin konkret. Në lidhje me këtë, me nenin 3 pika a), të LCSHF shprehimisht është përcaktuar se: *"Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër"*. Në pikën b) të këtij neni shprehimisht është përcaktuar: *"Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese"*. Në pikën c) është përcaktuar: *"Publikimi nënkupton përhapjen e shprehjes me shkrim ose gojarisht, përmes mediave të shkruara ose transmetuese apo përmes mjeteve tjera, shprehje të cilën e ka lexuar ose dëgjuar së paku një person i tretë*." Në pikën d) *"Publikues nënkupton personin i cili bënë publikimin.* Në pikën e) është përcaktuar: *"Autor nënkupton personin i cili kryen shprehjen në kuptim të pikës a dhe b të këtij neni*", ndërsa në pikën k) është përcaktuar: *"Çështje e interesit publik nënkupton çdo*

çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë".

Lidhur me përgjegjësinë për shpifje dhe fyerje, LCSHF në nenin 5 paragraf l ka përcaktuar: *"Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj*". Ndërsa, neni 5, paragraf 3 ka përcaktuar: *"Kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi i shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij*". Në paragraf 4 të po të njëjtit neni është paraparë: *"Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publikë mund të paraqesin kërkesë për kompensim e dëmit nga shpifja apo fyerja privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal". Ndërsa referuar nenit* 182 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashihet se: "*Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi të tërheq deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim".*

Për të vënë në dukje rëndësinë e lirisë së shprehjes, edhe Kushtetuta e Kosovës në nenin 40, ka paraparë Lirinë e Shprehjes, ndërsa në paragraf 1 të këtij neni ka përcaktuar se: "*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.",* kurse në paragraf 2, ka përcaktuar: *"Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza*

të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare". Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, qëndron fakti se të padituri, në faqet zyrtare të rrjetit social Facebook kanë publikuar artikujt kontestues, mirëpo bazuar në nenin 3 pika c) të LCSHF, publikimet e tilla nga të padituri, kanë qenë përhapje e shprehjes me shkrim përmes rrjetit social Facebook, e të cilat shprehje i ka lexuar ose dëgjuar së paku një person i tretë. Rrjedhimisht, sipas kësaj gjykate, thëniet e atilla drejtuar paditësit, në artikujt kontestues, janë më shumë në kontekst të qëllimit politik të zbehjes së imazhit ndaj tij, sesa tendencë për të kryer shpifje. Andaj, Gjykata duke vlerësuar kontekstin e diskutimit, gjen se opinionet e të paditurve për paditësin të përmendura si subjekt i artikujve, duhet të shihen në sfondin e polemikave politike në mes tyre si përkrahës apo kundërshtarë politik dhe jo medoemos si çështje faktike. Në këtë kuptim, duke u bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ, Gjykata bën dallimin në mes të fakteve dhe opinioneve, apo gjykimit të vlerave. Lidhur me këtë, GJEDNJ ka theksuar se: '*duhet bërë një dallim i qartë në mes të fakteve dhe gjykimit të vlerave. Ekzistenca e fakteve mund të dëshmohet, ndërsa vërtetësia e gjykimeve të vlerave nuk mund të provohet. Për sa i takon gjykimeve të vlerave, ky kriter për të provuar vërtetësinë e një gjykimi të vlerave është i pamundur të përmbushet dhe shkel vet lirinë e mendimit'* (Aktgjykimi në rastin *Lingens kundër Austrisë, i* datës 08 Korrik 1986, parag. 46; Aktgjykimi *Jerusalem kundër Austrisë,* i datës 27 Shkurt 2001).

Gjykata ankimore vlerëson se në rastin konkret, pikëpamjet e të paditurve në artikujt kontestues paraqesin vlerësime personale të tyre dhe këto deklarime janë opinione dhe jo fakte. Së këndejmi, duke qenë se i padituri i dytë, në cilësi të gazetarit, mund të ketë mendim të caktuar qoftë kundërshtues apo kritik për veprimtarinë e paditësit, gjykata është e mendimit se kjo duhet të shihet si opinion i lirë i tij dhe nuk mund t'i nënshtrohet barrës së të provuarit. Andaj, kërkesa që të padituri - qoftë e paditura e parë në cilësi të subjektit politik, apo i padituri i dytë në cilësi të kundërshtarit politik - të provojnë të vërtetën e një opinioni, do të

paraqiste shkelje në të drejtën për të dhënë ide dhe informacione, konform Nenit 10 të Konventës. Në këtë drejtim, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në nenin 10 paragraf 1 përcakton se: *"Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv".* Përveç kësaj edhe neni 7 i ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes përcakton se: "*Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla".* Në lidhje me këtë referuar, rëndësisë së zgjedhjeve lokale apo të përgjithshme që kanë për një shtet demokratik dhe interesit të publikut që ka për të zgjedhurit e tyre dhe vet procesin që i paraprinë këtyre zgjedhjeve, atëherë rezulton se në rastin konkret edhe konsiderohet normale dhe e rregullt pasja e interesit publik për këtë çështje *(se çka është interesi publik e përcakton dispozita e nenit 3, pika k e LCSHF-së),* e që jo në çdo rast edhe mund të ketë edhe përgjegjësi për personat apo subjektet të cilat i plasojnë informatat e tilla. Ndërsa në lidhje me këtë edhe dispozita e nenit 8 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes e përcakton qartë se: *"Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të cilën gjykata e ka vlerësuar të jetë një deklarim i opinionit, me kusht që opinioni të jetë shprehur me qëllim të mirë dhe të jetë bazuar në ndonjë fakt".*

Për të vlerësuar nëse deklarimet e të paditurve përbëjnë shpifje, kjo gjykatë, mori parasysh edhe pozicionin dhe angazhimin e paditësit në jetën publike, respektivisht politike apo publicitetin e tij (Shih rastin e GJEDNJ *Axel Springer AG kundër Gjermanisë,* i datës 7 Shkurt 2012, parag. 89). Vlen të theksohet për rastet kur një botim ka të bëjë me individë të caktuar, siç janë politikanët, zyrtarët publik ose figura tjera publike, GJEDNJ është shprehur se këta individë *"duhet të presin që të t'u nënshtrohen kufijve më të gjerë të kritikës së pranueshme".* Sipas

GJEDNJ *"kufijtë e komentit publik janë më të gjerë nëse është e përfshirë një figurë publike, duke qenë se ai e ekspozon veten ndaj kontrollit publik në mënyrë të pashmangshme dhe të vetëdijshme dhe për rrjedhojë, duhet të shfaqë një shkallë posaçërisht të lartë tolerance"* (shih rastin e GJEDNJ *Kulis kundër Polonisë,* Aktgjykimi i datës 18 Mars 2008, paragrafi 47).

Andaj, Gjykata e Apelit vlerëson se liria e shprehjes është një e drejtë kryesore e njeriut, në veçanti për arsye të rolit të saj themelor në mbështetje të demokracisë. Neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtën e lirisë së shprehjes si vijon: *"Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinioneve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë".* Gjithashtu liria e shprehjes mbrohet në të tri sistemet rajonale të të drejtave të njeriut, nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa Evropiane), nenin 13 të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 9 të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve. Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut, në veçanti për arsye të rolit të saj themelor në mbështetje të demokracisë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në rastin *"Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar",* 7 dhjetor 1976, Aplikimi Nr.5493/72, paragrafi 49, ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se: *"Liria e shprehjes përbën një ndër bazat themelore të shoqërisë (demokratike), një ndër kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu"*. Në anën tjetër, Gjykata Evropiane i jep vlerë të veçantë debatit politik dhe debatit për çështje të tjera me rëndësi publike. Kështu që në rastin "*Dichan dhe të tjerë kundër Austrisë",* shënimi 13, paragrafi 38, GJEDNJ ka theksuar se çdo deklaratë e bërë gjatë zhvillimit të këtij debati mund të kufizohet vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme: *"Ka pak vend për kufizime të fjalimeve politike ose debateve për çështje me interes publik".*

Si rrjedhojë, për Gjykatën e Apelit, nuk ishte kontestues fakti se paditësi hyn në kategorinë e figurave publike, përkatësisht politike në Kosovë. Kjo nga fakti se është fakt i njohur se paditësi është i angazhuar në jetën

politike si anëtar i L.., si dhe ka ushtruar në të kaluarën dhe ushtron aktualisht pozitën e kryetarit të komunës së L…, gjë që për gjykatën paraqet fakt të mjaftueshëm se paditësi hyn në domenin publik dhe si i tillë duhet të tregoj një shkallë më të lartë të tolerancës në raport me diskutimin publik për të apo veprimtarinë e tij politike. Andaj, nga sa u theksua më lartë, e duke marr parasysh se kjo gjykatë konstatoi se deklarimet e të paditurve paraqesin opinione rreth pozicionit të paditësit lidhur me situatat politike, përkatësisht në kohë të zgjedhjeve, pra rreth aktivitetit të tij në jetën politike si kandidat në atë kohë për kryetar të komunës së L…, gjykata ankimore vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e paditësit se deklarimet e të paditurve, respektivisht artikujt e publikuar paraqet shpifje. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shpifje, pasi që artikujt kontestues paraqesin gjykim të vlerave dhe opinionin e të paditurve rreth veprimtarisë politike të paditësit, përkatësisht në kuadër të aktivitetit të tij politik për zgjedhjet komunale të datës 22.10.2017, duke hyrë kështu në kuadër të diskutimit politik dhe të vlerësimit politik të paditësit.

Përfundimisht, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nga artikujt kontestues që e i referohet paditësi, të lexuar si tërësi del se nuk është provuar fakti se artikujt e publikuar nga ana e të paditurve, e të huazuara nga portalet e ndryshme të cekura si më lartë, përmbajnë ndonjë element të shpifjes apo fyerjes dhe rrjedhimisht nuk është provuar se përmes këtyre publikimeve paditësit i është shkaktuar ndonjë dëm material. Është vlerësim i gjykatës së shkallës së dytë se në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 3 të LCKSHF, kundër shpifjes dhe fyerjes, përkatësisht përkufizimeve për shpifjen për faktin se meqenëse ka rezultuar se të paditurit në artikujt e publikuar i janë referuar burimeve të gazeta elektronike-portaleve, kjo nënkupton se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me elemente të shpifjes. Si rrjedhojë e kësaj publikimi i artikujve të tillë nga të paditurit, nuk bartë pasoja të përgjegjësisë civile për kompensimin e dëmit material, ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar se me publikimin e artikujve të tillë, paditësit i është shkaktuar ndonjë dëm.

Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Qëndrimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është pranuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me vlerësim se i njëjti bazohet në zbatimin e drejtë të së drejtës materiale.

Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes në nenin 3 paragrafi 1 pika a) përcakton se: Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër. I njëjti nen i ligjit të njëjtë paragrafi nën pikën b) theksohet se: Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese. I njëjti ligj në nenin 2, theksohet se, ky ligj do të interpretohet në mënyrën e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij e maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura dhe bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga e cila rezulton se të padituri informacionet që kanë publikuar, ose të paktën një pjesë të atyre informacioneve, i kanë mësuar nga mediat elektronike dhe portaleve të tjera, dhe kjo nuk mund të ju vihet në barrë se e kanë ditur ose se janë detyruar ta dinë se bëhet fjalë për informacione të pavërteta. Përpos të cekurave, në rastin konkret duhet të kihet parasysh se bëhet fjalë për subjekte politike, dhe se kufijtë e kritikës së lejueshme janë shumë më të gjera sesa kur bëhet fjalë për individë privat. Kjo sepse personat e angazhuar në politikë ose profesione të tjera që janë të rëndësishme për publikun, me vetdëshirë dhe me vetëdije kanë pranuar që veprimet e tyre të analizohen nga media, i gjithë publiku, madje edhe nga kundërshtarët e tyre politikë, dhe për këtë arsye këta persona duhet të tregojnë një shkallë më të madhe tolerance. Pozicioni i Kryetarit të Komunës është pozicioni më i lartë politik në vetëqeverisjen lokale dhe e njëjta ndikon dhe krijon në masë të madhe gjendjen në një komunë, andaj është e pritshme që këta persona të shfaqen shpesh në media dhe në rrjetet sociale.

Gjithashtu, në këtë rast konkret, duhet të merret parasysh edhe periudha kohore kur janë botuar tekstet e lartpërmendura, e bëhet fjalë për periudhën menjëherë pas votimit dhe pas përfundimit të fushatës zgjedhore. Gjatë fushatës zgjedhore dhe menjëherë pas saj, kufijtë e shprehjes së opinioneve politike dhe madje edhe të gjykimeve vlerësuese për kundërshtarët politikë janë përgjithësisht më të gjera dhe shpesh negative, sepse secili pjesëmarrës në procesin zgjedhor dëshiron të fitojë favorin e sa më shumë votuesve në luftën politike për pushtet. Prandaj, është mjaft reale të pritet që partitë politike dhe udhëheqësit e tyre, nëse tashmë kanë pranuar të marrin pjesë në fushatën parazgjedhore, do të duhet të durojnë edhe kritika të pajustifikuara, duke përfshirë shprehje negative dhe fyese.

Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës është e qëndrimit se publikimet konkrete të të paditurve mund të përfshihen në nenin 7 të Ligjit Kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe se nuk mund të konsiderohet se në këtë mënyrë të drejtat personale të paditësit janë shkelur në masën që do të zbatohej në nenin 183 të LMD-së, dhe detyrimin e të paditurve që paditësit t'i paguajnë kompensim monetar në mënyrë që të kompensojnë këtë lloj dëmi jomaterial.

Aktvendimi Rev.nr.339/2023, datë 29.11.2023

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja M.S nga Prishtina, më datë 18.06.2010, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqit padi, kundër të padituërs, I.. R.. C.. G.. "K.S", në Prishtinë, te Z..., me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial në emër të shpifjes dhe fyerjes, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në precizimin e padisë. Ndërsa, me datë 05.12.2012, paditësja M.S nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të padituërs I.. R.. C.. G.. "K.S", në Prishtinë, te Z..., në Prishtinë, te Zona Industriale, me pronar R.K dhe Kryeredaktore M.K nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial në emër të shpifjes dhe fyerjes, për gjatë viteve 2011 dhe 2012, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në precizimin e padisë.
Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.627/2014 të datës 06.05.2019, është vendosur:

Miratohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses M.S nga Prishtina. Detyrohet e paditura NGB "K.S", në Prishtinë, me pronar R.K dhe kryeredaktore M.K, në mënyrë solidare paditëses M.S nga Prishtina, t`ia paguajnë dëmin jomaterial për shpifje dhe fyerje të bëra nga data 13.04.2010 e deri në vitin 2016, ashtu që për shpifje të paguajnë shumën 200,000 €, ndërsa për fyerje 50,000 €, të gjitha këto me kamatë si për mjetet e deponuara nëpër bankat private mbi një vit pa destinim të caktuar nga data 13.04.2010 e deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme 3,572 €, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e miratuar e në lartësi deri në 700,000 €, refuzohet si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5765/19, të datës 03.05.2023, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht ankesa e të paditurës NGB "K.S", me seli në Prishtinë, me pronar R.K dhe M.K kryeredaktore, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.627/2014 i datës 06.05.2019, ashtu që çështja gjykohet si vijon: Vërtetohet se e paditura NGB "K.S", me seli në Prishtinë përmes publikimit të artikujve gazetaresk, me përmbajtje të pavërteta - shpifëse dhe fyese, në të përditshmen "K.S", gjatë periudhës prej datës 13.04.2010 e deri në vitin 2016, ka shpifur për integritetin dhe fyer personalitetin e paditëses M.S nga Prishtina. II. Detyrohet e paditura NGB "K.S", me seli në Prishtinë, me pronar R.K dhe kryeredaktore M.K, që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, për vuajtjet e përjetuara nga shpifjet dhe fyerjet e bëra, paditëses M.S, solidarisht, t`ia kompensojnë shumën prej 18,000 €, me kamatën e cila do të llogaritet si për lartësinë për deponimet që aplikojnë bankat vendore të afatizuara për periudhë një vjeçare pa destinim të caktuar nga data 06.05.2019 e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi të shumës prej 3,572.40 €, ndërsa refuzohet si e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtej shumave të gjykuara e deri në shumat e kërkuara.

Vlerësimit e gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se sa i përket shumës se miratuar nga ana e gjykatës dhe atë për shpifje shumën 200,000 € dhe për fyerje

shumën 50,000 €, vendosi pasi që vlerësoi se dëmi jomaterial është shkaktuar nga ana e të paditurës duke vlerësuar se dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga shkrimet në vazhdimësi që nga viti 2010 e deri në vitin 2016, duke vazhduar edhe pas vitit 2016, kanë qenë të tilla sa që kanë cenuar rëndë integritetin dhe autoritetin e paditëses. Cenimi i integritetit dhe autoritetit ka qenë i tillë sa që ka shkaktuar tronditje psiko-emocionale, e cila tronditje ka shkaktuar ndryshime në rrjedhjen normale të jetës së paditëses deri në atë masë sa që te paditësja herë pas here janë shfaqur mendime suicidale, pasi që të gjitha akuzat dhe shkrimet janë bërë përmes mediumeve publike që ka pasur shtrirje të gjerë në publik.
Sa i përket shumës 50,000 € për fyerje, ka vendosur për këtë shumë, duke pasur për bazë që pala e paditur nuk ka hedhur poshtë informacionet kundër paditëses, edhe pse me vendimin e Këshillit të Mediave të shkruara Ref. .../ - 2010 të datës ..., ka qenë e detyruar ta bëjë. Si dhe në vazhdimësi për vite të tëra ka përsëritur informacionet fyese dhe atë përmes mediumit publik. Gjykata gjatë gjykimit të shumës së dëmshpërblimit për shpifje kundër të paditurës, ka vlerësuar edhe qëndrimin e Gjykatës për të Drejtat e Njeriut, sa i përket proporcionalitet në mes shumës së miratuar në lidhje me dëmtimin e shkaktuar ndaj reputacionit të paditëses duke ardhur në përfundim që shuma e miratuar është e drejtë. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 154, 184, 200, të LMD-së, nenit 5, 14, dhe 15 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, nenit 8 dhe 10 të Konventës Evropiane për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut, dhe nenit 323 të LPK-së. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Në arsyetim të aktgjykimit Gjykata e Apelit ka theksuar se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar. Janë vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet ankimore të përfaqësuesit të

autorizuar të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Ndërsa kemi zbatim të gabuar të drejtës materiale, për shkak të shumës së gjykuar në emër të kompensimit të dëmit për shkak të shpifjes, ku për këto arste ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në dispozitiv të aktgjykimit, e kanë detyruar të padituri në kompensimin e dëmit në mënyrë solidare, mirëpo nuk kanë dhënë arsye se në rastin konkret përgjegjësia e të paditurve a mundet me qenë solidare, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Supreme të Kosovës, këtu përgjegjësia nuk mundet me qenë solidare, pasi veprimet duhet të jenë të individualizuara, dhe shkalla e përgjegjësisë nuk mundet me qenë e njëjtë, andaj edhe kompensimi duhet me qenë i individualizuar sikurse veprimi i tyre. Përveç kësaj pronari dhe kryeredaktorja në këtë rast me padi të precizuar si në parashtresat për precizimin e padisë, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk janë të përfshirë si palë e paditur.
Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, 182 paragrafi 2 pika k) e lidhur me nenin 73 dhe 76 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Në këtë kontekst Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se sipas Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se ligji në fjalë interpretohet në mënyrë e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij, maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Kushtetutën si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Vendimi në fjalë duhet të jetë në përputhje të plotë me frymën e vendimeve/praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg, sipas të cilës praktikë gjykatat vendore në çdo rast që kanë të bëjë me mediat, në raport me shpifjet apo fyerjet e pretenduara, kërkon kujdes maksimal të shqyrtimit para vendosjes, për arsye se kundër efekti i masave në raport me mediat nënkupton cenimin e frymës së lirisë së shprehjes dhe operimit të tyre.

Për caktimin e lartësisë së kompensimit gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë dhe psikologjisë për të përcaktuar dhimbjet psikike që i ka pësuar paditësja si pasojë e shpifjes dhe fyerjes, mirëpo në këtë rast por edhe në raste të ngjashme gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendos në bazë të njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat dhe atë: mënyrën e kryerjes së shpifjes apo fyerjes, pastaj veprimet e ndërmarrura nga pala e paditur me qëllim të zvogëlimit të dëmit, demanti apo tërheqja e informacionit nëse është bërë, kërkim falja nëse është shprehur, të ardhurat e personave që pretendohet se kanë kryer veprën e shpifjes, dhe krejt në fund të ketë kujdes që kompensimi më tepër duhet me qenë satisfakcion moral.

Vendimet e gjykatës në secilin rast që i referohen shpifjes apo fyerjes, duhet të jetë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e assesi përmes këtyre vendimeve të krijohet klima e frikës apo presionit të cenimit apo kufizimit të lirisë së shprehjes në raport

me gazetarët, për arsye se kjo bie në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së. Me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijojnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj ”. Në këtë kontekst fakti që duhet të merren parasysh të hyrat financiare të paditurve me rastin e caktimit të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga shpifja apo fyerja, vërteton faktin se përgjegjësia nuk mundet me qenë solidare, por individuale, edhe pse personat e theksuar në nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, munden me qenë bashkëkryes, mirëpo nuk mund të kenë përgjegjësi solidare.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë arsyetuar lartësisë e kompensimit në raport me secilin të paditur, pra sa kanë qenë të hyrat e gazetës, pastaj kompensimi a është adekuat, por jo të arsyetohet në raport me lartësinë vetëm duke iu referuar njërës të paditur, kur kemi më shumë se një të paditur. Asnjë arsyetim nuk është dhënë në raport me lartësinë e kompensimit për pronarin dhe kryeredaktoren, sa kanë qenë të hyrat e tyre në kohën e shkrimit, lartësia me të njëjtin a është adekuate, si do të mund të ndikon lartësia e të njëjtit në cenimin apo kufizimin e lirisë së shprehjes, interesit publik të informimit nga ana e gazetarëve, dhe se vet konstatimi se ka pasur shpifje apo fyerje dhe një kompensim më tepër moral a do të mund të arrinte efektin e synuar dhe a është në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së.

Gjykata në secilin rast të gjykimit në raport me shpifjen apo fyerjen duhet të balancojë që në njërën anë të kujdeset që të mbrohet dinjiteti dhe personaliteti i individit, që gazetarët dhe të gjithë personat tjerë që ushtrojnë veprimtari mediale të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore duke respektuar në maksimum kodin e etikës gazetareske, mirëpo në anën tjetër duhet të ketë në konsideratë interesin publik për figura publike, nevojën e informimit dhe lirisë së shprehjes në atë mënyrë që asnjë vendim të mos ndikoj në cenimin e funksionimit të lirisë së shprehjes si një e drejtë po ashtu e garantuar me Konventë. Në rastet që i referohen mbrojtjes së personalitetit/dinjitetit të individit dhe lirisë së shprehjes, në një masë të caktuar vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rekomandojnë që lehtësisht në një masë mund të

tejkalohet liria e shprehjes edhe në dëm të individit (personaliteti publik), por kjo duhet të përbën me të vërtetë interes publik, pra nevojën që publiku të informohet, por duhet me qenë të qartë që kjo assesi nuk nënkupton cenim dhe degradim të rëndë të personalitetit. Si pasojë e shkeljeve të konstatuara si më lartë, aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët është dashur të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Të gjeturat nga praktika gjyqësore për raste e tilla

Nga praktika e deritanishme gjyqësore për raste të tilla, Gjykata Supreme ka vërejtur se gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë trajtojnë çështje të padive të cilat për objekt kanë kompensimin e demit material dhe jo material për shkak të shpifjes, si dhe tërheqjen e publikimeve, apo ndalimin e përhapjes së tyre me shprehjet shpifëse, përmes caktimit të urdhëresave paraprake. Mirëpo, në shumicën e rasteve, rezulton se gjykatat e instancës më të ulët, për çështjen e vendosur kryesisht japin një arsyetim të përgjithshëm se në këtë rast përmbushen apo jo kriteret ligjore sipas LCSHF, për tu konsideruar deklaratat apo publikimet e tilla si shpifje, pa dhënë arsye konkrete dhe në bazë të dispozitave ligjore që rregullojnë çështjen e shpifjes, si dhe të njëjtave në masë të madhe i mungon mbështetja e aktgjykimit në praktikën e GJEDNJ.

Si rrjedhojë, referuar aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi shpifjen si më lartë, rezulton se kjo e fundit në masë të madhe ka trajtuar revizionet e palëve, duke u mbështetur në legjislacionin vendor dhe praktikën e GJEDNJ. Si rezultat i kësaj, nga aktgjykimet e Gjykatës Supreme të përshkruara si më lartë, rezulton se kjo e fundit ndër të tjera ka sqaruar rëndësinë e balancës midis të drejtave në konflikt, duke e konsideruar si detyrë thelbësore gjetjen e ekuilibrit midis nenit 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (liria e shprehjes) dhe nenit 36 të saj (e drejta për privatësi dhe reputacion). Përveç kësaj, Gjykata Supreme, ka theksuar se liria e shprehjes nuk është absolute, por kufizohet kur dëmton dinjitetin dhe reputacionin e individit.

Në vijim të kësaj, Gjykata Supreme në aktgjykimin Rev.nr.77/24, ka sqaruar rëndësinë dhe dallimin që duhet të bëhet mes faktit dhe opinionit, duke ndjekur standardet evropiane të cilat mbështetën në praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Në lidhje me këtë, në këtë aktgjykim konstatohet se faktet që janë të rreme dhe dëmtojnë reputacionin sjellin përgjegjësi, ndërsa opinionet dhe kritikat (veçanërisht ndaj figurave publike) gëzojnë mbrojtje më të gjerë. Me këtë analizohet edhe roli i figurave publike, duke potencuar faktin se politikanët dhe personat publikë kanë një "prag më të lartë tolerance" ndaj kritikave. Përveç kësaj, Gjykata Supreme ka potencuar faktin se interesi publik prevalon në rastet kur diskutohet mbi çështje të rëndësishme shoqërore, politike ose qeverisëse. Si fakt i rëndësishëm cekët ajo se Gjykata Evropiane i jep vlerë të veçantë debatit politik dhe debatit për çështje të tjera me rëndësi publike (interes publik). Kështu që në rastin "*Dichan dhe të tjerë kundër Austrisë"*, shënimi 13, paragrafi 38, GJEDNJ ka theksuar se çdo deklaratë e bërë gjatë zhvillimit të këtij debati mund të kufizohet vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme: *"Ka pak vend për kufizime të fjalimeve politike ose debateve për çështje me interes publik".*

Në anën tjetër, Gjykata Supreme në aktgjykimet e saj, ka potencuar edhe rëndësinë që duhet ti kushtojnë gjykatat e instancës më të ulët me rastin e vendosjes së padive për shpifje, të drejtës për reagim dhe korrigjim, e cila parashihet me nenin 13 të LCSHF. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme ka theksuar rëndësinë e së drejtës për reagim si një mjet më pak kufizues dhe më i shpejtë për mbrojtjen e reputacionit, krahas kërkesave për kompensim financiar. Përveç kësaj, një çështje tjetër me rëndësi e trajtuar nga Gjykata Supreme është edhe detyrimi i palës së dëmtuar për të zbutur dëmin, para se të dorëzon padi në gjykatë për mbrojtje nga shpifja. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme ka potencuar parimin se pala e dëmtuar nuk mund të mbetet pasive, ndërsa nëse nuk ndërmerr hapa për të zbutur pasojat e shpifjes, kjo ndikon më pas në vlerësimin dhe gjykimin e lartësisë së kompensimit.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme ka analizuar dhe vlerësuar rëndësinë që gjykatat e instancës më të ulët duhet ti kushtojnë parimit të proporcionalitetit në kompensimin e dëmit material apo jo material, me

rastin e gjykimit të padive për shpifje, sigurisht kur paraprakisht provohet fakti i shpifjes, si dhe kur nuk përmbushen kushtet ligjore sipas dispozitave të LCSHF, për përjashtimin nga përgjegjësia. Në raste të tilla, është theksuar rëndësia që kompensimi për dëmin moral dhe material duhet të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar. Si rrjedhojë e kësaj, rezulton se Gjykata Supreme ka potencuar edhe rëndësinë që duhet ti kushtojnë gjykatat e instancës më të ulët kësaj çështje, duke shmangur kompensimet e tepruara financiare, për të mos shkaktuar efektin frenues mbi lirinë e shprehjes, duke ndjekur dhe zbatuar në këtë rast standardet e GJEDNJ-së.

Po ashtu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, përkatësisht aktgjykimeve të përshkruara më lart, rezulton se harmonizimit të kësaj praktike me jurisprudencën evropiane të GJEDNJ i është kushtruar rëndësi e veçantë. Në këto aktgjykime, Gjykata Supreme e Kosovës është mbështetur në praktikat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut psh, rastet Lingens kundër Austrisë, Axel Springer kundër Gjermanisë, Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar, etj. Kjo me qëllim që të sigurohet se e drejta vendore të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat garantohen nga GJEDNJ, përmes aktgjykimeve të saj. Si përfundim, gjykatat e instancës më të ulët, e me theks të veçantë Gjykata Supreme si autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë, kanë një rol vendimtar në garantimin e balancimit në mes të lirisë së shprehjes dhe të drejtës për privatësi, duke vendosur standarde të arsyetuara dhe të harmonizuara me praktikat evropiane.

Zenel Leku

Vlera e objektit të kontestit në praktikën gjyqësore: rastet, mangësitë, pasojat juridike dhe sugjerime për unifikimin e praktikës

1. Hyrja

Vlera e objektit të kontestit paraqet një ndër elementet më të rëndësishme të procedurës kontestimore civile, pasi ndikon drejtpërdrejt në trajtimin procedural të çështjes nga gjykatat, përfshirë pagesën e taksës gjyqësore, lejueshmërinë e mjeteve juridike, si dhe të drejtën për qasje në gjykatë. Objekt i kontestit është vetë kërkesa juridiko-civile e paditësit – siç është kërkesa për kompensim, vërtetim të pronësisë, anulim kontrate apo çdo kërkesë tjetër materiale – ndërsa vlera e këtij objekti përfaqëson interesin pasuror për të cilin kërkohet mbrojtje juridike.

Edhe pse Ligji për Procedurën Kontestimore e përcakton obligimin e paditësit për të caktuar vlerën e objektit të kontestit, praktika gjyqësore në Kosovë ka treguar qasje të ndryshme në interpretim dhe zbatim të këtij obligimi. Kjo ka krijuar paqartësi dhe pasiguri juridike, veçanërisht në kontekstin e lejueshmërisë së revizionit si mjet juridik i jashtëzakonshëm, ku vlera e objektit të kontestit merret si kriter vendimtar për të lejuar apo jo revizionin.

Në këtë punim, trajtohet në mënyrë të detajuar baza ligjore dhe praktika gjyqësore lidhur me vlerën e objektit të kontestit, duke u ndalur posaçërisht në rastet e ndryshimit të padisë, bashkëndërgjyqësisë, kontesteve pa kërkesa në të holla, si dhe ndikimit të moscaktimit ose caktimit jo të saktë të kësaj vlere në të drejtën për qasje në gjykatë. Po ashtu, analizohet roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e dispozitave përkatëse të LPK-së, si dhe qasja e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në vlerësimin e kufizimeve *ratione valoris* në raport me të drejtën për gjykim të drejtë.

Qëllimi i këtij punimi është të identifikojë mospërputhjet në praktikën gjyqësore, të theksojë rëndësinë e përcaktimit të saktë të vlerës së objektit të kontestit dhe të japë rekomandime për harmonizimin e qasjes

gjyqësore në mënyrë që të garantohet siguria juridike dhe e drejta për qasje efektive në drejtësi.

2. Baza ligjore

Vlera e objektit të kontestit është element i padisë ashtu siç është përcaktuar me nenin 253 paragrafi 1, pika d) e LPK-së, ndërsa me nenin 30.1 të këtij ligji është përcaktuar se: "*Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore"* Mirëpo pavarësisht kësaj mënyre të rregullimit, praktika gjyqësore vlerën e objektit të kontestit nuk e konsideron si element të domosdoshëm të padisë, pasi që paditësit nuk i kthehet në plotësim dhe përmirësim padia nëse nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit, ose në rastin kur vlerën e ka caktuar tepër të lartë apo shumë të vogël. Një gjë e tillë rezulton edhe nga dispozita e nenit 36 i LPK-së, ku është përcaktuar se: "*Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të këtillë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi*"

Referuar dispozitave të nenit 30 par.1 dhe par.2 të LPK-së, si vlerë e objektit të kontestit duhet të merret vetëm vlera e kërkesës kryesore, por jo edhe kërkesat aksesore si: kamata, shpenzimet e procedurës, penalitetet e kontraktuatra dhe kërkesat tjera aksesore, nëse nuk përbëjnë kërkesë kryesore. Pra nëse këto kërkesa paraqiten bashkë me kërkesën kryesore nuk do të llogariten në vlerë të kontestit, ndërsa nëse paraqiten si të pavarura atëherë do të llogariten në përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit.

Me nenin 32, par. 1 të LPK-së është përcaktuar se: "*Në qoftë se një padi e ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështetën në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit*

caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave", ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: "*Në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë ngritur kundër disa të paditurve, vlera e objektit te kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç*" Këto dispozita do të elaborohen në vijim në ndërlidhje me nenet 264 dhe 268 e që kanë të bëjnë me bashkëndërgjyqësin, ndërsa fokusi do të jetë në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe të Gjykatës Kushtetuese lidhur me atë se si trajtohet vlera e objektit të kontestit të rasti i bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë.

Ndërsa kur kemi të bëjmë me konteste ekonomike që hyn në juridiksionin e Gjykatës Komerciale, Ligji për Gjykatën Komerciale (LIGJI NR. 08/L-015), me nenin 14 ka paraparë Mjetet e Jashtëzakonshme Juridike, ku me paragrafin 1. të këtij neni është përcaktuar se: "*Lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës zbatohen ligjet procedurale në fuqi*", ndërsa me paragrafin 2 është përcaktuar se: "*Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, revizioni lejohet në kontestet me kusht që vlera e kontestit të jetë jo më pak se 30.000 (tridhjetëmijë Euro)*"

3. Roli i gjykatës së shkallës së parë në caktimin e vlerës së objektit të kontestit

Gjykata nuk ndërhyn në caktimin e vlerës se objektit të kontestit në situatën kur kërkesa e paditësit ka të bëjë me kompensimin e dëmit apo ndonjë dhënie, kjo, pasi që vlerë e objektit të kontestit konsiderohet ajo që ka kërkuar pala paditëse me kërkesëpadi. P.sh nëse paditësi kërkon kompensimin e dëmit material të shkaktuar në automjet dhe lartësia e dëmit të shkaktuar është në shumën 2.500€, atëherë si vlerë e kontestit konsiderohet shuma që është kërkuar.

Edhe në këto konteste në disa raste kanë ndodhur keqkuptime në lidhje me atë se cila është vlera e objektit të kontestit që duhet merret për bazë në vendosjen lidhur me lejimin apo jo të revizionit si mjet juridik i jashtëzakonshëm, dhe kjo ka ndodhur në rastet kur pala paditëse fillimisht kërkesën për kompensim e ka pasur nën vlerën prej 3000€, dhe për këtë

shumë e ka paguar taksën gjyqësore, por që ndërkohë gjatë procesit gjyqësor e ka ndryshuar padinë sepse ka kërkuar shuma më të larta, p.sh, shumën prej 15.000€. Roli i gjykatës së shkallës së parë në këtë rast është që të marr vendim të veçantë për të lejuar apo jo ndryshimin e padisë, dhe në rast se e lejon ndryshimin e padisë, atëherë vlerë e objektit të kontestit konsiderohet kërkesa sipas padisë së ndryshuar, por që pala paditëse duhet ta paguaj diferencën e taksës gjyqësore nga vlera e padisë fillestare. Nëse pala paditëse nuk ka paguar diferencën e taksës dhe gjykata megjithatë ka proceduar me rastin, çështja që është ngritur në praktikë gjyqësore është, se, me rastin e lejimit të revizionit, cila shumë duhet të merret për bazë, ajo e padisë fillestare apo ajo e padisë së ndryshuar. Si dhe situatat kur pala paditëse ka kërkuar kompensimin e dëmit pa e precizuar shumën në kërkesën fillestare, ndërsa për këtë kërkesë ka paguar taksën gjyqësore në shumën e caktuar nga gjykata sipas udhëzimit administrativ për taksat gjyqësore, mirëpo ndërkohë gjatë procesit ka precizuar kërkesën ku ka kërkuar shumën konkrete p.sh 50.000€. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesën e paditësit, por pa e përmendur në dispozitiv të vendimit shumën që e ka precizuar, ndërsa kur pala paditëse ka paraqitur revizion, Gjykata Supreme lejueshmerinë e revizionit e ka lidhur me lartësinë e taksës që pala paditëse e ka paguar, pa e trajtuar çështjen e precizimit të kërkesës së bërë në seancë kryesore.

Nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së rezulton se në këto raste duhet të ndryshoj praktika e Gjykatës Supreme sa i përket vlerësimit të lejueshmërisë së revizionit në raport me vlerën e objektit të kontestit. Në rastin e parë për vlerë të objektit të kontestit duhet të merret vlera e padisë së ndryshuar, pavarësisht faktit se pala paditëse ka paguar apo jo taksën për diferencë, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë me kohë masat e parapara për çështjen e mos pagesës së taksës, andaj në fazën e shqyrtimit të revizionit kjo nuk mund të jetë pengesë dhe pala të privohet nga mundësia e trajtimit të rastit të saj në gjykatë. Ndërsa në rastin e dytë, Gjykata Supreme nuk është dashur të hedh revizionin duke ju referuar lartësisë së taksës gjyqësore të paguar nga pala paditëse, kjo pasi që pala paditëse ka precizuar kërkesën në seancë gjyqësore duke e përcaktuar edhe vlerën e kërkesës, ashtu siç është përcaktuar me nenin

30.1 të LPK-së. Kjo çështje tashmë është qartësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës[167]

Situate është më ndryshe në kontestet ku pala paditëse nuk ka kërkesë në të holla por që kërkon p.sh vërtetimin e pronësisë në paluajtshmëri, anulim kontrate, lirim paluajtshmerisë, etj. Në këto raste pala paditëse ka për detyrë që ta caktoj vlerën e objektit të kontestit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 30 të LPK-së. Ndodh që në këto konteste pala paditëse e cakton vlerën e kontestit në shumë të ulët p.sh, kërkon vërtetimin e pronësisë në banesën që gjendet në Prishtinë dhe si vlerë të kontestit shënon shumën prej 1000€, mirëpo, në këtë rast dhe në rastin kur vlera e kontestit nuk është caktuar fare, padia nuk kthehet në plotësim dhe përmirësim me qëllim të caktimit të vlerës së kontestit apo caktimit të saktë të saj ngase gjykata ka rol aktiv që ta rregulloj këtë. Autorizimet e gjykatës dalin nga neni 36 i LPK-së, ku gjykata zyrtarisht apo sipas prapësimit të palës e cakton vlerën e kontestit kur ajo nuk është caktuar apo më rastin kur është treguar vlera e kontestit e cila në mënyrë të dukshme ndryshon (si tepër e lartë apo shumë e vogël) nga vlera e vërtetë e objektit të kontestit. Në rast të këtillë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi.

3.1. Pasojat e mos caktimit ose caktimit në mënyrë jo të duhur të vlerës së objektit të kontestit

Nëse gjykata e shkallës së parë nuk vepron sipas autorizimeve që burojnë nga neni 36 i LPK-së, pra zyrtarisht apo sipas prapësimit të palës nuk e cakton vlerën e kontestit kur ajo nuk është caktuar nga pala apo më rastin kur është treguar vlera e kontestit por është tepër e lartë apo shumë e vogël, atëherë ky lëshim i gjykatës nuk hyn në kuadër të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 182.2, pika a), b), c), d), e), f), g), h),i),j),k), l), m), n) dhe o) të LPK-së, ku për disa nga këto shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare ndërsa për shkelje tjera pala duhet të thirret në ankesë. Nga përmbajtja e të gjitha pikave të sipër theksuara, në asnjërën prej tyre nuk është përcaktuar si shkelje esenciale

[167] Shih aktgjykimen ne rastet nr. KI117 / 23 dhe nr. K1186/22

e dispozitave procedurale në rast se gjykata nuk cakton apo e cakton në mënyrën jo të duhur vlerën e objektit të kontestit.
Mos veprimi i tillë i gjykatës së shkallës së parë mund të trajtohej eventualisht si shkelje esenciale relative, të cilën e trajton gjykata e shkalles së dytë vetëm nëse pala është thirr shprehimisht në ankesë dhe nëse ka arrit të argumentoj se kjo e metë ka ndikuar ose ka mundur të ndikoj në nxjerrjen e vendimit të gjykatës (neni 182 par 1 LPK-së).
Ndërsa sa i përket Gjykatës Supreme, çështja e vlerës së objektit të kontestit nuk hyn në kuadër të shkeljeve procedurale të cilat i trajton kjo gjykatë, marrë për bazë faktin që ajo vepron sipas mjeteve të jashtëzakonshme në këtë rast revizionit, i cili si mjet juridik i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimit të formës së prerë është me i kufizuar se ankesa, në kuptimin e pretendimeve që mund të paraqesin palët sa i përket shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 214 të LPK-së. Pra, shikuar nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet revizioni, rezulton se pala nuk ka asnjë bazë që të thirret në shkeljet procedurale në revizionin e paraqitur, në situatën kur gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë trajtuar çështjen e vlerës së kontestit sipas detyrës zyrtare dhe prapësimit të palës, siç u elaborua më lart.
Gjykata Supreme e trajton revizionit sipas nenit 211, ku me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: "*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro,* ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro"* Ndërsa për kontestet tregtare me nenin 508 të LPK-së është përcaktuar se: "*Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro*" mirëpo me Ligjin për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-015), me nenin 14 të këtij ligji janë përcaktuar Mjetet e Jashtëzakonshme Juridike, ku me paragrafin 2 të këtij neni është

përcaktuar se: "*Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, revizioni lejohet në kontestet me kusht që vlera e kontestit të jetë jo më pak se 30.000 (tridhjetëmijë Euro)*" Nga kjo rezulton se në kontestet tregtare vlera e kontestit duhet të llogaritet sipas ligjit për Gjykatën Komerciale e jo sipas nenit 508 të LPK-së. Gjykata Supreme sipas kufizimeve të tilla ligjore trajton revizionin dhe në të gjitha rastet kur nuk kalohet pragu ligjor që ka të bëjë me vlerën e objektit të kontestit sipas pëkufizimeve ligjore si më lart, atëherë merr aktvendim dhe hedh revizionin.

Nga rregullimi i tillë ligjor rezulton se gjykatat e rregullta kanë liri të gjerë në vlerësim të mënyrës së zbatimit të kufizimeve përkatëse sa i përket çështjes së vlerës së objektit të kontestit - *ratione valoris.* Madje Gjykata Supreme duhet të kujdeset që të mos anashkalon kërkesat ligjore përkitazi me vlerën e shumës së goditur me revizion, siç janë përcaktuar me nenin 211 të LPK-së, ngase do të tejkalonte juridiksionin e saj të përcaktuar me ketë ligj, e që kjo do të rezultonte në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 te Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të KEDNJ-se. Pra, nëse gjykata vendos jashtë juridiksionit të saj, mund të cenohet çështja e të drejtës se "*gjykatës së themeluar me ligj*" si pjese përbërëse e një gjykimi të drejtë[168]

Pavarësisht rregullimit ligjor të sipër theksuar, autorizimeve të gjykatave të rregullta që veprojnë sipas mjeteve të rregullta dhe jashtëzakonshme në trajtimin e kësaj çështja, vlera e objektit të kontestit apo "*ratione valoris*" duhet trajtuar edhe në aspektin e të drejtës për gjykim të drejtë sipas neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe te Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces te rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

[168] Shih rastin e Gjykatës KII4/22, parashtrues Shpresa Gervalla, Aktgjykimi i 23 shkurtit 2023, paragrafi 58 si dhe rastet *Coëme dhe te tjeret kunder Belgjikes,* nr. 32492/ 96 dhe katër te tjerë, Aktgjykim i 22 qershorit 2000, paragrafët 107-109 dhe *Sokurenko and Strygun kundiir Ukraines,* nr. 29458/04 dhe 29465/04, Aktgjykim i 20 korrikut 2006, paragrafet 26-28)

Gjykata Kushtetuese përmes zbatimit të praktikës së GJEDNJ, në interpretim të nenit 31 të Kushtetues, ka trajtuar këto raste duke ju referuar qasjes në gjykatë, që:

- U siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedura për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre civile pranë një gjykate ose tribunali;
- Nuk është absolute dhe mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim;

Kufizimet e përcaktuara për këtë të drejtë:

- Nuk guxojnë të zvogëlojnë qasjen në gjykatë në atë mënyrë apo deri në një masë që cenojnë vetë thelbin e së drejtës; dhe
- Nuk do të jenë të arsyetuara nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet.

E drejta për qasje në gjykatë mund të cenohet në rastet që, ndër të tjera, ndërlidhen me:

- afatet kohore;
- kufizimet ratione valoris për qasje në Gjykatën Supreme;
- pengesat procedurale që pengojnë ose kufizojnë mundësitë e qasjes në gjykatë, e që mes tjerash ndërlidhen me mos pagesën e taksës gjyqësore; dhe (b) autorizimin e përfaqësuesit ligjor, si në procedurën civile dhe atë penale;
- mos shqyrtimin e akteve administrative të autoriteteve publike;
- mos shqyrtimin e kërkesëpadive/ankesave të palëve në procedurë gjyqësore.

Gjykata kushtetuese të drejtën për qasje në gjykatë për aspektet që ndërlidhen me vlerën e kontestit apo "*Ratione Valoris*", në trajtimin e rasteve u është përmbajtur kritereve të përcaktuara nga GJEDNJ-së, të cilat kanë të bëjnë me Vlerësimin e Kufizimeve *Ratione Valoris, dhe atë*:

- Parashikueshmëria: vlerësimi nëse rregullat procedurale janë të qarta dhe të parashikueshme;
- Atribuimi i gabimeve: vlerësimi se kush duhet të mbajë pasojat e gabimeve procedurale pala apo shteti;
- Formalizmi i tepruar: nëse zbatimi i rreptë i rregullave kufizon padrejtësisht qasjen në drejtësi.

Referuar dispozitave ligjore të LPK-së, mbi bazën e të cilave gjykatat e rregullta duhet të trajtojnë çështjen e vlerës së objektit të kontestit, Gjykata Kushtetuese në disa nga vendimet e saj ka konstatuar se gjykatat e rregullta gëzojnë një liri të gjerë të vlerësimit të mënyrës së zbatimit të kufizimeve përkatëse *ratione valoris,* mirëpo nuk do të thotë se gjykatat gëzojnë diskrecion të pakufizuar në këtë kuptim. Pra është konstatuar se gjykatat e rregullta gëzojnë liri të vlerësimit por se në disa rast kjo liri është tejkaluar, ndërsa për vlerësim se është tejkaluar apo jo kjo liri Gjykata Kushtetuese vëmendje të veçantë i ka kushtuar tre kritereve, përkatësisht (i) parashikueshmërisë së procedurës e cila zbatohet në lidhje me revizionin; (ii) çështjes se kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të bëra gjatë procedurës, dhe (iii) çështjes nëse qasja e parashtruesit në Gjykatën Supreme është kufizuar nga formalizmi i tepruar.

Në vijim do të pasqyrohen disa raste nga praktika gjyqësore e gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese ku është trajtuar çështja e vlerës së objektit të kontestit, posaçërisht rastet kur gjykatat e rregullta përkatësisht Gjykata Supreme ka vlerësuar se është duke vepruar brenda juridiksionit të saj përkatësisht kërkesave ligjore në lidhje me çështjen e lejueshmërisë së revizionit sipas vlerës së kontestit, ndërsa Gjykata Kushtetuese në disa prej këtyre rasteve ka konstatuar se gjykatat e rregullta nuk u janë përmbajtur kritereve të lartpërmendura e që për pasoj palës i është cenuar e drejta për qasje në drejtësi.

4. Të gjeturat nga praktika gjyqësore e gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese

Në vijim do paraqiten disa raste nga praktika e gjykatave të rregullta dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese dhe do të pasqyrohet se si është trajtuar çështja e mos caktimit ose e caktimit jo të saktë të vlerës së objekti të

kontestit nga pala, roli i gjykatave të rregullta në trajtimin e kësaj çështje si dhe rastet kur ka pasur vlerësim ndryshe nga gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese sa i përket çështjes së vlerës së objektit të kontestit. Në disa nga rastet në vijim Gjykata Kushtetuese ka shpallur të pavlefshme vendimet e Gjykatës Supreme dhe ka kërkuar që revizioni të trajtohet i lejuar, me vlerësim se gjykatat e shkallës së parë nuk u janë përmbajtur autorizimeve nga neni 36 i LPK-së dhe për pasoj hedhja e revizioni është konsideruar si shkelje e të drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-se), përkatësisht shkelje e parimit për qasje në gjykatë.

Moscaktimi ose caktimi i pasaktë i vlerës së kontestit nga pala, si dhe mosveprimi i gjykatës së shkallës së parë në përputhje me nenin 36 të LPK-së, e ka pamundësuar trajtimin meritor të rastit nga Gjykata Supreme. Si pasojë, kjo ka çuar në krijimin e divergjencave në praktikën gjyqësore ndërmjet gjykatave të shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit, në rastet që bazohen në rrethana të njëjta faktike dhe juridike.

Për më tepër, kjo situatë ka ndikuar që Gjykata Supreme të mos ketë mundësi të japë një vlerësim përfundimtar për çështje të caktuara pronësore, të cilat konsiderohen të rëndësishme për sigurimin e një zbatimi unik dhe të qëndrueshëm të praktikës gjyqësore, sidomos në rastet që mbështeten në rrethana të njëjta faktike dhe juridike.[169]

Rasti i parë

Ky rast njihet edhe si rasti Bajgora ku nga elaborimi në vijim shihet se mes Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese ka pasur pikëpamje të ndryshme në lidhje me çështjen e vlerës së kontestit. Gjykata Supreme ka vlerësuar se duhet të veproj sipas kërkesave ligjore përkitazi me vlerën e shumes se goditur me revizion, siç është ë përcaktuar me nenin 211 te LPK-se, ngase do te tejkalonte juridiksionin e saj. Ndërsa Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ka pasur interpretim formal të rregullave procedurale ku është krijuar një pengesë për parashtruesin e kërkesës që çështja e tij të zgjidhej në merita.

[169] Aktgjykimi Ac.nr.530/2016, datë 18.06.2018, Aktgjykimi KI145/2018, datë 1308.2019, Aktgjykimi Ac.nr.530/2016, datë 10.12.2019, aktgjykimi KI.49/19, datë 10.12.2019, Aktgjykimi ac.nr.530/2016, datë 30.03.2023 dhe Aktgjykimi KI118/23, datë 23.12.2024.

Në ketë rast paditësi kishte ushtruar padi, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., me kërkesë që e paditura paditësit t'ia paguaj në emër të tri pagave jubilare shumën prej 2739.00 € dhe në emër të diferencës së pagës në emër të shtesës për përvojë për tri paga të pensionimit shumën prej 547.80 €, e të gjitha këto në shumë të tërësishme prej 3.286.80 euro me kamatë ligjore prej 8%, që nga dita e pensionimit datë 27.08.2017, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 260.00 €.

Vendimi i shkallës së parë

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.3845/18 të datës 07.05.2019, në pikën një të dispozitivit, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa në pikën dy të dispozitivit, është detyruar e paditura Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a., që paditësit në emër të tri pagave jubilare t'ia paguaj shumën prej 2.739.00 € (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 (shtatë) ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

- Në pikën tre të dispozitivit, është refuzuar si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë në shumën 547.80 € (pesëqind e katërdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë cent) në emër të pagesës së diferencës së pagës në emër të shtesës për përvojë për tri paga të pensionimit, dhe në pikën katër të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 260.00 € (dyqind e gjashtëdhjetë euro).

Kundër pikës një dhe dy të dispozitivit ka paraqitur ankesë pala e paditur, pra pala me interes, ndërsa pala paditëse nuk ka paraqit fare ankesë kundër pikës tre të dispozitivit ku i është refuzuar ankesa, mirëpo ka paraqit përgjigje në ankesë ku ndër të tjera ka kërkuar që të aprovohet në tersi kërkesa e tij.

Vendimi i shkallës së dytë

Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr.5071/19 të datës 17.01.2020, në pikën një të dispozitivit, ka aprovuar ankesën e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK) në Prishtinë, duke e ndryshuar aktgjykimin e lartpërmendur, të shkallës së parë, në pikën I, II, dhe IV të dispozitivit, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e

paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të tri pagave për shpërblim jubilar t'i paguaj shumën prej 2,739.00 euro, në emër të diferencës në shumë prej 547.80 € dhe shpenzimet e procedurës, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm, dhe në pikën II, është vendosur që aktgjykimi i shkallës së parë, në pikën III të dispozitivit mbetet i paprekur.

Kundër këtij vendimi pala paditëse ka paraqit revizion në Gjykatën Supreme

Vendimi i Gjykatës Supreme

Kjo gjykatë me aktvendimin Rev.nr.558/2020 të datës 22.02.2021, e ka hedhë si të pa lejuar revizionin e të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.5071/19 të datës 17.01.2020. Gjykata Supreme e ka hedh poshtë revizionin e palës paditëse pasi që ka konstatuar se pala paditëse nuk ka ushtruar ankese kundër aktgjykimit te shkalles se pare, as ne pjesën refuzuese te tij, si ne piken tre (III) te dispozitivit, dhe derisa ankese ka ushtruar vetëm pala e paditur, ne ketë pjese vendimi i gjykatës se shkalles se pare ka mbetur i pa shqyrtuar, dhe paditësi derisa ne ketë pjese nuk ka ushtruar mjetin e rregullt-ankesën, nuk mund te ushtroj revizionin si mjet te jashtëzakonshëm, sa i përket kërkesës se refuzuar ne emër te diferencës ne shume prej 547.80€. Pra gjykata ka konstatuar se vlera e kontestit nuk mbërrin shumën mbi 3000€, andaj revizioni është hedh poshtë si i palejuar

Vlerësime e Gjykatës Kushtetuese për rastin

Me aktgjykimin KI143/21 të datës 13 dhjetor 2021, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka deklaruar kërkesën të pranueshme, dhe ka vlerësuar se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe te Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces te rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, si dhe e ka shpallur të pavlefshëm Aktvendimin [Rev.nr.558/2020] të Gjykatës Supreme, të 22 shkurtit 2020 dhe të njëjtin e ka kthyer në rivendosje.

Shkeljet e gjetura nga Gjykata Kushtetuese

Gjykata rikujton se esenca e pretendimeve për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme,

ndërlidhet me mohimin e të drejtës për qasje në gjykatë, si rrjedhojë edhe mohimin e mjetit efektiv juridik dhe të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, të cilat pretendohet se janë shkaktuar nga konkluzionet arbitrare të Gjykatës Supreme, në lidhje me vlerësimin e vlerës së objektit të kontestit, si parakusht për të vlerësuar meritat e rastit.

Ne lidhje me ketë, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës ne parashtresën e tij dorëzuar Gjykatës se Apelit, shprehimisht ka kërkuar që të ndryshohej Aktgjykimi C. nr. 3845/18 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në piken III te dispozitivit, me arsyetimin se Gjykata Themelore në Prishtinë: " ... *gabimisht ka vendosur që të refuzojë pjesën e kërkesëpadisë në emër të diferencës së pagës për shtesë, për tri paga përcjellëse për pensionim, e kjo pasi që e paditura me rastin e dhënies se tri pagave, me rastin e pensionimit e ka llogaritur vetëm pjesën e pagës bazë të paditësit, ndërsa është dashur që t'i llogarisë tri pagat mujore të cilat i ka marrë paditësi para pensionimit, bazuar në nenin 53 te MPPK-se. Andaj edhe nga këto arsye paditësi ka kërkuar qe t'i njihet edhe e drejta në diferencën për tri paga përcjellëse në emër të pensionimit. Paditësi bazuar në shkresat e lëndës dhe thënieve të lartcekura si dhe deklarimeve gjatë seancave të mbajtura i propozon Gjykatës se Apelit qe ankesën e paditësit ta REFUZOJ në tërësi si të pabazuar, ndërsa Aktgjykimin C.nr.3845/18 të datës 07.05.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ta ndryshoj në atë mënyrë që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe të ndryshoj edhe në pjesën e dispozitivit, lidhur me shpenzimet duke i njohur edhe shpenzimet për ketë përgjigje në ankesë në vlerën prej 208 €, në total t'i njeh në emër të shpenzimeve paditësit vlerën prej 468€".*

Kjo gjykatë konsideron se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk ka hequr dorë nga vlera prej 547,80€, të cilën e ka kërkuar në emër të diferencës së pagës, se tri pagave përcjellëse të pensionimit, siç gabimisht ka theksuar Gjykata e Apelit në Aktgjykim të 17 janarit 2020, nga ku është bazuar dhe Gjykata Supreme. Parashtruesi i kërkesës ishte i qartë në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Apelit nga e cila ka kërkuar që ta refuzojë ankesën e të padituröes KEK-Sh.A., dhe të aprovoje në tërësi kërkesëpadinë e tij, që nënkupton se ka kërkuar të ndryshohej Aktgjykimi C. nr. 3845/18 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në piken III të dispozitivit, duke aprovuar diferencën e pagave në shumen prej 547,80 €,

si dhe të ndryshohej aktgjykimi në fjalë edhe në piken IV të dispozitivit, përkitazi me shpenzimet e procedurës, duke kërkuar që vlerës se aprovuar prej 260€, nga shkalla e parë, t'i shtoheshin edhe shpenzimet e procedurës pranë Gjykatës se Apelit, në vlerën prej 208€, dhe në tërësi të aprovohej vlera prej 468€.

Ne rastin konkret, qartazi vërehet se parashtruesi i kërkesës e ka atakuar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës se Apelit, me të cilin u refuzua në tërësi kërkesëpadia e tij. Rrjedhimisht atij i është refuzuar, vlera e tërësishme prej 3,286.80€, e kërkuar me kërkesëpadi, që në rastin konkret përben vlerën e objektit te kontestit në kuptim të nenit 211.2 te LPK-se.

Në ketë kontekst, Gjykata duke iu referuar po ashtu kërkesës për revizion, verën se parashtruesi i kërkesës ka atakuar në të gjitha pikat e dispozitivit Aktgjykimin e Gjykatës se Apelit, me të cilin u refuzua vlera e tërësishme prej 3,286.80 €, e cila përfshin edhe pagesën e diferencës në pagë, në vlerën prej 547,80 €, por qe në kuptim të vlerësimit të vlerës se objektit të kontestit, nuk përmendet askund shifra prej 468€ e cila ishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit, në emër të shpenzimeve të procedurës, e që në rastin konkret përben po ashtu vlerë të objektit të kontestit të goditur me revizion. Në ketë kuptim, Gjykata gjen se vlera reale e objektit të kontestit (dëmi i pësuar) qe është goditur me revizion, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në kuptim të nenit 211.2, të LPK-së, del të jetë shuma e tërësishme prej 3,694.80€.

Vendosja për herë të dytë nga Gjykata Supreme lidhur me këtë rast

Nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese është vërejt se kjo gjykatë në trajtimin e rastit të paditësit si referencë ka marr përgjigjen në ankesë, ku është thënë se paditësi asnjëherë nuk kishte hequr dorë nga kërkesa e tij në shumën prej 547,80 € si dhe është konstatuar se nuk është përmend vlera 468€ në emër të shpenzimeve të procedurës, që në rastin konkret përbën vlerë të kontestit të goditur me revizion.

Këto çështje që janë ngritur nga Gjykata Kushtetuese janë trajtuar nga Gjykata Supreme në aktvendimin Rev.nr.43/2022 të datës 10.10.2022, ku për herë të dytë është hedhë si i pa lejuar revizionin i të autorizuarit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.5071/19 të datës 17.01.2020.

Vlerësimet e Gjykatës Supreme në raport me përgjigjen në ankesë dhe rolin e saj

Gjykata Supreme ka vlerësuar se në asnjë rrethanë përgjigja në ankesë nuk mund të trajtohet si ankesë. Ligji i Procedurës Kontestimore në nenin 187 ka përcaktuar rolin e përgjigjes në ankesë, ku për të respektuar parimin e kontradiktoritetit palës kundërshtare duhet t'i jepet mundësia për t'u deklaruar – përgjigjur në ankesën e palës tjetër, ndërsa pala mundet që në afatin prej 7 ditësh të paraqes përgjigje në ankesë. Sipas kësaj gjykate, qëllimi i përgjigjes në ankesë është që pala kundërshtare përmes përgjigjes të deklarohet dhe të jap shpjegime për pretendimet ankimore të palës tjetër të paraqitura në ankesë. Edhe nëse pala kundërshtare në këtë rast pala paditëse në përgjigje në ankesë ngrit çështje që mund të trajtohen si pretendime ankimore (ashtu siç në këtë rast është marrë për bazë propozimi i paraqitur në përgjigje në ankesë), Gjykata Supreme vlerëson se përgjigja në ankesë nuk është mjet juridik ankimor dhe nuk mund të trajtohet si e tillë pavarësisht se çka propozon pala që e paraqet atë.

Kjo gjykatë e ka trajtuar këtë çështje edhe me opsionin që përgjigja në ankesë eventualisht të trajtohet ankesë, atëherë duhet të shikohet afatshmëria e ankesës e që rezulton se është jasht afatit ligjor, për shkak se pala paditëse vendimin e shkallës së parë e ka marrë më datën 17.06.2019 ndërsa përgjigjen në ankesë e ka paraqitë në gjykatë me datë 26.07.2019, që do të thotë se është në kundërshtim me nenin 477 të LPK-së.

Përveç kësaj, për tu trajtuar një parashtresë si ankesë duhet që patjetër të përmbaj elementet që janë përcaktuar me nenin 178 të LPK-së, të cilat elemente nuk i përmban përgjigja në ankesë. Propozimi i paraqitur në përgjigje në ankesë nga pala paditëse nuk mund të merret si pretendim ankimor, kjo pasi që është pjesë e përgjigjes në ankesë që nuk është mjet juridik ankimor dhe gjithashtu propozimi nuk është obligativ dhe me të nuk është e lidhur gjykata që vepron sipas mjetit juridik, ashtu siç është përcaktuar me nenin 178 të LPK-së.

Vlerësimet e Gjykatës Supreme sa i përket shpenzimeve të procedurës në raport me vlerën e kontestit

Kjo gjykatë ka vlerësuar se në këtë rast kërkesa për shpenzime të procedurës në shumen pre 468€ nuk mund të merret parasysh për të përcaktuar vlerën e objektit të kontestit, kjo pasi që nuk është kërkesë kryesore por është kërkesë akcesore dhe kjo është definuar qartë me

dispozitën nga neni 30 të LPK-së. Deri sa kjo dispozitë ligjore është në fuqi, nuk është shpall kundër kushtetuese, gjykatat e instancave të ndryshme janë të obliguara ta zbatojnë atë qoftë në fazën e trajtimit të padisë apo në fazën e trajtimit të mjetit juridik të jashtëzakonshëm. Është vlerësuar se revizioni i palës paditëse në këtë rast duhet trajtuar duke ju referuar dispozitave nga neni 211.2 të LPK-së, ku përcaktohet qartë se në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë prestimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €, revizioni nuk lejohet.

Gjykata Supreme ka konstatuar se në këtë rast duhet të merret parasysh faktin se pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, as në pjesën refuzuese të tij si në pikën tre të dispozitivit, dhe deri sa ankesë ka ushtruar vetëm pala e paditur, në këtë pjesë vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur i pa shqyrtuar, dhe paditësi deri sa në këtë pjesë nuk ka ushtruar mjetin e rregullt –ankesën, nuk mund të ushtroj revizionin si mjet të jashtëzakonshëm, sa i përket kërkesës së refuzuar në emër të diferencës në shumë prej 547.80 €.

Për këtë arsye, pavarësisht faktit se Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën dy të dispozitivit të aktgjykimit, që të refuzoj kërkesëpadinë në emër të kërkesës për tri paga për shpërblim jubilar në shumën prej 2.739.00 €, dhe në emër të diferencës në shumë prej 547.80 euro, në shumë të përgjithshme prej 3.286.80 €, kjo nuk e ndryshon vlerën e kontestit që mund goditet me revizion, pasi objekti i revizionit mund të jetë vetëm kërkesa për tri paga për shpërblim jubilar në shumën prej 2.739.00 €, në të cilën pjesë revizioni është i palejuar, për shkak të vlerës së kërkesës, e cila është goditur me revizion, e cila është në shumën prej vetëm 2.739.00 €, do të thotë nuk kalon limitin prej 3.000 €, të paraparë si kusht ligjor për mundësinë e paraqitjes së revizionit, për çka revizioni i paditësit, është i pa lejuar dhe është dashur të hedhet.

Vendosja për herë të dytë nga Gjykata Kushtetuese

Me aktgjykimin KI04/23 të datës 24 korrik 2024, kjo gjykatë konstatojë se Aktvendimi Rev.nr.43/2022 i 10 tetorit 2022, i Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim te Drejte dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në

lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta te Njeriut, të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [Rev.nr. 43/2022] të 10 tetorit 2022 të Gjykatës Supreme dhe të njëjtin ta kthejë për rivendosje të revizionit në merita.

Shkeljet e pretenduara nga Gjykata Kushtetuese
Gjykata vëren se interpretimi strikt i Gjykatës Supreme i rregullave të pragut të vlerës së objektit në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, e që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhen me Aktgjykimin e goditur të Gjykatës së Apelit, bie ndesh me kriterin e garantimit të së drejtës praktike dhe efektive të qasjes në gjykatë në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Gjykata vlerësoj se interpretimi formalist i rregullave procedurale krijoi një pengesë për parashtruesin e kërkesës që çështja e tij të zgjidhej në merita. Aktvendimi i kontestuar, i Gjykatës Supreme, i cili për herë të dytë hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës përbën një formalizëm të tepruar, i cili ka rezultuar në interpretim dhe zbatim strikt të rregullave procedurale, të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe për pasojë në mënyrë të pajustifikuar ka cenuar qasjen e parashtruesit të kërkesës në juridiksionin e saj. Gjykata theksoj se nuk e konteston apo vë në pikëpyetje përmbajtjen e paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së, si dhe aplikueshmërinë e kësaj dispozite në rrethanat e rastit konkret, megjithatë konkludon se interpretimi dhe zbatimi i dispozitave përkatëse të LPK-së, që ndërlidhen me lejueshmërinë e revizionit nuk ishte proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimin e mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.
Në rrethana të tilla Gjykata Supreme është dashur që revizionin e paditësit ta trajtoj në merita të tij, pavarësisht vlerës së kontestit, dhe të vendos lidhur me pretendimet e paraqitura në revizion[170]

[170] Shih aktgjykimin Rev.nr.347/2024, datë 05.11.2024

Rasti i dytë
Rasti KI172/23, parashtrues R.C. , F,C. , L.C. dhe S. C.
Ky rast i referohet çështjes së vlerës së objektit të kontestit në rastet e bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë.
Paditësit në këtë rast kanë paraqit padi të përbashkët me kërkesa individuale, kundër kompanisë se sigurimeve "E. Sh.A." (ne tekstin e mëtejmë: kompania e sigurimeve), për kompensim të demit material dhe jo-material për shkak te vdekjes se djalit, përkatësisht vëllait te tyre në aksident komunikacioni.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë
Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.237/18 të datës 10.01.2020, ka vendosur që të miratohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve Sh.C, M.C, R.C, F.C, L.C dhe e mitura S.C, të cilën e përfaqëson i ati Sh.C dhe është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve " Elsig" me seli në Prishtinë, që paditësve për vdekjen e fëmijës dhe vëllait të tyre në aksidentin e datës 08.06.2018, t'ua kompensoj dëmin jo material dhe material si vijon: a). Dëmin jo material: për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes, për personat si në vijim: 1.S.C, babai i të ndjerit shumën prej 10,000.00 €; 2.M.C, nëna e të ndjerit shumën prej 10,000.00 €; 3.R. C, motra e të ndjerit shumën prej 8,000.00 €; 4.F.C, motra e të ndjerit shumën prej 8,000.00 €; 5.L.C, motra e të ndjerit shumën prej 8,000.00 €,; 6.E.D, motra e të ndjerit shumën prej 8,000.00 €,
b.) Dëmin material: Paditësit Sh.C babai i të ndjerit t'ia paguaj edhe atë: Për shpenzimet e varrimit shumën prej 1500.00 €, për ngritjen e përmendores shumën prej 1500 €. Të gjitha këto shuma me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 11.12.2019, e gjerë në pagesën definitive. Ndërsa është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve R.C, F.C, L.C dhe E.D motrat e të ndjerit, mbi shumat e miratuara në lartësi prej 4000.00 €. E paditura është detyruar që paditësve t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I/a. dhe I/b të këtij dispozitivi, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2396.00€, këto pagesa të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë

Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr.3023/2020 të datës 07.04.2023, ka vendosur që aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "E" me seli në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.237/18, i datës 13.12.2019 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit sa i përket dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për paditëset R.C, F.C, L.C si dhe S.C dhe në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe tani gjykohet si vijon: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "ELSIG" me seli në Prishtinë, që për dëmin jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes ti paguajë shumat si në vijim: paditëses R.C, motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro, paditëses F.C, motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro, paditëses L.C, motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro dhe paditëses S.C, motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 13.12.2019, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Refuzohet e pa themeltë kërkesëpadia e paditëseve R.C, F.C, L.C si dhe S.C, motrat e të ndjerit përtej shumave të aprovuara sikurse në këtë pikë të dispozitivit të aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi dhe atë pikës II të dispozitivit, ku është refuzuar kërkesa e secilit nga paditësit mbi shumën e gjykuar dhe atë nga 3000€ për secilin, revizion kanë paraqitur paditësit.

Vendimi i Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme ka hedh revizionin e paditësve me aktvendimin Rev.nr.216/2023, të 19 qershorit 2023, me arsyetimin se vlera e kontestit e secilit paditës veç e veç, bazuar ne bashkëndergjyesinë e thjeshte, nuk kalonte shumen prej 3,000 (tremijë)€. Kjo gjykatë vendimin e saj e ka mbështetur në paragrafin 2 te nenit 211 të LPK-së, që përcakton se "*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro"*, dhe nenin 268 të LPK-se, sipas se cilit: "*Secili bashkëndërgjyqes në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm*

bashkëndërgjyqësve të tjerë." Kjo gjykatë ka vlerësuar se secili bashkëndërgjyqës në ketë proces kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkon në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë. Ka vlerësuar gjithashtu se asnjëra nga parashtrueset e kërkesës nuk kishte kaluar pragun prej 3,000 (tremijë) eurove, siç përcaktohet ne nenin 211 te LPK-se.

Vlerësimet e Gjykatës Kushtetuesi lidhur me këtë rast

Me aktgjykimin KI172/23 të datës 24 korrik 2024, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka shpallur të pranueshme kërkesën e paditësve, ka konstatuar se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces te rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ka shpallë të pavlefshëm Aktvendimin Rev.nr.216/2023 të 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Sipas kësaj gjykate parashtrueset e kërkesës që nga fillimi i procedurës gjyqësore ishin të përfaqësuara nga i njëjti përfaqësues ligjor, i cili i kishte këshilluar në përdorimin e mjeteve juridike sipas radhës, përfshirë paraqitjen e revizionit para Gjykatës Supreme dhe se kërkesëpadia, në parim, kishte të bënte me të njëjtat rrethana faktike dhe juridike për të gjitha parashtrueset e kërkesës. Kjo sepse, as nga përmbajtja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe as atij të Gjykatës së Apelit, nuk rezulton se kërkesat e parashtrueseve të kërkesës janë trajtuar si të veçanta, por të dyja aktgjykimet përmbajnë të njëjtin arsyetim përkitazi me akordimin e shumave të njëjta për të gjitha parashtrueset, në emër të kompensimit të dëmit jo material, ndonëse shumat në dispozitivin e aktgjykimeve janë vendosur veçantë për secilën.

Kontestuese për Shumicën ka qene vetëm nëse në interpretimin e ligjit të aplikueshëm ka pasur "formalizëm të tepruar" nga ana e Gjykatës Supreme dhe atë për faktin se Gjykata Supreme nuk i'u referua dhe as nuk sqaroi dispozitën e LPK-se, përkatësisht nenin 32 te saj, dhe e cila ndërlidhet me mënyrën e përcaktimit te vlerës se përgjithshme të objektit të kontestit. Kjo gjykatë ka konstatuar se shkelja e sipër theksuar vlen vetëm në rrethanat e rastit konkret duke u bazuar në vlerësimin se interpretimi i nenit 32, në lidhje me nenet 211, 214 dhe 268 të LPK-së

nga ana e Gjykatës Supreme është jo proporcional sepse përfaqëson formalizëm të tepruar.

5. Praktika gjyqësore dhe vlerësimet e Gjykatës Supreme për rastet e bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë

Nisur nga praktika gjyqësore e kësaj gjykate rezulton se këto raste janë trajtuar në kuptim të dispozitave nga nenet 264 dhe 268 të LPK-së. Me nenin 264 të LPK-së është rregulluar çështja e bashkëndërgjyqësisë, andaj referuar kësaj dispozite dhe pozitës të cilën e kanë paditësit në kontestet e kompensimit të dëmit, rezulton se ata në këto konteste e kanë cilësinë e bashkëndërgjyqësit material pasi që autorizimet apo detyrimet e tyre mbështeten në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, mirëpo mes tyre nuk ekziston kurrfarë bashkësie juridike, si te rasti i bashkëndërgjyqësisë unike (neni 269 I LPK-së). Shikuar në aspektin e pozitës procedurale të bashkëndërgjyqësve, paditësit në konteste e tilla të kompensimit të dëmit e kanë pozitën procedurale të bashkëndërgjyqësit të thjeshtë dhe si të tillë trajtohen ashtu siç është rregulluar me nenin 268 të LPK-së, që ka përcaktuar se: "*Secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë.*
Nga kjo rezulton se secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm të bashkëndërgjyqësve të tjerë. Pozita e bashkëndërgjyqësve të thjeshtë është e njëjtë sikurse të njëjtit të kishin ngritur padi të veçanta apo të ishin paditur në mënyrë të veçantë secili. Duhet theksuar se pavarësia e bashkëndërgjyqësve vjen në shprehje edhe në qëndrimet e tyre ndaj pretendimeve faktike të kundërshtarit. Në këtë kuptim në qoftë së njëri nga bashkëndërgjyqësit e kundërshton një fakt, ndërsa të tjerët nuk e kundërshtojnë, gjykata për atë që e ka kundërshtuar faktin e merr si fakt kontestuese ndërsa për ata që nuk e kanë kundërshtuar e merr si jo kontestuese, mirëpo me rastin e çmuarjes së provave në raste e tilla gjykata duhet të marrë parasysh edhe pohimin e të tjerëve sepse ajo i çmon provat në bazë të rezultatit të gjithë shqyrtimit (neni 8 i LPK). P.sh., njëri e pranon detyrimin, tjetri pretendon se e ka paguar, i treti bën prapësimin e parashkrimit të padisë etj. Po

kështu edhe pala tjetër (paditëse) mund t'i kundërshtojë vetëm njërit nga bashkendergjyqesit prapësimin e kompensimit dhe jo edhe të tjerëve. Nga këto shembuj rezulton se padia mund të pranohet kundrejt njërit bashkendergjyqes dhe të refuzohet kundrejt tjetrit, në varësi nga sjellje qe ka mbajtur çdo njeri në proces dhe nga sjellja e palës kundërshtarë kundrejt tij.

Gjykata Supreme vlerëson se në këto rast vendimtare për caktimin e vlerës së objektit të kontestit nuk është neni 32 i LPK-së, pasi që ky nen ndërlidhet me vlerën e përgjithshme të kontestit me rastin e paraqitjes së padisë dhe jo me vlerën e goditur përmes revizionit, siç përcaktohej me nenin 211 të LPK-së. Çështja e lejimit apo jo të revizionit në këto raste duhet trajtuar sipas nenit 211, par. 2 të LPK-së, qe përcakton se*: "Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro*", dhe nenin 268 te LPK-se sipas se cilit: "*Secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimore është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë"* Nisur nga fakti që paditësit në këto konteste e kanë cilësinë e bashkëndërgjyqësve të thjeshtë dhe jo unik, duke qenë se secila palë në procedurë është palë në vete, dhe se kontesti jo domosdoshmërisht do të duhej të zgjidhej në mënyrë të njëjtë për të gjithë parashtruesit e kërkesës, në rastin konkret janë të aplikueshme dispozitat e nenit 268 të LPK-së, përkitazi me bashkëndërgjyqësinë e thjeshtë dhe llogaritja e vlerës se goditur me revizion duhet të bëhet për secilin paditës.

Për më tepër, kjo gjykatë vë në pah se përkitazi me llogaritjen e vlerës së goditur me revizion, kur kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi të thjeshtë, tashmë ka një praktikë koherente gjyqësore dhe të cilën e zbaton në mënyrë të qëndrueshme. Kjo gjykatë vlerëson se nëse ndjekë një praktikë tjetër për këtë çështje, atëherë do të humbte kuptimin i institutit të bashkëndërgjyqësisë, konkretisht bashkëndërgjyqësia e thjeshtë dhe rrjedhimisht do anashkalonte kërkesat ligjore përkitazi me vlerën e shumes se goditur me revizion, siç janë përcaktuar ne nenin 211 te LPK-se, e për pasoj do të tejkalonte juridiksionin e saj të përcaktuar me ketë

ligj, e qe kjo do të rezultonte ne shkelje te se drejtës për një gjykim te drejte te garantuar me nenin 31 te Kushtetutës dhe nenin 6 te KEDNJ-se.
Rasti i tretë
Ky rast i referohet lëndës me numër KI96/ 22 (N.H dhe U. H)
Në padinë e paraqitur në gjykatë më datë 16.03.2016, me objekt kontesti anulim i kontratës, paditësit kishin përcaktuar vlerën e këtij kontesti në lartësi prej 3000€, e cila vlerë kontesti nuk ishte ndryshuar gjatë tërë zhvillimit të procedurës gjyqësore lidhur me këtë padi.
Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesën e paditësit, ndërsa me ankesën e të padituri lënda është trajtuar në Gjykatën e Apelit e cila e ka refuzuar ankesën e të padituri dhe e ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë.
Revizion ka paraqitur pala e paditur, mirëpo Gjykata Supreme revizioni e ka hedh në kuptim të nenit 211, par. 2 të LPK-së, kjo pasi që vlera e objektit të kontestit ka qenë në shumën prej 3000€.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me aktgjykimin KI96/22 të datës 30 tetor 2023, e ka deklaruar të papranueshme kërkesën e parashtruesve (të padituve) N. H dhe U. H, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev.nr.570/2021 të datës 5.5.2022 dhe të Gjykatës së Apelit.
Këtu kemi të bëjmë me një situatë kur pala paditëse ka caktuar vlerën e kontestit, por që nga vlera e cekur rasti nuk ka mundur të trajtohet nga Gjykata Supreme për shkak të pragut ligjor të caktuar për lejueshmërinë e revizionit. Në këtë rast as gjykata e shkallës së parë nuk e ka ndryshuar zyrtarisht vlerën e objektit të kontestit por këtë nuk e ka kërkuar as pala e paditur, mirëpo Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, referuar kritereve si në vijim:

- Parashikueshmëria - është konstatuar se Gjykata Supreme ka një praktikë mirë të konsoliduar gjyqësore në lidhje me pragun ligjor për lejueshmërinë e revizionit. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se parashtruesi i kërkesës N.H, në cilësinë edhe të përfaqësuesit ligjor të padituri duhet të ketë ditur se, në mungesë të një vendimi të posaçëm nga gjykata e shkallës së parë, ndryshimi i

mëvonshëm i vlerës nuk mund të merret parasysh për qëllim të qasjes në Gjykatën Supreme.

- Atribuimi i gabimeve- sipas këtij kriteri është vlerësuar se konstatimi se revizioni ishte i palejuar mund t'i atribuohet gjykatave apo parashtruesve të kërkesës. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur përmes fakteve nëse ata kanë kërkuar ndryshimin e vlerës së padisë përgjatë zhvillimit të procedurave para Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, dhe nëse ka një vendim të Gjykatës Themelore për ndryshimin e vlerës.
- Formalizmi i tepruar: sipas këtij kriteri është vlerësuar nëse Gjykata Supreme ka përdorur apo jo formalizëm të tepruar gjatë interpretimit të dispozitave përkatëse ligjore në fuqi e që ndërlidhen me lejueshmërinë e revizionit, Gjykata vlerëson se konstatimi i Gjykatës Supreme përmes aktvendimit të saj për refuzim të revizionit nuk përfaqëson formalizëm të tepruar. Gjykata në pajtim me praktikën e vet gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së thekson se respektimi i rregullave formale në procedurë është më vlerë dhe një rëndësie të tillë që ndalon arbitraritetin, dhe siguron vendimmarrjen efektive përkitazi me një kontest dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor, si dhe siguron siguri juridike dhe respekt për gjykatën.

Në fund të kësaj, Gjykata konsideron se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme nuk ishte rezultat i rregullave procedurale jo-fleksibile, për arsye se dispozitat e LPK-së, përkatësisht neni 36 i tij parasheh mundësinë e ndryshimit të vlerës së objektit të kontestit në një fazë më të hershme të procesit gjyqësor, përkatësisht gjatë zhvillimit të procedurës para Gjykatës Themelore. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës në dispozicion kishin edhe mjetin tjetër të jashtëzakonshëm të goditjes, atë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të përcaktuar me nenin 245 të LPK-së, të cilin ata nuk e kishin bërë. Thënë këtë, Gjykata në pajtim me konstatimin dhe qëndrimin e GEJDNJ-së konkludon se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme përmes pragut ligjor ratione valoris justifikohet nga qëllimi legjitim i Gjykatës Supreme që të merret vetëm me çështje më të rëndësishme, dhe si rrjedhojë nuk përbën kufizim

jo proporcional të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për qasje në gjykatë.

Rasti i katërt

Në disa konteste kryesisht çështje pronësore pala paditëse në padi nuk e ka treguar fare vlerën e objektit të kontestit, mirëpo gjykatat e shkallës së parë kanë përcjellë një praktikë ku pa e caktuar vlerën e kontestit kanë kërkuar nga pala që ta paguaj taksën gjyqësore për padi pa e mbështetur në vlerë konkrete të objektit të kontestit. Pra, në këto raste, gjyqtari i shkallës së parë nuk u është përmbajtura autorizimeve nga neni 36 i LPK-së, nuk e ka caktuar vlerën e kontestit as sipas detyrës zyrtare e as sipas prapësimit të palës. P.sh në një rast vërtetim pronësie i dërgohet palës paditëse vërejtja për taksë në shumën prej 15€, e cila shumë paguhet për kontestet deri në vlerë prej 1,000.00 (njëmijë) euro sipas udhëzimit administrative për taksa gjyqësore, ndërsa këtë shumë e merr për bazë Gjykata Supreme kur vendos për lejueshmërinë e revizionit.

Deri me tani Gjykata Supreme ka pasur praktikë gjyqësore për këto raste dhe revizionet i ka hedh te palejuara me konstatimin: "*Në këso situatash, kur paditësi nuk ka përcaktuar vlerën e kontestit në padinë e paraqitur, dhe vlera e kontestit nuk është caktuar as në gjykatën e shkallës së parë në kuptim të kësaj dispozite ligjore, sipas praktikës gjyqësore të gjerë-tanishme lejueshmëria e revizionit bëhet sipas lartësisë në të cilën është paguar taksa gjyqësore për padi*". Mirëpo tashmë kjo praktikë ka ndryshuar, ndërsa ndryshimit të praktikës i ka kontribuar Gjykata Kushtetuese me disa nga vendimet e saj.

Rasti nr. KI241/23, Parashtrues S.S

Në funksion të ndryshimit të kësaj praktike është edhe vendimi nr. KI241/23, S.S, ku në këtë rast z.S. kishte paraqit padi për vërtetim pronësie por që nuk kishte përcaktuar fare vlerën e objektit të kontestit, andaj sipas praktikës gjyqësore në vlerësimin e lejueshmërisë së revizionit është marrë për bazë lartësia e vlerës së objektit të kontestit për të cilën është paguar taksa gjyqësore. Në këtë rast Gjykata Supreme është bazuar në shumën prej pesëmbëdhjetë (15) euro të paguar me rastin e paraqitjes së padisë, e cila shumë përkon me kontestet në vlerë deri në 1,000.00(njëmijë) euro. Andaj, Gjykata Supreme ka nxjerr përfundimin se revizioni është i palejuar, me konstatim se vlera e kontestit është nën shumën prej 3,000.00(tremijë) euro.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se në këtë rast ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut/

Sipas Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Themelore në këtë rast ka pasur për detyrë ligjore që bazuar në nenin 36 të LPK-së të caktojë vet vlerën e objektit të kontestit dhe atë nëpërmjet nxjerrjes se një aktvendimi para fillimit të seancës së shqyrtimit kryesor. Gabimet në procedurë mund të ishin evituar që në fillim, në qoftë se Gjykata Themelore do të kishte vepruar me kujdes dhe në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 36 të LPK-së. Nga kjo rezulton se këto gabime nuk mund t'i atribuohen parashtruesit të kërkesës, si palë në këtë proces gjyqësor.

Kjo gjykatë konstatoj se është përdorur formalizëm i tepruar gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi lidhur me pragun e lejueshmërisë së revizionit. Gjykata Supreme nuk do të duhej të ishte e lidhur nga gabimet e gjykatave më të ulëta gjatë vendosjes, nëse do u mundësohej qasja në gjykatë parashtruesit të kërkesës, por do të duhej të kishte shqyrtuar nëse qasja tek ajo si gjykatë më e lartë e juridiksionit të rregullt ishte pamundësuar nga lëshimet procedurale të gjykatave të shkallës më të ulët.

6. Vlerësime përfundimtarë dhe rekomandime për unifikim të praktikës gjyqësore lidhur me vlerën e objektit të kontestit

Nga elaborimet e mësipërme rezulton se vlera e objektit të kontestit është element kyç procedural. Praktika gjyqësore tek ne ka treguar se mospërcaktimi ose caktimi i pasaktë i vlerës së objektit të kontestit mund të shkaktojë hedhje të revizionit, pra mos trajtim në merita të çështjes e për rrjedhojë të trajtohet si pengesë në qasjen në gjykatë.

Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ vendosin standarde të qarta për respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë dhe qasjen efektive në gjykatë. Harmonizimi i praktikës dhe përdorimi i standardeve ndërkombëtare janë thelbësore për sigurinë juridike dhe qasjen efektive në drejtësi.

Gjykatat e rregullta kanë liri të gjerë në vlerësim të mënyrës së zbatimit të kufizimeve që kanë të bëjnë me çështjen e vlerës së objektit të kontestit, madje Gjykata Supreme duhet të kujdeset që të mos anashkalon kërkesat ligjore përkitazi me vlerën e shumës së goditur me revizion, siç janë përcaktuar me nenin 211 te LPK-se, ngase do të tejkalonte juridiksionin e saj të përcaktuar me këtë ligj. Mirëpo, pavarësisht kësaj lirie në vlerësim, gjykatat e rregullta duhet të kujdesen që vlera e objekti të kontestit apo *ratione valoris* të mos jetë shkak që palës në procedurë t'i cenohet qasja në Gjykatën Supreme.

Me qëllim të harmonizimit të praktikës gjyqësore për raste të tilla, që mos të vije deri të shkelja e parimit për qasjes në gjykatë, për çështjet që ndërlidhen me *ratione valoris*, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin masat si në vijim;

- Gjykata themelore përkatësisht gjyqtari i çështjes duhet që të respektoj dispozitat nga neni 36 i LPK-së, pra zyrtarisht apo sipas prapësimit të palës të cakton vlerën e kontestit kur ajo nuk është caktuar apo në rastin kur është treguar vlera e kontestit e cila në mënyrë të dukshme ndryshon (si tepër e lartë apo shumë e vogël) nga vlera e vërtetë e objektit të kontestit.
- Të bashkëndërgjyqësia e thjeshtë, llogaritja e vlerës së objektit të kontestit duhet të bëhet duke e llogaritur vlerën e goditur me revizion për secilin paditës, ndërsa duhet të aplikohen dispozitat e nenit 268 të LPK-së.
- Gjykata Supreme nuk duhet ta marrë për bazë lartësinë e taksës gjyqësore të paguar nga pala paditëse në vlerësim të lejueshmërisë së revizionit, në rast se pala paditëse nuk ka caktuar fare vlerë të objekti të kontestit, ndërsa këtë nuk e ka bërë as gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 36 të LPK-së.
- Të rastet e ndryshimit të padisë, përkatësisht rastet kur pala paditëse në kërkesën fillestare të padisë ka p.sh shumën nën 3000€, dhe për këtë shumë ka paguar taksën gjyqësore, mirëpo në shqyrtim kryesor atë e ka ndryshuar duke kërkuar shumën 30.000€, ndërsa ndryshimin e padisë e ka lejuar gjykata, atëherë pavarësisht faktit që pala paditëse nuk ka paguar diferencën e taksës, Gjykata Supreme në vlerësimin e lejueshmërisë së

revizionit duhet ta merr jo shumën fillestare të kërkesëpadisë, por duhet ta marrë shumën për të cilën është lejuar ndryshimi i padisë.

- Pavarësisht faktit që vlera e objektit të kontestit nuk mund të përdoret si shkak për paraqitjen e revizionit, pra nuk mund të paraqitet revizioni për këtë shkelje, megjithatë Gjykata Supreme duhet të kujdeset që vlerën e objektit të kontestit apo "*ratione valoris*" të trajtoj edhe në aspektin e të drejtës për gjykim të drejtë sipas neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe te Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces te rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.
- Gjykata Supreme të drejtën për qasje në gjykatë për aspektet që ndërlidhen me vlerën e kontestit apo "*Ratione Valoris*", në trajtimin e rasteve duhet t'i përmbahet praktikës së ndërtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës si dhe kritereve të përcaktuara nga GJEDNJ-së, të cilat kanë të bëjnë me Vlerësimin e Kufizimeve *Ratione Valoris, dhe atë*: Parashikueshmëria: vlerësimi nëse rregullat procedurale janë të qarta dhe të parashikueshme; Atribuimi i gabimeve: vlerësimi se kush duhet të mbajë pasojat e gabimeve procedurale pala apo shteti dhe Formalizmi i tepruar: nëse zbatimi i rreptë i rregullave kufizon padrejtësisht qasjen në drejtësi.

Nenad Lazić

Servitutet dhe mbrojtja gjyqësore e servituteve

1. Koncepti i servituteve

Zyrtarizmat, formalitetet, shërbyeshmëritë, servitutet, janë të drejta sendore, titullari i të cilave është i autorizuar që në masë të caktuar t'i shfrytëzojë, përdorë, përzgjedh frytet, sendin e tjetrit, ose të kërkojë nga pronari i saj të mos e përdorë atë në një farë mënyre. Servitutet, pra, janë të drejta sendore mbi sendin e dikujt tjetër, që quhet një gjë shërbyese, një e mirë shërbyese. Në varësi të asaj se a janë krijuar në favor të pronarit të një paluajtshmërie ose në favor të një personi të caktuar, ndahen në sendore dhe personale. Në sistemin tonë juridik janë të rregulluara me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, nenet 218-264, dhe Ligjin për marrëdhëniet themelore juridike pronësore, nenet 49-60.

2. Servitutet personale

Siç ju tregon edhe emri, servitutet personale krijohen në favor të një personi dhe janë të lidhura me atë personalitet. Një servitut personal është një e drejtë e kufizuar sendore që i jep autorizim një personi të caktuar që në mënyrë të caktuar të shfrytëzojë sendin e dikujt tjetër (send shërbyes), kurse çdo pronar i atij sendi duhet ta durojë atë.

Servitutet personale janë: e drejta e frutgëzimit, e drejta e përdorimit dhe e drejta e banimit.

Servitutet personale krijohen për një kohë të caktuar kohore dhe pushojnë me skadimin e kohës për të cilën ato janë krijuar, dhe më së voni me vdekjen e personit të autorizuar, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Servitutet personale për shkak të vetë karakterit të tyre, përkatësisht për shkak të lidhjes me personalitetin e titullarit, nuk mund të barten te personi tjetër.

Për të njëjtën arsye, servitutet personale nuk mund të trashëgohen, përveç servituteve të përcaktuara shprehimisht edhe për trashëgimtarët e personit të autorizuar.

Servituti personal i përcaktuar shprehimisht edhe për trashëgimtarët e personit të autorizuar shuhet me vdekjen e trashëgimtarit të fundit.

2.1. E drejta e frutgëzimit

E drejta e frutgëzimit (lat. usufructus) është e drejtë sendore që autorizon mbajtësin e saj - frutgëzuesin - të përdorë sendin e huaj dhe të korrë frytet e saj, me ç' rast është i detyruar ta ruajë vetë sendin në thelbin dhe dedikimin e saj. Kjo do të thotë se frutgëzuesi mund të përdorë, për shembull, tokën bujqësore, banesë ose pemëtore, dhe të realizojë të ardhurat dhe përfitimet që ato sjellin, por nuk duhet të tjetërsojë ose shkatërrojë vetë sendin. E drejta e frutgëzuesit sipas rregullit është e kufizuar në kohë, më së shpeshti zgjat deri në vdekjen e një personi fizik ose deri në skadimin e periudhës së përcaktuar me kontratë, kurse mund të përcaktohet në bazë të ligjit, punës juridik ose vendimit të gjykatës. Pas përfundimit të kësaj të drejte, pronarit të sendit i kthehet autorizimi i plotë e disponimit dhe gëzimit.

2.2. E drejta e përdorimit

E drejta e përdorimit është një servitut personal që autorizon një person të caktuar që në kufij të nevojave të tij personale dhe nevojave të anëtarëve të familjes së tij të përdorë sendin e dikujt (sendi shërbyes) sipas qëllimit të tij, duke ruajtur përmbajtjen e tij.
E drejta e përdorimit mund të ekzistojë në një send të shfrytëzueshëm të pakonsumuar, të luajtshëm ose të paluajtshëm, ose në disa sende të luajtshme. Në sendet e konsumueshme nuk është e mundur të vendoset ky lloj servituti.

2.3. E drejta e banimit

E drejta e banimit është një servitut personal që autorizon titullarin e tij të përdorë ndërtesën e banimit të dikujt ose një pjesë të saj të destinuar për banim (sendi shërbyes) në përputhje me atë qëllim, duke ruajtur përmbajtjen e sendit shërbyes.
Pronari rezervon të drejtën e disponimit të atyre pjesëve të paluajtshmërisë që nuk janë të destinuara për banim, si dhe pjesët e

banimit që nuk janë lëndë e së drejtës së banimit, por jo në një mënyrë që pengon ushtrimin e së drejtës së banimit.
Ushtrimi i së drejtës së banimit nuk duhet t'i pengohet ose vështirësohet pronarit monitorimi i nevojshëm i të gjithë pronës së tij të paluajtshme.

3. Servitutet Sendore

Servitut i vërtetë është e drejta e pronarit të një paluajtshmërie që në mënyrë të caktuar të përdorur paluajtshmërinë fqinje ose për të kërkuar nga pronari i paluajtshmërisë fqinje të përmbahet nga sjellje të caktuara. Prandaj, servitutet sendore janë të drejta mbi sendet e huaja, dhe ky lloj instituti juridik ekziston që nga kohërat antike. Qoftë nëse është fjala për të drejtën e kalimit, ndjekja e bagëtive, përdorimi i ujit, zbatimi i ujit të shiut, ideja e cila qëndron pas këtij instituti juridik është të lehtësojë shfrytëzimin e disa paluajtshmërive duke përdorur paluajtshmërinë fqinje në një mënyrë të caktuar. Servitutet sendore janë të lidhura me paluajtshmëritë dhe ndajnë fatin e tyre. Duke pasur parasysh se si janë ndarë të drejtat dhe detyrimet në këtë institut, dallojmë të mirave të privilegjuara, d.m.th. paluajtshmëria në "përfitimin" e së cilës është krijuar servituti dhe pronari i së cilës është titullari i të drejtës nga servituti; dhe e mira shërbyese, d.m.th. paluajtshmëria në "dëm" të së cilës është krijuar servituti dhe pronari i së cilës ka detyrimin të durojë sjellje të caktuara të pronarit të së mirës së privilegjuar, përkatësisht të përmbahet nga ndonjë sjellje. Me këtë, është detyrim i titullarit të servitutit të përdorë servitutin në një mënyrë që rëndon më pak të mirën shërbyese.

3.1. Lindja, krijimi i servituteve sendore

Janë tre mënyra themelore të lindjes së servitute sendore. Dallohen ato që janë përcaktuar nga vetë ligji dhe që ekzistojnë me zbatimin e tij të drejtpërdrejtë, ato që lindin nga lidhja e një kontrate midis pronarit të së mirës së privilegjuar dhe shërbyese dhe ato që lindin nga mirëmbajtja - ushtrimi i papenguar i servitutit gjatë periudhës së caktuar kohore.

3.2. Servitutet sendore ligjore

Servitutet sendore ligjore janë ato që ekzistojnë në bazë të vetë ligjit. Përmbajtja e të drejtave dhe detyrimeve, autorizimet dhe detyrimet e personave që marrin pjesë në këtë marrëdhënie juridike, kohëzgjatja, etj., janë të përcaktuara me vetë ligjin dhe nuk kanë nevojë të përcaktohen me një punë juridike ose të regjistrohen në librin e tokës për të prodhuar efekte juridike. Ky lloj i servituteve sendore quhet edhe të drejtat fqinjësore sepse qëllimi i tyre themelor është ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe mundësimi i përdorimit të papenguar dhe sa më të lehtë të paluajtshmërisë. Të drejtat e fqinjësisë ndahen në ato që merren me të drejtat që rrjedhin nga demarkacioni i paluajtshmërisë, të drejtat fqinjësore që autorizojnë pronarin e një paluajtshmërie që në njëfarë mënyre të përdorë paluajtshmërinë e fqinjit të tij, të drejtat fqinjësore që autorizojnë pronarin e paluajtshmërisë të kërkojë nga pronari i një paluajtshmërie fqinje të përmbahet nga sjellje të caktuara dhe së fundi, ato të drejta fqinjësore që autorizojnë pronarin e një paluajtshmërie të kërkojë nga fqinji i tij të bëjë diçka.

-*Të drejtat fqinjësore që merren me demarkacionin e paluajtshmërisë* është e caktuar që të rrethohen, brazdat, megjat, kanalet dhe ndarjet e ngjashme që gjenden midis tokave fqinje, gjenden në pronësi të përbashkët të fqinjëve, përveç nëse vërtetohet se janë në pronësi ekskluzivisht të njërit prej fqinjëve. Me mur të përbashkët, gardh, brazdë, etj., mund të përdoret lirisht nga çdo fqinj deri në gjysmën e gjerësisë së tyre. Pema e cila gjendet në megje është gjithashtu pronë e përbashkët e fqinjëve. Pronësia e pemës përcaktohet sipas trungut dhe jo sipas rrënjës, kështu që rregulli është që pema i përket atij në tokën e të cilit është pema, me atë që fqinji që duron degët që kalojnë në tokën e tij ka të drejtën edhe në frutat prej tyre.
"Të drejtat e përdorimit të paluajtshmërive fqinje konsistojnë para së gjithash në autorizimin e pronarit të një paluajtshmërie për të kaluar në paluajtshmërinë e fqinjit për të kapur një kafshë të arratisur, një tufë bletësh të arratisur, pastaj për të mbledhur fruta nga pema e tij frutore ose për të kthyer gjërat që aksidentalisht përfunduan atje. Gjithashtu, pronari i paluajtshmërisë është i autorizuar që, pasi të njoftojë fqinjin për këtë, dhe nëse nuk mund të kryejë riparime në tokën e tij, të përdorë

paluajtshmërinë e fqinjit për mbajtjen e materialeve, vendosjen e skelave dhe për qasje te punëtorët.

- *Të drejtat për të kërkuar nga fqinji të mos përdorë paluajtshmërinë e tij në një mënyrë të caktuar* konsiston në autorizimin e pronarit të një paluajtshmërie që të kërkojë nga fqinji të mos përdorë paluajtshmërinë e tij në një drejtim të caktuar. Pronari i një paluajtshmërie nuk guxon të kryejë punë në tokën e tij që rrezikojnë paluajtshmërinë e fqinjit (p.sh. gërmimi i tokës ose themeleve) përveç nëse nuk merr masat e duhura të sigurisë. Në këtë të drejtë fqinjësore bie edhe e drejta e pronarit të paluajtshmërisë për të mos vuajë *emetime të dëmshme* që rrjedhin nga paluajtshmëria e fqinjit. Kjo e drejtë konsiston në autorizimin e pronarit të një paluajtshmërie për të kërkuar që fqinji të ndalojë me *emetimet* e panevojshme dhe të dëmshme. Edhe këtu ideja është të mbrohet nga përdorimi i dëmshëm i paluajtshmërisë nga ana e fqinjit. Në këto emetime bien pluhuri, tymi, aromat, ujërat e zeza, zhurma, etj. Megjithatë, këto emetime duhet të durohen deri në një masë të caktuar, dhe vetëm nëse emetuesi tejkalon kufirin e tolerancës, fqinji i tij ka të drejtë të kërkojë që emetimet të ndalen, d.m.th. të reduktohen në masë të duhur. Kufiri deri te i cili mund të durohen emetimet nuk është i fiksuar me ligj, as nuk mund të jetë, por varet nga natyra dhe destinimi i paluajtshmërisë dhe nga rrethanat lokale (p.sh. aromat që janë të zakonshme dhe të domosdoshme në mjedisin rural nuk mund dhe nuk duhet të durohen në mjedisin urban). Gjithashtu, nëse emetimet burojnë nga veprimtaria e cila është me interes të përgjithshëm, nuk mund të kërkohet heqja e plotë e tyre, por vetëm të reduktohen në një masë më të vogël me përdorimin e mjeteve teknike.

- *Të drejtat për t'i kërkuar pronarit të një paluajtshmërie fqinje të bëjë diçka* konsistojnë para së gjithash në të drejtën e pronarit të paluajtshmërisë e cila është e rrezikuar nga rrënimi i ndërtesës për të kërkuar nga ai person që do të ishte përgjegjës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga rrënimi të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe shmangien e dëmit. Pronari i një paluajtshmërie gjithashtu ka të drejtë të kërkojë që fqinji të mos kullojë ujin e tij të shiut në tokën e tij. Gjithashtu, fqinjët kanë të drejtë të kërkojnë një përcaktim me marrëveshjeje të kufirit midis paluajtshmërive dhe vendosjen e megjave në procedurë jokontestimore.

4. Servitutet sendore kontraktuale

Me kontratë mund të rregullohen në mënyrë më të mirë marrëdhëniet midis pronarëve të dy paluajtshmërive fqinje, d.m.th. të caktohet përmbajtja e servituteve sendore. Kjo kontratë duhet të përpilohet në formë të shkruar dhe pas kësaj, servituti sendor duhet të jetë e regjistruar edhe në librin e tokës. Në rast se një nga paluajtshmëritë ka më shumë pronar, pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve është i domosdoshëm për lidhjen e kësaj kontrate. Me kontratë mund të përcaktohet por edhe nuk është patjetër kompensimi. Pra, në varësi të vullnetit të kontraktorit, kjo kontratë mund të jetë edhe barrë edhe bamirësi. Servituti sendor mund të lindë edhe në bazë të testamentit në formën e një trashëgimie, ku testatori krijon një servitut në favor të trashëgimtarit, d.m.th. pronari i të mirës së privilegjuar. Servitutet sendore që fitohen përmes një pune juridike janë më në numër, të përmendim vetëm disa - e drejta për të mbështetur një ndërtesë në murin e fqinjit, e drejta për të hapur dritaret në murin e fqinjit, e drejta për të lënë tym përmes oxhakut të fqinjit, e drejta për të vendosur antena në kulmin e fqinjit, e drejta për të lëshuar lëngje në tokën e fqinjit. Nga ato që ndalojnë pronarin të paluajtshmërisë sjellje të caktuar, le të përmendim - detyrimin për të mos e bërë shtëpinë më të lartë ose më të ulët, detyrimin për të mos e privuar ndërtesën fqinje nga drita ose ajri, detyrimin për të mos kulluar ujin e shiut nga toka e fqinjit nëse atij i shërben për ujitje, etj. Nga servitutet sendore, d.m.th. ato që janë karakteristike për mjedisin rural aty janë - e drejta për mirëmbajtjen e shtegut, rrugë bagëtish ose kolosale në tokën e fqinjit, dhënien e ujit bagëtive në tokën e fqinjit, pompimi i ujit për ujitje, nxjerrja e rërës, gëlqeres ose gurit, etj.

4.1. Servitutet sendore të lindura nga mirëmbajtja

Ligji për bazat e marrëdhënieve pronësoro-juridike përcakton afat prej 20 vitesh për fitimin e servitutit sendor me mirëmbajtje. Nëse brenda këtij afati pronari i të mirës së privilegjuar faktikisht ka realizuar servitutin kurse pronari i të mirës shërbyese nuk i është kundërshtuar kësaj, servituti sendor është fituar në bazë të mirëmbajtjes. Është gjithashtu e nevojshme që ai ushtrim faktik i servitutit sendor të mos jetë kryer nga abuzimi me

besimin e pronarit ose mbajtësit të së mirës së privilegjuar, me forcë, mashtrim, ose nëse servituti është dhënë deri në revokim. Prandaj, pronari i të mirës shërbyese që nuk kundërshton ushtrimin e këtij servituti dakordohet në heshtje me ekzistencën e saj. Barra e provës së të gjitha këtyre fakteve bie mbi pronarin e së mirës së privilegjuar. Në rast se ushtrimi i servitutit është dhënë deri në revokim, nuk mund të arrihet deri te fitimi i kësaj të drejte me mirëmbajtje, sepse me këtë do të abuzohej me dobinë e pronarit të së mirës shërbyese që lejonte përdorimin e paluajtshmërisë nga marrëdhëniet miqësore. Në këtë rast, servituti përfundon me revokimin, përkatësisht me deklaratë të njëanshme të vullnetit të pronarit të së mirës shërbyese.

4.2. Servitutet sendore të përcaktuara me vendim gjykate

Servitutet sendore mund të fitohen edhe me vendim gjykate ose organi tjetër kompetent. Me vendim gjykate, atëherë kur pronari i së mirës shërbyese e kundërshton atë, do të përcaktohet servituti sendor, nëse pronari i të mirës së privilegjuar nuk mund ta përdorë atë të mirë tërësisht ose pjesërisht pa përdorur të mirën shërbyese. Gjykata me kërkesë të pronarit të së mirës shërbyese mund të përcaktojë edhe tarifën që pronari i të mirës së privilegjuar do të jetë i detyruar të paguajë. Për këtë lloj kërkese është kompetente gjykata në territorin e së cilës ndodhen paluajtshmëritë, me rastin e së cilës duhet të vendoset e drejta e servitutit. Nëse këto paluajtshmëritë ndodhen në territore për të cilat më shumë se një gjykatë janë kompetente, mund të ngrihet padi në cilëndo prej tyre. Ky servitut lind në ditën kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë dhe nuk ka nevojë të regjistrohet në librin e tokës. Servituti më karakteristik që përcaktohet me vendim gjykate është servituti *i kalimit të domosdoshëm.* Ai përcaktohet në rastin e ekzistencës së enklavës, d.m.th. tokës që nuk ka dalje në rrugë publike përveç përmes të mirës shërbyese, si dhe në rastin kur deri në rrugë publike mund të arrihet vetëm me anashkalim të tepruar. Kalimi mund të përcaktohet si e drejta e kalimit në këmbë, me makinë, mjetet motorike ose makineri bujqësore. Për këtë servitut paguhet tarifa. Me vendim gjykate gjithashtu mund të përcaktohet edhe servituti i vendosjes së linjave (elektrike, ujësjellësit, kanalizimit, gazit,

telekomunikacionit, etj.) mbi ose përmes tokës së fqinjit, nëse vendosja e linjave diku tjetër do të shkaktonte kosto joproporcionale.

4.3. Karakteristikat e servituteve sendore

Meqenëse format e së drejtës së servitutit sendor nuk janë rregulluara me ligj në kuptim të përmbajtjes që nga e drejta romake, kjo te e drejta e servitutit sendor flitet për parime dhe karakteristika. Ato janë një "digë" kundër kufizimit të tepruar të të drejtave të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme edhe në rastet kur për këtë nuk ka nevojë. Prandaj, në vend të shqyrtimit të formave individuale servitutet sendore përcaktojnë parimet dhe karakteristikat, të cilat kanë për qëllim të lejojnë konstituimin e servituteve sendore vetëm në raste të caktuara, në mënyrë që të mos kufizohet për së tepërmi të drejtën e pronës private. Prona do të duhet të përfaqësonte institut të paprekshëm, përkatësisht, një e drejtë absolute me efekt erga omnes, por kufizimet ekzistuese që kanë të bëjnë me pronarin e një prone të caktuar dhe të cilat i njeh Ligji dëshmojnë se edhe ky absolutitet mund të jetë, thënë kushtimisht e rrezikuar. Në mënyrë që të zvogëlohet shkalla e kufizimit të pushtetit ligjor të një personi mbi sendin e tij, dhe në atë mënyrë të mbrohet prona private, janë kristalizuar karakteristikat e caktuara të servituteve sendore si një institut me të cilin kufizohet e drejta e pronës.

- Servituti krijohet me qëllim të përdorimin më të mirë të së mirës së privilegjuar (praedio utilis)

Servitutet sendore konstituohen me qëllim të ofrimit të një përfitimi të caktuar për të mirën e privilegjuar (praedio utilis) e assesi për t'i ofruar përfitim personal pronarit të së mirës së privilegjuar. Kjo do të thotë se servituti sendor nuk mund të ekzistojë për lehtësi, por vetëm kur është i domosdoshëm dhe i nevojshëm. Servituti sendor që nuk do të paraqiste përfitim për të mirën shërbyese nuk do të justifikonte ekzistencën e tij, kështu që mbijetesa e tij do të nënkuptonte një abuzim të së drejtës, në një farë kuptimi kjo do të ishte ngacmim.

- Nuk është i lejuar konstituimi i servitutit me qëllim të plotësimit të nevojave personale ose interesave personale të pronarit të një të mire të privilegjuar, p.sh. servituti sendor për qëllime kursimi. Prandaj, nuk mund të merren parasysh nevojat personale të pronarit me rastin e

konstituimit të servituteve personale, sepse atëherë do të kishim të bënim me servitute personale dhe jo sendore. Sipas praktikës gjyqësore, ekzistenca e një rruge rurale drejt një të mire të privilegjuar që nuk është mjaftueshëm e rehatshme nuk paraqet arsye për të përcaktuar të drejtën e servitutit sendor.

- E drejta e servitutit si autorizim për t'u shërbyer me sendin e huaj mund të ketë si qëllim komoditetin për titullarin e kësaj të drejte të Servitutit sendor. Kjo është një çështje faktike, kështu që gjykata vlerëson justifikimin e konstituimit të servitutit sendor në çdo rast të veçantë. Ndërprerja e një nevoje objektive mund të çojë në anulimin e servitutit sendor, përkatësisht, në atë rast, pronari i të mirës shërbyese është në gjendje të kërkojë shfuqizimin e saj. Në situata të tilla, gjykata do të vlerësojë bazueshmërinë e kërkesës.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.370/2020 i datës 19.10.2021:

"Në bazë të dispozitës së nenit 260 të Ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore është përcaktuar: "Për shuarjen e servitutit sendor janë të nevojshme deklarata e pronarit të paluajtshmërisë dominuese për heqjen dorë nga servituti sendor dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. 2. Pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar mund të kërkojë shlyerjen e servitutit sendor, nëse servituti sendor nuk është më i nevojshëm për shfrytëzimin e paluajtshmërisë dominuese ose nëse në mënyrë substanciale kanë ndryshuar rrethanat. Shlyerja e servitutit duhet të regjistrohet në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri". Nëse marrim parasysh paragrafin e parë të kësaj dispozite, për shuarjen e servitutit është e nevojshme deklarata e heqjes dorë nga e drejta e pronarit të paluajtshmërisë së privilegjuar, në rastin konkret të paditurit, e meqenëse nuk kemi një deklaratë të tillë, nuk është përmbushur kushti për shuarjen sipas kësaj dispozite. Gjithashtu, edhe nëse marrim paragrafin e dytë të këtij neni, nga shkresat e lëndës nuk mund të përcaktohej kushti se servituti sendor nuk është më i nevojshëm për shfrytëzimin e të mirës së privilegjuar dhe se rrethanat nuk kanë ndryshuar në thelb, sepse nuk është vërtetuar se rrethanat kanë ndryshuar që nga koha kur është përcaktuar e drejta e servitutit sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë C. nr. 43/07 e datës

19.09.2007, e cila u konfirmua me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ae. nr. 308/08 e datës 03.02.2009".

- Parimi i kursimit në ushtrimin e të drejtës së servitutit sendor (fundus fundo servit)

Pronari i të mirës së privilegjuar është i autorizuar të ushtrojë të drejtën që është krijuar me qëllim të shfrytëzimit më të mirë të mirës së tij. Në këtë drejtim, ai nuk duhet të jetë i kufizuar nga ana e pronarit të së mirës shërbyese, si dhe nga palët e treta. Meqenëse servitutet sendore paraqesin të drejta që kanë të bëjnë me pronën e huaj, titullari i të drejtës së të mirave shërbyese duhet të ushtrojë të drejtën e tij në mënyrë që më së paku e rëndon të mirën shërbyese dhe duhet t'i përdorë me kujdes, siç është karakteristikë e një mikpritësi të mirë. Parimi i kursimit ose kufizimit paraqitet gjithmonë kur në ushtrimin e së drejtës ekziston një komunitet i caktuar, dhe ky është pikërisht rasti me servitutet sendore. Në të drejtën romake, u krijua një rregull që titullari i të drejtës së servitutit duhet të shfrytëzojë të drejtën e tij si qytetar i ndërgjegjshëm (servitus civiliter exercenda est), pra si një mikpritës i mirë (p.sh. nëse dikush ka të drejtën e kalimit në këmbë, ai nuk mund të kullotë bagëti atje, ose nëse dikush ka të drejtën e kalimit me bagëti, kjo nuk do të thotë se ai ka të drejtën e kalimit me mjet motorik). Servitutet sendore nuk mund të zgjaten. Në këtë nuk ndikojnë nevojat e reja të së mirës së privilegjuar, nëse ato nuk janë pasojë e zhvillimit dhe shfrytëzimit normal të së mirës së privilegjuar. Për shkak se ato paraqesin barrë për pronarin e së mirës shërbyese, personi që ka të drejtën e servitutit sendor duhet të ketë kujdes për interesat e pronarit, duke ruajtur të mirën shërbyese sa më shumë që të jetë e mundur dhe duke mos e rrezikuar atë. Kur bëhet fjalë për kursimin e së drejtës shërbyese, titullari i së drejtës së servitutit sendor duhet të ketë parasysh parimin e kufizimit, përkatësisht ngushtimin e të drejtës së servitutit sendor. Titullari i së drejtës së servitutit sendor që injoron këtë parim bën abuzim me të drejtën, duke pasur parasysh se kjo e drejtë duhet të ushtrohet me ndërgjegje dhe ndershmëri.

- Ekzistenca e më shumë servituteve në të njëjtin send

Në një pronë të privilegjuar mund të ekzistojë disa servitute të të njëjtit lloj ose të ndryshëm, dhe megjithatë i njëjti lloj servituti mund të jetë i

njëjtë ose i ndryshëm. Megjithatë, në rast se rrethanat ndryshojnë dhe si rezultat i kësaj shfaqet pamundësia e ushtrimit të të gjitha servituteve në masën e plotë, përparësi do të ketë ai servituti që është fituar më parë. Këtu vlen rregulli prior tempore potior iure - krijimi i një servituti të ri nuk duhet të kufizojë një servitut tashmë ekzistues. Pra, vlen rregulli që një e drejtë e fituar më herët është më e fortë se një e drejtë e fituar më vonë. Servituti i fundit është i ngushtuar në vëllimin e tij, dhe mund edhe të përfundojë, e kështu me radhë nga më herët në të mëvonshmen. Nëse dy servitute fitohen në të njëjtën kohë, por ekzekutimi i njërit ndërhyn në ekzekutimin e tjetrit dhe me këtë titullarët e servituteve nuk arrijnë një marrëveshje, secili prej tyre mund të kërkojë që gjykata të rregullojë ekzekutimin e përmbajtjes së servitutit duke u kujdesur për interesat e të dy titullarëve.

- Nuk ka servitut në sendin e vet (nulli res sua servit)

Servituti nuk mund të kihet në paluajtshmërinë e vet (nulli res sua servit). E drejta romake qëndroi në të njëjtin këndvështrim. Duke qenë se servituti sendor paraqet marrëdhënie juridike midis pronarëve të dy paluajtshmërive, është logjike që ajo nuk mund të jetë e përbërë në sendin vetjak, por vetëm në të huaj. Pronari i sendit në kuptim të sendit vetjak ka një grup të kompetencave më të gjera, të cilat janë shumë më të gjera se ato të cilat i ka titullari i servitutit, kështu që servituti as që i është i nevojshëm. Kur bëhet fjalë për paluajtshërinë e pandarë në bashkëpronësi, deri në shpërbërjen e bashkëpronësisë me mjete fizike, bashkëpronarët përdorin së bashku paluajtshmërinë e pandarë, kështu që në atë rast ata nuk mund të jenë titullarë të së drejtës së servitutit sendor mbi të njëjtën. Në procedurën e ndarjes, bashkëpronarët mund me marrëveshje ose në bazë të vendimit gjyqësor që në pjesët e ndara fizikisht konstituojnë servitut. Sipas të drejtës sonë, asnjë person nuk mund të ketë servitut mbi paluajtshmërinë vetjake, dhe rrjedhimisht edhe mbi paluajtshmërinë që është në pronësi të përbashkët, kështu që gjykata nuk do të ofrojë mbrojtje për të drejtën e servitutit të kalimit në paluajtshmërinë që është në pronësi të përbashkët të palëve. Servituti sendor përcaktohet vetëm në situatë kur pronari i të mirës së privilegjuar, pa kufizim të së drejtave pronësore të pronarëve të së mirës shërbyese, nuk mund fare ose nuk mund të kryejë pa dëm disproporcional që të bëjë shfrytëzimin ekonomik të së mirës së tij.

- Pandashmëria e së drejtës së servitutit sendor

Servituti sendor mund të ekzistojë vetëm në favor, përkatësisht, në barrë të paluajtshmërisë së të tërësishme, dhe aspak vetëm një pjesë të saj. Në këtë pasqyrohet pandashmëria e servitutit sendor. Ato nuk mund të fitohen dhe as të humbasin në pjesë alikuate, përkatësisht në favor ose në barrë të pjesës së tokës. Prandaj, një nga bashkëpronarët e paluajtshmërisë, e cila duhet të bëhet e mirë shërbyes, nuk mund ta bazojë servitutin në pjesën e tij ideale të bashkëpronësisë së asaj paluajtshmërie. Gjithashtu, asnjë nga bashkëpronarët nuk mund të fitojë një servitut sendor në favor të pjesës së tij të paluajtshme (servitus per partes squiri non potest), sepse bashkëpronari ka të drejtën e pronësisë së secilës pjesë të sendit të bashkëpronësisë, në proporcion me pjesën e tij të bashkëpronësisë (pjesa ideale). Parimi i pandashmërisë së servitutit buron nga natyra e servitutit, sipas së cilës përfitimi i cili realizohet nga servituti i pandashëm. Me ndarjen e së mirës së privilegjuar nuk duhet të rrisë barrën mbi të mirën shërbyese, sepse shtrirja e servitutit është caktuar me aktin e konstituimit. Në rast se vije deri te ndarja e së mirës shërbyese, servituti do të rëndojë të gjithë paluajtshmërinë e sapoformuar, dhe nëse ushtrimi i saj faktikisht shtrihet vetëm në disa, pronarët e të tjerave mund të kërkojnë fshirjen e servitutit nga parcelat vetjake.

- Detyrimi i pronarit të së mirës shërbyese nuk mund të konsistojë në bërjen (servitus in faciendo consistere nequit)

Detyrimi i pronarit të së mirës shërbyese nuk mund të konsistojë në bërjen (servitus in faciendo consistere nequit). Ky parim u krijua qysh në të drejtën romake: “Të gjitha servitutet janë të drejta sendore. Prandaj, titullari i servitutit nuk mund të kërkojë ndonjë veprimtari pozitive nga pronari i së mirës shërbyese. Ai vetëm mund ta parandalojë pronarin të bëjë diçka që është e dëmshme për servitutin dhe t'i kërkojë pronarit të mos e pengojë në shfrytëzimin e servitutit. E drejta e servitutit sendor i jep pronarit të një të mire të privilegjuar të mund të kërkojë nga pronari i të mirës shërbyese një tolerancë ose mirëmbajtje, por pronari që zotëron të mirën nuk mund të kërkojë në asnjë mënyrë asnjë veprim. Të drejtat sendore nuk korrespondojnë kurrë me një detyrim për një veprim pozitiv të debitorit, vetëm nga ky detyrim skadon një detyrim i ri për të hequr

detyrimin. Megjithatë, ka një devijim nga ky rregull. Të drejtat moderne janë përballur me situata në të cilat është i nevojshëm ndonjë veprim, d.m.th. veprim pozitiv, nga ana e pronarit të së mirës shërbyese në mënyrë që të mund të ushtrohet vetëm e drejta e servitutit sendor. Ky veprim mund të manifestohet si mirëmbajtja e tubave të ujësjellësit, puseve, rrugëve dhe të ngjashme. Nëse për shfrytëzimin e servitutit është i nevojshëm përdorimi i pajisjes së caktuar, atëherë kostot e mirëmbajtjes së asaj pajisjeje i bart titullari të servitutit sendor, por nëse ajo pajisje është po aq e dobishme për pronarin e të mirës së privilegjuar dhe pronarin e së mirës shërbyese, atëherë kostot rreth mirëmbajtjes së saj bartin në mënyrë të barabartë. Detyrime të tilla të titullarit (pozitive) janë të lejueshme nëse janë tërthore dhe nëse nuk ndikojnë ndjeshëm në rregullin e servitus in faciendo consistere nequit, pra, me to nuk duhet të ndryshohet e drejta juridike e të drejtës së servitutit sendor. Jemi dëshmitar se në kohën e sotshme ndryshohen nevojat me ritme të përshpejtuara, dhe për këtë arsye edhe ky detyrim i pronarit të së mirës shërbyese në shtrirjen e saj mund të bëhet me kalimin e kohës shumë më i madh se ai që ekzistonte në fillim dhe kështu të paraqesë një barrë të madhe për të. Në këtë rast, sipas disa kodeve civile, pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar mund të lirohet nga servituti, pjesa e paluajtshmërisë e cila është e ngarkuar me servitut apo edhe e gjithë paluajtshmëria që paraqet një e mirë shërbyese, sipas parimit të braktisjes (e drejta për të braktisur pronën).

- E drejta e servitutit sendor një e drejtë ndihmëse

Servituti sendor ndan fatin e të mirës së privilegjuar, përkatësisht të drejtës shërbyese. Servitutet sendore në asnjë rast nuk mund të ndahen ose tjetërsohen nga e mira mbi të cilën janë konstituuar, sepse ato janë të lidhura ngushtë me të mirën shërbyese, kështu që në qarkullimin sendor kanë fatin e përbashkët sendor. Servituti sendor me rastin e tjetërsimit shfaqet si pjesë e së mirës së privilegjuar, si atributi i saj. Vetë ndryshimi i pronarit të së mirës së privilegjuar ose shërbyese, ose të dyjave, nuk e ndryshon përmbajtjen e servitutit sendor, sepse kjo nuk ka të bëjë me të drejtën e personit të caktuar, por ka të bëjë me ndryshimin e pronarit, ndryshimi i të cilit është i lejuar. Servituti si e drejtë sendore është një e drejtë absolute dhe vepron ndaj të gjithëve (erga omnes), dhe jo vetëm midis personave të caktuar, pavarësisht se kush është pronari i së mirës

shërbyese, dhe pavarësisht nëse pronari i së mirës shërbyese apo një palë e tretë fyen ose kundërshton të drejtën e servitutit ndaj pronarit të së mirës së privilegjuar. Servituti sendor është një e drejtë sendore, dhe me tjetërsimin e paluajtshmërisë dhe ndryshimin e të drejtave sendore, në mënyrë automatike bën edhe bartjen e servitutit sendor, kështu që nuk ka nevojë për një dispozitë të veçantë për këtë, dhe në këtë shihet natyra ndihmëse e servituteve sendore.

- Mostransferueshmëria e së drejtës së servitutit sendor

Servituti sendor është vetvetiu e patransferueshme dhe si e tillë rëndon të gjithë të mirën shërbyese dhe është e lidhur me të gjithë të mirën e privilegjuar. Mostransferueshmëria e servitutit sendor do të thotë që servituti sendor nuk mund të transferohet dhe të ndahet nga e mira e privilegjuar në ndonjë paluajtshmëri tjetër. Servituti sendor shoqëron të mirën e privilegjuar dhe shërbyese, ashtu që me tjetërsimin e tyre vjen vetëm në një ndryshim të pronarëve të së njëjtave, përkatësisht persona të rinj shfaqen si mbajtës të këtyre të drejtave. Pra, këtu vlejnë dy rregullat e mëposhtme:

a) pronari i një sendi të privilegjuar, pavarësisht në cilën bazë juridike fiton sendin, fiton njëkohësisht të drejtën e servitutit sendor si përkatësi e saj;

b) kushdo që fiton të drejtën e pronësisë në sendin shërbyes mbi çfarëdo baze juridike, e fiton atë me servitutin ekzistues sendor, i cili paraqet barrë në të mirën sendore.

Në përputhje me karakteristikë të tillë, servitutet sendore as nuk mund të hipotekohen, sepse me këtë do të vihet deri te ndarja e tyre nga vetë e mira e privilegjuar, dhe tashmë është thënë më herët se ato përfaqësojnë të drejta ndihmëse dhe se si të tilla ndajnë fatin juridik të së mirës së privilegjuar përkatësisht të së mirës shërbyese.

5. Ndërprerja e servituteve sendore

Servitutet sendore mund të pushojnë së vlefshmi përmes punës juridike, për shkak të mosushtrimit në afat të caktuar dhe në bazë të vendimit të gjyqit.

Duke qenë se rregullat e përgjithshme për ndërprerjen e të drejtave vlejnë për servitutet, ato mund të ndërpriten *në bazë të një kontrate* midis pronarit të pronës së privilegjuar dhe shërbyese, por edhe me heqje dorë nga ana e pronarit të së mirës së privilegjuar. Kontrata gjithashtu duhet të përpilohet në formë të shkruar. Në bazë të kësaj kontrate do të vije edhe deri te fshirja e servitutit sendor nga libri i tokës. Për ndërprerje të servitutit gjithashtu është i nevojshëm pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve të së mirës së privilegjuar.
Ndërprerja për shkak të mosushtrimit është një formë e veçantë e ndërprerjes së kësaj të drejte. Ideja themelore e këtij instituti është në atë se servituti sendor të cilin titullari nuk përdor, për të cilën nuk është i interesuar, hiqet si barrë nga e mira shërbyese. Do të ishte e pajustifikuar që pronari i të mirës shërbyese të toleronte këtë kufizim të së drejtës së tij të pronësisë nëse pronari i së mirës së privilegjuar dukshëm nuk është i interesuar ta ushtrojë atë të drejtë, d.m.th. dukshëm nuk i është e domosdoshme. Afati i cili është i nevojshëm për skadimin e kësaj të drejte për shkak të mosushtrimit është njëzet vjet. Ligji parasheh edhe rast të veçantë të ndërprerjes për shkak të mosushtrimit të të drejtave. Domethënë, në rast se pronari i të mirës shërbyese kundërshton ekzistencën e servitutit sendor, atëherë ky afat është tre vjet.
Servitutet sendore mund të pushojnë së ekzistuari edhe *me vendimin e gjykatës* kur pronari i të mirës shërbyese kërkon anulimin e servitutit sendor nëse ai ka humbur çdo dobi për të mirën e privilegjuar. Për shembull, nëse pronari i të mirës së privilegjuar fiton mundësinë e kalimit mbi pronën e tij, do të ishte e dëmshme për pronarin e së mirës shërbyese të vazhdojë edhe më tej të mbajë barrën e së drejtës së tij të pronësisë.

Servitutet sendore mund të zhduken edhe nëse vjen deri te ndarja e së mirës së privilegjuar ose e servitutit shërbyes në më shumë pjesë. Nëse ndahet e mira e privilegjuar, servituti lind për të ekzistuar për secilën prej këtyre tërësive të reja veçanërisht. Nëse vjen deri te ndarja e së mirës shërbyese, servituti lind të ekzistojë vetëm për atë pjesë të së mirës shërbyese mbi të cilën ushtrohet servituti.

Servitutet sendore ligjore mund të ndërpriten vetëm nëse me kontratë

vërtetohet një servitut sendor që do ta zëvendësojë atë në mënyrë adekuate.

6. Mbrojtja gjyqësore e servitutit

Meqenëse mbajtësi i servitutit sendor është mbajtësi i së drejtës, ai mund të përdorë padi poseduese (shtetërore) për ndërhyrje në shtet. Kjo lloj padie duhet të ngrihet në afat prej tridhjetë ditëve nga data kur paditësi ka kuptuar për ndërhyrjen në përdorimin e servitutit sendor ose në afat prej një viti nga data kur ka filluar ndërhyrja, pavarësisht nëse mbajtësi ka kuptuar për të. Në mosmarrëveshjet shtetërore nuk diskutohen çështje juridike, por vetëm faktike. Prandaj, gjykata nuk do të merret me bazën juridike, përkatësisht ekzistencën ose mosekzistencën e së drejtës së servitutit sendor, por do të merret vetëm me ndërhyrjen e servitutit shtetëror më parë paqësor, pas së cilës me aktvendim do të urdhërojë të pandehurin të ndalojë ndërhyrjen e mëtejshme. Për këtë arsye, efektet e kësaj padie janë të përkohshme kurse ekzistenca ose mosekzistenca e së drejtës së servitutit mund të përcaktohet përfundimisht vetëm me një padi konfesionale. Për këtë lloj procedure është kompetente gjykata themelore, në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në të cilën ndodhi ndërhyrja. Në këtë lloj procedure është përcaktuar urgjenca e veprimit.

Titullari i të drejtës së servitutit (pronari i së mirës së privilegjuar) mund, siç u përmend tashmë, të ngrejë padi rrëfyese për mbrojtjen e së drejtës së servitutit në shkallë të plotë. Qëllimi i kësaj padie është që i padituri me aktgjykim të detyrohet të lejojë ushtrimin e të drejtës së servitutit në shkallë të plotë, ashtu siç thuhet, dhe t'ia ndalojë çdo ndërhyrje të mëtejshme. I padituri mund të jetë pronari i të mirës së privilegjuar si dhe çdo palë e tretë e cila parandalon përkatësisht pengon ushtrimin e së drejtës së servitutit. Baza e padisë është e drejta e servitutit, kështu që për të pasur sukses në këtë mosmarrëveshje, pronari i të mirës së privilegjuar duhet të dëshmojë ekzistencën e së drejtës së servitutit sendor (për dallim nga mosmarrëveshja shtetërore ku duhet të dëshmojë vetëm pronën shtetërore paqësore të kësaj të drejte).

Ekstrakte nga praktika gjyqësore

"kërkesëpadia e paditësve nuk është e bazuar, në kuptimin e nenit 58 të LBMPJ, i cili parashikon se servituti ndërpritet vetëm nëse pronari i pronës me të cilën shfrytëzohet i kundërshtohet një përdorimi të tillë, kurse pronari që e përdor tre vjet vazhdimisht të mos përdorë të drejtën e tij, ose nëse pronari i pronës shërbyese kërkon që e drejta e servitutit të ndërpritet kur e njëjta bëhet e panevojshme pas përfundimit të punimeve ose kur nuk ekzistojnë më shumë arsye për të cilat është vendosur fillimisht." Më tej, u theksua se "*ka rezultuar nga faktet e dëshmuara dhe provat se rruga e cila është lëndë e mosmarrëveshjes, mohimi i së cilës kërkohet nga paditësit, ka ekzistuar që nga viti 1973-74, fakte të cilat janë konfirmuar nga seanca dëgjimore e dëshmitarëve X.Y. dhe Z., të cilëve gjykata u dha besueshmëri sepse dëshmia e tyre përputhet me provat e tjera në lëndën dhe skicën e matjes nr. 13 të datës 21.08.1973, të lëshuar nga ana e Komunës e Pejës, ku është cekur ndarja e parcelave, edhe atë: 1) I.S., parcela nr. 5382/29, 2) M. M. parcela nr. 5382/4, tani parcela e paditësit, parcela nr. 5382/30, B.U., etj., si dhe me marrëveshjen e pronarëve të pasurive të paluajtshme kur është formuar rruga për kalimin për pronarët e parcelave të lartpërmendura dhe rruga që është lëndë e kontestit është përdorur pandërprerë nga ana e pronarëve të mëparshëm dhe përdoret edhe sot nga pronarët aktual, për ç' gjë padia e paditësve mbi këtë bazë duhet të refuzohet."*

(Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 89612 i datës 18.05.2016)

"gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave materiale të ekspertizës përkatëse gjeodezike, deklaratave të dëshmitarëve si dhe fakteve të pakundërshtueshme, ka konstatuar si duhet faktin se paditësit pa asnjë të drejtë kërkojnë të kundërshtojnë të drejtën e servitutit për të paditurit, të cilët, sipas vlerësimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ajo rrugë për të cilën paditësit kërkojnë kundërshtimin e servitutit, të paditurit e përdorin të njëjtën që nga viti 1973-74, dhe në lidhje me këtë nuk kanë pasur kurrë kurrfarë pengesash."

"paditësit nuk kanë mundur të kërkonin një të drejtë të tillë të cilën nuk e ka pasur as pronari i mëparshëm, përkatësisht shitësi në këtë rast konkret, dhe nga i cili paditësit e kanë blerë këtë pasuri të paluajtshme gjatë vitit 2010. Për rrugën e cila ekziston dhe për të cilën shumë vite nuk ekzistojnë kushtet ligjore për shuarjen e servitutit, përkatësisht kundërshtim të së njëjtës...

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Gž.nr.2743/16 i datës 25.01.2018)

"gjykatat e shkallës më të ulët kanë përcaktuar si duhet dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike që ka të bëjë me faktet vendimtare për gjykimin e saktë në këtë çështje juridike, në një gjendje të tillë faktike, sipas vlerësimeve të kësaj gjykate, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale [...]. Sipas gjendjes faktike të vërtetuar, rrjedh se rruga që është lëndë e kontestit përdoret pandërprerë që nga viti 1973 dhe e njëjta është lënë si kalim në bazë të marrëveshjes së pronarëve të parcelave nëpër të cilat kalon kjo rrugë, dhe një pjesë e asaj rruge kalon edhe përmes parcelës së paditësve në sipërfaqen 76 m^2. Sipas dispozitave të nenit 54, paragrafi 1 të LBMPJ, i cili zbatohet në këtë çështje juridike, është paraparë se "Servituti sendor fitohet me mirëmbajtje kur pronari i të mirës së privilegjuar faktikisht e ka ushtruar servitutin për kohë prej 20 vjetësh kurse pronari i të mirës shërbyese me këtë nuk është kundërshtuar". Gjykata e shkallës së parë në bazë të dispozitës së cekur ka vlerësuar drejtë se të padituri kanë fituar të drejtën e servitutit në rrugë e cila shtrihet nëpër parcelën 5382/4 e cila është në pronësi të paditësit si e mirë shërbyese, për arsye se të padituri e përdorin këtë rrugë më shumë se 20 vjet, si dhe kur paditësit e blenë parcelën e cekur, ata e blenë kur rruga ekzistonte tashmë. Sipas nenit 51 të LBMPJ, Servituti sendor bazohet me punë juridike, vendim të organit shtetëror dhe me mirëmbajtje, kurse në këtë rast konkret, baza e fitimit të servitutit është mirëmbajtja."

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 157/2018 i datës 4 korrik 2018)

"Duke respektuar pozicionin juridik të Gjykatës së Apelit të dhënë në këtë çështje ligjërisht gjyqësore, me aktvendim CA. nr. 783/13 të datës 03.07.2013, ku ndër të tjera theksohet se edhe servitutet e paregjistruara gëzojnë mbrojtje ligjore (nëse merret ose krijohet disponimi në përdorimin e tyre në mënyrë të ligjshme), atëherë, në përputhje me nenin 480 të Ligjit për procedurë kontestimore gjykata kufizohet vetëm në përcaktimin e dëshmimit të fakteve dhe gjendjes së fundit të disponimit dhe pengimit, duke mos u lëshuar në shqyrtimin në lidhje me të drejtën e disponimit, bazën juridike, disponim të ndërgjegjshëm apo të pandërgjegjshëm.. […] *në bazë të provave të paraqitura, gjykata konsideron se paditësit ishin mbajtësit e fundit faktik të rrugës së kontestuar* [...], *ndërsa të paditurit i privuan ata nga disponimi i tyre kundër vullnetit të tyre* [...], *dhe në këtë mënyrë vepruan paligjshëm, ku, si rezultat i kësaj gjykata vendosi t'u ofrojë mbrojtje gjyqësore paditësve."*

(Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 614/13 i datës 30.10. 2013)

Duke qenë se lënda e shqyrtimit është ndërhyrja në disponim, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin dhe argumentimin e fakteve të gjendjes faktike të disponimit dhe ndërhyrjes së shkaktuar. Në këtë kontest, është përjashtuar ekzistimi i së drejtës së disponimit në lidhje me bazën juridike, ndërgjegjen dhe mosndërgjegjen e disponimit. Në këtë rast, nuk është e rëndësishme që paditësit të kenë të drejtën e servitutit të kalimit në rrugën e kontestuar. […] Që paditësit faktikisht kanë përdorur rrugën e kontestuar është fakt i cili nuk mund të kontestohet as me ankesë. Ankesa konteston bazën juridike për servitutin e kalimit, duke theksuar se e drejta nuk është vendosur as me një akt juridik dhe as me regjistrimin në regjistrin e të drejtave të paluajtshmërive."

(Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës 4079/13 i datës 24.03.2014)

Në kuptimin e të lartpërmendurës, imponohet përfundimi se servitutet si instituti juridik lindën si pasqyrim i nevojave në jetën e përditshme, si rezultat i situatave praktike të cilat i impononte jeta, e të cilat ligjvënësi

më vonë duhej t'i formësonte juridikisht, kurse përpunimin e mëtejshëm të tyre kryente dhe e kryen praktika gjyqësore. Gjithmonë duhet pasur parasysh se servitutet, para së gjithash servitutet sendore, paraqesin kufizime të së drejtave sendore të personave të tjerë dhe se duhet të anohet një ekuilibër midis domosdoshmërisë së tyre dhe respektimit të pronës së huaj mbi të mirën e cila ngarkohet. Për këtë qëllim, edhe janë caktuar parimet të listuara më parë, dhe qëllimi i të cilave është pikërisht ky, që të mundësohet përdorimi i servitutit atëherë kur kjo është e domosdoshme, duke kufizuar kështu sa më pak e drejta e pronësisë të së mirës shërbyese.

Milena Djeric

Puna e gjykatave të instancave më të ulëta në lidhje me zbatimin adekuat të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, në lidhje me nulitetin dhe anulimin e kontratave

Qëllimi i këtij punimi është që gjyqtarët e Gjykatës Supreme të japin rekomandime se si të veprojmë në procedurat civile që zhvillohen për njërën nga mënyrat e ndërprerjes së kontratës, përkatësisht nulitetin dhe/ose rrezueshmerine e kontratës, dhe si ta bëjnë atë sa më efikase të jetë e mundur. Punimi do të flasë për kontratat e detyrimeve, për të cilat zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
Sipas qëndrimit dhe mendimit me shkrim të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për marrëdhëniet e detyrimeve, respektivisht kontratat e detyrimeve që janë krijuar para 20.12. 2012, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 29/78, 39/85 dhe 57/89), ndërsa për kontratat e detyrimeve të krijuara pas datës 19.12.2012, zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/19 e 19.06.2012).
Para përpunimit specifik të vetë temës, do të merremi me çështjen se çfarë është e nevojshme që të gjitha kontratat të konsiderohen të ligjshme dhe të prodhojnë efekte ligjore, përkatësisht, të gjitha kontratat duhet të plotësojnë kushte të caktuara, të cilat mund t'i ndajmë konkretisht në sa vijon:
1. deklarata e vullnetit duhet të jepet nga një person që ka zotësinë e nevojshme te veprimit, serioze - e bërë me qëllim prodhimin e një efekti juridik, dhe jo për ndonjë qëllim tjetër, e lirë (të mos këtë mungese vullneti) - lajthitje, mashtrim dhe/ose kërcënim, në formën e kërkuar, që efektet ligjore të dëshiruara të jenë në përputhje me ligjin dhe moralin
2. të ekzistoje baza e kontratës
3. që kushti të jete i lejueshëm dhe i mundshëm.
Kushtet e përmendura janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 18, 34, 35, 37 dhe 39 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077.

Sanksioni për mospërmbushjen e kushteve të përmendura është pavlefshmëria e kontratës, e cila mund të jetë e ndryshme, varësisht nga lloji i defektit.
Për defektet më të rënda, në praktikë sanksioni është nuliteti i kontratës (pavlefshmëri absolute), ndërsa për ato me një shkallë më të ulët shkeljeje, është anulimi, respektivisht rrëzueshmëria e kontratës (pavlefshmëri relative).
Pavlefshmëria ose anulimi i kontratës sugjeron në shikim të parë se ekziston një zgjidhje e kontratës që është krijuar tashmë, e cila prodhon efekte të caktuara ligjore.

1. Kontratat nule

Një kontratë që është në kundërshtim me rregulloret detyruese, rendin publik ose zakonet e mira është nule, d.m.th. siç përcaktohet në nenin 37 të Ligjit për Detyrimet, subjekti i detyrimit është i papranueshëm nëse është në kundërshtim me rregulloret e rendit publik, rregulloret detyruese ose moralin e shoqërisë.
Dispozita e nenit 35 të Ligjit për Detyrimet përcakton se kur subjekti i detyrimit është i pamundur, i papranueshëm, i pacaktuar ose i papërcaktueshëm, kontrata është absolutisht nule.
Dispozita e nenit 89, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Detyrimet përcakton se një kontratë që është në kundërshtim me rendin publik, rregulloret detyruese ose moralin e shoqërisë është nule nëse qëllimi i rregullit të shkelur nuk i referohet ndonjë sanksioni tjetër ose nëse ligji nuk parashikon diçka tjetër në një rast specifik. Nëse lidhja e një kontrate të caktuar i ndalohet vetëm njërës palë, kontrata do të mbetet në fuqi përveç nëse ligji parashikon ndryshe për një rast specifik, dhe pala që ka shkelur ndalimin ligjor do të mbajë pasojat përkatëse.

a) Rregulloret detyruese përfshijnë norma të së drejtës civile, penale, administrative, ekonomike, kundërvajtjeje - të cilat gjenden në akte ligjore dhe nënligjore. Në norma të tilla, përcaktohet se palëve kontraktuese u ndalohet të hyjnë në dispozita në kundërshtim me përmbajtjen e tyre. Për shembull, në të drejtën civile, afati i përgjithshëm i parashkrimit është dhjetë vjet dhe

është e ndaluar që palët kontraktuese të bien dakord për një afat tjetër të përgjithshëm të parashkrimit dhe një dispozitë e tillë kontraktuale do të ishte e pavlefshme (nule). Gjithashtu, është e ndaluar që palët kontraktuese të kontraktojnë një normë maksimale interesi kontraktuale më të lartë se ajo e përcaktuar me ligj, dhe nëse do të kontraktohej një normë interesi më e lartë, do të konsiderohej sikur të ishte kontraktuar norma më e lartë e lejuar.

b) Rendi publik është kategoria më e gjerë dhe nuk është e lehtë të përcaktohet se çfarë mund të jetë rendi publik, por është e qartë se është diçka që nuk mund të modifikohet me kontratë. Kështu, rendi publik mund të shihet si moral publik, norma morali që të gjithë duhet t'i respektojnë, pra si norma të së drejtës së brendshme që duhet të mbrohen në çdo rast. Në thelb, rendi publik mbron të gjitha ato norma që përmbajnë parimet themelore mbi të cilat bazohet ekzistenca e një shteti. Për shembull, në një rast nga praktika gjyqësore, dhënia e parave me qëllim "blerjen" e një nuseje, megjithëse një dukuri e shpeshtë në komunitetin rom, u shpall si një transaksion juridik absolutisht i pavlefshëm (nul) sepse është kundër rregullave të detyrueshme, rendit publik dhe zakoneve të mira, për arsye imoraliteti. Kështu, paratë që babai i dhëndrit i kërkoi mbrapsht babait të nuses (sepse martesa midis fëmijëve të tyre nuk u zhvillua) u morën, sepse ligji përcakton që pala tjetër duhet të kthejë atë që ka marrë në bazë të një transaksioni juridik të ndaluar. Po kështu, dispozita kontraktuale që thotë se babai i jep të birit një dhuratë me vlerë të madhe (një shtëpi për shembull) me kusht që ky i fundit të mos martohet me një grua të një kombësie tjetër është kundër rendit publik të Kosovës.

c) Zakonet e mira janë rregulla të pashkruara sjelljeje, të krijuara spontanisht nga përsëritja afatgjatë dhe të cilat pranohen përgjithësisht në një mjedis të caktuar, dhe në atë mjedis ekziston një vetëdije për detyrimin për të respektuar zakone të tilla. Në çdo rast specifik, gjykata do të vendosë nëse është një zakon i mirë, sepse në rastin e përshkruar më sipër të "blerjes" së një nuseje,

edhe pse është një zakon në komunitetin rom, nuk mund të kualifikohet si i mirë.

1.1. Pasojat e nulitetit

Në rast të nulitetit të kontratës, secila palë kontraktuese është e detyruar t'i kthejë palës tjetër gjithçka që ka marrë në bazë të një kontrate të tillë, dhe nëse kjo nuk është e mundur, ose nëse natyra e asaj që është përmbushur kundërshton kthimin, duhet të jepet një kompensim i përshtatshëm në para, sipas çmimeve në kohën e vendimit të gjykatës, përveç nëse ligji përcakton ndryshe. Por, nëse kontrata është nule sepse përmbajtja ose qëllimi i saj është në kundërshtim me rregulloret detyruese, rendin publik ose zakonet e mira, gjykata mund ta refuzojë, tërësisht ose pjesërisht, kërkesën e palës së pandershme për të kthyer atë që i ka dhënë palës tjetër. Gjatë vendosjes, gjykata do të marrë parasysh ndërgjegjen e njërës ose të të dyja palëve, si dhe rëndësinë e interesave në fjalë. (Dispozita e nenit 90, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Detyrimet).

1.2. Nuliteti i pjesshëm

Nuliteti i një dispozite të kontratës nuk nenkupton nulitetin e vetë kontratës, nëse ajo mund të mbijetojë pa dispozitën nule, dhe nëse nuk ka qenë as kusht i kontratës dhe as arsye vendimtare për lidhjen e kontratës. Por kontrata do të mbetet në fuqi edhe nëse dispozita nule ka qenë kusht ose motiv vendimtar i kontratës në rastin kur nuliteti është përcaktuar pikërisht në mënyrë që kontrata të lirohet nga ajo dispozitë dhe të jetë e vlefshme pa të. (Dispozita e nenit 91, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Detyrimet).

1.3. Konversioni

Kur një kontratë nule plotëson kushtet për vlefshmërinë e një kontrate tjetër, atëherë ajo kontratë tjetër do të jetë e vlefshme midis palëve kontraktuese, nëse do të ishte në përputhje me qëllimin që palët kontraktuese kishin në mendje kur lidhën kontratën dhe nëse mund të supozohet se ato do ta kishin lidhur atë kontratë po të ishin ne dijeni për

nulitetin e kontratës së tyre. (Dispozita e nenit 92 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).

1.4. Shuarja e mëvonshme e shkaqeve të nulitetit

Kontrata nule nuk bëhet e vlefshme, nëse ndalesa ose ndonjë shkak tjetër i pavlefshmërisë (nulitetit) zhduket më vonë.
Mirëpo, në qoftë se ndalesa ka qenë me rëndësi të vogël, ndërsa kontrata është zbatuar, atëherë
nuk mund të kërkohet nuliteti.
- Përgjegjësia e personit fajtor për nulitetin e kontratës
Kontraktuesi që është fajtor për lidhjen e kontratës nule i përgjigjet bashkë kontraktuesit të tij për dëmin që pëson për shkak të nulitetit të kontratës, në qoftë se ky nuk ishte në dijeni apo sipas rrethanave nuk do të duhej te ishte ne dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit. (Dispozita e nenit 93 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).
- Kërkimi i nulitetit
Për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar. (Dispozita e nenit 95 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).
Kërkimi i pakufizuar i nulitetit, perkatesisht e drejta e paraqitjes së kërkesës të nulitetit nuk shuhet. (Dispozita e nenit 96 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).

2. Kontrata e rrëzueshme

Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj ose me dispozitë të veçantë. (Dispozita e nenit 97 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).
Kontratat e rrëzueshme prodhojnë efekt juridik derisa njëri nga personat e autorizuar të kërkojë që kontrata të anulohet.
- Anulimi i kontratës
Pala kontraktuese, në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria, mund të kërkojë që kontrata

të shpallet e pavlefshme. Mirëpo, bashkëkontraktuesi i kësaj pale mund të kërkojë prej saj që, brenda afatit të caktuar, por jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë, të deklarohet se a mbetet pranë kontratës apo jo, sepse në të kundërtën do të konsiderojë se kontrata është anuluar. (Dispozita e nenit 98 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).
E drejta për të kërkuar anulimin e një kontrate të rrëzueshme pushon me kalimin e një afati prej një viti nga dijenia e arsyes së rrëzueshmërisë, pra nga ndërprerja e detyrimit. Ky afat i parë është subjektiv dhe për këtë arsye fillon nga dita e te qenit ne dijeni. Ekziston gjithashtu një afat objektiv prej tre vitesh, dhe Ligji për Detyrimet përcakton se e drejta për të anuluar një kontratë të të rrëzueshme në çdo rast përfundon me skadimin e një afati prej tre vitesh nga data e lidhjes së kontratës. (Dispozita e nenit 102, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Detyrimet). Si rregull, anulimi i një kontrate të rrëzueshme ka efekt prapaveprues (retroaktiv), duke rezultuar në kthimin e asaj që është dhënë, nëse është e mundur, dhe/ose kompensimin e dëmeve, kur dëmshpërblimi natyror nuk është i mundur, dhe kompensimin e dëmeve në rastin kur një palë e ndërgjegjshme ka pësuar dëme. Kur dëmshpërblimi në natyrë nuk është i mundur (për shembull, një makinë e shitur që është shkatërruar në një aksident trafiku që blerësi e ka pasur pas përmbushjes së kontratës së shitjes), atëherë ajo kthehet në para, dhe vlera e sendit merret në kohën e kthimit, pra në kohën e vendimit të gjykatës.

2.1. Pasojat e anulimit

Në rast se në bazë të kontratës se rrëzueshme që është anuluar është përmbushur diçka, duhet të
bëhet kthimi; në rast se kjo është e pamundshme apo në rast se kthimi ndalohet nga natyra e asaj që është përmbushur, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla. (Dispozita e nenit 99 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).
-Kthimi dhe kompensimi në rast të anulimit të kontratës së një personi me aftësi të kufizuar veprimi
Në rast të anulimit të kontratës për shkak të aftësisë së kufizuar të veprimit të një kontraktori, bashkëkontraktori i një personi të tillë mund të kërkojë kthimin vetëm të asaj pjese që është në pronësi të personit me

aftësi të kufizuar veprimi, ose është përdorur në dobi të tij, si dhe atë që është shkatërruar ose tjetërsuar qëllimisht.
- Përgjegjësia për anulimin e kontratës
Kontraktuesi, në anën e të cilit është shkaku i rrëzueshmërisë, i përgjigjet bashkë kontraktuesit për
dëmin që pëson për shkak të anulimit të kontratës, nëse ky nuk ishte në dijeni dhe as që duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të rrëzueshmërisë së kontratës.
- Përgjegjësia e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar
Personi me aftësi të kufizuar për të vepruar përgjigjet për dëmin e shkaktuar me anulimin e kontratës, në qoftë se me dinakëri e ka bindur bashkë kontraktuesin e tij se është i aftë për të vepruar. (Dispozita e nenit 101 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).

2.2. Shuarja e së drejtës

E drejta për të kërkuar anulimin të një kontrate të rrëzueshme shuhet me skadimin e afatit prej një (1) viti nga dita kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, përkatësisht prej pushimit të detyrimit. Kjo e drejtë në çdo rast shuhet me skadimin e afatit prej tri (3) vitesh nga dita e lidhjes së kontratës. (Dispozita e nenit 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve).

3. Gjetjet nga praktika e Gjykatës Supreme

Duke marrë parasysh sa më sipër, si dhe faktin që Ligji për Detyrimet përcakton në një mënyrë shumë të detajuar dhe të qartë se çfarë përbën kontrata nule dhe çfarë përbën kontrata e anulueshme (rrëzueshme), në praktikën gjyqësore hasim probleme të shumta mbi këtë çështje specifike. Konkretisht, kur bëhet fjalë për zbatimin e dispozitave të Ligjit për marredheniet e Detyrimeve në rastin e nulitetit të kontratës ose anulueshmërisë së kontratës, si gjyqtarët e gjykatave themelore ashtu edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit në Kosovë e trajtojnë dhe e shqyrtojnë këtë problem në mënyra të ndryshme.
Një nga problemet më të zakonshme dhe më të mëdha me të cilat përballemi në praktikën gjyqësore është se as palët, as përfaqësuesit e

tyre të autorizuar ose përfaqësuesit, pra avokatët, dhe as gjyqtarët, nuk bëjnë dallim midis kontratave nule dhe kontratave të anulueshme (rrëzueshme).

Në ligj, ashtu si në teori, ekziston një dallim i qartë midis dy llojeve të kontratave të pavlefshme. Kontratat nule (absolutisht nule) nuk prodhojnë efekte juridike që nga momenti që ato krijohen, domethënë konsiderohen se nuk janë krijuar kurrë. Kushdo mund të kërkojë anulimin e këtyre kontratave. Anulimi mund të kërkohet në çdo kohë, sepse e drejta për të anuluar këto kontrata nuk parashkruhet.

Nga ana tjetër, kontratat e rrëzueshme prodhojnë efekte juridike, por mund të anulohen brenda një periudhe të caktuar. Nëse nuk anulohen brenda periudhës së përcaktuar, këto kontrata janë plotësisht detyruese. Anulimi i kontratave të rrëzueshme mund të kërkohet vetëm nga personat që kanë një interes ligjor në të, dhe brenda një periudhe të kufizuar kohore, sepse e drejta për të anuluar këto kontrata parashkruhet.

Në praktikë, shpesh ngrihet pyetja nëse është e mundur të renditen kontratat që klasifikohen si nule dhe/ose të rrëzueshme, megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se nuk është e mundur të jepet një listë e saktë e kontratave që mund të klasifikohen si nule ose/dhe të rrëzueshme, prandaj dispozitat ligjore janë formuluar në një mënyrë të përgjithshme.

Për shembull, një kontratë absolutisht nule është një kontratë që është lidhur me qëllim përhapjen e fajdeve (Dispozita e nenit 123, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Detyrimet) ose një kontratë objekti i së cilës është i pamundur, i papranueshëm ose i papërcaktuar, ose është një kontratë që nuk është lidhur në formën e përcaktuar me ligj. Është e rëndësishme të theksohet se meqenëse këto kontrata janë me rëndësi të jashtëzakonshme për shoqërinë dhe shtetin, gjykata është e detyruar sipas detyres zyrtare të merret me këtë lloj nuliteti.

Palët kontraktuese nuk mund të bëjnë kurrë me vullnetin e tyre që një kontratë absolutisht nule të mbijetojë në sferën juridike. Megjithatë, nëse ndodh që kontrata të ekzekutohet, ligji lejon të kërkohet kthimi ose kompensimi i asaj që është dhënë në bazë të pasurimit të padrejtë (kompensim monetar ose në natyrë - gjithçka varet nga rasti specifik). Një kontratë nule nuk mund të mbijetojë dhe nuk prodhon efekte juridike.

Nga ana tjetër, një kontratë e rrëzueshme është një kontratë që është lidhur nën kërcënim, lajthitje ose mashtrim, si dhe një kontratë në të cilën

njëra nga palët dëmtohet padrejtësisht, ose kur një situatë e tillë përcaktohet nga Ligji për marredheniet e Detyrimeve ose rregullore të veçanta. Këto kontrata mbeten ligjërisht të vlefshme derisa një person i autorizuar të kërkojë anulimin e tyre. Kjo qasje e ligjvënësit ndaj kontratave të rrëzueshme është më e butë, sepse defekti (mangësite) në këto kontrata nuk prek interesat më të gjera shoqërore, por vetëm ato individuale. Gjithashtu, palët e treta që nuk kanë interes në lidhje me kontratën e përmendur nuk mund të kërkojnë kurrë anulimin e kontratës, d.m.th. ata nuk janë persona të autorizuar, nga ana tjetër, nëse personi i autorizuar nuk kërkon anulimin e kontratës brenda një periudhe të kufizuar kohore, atëherë kontrata e rrëzueshme është detyruese dhe mbetet në fuqi ashtu siç është.

Në fillim të këtij punimi, ceket se anulimi i kontratës është një nga mënyrat e zgjidhjes së kontratës, një mënyrë tjetër e zgjidhjes së kontratës është shkëputja e saj. Në praktikë, shumë shpesh ndodh që palët, si dhe avokatët ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, madje edhe gjyqtari, ngatërrohen, domethënë nuk bëjnë dallimin midis anulimit dhe shkëputjes së kontratës.

Një kontratë mund të zgjidhet në shumë mënyra, dhe qëllimi kryesor është zgjidhja e kontratës, pra me realizimin e asaj për të cilën palët kontraktuese kanë rënë dakord. Megjithatë, kontrata mund të zgjidhet edhe në mënyra të tjera, pra jo vetëm me "përmbushje", por edhe me një marrëveshje (dakordim) të re të vullnetit të palëve kontraktuese për zgjidhjen e kontratës, pra me shkëputjen e kontratës. Një pyetje e shpeshtë për palët, avokatët dhe madje edhe gjyqtarët, siç është e qartë në shikim të parë, shkëputja dhe anulimi i një kontrate nuk janë e njëjta gjë, megjithëse pasoja është e njëjtë - një kontratë e shkëputur ose e anuluar nuk prodhon më efekte ligjore.

Shkëputja e kontratës është një lloj tjetër i zgjidhjes së kontratës dhe mund të jetë shkëputje e njëanshme ose e ndërsjellë. Shkaku i shkëputjes lind pas lidhjes së kontratës, që është ndryshimi real në lidhje me kontratat absolutisht dhe relativisht nule, ku shkaku i anulimit ekziston tashmë kur kontrata është lidhur. Po kështu, vetëm kontratat e vlefshme shkëputen, domethënë ato kontrata të cilat, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave, duhet të zgjidhen me përmbushje. Nëse kontrata është përmbushur tashmë, shkëputja e kontratës nuk është e mundur. Shkëputja

nuk është e njëjtë me anulimin e kontratës, i cili është një deklaratë e njëanshme nga pala kontraktuese që i jep fund një marrëdhënieje kontraktuale më të përhershme për një periudhë të pacaktuar kohore. Shkëputja e kontratës çon në detyrimin e kompensimit ose kthimit të të dhënës. Nëse paratë jepen, do të paguhet edhe kamata e vonesës. Përfitimet që pala kontraktuese kishte nga ajo që do të kthehej duhet të kthehen ose të kompensohen në para. (Dispozitat e nenit 106-119 të Ligjit për Detyrimet).
Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, është e qartë se ekziston një ndryshim i madh midis anulimit të kontratës dhe/ose shkëputjes së saj, dhe madje edhe denoncimit të saj, dhe në praktikë nuk duhet të ketë dyshime ose dilema për këtë çështje.

Referencë mbi arsyetimet e vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

Aktvendim Rev.nr.485/2023 i datës 16.01.2024
Arsyetimi
.....Në këtë situatë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është dhënë me një shkelje të konsiderueshme të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n), sepse ka të meta që e bëjnë të pakuptueshëm, dispozitivi i tij nuk është në përputhje me arsyet mbi faktet thelbësore të dhëna në arsyetim, dhe arsyet mbi faktet thelbësore nuk janë në lidhje logjike me provat e paraqitura. Mangësitë e përmendura pengojnë verifikimin e korrektësisë së zbatimit të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së dytë.
Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se objekti i mosmarrëveshjes sipas padisë së paditësit-kundërpaditesit të paraqitur më: 17.12.2004, dhe të specifikuar në parashtresën me shkrim të paraqitur më 09.01.2018: anulimi i kontratës mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme dhe vërtetimi i të drejtave të pronësisë.
Objekti i mosmarrëveshjes sipas kundërpadisë së të padituve-kundërpaditësve të paraqitur më: 14.07.2017. është: përcaktimi i të drejtave të pronësisë dhe lirimi i pronës nga njerëzit dhe sendet.

Pas shqyrtimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi se ato e pranuan padinë e paditësit-kundërpaditësit dhe anuluan kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme të lidhur midis shitësit: Predrag Đekić nga Çaglavica, paraardhësit ligjor të të paditurve: Olga dhe Goran Đekić, të dy nga Çaglavica, dhe blerësit: Perihane Doda nga Prishtina, paraardhësit ligjor të të paditurve-kundërpaditësve: Sami dhe Selma Doda, të dy nga Prishtina, e cila u vërtetua nga Gjykata Komunale në Prishtina më 22 janar 2001. me numrin: OV.br.374/2001. Me atë rast, gjykatat më të ulëta iu referuan dispozitave të nenit 103 dhe 109 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyruese ("Gazeta Zyrtare e RSFJ-së", nr. 29/78), dispozita e nenit 103, paragrafi 1 i ligjit përkates përcakton se një kontratë që është në kundërshtim me rregulloret detyruese, rendin publik ose zakonet e mira është nule nëse qëllimi i rregullit të shkelur nuk i referohet ndonjë sanksioni tjetër ose nëse ligji nuk parashikon asgjë tjetër në një rast specifik, dhe dispozitat e nenit 109, paragrafi 1 dhe 2 të ligjit të lartpërmendur përcaktojnë se gjykata e monitoron nulitetin sipas detyrës zyrtare dhe çdo person i interesuar mund t'i referohet asaj, dhe prokurori publik gjithashtu ka të drejtë të kërkojë përcaktimin e nulitetit. Duke pasur parasysh dispozitat e cituara të ligjit, Gjykata Supreme thekson se nuk është e qartë se cili është objekti specifik i mosmarrëveshjes në këtë pjesë të padisë?

Domethënë, mbrojtja ligjore e kërkuar në një padi për anulimin e një kontrate është krejtësisht e ndryshme nga ajo e kërkuar në një padi për vërtetimin e nulitetit, ka arsye të ndryshme që mund të çojnë në anulim, gjegjësisht në nulitet, dhe identifikimi aktiv është gjithashtu i ndryshëm, sepse ligji i njeh të drejtën për të theksuar nulitetin e një kontrate çdo pale të interesuar, ndërsa e drejta për të kërkuar anulimin e një kontrate është në dispozicion vetëm për kontraktorët. Një kontratë që është nule në kuptimin e nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, nuk ka qenë kurrë e vlefshme, kështu që nuk mund të anulohet më pas. Nga ana tjetër, arsyet për anulimin e kontratës janë krejtësisht të ndryshme nga dispozitat e nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, dhe përcaktohen nga dispozitat e nenit 111 në lidhje me dispozitën e nenit 112 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore.

Duke pasur parasysh sa më sipër dhe duke shqyrtuar shkresat e lëndes, Gjykata Supreme konstatoi se paditësi-kunderpaditesi kërkoi: anulimin e

kontrates së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, dhe se gjykatat e shkallës së parë zbatuan dispozitat e nenit 103 dhe 109 të ligjit të lartpërmendur. Dispozita e nenit 112 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyruese ("Gazeta Zyrtare e RSFJ-së", nr. 29/78), paragrafi 1, përcakton se pala kontraktuese në interes të së cilës vërtetohet rrëzueshmeria mund të kërkojë që kontrata të anulohet, dhe dispozita e nenit 117, paragrafi 1 dhe 2, përcakton afatet brenda të cilave mund të kërkohet anulimi i një kontrate të rrëzueshme.
Në rastin konkret, gjykatat e shkallës së parë nuk i kanë cekur arsyet specifike që kanë çuar në nulitetin e kontratës, meqenëse ato iu referuan dispozitës së nenit 103 të Ligjit të atëhershëm për Marrëdhëniet Detyrimore, pse kontrata në fjalë është kundër rregullave të detyrueshme, rendit publik ose zakoneve të mira? Kontrata specifike e kontestuar si transaksion juridik është lidhur në përputhje me dispozitat e nenit 455 të Ligjit të atëhershëm për Marrëdhëniet Detyrimore, i cili përcakton se kontrata për shitjen e pasurisë së paluajtshme duhet të lidhet me shkrim, nën kërcënimin e nulitetit, është vërtetuar nga gjykata kompetente, dhe sipas të njëjtës, blerësi është regjistruar në regjistrin publik.
Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata Supreme konstaton se gjykatat e shkallës së parë nuk kanë arritur të përcaktojnë faktet relevante për vendimin mbi këtë pjesë të padisë së paditësit-kundërpaditesit, dhe se pas kësaj, ato nuk kanë arritur të zbatojnë siç duhet ligjin përkatës material.……

Aktvendimi E. Rev. nr.50/2023 dt. 16.09.2025
Arsyetimi

…….. Duke marrë parasysh gjendjen faktike të vërtetuar, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se gjykatat më të ulëta e kanë zbatuar drejt të drejtën materiale dhe kanë vepruar drejt kur e kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.
Gjykata Supreme thekson se objekti i mosmarrëveshjes specifike është:
- kërkesa për shpalljen e nulitetit të Kontratës së Kredisë, nr. 043/05 të datës 31.01.2005, pastaj, Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Klinë mbi lejimin e Intabulacionit nr. 14/2005-int nr. 6/2005, si dhe Kontrata për Siguri ose Kolateral të datës 31.01.2005, sepse sipas qëndrimit të

paditësve, kontratat e përmendura janë lidhur në shkelje të rendit juridik dhe normave imperative.
- të konfirmojë pronësinë e paditësit të dytë Luigj Ademi, në ngastrën kadastrale nr. 98.99, nr. 71011021, e cila është identifikuar në bazë të aktit të pronësisë nr. 151, në vendin e quajtur Bregu, Poteriq I Epërm, komuna e Klinës, sipas kulturës: tokë e punueshme në sipërfaqe prej 0.48.66 hektarësh, dhe të detyrojë të padituri të pranojë regjistrimin e pronësisë në emër të paditësit të dytë Luigj Ademi.
- që nëse kërkesat e lartpërmendura refuzohen nga gjykata, atëherë i padituri duhet të detyrohet t'u paguajë paditësve shumën prej 867,630.00 eurosh, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë, dhe në emër të kompensimit për dëmet për shkak të pasurimit të padrejtë (pajustifikuar).
Gjykata Supreme potencon se dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/1978), si dhe dispozitat e Ligjit mbi Bazat e Marrëdhënieve Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 6/1980) zbatohen për të ofruar mbrojtje gjyqësore në një rast specifik. Dispozita e nenit 103, paragrafi 1 i Ligjit të lartpërmendur për Detyrimet përcakton se një kontratë që është në kundërshtim me rregulloret detyruese, rendin publik ose zakonet e mira është nule nëse qëllimi i rregullit të shkelur nuk i referohet ndonjë sanksioni tjetër ose nëse ligji nuk parashikon diçka tjetër në një rast specifik. Dispozita e nenit 109, paragrafi 1 dhe 2 të ligjit të përmendur përcakton se gjykata e mbikëqyr nulitetin sipas detyrës zyrtare dhe çdo person i interesuar mund t'i referohet asaj. Prokurori publik gjithashtu ka të drejtë të kërkojë shpalljen e nulitetit. Ndërsa dispozita e nenit 110 të të njëjtit ligj përcakton se e drejta për të kërkuar nulitet nuk shuhet.
Duke pasur parasysh nenet e përmendura të ligjit përkatës, si dhe dosjet e plota të lëndës, Gjykata Supreme vlerëson se Kontrata e kontestuar e Kredisë, Aktvendimi i kontestuar për Lejen e Intabulimit, si dhe Kontrata e kontestuar e Sigurisë, perkatesisht kolateralet, janë hartuar dhe lidhur plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me të gjitha ligjet e tjera përkatëse që ishin në fuqi në atë kohë. Gjykata Supreme e refuzon si të pabazuar një pretendim specifik të revizionit që lidhet me ligjshmërinë e kontratave përkatëse të kontestuara. Konkretisht, Gjykata Supreme e pranon plotësisht qëndrimin e shprehur nga gjykatat

e shkallës së parë në lidhje me ligjshmërinë e dokumenteve të kontestuara, i cili deklaroi se gjykata nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë e kontratave që tashmë janë vlerësuar si plotësisht të ligjshme dhe kanë shërbyer si tituj të ekzekutueshëm, në të gjitha nivelet e gjykatave dhe mbi bazën e të cilave është konfirmuar ekzekutimi i pasurisë së paluajtshme të lejuar dhe të përcaktuar nga një përmbarues privat. Gjykata Supreme shton se ligjshmëria e dokumenteve të kontestuara është vlerësuar me anë të kundërshtimit dhe me anë të ankesës në të gjitha fazat e procedurës së përmbarimit, e cila është kryer në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit të atëhershëm për Procedurën Përmbarimore, si dhe të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me situatë të saktë dhe të vërtetuar plotësisht faktike dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale, procedura e përmbarimit në fjalë është përfunduar me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Dispozita e nenit 20 të Ligjit mbi bazat e marrëdhënieve pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 6/1980), parashikon që e drejta e pronësisë fitohet me vetë ligjin, në bazë të një transaksioni juridik dhe me trashëgimi...

Dispozita e nenit 33 të ligjit të lartpërmendur përcakton se, në bazë të një transaksioni juridik, e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrim në regjistrat publikë ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme të përcaktuar me ligj.

Dispozita e nenit 63 të ligjit të lartpërmendur përcakton se për të siguruar një kërkesë specifike, një send i paluajtshëm mund të ngarkohet me të drejtën e pengut në favor të kreditorit (hipoteka) i cili është i autorizuar, në mënyrën e parashikuar me ligj, të kërkojë zgjidhjen e kërkesës së tij nga vlera e asaj pasurie të paluajtshme para kreditorëve që nuk kanë hipotekë mbi të, si dhe para kreditorëve që kanë fituar hipotekë mbi të pas tij, pavarësisht nga ndryshimi i pronarit të pasurisë së paluajtshme të ngarkuar. Hipoteka i referohet të gjithë pasurisë së paluajtshme, prodhimeve të saj për sa kohë që ato janë të pandara, si dhe pjesëve të tjera përbërëse të pasurisë.

Për të siguruar një kërkesë, një hipotekë mund të bazohet në disa pasuri të paluajtshme (hipotekë e përbashkët). Pasuria e paluajtshme e lënë peng në tërësi siguron kërkesën e kreditorit deri në shlyerjen e plotë të kërkesës, pavarësisht nga ndarja e mëvonshme e pasurisë së paluajtshme

(pandashmëria e hipotekës). Dispozita e nenit 64 të ligjit të lartpërmendur përcakton se në bazë të një transaksioni juridik ose një vendimi gjyqësor, një hipotekë fitohet me regjistrim në regjistrin publik ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme të përcaktuar me ligj. Bazuar në ligj, një hipotekë fitohet në momentin kur plotësohen kushtet e përcaktuara nga ligji. Duke pasur parasysh dispozitat e cituara të Ligjit mbi Bazat e Marrëdhënieve Pronësiore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 6/1980), si dhe shkresat e plota të lëndës, Gjykata Supreme thekson se pretendimi i shqyrtimit që lidhet me një pjesë të padisë së paditësit të dytë, që është të vërtetojë të drejtën e tij të pronësisë mbi ngastrën kadastrale nr. 98.99, nr. 71011021, e cila është identifikuar në bazë të aktit të pronësisë nr. 151, në vendin e quajtur Bregu, Poteriq i Epërm, komuna e Klinës, sipas kulturës: tokë e punueshme në një sipërfaqe prej 0.48.66 hektarësh. Gjykatat e shkallës së parë me të drejtë e kanë refuzuar pjesën specifike të padisë së paditësit të dytë si të pabazuar, përkatësisht, paditësi i dytë ka vendosur një hipotekë si pronar i pasurisë së paluajtshme në fjalë, domethënë, ai e ka ngarkuar pasurinë e tij të paluajtshme për të siguruar borxhin e paditësit të parë. Paditësi i parë lidhi një kontrate huaje me të padituri, e cila është një transaksion juridik i vlefshëm dhe përfaqëson bazën ligjore për vendosjen e një hipoteke. Në kohën kur u vendos hipoteka, pasuria e paluajtshme e kontestuar ishte pronë ekskluzive e paditësit të dytë, dhe ai e ngarkoi atë plotësisht me hipotekë. Paditësi i dytë nuk kishte nevojë për pëlqimin e asnjë anëtari të familjes, madje as të bashkëshortit/es, sepse paditësi i dytë nuk provoi me asnjë provë se ishte pronë e përbashkët. Në revision, revidenti thekson se pasuria e paluajtshme në fjalë është pronë e përbashkët, dhe se gjatë vendosjes së hipotekës, pëlqimi i bashkëshortëve ishte i nevojshëm. Megjithatë, gjatë kohëzgjatjes së procedurës së përmbarimit, si dhe gjatë kohëzgjatjes së procedurës para gjykatave të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, revidenti nuk theksoi, as nuk përmendi se pasuria e paluajtshme e kontestuar është në pronësi të përbashkët, ai nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar pretendimet specifike të bëra, prandaj Gjykata Supreme e refuzoj këtë pretendim specifik të revizionit si të pabazuar.

Dispozita e nenit 210, paragrafi 1 i Ligjit mbi Detyrimet (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/1978) parashikon që kur një pjesë e pasurisë së një personi është transferuar në çfarëdo mënyre në pasurinë e një personi

tjetër, dhe ky transferim nuk ka bazë në një transaksion juridik ose në ligj, fituesi është i detyruar ta kthejë atë, dhe kur kjo nuk është e mundur, të kompensojë vlerën e përfitimeve të arritura.

Duke pasur parasysh dispozitën e cituar të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe shkresat e plota të lëndes, Gjykata Supreme vlerësoi se gjykatat e shkallës së parë kanë vërtetuar saktë se një pjesë e padisë së paditësve ishte e pabazuar, me anë të së cilës kërkuan që nëse pjesët e përmendura të padisë së paditësve refuzohen nga gjykata, atëherë i padituri duhet të detyrohet t'u paguajë paditësve shumën prej 867,630.00 euro, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë, dhe në emër të kompensimit për dëmet për shkak të pasurimit të pajustifikuar. Gjykata Supreme e refuzon si të pabazuar pretendimin konkret të revizionit dhe pranon plotësisht qëndrimin e gjykatave të shkallës së parë, të cilat konstatuan se i padituri ishte paditur, bazuar në një transaksion juridik të vlefshëm (i cili është baza ligjore), pasi paditësit nuk e përmbushën detyrimin e marrë përsipër, nuk iniciuan procedurën përmbarimore dhe nuk e realizuan kërkesën e tyre nga objekti i hipotekës. Që do të thotë se nuk ka pasurim të pajustifikuar nga ana e të paditurës, sepse ajo e fitoi të drejtën e pronësisë në bazë të një transaksioni juridik të vlefshëm, në të cilin gjendet baza ligjore.

Në revizionin e parashtruar, revidenti përsërit pretendimet ankimore që u vlerësuan plotësisht dhe drejte nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme gjithashtu shqyrtoi të gjitha pretendimet e tjera nga revizioni, por ato nuk ishin të rëndësishme për vendimin, kështu që gjykata nuk i arsyetoj ato ne veçanti.

Për arsyet e cekura, u vendos si në dispozitiv në kuptim të dispozitave të nenit 222 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje administrative

Delushe Halimi

Kontrolli gjyqësor i ligjshmërisë së akteve normative dhe shqyrtimi incidental i akteve nënligjore

Kontrolli i ligjshmërisë së akteve normative dhe shqyrtimi incidental i akteve nënligjore përfaqëson një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës dhe të sistemit demokratik kushtetues. Në një rend juridik modern, parimi i sundimit të ligjit ("rule of law") kërkon që çdo akt i nxjerrë nga organet publike të jetë në harmoni me Kushtetutën, me ligjin dhe me hierarkinë e burimeve juridike. Kjo nënkupton se asnjë organ publik nuk mund të ushtrojë kompetencë përtej asaj që i është dhënë me Kushtetutë dhe me ligj, dhe çdo tejkalim i këtyre kufijve sjell pasojë juridike pavlefshmërinë e aktit.

Në Republikën e Kosovës, baza kushtetuese e kontrollit të ligjshmërisë së akteve normative gjendet në nenin 16 të Kushtetutës, ku përcaktohet se Kushtetuta është akti më i lartë juridik i vendit dhe se ligjet e tjera duhet të jenë në përputhje me të. Njëkohësisht, neni 102 i Kushtetutës përcakton rolin e gjyqësorit si autoritet i pavarur për të siguruar zbatimin e drejtë dhe të paanshëm të ligjit. Në këtë kuadër, gjykatat e rregullta, përmes procedurës së shqyrtimit incidental, janë të thirrura të mbrojnë individët nga zbatimi i akteve nënligjore që bien ndesh me ligjin ose Kushtetutën.

Kontrolli i akteve normative, si koncept, ndahet në dy dimensione kryesore: kontrolli abstrakt dhe kontrolli konkret (incidental). Kontrolli abstrakt zakonisht është në kompetencë të Gjykatës Supreme, e cila shqyrton aktet pa lidhje me një rast konkret gjyqësor, ndërsa kontrolli konkret (ose incidental) realizohet nga gjykatat e shkallës së parë gjatë trajtimit të një padie të veçantë të ushtruar kundër një akti administrativ.

Qëllimi kryesor është që të analizojë në mënyrë të detajuar bazën ligjore dhe praktike të kontrollit gjyqësor mbi aktet normative, me theks të veçantë tek shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit normativ si dhe shqyrtimin incidental. Fillimisht do të trajtohet procedura e nxjerrjes së akteve normative nga organet publike dhe standardet që duhen respektuar për të siguruar ligjshmërinë e tyre. Në vijim, do të analizohet kompetenca e

gjykatave në raport me këto akte, duke u mbështetur në Ligjin për konfliktet administrative, si dhe praktikat gjyqësore që kanë zhvilluar këtë fushë. Një pjesë e rëndësishme do t'i kushtohet shqyrtimit incidental në shkallë të parë, duke u ndalur në procedurën gjyqësore, efektet juridike dhe rolin e instancave më të larta në unifikimin e praktikës.

Gjithashtu, do të pasurohet me standarde dhe praktika evropiane, duke marrë në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, si dhe praktikat e vendeve të rajonit dhe modelet e sistemeve të zhvilluara juridike si Gjermania dhe Franca. Ky krahasim është i domosdoshëm për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë e sistemit gjyqësor të Kosovës në zbatimin e kontrollit të ligjshmërisë së akteve normative.

Në fokus do të jetë analiza krahasuese, qasjen doktrinare dhe shqyrtimin e praktikës gjyqësore. Një rol të veçantë do të ketë analiza e aktgjykimeve të gjykatës Supreme, që trajtojnë çështjen e ligjshmërisë së akteve normative dhe moszbatimin e akteve nënligjore të paligjshme. Këto vendime, të cilat përfshihen në shtojcë, do të shërbejnë si shembull praktik për të ilustruar mënyrën se si Gjykata Supreme ka vendosur lidhur me këto çështje dhe si e ka aplikuar institutin e shqyrtimit incidental.

Në përfundim, synimi kryesor është që të nxirret një përfundim i argumentuar mbi rolin e gjykatave në mbrojtjen e rendit juridik dhe të drejtave të individëve, si dhe të ofrohen rekomandime për përmirësimin e praktikës gjyqësore dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë mënyrë, do të kontribuhet jo vetëm në aspektin akademik dhe teorik, por edhe në atë praktik, duke shërbyer si udhëzues për gjyqtarët, juristët dhe studiuesit e së drejtës administrative dhe kushtetuese

Kapitulli I: Korniza juridike për aktet normative të organeve publike

1.1. Përkufizimi dhe karakteri juridik i akteve normative

Akti normativ përkufizohet si një instrument juridik i përgjithshëm dhe abstrakt, i cili synon të rregullojë marrëdhënie shoqërore në mënyrë të përsëritur dhe të detyrueshme. Karakteri i tij juridik buron nga fakti se ai

nuk ka për objekt një rast individual apo një situatë të veçantë, por përcakton rregulla të përgjithshme të sjelljes që zbatohen për kategori më të gjera të subjekteve dhe për një periudhë të pacaktuar kohe.

Për shembull, një **rregullore** e nxjerrë nga një ministri që përcakton kriteret dhe procedurat e konkurrimit në shërbimin civil është një akt normativ, sepse rregullon në mënyrë të përgjithshme marrëdhëniet e të gjithë kandidatëve të mundshëm për punësim. Ndërkaq, një **vendim** për emërimin e një individi të caktuar në një pozitë të shërbimit civil është akt individual, sepse prodhon efekte vetëm për një subjekt të veçantë.

Në doktrinën juridike, dallimi ndërmjet akteve normative dhe atyre individuale bëhet mbi disa kritere themelore:

Përmbajtja

Akti normativ përmban rregulla të përgjithshme dhe abstrakte të sjelljes, të cilat përcaktojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e subjekteve të së drejtës në mënyrë të pa individualizuar.

Ndryshe nga kjo, akti individual është i lidhur me një situatë konkrete dhe përcakton të drejta apo detyrime për një person ose subjekt specifik (p.sh., lëshimi i një leje ndërtimi për një kompani të caktuar).

Shtrirja kohore

Akti normativ ka fuqi juridike të përsëritur dhe zbatohet vazhdimisht, derisa të shfuqizohet ose të ndryshohet me një akt të ri normativ. Ai nuk konsumon efektet e tij pas një rasti të vetëm, por mbetet i vlefshëm për të gjitha rastet që bien nën fushëveprimin e tij.

Ndërsa akti individual është i karakterit njëherësh dhe konsumon efektet e tij pas zbatimit të vetëm një herë. Vendimi për të pranuar një kandidat në shërbim civil prodhon efekt vetëm për atë rast konkret dhe nuk ka efekt të përgjithshëm.

Subjektet

Akti normativ ka fuqi detyruese për një kategori të gjerë subjektesh (të gjithë qytetarët, të gjithë punonjësit publikë, të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë një aktivitet të caktuar etj.). Pra, subjekti i aktit normativ është i pa individualizuar dhe potencialisht i pakufizuar në numër.

Në të kundërt, akti individual lidhet vetëm me subjektet konkrete që përmenden në akt (një person fizik, një ndërmarrje, një organizatë), pra ka fuqi vetëm për palët e përfshira në rastin përkatës.

Ky dallim ndërmjet akteve normative dhe individuale është thelbësor në **të drejtën administrative dhe gjyqësore**, sepse përcakton jo vetëm natyrën e aktit juridik, por edhe kompetencën dhe mënyrën e kontrollit gjyqësor mbi to. Gjykatat, në ushtrimin e funksionit të tyre, i qasen ndryshe kontrollit të ligjshmërisë së akteve normative (që lidhen me normat e përgjithshme dhe abstrakte) dhe atyre individuale (që lidhen me vendime konkrete mbi të drejtat e subjekteve). Në këtë kuptim, dallimi i qartë ndërmjet këtyre dy kategorive të akteve shërben si bazë për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e sigurisë juridike.

1.2. Hierarkia e akteve juridike në Republikën e Kosovës

Sistemi juridik i Republikës së Kosovës është i ndërtuar mbi parimin e hierarkisë së burimeve të së drejtës, ku secili akt juridik duhet të jetë në përputhje me aktin më të lartë kushtetues. Kjo hierarki siguron koherencën e rendit juridik dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve.

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta është akti më i lartë juridik (neni 16 i Kushtetutës). Ka fuqi detyruese për të gjithë personat dhe institucionet publike e private. Çdo ligj ose akt tjetër juridik duhet të jetë në pajtim të plotë me Kushtetutën.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi kanë përparësi ndaj ligjeve të brendshme, përveç Kushtetutës (neni 19). Ato bëhen pjesë integrale e rendit juridik të Kosovës.

3. Ligjet

Ligjet miratohen nga Kuvendi i Kosovës. Rregullojnë çështje të rëndësishme shoqërore, ekonomike, politike dhe juridike. Duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

4. Aktet nënligjore

Aktet nënligjore përfshijnë rregulloret, udhëzimet administrative, vendimet dhe aktet e tjera që nxirren nga Qeveria, ministritë dhe organet e tjera publike. Qëllimi i tyre është zbatimi praktik i ligjeve. Nuk mund të krijojnë norma të reja që kufizojnë të drejtat dhe liritë themelore pa bazë të qartë ligjore.

5. Aktet individuale

Aktet individuale janë vendimet konkrete të institucioneve shtetërore (p.sh. vendimet administrative, gjyqësore ose kontratat e lidhura nga organet publike), të cilat duhet të jenë gjithmonë në përputhje me aktet më të larta juridike.

Hierarkia e tillë është përforcuar nga praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka theksuar se organet administrative nuk mund të nxjerrin akte që krijojnë kufizime të të drejtave themelore pa bazë ligjore të qartë. Nëse një akt nënligjor bie ndesh me ligjin ose Kushtetutën, ai është i pazbatueshëm.

Gjithashtu, **Ligji për Konfliktet Administrative (LKA)** u ofron gjykatave të rregullta mekanizmin për të shpallur akte nënligjore të paligjshme, duke siguruar kontroll gjyqësor mbi ligjshmërinë dhe respektimin e hierarkisë normative.

1.3. Procedura e nxjerrjes së akteve normative në organet publike

Nxjerrja e akteve normative dhe parimi i Ligjshmërisë në Republikën e Kosovës.

Nxjerrja e akteve normative në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, është ngushtë i lidhur me **parimin e ligjshmërisë**, i cili përbën një nga shtyllat themelore të së drejtës publike. Ky parim, i parashikuar si në Kushtetutë ashtu edhe në **nenin 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA)**, kërkon që çdo organ publik të veprojë vetëm:

në bazë të ligjit,

brenda kompetencave të përcaktuara me ligj, dhe

në pajtim me procedurat e parashikuara ligjore.

Kjo do të thotë se asnjë organ publik, nuk mund të nxjerrë një akt normativ pa pasur **autorizim të qartë ligjor**, dhe nuk mund të krijojë rregulla që tejkalojnë apo bien në kundërshtim me ligjin.

Elementet themelore të ligjshmërisë në nxjerrjen e akteve normative

1. Baza ligjore

Çdo akt normativ duhet të ketë mbështetje të drejtpërdrejtë në një dispozitë ligjore. Ligji përcakton qartë organin kompetent, fushën e rregullimit dhe kufijtë e kompetencës. Pa një bazë të tillë, akti konsiderohet i paligjshëm dhe i pazbatueshëm.

2. Procedura e nxjerrjes

Procesi i nxjerrjes së akteve normative zakonisht përfshin disa faza të detyrueshme:

Iniciativa: akti normativ propozohet nga organi kompetent (ministria, qeveria, apo një institucion tjetër publik).

Hartimi i draftit: përgatitet teksti fillestar mbi bazën e ligjit përkatës, shpesh me përfshirjen e ekspertëve juridikë dhe teknikë.

Konsultimet e brendshme: drafti shqyrtohet brenda institucionit propozues, duke u harmonizuar me aktet ekzistuese.

Konsultimet publike: sipas Ligjit, organet publike janë të obliguara që projekt-aktet normative t'i vënë në dispozicion të publikut për komente, veçanërisht kur ato prekin interesa të gjera shoqërore.

Miratimi formal: akti miratohet nga organi kompetent sipas procedurave të brendshme (p.sh. Qeveria me vendim kolegjial, ministria me udhëzim administrativ etj.).

Publikimi zyrtar: çdo akt normativ hyn në fuqi vetëm pas publikimit në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës**, që garanton transparencë dhe siguri juridike.

3. Arsyetimi i aktit normativ

Akti normativ duhet të shoqërohet me një **arsyetim ligjor e faktik**, që shpjegon:

- nevojën për nxjerrjen e tij,
- kompetencën ligjore mbi të cilën mbështetet,
- qëllimin që synohet të arrihet,
- si dhe lidhjen e tij me ligjet dhe aktet e tjera ekzistuese.

Ky arsyetim është i domosdoshëm jo vetëm për transparencë, por edhe për kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së aktit.

4. Vështirësitë në praktikë

Në praktikën administrative në Kosovë, shpesh paraqiten vështirësi kur:

organet nxjerrin akte normative **pa autorizim të qartë ligjor**, tejkalojnë kufijtë e autorizimit të dhënë nga ligji, duke futur rregulla të reja që nuk janë të parashikuara në ligj, ose nuk respektojnë procedurat e konsultimeve dhe publikimit.

Në raste të tilla, aktet e tilla nënligjore bien ndesh me parimin e ligjshmërisë dhe mund të:

shpallen të pavlefshme nga Gjykata Supreme.

ose të mos zbatohen nga gjykatat e rregullta përmes shqyrtimit incidental, të **kontrollit gjyqësor në konfliktet administrative** (sipas LKA).

1.4. Ndalimi i arbitraritetit dhe parimi i ligjshmërisë - Ndalimi i arbitraritetit në veprimtarinë publike.

Arbitrariteti në veprimtarinë e organeve shtetërore nënkupton veprime të kryera pa bazë ligjore, në mënyrë të rastësishme ose sipas preferencave personale të zyrtarëve, që nuk bazohen në norma të qarta juridike. Veprimet arbitrare cenojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, krijojnë pasiguri juridike dhe humbin besimin në institucionet publike.

Parimi i ligjshmërisë, i sanksionuar në Kushtetutë dhe ligjet themelore administrative, është mekanizmi kryesor për **ndalimin e arbitraritetit.** Ai kërkon që:

Çdo veprim publik të ketë bazë ligjore të qartë – organet nuk mund të veprojnë sipas mendimit të tyre pa autorizim nga ligji.

Veprimet të jenë të parashikueshme – qytetarët duhet të dinë më parë se cilat janë detyrimet dhe të drejtat e tyre.

Respektimi i procedurave formale dhe arsyetimi – çdo vendim ose akt normativ duhet të ketë një shpjegim ligjor dhe faktik që justifikon nxjerrjen ose zbatimin e tij.

Në praktikë, **ndalimi i arbitraritetit** realizohet përmes disa mekanizmave:

Kontrolli gjyqësor: Gjykata Supreme mund të shpallë të pavlefshëm pjesërisht apo plotësisht një akt normativ që bie në kundërshtim me ligjin ose Kushtetutën dhe gjykatat e shkallës së parë përmes shqyrtimit incidental, mos zbatimin e aktit nënligjore.

Konsultimet publike dhe transparenca: duke i hapur draftet normative për komente publike, zvogëlohet mundësia e vendimeve arbitrare dhe përfshihet shoqëria civile në procesin e vendimmarrjes.

Parimi i ligjshmërisë përbën një nga themelet e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës. Ai është i sanksionuar shprehimisht me **Kushtetutën** si dhe me ligjet themelore të së drejtës administrative. Ky parim garanton se çdo organ i pushtetit publik mund të veprojë vetëm mbi bazën e ligjit, brenda kufijve të kompetencave të përcaktuara dhe në përputhje me procedurat ligjore.

Zbatimi i parimit të ligjshmërisë ndalon çdo formë të veprimit arbitrar nga ana e autoriteteve shtetërore, duke vendosur kështu një garanci thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve. Çdo akt normativ që miratohet nga organet publike duhet:

të ketë një **bazë të qartë ligjore,**

të jetë **i saktë dhe i përcaktuar në përmbajtje,**

të shoqërohet me një **arsyetim ligjor dhe faktik**, dhe

të jetë në **harmoni me normat më të larta juridike** (ligjet dhe Kushtetutën).

Në të kundërtën, një akt normativ që është i **paqartë**, i **paarsyetuar**, apo i **papajtueshëm me ligjin**, cenon drejtpërdrejt **parimin e sigurisë juridike** dhe për pasojë bie në kundërshtim me Kushtetutën. Siguria juridike është element përbërës i sundimit të ligjit dhe kërkon që qytetarët të jenë të aftë të parashohin me saktësi pasojat juridike të normave që u zbatohen.

Prandaj, parimi i ligjshmërisë nuk është vetëm një kërkesë formale, por një standard substancial që mbron qytetarët nga pasiguria dhe arbitrariteti, duke siguruar që e gjithë veprimtaria normative e institucioneve publike të zhvillohet në përputhje me rendin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Shqyrtimi incidental është një instrument juridik i përdorur nga gjykatat e rregullta -gjykata e shkallës së parë për të mos zbatuar aktet normative në kuadër të një procedure konkrete gjyqësore. Ai nuk është një proces i pavarur, por zhvillohet **brenda një procesi kryesor** ku një palë ka kontestuar një vendim ose akt administrativ. Ky mekanizëm është themelor për parandalimin e **arbitraritetit të organeve publike**, pasi siguron që:

çdo akt i nxjerrë nga autoritetet shtetërore të jetë në përputhje me ligjin,

qytetarët të mos preken nga veprime arbitrare që cenojnë të drejtat dhe liritë e tyre,

organet administrative të veprojnë brenda kompetencave të ligjshme dhe në respektim të procedurave të parashikuara.

Procedura e shqyrtimit incidental në Republikën e Kosovës zhvillohet si më poshtë:

Paraqitja e kontestimit nga pala

Një qytetar ose subjekt i caktuar konteston një **akt administrativ individual**, duke ushtruar padi para gjykatës, duke pretenduar se ai bazohet në një **akt normativ të paligjshëm.**

Kjo mund të jetë, për shembull, një vendim administrativ që ndikon në të drejtat e punës, pronësisë, ose shërbimeve publike.

Shqyrtimi fillestar i gjykatës

Gjykata, pasi merr çështjen, nuk shqyrton vetëm ligjshmërinë e aktit individual, por edhe **ligjshmërinë e aktit normativ** mbi të cilin është bazuar vendimi i kontestuar.

Kontrolli i ligjshmërisë së aktit normativ

Gjykata analizon nëse akti individual, është i bazuar në një akt normativ që sipas padisë është i paligjshëm, në kundërshtim **me parimet kushtetuese**, ligjet dhe procedurat administrative të përcaktuara.

Nëse akti individual është nxjerrë duke u bazuar pikërisht në aktin normativ kontestues.

Gjykata me vendim duhet sipas (LKA) të:

Ndërprenë shqyrtimin e çështjes në gjykim, dhe lëndën ta përcjellë në Gjykatën Supreme sipas dispozitave të LKA-së për shqyrtimin incidental, që e njëjta të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit normativ, pastaj pas përfundimit të procedurës dhe marrjes së vendimit, lëndën së bashku me shkresat e sajë ja dërgon gjykatës së shkallës së parë për të vendosur për aktin individual administrativ të kontestuar.

Rëndësia e shqyrtimit incidental

Parandalon arbitraritetin: Me këtë mekanizëm, asnjë organ publik nuk mund të veprojë e as të merre vendim duke e bazuar në një akt normativ të paligjshëm.

Garanton sigurinë juridike: Palët mund të jenë të sigurt se çdo vendim administrativ bazuar në një akt normativ është i ligjshëm dhe i justifikuar.

Siguron respektimin e parimeve kushtetuese: Çdo akt normativ duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtat themelore të qytetarëve.

Efektiv në praktikë: Shqyrtimi incidental lejon gjykatat e rregullta të veprojnë si një "kontroll i dytë" pas legjislacionit, pa nevojën për një proces të veçantë.

Në përmbledhje, **shqyrtimi incidental** është një mekanizëm thelbësor që siguron se veprimet administrative janë në përputhje me ligjin dhe

parandalon veprimet arbitrare, duke mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

1.5. Publikimi dhe hyrja në fuqi e akteve normative

Publikimi është një nga elementët më të rëndësishëm që garanton **vlefshmërinë dhe efektivitetin juridik** të një akti normativ në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës. Sipas **nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,** çdo akt normativ i përgjithshëm duhet të publikohet në **Gazetën Zyrtare**, dhe ky publikim është kusht i domosdoshëm për prodhimin e efekteve juridike të aktit.

Kjo kërkesë nuk ka karakter formalist, por është thelbësore për disa arsye:

Siguria juridike e qytetarëve

Publikimi i aktit normativ siguron që qytetarët dhe subjektet e tjera të jenë të informuar për rregullat që ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Pa publikim, qytetarët nuk mund të parashohin me siguri pasojat juridike të normave të reja, gjë që cenon **parimin e sigurisë juridike.**

Detyrimi i respektimit të ligjit nga organet publike

Aktet normative të pa publikuara nuk mund të përdoren si bazë për vendime administrative ose për zbatim të ligjit.

Në këtë mënyrë, publikimi garanton që çdo veprim i institucioneve publike të jetë **i ligjshëm dhe i parashikueshëm.**

Transparenca dhe përgjegjësia

Publikimi në Gazetën Zyrtare i hap mundësinë qytetarëve, medias dhe akterëve të tjerë shoqërorë të monitorojnë aktivitetin legjislativ dhe të bëjnë komente ose ankesa, kur është e nevojshme.

Ky mekanizëm promovon **qeverisje të hapur** dhe zvogëlon mundësinë e arbitraritetit të organeve administrative.

Efektiviteti juridik

Një akt normativ bëhet i detyrueshëm për subjektet e ligjit vetëm pas publikimit të tij.

Në mungesë të publikimit, akti nuk ka fuqi ligjore, dhe çdo veprim i bazuar mbi të mund të shpallet i pavlefshëm nga gjykatat.

Parashtrimi i procedurave formale dhe ligjore

Publikimi është gjithashtu një hap i domosdoshëm për respektimin e procedurave formale të miratimit të aktit normativ.

Ai dokumenton se akti ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme të shqyrtimit dhe konsultimit dhe është miratuar në përputhje me ligjin.

Pa publikim, një akt normativ është **juridikisht i paefektshëm** dhe nuk mund të përdoret për të imponuar të drejta ose detyrime. Ky parim i bën aktet normative **të njohura, të parashikueshme dhe të ligjshme**, duke mbrojtur qytetarët nga vendimet arbitrare dhe duke siguruar funksionimin e shtetit të së drejtës. Në këtë mënyrë, **publikimi nuk është vetëm një detyrim formal**, por një mjet thelbësor për të garantuar **transparencë, ligjshmëri dhe siguri juridike.**

Pasojat e parregullsisë së publikimit të akteve normative

Në praktikën juridike të Republikës së Kosovës, gjykatat kanë hasur raste ku një **akt normativ,** megjithëse i miratuar sipas procedurave formale, **nuk ka mundur të zbatohet,** për shkak se nuk është publikuar në mënyrë të rregullt në **Gazetën Zyrtare,** siç percakton **neni 80 i Kushtetutës** dhe ligjet përkatëse administrative.

Parregullsia në publikim ka pasoja të rëndësishme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ligjshmërinë, sigurinë juridike dhe funksionimin e shtetit të së drejtës:

Mungesa e efektit juridik

Një akt normativ i pa publikuar nuk prodhon efekte juridike, dhe nuk mund të përdoret si bazë ligjore për vendime administrative, gjyqësore apo të tjera.

Çdo veprim i bazuar mbi një akt të tillë mund të shpallet i pavlefshëm, duke krijuar pasiguri juridike dhe konflikt ligjor.

Cenimi i sigurisë juridike

Qytetarët dhe subjektet juridike kanë të drejtë të dinë rregullat që ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Në mungesë të publikimit, palët nuk mund të parashohin pasojat e normave të reja dhe rrezikohen të penalizohen ose kufizohen në mënyrë të papritur, duke cenuar parimin e **sigurisë juridike.**

Dëmtimi i transparencës dhe llogaridhënies

Publikimi është një instrument thelbësor për të siguruar transparencën në veprimtarinë legjislative dhe administrative.

Kur aktet normative nuk publikohen, qytetarët dhe shoqëria civile nuk kanë mundësi të monitorojnë veprimet e autoriteteve, gjë që zvogëlon llogaridhënien e institucioneve.

Rreziku i arbitraritetit

Një akt normativ i pa publikuar mund të përdoret në mënyrë të papërgjegjshme ose selektive nga autoritetet administrative, duke krijuar mundësi për veprime arbitrare.

Kjo shkel **parimin e ligjshmërisë** dhe humbë besimin e qytetarëve në drejtësinë dhe funksionimin e shtetit.

Pasojat për sistemin ligjor

Gjykatat, në raste të tilla, duhet të mos zbatojnë aktin normativ dhe të shpallin të pavlefshme çdo vendim të bazuar mbi të, gjë që mund të krijojë ngërç ligjor dhe të rrisë barrën e gjykatave për zgjidhjen e konflikteve.

Publikimi i rregullt i aktit normativ është jo vetëm një kërkesë formale, por një **parakusht për ligjshmëri, siguri juridike dhe transparencë.** Parregullsia në publikim mund të çojë në pamundësi zbatimi, cenim të të drejtave të qytetarëve, rritje të arbitraritetit dhe pasiguri në funksionimin e sistemit juridik. Prandaj, çdo akt normativ duhet të publikohet në

përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe procedurat e parashikuara, për të garantuar qëndrueshmërinë juridike dhe sundimin e ligjit.

Kapitulli II: Procedura administrative në lidhje me aktet normative

2.1. Kompetencat e organeve administrative për nxjerrjen e akteve normative

Institucionet me kompetencë për nxjerrjen e akteve normative. Në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, **kompetenca për nxjerrjen e akteve normative** i njihet vetëm atyre institucioneve që janë te parashikuar qartë me ligj. Kjo kompetencë është e kufizuar nga parimi i **ligjshmërisë**, i sanksionuar në **nenin 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA)**, sipas të cilit çdo organ i administratës publike duhet të veprojë gjithmonë mbi bazën dhe në përputhje me ligjin.

Kuptimi i këtij parimi është se **asnjë organ publik nuk mund të krijojë norma të reja që tejkalojnë autorizimet e dhëna nga ligji themelor.** Kjo ka për qëllim të mbrojë qytetarët nga arbitrariteti dhe të sigurojë një rend të qartë juridik.

Institucionet që mund të nxjerrin akte normative:

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Është organi ligjvënës i vendit dhe ka kompetencën më të gjerë për të nxjerrë **ligje.**

Ligjet e miratuara nga Kuvendi janë aktet normative më të rëndësishme dhe duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministritë

Qeveria dhe ministritë mund të nxjerrin **rregullore dhe udhëzime administrative** vetëm kur kjo kompetencë është përcaktuar me ligj.

Rregulloret e ministrive duhet të zbatojnë ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe nuk mund të shkelin kompetencat e tjera shtetërore.

Për shembull, një ministri mund të nxjerrë rregullore që përcakton procedurat për ofrimin e një shërbimi publik, por nuk mund të krijojë detyrime që nuk janë parashikuar nga ligji themelor.

Komunat

Komunat mund të miratojnë **akte nënligjore lokale,** si vendime ose udhëzime, brenda kompetencave që u janë dhënë me ligj qendror.

Një komunë nuk mund të nxjerrë akte që bien në kundërshtim me ligjet qendrore ose që shkelin të drejtat themelore të qytetarëve.

Organe të tjera të administratës publike me kompetencë të veçantë

Disa organe shtetërore, të parashikuara me ligje specifike, mund të nxjerrin **aktet e tyre normative,** gjithmonë brenda kufijve të përcaktuar me ligj.

Këto organe mund të përfshijnë agjenci të pavarura, komisione të veçanta ose autoritete rregullatore, të cilat kanë detyra të sanksionuara ligjërisht.

Parimet që rregullojnë kompetencën

Baza ligjore: çdo akt normativ duhet të ketë një **autorizim të qartë ligjor.**

Kufiri i kompetencës: organi publik nuk mund të veprojë jashtë kompetencave të dhëna me ligj.

Përputhshmëria me ligjet dhe Kushtetutën: aktet e nxjerra nga administrata nuk mund të bien ndesh me ligjet qendrore ose parimet kushtetuese.

Kontrolli gjyqësor: Gjykata Supreme vlereson ligjshmërinë e aktit normativ dhe të ndalojnë zbatimin e tij nëse konstatohen shkelje.

Kompetenca për nxjerrjen e akteve normative është një e drejtë e kufizuar dhe e sanksionuar qartë me ligj. Vetëm organet e autorizuara, si Kuvendi, Qeveria, ministritë, komunat dhe disa organe të veçanta të administratës publike, mund të krijojnë akte normative. Kjo rregullon **parimin e ligjshmërisë**, mbron qytetarët nga arbitrariteti dhe siguron një funksionim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të rendit juridik.

Tejkalimi i kompetencave nga institucionet publike në nxjerrjen e akteve normative

Në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, institucionet publike kanë të drejtë të nxjerrin akte normative vetëm brenda kufijve të përcaktuar qartë me ligj. Kjo kompetencë është e kufizuar nga parimi i **ligjshmërisë,** i sanksionuar në **nenin 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA).** Megjithatë, në praktikë, gjykatat shpesh përballen me raste ku aktet normative janë kontestuar për shkak se institucionet i kanë tejkaluar kompetencat e tyre.

Mënyrat se si institucionet publike tejkalojnë kompetencat

Nxjerrja e akteve jashtë bazës ligjore

Disa institucione nxjerrin rregullore, udhëzime ose vendime administrative pa një autorizim të qartë ligjor.

Për shembull, një insitucion me autorizim publik mund të përpiqet të krijojë detyrime të reja për qytetarët që nuk janë parashikuar nga ligji themelor.

Shkelja e hierarkisë së akteve juridike

Një akt nënligjor nuk mund të jete ne kundërshtim me ligjet themelore ose Kushtetutën.

Kur një komunë ose organ i administratës nxjerr akte që bien ndesh me ligjet e miratuara nga Kuvendi, kjo konsiderohet tejkalim kompetencash.

Përdorimi i kompetencës për të krijuar rregulla të reja që kufizojnë të drejtat

Disa institucione përdorin kompetencën e dhënë për çështje teknike ose proceduriale për të vendosur kufizime të reja, që nuk janë të autorizuara me ligj.

Mosrespektimi i procedurave të miratimit

Shpesh aktet normative miratohen pa konsultime të nevojshme, pa transparencë ose pa publikim në Gazetën Zyrtare.

Ky mosrespektim krijon një situatë ku akti është juridikisht i paefektshëm.

Pasojat e tejkalimit të kompetencave

Pavlefshmëria juridike e aktit normativ

Një akt që tejkalon kompetencën nuk ka efekt ligjor dhe nuk mund të përdoret si bazë për vendime administrative ose gjyqësore.

Refuzimi i zbatimit nga gjykatat

Gjykatat e rregullta, përmes **shqyrtimit incidental**, mund të mos zbatojnë një akt normativ që tejkalon kompetencën e organit që e ka nxjerrë.

Ky mekanizëm është thelbësor për të parandaluar arbitraritetin dhe për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve.

Cenimi i parimit të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike

Tejkalimi i kompetencës krijon pasiguri juridike, sepse qytetarët dhe subjektet nuk mund të dinë me siguri rregullat që duhet të ndjekin.

Rritja e konfliktit ligjor dhe ngarkesa gjyqësore

Çështjet ku ka tejkalim kompetencash shpesh çojnë në procese të shumta gjyqësore, duke rritur ngarkesën e gjykatave dhe duke vonuar zbatimin e drejtësisë.

Humbja e besimit në institucionet publike

Kur institucionet tejkalojnë kompetencat, qytetarët humbasin besimin në qeverisje dhe në respektimin e ligjit, duke cenuar legitimimin e shtetit të së drejtës.

Tejkalimi i kompetencave në nxjerrjen e akteve normative është një problem serioz për sistemin juridik, sepse cenon **ligjshmërinë, sigurinë juridike dhe parimin e sundimit të ligjit**. Gjykatat, përmes vlerësimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe shqyrtimit incidental, kanë një rol kyç në **kontrollin e ligjshmërisë** dhe në mbrojtjen e qytetarëve nga veprimet arbitrare të administratës publike. Për këtë arsye, çdo institucion publik duhet të veprojë strikt brenda kufijve të autorizimeve të dhëna me ligj dhe të respektojë procedurat formale të nxjerrjes së akteve normative, për të garantuar një rend juridik të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm.

2.2. Procedurat paraprake dhe konsultative

Sigurimi i legjitimitetit të akteve normative.

Legjitimiteti i akteve normative është një parakusht themelor për funksionimin e drejtë dhe të parashikueshëm të sistemit juridik dhe për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Kjo nënkupton që çdo akt normativ:

Bazohet në ligj – çdo akt normativ duhet të ketë një autorizim të qartë ligjor nga organi kompetent;

Miratohet përmes procedurave të rregullta – duke përfshirë shqyrtimin brenda institucionit dhe konsultime të nevojshme;

Është i arsyetuar dhe transparent – akti duhet të ketë një arsyetim ligjor dhe faktik, që tregon nevojën dhe qëllimin e tij;

Është i publikuar në mënyrë të rregullt – për të siguruar njohurinë dhe parashikueshmërinë e rregullave për qytetarët dhe subjektet juridike.

Procedurat që sigurojnë legjitimitetin e akteve normative.

Organet publike janë të detyruara të zhvillojnë **procedura të brendshme dhe konsultime paraprake** që garantojnë legjitimitetin dhe cilësinë e aktit normativ. Këto procedura përfshijnë:

Analizë e bazës ligjore dhe kompetencave

Para nxjerrjes së një akti normativ, organi publik duhet të shqyrtojë ligjin themelor dhe autorizimin që ka marrë për të siguruar që akti nuk tejkalon kompetencën.

Kjo analizë ndihmon në parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe veprimeve arbitrare.

Konsultime ndër-institucionale

Në nivel qendror, aktet normative kalojnë shpesh për shqyrtim në disa institucione përkatëse, përfshirë ministritë, agjencitë dhe komisionet e specializuara.

Konsultimet ndër-institucionale sigurojnë që akti të jetë i përputhshëm me rregullat ligjore ekzistuese dhe me politikën publike.

Konsultime publike dhe pjesëmarrje qytetare

Kur aktet normative ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtat ose interesat e qytetarëve, ligji mund të kërkojë publikim paraprak për komente ose sugjerime.

Kjo praktikë rrit **transparencën** dhe u jep qytetarëve mundësinë të ndikojnë në procesin legjislativ, duke promovuar **qeverisje të hapur**.

Procedura e shqyrtimit dhe arsyetimi i aktit

Organet duhet të përgatisin një **arsyetim të detajuar ligjor dhe faktik**, i cili tregon qëllimin, domosdoshmërinë dhe efektet e aktit normativ.

Arsyetimi është i rëndësishëm për gjykatat që mund të kontrollojnë ligjshmërinë e aktit si dhe përmes **shqyrtimit incidental.**

Publikimi zyrtar

Pas përfundimit të procedurave të brendshme dhe konsultimeve, akti duhet të publikohet në **Gazetën Zyrtare**, duke siguruar njohjen dhe efektivitetin juridik të tij.

Përfitimet e këtyre procedurave

- Sigurojnë **ligjshmëri dhe legjitimitet** të akteve normative;
- Parandalojnë **tejkalimin e kompetencave** nga organet publike;
- Përmirësojnë **transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare**;
- Reduktojnë mundësinë e **ankesave dhe kontesteve gjyqësore;**
- Forcojnë **besimin e qytetarëve** në institucionet publike dhe sundimin e ligjit.

Zhvillimi i procedurave të brendshme dhe konsultimeve paraprake është një detyrim i domosdoshëm për **sigurimin e legjitimitetit të akteve normative.** Ky proces garanton që çdo akt normativ të jetë i bazuar ligjërisht, i arsyetuar, transparent dhe i publikuar, duke ruajtur parimin e ligjshmërisë, sigurinë juridike dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin legjislativ.

Standardet evropiane për aktet normative dhe roli i Komisionit të Venecias

Në kontekstin evropian, nxjerrja e akteve normative duhet të respektojë **standarde të larta transparencë, legjitimitet dhe pjesëmarrjeje qytetare,** si pjesë e respektimit të parimit të sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore të njeriut. Këto standarde janë të pasqyruara edhe në **udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias**, i cili shërben si organ këshillues i Këshillit të Evropës për çështje kushtetuese dhe demokratike.

Karakteristikat kryesore të një akti normativ vendor sipas standardeve evropiane

Baza ligjore e qartë dhe kompetenca e autorizuar

Çdo akt normativ duhet të bazohet në një ligj themelor që përcakton qartë kompetencën e organit që e nxjerr.

Tejkalimi i kompetencave ose nxjerrja e aktit pa autorizim ligjor është i papranueshëm.

Standardet evropiane kërkojnë që baza ligjore të jetë e **parashikueshme, e qartë dhe e aksesueshme për qytetarët.**

Procedurat e hapura dhe konsultimi publik

Aktet normative nuk duhet të miratohen brenda një procesi të mbyllur administrativ.

Standardet evropiane kërkojnë që **palët e interesuara**, qytetarët, shoqëria civile dhe institucionet kompetente të kenë mundësi të japin sugjerime dhe komente para miratimit përfundimtar.

Kjo praktikë jo vetëm që rrit **cilësinë e aktit normativ**, por zvogëlon mundësinë e konflikteve gjyqësore të mëvonshme.

Arsyetimi i detajuar i aktit

Aktet normative duhet të shoqërohen me një **arsyetim të qartë dhe të plotë,** që tregon nevojën për aktin, qëllimet, efektet e parashikuara dhe ndikimin në të drejtat e qytetarëve.

Komisioni i Venecias thekson rëndësinë e arsyetimit për **kontrollin gjyqësor** dhe për sigurinë juridike të qytetarëve.

Përputhshmëria me parimet kushtetuese dhe ligjet themelore ekzistuese

Akti normativ duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet ekzistuese, duke respektuar **të drejtat themelore dhe parimet e drejtësisë.**

Shkelja e këtyre parimeve mund të çojë në shpalljen e pavlefshmërisë të aktit nga gjykatat respektivisht nga Gjykata Supreme.

Publikimi dhe transparenca

Një akt normativ duhet të publikohet në **Gazetën Zyrtare** ose në një platformë të qasshme publikisht, për t'u njohur nga të gjithë qytetarët dhe subjektet juridike.

Publikimi siguron **njohjen, parashikueshmërinë dhe zbatueshmërinë** e ligjit, duke respektuar standardet e Komisionit të Venecias për transparencë dhe qeverisje të hapur.

Përfitimet e respektimit të standardeve evropiane

- Siguron **cilësi më të lartë të akteve normative**, duke minimizuar keqinterpretimet ose shkeljet e ligjit;
- Redukton **konfliktet gjyqësore** dhe ankesat administrative;
- Rrit **besimin e qytetarëve** dhe transparencën e institucioneve;
- Përmirëson **efektivitetin dhe legjitimitetin** e qeverisjes.

Një **akt normativ vendor** që respekton standardet evropiane dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias duhet të:

- Të ketë **bazë ligjore të qartë** dhe kompetencë të autorizuar;
- Të zhvillohet përmes **procedurave të hapura dhe konsultimeve** paraprake;
- Të jetë **i arsyetuar** dhe transparent;

- Të respektojë **parimet kushtetuese dhe ligjet ekzistuese** dhe
- Të publikohet për të garantuar **parashikueshmëri dhe siguri juridike**.

Respektimi i këtyre parimeve siguron që aktet normative të jenë të **ligjshme, të zbatueshme dhe të pranueshme nga qytetarët,** duke forcuar sundimin e ligjit dhe besimin në institucionet publike.

2.3. Parimi i proporcionalitetit dhe administrata e drejtë-Përmbajtja dhe dimensionet e parimit të proporcionalitetit

Parimi i proporcionalitetit nënkupton se çdo veprim administrativ, përfshirë nxjerrjen e akteve normative, duhet të përmbushë tre kritere kryesore:

Domosdoshmëria (Necessity)

Veprimi i organit publik duhet të jetë i nevojshëm për arritjen e qëllimit të ligjshëm që synon.

Nëse ekziston një mënyrë më pak kufizuese për të arritur të njëjtin qëllim, atëherë zgjidhet ajo alternativë.

Për shembull, nëse një rregullore administrative ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, ajo nuk mund të imponojë masa më të rrepta se sa ato të domosdoshme për këtë qëllim.

Përshtatshmëria (Suitability)

Akti normativ duhet të jetë efektiv dhe i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar.

Një masë administrative që nuk ndihmon në realizimin e objektivit ligjor ose që është e padobishme konsiderohet jo e përshtatshme.

Për shembull, një rregullore që vendos detyrime administrative të panevojshme për qytetarët pa përfitim të qartë publik nuk e plotëson këtë kriter.

Proporcionaliteti në kuptimin e ngarkesës ndaj individit (Proportionality in the strict sense)

Masat e vendosura nga administrata nuk duhet të shkaktojnë një ngarkesë të tepruar për qytetarët në raport me përfitimet që sjellin.

Kjo do të thotë se kufizimet e drejtpërdrejta ose indirekte që imponon akti normativ duhet të jenë të balancuara me qëllimin publik që synohet.

Për shembull, një gjobë e tepërt për një shkelje administrative të vogël do të konsiderohej shkelje e parimit të proporcionalitetit.

Rëndësia e parimit të proporcionalitetit

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive individuale

Parimi i proporcionalitetit siguron që veprimet administrative të mos cenojnë të drejtat themelore më shumë se sa është e nevojshme.

Ai ndihmon në mbajtjen e ekuilibrit midis interesit publik dhe interesit individual.

Kontrolli gjyqësor i akteve normative

Gjykata Supreme, vlerëson ligjshmërinë e akteve normative përmes një procesi të rregullt gjyqësorë.

Gjykatat e rregullta, përmes **shqyrtimit incidental**, mund të vlerësojnë nëse një akt normativ ose vendim administrativ i bazuar në të respekton parimin e proporcionalitetit.

Në rast se nga gjykata konstatohet se një akt imponon masa të tepruara, ajo mund ta shpallë të pavlefshëm dhe të paligjshëm në një pjesë të tij ose tërësisht.

Siguria juridike dhe parashikueshmëria

Kur aktet normative respektojnë proporcionalitetin, qytetarët mund të parashikojnë efektet e rregullave dhe të planifikojnë veprimet e tyre në mënyrë të sigurt.

Përputhshmëria me standardet evropiane

Parimi i proporcionalitetit është thelbësor edhe në të drejtën e Bashkimit Evropian dhe praktikat e Komisionit të Venecias.

Ai siguron që masat administrative dhe normative janë të bazuara në një **balancim të arsyeshëm** midis nevojës publike dhe interesave individuale.

Parimi i proporcionalitetit është një **mjet i domosdoshëm për garantimin e drejtësisë administrative**. Ai kërkon që çdo akt normativ të jetë i:

Domosdoshëm për arritjen e objektivit publik;

Përshtatshëm për realizimin e qëllimit të ligjshëm;

Proporcional në ndikimin ndaj individëve dhe subjekteve juridike.

Respektimi i këtij parimi jo vetëm që siguron legjitimitetin dhe efektivitetin e akteve normative, por edhe mbron qytetarët nga veprime administrative arbitrare dhe tepruese, duke forcuar **sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike.**

2.4. Mjetet e kontrollit administrativ të brendshëm

Përpara se të arrijë tek gjykata, një akt normativ mund të sfidohet përmes mjeteve të kontrollit të brendshëm administrativ. Këtu përfshihen:

Ankesat administrative ndaj akteve të nxjerra nga organet e vartëse;

Rishqyrtimi administrativ nga organi që e ka nxjerrë aktin;

Kontrolli hierarkik nga organet më të larta të administratës.

Megjithatë, këto mekanizma shpesh nuk janë të mjaftueshëm për të korrigjuar paligjshmëritë, dhe roli i gjykatave mbetet vendimtar.

2.5. Dallimi midis akteve normative dhe atyre individuale - Dallimi midis aktit normativ dhe aktit individual

Në të drejtën administrative, dallimi midis **aktit normativ** dhe **aktit individual** është një çështje thelbësore, pasi përcakton jo vetëm kompetencat e autoriteteve që i nxjerrin, por edhe mënyrën e kontrollit gjyqësor mbi to. Në praktikë, dallimi nuk është gjithmonë i dukshëm, dhe shpesh lindin dilema kur administrata tenton të justifikojë një akt

individual si akt normativ për të shmangur **shqyrtimin gjyqësor**. Gjykatat kanë rol kyç në përcaktimin e natyrës së aktit, bazuar në përmbajtje, efekt juridik, subjektet e prekura dhe qëllimin e tij.

Karakteristikat kryesore të aktit normativ

Përmbajtja e përgjithshme dhe abstrakte

Akti normativ është i përgjithshëm dhe nuk ka për objekt një rast të veçantë.

Ai rregullon marrëdhënie shoqërore ose detyrime ligjore që prekin një kategori të gjerë subjektesh.

Shembuj: ligje, rregullore qeveritare, udhëzime administrative që vlejnë për të gjithë punonjësit e një institucioni publik.

Shtrirja kohore dhe vazhdimësia

Aktet normative kanë **fuqi vazhduese**, duke u zbatuar për një periudhë të pacaktuar, derisa të ndryshohen ose të anulohen.

Subjektet e prekur

Akti normativ prek kategori të gjera subjektesh ose të gjithë individët që bien nën juridiksionin e tij.

Ai nuk adreson vetëm një person ose subjekt të caktuar, por rregullon **të drejtat dhe detyrimet e një grupi**.

Kontrolli gjyqësor

Aktet normative mund të kontestohen përmes **kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë** ose përmes shqyrtimit incidental, nëse një akt individual i bazuar në ta bie ndesh me ligjin ose Kushtetutën.

Karakteristikat kryesore të aktit individual

Përmbajtja specifike dhe konkrete

Akti individual ka për objekt një **rast të veçantë** dhe vendos të drejta ose detyrime për një person ose një grup të caktuar individësh.

Shembuj: vendim për emërimin e një punonjësi, autorizimi për përdorim të një prone publike, dhënia e një leje ose licencë specifike.

Shtrirja kohore dhe efektet

Akti individual ka një **efekt të njëhershëm**, i cili zakonisht nuk ka karakter të përgjithshëm.

Subjektet e prekur

Përveçse ka efekt të drejtpërdrejtë ndaj palës së përfshirë, akti individual nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të tjerët jashtë subjekteve të adresuara.

Kontrolli gjyqësor

Aktet individuale mund të kontestohen drejtpërdrejt përmes **procedurës administrative ose gjyqësore**, dhe gjykatat mund të vlerësojnë ligjshmërinë e tyre duke përfshirë edhe bazën ligjore të aktit normativ mbi të cilin mbështeten.

Sfida praktike dhe rastet e gabueshme

Shpesh administrata tenton të maskojë një **akt individual** si akt normativ për të shmangur kontrollet gjyqësore.

Për shembull, një vendim për dhënien e një shërbimi të caktuar mund të prezantohet si rregullore e përgjithshme, edhe pse ka efekt vetëm mbi një subjekt.

Gjykatat analizojnë elemente të tilla si: përmbajtja, personat e prekur, qëllimi, shtrirja kohore dhe ndikimi për të përcaktuar natyrën e aktit.

Rëndësia e dallimit aktit normative dhe aktit individual

Kompetenca dhe legjitimiteti

Aktet normative kërkojnë **autorizim ligjor të qartë** për nxjerrje, ndërsa aktet individuale mund të nxirren brenda kompetencave të një organi të caktuar.

Kontrolli gjyqësor

Njohja e natyrës së aktit përcakton **procesin e kontestimit gjyqësor** dhe fuqinë e gjykatës për të vlerësuar ligjshmërinë e tij.

Siguria juridike dhe parashikueshmëria

Dallimi i qartë midis aktit normativ dhe aktit individual ruan **sigurinë juridike** dhe parashikueshmërinë e rregullave për qytetarët dhe subjektet juridike.

Dallimi midis **aktit normativ dhe aktit individual** është vendimtar për zbatimin e drejtë të ligjit dhe kontrollin gjyqësor.

Akti normativ rregullon **kategori të gjera subjektesh**, ka **efekt të vazhdueshëm** dhe është i bazuar në autorizim ligjor të qartë.

Akti individual ka efekt mbi **një rast të veçantë**, është i adresuar ndaj një personi ose grupi të kufizuar, dhe mund të kontestohet drejtpërdrejt në gjykatë.

Ky dallim garanton që **administrata të veprojë brenda kompetencave,** që qytetarët të mbrojnë të drejtat e tyre, dhe që **gjykatat të kryejnë funksionin e kontrollit ligjor** në mënyrë efektive.

Kapitulli III: Kompetenca e gjykatave në raport me aktet normative

3.1. Ligji për konfliktet administrative – kuadri themelor

Ligji për konfliktet administrative (LKA) dhe roli i tij në garantimin e ligjshmërisë.

Ligji për konfliktet administrative (LKA) është akti themelor që rregullon **kontrollin gjyqësor të veprimeve të administratës publike në Republikën e Kosovës**. Ky ligj përcakton qartë kompetencën e gjykatave për të shqyrtuar ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet publike dhe për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve nga shkeljet e mundshme të ligjit.

Qëllimi kryesor i LKA-së

Mbrojtja e të drejtave dhe interesave subjektive të qytetarëve Ligji ka për qëllim të sigurojë që individët dhe subjektet juridike të mos preken në mënyrë të padrejtë nga veprime arbitrare të administratës. Ai

krijon mekanizma për **kontestimin e akteve administrative** që mund të cenojnë të drejtat ligjore të palëve të interesuara.

Sigurimi i veprimit të administratës në përputhje me ligjin, LKA-ja vendos që çdo organ publik duhet të veprojë **brenda kufijve të kompetencës së dhënë me ligj**, duke respektuar parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe arsyeshmërisë.

Funksionet e Ligjit për konfliktet administrative

Kontrolli gjyqësor i ligjshmërisë së akteve administrative

Gjykatat e rregullta, sipas LKA-së, kanë kompetencë të shqyrtojnë nëse aktet e nxjerra nga administrata respektojnë ligjin dhe Kushtetutën.

Ky kontroll përfshin **akte normative** (për shembull, rregullore të nxjerra nga ministritë) dhe **akte individuale** (për shembull, vendime administrative të drejtpërdrejta ndaj qytetarëve).

Parandalimi i arbitraritetit dhe shkeljeve të ligjit

Ligji siguron që administrata të mos veprojë në mënyrë të njëanshme ose të tejkalojë kompetencat e saj.

Në rast se konstatohet shkelje e ligjit, gjykata ka mundësinë të **shpallë te pavlefshëm apo të paligjshëm aktin** plotësisht apo pjesërisht.

Garancia e drejtësisë administrative

LKA-ja është instrument për të **siguruar ekuilibrin midis interesit publik dhe të drejtave individuale**, duke ofruar një mekanizëm për mbrojtjen e qytetarëve kundër vendimeve ose akteve administrative të padrejta.

Rëndësia e LKA-së në praktikën administrative

Mbështetje për sundimin e Ligjit, forcon parimin që çdo veprim i administratës publike duhet të ketë **bazë ligjore të qartë**, të jetë i arsyeshëm dhe proporcional.

Siguria juridike dhe transparenca, LKA si instrument kontrolli i lejon qytetarëve të njohin të drejtat e tyre dhe të marrin masa për t'i mbrojtur në gjykatë.

Roli i gjykatave, Gjykatat nëpërmjet shqyrtimit të konflikteve administrative, funksionojnë si **gardianë të ligjshmërisë**, duke parandaluar veprime arbitrare dhe duke siguruar respektimin e parimeve kushtetuese dhe ligjore nga organet publike.

Ligji për konfliktet administrative (LKA), është një instrument i domosdoshëm për funksionimin e një administrate të ligjshme dhe të drejtë. Ai:

Siguron që organet publike të veprojnë brenda kompetencave të tyre;

Mbron të drejtat dhe interesat e qytetarëve nga veprimet arbitrare të administratës;

Garanton që gjykatat të ushtrojnë **kontroll efektiv mbi ligjshmërinë e akteve normative administrative;**

Forcon **sundimin e ligjit, sigurinë juridike dhe transparencën** në funksionimin e institucioneve publike.

Në këtë mënyrë, LKA-ja është themeli i drejtësisë administrative në Kosovë, duke krijuar një **balancë të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave individuale**, dhe duke përmirësuar besimin e qytetarëve në administratën publike dhe sistemin gjyqësor.

Kompetenca e gjykatave sipas Ligjit për konfliktet administrative

Në kuadër të **Ligjit për konfliktet administrative (LKA),** kompetenca e gjykatave të rregullta nuk kufizohet vetëm në shqyrtimin e **akteve individuale administrative**, të cilat prekin drejtpërdrejt të drejtat dhe interesat subjektive të qytetarëve. Një nga mekanizmat më të rëndësishëm të parashikuar në këtë ligj është edhe **kompetenca e gjykatave për të bërë vlerësimin e lighmërisë së akteve normative dhe shqyrtimin incidental të akteve nënligjore**, të cilat shërbejnë si bazë juridike për nxjerrjen e akteve individuale. Rëndësia e kësaj kompetence është **sigurimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore, pasi që** shumë vendime administrative mbështeten mbi **akte të përgjithshme ose nënligjore**, siç janë rregulloret, udhëzimet administrative apo aktet e ngjashme të nxjerra nga organet publike. Nëse këto akte nuk janë në përputhje me ligjin apo me Kushtetutën, ato krijojnë pasiguri juridike dhe cenojnë drejtpërdrejt të drejtat e qytetarëve. Përmes shqyrtimit të

ligjshmërisë, gjykatat kanë mundësi të vlerësojnë nëse akti nënligjor është i mbështetur në ligj dhe kushtetutë.

Parandalimi i zbatimit të akteve të paligjshme

Ky mekanizëm parandalon që qytetarët të mbeten të ekspozuar ndaj efekteve të një akti nënligjor të paligjshëm, i cili përndryshe do të vazhdonte të prodhonte pasoja juridike derisa të shfuqizohej formalisht. Gjykata, në kuadër të një procedure konkrete, mund të shfuqizojë dhe të shpallë të pavlefshëm një akt të tillë dhe të mbrojë të drejtat e palës së dëmtuar.

Mbrojtja e të drejtave themelore

Kontrolli gjyqësor mbi aktet nënligjore është një mjet efektiv për të garantuar se administrata publike nuk tejkalon kompetencat e saj dhe se çdo akt i saj është në harmoni me parimin e **ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike**. Kështu, qytetarët kanë një mbrojtje më të fuqishme të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese.

Roli i gjykatave në sundimin e ligjit.

Ky mekanizëm ka një funksion të dyfishtë:

Mbrojtës – garanton mbrojtjen e individëve nga pasojat e akteve të paligjshme, duke siguruar që vendimet administrative që prekin të drejtat e qytetarëve të mbështeten vetëm mbi norma juridike të vlefshme.

Parandalues – ndikon në vetë administratën publike që të ushtrojë kompetencat e saj me kujdes dhe në përputhje me ligjin, duke qenë se aktet e saj mund të jenë subjekt i kontrollit gjyqësor.

Në këtë kuptim, **vlerësimi i akteve nënligjore** nga gjykata është një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit, sepse krijon një **mekanizëm mbrojtës kundër arbitraritetit të administratës publike**, forcon **sigurinë juridike** dhe mbron **të drejtat themelore të njeriut.**

Prandaj, kompetenca e gjykatave për të shqyrtuar jo vetëm aktet individuale, por edhe ligjshmërinë e akteve nënligjore, përfaqëson një **garanci të fuqishme institucionale për qytetarët**. Ky mekanizëm e bën gjyqësorin një **faktor kyç në kontrollin e administratës publike**, duke kontribuar në:

- forcimin e **parimit të ligjshmërisë,**
- respektimin e **parimit të proporcionalitetit,**
- garantimin e **sigurisë juridike,**
- dhe mbrojtjen efektive të **të drejtave themelore të njeriut.**

Në këtë mënyrë, LKA-ja vendos një **balancë të domosdoshme midis interesit publik dhe të drejtave subjektive të qytetarëve**, duke e përmirësuar funksionimin e shtetit të së drejtës në Kosovë.

3.2. Kompetenca e gjykatës për kontrollin e akteve normative

Kompetenca e Gjykatës Supreme për shfuqizimin e akteve nënligjore normative.

Një nga mekanizmat më të rëndësishëm për garantimin e **sundimit të ligjit** dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve është kompetenca e **Gjykatës Supreme** për të shfuqizuar aktet nënligjore normative, të cilat rezultojnë në kundërshtim me ligjin ose me Kushtetutën. Ky rol i veçantë i Gjykatës Supreme është i lidhur ngushtë me nevojën që sistemi juridik të mbetet koherent, hierarkia e normave juridike të respektohet dhe që qytetarët të mos mbeten të ekspozuar ndaj rregullave të paligjshme. Rëndësia e këtij mekanizmi është **mbrojtja e palëve në proces.** shfuqizimi i një akti nënligjor të paligjshëm nga Gjykata Supreme i mbron palët nga zbatimi i një norme të pavlefshme. Në këtë mënyrë, gjykata nuk kufizohet vetëm në trajtimin e çështjes konkrete, por ndikon drejtpërdrejt në sigurimin e një **mbrojtjeje të gjerë sistemike,** duke eliminuar nga rendi juridik çdo normë që cenon të drejtat e individëve ose që është nxjerrë në tejkalim të kompetencave ligjore.

Sigurimi i hierarkisë normative.

Çdo akt nënligjor duhet të jetë në përputhje me ligjin themelor mbi bazën e të cilit nxirret. Nëse një ministri, agjenci ose komunë miraton një akt që bie në kundërshtim me ligjin themelor ose Kushtetutën, ai akt jo vetëm që krijon paqartësi juridike, por rrezikon të deformojë gjithë praktikën administrative. Kompetenca e Gjykatës Supreme për të shfuqizuar akte të tilla është thelbësore për ruajtjen e **unitetit të rendit juridik.**

Efektiviteti i së drejtës në praktikë.

Pa këtë mekanizëm, mbrojtja gjyqësore do të ishte fragmentare dhe shpesh e pamjaftueshme, pasi qytetarët do të duhej të sfidonin çdo vendim individual të mbështetur në një akt të paligjshëm. Shfuqizimi ose shpallja e pavlefshëme e plotë apo e pjesshme e një akti normativ nga Gjykata Supreme, bën të mundur që akti i paligjshëm të largohet përfundimisht nga sistemi juridik, duke siguruar që **praktika administrative dhe gjyqësore të mbështetet vetëm mbi norma të ligjshme.**

Sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike.

Ky rol i Gjykatës Supreme nuk ka vetëm efekt mbrojtës për palët e përfshira në një proces konkret, por shërben edhe si një **garanci e gjerë për shoqërinë**. Përmes shfuqizimit të akteve nënligjore të paligjshme, gjykata kontribuon në:

forcimin e **parimit të ligjshmërisë**, sipas të cilit çdo akt juridik duhet të ketë bazë dhe kufizime të qarta ligjore;

garantimin e **sigurisë juridike,** duke krijuar një mjedis të parashikueshëm për qytetarët dhe subjektet juridike;

mbrojtjen e **të drejtave themelore të njeriut,** të cilat shpesh mund të cenohen nga kufizime të panevojshme ose të tepruara në aktet nënligjore.

Pra, kompetenca e Gjykatës Supreme për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve nënligjore normative është një mekanizëm thelbësor për të ruajtur **koherencën e sistemit juridik** dhe për të siguruar që **e drejta të jetë efektive në praktikë**. Ky mekanizëm ndihmon jo vetëm në mbrojtjen e palëve individuale në proces, por edhe në garantimin e **shtetit të së drejtës** në tërësi, duke vendosur një standard të qartë se asnjë organ publik nuk mund të ushtrojë kompetenca përtej atyre që i ka dhënë ligji.

Në praktikën administrative shfaqen shpesh akte normative që lidhen me **nxjerrjen e udhëzimeve administrative nga ministritë përkatëse**, të cilat parashikojnë procedura ose detyrime që nuk gjejnë mbështetje në ligjin themelor. Për shembull, një ministri miraton një **udhëzim administrativ** që përcakton një procedurë shtesë për një shërbim të caktuar e cila procedurë **nuk është paraparë në ligjin përkatës që e**

rregullon fushën për të cilën është nxjerr udhëzimi dhe as në ndonjë ligj tjetër përkatës, atëherë lind një problem thelbësor i ligjshmërisë.

Në një situatë të tillë, kur organet administrative përpiqen të zbatojnë këtë udhëzim ndaj një pale në proces, **gjykata ka të drejtë dhe detyrim** që të shqyrtojë ligjshmërinë e tij dhe mund të konstatojë se ky udhëzim administrativ ka tejkaluar kompetencat që i janë dhënë ministrisë me ligj, duke krijuar rregulla të reja pa bazë juridike. Si rrjedhojë, gjykata e shpall të pa ligjshëm respektivisht e shfuqizon pjesërisht apo plotësisht udhëzimin dhe **mbështet vendimin e saj vetëm në ligjin përkatës**, i cili është burimi kryesor dhe detyrues për të gjithë.

Ky shembull ilustron qartë se si **gjykata** bënë garanci themelore për **parandalimin e abuzimeve të administratës,** mbrojtjen e qytetarëve nga norma të paligjshme. Në thelb, ky mekanizëm siguron që **ligji mbetet burimi kryesor i të drejtave dhe detyrimeve**, ndërsa aktet nënligjore kanë vetëm rol plotësues dhe zbatues, por kurrsesi krijues të normave të reja përtej ligjit.

3.3. Natyra e padisë kundër akteve normative

1. Padi për shfuqizimin e aktit nënligjorë normativ (drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme)

Kush mund ta paraqet padi: qytetarët, shoqatat, organet publike ose subjekte të tjera që kanë interes juridik.

Objekti i padisë: shfuqizimi i një akti normativ nënligjor (p.sh. një rregullore, udhëzim administrativ) që bie ndesh me Kushtetutën ose me ligjin.

Karakteristika kryesore: nuk kërkohet që të ekzistojë një rast individual i prekur. Padia paraqitet **në mënyrë të pavarur**, vetëm për të kontrolluar ligjshmërinë e aktit normativ.

Efekti juridik: nëse Gjykata Supreme e shfuqizon aktin, ai **nuk prodhon më efekte juridike,** duke u bërë i pavlefshëm për të gjithë.

Qëllimi: parandalimi i arbitraritetit dhe sigurimi i **sundimit të ligjit në mënyrë të përgjithshme.**

2. **Padi e kombinuar (individuale me element normativ), shqyrtimi incidental**

Kush mund ta paraqet padi: palët që kontestojnë një akt individual, por kërkojnë edhe vlerësimin e aktit normativ mbi të cilin mbështetet ai.

Objekti i padisë: gjykata fillimisht shqyrton aktin individual, por njëkohësisht trajton edhe bazën normative (p.sh. një udhëzim administrativ ose rregullore).

Efekti juridik: nëse gjykata konstaton se akti normativ është i paligjshëm, atëherë: nuk zbatohet për palën në fjalë (kontroll incidental), por nëse rasti është i natyrës më të gjerë, gjykata mund të dërgojë çështjen në Gjykatën Supreme për kontroll abstrakt.

Me hyrjen në fuqi të **Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) në janar 2025**, sistemi juridik i Republikës së Kosovës ka sjellë një risi të rëndësishme në fushën e kontrollit gjyqësor mbi administratën publike. Ndryshe nga praktika e mëhershme, kur gjykata kryesisht ushtronin kontroll **incidental** mbi aktet nënligjore normative gjatë shqyrtimit të një akti individual, ligji i ri ka paraparë mundësinë që **aktet nënligjore normative të kontestohen drejtpërdrejt përmes padisë para Gjykatës Supreme të Kosovës.** Ky mekanizëm përfaqëson një hap cilësor përpara në drejtim të **garantimit të sundimit të ligjit dhe forcimit të kontrollit gjyqësor ndaj pushtetit ekzekutiv**.

Përmes kësaj procedure, qytetarët, shoqatat apo edhe institucionet publike mund t'i drejtohen **drejtpërdrejt Gjykatës Supreme**, duke kërkuar **shfuqizimin e një akti nënligjor normativ** që konsiderohet se ka tejkaluar kompetencat ose është nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo i jep publikut një mjet të fuqishëm mbrojtjeje, duke mos e kufizuar kontrollin vetëm në rastet kur një akt individual bazohet mbi një akt të tillë të paligjshëm.

Ky kontroll i drejtpërdrejtë (abstrakt) ndikon që:

- të parandalohet aplikimi i normave të paligjshme ndaj një numri të madh subjektesh,
- të sigurohet një **qartësi juridike** për të gjithë qytetarët dhe institucionet,

- të forcohet **besimi në rendin juridik.**

4. Krahasimi me juridiksione të tjera evropiane

Mekanizma të tillë ekzistojnë prej kohësh në sisteme të konsoliduara të së drejtës administrative:

Në Gjermani, ligjshmëria e akteve normative kontrollohet nga gjykatat administrative përmes padive abstrakte, me qëllim garantimin e respektimit të **parimit i ligjshmërisë, (Gesetzmäßigkeit der Verëaltung).**

Në Francë, Këshilli i Shtetit (Conseil d'État) është autoriteti më i lartë administrativ që ushtron kontroll abstrakt mbi aktet nënligjore, duke shfuqizuar normat që nuk përputhen me ligjin ose Kushtetutën.

Duke u bazuar në këto modele, **Ligji i ri për Konfliktet Administrative i Kosovës** është i harmonizuar me standardet evropiane dhe praktikat e Komisionit të Venecias, i cili gjithmonë ka rekomanduar mekanizma efektivë të kontrollit gjyqësor mbi pushtetin administrativ.

5. Arsyetimi juridik për rëndësinë e kësaj risie ligjore- juridike

Ky zhvillim ka disa efekte pozitive thelbësore:

Parandalimi i arbitraritetit – Administrata publike nuk mund të krijojë norma të reja që kufizojnë të drejtat apo imponojnë detyrime pa bazë të qartë ligjore, pasi rrezikon që Gjykata Supreme t'i shfuqizojë ato.

Rritja e sigurisë juridike – Subjektet juridike nuk do të kenë nevojë të presin që një akt individual të nxirret kundër tyre për të kontestuar një normë të paligjshme; ato mund të veprojnë menjëherë kundër aktit nënligjor.

Efikasitet më i madh gjyqësor – Përmes shfuqizimit të një akti të paligjshëm, shmangen mijëra konteste të mundshme individuale që do të lindnin nga zbatimi i tij.

Përputhshmëria me standardet evropiane – Ky mekanizëm ofron sistemin juridik të Kosovës me traditat juridike të vendeve anëtare të BE-së dhe forcon zbatimin e parimeve të shtetit të së drejtës.

Mundësia e parashikuar në **LKA**, që aktet nënligjore normative të shfuqizohen drejtpërdrejt nga **Gjykata Supreme**, është një garanci e re juridike për qytetarët dhe institucionet. Ky instrument i kontrollit abstrakt jo vetëm që përforcon **mbrojtjen e të drejtave themelore**, por edhe siguron që administrata publike të veprojë **vetëm brenda kufijve të kompetencave të saj ligjore**, duke rritur **legjitimitetin, transparencën dhe parashikueshmërinë e rendit juridik.**

3.4. Lidhja ndërmjet kontrollit gjyqësor dhe kontrollit kushtetues

Dallimi ndërmjet kompetencës së Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në lidhje me aktet normative në Republikën e Kosovës

1. Gjykata Supreme – Kontrolli i ligjshmërisë së akteve normative

Baza ligjore: Ligji për Konfliktin Administrativ (2025).

Objekti: Gjykata Supreme shqyrton **aktet nënligjore normative** (rregullore, udhëzime administrative, vendime të përgjithshme të organeve publike) për të vlerësuar nëse ato janë në përputhje me **ligjin**.

Karakteristika:

Kontrolli është **juridik-administrativ**, pra kufizohet në **hierarkinë e akteve juridike** (në raport me ligjin).

Gjykata Supreme **nuk shqyrton pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën,** pasi kjo është kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese. Por vlerëson pajtueshmërinë e aktit nënligjorë me Kushtetutën dhe Ligjin.

Ky kontroll bëhet në dy forma: **kontroll abstrakt** (padi e drejtpërdrejtë kundër një akti normativ) dhe **kontroll incidental** (moszbatim i aktit në një rast konkret).

Qëllimi: sigurimi i **sundimit të ligjit** dhe mbrojtja e qytetarëve nga aplikimi i një akti nënligjor që del jashtë kompetencës së organit nxjerrës ose bie ndesh me ligjin.

2. Gjykata Kushtetuese – Kontrolli i kushtetutshmërisë së akteve normative

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës (nenet 113 dhe vijues).

Objekti: Gjykata Kushtetuese kontrollon nëse **ligjet,** janë në përputhje me **Kushtetutën.**

Karakteristika:

Kontrolli është **kushtetues**, pra synon mbrojtjen e **hierarkisë më të lartë juridike** – Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese mund të shfuqizojë ligje ose dispozita ligjore.

Ka kompetencë të vendosë edhe për shkeljet e **të drejtave themelore dhe lirive kushtetuese**.

Qëllimi: garantimi i **supremacisë së Kushtetutës** dhe mbrojtja e rendit kushtetues demokratik.

3. Bashkëveprimi i Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në kontrollin e akteve normative

Bashkëveprimi ndërmjet Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në sistemin juridik të Republikës së Kosovës përbën një mekanizëm të gjithanshëm kontrolli të akteve normative. Ky bashkëveprim është i domosdoshëm, sepse nga njëra anë, Gjykata Supreme ushtron kontrollin mbi **ligjshmërinë** e akteve nënligjore, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave subjektive të individëve përballë administratës publike, ndërsa nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese siguron **kushtetutshmërinë** e ligjeve duke ruajtur koherencën e rendit juridik dhe supremacinë e Kushtetutës.

Kështu, përmes Gjykatës Supreme, qytetari fiton mbrojtje të drejtpërdrejtë ndaj aplikimit të një norme të paligjshme që ka karakter nënligjor, ndërsa përmes Gjykatës Kushtetuese, garantohet që vetë ligji i

miratuar nga Kuvendi të mos cenojë të drejtat dhe liritë kushtetuese. Ky sistem i dyfishtë krijon një **balancë institucionale**, ku njëkohësisht mbrohen të drejtat individuale dhe sigurohet hierarkia e burimeve juridike në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës.

Në këtë mënyrë, mekanizmi i kombinuar i kontrollit – ligjshmëri nga Gjykata Supreme dhe kushtetutshmëri nga Gjykata Kushtetuese – është thelbësor për të shmangur arbitraritetin e administratës, për të forcuar besimin e qytetarëve në institucionet publike dhe për të ruajtur koherencën e të gjithë rendit juridik.

Kapitulli IV: Shqyrtimi incidental i akteve normative nënligjore

4.1. Kuptimi dhe natyra juridike e shqyrtimit incidental

Shqyrtimi incidental përbën një nga mekanizmat e rëndësishëm të kontrollit gjyqësor në fushën e së drejtës administrative, pasi garanton mbrojtjen efektive të të drejtave dhe interesave subjektive të individëve përballë normave nënligjore të cilat mund të jenë në kundërshtim me ligjin ose Kushtetutën. Ky institut juridik ka një funksion thelbësor për sigurimin e sundimit të ligjit, duke ndaluar që aktet nënligjore të paligjshme të prodhojnë efekte juridike në dëm të qytetarëve.

Në thelb, shqyrtimi incidental nënkupton se gjykata, gjatë trajtimit të një kontesti konkret, nuk kufizohet vetëm në verifikimin e ligjshmërisë së aktit individual të nxjerrë nga administrata publike, por ka kompetencë të refuzojë zbatimin e një akti normativ që është në kundërshtim me normat hierarkikisht më të larta – ligjin ose Kushtetutën. Ky mekanizëm i jep gjykatës një rol aktiv në sigurimin e koherencës së rendit juridik, duke shmangur situatat ku një normë nënligjore, e cila tejkalon kompetencat e organit nxjerrës ose bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, do të zbatohej në dëm të palëve në proces.

Përparësia kryesore e shqyrtimit incidental qëndron në natyrën e tij praktike dhe të menjëhershme. Ndryshe nga kontrolli abstrakt, i cili zakonisht ushtrohet nëpërmjet procedurave të posaçme dhe kërkon iniciativë institucionale, shqyrtimi incidental aktivizohet drejtpërdrejt nga gjykata gjatë gjykimit të një çështje konkrete. Kjo e bën atë një mjet

efektiv për mbrojtjen e qytetarëve, sepse gjykata nuk detyrohet të zbatojë një akt nënligjor vetëm për shkak se ai është në fuqi, nëse vëren se ai bie ndesh me ligjin ose Kushtetutën.

Në këtë mënyrë, shqyrtimi incidental përfaqëson një garanci të rëndësishme për respektimin e hierarkisë së normave dhe për mbrojtjen e të drejtave themelore. Përmes këtij instituti, gjykata jo vetëm që zgjidh konfliktin konkret midis palëve, por gjithashtu kontribon në forcimin e shtetit të së drejtës, duke parandaluar që akte nënligjore të paligjshme të marrin jetë dhe të prodhojnë pasoja juridike.

4.2. Procedura gjyqësore në shqyrtimin incidental

Procedura e shqyrtimit incidental- paraqet një mekanizëm të veçantë juridik, i cili zhvillohet gjatë shqyrtimit të padisë administrative në gjykatë në procedurën e konfliktit administrativ, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2025. Ky institucion juridik i jep gjykatës kompetencën që, nëse gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së një akti administrativ individual konstaton se ky akt bazohet në një akt normativ të paligjshëm (si rregullore, udhëzim administrativ apo akt tjetër i përgjithshëm), të mos e aplikojë atë akt normativ në rastin konkret.

Thelbi i kësaj procedure qëndron në faktin se gjykata, pa pasur nevojë të iniciojë një procedurë të veçantë për kontrollin e kushtetutshmërisë apo ligjshmërisë së aktit normativ, ushtron kompetencën e saj për të mbrojtur parimin e ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës. Kështu, gjykata nuk e anulon aktin normativ si të tillë, por refuzon aplikimin e tij në rastin konkret, duke siguruar që vendimi gjyqësor të bazohet vetëm mbi norma juridike të vlefshme e legjitime.

Ky mekanizëm procedural është i rëndësishëm për disa arsye:

Siguron mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive të palëve në procedurën e konfliktit administrativ, sepse u mundëson atyre që të mos dëmtohen nga zbatimi i një norme të paligjshme.

Forcon parimin e hierarkisë së akteve juridike, duke parandaluar që aktet normative të nxjerra në kundërshtim me ligjin të prodhojnë pasoja juridike konkrete.

Ruhet balanca ndërmjet kompetencave të gjykatave dhe organeve të tjera.

Në këtë mënyrë, procedura e shqyrtimit incidental, shërben si një instrument i drejtpërdrejtë dhe praktik për të garantuar sundimin e ligjit, duke e bërë Gjykatën Supreme një faktor aktiv në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe në kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të administratës publike.

4.3. Efektet juridike të vendimit të gjykatës

Vendimi i gjykatës për të refuzuar zbatimin e një akti nënligjor normativ, i cili konstatohet i paligjshëm gjatë shqyrtimit incidental, prodhon efekte vetëm në rastin konkret që është objekt i gjykimit sipas padisë. Ky vendim nuk ka fuqi shfuqizuese ndaj aktit në tërësi, as nuk e pengon administratën që të vazhdojë ta zbatojë atë akt në raste të tjera. Në këtë kuptim, efektet e tij janë relative (inter partes), pasi kufizohen vetëm ndërmjet palëve të përfshira në procesin konkret gjyqësorë.

Kjo rrjedh qartë nga neni 55 i Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili parashikon se gjykata, nëse krijon bindjen për mospërputhshmërinë e një akti nënligjor normativ me ligjin, është e detyruar ta referojë çështjen në Gjykatën Supreme për vlerësim. Deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Supreme, procedura para gjykatës referuese pezullohet, gjë që garanton siguri juridike dhe shmang krijimin e efekteve të drejtpërdrejta shfuqizuese nga një gjykatë e shkallës së parë

Megjithatë, edhe pse vendimi i gjykatës për refuzimin e zbatimit të një norme prodhon vetëm efekte relative, ai ka një ndikim të rëndësishëm në praktikën gjyqësore.

Së pari, krijon një precedent gjyqësor që mund të ndiqet në raste të ngjashme, duke kontribuar në unifikimin e praktikës gjyqësore.

Së dyti, ushtron presion mbi organet administrative që të rishikojnë ose të shfuqizojnë vetë aktin nënligjor të paligjshëm, për të shmangur situata të përsëritura të refuzimit të aplikimit nga gjykatat.

Ndërkaq, kur kemi të bëjmë me padinë e drejtpërdrejtë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, sipas nenit 70 dhe nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, aktgjykimi që e shfuqizon normën, pasi merr formë të prerë, prodhon efekte erga omnes dhe vetëm për të ardhmen.

Pra, ndryshimi thelbësor mes shqyrtimit incidental dhe padisë për shfuqizimin, qëndron te shtrirja e efekteve: në rastin e parë janë relative, ndërsa në rastin e dytë janë të përgjithshme dhe për të ardhmen

Në përfundim, edhe pse vendimi incidental nuk shfuqizon aktin në tërësi, rëndësia e tij qëndron në ndikimin indirekt që ushtron në sistemin juridik:

- mbron të drejtat e individëve në rastin konkret,
- forcon parimin e ligjshmërisë dhe hierarkisë së akteve,
- kontribuon në krijimin e një praktike gjyqësore të qëndrueshme,
- dhe nxit administratën për të ndërmarrë korrigjime të nevojshme normative.

4.4. Roli i jurisprudencës dhe unifikimi i praktikës gjyqësore

1. Baza ligjore e shqyrtimit incidental

Instituti i **shqyrtimit incidental** është paraparë në Ligjin Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative. Sipas **nenit 55**, nëse gjykata e shkallës së parë ose ajo e apelit konstaton se një akt nënligjor normativ, mbi të cilin mbështetet akti individual administrativ i kontestuar, është në kundërshtim me ligjin, ajo është e detyruar ta **referojë çështjen në Gjykatën Supreme**. Deri në marrjen e vendimit nga kjo e fundit, procedura para gjykatës referuese **pezullohet.**

Ky mekanizëm garanton që gjykatat e shkallëve më të ulëta të mos ushtrojnë kompetencë përfundimtare mbi vlefshmërinë e akteve normative, por njëkohësisht siguron mbrojtje të menjëhershme për individin, duke refuzuar aplikimin e një norme të paligjshme në rastin

konkret. Efekti i vendimit incidental është **relative** (inter partes), pra prodhon pasoja vetëm ndërmjet palëve në konfliktin administrativ.

2. Roli i Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës luan një rol vendimtar në këtë mekanizëm. Në përputhje me **nenin 10 paragrafi 4** të ligjit, Gjykata Supreme gjykon si shkallë e parë dhe e vetme paditë për shfuqizimin e akteve nënligjore normative. Po ashtu, në rastet e referuara nga gjykatat e tjera, ajo është instanca që jep vendimin përfundimtar mbi ligjshmërinë e aktit normativ.

Ky rol i jep Gjykatës Supreme funksionin e **unifikimit të praktikës gjyqësore.** Përmes vendimeve të saj, ajo siguron interpretim të qëndrueshëm dhe të njëtrajtshëm të ligjit, duke shmangur pasigurinë juridike që do të lindte nga vendime kontradiktore të gjykatave të shkallëve më të ulëta. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme kontribuon në forcimin e **parimit të sigurisë juridike** dhe krijon standarde të cilat adminstrata publike është e detyruar t'i marrë parasysh gjatë nxjerrjes së akteve të saj.

3. Raporti me jurisprudencën evropiane

Mekanizmi i shqyrtimit incidental është në harmoni të plotë me **standardet evropiane për mbrojtjen gjyqësore efektive,** të zhvilluara në praktikën e **Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).** Sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, çdo individ duhet të ketë qasje në një gjykatë e cila i ofron një mjet **efektiv, të shpejtë dhe të paanshëm** për mbrojtjen e të drejtave të tij.

Në këtë kuptim, shqyrtimi incidental është një instrument kombëtar që garanton që individi të mos detyrohet të respektojë një normë të paligjshme, derisa Gjykata Supreme të vendosë përfundimisht për ligjshmërinë e saj. Ky mekanizëm është analog me praktikat e shumë vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, ku gjykatat e zakonshme refuzojnë aplikimin e një norme të paligjshme dhe çështjen ia referojnë gjykatës më të lartë për vendim unifikues.

4. Ndikimi në sigurinë juridike dhe zhvillimin e jurisprudencës

Edhe pse vendimi incidental prodhon efekte vetëm për rastin konkret, ai ka një ndikim të gjerë në sistemin juridik:

Për gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, vendimet e tyre krijojnë praktika të cilat mund të ndiqen në raste të ngjashme, duke kontribuar në zhvillimin e jurisprudencës vendore.

Për Gjykatën Supreme, aktgjykimet e saj mbi ligjshmërinë e akteve normative kanë efekte **erga omnes**, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe uniformitet të gjithë sistemit juridik.

Për administratën publike, praktika gjyqësore ushtron presion për të rishikuar dhe harmonizuar aktet normative me ligjin, duke forcuar parimin e ligjshmërisë.

Për qytetarët, ky mekanizëm siguron që të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme të mos cënohen nga zbatimi i normave të paligjshme, duke rritur besimin në sistemin e drejtësisë.

Kapitulli V: Standardet ndërkombëtare dhe krahasimi me legjislacionin vendor

5.1. Standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përfaqëson një referencë themelore për standardet e mbrojtjes gjyqësore në Evropë, duke përcaktuar të drejtat dhe liritë themelore që çdo individ ka të drejtë t'i gëzojë dhe të mbrohen nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit. Neni 6 i Konventës garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor (fair trial), i cili përfshin jo vetëm mundësinë për të paraqitur çështjen para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, por edhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve, përfshirë informimin e drejtë mbi akuzat ose pretendimet, të drejtën për mbrojtje ligjore dhe trajtimin e drejtë dhe të barabartë gjatë gjithë procedurës. Ky nen është themelor për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së veprimeve të organeve publike, duke krijuar një mjet për individin që të sfidojë çdo akt që mund të cenojë të drejtat e tij themelore.

Nga ana tjetër, Neni 13 i Konventës garanton të drejtën për një mjet efektiv juridik (effective remedy). Ky nen shton dimensionin praktik të garantimit të të drejtave të njeriut, duke kërkuar që çdo individ të ketë qasje në mekanizma ligjorë që mund të vlerësojnë ligjshmërinë e veprimeve ose mosveprimeve të organeve shtetërore. Në këtë kontekst, mjeti efektiv juridik nuk kufizohet vetëm në sfidimin e aktve individuale, por përfshin edhe mundësinë për të kundërshtuar aktet normative të organeve publike që ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtat themelore të individit. Kjo ka një rëndësi të veçantë, pasi siguron që shteti të mbajë një llogaridhënie të vazhdueshme dhe që veprimet administrative ose legjislative të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut.

Përmes kombinimit të nenit 6 dhe nenit 13, KEDNJ vendos një kornizë të qartë për mbrojtjen gjyqësore, e cila kërkon jo vetëm ekzistencën formale të gjykatave dhe procedurave ligjore, por edhe efektivitetin e tyre në praktikë. Kjo nënkupton se individët duhet të kenë mundësi reale për të kërkuar drejtësi dhe për të parandaluar shkeljet e të drejtave të tyre, duke përfshirë edhe mbrojtjen kundër veprimeve arbitrare të administratës dhe aktve normative të organeve publike.

Në këtë mënyrë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut jo vetëm që garanton parimet themelore të drejtësisë, por gjithashtu imponon një përgjegjësi ligjore dhe procedurale mbi shtetin për të siguruar që të drejtat e individit nuk cënohen, duke krijuar një standard të lartë për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore në të gjithë Evropën.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar në mënyrë të përsëritur se ekzistenca formale e një mjeti juridik nuk është e mjaftueshme; ai konsiderohet efektiv vetëm nëse është në gjendje të parandalojë shkeljen e të drejtave të njeriut ose të ofrojë një korrigjim efektiv në rast të ndodhjes së një shkeljeje. Ky parim reflekton një standard praktik, sipas të cilit çdo individ duhet të ketë qasje reale dhe të menjëhershme në mekanizmat ligjorë që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të tij themelore.

Në këtë kontekst, kontrolli gjyqësor mbi aktet normative të organeve publike nuk duhet të jetë vetëm formal ose tejet i kufizuar, por duhet të jetë i qasshëm, i shpejtë dhe i efektshëm në praktikë. GJEDNJ ka vënë në

dukje se vonesat, vështirësitë procedurale ose mungesa e qartësisë në rrugët e ankimit mund të cenojnë efektivitetin e një mjeti juridik, duke e bërë të pamundur për individin të mbrojë të drejtat e tij në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Për më tepër, standardi i efektivitetit kërkon që gjykata të ketë kompetencë të vlerësojë ligjshmërinë e aktit normativ dhe të sigurojë një zgjidhje reale që mund të ndikojë në shpalljen e pavlefshme dhe shfuqizimin e tij, nëse ai bie ndesh me të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo qasje ka për qëllim të ruajë besimin e publikut tek sistemet juridike dhe të garantojë që të drejtat themelore të individëve nuk mbeten të pambrojtura për shkak të mungesës së mjeteve të efektshme ligjore.

Në këtë mënyrë, Gjykata Evropiane përcakton një standard të qartë për funksionimin e mjeteve juridike, duke theksuar domosdoshmërinë e një balancimi midis aksesit të qasshëm, shpejtësisë së procedurës dhe efektivitetit real të gjykimit, që siguron mbrojtje reale për të drejtat e individit kundër çdo akti të paligjshëm ose arbitrar të organeve shtetërore.

5.2. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka shprehur në mënyrë të qartë në jurisprudencën e saj se shtetet kanë përgjegjësi për të siguruar një kontroll efektiv mbi aktet normative dhe për të garantuar që veprimet e tyre nuk cenojnë të drejtat themelore të individëve. Mungesa e një kontrolli të tillë është ndëshkuar në disa raste të njohura, të cilat shërbejnë si parime udhëzuese për interpretimin dhe zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në çështjen **Kruslin kundër Francës (1990)**, Gjykata theksoi se çdo ndërhyrje në të drejtat e individëve duhet të ketë një bazë të qartë ligjore dhe të jetë e parashikueshme. Ky rast ilustron rëndësinë e qartësisë dhe sigurisë juridike, duke treguar se aktet normative që ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtat e individëve nuk mund të jenë arbitrare ose të paqartë.

Në çështjen **Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (1983),** Gjykata theksoi nevojën për qartësi të normave nënligjore dhe për mundësinë e qytetarëve për t'i kuptuar dhe aksesuar ato. Ky standard siguron që individët të jenë në gjendje të orientojnë sjelljen e tyre sipas ligjit dhe të dinë se si mund të mbrojnë të drejtat e tyre përmes mekanizmave ligjorë.

Po ashtu, në çështjen **Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (1979)**, Gjykata vendosi se ligji duhet të jetë i qartë, i aksesueshëm dhe i parashikueshëm, në mënyrë që individët të mund të planifikojnë veprimet e tyre dhe të shmangin shkeljet e mundshme të të drejtave. Ky rast forcon idenë se standardi i qartësisë së ligjit dhe i efektivitetit të mjeteve juridike nuk është thjesht formal, por ka një rëndësi praktike në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Përmes këtyre vendimeve, GJEDNJ ka vendosur parimin se kontrolli gjyqësor mbi aktet normative duhet të jetë real dhe efektiv. Nuk mjafton ekzistenca formale e një gjykate ose e një procedure ligjore; individët duhet të kenë mundësi të qasshme dhe të shpejtë për të kundërshtuar çdo akt që bie ndesh me të drejtat e tyre. Këto raste nënvizojnë një dimension praktik të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke integruar kërkesën për qartësi, para shikueshmëri dhe qasje të plotë në mekanizmat juridikë.

Këto standarde të qartësisë, para shikueshmërisë dhe qasjes në ligje janë të lidhura ngushtë me institutin e **shqyrtimit incidental** në procedurën gjyqësore. Në kuadër të këtij shqyrtimi, gjykatat vendore janë të obliguara të verifikojnë ligjshmërinë e akteve normative që janë të aplikuara në rastet konkrete dhe të refuzojnë zbatimin e tyre nëse ato rezultojnë të paqarta, të papublikuara ose në kundërshtim me të drejtat themelore të individit.

Shqyrtimi incidental përbën një mjet praktik të kontrollit gjyqësor mbi veprimet e organeve publike, duke u siguruar qytetarëve mundësinë për të kundërshtuar shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre pa pasur nevojë të presin për një proces të veçantë të anulimit të aktit normativ. Ky mekanizëm garanton që veprimet administrative dhe normat ligjore të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, duke respektuar

kërkesat e përcaktuara nga **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)** në jurisprudencën e saj.

Në këtë mënyrë, shqyrtimi incidental nuk është vetëm një formë teknike e kontrollit ligjor, por një instrument esencial për **mbrojtjen efektive të të drejtave themelore**, i cili siguron që individët të mos përballen me aktet normative arbitrare ose të papërcaktuara dhe që gjykatat të veprojnë si një gardian i sundimit të ligjit. Ky parim harmonizohet me kërkesat e KEDNJ, duke theksuar se çdo ndërhyrje në të drejtat e individit duhet të jetë e bazuar mbi ligj të qartë, të aksesueshëm dhe të zbatueshëm, duke ruajtur kështu parimin e para shikueshmërisë dhe sigurisë juridike.

5.3. Roli i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE), ka zhvilluar një praktikë të gjerë dhe konsistente në lidhje me kontrollin e ligjshmërisë së akteve normative, duke theksuar rëndësinë e supremacisë së së drejtës së BE-së mbi normat kombëtare. Ky parim kërkon që gjykatat kombëtare të mos zbatojnë asnjë dispozitë kombëtare që bie ndesh me të drejtën e BE-së, duke siguruar që parimet dhe normat themelore të së drejtës evropiane të kenë efekt të drejtpërdrejtë dhe të jenë të zbatueshme në praktikë.

Në **çështjen Costa kundër ENEL (1964),** GJDBE vendosi parimin themelor të supremacisë së së drejtës evropiane, duke sqaruar se aktet e BE-së kanë një pozicion juridik mbi ligjet kombëtare dhe se shtetet anëtare nuk mund të krijojnë norma që kufizojnë ose zhbëjnë efektin e së drejtës evropiane. Ky vendim shërben si bazë për garantimin e një hierarkie të qartë ligjore dhe për ruajtjen e koherencës së sistemit të së drejtës së BE-së.

Në **çështjen Simmenthal (1978)**, Gjykata theksoi se gjykatat kombëtare kanë detyrimin e menjëhershëm për të refuzuar zbatimin e çdo norme kombëtare që është në kundërshtim me të drejtën e BE-së, pa pasur nevojë të presin shfuqizimin formal të saj nga autoritetet kombëtare. Ky parim forcon efektivitetin e menjëhershëm të së drejtës evropiane dhe siguron që individët të mund të mbështeten në të drejtën e BE-së për të mbrojtur të drejtat e tyre në praktikë.

Në **çështjen Internationale Handelsgesellschaft (1970)**, Gjykata vendosi se edhe normat kushtetuese kombëtare nuk mund të cenojnë parimet themelore të së drejtës së BE-së. Ky rast thekson se përparësia e së drejtës evropiane nuk kufizohet nga dispozitat kombëtare, përfshirë ato kushtetuese, dhe që çdo veprim shtetëror duhet të jetë në përputhje me parimet themelore të BE-së, duke përfshirë respektimin e të drejtave themelore dhe parimin e ligjshmërisë.

Këto vendime, në mënyrë të qartë, vendosin një standard praktik për gjykatat kombëtare: ato nuk janë vetëm arbitre të ligjeve kombëtare, por edhe garantuese të efektivitetit të së drejtës së BE-së. Në këtë kuadër, parimi i supremacisë dhe detyrimi për të refuzuar normat që bien ndesh me të drejtën evropiane sigurojnë një kontroll të vazhdueshëm mbi ligjshmërinë e akteve normative dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të individëve.

Ky standard i kontrollit të ligjshmërisë së akteve normative është analog me institutin e **shqyrtimit incidental** në Kosovë, ku gjykatat kombëtare kanë kompetencë të refuzojnë zbatimin e çdo **akti nënligjor që është i paligjshëm** ose në kundërshtim me të drejtat themelore të individëve. Në këtë kuadër, gjykatat nuk veprojnë thjesht si interpretues të ligjit, por edhe si **gardianë të ligjshmërisë dhe mbrojtjes së të drejtave**.

Në praktikën tonë, shqyrtimi incidental ofron një mekanizëm të efektshëm për të siguruar që normat administrative dhe aktet nënligjore të jenë **të qarta, të parashikueshme dhe të përputhshme me standardet e të drejtave të njeriut**, duke reflektuar parimet e përcaktuara nga jurisprudenca ndërkombëtare, përfshirë Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE).

Ky mekanizëm garanton një **mbrojtje efektive** për individët, pasi nuk është e nevojshme të presin për shfuqizimin formal të një akti normativ për të kundërshtuar aplikimin e tij; gjykatat mund të ndërhyjnë menjëherë gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete. Në këtë mënyrë, standardi i shqyrtimit incidental siguron një balancë mes **efektivitetit të mbrojtjes së të drejtave të individit** dhe **sigurisë juridike së sistemit ligjor**, duke

u harmonizuar me parimet e qartësisë, para shikueshmërisë dhe aksesit të drejtë në mekanizmat juridikë.

Përveç aspektit praktik, shqyrtimi incidental ka një rol parësor në **forcimin e sundimit të ligjit**, pasi gjykatat vendore nuk e konsiderojnë një akt nënligjor si të ligjshëm vetëm për shkak të ekzistencës së tij formal. Në këtë mënyrë, standardi jonë i kontrollit të ligjshmërisë së akteve nënligjore reflekton një qasje të përgjegjshme dhe efektive, e cila përputhet me praktikat ndërkombëtare dhe garanton që individët të kenë një **mjet real për të mbrojtur të drejtat e tyre themelore.**

5.4. Modelet kombëtare: Gjermania, Franca dhe rajoni i Ballkanit

Roli i gjykatave në kontrollin e ligjshmërisë së akteve normative ndryshon nga një shtet në tjetrin, por ekzistojnë modele të qarta që ofrojnë një perspektivë të dobishme krahasuese.

Gjermania paraqet një model të dyfishtë të kontrollit gjyqësor: Gjykata Kushtetuese Federale ushtron **kontroll abstrakt** mbi normat ligjore, duke vlerësuar përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën Federale, ndërsa gjykatat e rregullta kanë kompetencë për **kontroll konkret** (incidental) mbi aktet normative gjatë trajtimit të çështjeve të veçanta. Ky sistem kombinon parimet e para shikueshmërisë dhe efektivitetit, duke siguruar që individët të mund të kundërshtojnë aktet normative që bien ndesh me të drejtat e tyre themelore.

Franca, nga ana tjetër, ka një sistem të centralizuar administrativ, ku **Conseil d'État** ka kompetencë të plotë për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve normative dhe për të anuluar aktet nënligjore që shkelin ligjin ose parimet kushtetuese. Ky model tregon një qasje pro-aktive të shtetit për të garantuar ligjshmërinë dhe qartësinë e normave administrative, duke integruar standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sigurisë juridike.

Në **Ballkan**, ekzistojnë modele të ndryshme, por shpesh të kombinuara:

Në **Shqipëri**, gjykatat administrative kanë kompetencë për të anuluar aktet nënligjore që cenojnë ligjshmërinë, duke ushtruar një kontroll të drejtpërdrejtë mbi veprimet administrative.

Në **Maqedoninë e Veriut** dhe **Mal të Zi,** funksionon një kombinim i kontrollit gjyqësor dhe kushtetues, ku gjykatat e rregullta mund të shqyrtojnë ligjshmërinë e aktit në kuadër të një rasti konkret, ndërsa gjykatat kushtetuese mund të ushtrojnë kontroll abstrakt. Ky model është i ngjashëm me atë të **Kosovës**, ku gjykatat kombëtare kanë kompetencë për kontroll të incidenteve mbi aktet normative gjatë shqyrtimit të çështjeve konkrete, ndërsa Gjykata Kushtetuese ka kompetencë për kontroll abstrakt, përveç dallimit që në Kosovë këtë kompetencë për aktet nënligjore e ka ekskluzivisht Gjykata Supreme.

Ky krahasim tregon se, pavarësisht nga dallimet strukturore, parimet themelore mbeten të njëjta: **garantimi i ligjshmërisë së aktit normativ, siguria juridike dhe mbrojtja e të drejtave themelore të individit.** Modeli i kombinimit midis kontrollit abstrakt dhe konkret (incidental) rezulton veçanërisht efektiv, pasi siguron që çdo individ të ketë mundësi reale për të sfiduar aktet normative që cenojnë të drejtat e tij, duke respektuar standardet e përcaktuara nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga Gjykata e Drejtësisë së BE-së.

Krahasimi ndërkombëtar tregon se **Kosova ka adoptuar një model të ngjashëm me atë të Gjermanisë**, duke ndarë kompetencat midis gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese. Në këtë sistem, gjykatat kombëtare kanë kompetencë për të ushtruar **kontroll konkret ose incidental**, duke refuzuar zbatimin e çdo norme të paligjshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete. Kjo qasje u siguron individëve një **mjet efektiv për të kundërshtuar aktet normative që cenojnë të drejtat e tyre**, pa pasur nevojë të presin për shfuqizimin formal të aktit nga autoriteti kompetent.

Nga ana tjetër, **kontrolli abstrakt mbi ligjet** mbetet kompetencë e **Gjykatës Kushtetuese**, e cila vlerëson përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe parimet themelore të të drejtave të njeriut. Ndërsa vlerësimi i ligjshmërisë së akteve nën ligjore mbetet në kompetencë të Gjykatës Supreme. Kjo ndarje kompetencash krijon një **balancë të qëndrueshme** midis efektivitetit të mbrojtjes së të drejtave të individit dhe ruajtjes së sigurisë juridike të sistemit ligjor.

Modeli kosovar, duke u bazuar mbi këtë ndarje të kompetencave, siguron që çdo individ të ketë qasje reale dhe të menjëhershme në mekanizmat juridikë për të mbrojtur të drejtat e tij, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese ofron një **kontroll parimor dhe abstrakt** mbi normat, duke garantuar që aktet normative të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në këtë mënyrë, modeli i Kosovës pasqyron një praktikë të konsoliduar evropiane, e cila kombinon **kontrollin incidental dhe atë abstrakt** në mënyrë komplementare, duke forcuar sundimin e ligjit, qartësinë e normave dhe efektivitetin e mbrojtjes së të drejtave themelore. Ky model demonstron gjithashtu harmonizimin e praktikës kosovare me standardet ndërkombëtare, si ato të **Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, ashtu edhe të **Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian**, në zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, qartësisë dhe efektivitetit të mjeteve juridike.

5.5. Vlerësimi krahasues dhe rëndësia për Kosovën

Nga analiza krahasuese rezulton se **modeli i Kosovës në kontrollin e ligjshmërisë së akteve normative është i përafërt me praktikat më të avancuara evropiane**, duke kombinuar kontrollin incidental nga gjykatat e rregullta dhe kontrollin abstrakt nga Gjykata Kushtetuese. Ky model ofron një kornizë të qëndrueshme për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe garantimin e ligjshmërisë, duke e harmonizuar praktikën kosovare me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, **ndërgjegjësimi i administratës publike** për kufizimet dhe detyrimet ligjore që rrjedhin nga kontrolli gjyqësor është thelbësor. Pa një administratë të informuar dhe të bashkëpunueshme, mundësitë për zbatimin e ligjshmërisë dhe për parandalimin e shkeljeve të të drejtave themelore zvogëlohen ndjeshëm.

Në këtë kontekst, për të siguruar që modeli i Kosovës të funksionojë në mënyrë efektive, është e domosdoshme një qasje e integruar, e cila përfshin:

Unifikimin e praktikës gjyqësore, për të siguruar që vendimet të jenë të parashikueshme dhe të harmonizuara në të gjithë sistemin gjyqësor;

Trajnimin e gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor, me fokus në jurisprudencën ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane;

Ndërgjegjësimin dhe edukimin e administratës publike, për të garantuar respektimin e standardeve të ligjshmërisë dhe të të drejtave themelore.

Vetëm përmes implementimit të këtyre masave mund të sigurohet që modeli i Kosovës të mos mbetet vetëm një standard formal, por të funksionojë si një mekanizëm real dhe efektiv për **mbrojtjen e të drejtave themelore, garantimin e ligjshmërisë dhe forcimin e sundimit të ligjit** në nivel kombëtar.

Standardet e përcaktuara nga **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)** dhe **Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)** nënvizojnë se gjykatat duhet të jenë **të guximshme dhe pro-aktive në mbrojtjen e të drejtave themelore,** duke mos hezituar të refuzojnë çdo normë ose akt nënligjor që është i paligjshëm ose bie ndesh me parimet themelore të të drejtave të njeriut. Ky standard nënkupton jo vetëm ekzistencën formale të mekanizmave juridikë, por edhe efektivitetin e tyre praktik, duke garantuar që individët të kenë një **mjet real për të mbrojtur të drejtat e tyre.**

Për Kosovën, zbatimi i këtij standardi përbën një **sfidë të dukshme,** për shkak të faktorëve të ndryshëm, përfshirë nevojën për **unifikim të praktikës gjyqësore,** mungesën e përvojës së gjerë me shqyrtimin incidental dhe nevojën për trajnime të vazhdueshme të gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor, për shkak të hyrjes së Ligjit të Ri në fuqi respektivisht në janar të këtij viti. Megjithatë, ky standard përbën gjithashtu një **mundësi të rëndësishme** për të forcuar **shtetin e së drejtës** në Kosovë dhe për të harmonizuar sistemin juridik kombëtar me praktikat më të avancuara evropiane.

Duke adoptuar një qasje të vendosur dhe të koordinuar, gjykatat në Kosovë mund të bëhen **gardianë efektivë të ligjshmërisë dhe të të drejtave themelore,** duke siguruar që aktet nënligjore të mos cenojnë parimet kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për më tepër, ky standard promovon **transparencë, para shikueshmëri dhe siguri juridike,** duke rritur besimin e qytetarëve tek sistemi gjyqësore dhe duke kontribuar në konsolidimin e sundimit të ligjit në nivel kombëtar.

Në këtë mënyrë, orientimi drejt respektimit të parimeve të GJEDNJ dhe GJDBE nuk përfaqëson vetëm një kërkesë formale, por një **instrument praktik për forcimin e sistemit juridik kosovar,** duke krijuar një urë mes standardeve ndërkombëtare dhe praktikës kombëtare të mbrojtjes së të drejtave themelore.

Kapitulli VI: Analiza teorike dhe praktike

6.1. Roli i praktikës gjyqësore në konsolidimin e vlerësimit të akteve normative dhe shqyrtimit incidental

Praktika gjyqësore ka një **rol vendimtar në konsolidimin e vlerësimit të akteve normative nënligjore dhe funksionalizimin e institutit të shqyrtimit incidental.** Ndërsa **Ligji për konfliktet administrative** ofron kuadrin ligjor bazë për këtë mekanizëm, është jurisprudenca e gjykatave ajo që i jep atij **efektivitetin dhe zbatueshmërinë praktike.** Në mungesë të interpretimit dhe përcaktimit të standardeve nga gjykatat, dispozitat ligjore mund të mbeten thjesht formale, pa ofruar një mbrojtje reale për individët kundër akteve të paligjshme të administratës publike.

Përmes aktgjykimeve të tyre, gjykatat përcaktojnë **standardet e interpretimit dhe të aplikimit të parimit të ligjshmërisë**, duke vendosur kriteret për rastet konkrete dhe duke krijuar një **orientim të qëndrueshëm** për organet publike dhe për gjykatat e tjera. Kjo praktikë kontribuon në një **uniformitet të vendimeve**, redukton pasigurinë juridike dhe siguron që aktet nënligjore të jenë në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Për më tepër, jurisprudenca krijon një **dialog të vazhdueshëm mes gjykatave dhe administratës publike,** ku vendimet gjyqësore nuk kanë vetëm efekt konkret për palët në çështje, por shërbejnë edhe si udhëzues për parimet e zbatimit të ligjit në nivel kombëtar. Ky mekanizëm **forcon sundimin e ligjit**, duke integruar kërkesat për qartësi, para shikueshmëri dhe efektivitet të mjeteve juridike, në përputhje me standardet e përcaktuara nga **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut** dhe **Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.**

Në këtë mënyrë, praktika gjyqësore nuk është thjesht zbatim i ligjit, por një element kyç për **zhvillimin e një sistemi juridik funksional dhe të besueshëm,** ku kompetenca e Gjykatës Supreme për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve normative nënligjore mund të operojë si një mekanizëm real dhe efektiv për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe për garantimin e ligjshmërisë së akteve normative.

Në këtë kontekst, roli i Gjykatës Supreme lidhur me shpalljen e paligjshme të akteve normative nënligjore dhe vendimeve unifikuese është thelbësor për garantimin e besueshmërisë në sistemin gjyqësorë. Përveç kësaj përmes vendimeve të saj, Gjykata Supreme jo vetëm që vlerëson ligjshmërinë e akteve normative nën ligjore në raste konkrete, por gjithashtu përcakton standarde uniforme të interpretimit dhe zbatimit të normave ligjore për të gjitha instancat gjyqësore. Ky funksion ka dy dimensione të rëndësishme:

Sigurimi i një qasjeje të njëtrajtshme në të gjithë sistemin gjyqësor, duke eliminuar divergjencat në praktikë dhe duke garantuar që çdo individ të trajtohet në mënyrë të barabartë para ligjit;

Konsolidimi i jurisprudencës, i cili krijon një orientim të qëndrueshëm për gjykatat e instancave të ulëta dhe për administratën publike, duke rritur efektivitetin e mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave dhe ligjshmërisë së akteve normative.

Në këtë mënyrë, vendimet unifikuese të Gjykatës Supreme nuk janë thjesht akt interpretues, por instrument kyç për ruajtjen e sigurisë juridike, garancisë dhe besueshmërisë së sistemit gjyqësor, duke garantuar që zbatimi i ligjit të jetë i drejtë, i qëndrueshëm dhe i

harmonizuar me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të ligjshmërisë.

6.2. Roli i Gjykatës Supreme në ndërtimin e praktikës gjyqësore për kontrollin e akteve normative në Kosovë

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Konfliktet Administrative më 10 janar 2025, kompetencat e Gjykatës Supreme janë zgjeruar edhe në shqyrtimin e aktit normative, duke u mundësuar palëve që të kontestojnë ligjshmërinë e akteve nënligjore dhe normative. Si pasojë, procedimi dhe vendosja e padive që synojnë shfuqizimin ose ndryshimin e dispozitave të akteve normative ka filluar të zhvillohet në këtë gjykatë që nga muaji mars/prill 2025.

Deri më tani, duke qenë se procesi është në fazat e hershme, Gjykata Supreme nuk ka krijuar ende një praktikë të konsoliduar dhe të unifikuar lidhur me shqyrtimin e këtyre çështjeve. Kjo situatë lidhet me natyrën komplekse të rasteve që lidhen me aktet normative dhe nevojën për interpretim të kujdesshëm të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe për marrjen parasysh të standardeve të barazisë, proporcionalitetit dhe transparencës në veprimet administrative.

Në këtë kontekst, është e nevojshme që në analizimin e rasteve të para të vendosura nga Gjykata Supreme të bëhet një shqyrtim i kujdesshëm dhe kritik i arsyetimeve të dhëna, duke identifikuar elementet e jurisprudencës së formuar, interpretimin e dispozitave ligjore dhe ndikimin e vendimeve në praktikën administrative dhe në të drejtat e subjekteve të prekur. Analiza e këtyre rasteve jo vetëm që ndihmon në identifikimin e tendencave fillestare të gjykatës, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin gradual të një praktike të qëndrueshme dhe të parashikueshme në fushën e konfliktit administrativ mbi aktet normative.

Duke pasur parasysh këtë fazë të hershme të zhvillimit të jurisprudencës, fokusi do të jetë në komentimin e disa rasteve të përzgjedhura nga vendimet e Gjykatës Supreme deri më tani, duke theksuar rëndësinë e këtyre vendimeve për interpretimin e ligjit, standardet e mbrojtjes së të

drejtave themelore të palëve dhe për konsolidimin e praktikës së ardhshme gjyqësore.

6.2.1. Aktgjykimi P.A.nr.08/2025 i datës 14.07.2025

Koment mbi objektin e kërkesës/padisë

1. Përcaktimi i objektit të padisë

Objekti i padisë është shfuqizimi i një dispozite specifike të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2025, për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2025 – konkretisht neni 21 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1 dhe 2.2. Kjo dispozitë përcakton një përshkallëzim të subvencioneve për sipërfaqet mbi 100 hektarë, duke rezultuar në një përfitim më të ulët për këtë kategori të tokës bujqësore.

Padia është e fokusuar tek ky segment i aktit nënligjor, për shkak se ky rregull prek drejtpërdrejt paditësin "N.N" Sh.p.k, që zotëron dhe kultivon vreshta mbi 100 hektarë – duke e bërë subjekt unik të aplikimit të këtij përshkallëzimi. Pra, objekti i padisë nuk është i përgjithshëm, por i drejtuar ndaj një dispozite konkrete që ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe ekskluziv mbi paditësin.

2. Qëllimi ligjor dhe juridik i padisë

Paditësi kërkon shfuqizimin e dispozitës së kontestuar për shkak se konsideron se kjo dispozitë është diskriminuese dhe cenon parimet e barazisë dhe mos diskriminimit të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (nenet 24 dhe 46), si dhe nga instrumentet ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 14) dhe Protokollin Nr.12 të saj.

Kjo do të thotë se paditësi synon të mbrojë të drejtat e tij themelore dhe të sigurojë që aktet administrative të jenë të bazuara në kriteret objektive, transparente dhe të ligjshme, duke shmangur çdo përjashtim selektiv që favorizon ose penalizon një subjekt të caktuar.

3. Lloji i padisë

Padia është e karakterit tipik të konfliktit administrativ ndaj aktit nënligjor normativ. Ajo shërben si një mjet juridik për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve të administratës publike, duke përfshirë:

Shkeljen e parimeve të barazisë dhe mos diskriminimit;

Mungesën e argumentimit të arsyeshëm për përjashtime ose përshkallëzime të caktuara;

Kufizimin e të drejtës së përfitimit nga politikat bujqësore për një subjekt të vetëm, në mënyrë të pajustifikuar.

Kjo lloj i padisë është një instrument i drejtpërdrejtë ligjor për mbrojtjen e të drejtave të subjekteve afariste kundër veprimeve të njëanshme, selektive ose jo proporcionale të administratës.

5. Objekti i padisë

Objekti i padisë është qartë i individualizuar: paditësi nuk synon të sfidojë të gjithë Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2025, por vetëm dispozitat e veçanta që e prekin atë direkt. Kjo tregon një fokus të qartë juridik dhe proporcionalitet në kërkesë, duke respektuar parimin që padia kundër aktit nënligjor duhet të jetë specifike dhe e argumentuar me bazë faktike dhe ligjore.

Objekti i padisë është një dispozitë konkrete që ka efekt të drejtpërdrejtë mbi paditësin dhe që ka potencialin të shkelë të drejtat themelore të tij. Kërkesa është e bazuar në parime kushtetuese dhe ligjore, duke synuar shfuqizimin e një norme diskriminuese dhe jo proporcionale. Në këtë kontekst, padia është e qartë, fokusuar dhe e drejtë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative dhe të drejtën kushtetuese të barazisë dhe mbrojtjes ligjore.

2. Vendimmarrja e Gjykatës Supreme dhe konsolidimi i kontrollit gjyqësor mbi aktet nënligjore

Vendimmarrja e Gjykatës Supreme është e një rëndësie të veçantë, pasi me të pranohet kërkesëpadia e paditësit dhe shpallen të paligjshëm nën paragrafët 2.1 dhe 2.2 të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2025 për Pagesat Direkte në Bujqësi. Me këtë aktgjykim, gjykata ka ndërhyrë drejtpërdrejt në eliminimin e një norme administrative që është konstatuar si diskriminuese dhe e pambështetur në argumente të qëndrueshme juridike apo analiza objektive.

Ky vendim shënon një pikë kthese të rëndësishme për jurisprudencën vendore, sepse jo vetëm që vendos për një rast konkret, por edhe përcakton standarde të reja mbi kufijtë e ligjshmërisë së akteve normative. Gjykata ka afirmuar qartë se administrata publike nuk mund të miratojë dispozita që krijojnë trajtim të pabarabartë mes subjekteve të së drejtës, pa pasur një arsyetim të fortë dhe proporcional. Në këtë mënyrë, është forcuar parimi i barazisë, si një ndër shtyllat themelore të shtetit të së drejtës.

Një element tjetër me rëndësi është fakti se aktgjykimi është i formës së prerë, menjëherë pas komunikimit dhe parashikon publikimin në Gazetën Zyrtare. Kjo i jep vendimit jo vetëm efekt të menjëhershëm ekzekutiv, por edhe transparencë publike, duke siguruar që norma e paligjshme të largohet pa vonesa nga rendi juridik dhe të mos prodhojë më pasoja diskriminuese në praktikë.

Në planin më të gjerë, ky vendim konfirmon rolin e gjykatave si garant të mbrojtjes së të drejtave themelore të individëve dhe subjekteve afariste kundër akteve të paligjshme të administratës. Ai demonstron se kontrolli gjyqësor ndaj akteve normative nuk është thjesht formal, por substancial, duke e bërë gjykatën një akter aktiv në mbrojtjen e parimeve të barazisë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

3. Arsyet e vendimmarrjes

Bazuar në provat dhe faktet e paraqitura në shqyrtim, Gjykata Supreme ka konstatuar se paditësja – kompania “N.N” Sh.p.k – është

subjekti i vetëm në Kosovë që zotëron dhe kultivon vreshta mbi 100 hektarë. Kjo rrethanë faktike tregon qartë se dispozita e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2025, e cila parashikon përshkallëzimin e subvencioneve për sipërfaqe mbi këtë kufi, prek në mënyrë ekskluzive vetëm paditësen. Si rrjedhojë, masa e kontestuar nuk ka karakter të përgjithshëm e të paanshëm, por është selektive në zbatim, duke krijuar një efekt të drejtpërdrejtë diskriminues. Për më tepër, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka ofruar asnjë analizë të qartë apo argument objektiv që të justifikojë një trajtim të tillë diferencues.

Nga aspekti juridik dhe kushtetues, Gjykata ka vlerësuar se dispozita e kontestuar është në kundërshtim me parimet themelore të rendit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim:

a. Kushtetuta e Kosovës garanton barazinë para ligjit (neni 24), të drejtën për mbrojtje të të drejtave të njeriut (neni 21) dhe ndalon kufizimet arbitrare të lirive e të drejtave themelore (neni 55). Përshkallëzimi i subvencioneve, pa bazë të qartë dhe objektive, bie ndesh me këto dispozita, sepse vendos një kufizim selektiv që prek vetëm një subjekt.

b. Ligji për Konfliktet Administrative i jep kompetencë Gjykatës për të shqyrtuar ligjshmërinë e akteve nënligjore dhe për të shfuqizuar ato dispozita që bien në kundërshtim me ligjin ose me Kushtetutën. Kjo kompetencë u ushtrua në mënyrë të plotë në rastin konkret.

c. Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural kërkon që masat mbështetëse të jenë jodiskriminuese, transparente dhe të bazuara në kritere të qarta që nxisin zhvillimin e sektorit bujqësor. Dispozita e kontestuar, duke prekur vetëm një subjekt, dështoi të përmbushë këto kërkesa.

d. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon se çdo trajtim diferencues pa bazë objektive dhe të arsyeshme është i ndaluar. Gjykata konstatoi se masa e aplikueshme ndaj paditëses nuk kishte asnjë justifikim objektiv dhe proporcional, duke e bërë atë të paligjshme.

Nga analiza dhe konstatimi i Gjykatës, rezulton se përshkallëzimi i subvencioneve është selektiv dhe diskriminues. Duke qenë se prek vetëm paditësen dhe nuk mbështetet në asnjë studim, raport apo analizë objektive, ky diferencim nuk ka karakter të përgjithshëm dhe të arsyetuar, por është një masë e njëanshme që bie ndesh me parimet e barazisë dhe proporcionalitetit. Gjykata theksoi se çdo ndryshim i trajtimit të subjekteve të së drejtës duhet të mbështetet në kritere objektive, transparente dhe të verifikueshme, në mënyrë që të mos cenohet parimi i trajtimit të barabartë dhe siguria juridike.

Përfundimisht, arsyetimi i Gjykatës është i detajuar dhe i mbështetur si në provat faktike, ashtu edhe në bazën kushtetuese e ligjore. Ai lidh situatën konkrete të paditëses me parimet e përgjithshme të shtetit të së drejtës, duke e bërë vendimin një precedent të rëndësishëm në drejtim të konsolidimit të jurisprudencës mbi kontrollin gjyqësor të akteve normative.

4. Pasojat dhe efektet e aktit normativ të shpallur të paligjshëm

1. Për paditësen

Vendimi i Gjykatës ka efekte të drejtpërdrejta dhe të favorshme për paditësen. Ajo fiton të drejtën e plotë për të përfituar nga skemat e pagesave direkte për vitin 2025, pa iu nënshtruar kufizimeve të përshkallëzimit të parashikuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2025. Ky rezultat garanton që paditësja trajtohet në mënyrë të barabartë me të gjithë aplikuesit e tjerë, duke eliminuar çdo element diskriminues që ishte projektuar për të pasur efekt vetëm mbi të. Në këtë mënyrë, paditësja jo vetëm që fiton të drejtën materiale për subvencionim, por njëkohësisht mbrohet edhe nga cenimi i parimeve kushtetuese të barazisë dhe proporcionalitetit.

2. Për të padituren – Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Ky vendim vendos mbi të padituren një obligim të qartë ligjor për respektimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në shpërndarjen e

subvencioneve. MBPZHR detyrohet të zbatojë vendimin gjyqësor dhe të përjashtojë çdo element diskriminues në politikat e pagesave direkte. Gjithashtu, ky vendim ngre nevojën e domosdoshme që ministria të rishikojë jo vetëm këtë Udhëzim Administrativ, por edhe të gjitha aktet e ardhshme normative që rregullojnë skemat mbështetëse. Rishikimi duhet të bëhet në mënyrë që politikat bujqësore të jenë të ndërtuara mbi kritere të qarta, transparente, objektive dhe të aplikueshme në mënyrë të përgjithshme, pa favorizime apo penalizime selektive. Kjo kërkesë për rishikim nuk ka vetëm karakter formal, por shkon në funksion të forcimit të besueshmërisë së institucioneve publike dhe të politikave shtetërore në sektorin e bujqësisë.

3. Për sistemin juridik dhe praktikën administrative

Vendimi i Gjykatës përbën një hap të rëndësishëm për konsolidimin e parimit të barazisë dhe drejtësisë në politikat publike dhe në shpërndarjen e fondeve bujqësore. Ai krijon një precedent të qartë gjyqësor në lidhje me shfuqizimin e dispozitave diskriminuese të akteve nënligjore, duke afirmuar rolin e gjykatave në kontrollin e ligjshmërisë së akteve normative. Njëkohësisht, vendimi kontribuon në rritjen e transparencës, sigurisë juridike dhe para shikueshmërisë për të gjithë aplikuesit e ardhshëm të skemave të pagesave direkte. Për rrjedhojë, vendimi nuk kufizohet vetëm në rregullimin e situatës së paditëses, por krijon një standard të ri që administrata duhet ta ndjekë në të gjitha rastet e ngjashme.

4. Për efektin normativ

Nga pikëpamja normative, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2025, duhet të zbatohet pa ato dispozita që janë konstatuar si diskriminuese dhe selektive. Kjo do të thotë se akti nënligjor mbetet në fuqi vetëm në masën që është në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën, ndërsa dispozitat e shfuqizuara nuk mund të kenë më efekt juridik. Vendimi i Gjykatës, sipas parimeve të së drejtës kontestimore dhe të ligjit mbi konfliktet administrative, është i detyrueshëm për palët dhe i ekzekutueshëm nga

momenti i hyrjes në fuqi. Për më tepër, publikimi i vendimit siguron transparencë dhe një efekt orientues për politikë bërësit dhe administratën, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën e hartimit dhe zbatimit të politikave të ardhshme të subvencionimit bujqësor.

6.2.2. Aktgjykimi Pa.nr.02/2025 i datës 06.04.2025

1. Objekti i kërkesëpadisë

Objekti i kësaj kërkesëpadie ishte **shpallja e paligjshmërisë dhe shfuqizimi i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës,** të miratuar më 21.12.2023 dhe të publikuar më 26.12.2023.

Paditësja argumentoi se kjo rregullore:

është nxjerrë në kundërshtim me **parimin e ligjshmërisë**,

bie ndesh me dispozitat e ligjeve primare (Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor, Ligji për Kundërvajtje, Ligji për Shoqëritë Tregtare, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj.),

cenon të drejtat dhe liritë e qytetarëve të garantuara me **Kushtetutën e Republikës së Kosovës** dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Koment mbi Objektin e kërkesëpadisë

Objekti i kërkesëpadisë është themelor për përcaktimin e kufijve të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë rast, paditësja ka kërkuar shfuqizimin e një akti normativ të përgjithshëm (rregullore komunale). Kjo tregon karakterin e **kontrollit të ligjshmërisë së akteve nënligjore,** ku gjykata ka kompetencë të verifikojë përputhshmërinë e tyre me normat më të larta (kushtetuese dhe ligjore). Komenti i rëndësishëm është se padia nuk synonte një interes individual të kufizuar, por kishte një **karakter publik**, duke mbrojtur interesin e përgjithshëm të qytetarëve ndaj një akti me efekte të gjera. Ky element e vendos çështjen në kuadër të jurisprudencës së kontrollit të akteve të pushtetit vendor.

2. Vendimmarrja e Gjykatës Supreme

Pas shqyrtimit të argumenteve të palëve dhe analizimit të ligjshmërisë së aktit, Gjykata Supreme vendosi:

Aprovoi pjesërisht padinë duke shpallur të paligjshme dhe shfuqizuar:

nenin 1 (vetëm sa i përket mënyrës së pagesës),

nenet 14 dhe 15,

nenin 8 (pjesën për kufizimin e parkimit të vizitorëve në zonat rezidenciale ndërmjet orës 16:00–18:00),

nenin 12, paragrafët 1 dhe 9,

nenin 22, paragrafët 1, 8 dhe 9.

Refuzoi pjesën tjetër të padisë, duke lënë në fuqi dispozitat e tjera të rregullores.

Përcaktoi që **secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale**.

Ky aktgjykim është **i formës së prerë** me shpalljen e tij dhe **obligon publikimin në Gazetën Zyrtare.**

Koment mbi Vendimmarrjen e Gjykatës Supreme

Gjykata nuk e shfuqizoi tërësisht rregulloren, por vetëm ato dispozita që u vlerësuan si të paligjshme dhe disproporcionale. Ky lloj vendimi është tipik për kontrollin e akteve normative, pasi gjykata respekton autonominë vendimmarrëse të komunës, por ndërhyn aty ku kjo autonomi bie ndesh me ligjin dhe të drejtat themelore. Kjo tregon se gjykata ushtron një **kontroll të kufizuar, por efektiv**, duke ndaluar shfuqizimin e panevojshëm të dispozitave që mund të funksionojnë në përputhje me ligjin. Vendimi gjithashtu nënvizon rëndësinë e **efektit të menjëhershëm** dhe të **publikimit në Gazetën Zyrtare,** duke e forcuar parimin e transparencës.

3. Arsyet e vendimmarrjes

Gjykata e arsyetoi vendimmarrjen mbi këto baza kryesore:

a) Parimi i ligjshmërisë

Sipas nenit 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, çdo akt administrativ duhet të jetë i ligjshëm, proporcional dhe të garantojë trajtim të barabartë. Dispozitat e kontestuara nuk i plotësonin këto kritere.

b) Kundërshtimi me Kushtetutën

Neni 24 (barazia para ligjit): pagesa vetëm me telefon krijon diskriminim ndaj personave të moshuar, të huajve dhe qytetarëve pa qasje në teknologji.

Neni 41 (qasja në shërbime publike): kufizimi teknologjik pengon qasjen universale në shërbimet publike.

Neni 36 (privatësia dhe jeta familjare): kufizimi i vizitave në zonat rezidenciale për vetëm 2 orë cenon jetën private dhe familjare.

Neni 55 (kufizimet e të drejtave): kufizimet nuk ishin të domosdoshme dhe nuk përmbushnin testin e proporcionalitetit.

Koment mbi Arsyet e vendimmarrjes

Arsyetimi i gjykatës është i ndërtuar mbi tri shtylla: (i) **parimi i ligjshmërisë,** (ii) **proporcionaliteti dhe respektimi i të drejtave kushtetuese,** dhe (iii) **përputhshmëria me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.** Kjo tregon një qasje moderne të gjykatës, që nuk kufizohet vetëm në krahasimin formal të rregullores me ligjin, por bën edhe një **test substancial të proporcionalitetit** dhe referim të drejtpërdrejtë në KEDNJ dhe konventa ndërkombëtare. Kjo e fuqizon jurisprudencën vendore dhe e integron atë në kontekstin evropian. Komenti kryesor është se arsyetimi krijon **precedent gjyqësor** që i obligon organet komunale të marrin parasysh jo vetëm ligjet e brendshme, por edhe standardet ndërkombëtare kur nxjerrin akte nënligjore.

c) Mungesa e proporcionalitetit

Gjykata konstatoi se masa të tilla si:

pagesa ekskluzive me telefon,

vizitat vetëm 2 orëshe në zonat rezidenciale,

përjashtimi i përgjegjësisë për dëmet ndaj automjeteve, ishin kufizime jo proporcionale dhe të panevojshme, kur ekzistonin alternativa më të përshtatshme dhe më pak kufizuese (p.sh. pagesa cash, makina automatike, leje më fleksibile për vizitorët).

Koment i mungesës së proporcionalitetit

Gjykata ka vlerësuar se disa dispozita të rregullores komunale ishin në kundërshtim me parimin e **proporcionalitetit**, pasi vendosnin kufizime më të rënda sesa kërkonte mbrojtja e interesit publik. Kufizime si pagesa vetëm me telefon, leja e vizitave në zonat rezidenciale për vetëm 2 orë dhe përjashtimi i përgjegjësisë për dëmet ndaj automjeteve u konsideruan si masa të **jo proporcionale dhe të panevojshme**, duke qenë se ekzistonin alternativa më të buta dhe gjithëpërfshirëse (pagesa cash, makina automatike, leje fleksibile për vizitorë).

Kështu, gjykata përforcoi standardin se çdo kufizim i vendosur nga pushteti vendor duhet të jetë **i domosdoshëm, proporcional dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare**,

4. Pasojat dhe efektet juridike të aktgjykimit

Efekti i menjëhershëm: Vendimi është i formës së prerë dhe nuk lejohet ankimimi, duke prodhuar efekte direkte.

Shfuqizimi i dispozitave të paligjshme: Nenet e konstatuara të paligjshme humbin fuqinë dhe nuk mund të prodhojnë më pasoja juridike.

Vazhdimi i pjesës tjetër të rregullores: Dispozitat që nuk janë kontestuar mbeten në fuqi.

Detyrimi i Komunës: Komuna e Prishtinës obligohet ta rishqyrtojë dhe ta plotësojë rregulloren, duke ofruar forma alternative të pagesës, duke eliminuar kufizimet disproporcionale dhe duke siguruar qasje të barabartë për qytetarët.

Pasojë praktike më e gjerë: Aktgjykimi krijon një standard të qartë jurisprudence për kontrollin e ligjshmërisë së akteve nënligjore komunale, duke forcuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave themelore të qytetarëve.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi nuk ka vetëm ndikim individual mbi rregulloren e kontestuar, por edhe një **efekt precedencial** për administratën publike dhe gjykatat në të ardhmen, duke përcaktuar se çdo ndërhyrje në të drejtat e qytetarëve duhet të kalojë testin e proporcionalitetit dhe të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare.

6.2.3. Aktgjykimi Pa.nr.06/2025 i datës 10.06.2025

1. Objekti i kërkesëpadisë

Paditësja, **N.N,** ka ushtruar kërkesëpadi pranë Gjykatës Supreme duke kontestuar ligjshmërinë e një akti normativ nënligjor dhe pasojat që kanë rrjedhur nga zbatimi i tij në praktikë.

1. Çfarë ka kërkuar paditësja?

Paditësja ka kërkuar:

a. Shfuqizimin e nenit 3 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së KPM-së (KPM-2025/01), me arsyetimin se kjo dispozitë i jep të drejtë Komisionit të zgjedhë kryetarin edhe **para përfundimit të mandatit të rregullt të kryetarit ekzistues.**

b. Anulimin e vendimit të datës 17 janar 2025 të KPM-së, për zgjedhjen e kryetarit të ri, pasi ky akt individual është mbështetur drejtpërdrejt në dispozitën e kontestuar të rregullores dhe për këtë arsye, është i paligjshëm.

2. Pse e ka kërkuar?

Paditësja e ka ndërtuar kërkesëpadinë mbi disa argumente juridike:

a. Shkelja e parimit të ligjshmërisë (neni 4 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative – LPPA): Organi publik mund të veprojë vetëm brenda kufijve të kompetencës së dhënë me ligj. Ligji për KPM (neni 15(11) përcakton qartë se zgjedhja e kryetarit bëhet vetëm në mbledhjen e parë pas përfundimit të mandatit të tij. Çdo devijim nga kjo dispozitë ligjore është **tejkalim i kompetencës.**

b. Shkelja e hierarkisë së akteve normative: Ligji ka forcë më të lartë juridike sesa rregulloret e brendshme. Rregullorja nuk mund të krijojë

dispozita të reja që bien në kundërshtim me normën ligjore. Në këtë rast, neni 3(2) i Rregullores ka "shtuar" një mundësi që ligji nuk e parashihte.

c. Cenimi i sigurisë juridike dhe stabilitetit institucional: Dispozita e kontestuar krijonte pasiguri të vazhdueshme në funksionimin e KPM-së, sepse lejonte ndërprerjen e parakohshme të mandatit të kryetarit dhe zgjedhjen e një tjetri në çdo moment, duke lënë organin të ekspozuar ndaj ndërhyrjeve politike ose vendimmarrjeve arbitrare.

d. Shkelja e procedurës së miratimit të akteve: Rregullorja e punës është miratuar dhe zbatuar në të njëjtën ditë, pa procedurë transparente dhe pa konsultim publik, në kundërshtim me parimin e transparencës dhe llogaridhënies.

3. Implikimet juridike të kërkesëpadisë

Kërkesëpadia, ka implikime të rëndësishme si në aspektin normativ, ashtu edhe në atë institucional:

a. Në aspektin normativ: Shfuqizimi i nenit 3(2) të Rregullores do të siguronte që aktet nënligjore të harmonizohen me ligjin dhe të ndalet praktika e miratimit të dispozitave që bien ndesh me ligjin. Ky rast krijon një **precedent gjyqësor** për kufizimin e organeve publike që tentojnë të zgjerojnë kompetencat e tyre përmes rregulloreve.

b. Në aspektin individual: Anulimi i vendimit të 17 janarit 2025 për zgjedhjen e kryetarit do të neutralizonte pasojat e një akti të nxjerrë mbi bazën e një norme të paligjshme, duke garantuar se veprimet e organeve publike nuk mund të mbeten të vlefshme kur mbështeten në baza të paligjshme.

c. Në aspektin institucional: Ky proces gjyqësor ka për qëllim të mbrojë **pavarësinë dhe funksionimin e rregullt të KPM-së** si organ i pavarur kushtetues. Një organ që zbaton rregullore të paligjshme rrezikon jo vetëm legjitimitetin e tij, por edhe besimin e publikut në të.

d. Në aspektin e së drejtës administrative: Rasti është një shembull tipik i **shqyrtimit incidental të ligjshmërisë së akteve nënligjore,** ku gjykata, duke shqyrtuar ligjshmërinë e një akti individual, është e thirrur të verifikojë paraprakisht edhe ligjshmërinë e normës mbi të cilën ky akt është mbështetur.

2. Vendimmarrja e Gjykatës Supreme

Pas shqyrtimit të kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësja dhe pas analizës së dispozitave ligjore përkatëse, Gjykata Supreme ka marrë vendim me këtë përmbajtje:

1. Aprovohet kërkesëpadia dhe shpallet i paligjshëm neni 3 (2) i Rregullores së KPM-së

Ky element i vendimit ka efekt **normativ** dhe është themeli i aktgjykimit. Shfuqizimi i nenit 3(2) nënkupton se kjo dispozitë e rregullores, e cila parashihte mundësinë e zgjedhjes së kryetarit para përfundimit të mandatit, nuk ka më fuqi juridike. Gjykata ka konstatuar se kjo dispozitë ishte në **kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin** (neni 15 (11) i Ligjit për KPM) dhe, për rrjedhojë, nuk mund të zbatohej.

a. Ky vendim ka rëndësi të madhe, sepse **konfirmon parimin e ligjshmërisë** dhe parandalon praktika të ngjashme ku organet e pavarura do të krijonin norma të reja që tejkalojnë ligjin.

b. Për më tepër, ky konstatim krijon **jurisprudencë gjyqësore** në fushën e kontrollit të akteve nënligjore të brendshme.

2. Dosja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për vlerësimin e vendimit për zgjedhjen e kryetarit

Ky element i vendimit ka karakter **procedural dhe individual.** Gjykata Supreme, pasi shfuqizoi normën mbi të cilën ishte bazuar zgjedhja e kryetarit të ri, e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë.

a. Kjo tregon se Gjykata Supreme, nuk e ka gjykuar vetë ligjshmërinë e aktit individual (vendimit për zgjedhjen e kryetarit), por ka kërkuar që gjykata më e ulët ta bëjë këtë vlerësim në harmoni me vendimin e saj.

b. Në këtë mënyrë, garantohet **procesi i rregullt gjyqësor**, duke respektuar kompetencat e secilës instancë.

c. Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, është e detyruar të marrë parasysh konstatimet e Gjykatës Supreme mbi paligjshmërinë e nenit 3 (2).

4. Aktgjykimi është i formës së prerë dhe duhet të publikohet nga KPM

Ky element ka **karakter detyrues** dhe përfshin dy dimensione:

a. Formën e prerë: Vendimi i Gjykatës Supreme nuk mund të ankimohet më tutje. Kjo siguron **finalitet juridik** dhe mbyllje përfundimtare të kontestit.

b. Detyrimi për publikim: KPM është e obliguar të publikojë aktgjykimin, duke përmbushur kështu parimin e **transparencës dhe llogaridhënies publike**. Ky detyrim e bën vendimin jo vetëm një çështje gjyqësore, por edhe një **akt publik i detyrueshëm për t'u respektuar dhe zbatuar nga organi i pavarur.**

3. Implikimet e vendimit të Gjykatës Supreme

I. Implikimet normative

1. Forcimi i hierarkisë së akteve juridike

Vendimi i Gjykatës Supreme për shpalljen e paligjshme të nenit 3(2) të Rregullores së Punës së KPM-së, konfirmon parimin e **hierarkisë së burimeve juridike**. Një akt nënligjor nuk mund të ndryshojë, shfuqizojë apo shtrembërojë dispozitat e një ligji të miratuar nga Kuvendi.

a. Arsyetim: Ky parim buron nga nocioni i shtetit të së drejtës (rule of laë), ku ligji qëndron mbi çdo akt tjetër dhe siguron koherencën e rendit juridik.

b. Efekti praktik: Vendimi krijon precedent për institucionet e tjera publike, duke i detyruar ato të respektojnë kufijtë e kompetencave të tyre dhe të sigurojnë përputhshmëri të akteve nënligjore me ligjin.

II. Implikimet procedurale

1. Respektimi i parimit të dy shkallëve të gjykimit

Kthimi i dosjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim tregon respektimin e **parimit të dy instancave,** i rregulluar në procedurën gjyqësore.

a. Arsyetim: Gjykata Supreme ushtron kontroll mbi ligjshmërinë, por nuk e zëvendëson rolin e instancave më të ulëta në vlerësimin faktik. Ky është një element i rëndësishëm i së drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

b. Efekti praktik: Gjykata e shkallës së parë do të duhet të rivlerësojë ligjshmërinë e vendimit individual për zgjedhjen e kryetarit, por tashmë mbi një bazë ligjore të qartë, pas eliminimit të dispozitës së paligjshme.

III. Implikimet institucionale

1. Transparenca dhe përgjegjësia e institucioneve publike

Detyrimi për publikimin e aktgjykimit nga KPM pasqyron parimin e **publicitetit dhe transparencës** në ushtrimin e pushtetit publik.

a. Arsyetim: Publikimi i vendimeve që kanë rëndësi për administratën publike siguron llogaridhënie dhe rrit besimin e qytetarëve në drejtësi dhe në institucionet publike. Ai është gjithashtu një garanci kundër arbitraritetit institucional.

b. Efekti praktik: Vendimi i Gjykatës Supreme bëhet i qasshëm për publikun dhe krijon një praktikë që detyron KPM dhe institucionet e tjera të marrin parasysh kontrollin gjyqësor dhe transparencën si pjesë të kulturës së tyre institucionale.

Vendimi i Gjykatës Supreme ka efekte që shtrihen përtej rastit konkret:

a. Në plan **normativ**, ai siguron mbrojtjen e hierarkisë së akteve juridike.

b. Në plan **procedural**, ruan balancën mes instancave dhe të drejtën për proces të rregullt.

c. Në plan **financiar**, shmang barrat e padrejta dhe mbron qasjen në drejtësi.

d. Në plan **institucional**, forcon transparencën dhe përgjegjësinë e organeve publike.

Ky vendim nuk ka vetëm funksion shfuqizues ndaj një dispozite të paligjshme, por edhe **funksion orientues dhe precedent-praktik** për të gjitha institucionet dhe organet publike që miratojnë akte nënligjore në Kosovë.

IV. Arsyet e vendimmarrjes së Gjykatës Supreme

1. Karakteri normativ i aktit

Gjykata Supreme ka vlerësuar se Rregullorja e Punës së KPM-së nuk është thjesht një akt i brendshëm administrativ, por ka karakter normativ.

a. Arsyetim juridik: Një akt i brendshëm ka efekt vetëm për marrëdhëniet e brendshme të një institucioni, ndërsa një akt normativ prodhon efekte juridike të përgjithshme dhe të detyrueshme. Në rastin konkret, rregullorja përcaktonte procedurën për zgjedhjen e kryetarit, një proces që lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e institucionit dhe me ushtrimin e kompetencave publike të tij.

b. Parimet e prekura: Parimi i ligjshmërisë kërkon që çdo akt normativ të jetë në harmoni me ligjin. Nëse një organ rregullator nxjerr një akt që bie në kundërshtim me ligjin, ai akt nuk mund të konsiderohet si rregullim i brendshëm, por si një shkelje e hierarkisë normative.

c. Implikimi: Kjo qasje e Gjykatës Supreme ka rëndësi të gjerë, sepse vendos një standard për të gjitha rregulloret e organeve publike: nëse ato rregullojnë procedura të funksionimit institucional me efekte të përgjithshme, ato i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë si çdo akt tjetër normativ.

2. Kundërligjshmëria e nenit 3 (2) të Rregullores

Gjykata ka konstatuar se neni 15 (11) i Ligjit për KPM, është i qartë dhe i pakundërshtueshëm: zgjedhja e kryetarit bëhet vetëm në mbledhjen e parë pas përfundimit të mandatit të tij. Rregullorja e kontestuar parashihte mundësinë e zgjedhjes edhe para skadimit të mandatit, duke krijuar një përjashtim që ligji nuk e parashikon.

a. Arsyetim juridik: Sipas parimit të **respektimit të burimit të ligjit**, një akt nënligjor nuk mund të krijojë rregulla të reja në kundërshtim me ligjin. Ky është një rregull themelor i së drejtës publike dhe administratives, i cili siguron stabilitetin dhe parashikueshmërinë e normave.

b. Pasojë: Shfuqizimi i kësaj dispozite ndalon praktika të ardhshme që cenojnë mandatin e organeve publike, duke siguruar kontinuitet dhe stabilitet institucional. Gjykata Supreme, në këtë mënyrë, ka mbrojtur integritetin e ligjit dhe ka parandaluar krijimin e një precedenti arbitrar.

3. Shkelja e procedurës së miratimit të rregullores

Gjykata ka vërejtur se rregullorja është miratuar dhe zbatuar në të njëjtën ditë, pa konsultim publik dhe pa transparencë të nevojshme.

a. Arsyetim juridik: Edhe pse jo të gjitha aktet nënligjore i nënshtrohen procedurave të gjera të konsultimit publik, aktet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e institucioneve kushtetuese dhe rregullatore duhet të kalojnë në një proces të hapur. Parimi i **transparencës** dhe **pjesëmarrjes së publikut** në procesin normativ është i lidhur ngushtë me konceptin e qeverisjes së mirë dhe me mbrojtjen e interesit publik.

b. Pasojë: Mosrespektimi i procedurave të konsultimit krijon jo vetëm pasiguri juridike, por edhe cenon besimin e publikut në institucion. Gjykata Supreme ka theksuar se ligjshmëria nuk është vetëm çështje përmbajtjeje (pajtueshmëria me ligjin), por edhe çështje procedure (respektimi i mënyrës së miratimit të akteve).

4. Paaftësia funksionale e KPM-së

Gjykata ka vlerësuar gjithashtu pasojat praktike të dispozitës së kontestuar. Edhe pas zgjedhjes së kryetarit mbi bazën e nenit 3(2), KPM mbeti jofunksionale për shkak të mungesës së kuorumit (vetëm tre anëtarë aktivë).

a. Arsyetim juridik: Kjo tregon se dispozita nuk ishte vetëm e kundërligjshme, por edhe **joefikase** në aspektin e funksionimit institucional. Sipas parimit të **proporcionalitetit** dhe **efikasitetit të administratës**, aktet juridike duhet të synojnë përmbushjen e qëllimit të tyre. Në këtë rast, qëllimi i supozuar i rregullores ishte të shmangte bllokimin institucional, por në praktikë ajo nuk arriti të sigurojë funksionalitetin.

b. Implikimi: Ky konstatim i Gjykatës Supreme tregon rëndësinë e kontrollit jo vetëm formal të ligjshmërisë, por edhe të analizës së ndikimit praktik të akteve juridike.

Arsyet e vendimmarrjes së Gjykatës Supreme janë të ndërtuara mbi katër shtylla kryesore:

a. Karakteri normativ i rregullores, i cili e bën atë subjekt të kontrollit gjyqësor.

b. Kundërligjshmëria e dispozitës, për shkak të konfliktit të qartë me ligjin.

c. Shkelja e procedurës së miratimit, që cenon transparencën dhe ligjshmërinë.

d. Paaftësia funksionale e dispozitës, që dëshmon se ajo nuk arriti të sigurojë funksionimin efektiv të institucionit.

Këto arsye tregojnë një qasje të gjerë të Gjykatës Supreme, e cila nuk është kufizuar vetëm në interpretimin formal të ligjit, por ka marrë parasysh edhe aspektet praktike dhe institucionale të kontestit. Vendimi, kësisoj, paraqet një precedent të rëndësishëm për kontrollin gjyqësor mbi aktet nënligjore dhe për forcimin e parimeve të shtetit të së drejtës.

V. Pasojat juridike të aktgjykimit të Gjykatës Supreme

Vendimi i Gjykatës Supreme nuk ka vetëm një dimension konstatues, por edhe një ndikim të drejtpërdrejtë në kuadrin normativ, institucional dhe procedural të (KPM). Pasojat mund të ndahen në katër kategori kryesore: normative, individuale, institucionale dhe procedurale.

1. Pasojat normative

a. Shfuqizimi i nenit 3(2) të Rregullores së Punës së KPM-së: Me vendimin e Gjykatës Supreme, kjo dispozitë konsiderohet e paligjshme dhe nuk ka më efekt juridik.

b. Arsyetim akademik: Shfuqizimi formal i dispozitës konfirmon **principin e supremacisë ligjit mbi aktet nënligjore**. Kjo do të thotë se asnjë organ i KPM-së nuk mund të mbështetet më në këtë dispozitë për

të organizuar zgjedhjet e kryetarit para përfundimit të mandatit. Ky vendim forcon hierarkinë normative, ku ligji ka përparësi ndaj çdo rregulloreje apo akti tjetër të brendshëm, duke garantuar një sistem juridik të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm.

c. Implikim praktik: Çdo akt i ardhshëm i KPM-së duhet të jetë në përputhje me Ligjin për KPM, dhe çdo rregullore tjetër që mund të cenojë këtë parim mund të kontestohet në gjykatë.

2. Pasojat individuale

a. Vlerësimi i vendimit për zgjedhjen e kryetarit më 17 janar 2025: Vendimi i bazuar mbi nenin 3(2) është i pavlefshëm juridikisht. Dosja do t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për shqyrtim të mëtejshëm.

b. Arsyetim akademik: Ky aspekt tregon se **kontrolli gjyqësor mbi aktet e organeve administrative** nuk është thjesht formal, por synon të korrigjojë veprime të kundërligjshme. Ai siguron respektimin e të drejtave të palëve dhe ruajtjen e legjitimitetit të funksionimit të institucioneve publike.

c. Implikim praktik: Çdo vendim i KPM-së që mund të ketë ndikim në funksionimin e institucionit ose të drejtën e palëve duhet të bëhet brenda kuadrit ligjor, për të shmangur vështirësi të mëtejshme juridike.

3. Pasojat institucionale

a. Detyrimi për publikim: KPM është e detyruar ta publikojë aktgjykimin, duke siguruar transparencën dhe duke pranuar kontrollin gjyqësor mbi veprimet e saj.

b. Parimi i përgjegjësisë: Ky detyrim pasqyron **principin e përgjegjësisë dhe transparencës në administratë**. Publikimi i vendimit nuk është vetëm formalitet; ai siguron që të gjithë aktorët institucionalë dhe qytetarët të jenë të informuar për statusin ligjor të dispozitës. Kjo praktikë rrit besueshmërinë e institucionit dhe parandalon keqinterpretimin ose zbatimin e paligjshëm të rregullores.

c. Implikim praktik: Publikimi kontribuon në forcimin e **shtetit të së drejtës,** duke lehtësuar kontrollin institucional dhe mbikëqyrjen publike

mbi vendimmarrjen e organeve administrative dhe krijon precedent për rastet e ardhshme, duke inkurajuar palët që të angazhohen në procese gjyqësore vetëm kur ato kanë bazë të fortë juridike, dhe duke shmangur ngarkesa të panevojshme financiare për sistemin gjyqësor.

Efektet juridike të këtij aktgjykimi janë të shumfishta dhe të ndërthurura.

a. Normative – Forcon hierarkinë ligjore dhe kontrollin mbi aktet nënligjore.

b. Individuale – Siguron korrigjimin e vendimeve të kundërligjshme dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve.

c. Institucionale – Rrit transparencën dhe përgjegjësinë e KPM-së, duke konsoliduar besimin publik në institucion.

d. Procedurale – Ruhet proporcionaliteti dhe barazia midis palëve, duke shmangur ngarkesa të panevojshme financiare.

Ky vendim shërben si një **referencë akademike dhe praktike** për rolin e Gjykatës Supreme në mbikëqyrjen e legjitimitetit të akteve administrative dhe për forcimin e shtetit të së drejtës në nivel institucional.

6.2.4. Aktgjykimi Pa.nr.01/2025 i datës 20.03.2025

1. Objekti i padisë

Objekti i kësaj padie është shfuqizimi i pjesshëm i një akti nënligjor normativ, përkatësisht i nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), i cili rregullon kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korrigjimit të emrit personal. Paditësi, përmes paraqitjes së kësaj padie, ka synuar që gjykata të verifikojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e këtij neni të aktit nënligjor dhe, nëse gjykata konstaton papajtueshmëri me normat më të larta juridike, të urdhërojë shfuqizimin e tij.

Pra, thelbi i objektit të padisë është kontestimi i hierarkisë normative: nëse një dispozitë e një akti nënligjor (udhëzim administrativ) ka

tejkaluar ose ka rënë në kundërshtim me ligjin përkatës dhe me normat kushtetuese dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

2. Baza juridike e kërkesë padisë

Paditësi, duke e artikuluar kërkesën e tij, e ka bazuar padinë në tri shtylla themelore të rendit juridik të Republikës së Kosovës:

Ligji Nr. 02/L-118 për Emrin Personal, ku neni 18 rregullon të drejtën e individit për ndryshimin e emrit personal dhe parashikon qartësisht kriteret dhe procedurat ligjore për këtë të drejtë. Pretendimi i paditësit është se neni 6 i Udhëzimit Administrativ ka vendosur kufizime shtesë që nuk janë të parapara nga ligji, duke cenuar parimin e ligjshmërisë (nulla poena sine lege, respektivisht asnjë kufizim pa bazë ligjore).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, e cila inkorporon drejtpërdrejt instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). E drejta për emër personal lidhet ngushtë me të drejtën për identitet dhe integritet personal, të mbrojtur me nenin 8 të KEDNJ-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Parimi i hierarkisë së normave juridike, sipas të cilit aktet nënligjore (siç janë udhëzimet administrative) duhet të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe aktet kushtetuese. Nëse një akt nënligjor del përtej kornizës së ligjit ose vendos kufizime që ligji nuk i parasheh, atëherë ai akt bie ndesh me parimin e ligjshmërisë (neni 16 i Kushtetutës) dhe është i pavlefshëm.

3. Karakteri juridik i objektit të padisë

Objekti i padisë nuk lidhet me një konflikt individual privat midis dy palëve, por me kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së një akti normativ nënligjor. Ky është një shqyrtim incidental i ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, i cili zhvillohet në kuadër të gjykimit administrativ.

Në këtë kuptim, objekti i padisë është i natyrës publiko-juridike, sepse synon mbrojtjen e një të drejte themelore të individit (e drejta për emër)

kundrejt ndërhyrjes së shtetit përmes një akti normativ që tejkalon kufijtë ligjorë të përcaktuar nga legjislatori.

4. Dimensioni i të drejtave themelore

Objekti i padisë bart në vete një dimension kushtetues dhe ndërkombëtar: emri personal është pjesë e identitetit personal dhe kulturor të individit. Çdo kufizim i së drejtës për të ndërruar ose korrigjuar emrin, i cili nuk bazohet në ligj, por në një akt nënligjor me natyrë administrative, paraqet ndërhyrje disproporcionale në të drejtën e garantuar me KEDNJ.

Ky dimension i jep objektit të padisë një rëndësi të shtuar, përtej kufijve të një mosmarrëveshjeje administrative klasike, sepse prek thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të individit. Në përfundim, objekti i padisë në këtë rast është kërkesa e paditësit që Gjykata Supreme të shpallë të paligjshëm dhe të shfuqizojë nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 të MPB-së, me arsyetimin se ky nen:

- është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit për Emrin Personal,
- bie ndesh me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës, dhe
- cenon të drejtën për respektimin e jetës private dhe identitetit personal, të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së.

Kësisoj, padia synon të vendosë kufij të qartë ndërmjet kompetencës së legjislacionit për të rregulluar të drejtën për emër dhe kompetencës së ekzekutivit për të nxjerrë akte nënligjore, duke riafirmuar parimin se normat nënligjore nuk mund të kufizojnë ose të deformojnë të drejtat e parashikuara nga ligji dhe Kushtetuta.

Vendimmarrja e gjykatës

Gjykata Supreme, pasi ka shqyrtuar kërkesëpadinë e paditësit, ka vendosur:

Ta aprovojë si të themeltë kërkesëpadinë, duke pranuar se pretendimet e ngritura janë të bazuara në ligj dhe në prova juridike.

Të shpallë të paligjshëm dhe të shfuqizojë nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 të MPB-së, i cili rregullonte kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korrigjimit të emrit personal.

Ky vendim ka efekt **konstitutiv**: nga momenti i shpalljes, ashtu qe neni i shfuqizuar nuk mund të prodhojë më pasoja juridike, duke eliminuar nga rendi juridik një normë që ishte e kundërligjshme.

2.1 Parimi i ligjshmërisë dhe hierarkia e normave

Sipas nenit 16 të Kushtetutës, **ligji është akti i vetëm që mund të vendosë kufizime mbi të drejtat dhe liritë e individit.** Udhëzimet administrative, si akte nënligjore, mund të nxirren vetëm për zbatimin e ligjit, pa tejkaluar ose ndryshuar përmbajtjen e tij. Gjykata ka konstatuar se **neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 ka vendosur kufizime të reja për ndërrimin e emrit personal,** të cilat nuk janë të parashikuara në **Ligjin Nr. 02/L-118 për Emrin Personal**. Me këtë, MPB ka vepruar përtej autorizimit që i jep ligji, duke cenuar parimin e ligjshmërisë.

2.2 Respektimi i të drejtave kushtetuese

Gjykata ka theksuar se **e drejta për emër personal** është pjesë e **identitetit individual dhe integritetit personal,** e mbrojtur me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 8 të **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).** Çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të jetë:

- I paraparë me ligj,
- I nevojshëm në një shoqëri demokratike, dhe
- Proporcional me qëllimin e mbrojtjes së interesit publik.

Duke qenë se kufizimi i parashikuar në nenin 6 të UA-së nuk mbështetej në ligj, ai përbënte **ndërhyrje joproporcionale dhe të paligjshme** në të drejtën e individit për identitet personal.

c) Kompetenca e Gjykatës Supreme në kontrollin e akteve nënligjore

Në kuptim të **Ligjit për Konfliktin Administrativ (2025)**, gjykata ka kompetencë të shqyrtojë aktet nënligjore dhe të shpallë të paligjshme ato që bien ndesh me ligjin ose Kushtetutën. Me këtë rast, Gjykata Supreme ka ushtruar rolin e saj si **garantuese e ligjshmërisë së akteve të**

administratës publike, duke kontrolluar ekzekutivin dhe duke parandaluar tejkalimin e kompetencave të tij.

Rëndësia e vendimmarrjes

Ky vendim i Gjykatës Supreme ka disa pasoja me peshë juridike dhe shoqërore:

Forcimi i parimit të shtetit të së drejtës – duke riafirmuar se organet e administratës publike nuk mund të krijojnë kufizime të reja për të drejtat e individit përmes udhëzimeve administrative.

Mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut – vendimi siguron që individët të kenë qasje të pakufizuar dhe të drejtë në realizimin e së drejtës për emër personal, pa u përballur me kufizime të pajustifikuara.

Vendosja e standardit të kontrollit gjyqësor mbi aktet nënligjore – ky aktgjykim shërben si precedent se gjykatat mund dhe duhet të ndërhyjnë kur ekzekutivi tejkalon kompetencat e tij, duke garantuar balancën ndërmjet pushteteve.

Efekti normativ i përgjithshëm – për shkak të natyrës së tij, vendimi nuk ka pasoja vetëm për paditësin, por për të gjithë qytetarët që mund të preken nga akti i shfuqizuar.

Vendimi i Gjykatës Supreme për të shfuqizuar nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 është një vendimmarrje e arsyetuar në mënyrë të qartë juridike, që mbështetet në:

Parimin e ligjshmërisë dhe hierarkisë së normave (aktet nënligjore nuk mund të cenojnë ligjin),

Mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ndërkombëtare (e drejta për emër si pjesë e identitetit personal), dhe

Rolin e gjykatave në kontrollin e ligjshmërisë së administratës publike.

Ky vendim përbën një shembull të rëndësishëm të praktikës gjyqësore në Kosovë për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e të drejtave themelore

Arsyetimi i vendimit

Arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme është i ndërtuar mbi parimin themelor të **hierarkisë së normave juridike** dhe mbi mbrojtjen e **të drejtave themelore të individit**, duke vënë në qendër faktin se **akti nënligjor (Udhëzimi Administrativ)** nuk mund të shkojë përtej kufijve të përcaktuar nga ligji dhe se çdo kufizim mbi të drejtat individuale duhet të jetë në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare.

2. Arsyetimi mbi konfliktin normativ

Gjykata ka konstatuar se neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2015 bie ndesh me:

Ligjin Nr. 02/L-118 për Emrin Personal, i cili në nenet 17 dhe 18 ka përcaktuar në mënyrë të plotë procedurën dhe pengesat për ndërrimin e emrit. Udhëzimi ka shtuar kufizime të tjera, duke dalë jashtë fushës së autorizimit që i jep ligji.

Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22, që garanton aplikimin e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit aktet nënligjore mund të nxirren vetëm për zbatimin e ligjit dhe nuk mund të krijojnë kufizime të reja.

Ky arsyetim tregon se gjykata ka bërë **një analizë të qartë të hierarkisë normative,** duke theksuar se ligji dhe Kushtetuta kanë përparësi ndaj çdo akti nënligjor.

3. Arsyetimi mbi të drejtat themelore

Gjykata ka vënë në qendër **të drejtën e individit për emër personal** si pjesë e **identitetit personal dhe integritetit privat.** Në këtë drejtim, ka argumentuar se kufizimet e parashikuara nga neni 6 i UA-së:

Cenojnë të drejtën e vetë përcaktimit – individi ka autonomi në zgjedhjen e emrit, si element i identitetit të tij.

Nuk janë të justifikuara – mungon një bazë ligjore dhe kushtetuese që t'i mbështesë ato kufizime.

Nuk kalojnë testin e proporcionalitetit – kufizimi nuk është as i nevojshëm, as i arsyeshëm për mbrojtjen e ndonjë interesi publik legjitim.

Ky arsyetim lidhet ngushtë me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku emri trajtohet si një element thelbësor i së drejtës për **respektimin e jetës private** sipas nenit 8 të KEDNJ-së.

4. Mbështetja në jurisprudencën ndërkombëtare

Gjykata Supreme ka përforcuar arsyetimin e saj duke iu referuar **praktikës së GJEDNJ-së,** duke marrë si shembull:

Çështja Güzel Erdagöz kundër Turqisë (2008) – ku u konstatuan kufizime disproporcionale mbi ndryshimin e emrit, që shkelën nenin 8 të KEDNJ-së.

Çështja Burghartz kundër Zvicrës (1994) – ku u theksua se emri i një personi është element esencial i identitetit të tij personal.

Përdorimi i këtyre rasteve tregon se Gjykata Supreme ka ndërtuar arsyetimin në harmoni me **standardet ndërkombëtare**, duke e vendosur Kosovën në linjë me praktikat evropiane të mbrojtjes së të drejtave themelore. Ky është një element me vlerë të shtuar, sepse shfaq gjykatën jo vetëm si interpretuese të së drejtës vendore, por si garantuese të harmonizimit të saj me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

5. Vlerësimi mbi parimin e proporcionalitetit

Një shtyllë e fortë e arsyetimit është **parimi i proporcionalitetit**. Gjykata ka analizuar nëse kufizimi i parashikuar nga neni 6 i UA-së:

Ka bazë ligjore,

Ndjek një qëllim legjitim,

Është i nevojshëm dhe i përshtatshëm për arritjen e atij qëllimi.

Përfundimi ka qenë se kufizimi nuk përmbush asnjërën nga këto kritere, prandaj është i pajustifikuar. Kjo tregon një qasje moderne të arsyetimit gjyqësor, të ndërtuar mbi **balancimin midis interesit publik dhe të drejtave individuale.**

6. Dimensioni krahasimor dhe efekti normativ

Gjykata ka vënë në dukje se edhe **praktika e shteteve evropiane** e refuzon vendosjen e kufizimeve të tilla për ndërrimin e emrit. Kjo përforcon bindjen se rregullimi i bërë nga UA Nr. 19/2015 nuk përputhet

as me standardet rajonale e as me ato evropiane. Efekti i vendimit është **normativ dhe i përgjithshëm:** me shfuqizimin e nenit 6, ky akt nuk prodhon më pasoja juridike për askënd, duke garantuar se asnjë qytetar nuk do të pengohet në ushtrimin e së drejtës së tij për ndërrimin e emrit mbi bazën e kufizimeve të paligjshme.

7. Përmbledhje kritike

Arsyetimi i Gjykatës Supreme është i artikuluar dhe bindës sepse:

- respekton **hierarkinë e normave,**
- mbron **të drejtat themelore të individit,**
- zbaton **parimin e proporcionalitetit,**
- mbështetet në **jurisprudencën ndërkombëtare** dhe në praktikat krahasimore,
- siguron **efekt të përgjithshëm normativ** në rendin juridik të Kosovës.

Ky arsyetim është shembull i **jurisprudencës moderne kushtetuese dhe administrative**, ku gjykata nuk mjaftohet me konstimin formal të paligjshmërisë, por ndërton një analizë të thellë mbi **të drejtën për identitet dhe autonomi personale**, duke e vendosur këtë të drejtë në qendër të shtetit të së drejtës.

Efektet dhe pasojat e aktgjykimit të Gjykatës Supreme

1. Efektet në rendin juridik të brendshëm

Shfuqizimi i nenit 6 të Udhëzimit Administrativ: Me këtë vendim, ky nen pushon së prodhuari efekte juridike, pra nuk mund të zbatohet më nga organet administrative. Në praktikë, kjo do të thotë se qytetarët që kërkojnë ndërrim ose korrigjim të emrit nuk mund të kufizohen nga kriteret shtesë të vendosura në këtë nen.

Forcimi i parimit të hierarkisë normative: Gjykata Supreme ka theksuar se një akt nënligjor (Udhëzim Administrativ) nuk mund të krijojë kufizime shtesë përtej atyre që janë paraparë me ligj. Ky efekt është i rëndësishëm sepse u jep organeve të administratës një sinjal të

qartë: **kompetencat e tyre janë të kufizuara dhe të lidhura ngushtë me ligjin.**

Sigurimi i qasjes më të gjerë për qytetarët: Pas shfuqizimit të nenit 6, qytetarët e Kosovës kanë një qasje më të lirë dhe më të drejtpërdrejtë për të realizuar të drejtën e ndërrimit të emrit personal, pa barriera administrative të panevojshme.

2. Efektet mbi të drejtat themelore të individëve

Forcimi i të drejtës për identitet personal: Vendimi riafirmon se emri është pjesë thelbësore e identitetit personal dhe gëzon mbrojtje kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Zbatimi i drejtpërdrejtë i KEDNJ-së: Duke u mbështetur në nenin 22 të Kushtetutës, Gjykata Supreme ka konfirmuar se standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Ky është një hap i rëndësishëm në konsolidimin e praktikës gjyqësore të orientuar drejt mbrojtjes së të drejtave themelore.

Reduktimi i ndërhyrjes arbitrare të shtetit: Vendimi i Gjykatës eliminon një kufizim disproporcional dhe i vendos kufijtë qartë ndërhyrjes shtetërore në sferën private të individit.

3. Pasojat institucionale dhe praktike për administratën publike

Rishikimi i praktikave administrative: MPB dhe organet e tjera përgjegjëse duhet të përshtatin praktikat e tyre të brendshme me këtë vendim, duke hequr çdo referencë ndaj nenit të shfuqizuar.

Nevoja për harmonizim të akteve nënligjore: Pas këtij vendimi, MPB duhet të rishikojë të gjithë Udhëzimin Administrativ për të siguruar që asnjë dispozitë tjetër nuk bie ndesh me ligjin për emrin personal ose me Kushtetutën.

Krijimi i një precedenti administrativ: Ky vendim pritet të ndikojë edhe në raste të tjera ku aktet nënligjore tejkalojnë ligjin. Organet e administratës do të jenë më të kujdesshme në nxjerrjen e udhëzimeve administrative.

4. Pasojat në sistemin gjyqësor

Konsolidimi i jurisprudencës: Gjykata Supreme ka vendosur një standard të ri interpretues, duke u bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së (p.sh. rastet *Güzel Erdagöz kundër Turqisë* dhe *Burghartz kundër Zvicrës*). Kjo nxit uniformitet në vendimet gjyqësore të ardhshme.

Nxitja e kontrollit gjyqësor mbi aktet administrative: Vendimi thekson rolin e gjykatave në mbrojtjen e qytetarëve nga kufizimet e pajustifikuara të organeve administrative.

5. Pasojat shoqërore dhe politike

Rritja e besimit të qytetarëve në gjyqësor: Vendimi është një shembull i drejtpërdrejtë i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut nga ana e gjykatave.

Forcimi i kulturës juridike mbi të drejtat e njeriut: Ky rast i mëson shoqërisë se identiteti personal, përfshirë të drejtën për emër, është një e drejtë themelore dhe e mbrojtur fuqishëm.

Kufizimi i mundësive për abuzim administrativ: Me këtë vendim, Gjykata ka dhënë një sinjal të fortë se nuk toleron kufizime të panevojshme apo të paarsyeshme ndaj lirive qytetare.

Kapitulli VII: Komente përmbledhëse dhe rekomandime

7.1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Nga analiza e bërë, del qartë se shqyrtimi gjyqësor i akteve normative përfaqëson një mjet thelbësor dhe strategjik të mbrojtjes së rendit juridik dhe të sundimit të ligjit. Ky mekanizëm siguron që individët dhe subjekte të ndryshme të mos jenë të detyruar të respektojnë akte nënligjore të paligjshme, duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe duke shmangur veprimet arbitrare të autoriteteve administrative.

Kjo praktikë funksionon si një kontroll efektiv mbi organet publike, duke siguruar që çdo vendim administrativ dhe çdo akt normativ nënligjorë të qëndrojë brenda kornizës ligjore dhe kushtetuese dhe duke garantuar përgjegjësinë e institucioneve për çdo veprim të kryer.

Përveç funksionit të menjëhershëm korrigjues, kjo qasje gjyqësore krijon precedentë të rëndësishëm për praktikën e ardhshme, duke fuqizuar rolin e gjyqësorit në ruajtjen e rendit juridik dhe në forcimin e besimit publik në sistemin ligjor. Gjithashtu, shqyrtimi i akteve normative ripohon hierarkinë e akteve juridike, duke riafirmuar se aktet nënligjore nuk mund të kundërshtojnë ose tejkalojnë ligjet dhe dispozitat kushtetuese.

Në këtë mënyrë, analiza tregon qartë se shqyrtimi gjyqësor i akteve normative nuk është vetëm një mekanizëm mbrojtës për individët, por edhe një instrument institucional që siguron funksionimin ligjor, të drejtë dhe të qëndrueshëm të administratës publike. Për më tepër, ai forcon parimet e transparencës, llogaridhënies dhe sigurisë juridike, duke e bërë të qartë se çdo akt i paligjshëm mund të korrigjohet përmes mekanizmave të kontrollit gjyqësor.

7.2. Vlerësimi i sistemit aktual në Kosovë

Sistemi juridik i Kosovës, në kontekstin e shqyrtimit të akteve normative, reflekton harmonizim me praktikat më të avancuara evropiane, duke vendosur standarde për transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit.

Një nder sfidat lidhet me veprimet e administratës publike, e cila herë pas here nxjerr **akte nënligjore pa respektuar kufijtë ligjorë** dhe procedurat e parashikuara nga ligji. Kjo situatë thekson rëndësinë e kontrollit gjyqësor si një mekanizëm korrigjues, i cili siguron që çdo akt nenligjore të jetë në përputhje me ligjin dhe të mos cenojë të drejtat themelore të individëve.

Në këtë kontekst, analiza tregon se ndërsa struktura institucionale e Kosovës është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe siguron një ndarje të qartë të kompetencave, **sfida kryesore mbetet konsolidimi i praktikës gjyqësore dhe forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit dhe administratës publike** për të zbatuar rregullat ligjore me qartësi dhe efikasitet. Pa këtë harmonizim praktik, edhe mekanizmat më të avancuar juridikë mund të jenë të kufizuar në ndikimin e tyre real.

7.3. Rekomandime për gjykatat

Bazuar në analizën e praktikës gjyqësore dhe të sistemit aktual të kontrollit të akteve normative në Kosovë, mund të formulohen disa rekomandime të qarta për përmirësimin e efikasitetit dhe funksionimit të gjyqësorit në këtë fushë:

Forcimi i rolit të shqyrtimit incidental – Gjykatat e rregullta duhet të adoptojnë një qëndrim më aktiv dhe të guximshëm në refuzimin e zbatimit të akteve normative të paligjshme. Ky veprim nuk synon të shkelë kompetencat e tjera institucionale, por përkundrazi të sigurojë që çdo veprim administrativ të jetë në përputhje të plotë me ligjin. Një qasje e tillë forcon funksionin korrigjues të gjyqësorit, garanton mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve dhe kontribuon në ruajtjen e legjitimitetit të sistemit administrativ.

Unifikimi i praktikës gjyqësore – Për të shmangur interpretimet të ndryshme të ligjit ndërmjet gjykatave të niveleve të ndryshme, Gjykata Supreme duhet të ushtrojë një rol më të madh në dhënien e udhëzimeve dhe vendimeve unifikuese. Një praktikë e unifikuar siguron stabilitet juridik, qartësi në aplikim dhe besim më të madh të publikut në sistemin gjyqësor, duke minimizuar pasigurinë dhe arbitraritetin në vendimmarrje.

Referimi më i shpeshtë në standardet evropiane – Gjyqtarët duhet të përdorin më gjerësisht jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës Evropiane për Drejtësinë (GJDBE), duke e integruar atë në arsyetimet e tyre. Kjo praktikë jo vetëm që fuqizon argumentimin juridik, por gjithashtu rrit harmonizimin e praktikës gjyqësore të Kosovës me standardet ndërkombëtare dhe kontribuon në zhvillimin e një jurisprudence të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

Trajnimi i gjyqtarëve – Për të përballuar sfidat e zbatimit të ligjit dhe për të siguruar vendimmarrje të saktë, kërkohet trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve në fushën e së drejtës administrative, konfliktit administrativ dhe së drejtës evropiane. Trajnimi profesional i përhershëm rrit kapacitetin e gjyqtarëve për të interpretuar ligjin me korrektësi, për të identifikuar shkeljet e akteve normative dhe për të dhënë vendime të bazuara në standarde të larta juridike.

Në përmbledhje, këto rekomandime synojnë të forcojnë funksionin mbikëqyrës dhe korrigjues të gjyqësorit në raport me aktet normative, të sigurojnë një praktikë gjyqësore të qëndrueshme dhe të harmonizuar, dhe të rrisin nivelin e besimit të publikut në legjitimitetin dhe efikasitetin e sistemit juridik në Kosovë.

7.4. Rekomandime për administratën publike

Analiza e praktikës aktuale në Kosovë tregon se për të garantuar ligjshmërinë dhe efektivitetin e aktet nënligjore, duhet të respektohen disa parime kyçe. Këto parime synojnë të rrisin transparencën, përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve normative:

Respektimi i kufijve ligjorë – Organet publike nuk duhet të nxjerrin akte normative pa autorizim të qartë ligjor. Kjo masë parandalon shkeljen e hierarkisë normative dhe siguron që çdo akt i lëshuar të ketë bazë të fortë juridike. Respektimi i kufijve ligjorë është themelor për ruajtjen e legjitimitetit të veprimeve administrative dhe për shmangien e konflikteve të mundshme ligjore.

Transparencë dhe publikim – Çdo akt normativ duhet të publikohet në mënyrë të rregullt dhe të qartë në Gazetën Zyrtare. Publikimi zyrtar garanton njohjen nga qytetarët dhe subjekte të ndryshme, duke krijuar mundësi për kontroll dhe verifikim publik. Kjo praktikë forcon parimin e llogaridhënies dhe rrit besimin në institucionet shtetërore.

Analizë e ndikimit – Para nxjerrjes së çdo akti normativ, duhet të kryhet një analizë e thelluar e ndikimit të tij mbi të drejtat dhe interesat e qytetarëve. Analiza e ndikimit lejon identifikimin e pasojave të mundshme sociale, ekonomike dhe juridike, duke minimizuar rrezikun e vendimeve arbitrare ose të dëmshme. Ky instrument është i rëndësishëm për një legjislacion të qëndrueshëm dhe efektiv.

Përfshirja e konsultimeve publike – Procesi i hartimit të akteve normative duhet të sigurojë pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile, ekspertëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Konsultimet publike mundësojnë një dialog konstruktiv dhe rrisin cilësinë e legjislacionit,

duke reflektuar më mirë nevojat reale të shoqërisë dhe duke shmangur vendime të nxituara ose të papërshtatshme.

Në përmbledhje, zbatimi i këtyre parimeve nuk përbën vetëm një obligim formal, por është një instrument strategjik për forcimin e sundimit të ligjit dhe krijimin e një administrate publike të përgjegjshme, transparente dhe të drejtë. Kjo qasje kontribuon gjithashtu në zhvillimin e një jurisprudence të qëndrueshme dhe në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve.

7.5. Rëndësia e harmonizimit me standardet evropiane

Harmonizimi i sistemit juridik të Kosovës me standardet evropiane përbën një kërkesë themelore në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, duke pasur si qëllim kryesor forcimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave themelore. Praktika gjyqësore evropiane, e udhëhequr nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJDBE), ofron udhëzime të qarta mbi mënyrën e interpretimit të ligjit, parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Në këtë kontekst, harmonizimi ka disa implikime të rëndësishme:

Forcimi i kontrollit incidental – Gjykatat e rregullta duhet të ushtrojnë me vendosmëri kompetencën e tyre për të refuzuar zbatimin e akteve normative të paligjshme. Kjo praktikë siguron që çdo veprim i administratës publike të jetë në përputhje me ligjin themelor dhe me standardet ndërkombëtare, duke garantuar respektimin e të drejtave themelore të qytetarëve.

Përmirësimi i praktikës gjyqësore – Aplikimi i standardeve evropiane ndihmon në krijimin e një jurisprudence të qëndrueshme dhe të parashikueshme. Gjyqtarët, duke iu referuar praktikës së GJEDNJ dhe GJDBE, mund të zhvillojnë arsyetim juridik më të thelluar dhe të ofrojnë vendime që nuk janë vetëm të bazuara në ligjin e brendshëm, por që pasqyrojnë gjithashtu parimet e harmonizuara ndërkombëtarisht.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike – Respektimi i standardeve evropiane nënkupton publikim të qartë të akteve normative, konsultim të shoqërisë civile dhe analiza të ndikimit para miratimit të çdo akti. Kjo praktikë parandalon arbitraritetin dhe rrit besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.

Konsolidimi i besueshmërisë së sistemit juridik – Përputhshmëria me standardet evropiane krijon një bazë të fortë për sigurinë juridike dhe stabilitetin institucional. Ajo siguron që vendimet e organeve publike të jenë të ligjshme, transparente dhe të mbështetura në praktika të miratuara ndërkombëtarisht, duke forcuar kështu autoritetin dhe besueshmërinë e gjyqësorit në sytë e qytetarëve dhe të partnerëve ndërkombëtarë.

Në përmbledhje, harmonizimi me standardet evropiane nuk është vetëm një kërkesë teknike, por një element thelbësor për ndërtimin e një sistemi juridik të qëndrueshëm, transparent dhe funksional në Kosovë. Ai siguron respektimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave themelore dhe krijimin e një precedent të qëndrueshëm për zhvillimin e jurisprudencës dhe praktikës institucionale.

Gjykata Supreme e Kosovës Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re"

Prishtinë

T1: +383 (0) 38/200 18775

T1: +383 (0) 38/200 18779

Email: gjykatasupreme@rks-gov-net